Ky projekt është i bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian

PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Co-funded by the European Union

EUIVJUSTICE

Implemented by:

ITALIAN AGENCY FOR DEVELOPMENT COOPERATION

CSM Consiglio Superiore della Magistratura

In partnership with:

EXPERTISE FRANCE GROUPE AFD

FIIAPP COOPERACIÓN ESPAÑOLA

Co-funded by the European Union
EUIVJUSTICE
Implemented by:
ITALIAN AGENCY FOR DEVELOPMENT COOPERATION
CSM Consiglio Superiore della Magistratura
In partnership with:
EXPERTISE FRANCE GROUPE AFD
FIIAPP COOPERACIÓN ESPAÑOLA

Përmbledhje e Legjislacionit të Sistemit të Drejtësisë

Mars, 2025

Design & Layout: Jonida Hoxha

Shtypur në shtypshkronjën MORAVA

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se 'Përmbledhja e Ligjeve të Sistemit të Drejtësisë' përmban tekstin e Kushtetutës si dhe disa tekste ligjesh që lidhen me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, institucioneve të qeverisjes së drejtësisë, gjykatave dhe prokurorive, si dhe ligje që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Tekstet e ligjeve janë konsoliduar nga ekspertët e Projektit EU4JUSTICE.

Tekstet e konsoliduara përbëjnë një dokument jozyrtar dhe synojnë të përdoren si mjete dokumentimi. EU4JUSTICE nuk merr asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e tyre. Ato nuk japin asnjë të drejtë dhe nuk vendosin asnjë detyrim përveç atyre që jepen ose vendosen nga legjislacioni i miratuar dhe i botuar në Fletoren Zyrtare. Për qëllime ligjore, jeni të lutur t'u referoheni teksteve të botuara në Fletoren Zyrtare.

EUIVJUSTICE

Rruga "Abdi Toptani",

Godina Torre Drin, Kati i 10-të, Tiranë

E-mail: info@eu4justice.al

Web: www.eu4justice.al

P Ë R M B A J T J A

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 5

Ligj nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" 85

Ligj nr. 98/2016 "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" 137

Ligj nr. 115/2016 "Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë 198

Ligj nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë 409

Ligj nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 548

Ligj nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë 611

Ligj nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë 694

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË*

Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit,

vendosim këtë Kushtetutë:

PJESA E PARË
PARIME THEMELORE

Neni 1

1. Shqipëria është republikë parlamentare.

2. Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm.

3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.

Neni 2

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.

2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.

---

* Miratuar me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;
Ndryshuar me Ligjin nr. 9675, datë 13.01.2007;
Ndryshuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008;
Ndryshuar me Ligjin nr. 88, datë 18.09.2012;
Ndryshuar me Ligjin nr. 137, datë 17.12.2015;
Ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016;
Ndryshuar me Ligjin nr. 115, datë 30.07.2020;
Ndryshuar me Ligjin nr. 16, datë 10.2.2022

3. Për ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtarë, Republika e Shqipërisëmund të marrë pjesë në një sistem sigurimi kolektiv, në bazë të një ligji të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 3

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

Neni 4

1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.

3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Neni 5

Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

Neni 6

Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

Neni 6/1
(shtuar me Ligjin nr. 137, datë 17.12.2015, neni 1)

Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 7

Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Neni 8

1. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj.

2. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet.

3. Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.

Neni 9

1. Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.

2. Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara sipas ligjit.

3. Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.

Neni 10

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare.

2. Shteti është asnjanës në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike.

3. Shteti njeh barazinë e bashkësive fetare.

4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve.

5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend.

6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Neni 11

1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

2. Prona private dhe publike mbrohen njëlloj me ligj.

3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.

Neni 12

1. Forcat e armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues.

2. Forcat e armatosura ruajnë asnjanësinë në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil.

3. Asnjë forcë e huaj ushtarake nuk mund të vendoset dhe as të kalojë në territorin shqiptar, si dhe asnjë forcë ushtarake shqiptare nuk mund të dërgohet jashtë, përveçse me një ligj të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 13

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.

Neni 14

1. Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja.

2. Flamuri kombëtar është i kuq me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes.

3. Stema e Republikës së Shqipërisë paraqet një shqyt me fushë të kuqe me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes. Në krye të shqytit, me ngjyrë të artë, është vendosur përkrenarja e Skënderbeut.

4. Himni kombëtar është "Rreth Flamurit të Përbashkuar".

5. Festa Kombëtare e Republikës së Shqipërisë është Dita e Flamurit, 28 Nëntori.

6. Kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë është Tirana.

7. Forma dhe përmasat e simboleve kombëtare, përmbajtja e tekstit të himnit kombëtar, si dhe përdorimi i tyre rregullohen me ligj.

PJESA E DYTË
TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore te njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.

2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara ne Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 19

1. Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj.

2. Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj.

Neni 20

1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.

2. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

KREU II
LIRITË DHE TË DREJTAT VETJAKE

Neni 21

Jeta e personit mbrohet me ligj.

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.

2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.

3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.

4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.

Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.

2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.

2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.

3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

Neni 25

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 26

Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.

Neni 27

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:

a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;

b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;

d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

Neni 28

1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.

2. Personi, të cilit i është hequr liria sipas Nenit 27, paragrafi 2, nën-paragrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.

3. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

4. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë

jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

5. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas Nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

Neni 29

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.

3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

Neni 30

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 31

Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 32

1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.

2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 33

1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.

2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

Neni 34

Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

Neni 35

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.

2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

Neni 36

Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara.

Neni 37

1. Paprekshmëria e banesës është e garantuar.

2. Kontrollet e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj.

3. Askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjanuar një rrezik që i kanoset sigurimit publik.

Neni 38

1. Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit.

2. Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit.

Neni 39

1. Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të dëbohet nga territori i shtetit.

2. Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor.

3. Ndalohet dëbimi kolektiv i të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj.

Neni 40

Të huajt kanë të drejtën e strehimit në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit.

Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 42

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij

kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 43

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 1)

Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

Neni 44

Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

KREU III
LIRITË DHE TË DREJTAT POLITIKE

Neni 45

(paragrafi 3 ndryshuar me Ligjin nr. 137, datë 17.12.2015, neni 2)

1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.

2. Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht.

3. Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim me vendim përfundimtar të formës së prerë për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cënim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.

4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

Neni 46

1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.

2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.

3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.

Neni 47

1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.

2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Neni 48

Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

KREU IV
LIRITË DHE TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

Neni 49

1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.

2. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.

Neni 50

Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës.

Neni 51

1. E drejta e të punësuarit për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e

punës, është e garantuar.

2. Kufizime për kategori të veçanta të punësuarish mund të vendosen me ligj për t'i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.

Neni 52

1. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.

2. Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj.

Neni 53

1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.

2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.

3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.

Neni 54

1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa.

3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

Neni 55

1. Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

2. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.

Neni 56

Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij.

Neni 57

1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.

2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.

3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.

4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.

5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.

7. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.

Neni 58

1. Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë.

2. E drejta e autorit mbrohet me ligj.

KREU V
OBJEKTIVAT SOCIALE

Neni 59

1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;

b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;

c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;

ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;

d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për

brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

2. Përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.

KREU VI
AVOKATI I POPULLIT

Neni 60

1. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij.

3. Avokati i Popullit ka buxhet të veçantë, të cilin e administron vetë. Ai e propozon buxhetin sipas ligjit.

Neni 61

1. Avokati i Popullit zgjidhet nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Avokati i Popullit mund të jetë çdo shtetas shqiptar, me arsim të lartë, me njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit.

3. Avokati i Popullit gëzon imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Avokati i Popullit nuk mund të bëjë pjesë në asnjë parti politike, nuk

mund të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale dhe as të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare.

Neni 62

1. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesë të motivuar të jo më pak se një së tretës së deputetëve.

2. Në këtë rast Kuvendi vendos me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 63

1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit.

2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme.

3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

4. Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij.

PJESA E TRETË
KUVENDI

KREU I
ZGJEDHJA DHE AFATI

Neni 64
(ndryshuar me Ligjin nr. 115/2020, datë 30.07.2020, neni 1)

1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar.

2. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar.

3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e

sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.

Neni 65

(ndryshuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008, neni 2)

1. Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë. Në çdo rast, Kuvendi qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur.

2. Zgjedhjet për Kuvendin e ri zhvillohen në periudhën zgjedhore më të afërt që i paraprin datës së përfundimit të mandatit të Kuvendit. Periudhat zgjedhore dhe rregullat për thirrjen e zgjedhjeve për Kuvendin përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

3. Në rast shpërndarjeje të Kuvendit para përfundimit të mandatit të plotë, zgjedhjet thirren jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së tij.

4. Kuvendi nuk mund të nxjerrë ligje gjatë periudhës 60 ditë para mbarimit të mandatit të tij deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri, me përjashtim të rasteve të vendosjes së masave të jashtëzakonshme.

Neni 66

Mandati i Kuvendit zgjatet vetëm në rast lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo. Kur Kuvendi është i shpërndarë, ai rithirret vetiu.

Neni 67

(ndryshuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008, neni 3)

1. Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë se data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

2. Në rast se Presidenti i Republikës nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi vetëmblidhet në ditën e dhjetë të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij Neni.

KREU II
DEPUTETËT

Neni 68
(paragrafi 1 ndryshuar me Ligjin nr. 115/2020, datë 30.07.2020, neni 2)
(paragrafi 2 ndryshuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008, neni 4)

1. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

2. Në ligjin për zgjedhjet përcaktohen edhe kritere dhe rregulla të tjera të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë ato për regjistrimin e zgjedhësve, zhvillimin e fushatës zgjedhore, administrimin, vlefshmërinë e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultateve të tyre.

Neni 69

1. Nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputetë, pa hequr dorë nga detyra:

a) gjyqtarët, prokurorët;

b) ushtarakët e shërbimit aktiv;

c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar;

ç) përfaqësuesit diplomatikë;

d) kryetarët e bashkive dhe të komunave, si dhe prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre;

dh) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve;

e) Presidenti i Republikës dhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të parashikuar nga ligji.

2. Mandati i fituar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij Neni është i pavlefshëm.

Neni 70

1. Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues.

2. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër

shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj.

3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre.

4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij Neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.

Neni 71

1. Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve.

2. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit:

a) kur ai nuk bën betimin;

b) kur heq dorë nga mandati;

c) kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 69, 70 paragrafët 2 dhe 3;

ç) kur mbaron mandati i Kuvendit;

d) kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend;

dh) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 72

Para fillimit të ushtrimit të mandatit deputetët bëjnë betimin në Kuvend.

Neni 73

(ndryshuar me Ligjin nr. 88, datë 18.09.2012, neni 1)
(paragrafi 3 ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 2)

1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.

2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.

3. Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës.

4. Për çështjet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij Neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur.

KREU III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 74

1. Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione. Sesioni i parë fillon të hënën e tretë të janarit dhe sesioni i dytë të hënën e parë të shtatorit.

2. Kuvendi mblidhet në sesion të jashtëzakonshëm, kur kërkohet nga Presidenti i Republikës, nga Kryeministri ose nga një e pesta e të gjithë deputetëve.

3. Sesionet e jashtëzakonshme thirren nga Kryetari i Kuvendit në bazë të një rendi dite të përcaktuar.

Neni 75

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet.

2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.

Neni 76

1. Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët.

2. Nëpunësi më i lartë civil i Kuvendit është sekretari i përgjithshëm.

3. Shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Kuvendit kryhen nga nëpunës të tjerë, siç përcaktohet në rregulloren e brendshme.

Neni 77

1. Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme.

2. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore.

3. Komisionet e hetimit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.

Neni 78

1. Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.

2. Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.

Neni 79

1. Mbledhjet e Kuvendit bëhen të hapura.

2. Me kërkesën e Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një së pestës së deputetëve mbledhjet e Kuvendit mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar shumica e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 80

1. Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet interpelancave dhe pyetjeve të deputetëve brenda tri javëve.

2. Anëtari i Këshillit të Ministrave ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit ose të komisioneve të tij; atij i jepet fjala sa herë që e kërkon.

3. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji.

KREU IV
PROCESI LIGJVËNËS

Neni 81

1. Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.

2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:

a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta;

b) ligji për shtetësinë;

c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore;

ç) ligji për referendumet;

d) kodet;

dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme;

e) ligji për statusin e funksionarëve publikë;

ë) ligji për amnistinë;

f) ligji për ndarjen administrative të Republikës.

Neni 82

1. Propozimi i ligjeve, kur është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij.

2. Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit.

3. Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme.

Neni 83

1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nen për nen dhe në tërësi.

2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj

me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.

3. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në Nenin 81 paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit dh.

Neni 84

1. Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

2. Ligji quhet i shpallur, në qoftë se Presidenti i Republikës nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij Neni dhe në paragrafin 1 të Nenit 85.

3. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

4. Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevoje e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.

2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

PJESA E KATËRT
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Neni 86

1. Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit.

2. President mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.

Neni 87

(ndryshuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008, neni 5)

1. Kandidati për President i propozohet Kuvendit nga një grup prej jo më pak se 20 deputetësh. Një deputet nuk lejohet të propozojë në të njëjtën kohë më shumë se një kandidat.

2. Presidenti i Republikës zgjidhet me votim të fshehtë dhe pa debat nga Kuvendi. Për zgjedhjen e Presidentit, Kuvendi zhvillon deri në pesë votime.

Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit. Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës. Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat. Në votimin e dytë, të tretë dhe të katërt mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij Neni.

3. Presidenti zgjidhet në votimin e parë, të dytë ose të tretë kur një kandidat merr jo më pak se tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në votimin e katërt dhe të pestë zgjidhet President kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

4. Votimi i pestë zhvillohet kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votim caktohet me short.

Në rast se pas votimit të katërt nuk ka mbetur asnjë kandidat në konkurrim, për këtë votim mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij Neni. Kur paraqiten më shumë se dy kandidatë, votimi zhvillohet midis dy kandidatëve që kanë siguruar numrin më të lartë të deputetëve propozues.

5. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses nuk paraqitet asnjë kandidaturë e re, Kuvendi shpërndahet. Zgjedhjet e reja zhvillohen brenda 45 ditëve nga shpërndarja e tij.

6. Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 88

(ndryshuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008, neni 6)

1. Presidenti i Republikës, në çdo rast, zgjidhet për 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Mandati përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të pestë nga data e betimit si President i Republikës. Mandati i Presidentit zgjatet vetëm në kohë lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo.

2.1. Procedura për zgjedhjen e Presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit presidencial paraardhës. Kur mandati presidencial përfundon në gjashtë muajt që i paraprijnë fundit të mandatit të Kuvendit ekzistues, procedura për zgjedhjen e Presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit të Kuvendit.

3. Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim:

"*Betohem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t'i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar*." Presidenti mund të shtojë edhe: "*Zoti më ndihmoftë*!"

4. Presidenti që jep dorëheqjen para mbarimit të mandatit të vet, nuk mund të kandidojë në zgjedhjen presidenciale që bëhet pas dorëheqjes së tij.

Neni 89

Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private.

Neni 90

1. Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij.

2. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.

3. Vendimi i Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila, kur

vërteton fajësinë e Presidentit të Republikës, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 91

1. Kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij.

2. Në rast se Presidenti nuk mund të ushtrojë detyrën për më shumë se 60 ditë, Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga dita e vërtetimit të pamundësisë.

Neni 92

Presidenti ushtron edhe këto kompetenca:

a) i drejton mesazhe Kuvendit;

b) ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit;

c) jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit;

ç) jep dekorata e tituj nderi sipas ligjit;

d) jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit;

dh) me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare;

e) pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë;

ë) lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit;

f) me propozim të Kryeministrit, emëron drejtorin e shërbimit informativ të shtetit;

g) emëron Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit;

gj) cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve;

h) kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre.

Neni 93

Presidenti i Republikës, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr dekrete.

Neni 94

Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.

PJESA E PESTË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Neni 95

1. Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat.

2. Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore.

Neni 96

1. Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.

2. Në qoftë se Kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi, Presidenti emëron një Kryeministër të ri brenda 10 ditëve.

3. Në qoftë se edhe Kryeministri i emëruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 ditëve Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri.

4. Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin.

Neni 97

Kryeministri i emëruar sipas Nenit 96, Nenit 104 ose 105, i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të

Ministrave së bashku me përbërjen e tij.

Neni 98

1. Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve.

2. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi.

Neni 99

Para fillimit të detyrës, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës.

Neni 100

1. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore.

2. Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës.

3. Mbledhjet e Këshillit të Ministrave bëhen të mbyllura.

4. Aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme, kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe ministri propozues.

5. Këshilli i Ministrave nxjerr vendime dhe udhëzime.

Neni 101

Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Neni 102

1. Kryeministri:

a) përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij;

b) koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to;

c) siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

ç) bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit;

d) kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje.

2. Kryeministri zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave.

3. Kryeministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra.

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

Neni 103

1. Ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet.

2. Ministri nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe as të jetë drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse.

3. Anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit.

Neni 104

(ndryshuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008, neni 7)

1. Kryeministri ka të drejtë t'i paraqesë Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave. Në rast se mocioni i besimit votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kryeministri, brenda 48 orëve nga votimi i mocionit, i kërkon Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit.

2. Presidenti shpërndan Kuvendin brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Kërkesa për mocion besimi nuk mund të paraqitet gjatë periudhës së shqyrtimit të mocionit të mosbesimit, sipas Nenit 105.

3. Votimi i mocionit nuk mund të bëhet pa kaluar tri ditë nga paraqitja e tij.

Neni 105

(ndryshuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008, neni 8)

1. Një e pesta e deputetëve ka të drejtë të paraqesë për votim në Kuvend një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit në detyrë, duke propozuar një Kryeministër të ri.

2. Kuvendi mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit vetëm duke zgjedhur me votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij një Kryeministër të ri.

3. Presidenti i Republikës dekreton shkarkimin e Kryeministrit në detyrë dhe emërimin e Kryeministrit të zgjedhur jo më vonë se 10 ditë nga votimi i mocionit në Kuvend.

Neni 106

Kryeministri dhe ministrat janë të detyruar të qëndrojnë në detyrë deri në formimin e Këshillit të Ministrave pasardhës.

Neni 107

1. Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit.

2. Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

3. Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj.

PJESA E GJASHTË
QEVERISJA VENDORE

Neni 108

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.

2. Ndarjet administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë me parë mendimi i popullsisë që banon në to.

3. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore.

4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me Nenin 151 paragrafi 2.

Neni 109

(ndryshuar me Ligjin nr. 9675, datë 13.01.2007, neni 1)

1. Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

2. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

3. Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendorë dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse.

4. Organet e njësive të qeverisjes vendore kanë të drejtë të formojnë bashkime dhe institucione të përbashkëta me njëri-tjetrin për përfaqësimin e interesave të tyre, të bashkëpunojnë me njësitë vendore të vendeve të tjera, si dhe të përfaqësohen në organizatat ndërkombëtare të pushteteve vendore.

Neni 110

1. Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e sociale dhe të interesave të përbashkët.

2. Qarku është njësia ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore.

3. Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Bashkitë dhe komunat delegojnë anëtarë në këshillin e qarkut në përpjesëtim me popullsinë e tyre, por për çdo rast të paktën një anëtar. Kryetarët e komunave dhe të bashkive janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut. Anëtarët e tjerë të tij zgjidhen me lista përpjesëtimore ndër këshilltarët bashkiakë ose komunalë nga këshillat përkatës.

4. Këshilli i qarkut ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese të përgjithshme për qarkun.

Neni 111

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë.

2. Njësitë e qeverisjes vendore kanë buxhet të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj.

Neni 112

1. Njësive të qeverisjes vendore mund t'u delegohen me ligj kompetenca të administratës shtetërore. Shpenzimet që kryhen për ushtrimin e delegimit, përballohen nga shteti.

2. Organeve të qeverisjes vendore mund t'u vihen detyrime vetëm në përputhje me ligjin ose sipas marrëveshjeve që ato lidhin. Shpenzimet që lidhen me detyrimet që u vihen me ligj organeve të qeverisjes vendore përballohen nga buxheti i shtetit.

Neni 113

1. Këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarkut:

a) rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre;

b) ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike;

c) kanë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre;

ç) kanë të drejtë të vendosin, në përputhje me ligjin, taksa vendore, si dhe nivelin e tyre;

d) caktojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre në pajtim me ligjin;

dh) krijojnë simbolet e qeverisjes vendore, si dhe titujt vendorë të nderit;

e) ndërmarrin nisma për çështje vendore përpara organeve të caktuara me ligj.

2. Organet e njësive të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra.

3. Të drejtat për vetëqeverisje të njësive të qeverisjes vendore mbrohen në gjykatë.

Neni 114

Këshilli i Ministrave cakton prefektin si përfaqësues të tij në çdo qark. Kompetencat e prefektit caktohen me ligj.

Neni 115

1. Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.

2. Organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet.

3. Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.

PJESA E SHTATË
AKTET NORMATIVE DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

KREU I
AKTET NORMATIVE

Neni 116

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.

Neni 117

1. Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.

2. Shpallja dhe botimi i akteve të tjera normative bëhet sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

3. Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit.

Neni 118

1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.

2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij Neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.

Neni 119

1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre.

2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera.

3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme.

Neni 120

Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj.

KREU II
MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Neni 121

1. Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë me:

a) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;

b) të drejtat dhe liritë e njeriut, si edhe detyrimet e shtetasve, siç parashikohen në Kushtetutë;

c) anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;

ç) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë;

d) miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve.

2. Kuvendi, me shumicën e të gjithë anëtarëve, mund të ratifikojë edhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare që nuk parashikohen në paragrafin 1 të këtij Neni.

3. Kryeministri e njofton Kuvendin sa herë që Këshilli i Ministrave nënshkruan një marrëveshje ndërkombëtare që nuk ratifikohet me ligj.

4. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe denoncimin e marrëveshjeve ndërkombëtare parashikohen me ligj.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Neni 123

1. Republika e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara.

2. Ligji me të cilin ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij Neni, miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

3. Kuvendi mund të vendosë që ratifikimi i një marrëveshjeje të tillë të bëhet me referendum.

PJESA E TETË
GJYKATA KUSHTETUESE

Neni 124
(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 3)

1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.

3. Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur.

Neni 125
(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 4)

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.

2. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar.

3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

6. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

7. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafët "c", "ç", "d" dhe "dh".

Neni 126

(ndryshuar me Ligjin nr. 88, datë 18.09.2012, neni 2; Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 5)

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim.

Neni 127

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 6)

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur:

   a) mbush moshën 70 vjeç;

   b) përfundon mandatin 9-vjeçar;

   c) jep dorëheqjen;

   ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës;

   d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

   dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi i emërtesës emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

Neni 128

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 7)

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.

2. Procesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për shkarkimin e tij kur:

a) konstaton shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit;

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 129

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.

Neni 130

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 8)

Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike, shtetërore, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohen kundrejt pagesës, me përjashtim të atyre të mësimdhënies, akademike dhe shkencore, sipas ligjit.

Neni 131

(shkronja "e" ndryshuar me Ligjin nr. 137, datë 17.12.2015, neni 3)
(shkronja "f" ndryshuar dhe paragrafi 2 shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 9)

1. Gjykata Kushtetuese vendos për:

a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në Nenin 122;

b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;

c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;

ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;

d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas Nenit 9 të kësaj Kushtetute;

dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;

e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;

ë) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

2. Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

Neni 132

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 10)

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër.

3. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.

Neni 133

(paragrafi 2 ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 11)

1. Pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj.

2. Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

Neni 134

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 12)

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:

a) Presidentit të Republikës;

b) Kryeministrit;

c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;

ç) Avokatit të Popullit;

d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

dh) çdo gjykate, sipas nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute;

e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;

ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

f) organeve të qeverisjes vendore;

g) organeve të bashkësive fetare;

gj) partive politike;

h) organizatave;

i) individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

PJESA E NËNTË
GJYKATAT

Neni 135
(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 13)

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.

2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.

4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme që parashikohen në paragrafin 2, të këtij neni, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.

Neni 136
(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 14)

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.

2. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.

4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët "c", "ç", "d" dhe "dh".

Neni 136/a

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 15)

1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

2. Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.

Neni 137

(ndryshuar me Ligjin nr. 88, datë 18.09.2012, neni 3; Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 16)

Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi.

Neni 138

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 17)

Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur:

a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare;

b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit;

c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.

Neni 139

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 18)

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron në rastet e mëposhtme:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandatin 9-vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 140 të Kushtetutës;

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë.

3. Procedura për emërimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pas përfundimit të mandatit rregullohet me ligj.

Neni 140

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 19)

1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës;

b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose

"arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;

c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 141

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 20)

1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.

Neni 142

1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

2. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës.

3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Neni 143

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 21)

Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit.

Neni 144

(shfuqizuar me ligjin nr. 76/2016, neni 22)

Neni 145

1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

2. Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë

çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.

3. Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 146

1. Gjykatat i japin vendimet në emër të Republikës.

2. Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast.

Neni 147

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 23)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë.

3. Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.

4. Dy anëtarë jogjyqtarë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve,

i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni.

7. Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës. Nënkomisioni përbëhet nga 5 deputetë, prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare. Nënkomisioni, me të paktën katër vota, mund të përfshijë në listën e kandidatëve edhe ata që janë përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për mospërmbushje të kritereve formale. Nënkomisioni përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short.

8. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga nënkomisioni përmblidhen në një listë dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

9. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë, sipas ligjit.

10. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët gjyqtarë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ose të gjykatës së posaçme i pezullohet mandati si gjyqtar gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Anëtarët jogjyqtarë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to.

Neni 147/a

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 24)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;

b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit;

ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;

d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;

e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;

ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.

Neni 147/b

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 25)

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbaron sipas rasteve të mëposhtme:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandatin 5-vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/c të Kushtetutës;

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.

4. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët "c", "ç", "d" dhe "dh", të paragrafit 1, të këtij neni.

Neni 147/c

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 26)

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;

b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 147/ç

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 27)

Qenia anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademike dhe shkencore, sipas ligjit.

Neni 147/d

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 28)

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

6. Procedura e vendimmarrjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rregullohet me ligj. Ankimet ndaj vendimeve lidhur me masat disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 147/dh

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 29)

1. Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbaron kur:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandatin 9-vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/e të Kushtetutës;

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deklarohet me vendim të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë deri në emërimin e Inspektorit të ri, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 1, nënparagrafët "c", "ç", "d" dhe "dh".

4. Pas përfundimit të mandatit, me kërkesë të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kthehet në detyrën që mbante para emërimit ose në një detyrë të përafërt me të.

Neni 147/e

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 30)

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;

b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë hetohen nga një komision hetimor i Kuvendit, duke respektuar të drejtën e tij për proces të rregullt. Komisioni hetimor, në rast se konstaton shkelje sipas paragrafit, 2 të këtij neni, i propozon Gjykatës Kushtetuese shkarkimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas ligjit.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 147/ë

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 31)

Qenia Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor, sipas ligjit.

PJESA E DHJETË
PROKURORIA

Neni 148

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 32)

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 148/a

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 33)

1. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për një mandat 7-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në një thirrje publike dhe procedurë transparente, përzgjedh dhe rendit tre kandidatët më të kualifikuar dhe ia përcjell Kuvendit, sipas ligjit.

3. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës ose kanë një gradë shkencore në drejtësi. Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

4. Nëse Kuvendi nuk zgjedh Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpallet i emëruar.

5. Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në gjykatën e apelit.

Neni 148/b

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 34)

Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

a) përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme;

b) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme;

c) siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, me përjashtim të administratës së Prokurorisë së Posaçme. Krijimi dhe mbarëvajtja e strukturave të teknologjisë së informacionit në prokurori rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme;

d) raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit;

dh) ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj.

Neni 148/c

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 35)

1. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm mbaron kur:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandatin 7-vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të Kushtetutës,

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 148/ç

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 36)

1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj.

Neni 148/d

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 37)

1. Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;

b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.

4. Prokurori pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 148/dh

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 38)

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë.

2. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Ligji vendos kritere të tjera për përzgjedhjen si dhe për procedurën transparente dhe publike të emërimit.

3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga radhët e prokurorëve të kësaj prokurorie me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje, sipas ligjit.

4. Prokurori i Prokurorisë së Posaçme shkarkohet për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një shkeljeje të rëndë disiplinore me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

5. Kandidati për prokuror, oficer i hetimit, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Njësisë së Posaçme Hetimore, si dhe familjarët

e afërm të tij, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve personale, sipas ligjit.

Neni 149

(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 39)

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë.

3. Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga radhët e prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë. Anëtarët joprokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.

4. Dy anëtarë joprokurorë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni.

7. Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen

e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës. Nënkomisioni përbëhet nga 5 deputetë, prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare. Nënkomisioni, me të paktën katër vota, mund të përfshijë në listën e kandidatëve edhe ata që janë përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për mospërmbushje të kritereve formale. Nënkomisioni përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short.

8. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga nënkomisioni përmblidhen në një listë dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

9. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve joprokurorë, sipas ligjit.

10. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët prokurorë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Mandati i prokurorit të posaçëm pezullohet gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Anëtarët joprokurorë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to.

Neni 149/a

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 40)

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;

b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;

c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;

ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;

d) propozon dhe administron buxhetin e tij;

dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;

e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 149/b

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 41)

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbaron kur:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandatin 5-vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të Kushtetutës;

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 149, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.

4. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët "c", "ç", "d" dhe "dh", të paragrafit 1, të këtij neni.

Neni 149/c

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 42)

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë shkarkohen nga Gjykata Kushtetuese kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;

b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 149/ç

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 43)

Qenia Prokuror i Përgjithshëm, prokuror ose anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor.

Neni 149/d

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 44)

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mblidhet sa herë është e nevojshme.

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

4. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

5. Kritere të tjera për shkallën e kualifikimit të kandidatëve që marrin pjesë në short parashikohen me ligj. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj.

PJESA E NJËMBËDHJETË
REFERENDUMI

Neni 150

1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë.

2. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një së pestës së deputetëve ose me propozimin e Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një çështje ose një projektligj i një rëndësie të veçantë të shtrohet në referendum.

3. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit, si dhe vlefshmëria e tij parashikohen me ligj.

Neni 151

1. Ligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikës.

2. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.

3. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet përpara se të kenë kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

Neni 152

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas Nenit 150 paragrafët 1 e 2, Nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas Nenit 177 paragrafët 4 e 5 brenda 60 ditëve.

2. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në Nenin 150 paragrafët 1 e 2 nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.

3. Data e referendumit caktohet nga Presidenti i Republikës brenda 45 ditëve pas shpalljes së vendimit pozitiv të Gjykatës Kushtetuese ose pas kalimit të afatit brenda të cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehej. Gjatë vitit referendumet zhvillohen vetëm në një ditë.

PJESA E DYMBËDHJETË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
(shfuqizuar me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008, neni 10)

PJESA E TREMBËDHJETË
FINANCAT PUBLIKE

Neni 155

Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.

Neni 156

Shteti mund të marrë e të garantojë hua dhe kredi financiare, kur autorizohet me ligj.

Neni 157

1. Sistemi buxhetor përbëhet nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet vendore.

2. Buxheti i shtetit krijohet nga të ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme. Ai përfshin të gjitha shpenzimet e shtetit.

3. Organet vendore caktojnë dhe mbledhin taksa dhe detyrime të tjera siç përcaktohet me ligj.

4. Organet e pushtetit qendror dhe atij vendor janë të detyruara t'i bëjnë publike të ardhurat dhe shpenzimet.

Neni 158

1. Kryeministri, në emër të Këshillit të Ministrave, i paraqet Kuvendit projektligjin për buxhetin e shtetit gjatë sesionit të vjeshtës, i cili nuk mund të mbyllet pa e miratuar atë.

2. Në qoftë se projektligji nuk arrin të miratohet deri në fillim të vitit të ardhshëm financiar, Këshilli i Ministrave zbaton çdo muaj një të dymbëdhjetën e buxhetit të vitit paraardhës, derisa të miratohet buxheti i ri.

3. Kuvendi miraton buxhetin e ri brenda 3 muajve nga dita e mbarimit të vitit të kaluar financiar, përveçse në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme.

4. Këshilli i Ministrave është i detyruar t'i paraqesë raport Kuvendit lidhur me zbatimin e buxhetit dhe me borxhin shtetëror për vitin e kaluar.

5. Kuvendi vendos përfundimisht pasi dëgjon edhe raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 159

Parimet dhe procedurat për hartimin e projektbuxhetit, si dhe për zbatimin e buxhetit përcaktohen me ligj.

Neni 160

1. Gjatë vitit financiar Kuvendi mund të bëjë ndryshime në buxhet.

2. Ndryshimet në buxhet bëhen sipas procedurës së parashikuar për hartimin dhe miratimin e vetë buxhetit.

3. Shpenzimet e parashikuara me ligje të tjera nuk mund të ulen sa kohë që këto ligje janë në fuqi.

Neni 161

1. Banka Qendrore e shtetit është Banka e Shqipërisë. Ajo ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, të zbatimit të pavarur të politikës monetare dhe të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë drejtohet nga një këshill, i cili kryesohet nga Guvernatori. Guvernatori zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

PJESA E KATËRMBËDHJETË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Neni 162

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 163

Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon:

a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë;

b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;

c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Neni 164

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:

a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit;

b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;

c) informacion për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkohet nga Kuvendi.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

Neni 165

1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shqyrtohen çështje që lidhen me funksionet e tij.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

PJESA E PESËMBËDHJETË
FORCAT E ARMATOSURA

Neni 166

1. Shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, siç parashikohet në ligj.

2. Shtetasi që, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranon shërbimin me armë në forcat e armatosura, është i detyruar të kryejë një shërbim alternativ, siç parashikohet në ligj.

Neni 167

1. Ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti ose në veprimtari politike.

2. Pjesëtarët e forcave të armatosura ose personat që kryejnë shërbim alternativ, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 168

1. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga forcat tokësore, detare dhe ajrore.

2. Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

3. Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor i Presidentit të Republikës.

Neni 169

1. Presidenti i Republikës, në kohë paqeje, ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes.

2. Presidenti i Republikës, në kohe lufte, emëron dhe shkarkon Komandantin e Forcave të Armatosura me propozim të Kryeministrit.

3. Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe

shkarkon Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, emëron dhe shkarkon komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore.

4. Kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj.

PJESA E GJASHTËMBËDHJETË
MASAT E JASHTËZAKONSHME

Neni 170

1. Masat e jashtëzakonshme mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjatin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje.

2. Parimet e veprimtarisë së organeve publike dhe shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, përcaktohen me ligj.

3. Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme.

4. Aktet që ndërmerren si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme, duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të shtetit.

5. Gjatë gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet asnjë prej këtyre akteve: Kushtetuta, ligjet për zgjedhjet për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor, si dhe ligjet për masat e jashtëzakonshme.

6. Gjatë periudhës së zbatimit të masave të jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohen zgjedhje vendore, nuk mund të zhvillohet referendum, si dhe nuk mund të zgjidhet një President i ri i Republikës. Zgjedhjet vendore mund të bëhen vetëm aty ku nuk zbatohen masat e jashtëzakonshme.

Neni 171

1. Në rast agresioni të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, shpall gjendjen e luftës.

2. Në rast kërcënimesh të jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare, Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës, shpall gjendjen e luftës, vendos gjendjen e mobilizimit dhe të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.

Neni 172

1. Në rastin e Nenit 171 paragrafi 1, Presidenti i Republikës i paraqet Kuvendit dekretin për vendosjen e gjendjes së luftës brenda 48 orëve nga nënshkrimi i tij, duke specifikuar të drejtat që kufizohen.

2. Kuvendi merr në shqyrtim menjëherë dhe vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve për dekretin e Presidentit.

Neni 173

1. Në rast rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike, Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit gjendjen e jashtëzakonshme, e cila zgjat për aq kohë sa vazhdon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë.

2. Me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme ndërhyrja e forcave të armatosura bëhet me vendim të Kuvendit dhe vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje të rivendosin rendin.

3. Zgjatja e afatit të gjendjes së jashtëzakonshme mund të bëhet vetëm me pëlqim të Kuvendit çdo 30 ditë, për një periudhë jo më shumë se 90 ditë.

Neni 174

1. Për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose aksidenti teknologjik, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit.

2. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.

Neni 175

1. Gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 15, 18, 19, 20, 21, 24, 25, 29, 30, 31, 32, 34, 39 paragrafi 1, 41 paragrafët 1, 2, 3 dhe 5, 42, 43, 48, 54, 55.

2. Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe

liritë e parashikuara nga nenet 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51.

3. Aktet për shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së fatkeqësisë natyrore duhet të cilësojnë të drejtat dhe liritë që kufizohen sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij Neni.

Neni 176

Kur Kuvendi nuk mund të mblidhet gjatë gjendjes së luftës, Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka të drejtë të nxjerrë akte që kanë fuqinë e ligjit, të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi në mbledhjen e tij më të parë.

PJESA E SHTATËMBËDHJETË
RISHIKIMI I KUSHTETUTËS

Neni 177

1. Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit.

2. Asnjë rishikim i Kushtetutës nuk mund të ndërmerret gjatë kohës kur janë vendosur masat e jashtëzakonshme.

3. Projekti miratohet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

4. Kuvendi mund të vendosë, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, që projektamendamentet kushtetuese të votohen me referendum. Projektligji për rishikimin e Kushtetutës hyn në fuqi pas ratifikimit me referendum, i cili bëhet jo më vonë se 60 ditë nga miratimi i tij në Kuvend.

5. Amendamenti kushtetues i miratuar i nënshtrohet referendumit, kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

6. Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për rishikimin e Kushtetutës.

7. Ligji i miratuar në referendum shpallet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi në datën e parashikuar në këtë ligj.

8. Rishikimi i Kushtetutës për të njëjtën çështje nuk mund të bëhet përpara se të ketë kaluar një vit nga dita e rrëzimit të projektligjit në Kuvend dhe jo më përpara se të kenë kaluar 3 vjet nga dita e rrëzimit të tij në referendum.

PJESA E TETËMBËDHJETË
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 178

1. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar.

2. Këshilli i Ministrave i paraqet Kuvendit projektligjet e nevojshme për vënien në zbatim të kësaj Kushtetute.

Neni 179
(ndryshuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 45)

1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese sipas mandatit të mëparshëm.

2. Anëtari i parë për t'u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti zgjidhet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga Gjykata e Lartë. Kjo radhë ndiqet për të gjitha emërimet që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri, që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028. Gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit.

4. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë gjyqtarë dhe dy anëtarë jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohen fillimisht për një mandat trevjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Për emërimet e para për anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve sipas nenit 147, të Kushtetutës, do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet brenda tetë muajve nga hyrja

në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë prokurorë dhe dy anëtarë joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë emërohen fillimisht për një mandat trevjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi. Për emërimet e para për anëtarët joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve sipas nenit 149, të Kushtetutës, do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do të emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Transferimi i çështjeve do të bëhet në përputhje me ligjin. Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria për Krimet e Rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet sipas ligjit.

9. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Mënyra e funksionimit të inspektorateve ekzistuese gjatë periudhës kalimtare rregullohet me ligj.

10. Gjyqtarët dhe prokurorët që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës qëndrojnë në detyrë dhe janë subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar të kualifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas nenit 179/b dhe aneksit të këtij ligji.

11. Presidenti i Republikës, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zgjedh me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës. Nëse Presidenti i Republikës nuk i përzgjedh anëtarët brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda dhjetë ditëve nga hyrja

në fuqi e këtij ligji. Të zgjedhurit qëndrojnë në detyrë deri në datën 31 dhjetor të vitit kur hyn në fuqi ky ligj. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen menjëherë procesit të rivlerësimit kalimtar të kualifikimit për gjyqtarë dhe prokurorë sipas nenit 179/b të këtij ligji.

12. Presidenti i Republikës vazhdon të qëndrojë Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Presidenti emëron gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, sipas nenit 136 të Kushtetutës. Presidenti plotëson vakancën e parë në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit 2, të këtij neni, dhe nenit 125 të Kushtetutës.

13. Deri në zgjedhjet parlamentare, që do të mbahen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por jo më vonë se data 1 shtator 2017, zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe e Prokurorit të Përgjithshëm do të bëhet me dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit. Zgjedhjet e tjera do të bëhen me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 179/a

(shtuar me Ligjin nr. 137, datë 17.12.2015, neni 3)

1. Mandati i funksionarëve zgjedhur ose të emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që është fituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji mbaron ose është i pavlefshëm kur konstatohet se i zgjedhuri ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që janë të përjashtuar nga e drejta për t'u zgjedhur, sipas neneve 6/1 dhe 45 pika 3 e Kushtetutës.

2. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi në përputhje me procedurën e nenit 81 pika 2 të Kushtetutës, miraton ligjin që përcakton kushtet dhe rregullat për garantimin e integritetit të organeve që zgjidhen, emërohen ose mbajnë funksione publike.

Neni 179/b

(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016, neni 46 zëvendësuar togfjalësh në fjalinë e parë të pikës 8 me ligjin nr. 16/2022, datë 10.2.2022)

1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.

2. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.

3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

4. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje.

6. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë të pavarur dhe të paanshëm.

7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ata që janë deleguar në pozicione të tjera, ish-gjyqtarë ose ish-prokurorë, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, qëndrojnë në detyrë ose emërohen gjyqtarë e prokurorë. Subjektet e tjera, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas ligjit.

8. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit është 9 vjet. Pas shpërbërjes së komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të prokurorëve shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit. Pas shpërbërjes së komisionerëve publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

9. Kuvendi vendos për shfuqizimin e këtij Aneksi pasi vendimi i fundit të ketë marrë formë të prerë, si dhe mbi bazën e raportit të paraqitur nga Kryetari i Apelimit mbi gjendjen e çështjeve të papërfunduara, ose kur përfundon mandati i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit.

10. Procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit dhe ligjit.

Neni 180

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute konsiderohen të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute.

2. Këshilli i Ministrave i paraqet Gjykatës Kushtetuese marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat përmbajnë dispozita që vijnë në kundërshtim me këtë Kushtetutë.

Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e Nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.

Neni 182

Ligji nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe ligjet e tjera kushtetuese shfuqizohen ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

Neni 183

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi me shpalljen nga Presidenti i Republikës.

*Miratuar me referendum m*ë datë *22.11.1998*

Shpallur me Dekretin nr.2260, date 28.11.1998
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Mejdani.

ANEKS
RIVLERËSIMI KALIMTAR I GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE
(shtuar me Ligjin nr. 76, datë 22.07.2016)

Neni A
Kufizimi i të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta

1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi "f", 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

2. Subjektet që kalojnë me sukses rivlerësimin, sipas parashikimeve të këtij Aneksi, i nënshtrohen sistemit të përhershëm të llogaridhënies, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj.

Neni B
Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

1. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së gjithë procesit. Ky Operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integrimit europian dhe bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Europian.

2. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i ushtron detyrat e veta sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit emëron vëzhguesit ndërkombëtarë pas njoftimit të Këshillit të Ministrave. Vëzhguesit emërohen nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në sistemin e drejtësisë së vendeve të tyre përkatëse. Mandati i vëzhguesit ndërkombëtar ndërpritet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për shkelje të rënda.

3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra:

a) i jep rekomandime Kuvendit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelimit dhe Komisionerit Publik;

b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelimit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelimit të marrë në shqyrtim

prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit;

c) u jep komisionerëve publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit;

ç) kanë të drejtën të marrin të gjithë informacionet menjëherë, të dhënat për persona dhe dokumentet e nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe fazat.

Neni C
Dispozita të përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit përbëhet nga katër trupa gjykues të përhershëm me tre anëtarë secili.

2. Dy komisionerë publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit.

3. Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, anëtarët e Komisionit dhe komisionerët publikë gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe mandati i tyre nuk kufizohet për shkak të moshës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

4. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, komisionerët publikë, si dhe punonjësit e tjerë të këtyre institucioneve nënshkruajnë deklaratë me shkrim, sipas ligjit, për të autorizuar kryerjen e kontrollit vjetor të pasurisë së tyre, monitorimin sistematik të llogarive dhe transaksioneve financiare, si dhe kufizimet e posaçme të së drejtës së fshehtësisë së komunikimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në detyrë. Deklaratat e pasurisë së tyre bëhen publike.

5. Anëtarët e Komisionit dhe gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit kanë arsim të lartë juridik dhe jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë. Kandidatët për anëtarë të Komisionit dhe gjyqtarë të Kolegjit nuk duhet të kenë qenë gjyqtarë, prokurorë ose këshilltarë ligjorë apo ndihmës ligjorë gjatë dy vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kandidatët nuk duhet të

kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe funksione drejtuese në partitë politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

6. Presidenti i Republikës së Shqipërisë organizon procesin e hapur dhe transparent të aplikimit për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe të Komisionerit Publik. Kandidatët i paraqesin Presidentit aplikimet dhe të gjitha deklaratat shoqëruese, sipas ligjit. Brenda 7 ditëve nga përfundimi i procesit të aplikimit, Presidenti përpilon një listë me kandidatë, të cilët plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion dhe një listë me kandidatë, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit monitoron këtë proces. Nëse Presidenti nuk e përfundon procesin brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

7. Një komision i përbërë nga të paktën tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit vlerëson kandidatët, sipas ligjit. Jo më vonë se katërmbëdhjetë ditë nga paraqitja e dy listave nga Presidenti, Komisioni, bazuar në vlerësimet e tij, i dërgon rekomandimet Presidentit, i cili ia përcjell ato Kuvendit. Nëse Presidenti nuk e ushtron këtë kompetencë brenda 5 ditëve, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

8.Brenda tre ditëve nga marrja e listës së kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale, listës së kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale dhe listës së rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Kuvendi krijon një komision *ad hoc* me gjashtë anëtarë të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare. Komisioni, me të paktën katër vota, mund të kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale tek lista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale. Komisioni, me të paktën pesë vota, mund kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve të rekomanduar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit tek lista e kandidatëve për votim. Brenda dhjetë ditëve nga krijimi i tij, komisioni *ad hoc* i përcjell listën e kandidatëve për votim për secilin pozicion komisioneve *ad hoc* përzgjedhëse. Dy listat e tjera nuk dërgohen për votim.

9. Kuvendi krijon brenda dhjetë ditëve dy komisione *ad hoc* përzgjedhëse të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare, ku një komision ka 12 anëtarë dhe një ka 6 anëtarë.

10. Brenda 30 ditëve nga konstituimi i komisionit *ad hoc*, secili anëtar i komisioni me 12 anëtarë përzgjedh një kandidat për komisioner nga lista e kandidatëve për votim pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik

ku secili anëtar i komisionit voton për një kandidat. Komisioni përzgjedh më pas dy kandidatë nga lista e kandidatëve për votim për komisionerë publikë përmes një votimi ku dy kandidatët me më shumë vota quhen të përzgjedhur. Në rast barazie të votave, fituesit përzgjidhen me short. Dy kandidatë zëvendësues për secilin pozicion përzgjidhen në të njëjtën mënyrë si për Komisionerin Publik.

11. Brenda 30 ditëve nga konstituimi i komisionit *ad hoc*, secili prej 6 anëtarëve të komisionit përzgjedh nga lista e kandidatëve për votim një kandidat për gjyqtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik ku secili anëtar i komisionit voton për një kandidat. Komisioni më pas përzgjedh gjyqtarin e shtatë nga kandidatët e mbetur të listës së kandidatëve për votim përmes një votimi të thjeshtë ku kandidati me më shumë vota quhet i përzgjedhur. Në rast barazie të votave, fituesi përzgjidhet me short. Dy gjyqtarë zëvendësues për secilin pozicion përzgjidhen në të njëjtën mënyrë si për gjyqtarin e shtatë.

12. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga dy komisionet *ad hoc* përzgjedhëse përmblidhen në një listë të vetme dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve në bllok me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk e miraton listën e kandidatëve në bllok, Kryetari i Kuvendit ia kthen atë komisioneve *ad hoc* për përsëritjen e procesit të përzgjedhjes dhe dërgimin e një liste të dytë brenda 10 ditëve. Kuvendi, brenda 10 ditëve, mund ta rrëzojë në bllok listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Në rast se lista nuk rrëzohet, kandidatët e përzgjedhur konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

13. Anëtari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Komisioneri Publik ushtrojnë detyrën me kohë të plotë dhe nuk mund të mbajnë asnjë pozicion apo të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër gjatë kohëzgjatjes së mandatit.

14. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe Komisionerët Publikë kanë buxhet, administratë dhe mjedise të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre si dhe për ushtrimin e funksioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë, sipas ligjit.

15. Gjuhët zyrtare të Komisionit, të Kolegjit të Apelimit dhe komisionerëve publikë janë gjuha shqipe dhe angleze. Të dyja organet punësojnë përkthyes për këtë qëllim.

16. Anëtari i Komisionit, gjyqtari i Kolegjit të Apelimit dhe Komisioneri Publik mban përgjegjësi disiplinore. Rastet e shkeljes disiplinore shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit, sipas ligjit.

17. Anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelimit, Komisionerit Publik, vëzhguesit ndërkombëtar, punonjësit të administratës dhe familjarëve të tyre u garantohet mbrojtje e nivelit më të lartë, sipas ligjit.

Neni Ç
Rivlerësimi

1. Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit.

2. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit publikojnë vendimet e tyre si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të marrë nga publiku. Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt.

3. Institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë bashkëpunojnë me Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit, duke vënë në dispozicion të tyre informacionin e kërkuar, si dhe duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në të dhënat. Ata mund të japin mendime ose të bëjnë propozime konkrete, sipas ligjit.

4. Komisioni ose Kolegji i Apelimit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, Komisionerit Publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Komisioni, Kolegji dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare, përveç atyre që janë klasifikuar "sekret shtetëror", duke përfshirë edhe dosjet personale të të rivlerësuarit, të dhënat statistikore, dosje të përzgjedhura për rivlerësim, vetëvlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat për trajnimet dhe ankimet ndaj të rivlerësuarve, rezultatet e verifikimit të ankesave, vendimet për marrjen e masave disiplinore ndaj të rivlerësuarve, të dhënat për pronat e të rivlerësuarit, llogaritë bankare, të dhënat tatimore, të dhënat për automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi, si dhe çdo dokument tjetër të dobishëm. Komisioni ose Kolegji mund të urdhërojë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me ligjin.

5. Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal.

Neni D
Vlerësimi i pasurive

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklarimit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni DH
Kontrolli i figurës

1. Subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja.

2. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit. Deklarata mund të

përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal.

3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni E
Vlerësimi i aftësive profesionale

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.

2. Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve në kohën kur kryhet rivlerësimi. Vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Vlerësimi i aftësisë për prokurorët përfshin aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Vlerësimi i aftësisë për këshilltarët ose ndihmësit ligjorë përfshin testimin pranë Shkollës së Magjistraturës. Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

3. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

4. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet

me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni Ë
Masat disiplinore

1. Komisioni ose Kolegji i Apelimit në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Në çdo rast vendimi jepet i arsyetuar.

2. Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë. Në fund të programit ai testohet për aftësitë e tij. Ky testim mbikëqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Subjekti i rivlerësimit që nuk e kalon testimin shkarkohet nga Komisioni.

3. Në çdo rast, shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet, mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim, sipas parashikimeve në ligjet procedurale.

Neni F
Kolegji i Apelimit

1. Kolegji i Apelimit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit. Kolegji vendos në trupa gjykuese me pesë anëtarë secili.

2. Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit Ë, paragrafi 2, të Aneksit.

3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

4. Vëzhguesi ndërkombëtar në Kolegjin e Apelimit gëzon të njëjtat të drejta si dhe vëzhguesi ndërkombëtar pranë Komisionit.

5. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit subjekti i rivlerësimit paguhet në masën 75 për qind të pagës. Nëse Kolegji pranon ankimin duke shfuqizuar vendimin e Komisionit, pjesa prej 25 për qind e pagës i paguhet subjektit për të gjithë periudhën e ndërprerjes. Vendimi përfundimtar që urdhëron shkarkimin nga detyra, hyn në fuqi menjëherë.

6. Kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji.

7. Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim me shkrim të arsyetuar. Në rastet ae ankimeve nga Komisioneri Publik, Kolegji nuk mund të vendosë një masë disiplinore më të rëndë, pa i dhënë subjektit të rivlerësimit kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për t'u dëgjuar në seancë.

8. Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni G
Dorëheqja

1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

L I G J
Nr.8577/2000

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË*

Në mbështetje të neneve 6, 81, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit
(ndryshuar pjesërisht pika 2 me ligjin nr.99/2016, neni 1)

1. Ky ligj përcakton rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, statusin e gjyqtarit, paraqitjen e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre, parimet dhe rregullat e gjykimit kushtetues, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre.

2. Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj apo nga Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat

Neni 2
Funksioni i Gjykatës Kushtetuese
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 2)

Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

---

* Ndryshuar me ligjin nr.99, datë 6.10.2016;
Ndryshuar me ligjin nr. 45, datë 23.3.2021

Neni 3
Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.

2. Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të caktuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj.

Neni 4
Selia e Gjykatës Kushtetuese

Selia e Gjykatës Kushtetuese është në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Neni 5
Simbolet që vendosen në Gjykatën Kushtetuese
(ndryshuar pjesërisht pika 1 me ligjin nr.99/2016, neni 3)

1. Në sallën e Gjykatës Kushtetuese vendoset Stema e Republikës së Shqipërisë, Flamuri Kombëtar dhe stema, si edhe një pamje e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

2. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjatë zhvillimit të seancës plenare, mban një veshje të veçantë; përshkrimi dhe forma e së cilës përcaktohet nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 6
Mjetet financiare

1. Gjykata Kushtetuese administron buxhetin e saj, i cili si pjesë e buxhetit të shtetit, hartohet prej saj dhe i paraqitet për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

2. Në mjetet financiare përfshihet edhe çdo e ardhur tjetër që nuk është e ndaluar me ligj.

3. Llogaritë financiare të Gjykatës Kushtetuese kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

KREU II

EMËRIMI, ZGJEDHJA DHE MBARIMI I MANDATIT TË ANËTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

(ndryshuar titulli me ligjin nr.99/2016, neni 4)

Neni 7
Përbërja e Gjykatës Kushtetuese
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 5)

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të cilëve tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

2. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet, me një të tretën e saj. Anëtarët e rinj caktohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë. Ky rregull ndiqet edhe në rastet e përfundimit para afatit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 7/a
Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 6)

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kritereve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

a) vjetërsisë në profesion;

b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;

c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;

ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;

d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;

dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Neni 7/b
Procedura e emërimit nga Presidenti i Republikës
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 6) (shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 3 me ligjin 45/2021, neni 1)

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, njofton për vendin vakant Presidentin e Republikës, i cili, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit, shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7/a paraqiten pranë Presidentit të

Republikës, i cili ia dërgon ato Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

2. Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të listës së kandidatëve, thërret mbledhjen e Këshillit që shqyrton plotësimin e kushteve dhe të kritereve ligjore nga kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes është publik dhe përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes. Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe të kritereve të emërimit, brenda 10 ditëve nga zhvillimi i mbledhjes harton një listë përfundimtare duke renditur kandidatët. Lista shoqërohet nga një raport me shkrim ku analizohet plotësimi i kushteve dhe kritereve ligjore për secilin kandidat. Raporti i arsyetuar, pasi miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet.

4. Presidenti brenda 30 ditëve nga marrja e listës prej Këshillit të Emërimeve në Drejtësi emëron gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese nga kandidatët e renditur në tre vendet e para të listës. Dekreti i emërimit shpallet i shoqëruar me arsyet e përzgjedhjes së kandidatit. Nëse Presidenti nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar.

Neni 7/c
Procedura e zgjedhjes nga Kuvendi
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 6) (shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 4 me ligjin 45/2021, neni 2)

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, njofton për vendin vakant Kuvendin, i cili, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit, shpall në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Pranë Kuvendit paraqiten aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7/a të këtij ligji.

2. Kuvendi, brenda 30 ditëve nga hapja e procedurës së aplikimit, publikon listën e kandidatëve dhe ia dërgon ato Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

3. Brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të listës së kandidatëve, Kryetari i Këshillit Emërimeve në Drejtësi thërret mbledhjen e Këshillit që shqyrton plotësimin e kushteve dhe të kritereve ligjore nga kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes është publik dhe përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes. Dosjet e kandidatëve, me kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, i vihen në dispozicion Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga Kuvendi i Shqipërisë.

4. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve të emërimit, brenda 10 ditëve harton një listë përfundimtare duke renditur kandidatët. Lista shoqërohet nga një raport me shkrim, ku analizohet plotësimi i kushteve dhe kritereve ligjore për secilin kandidat. Raporti i arsyetuar, pasi miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet.

5. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, sipas renditjes, brenda një afati të arsyeshëm, organizon seancat dëgjimore me kandidatët. Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Pas këtyre seancave, Komisioni i dërgon Kuvendit emrat e tre kandidatëve për çdo vend vakant bashkë me raportin e arsyetuar për secilin kandidat të përzgjedhur.

6. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen me tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar.

7. Nëse ka më shumë se një vend vakant njëkohësisht, të paktën një anëtar i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet nga kandidatët me arsim juridik, me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesionin e avokatit, profesorit ose lektorit të së drejtës, juristit të lartë në administratën publike.

Neni 7/ç
Procedura e zgjedhjes nga Gjykata e Lartë
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 6)

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, njofton për vendin vakant Kryetarin e Gjykatës së Lartë, i cili shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Kryetari i Gjykatës së Lartë pranon kandidaturat brenda 30 ditëve nga

njoftimi, i bën ato publike dhe ia dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe kritereve të emërimit, brenda 10 ditëve rendit kandidatët dhe i paraqet Kryetarit të Gjykatës së Lartë raportin e miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve, bashkë me listën dhe dokumentacionin shoqërues, për çdo kandidat. Raporti i arsyetuar, pasi miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet.

3. Kryetari i Gjykatës së Lartë thërret mbledhjen e posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Mbledhja është e vlefshme nëse marrin pjesë jo më pak se tre të katërtat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Lista me kandidatët u bëhet e njohur më parë të gjithë pjesëmarrësve në mbledhje.

4. Për çdo vend vakant votohet për secilin nga kandidatët e renditur në tre vendet e para të listës. Kandidati që merr tri të pestat e votave të gjyqtarëve të pranishëm shpallet i zgjedhur. Nëse nuk arrihet shumica e nevojshme, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konsiderohet i zgjedhur.

5. Emri i gjyqtarit të zgjedhur i njoftohet menjëherë Kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 7/d
Zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 6)

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtuese, për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Seanca për zgjedhjen e Kryetarit drejtohet nga gjyqtari më i vjetër në detyrë. Në rast se ka më shumë se një kandidat dhe gjatë votimit asnjëri prej tyre nuk merr shumicën e parashikuar të votave, bëhet një votim i ri dhe, pas këtij, vijohet me votimin mes kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në përfundim të këtij votimi shpallet i zgjedhur kandidati që ka marrë shumicën e votave. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave ose votat janë ndarë në mënyrë të barabartë, Kryetari caktohet me short. Procedura e zhvillimit të shortit parashikohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

3. Kryetari i zgjedhur njofton Presidentin e Republikës dhe Kryetarin e Kuvendit.

Neni 7/dh
Përtëritja e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 6)

1. Përbërja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese përtërihet rregullisht çdo 3 vjet, me një të tretën e saj.

2. Në rast të përfundimit të mandatit të gjyqtarit para afatit, zgjedhja e gjyqtarit të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar, ndjek radhën e parashikuar për zëvendësimin e tij, sipas nenit 7, pika 2, të këtij ligji.

Neni 8
Fillimi i detyrës
(ndryshuar pjesërisht pika 3 me ligjin nr.99/2016, neni 7)

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

2. Formula e betimit është: "*Betohem se gjatë kryerjes së detyrave të mia do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë*".

3. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

4. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij.

Neni 9
Mbarimi i mandatit
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 8)

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron në rastet e mëposhtme:

a) mbush moshën 70 vjeç;

b) përfundon mandatin 9-vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet, sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës;

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

3. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1, shkronjat "a" dhe "b", të këtij neni, si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka deklaruar përfundimin e mandatit.

4. Në çdo rast të mbarimit të mandatit të gjyqtarit vihet në dijeni Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë.

KREU II/1
PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 9)

Neni 10
Shkeljet disiplinore
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 10)

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore, veçanërisht për shkaqe të:

1. Mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë nga procedimi apo gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit procedural dhe gjyqtari është në dijeni të rrethanave të tilla.

2. Sjelljes, akteve dhe veprimeve të tjera të gjyqtarit që krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim.

3. Mosnjoftimit të Kryetarit të Gjykatës ose të organeve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet apo ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe subjekte të tjera.

4. Ndërhyrjeve ose çdo lloj ndikimi tjetër të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një gjyqtari tjetër.

5. Mosnjoftimit të Kryetarit dhe të institucioneve përgjegjëse për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit të tij.

6. Mospërmbushjes së pajustifikuar e në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur, përkatësisht të funksionit të tij.

7. Paraqitjes së kërkesës për heqje dorë dhe kryerjes së atyre veprimeve që nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj ose që bëhen në mënyrë të qëllimshme për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët, ose kur synojnë të shmangin gjyqtarin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga gjyqtarët të tjerë ose kur dorëheqja jepet e vonuar megjithëse ka qenë në dijeni të faktit për të cilin jep dorëheqjen.

8. Shkeljes së përsëritur ose të rëndë të rregullave të solemnitetit dhe rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, si edhe me gjyqtarë ose administratën e Gjykatës Kushtetuese.

9. Vonesës dhe zvarritjes së përsëritur dhe të pajustifikuar të veprimeve procedurale dhe gjatë ushtrimit të funksionit.

10. Bërjes publike të mendimeve që ka dhënë vetë ose gjyqtarët e tjerë gjatë procesit që akoma nuk kanë marrë formën e një akti të bërë publik.

11. Shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces apo i përfunduar, duke përfshirë lehtësinë e publikimit dhe shpërndarjes, gjithashtu edhe për shkak të neglizhencës, të akteve konfidenciale ose akteve procedurale ose informacioneve konfidenciale që rrjedhin nga çështjet të cilat janë në proces hetim ose gjykimi.

12. Bërjes së deklaratave publike dhe në media, për çështjet, me përjashtim të komunikimeve të shtypit brenda kufijve të detyrës së tij.

13. Parashtrimi të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra.

14. Përdorimit të mandatit të gjyqtarit, me qëllim për të realizuar përftime të pajustifikuara ose përfitime për vete ose për të tjerët.

15. Shoqërimit me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal, ose me persona të dënuar penalisht, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose persona të cilët janë të afërm me gjyqtarët në lidhje gjaku ose me ligj, dhe pasja e marrëdhënieve

biznesi të papërshtatshme me këta persona.

16. Përfitimit të padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit të magjistratit.

17. Sjelljes së papërshtatshme në përmbushjen e detyrimeve, në marrëdhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore dhe funksionarët e tyre, dhe raste të tjera me sjellje të papërshtatshme të pajustifikuar.

Neni 10/a
Fillimi dhe zhvillimi i procedimit disiplinor
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 11)

1. Kur ka të dhëna të mjaftueshme se një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka kryer shkelje të parashikuara në nenin 128, të Kushtetutës, dhe në nenin 10, të këtij ligji, me kërkesë të Kryetarit ose të çdo gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari, ose gjyqtari më i vjetër në detyrë, kur subjekt i procedimit është Kryetari, merr masat për fillimin e procedimit disiplinor.

2. Procedimi disiplinor fillon menjëherë nga momenti i konstatimit të shkeljes. Procedimi disiplinor pushon nëse gjyqtari jep dorëheqjen. Në këtë rast ai nuk ka të drejtë të emërohet më në funksione publike për një periudhë 15-vjeçare.

3. Dy gjyqtarë të caktuar me short mbledhin fakte, prova dhe të dhëna të tjera lidhur me shkeljen që i atribuohet gjyqtarit dhe brenda 30 ditëve përgatisin relacionin përkatës dhe ia dërgojnë atë për shqyrtim Komisionit Disiplinor.

4. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të caktuar me short, pa pjesëmarrjen e gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhjen e fakteve dhe provave, sipas pikës 3 të këtij neni. Komisioni merr në shqyrtim relacionin e paraqitur dhe vendos dhënien e masës disiplinore, sipas nenit 10/b, të këtij ligji, ose pushimin e çështjes për shkak se nuk provohet shkelja.

5. Gjyqtari, subjekt i procedimit, ka të drejtë të ushtrojë ankim ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor. Ankimi shqyrtohet nga komisioni ad hoc i përbërë nga tre gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, që nuk kanë marrë pjesë në procedim, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni.

Neni 10/b
Masat disiplinore
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 11)

1. Ndaj gjyqtarit mund të vendosen këto masa disiplinore:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje publike;

c) ulje e përkohshme e pagës deri në 50 për qind për një periudhë jo më të gjatë se 1 vit;

ç) pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 muaj deri në 6 muaj;

d) shkarkim nga detyra.

2. Gjatë kohës së procedimit disiplinor, gjyqtari pezullohet nga detyra, sipas nenit 10/ç, të këtij ligji, dhe përfiton 50 për qind të pagës së tij.

Neni 10/c
Shqyrtimi i shkeljes disiplinore
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 11)

1. Komisioni Disiplinor shqyrton çështjen brenda 10 ditëve nga paraqitja e relacionit dhe vendos:

a) dhënien e masës disiplinore;

b) rrëzimin e propozimit për masë disiplinore;

c) kthimin e çështjes për mbledhje të provave dhe fakteve të tjera;

ç) pushimin e çështjes, kur gjyqtari jep dorëheqjen nga detyra ose i mbaron mandati.

2. Vendimi i njoftohet gjyqtarit të proceduar dhe në çdo rast publikohet. Kur ndaj gjyqtarit të proceduar vendoset shkarkimi nga detyra, vendimi i dërgohet organit të emërtesës.

Neni 10/ç
Pezullimi i gjyqtarit nga detyra
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 11)

1. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”;

b) merr cilësinë e të pandehurit;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas këtij ligji.

2. Kryetari ose gjyqtari më i vjetër në detyrë, kur subjekt procedimi është Kryetari, brenda tri ditëve nga marrja dijeni e shkaqeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, thërret Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila vendos për masën e pezullimit ndaj gjyqtarit. Vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve është përfundimtar.

3. Gjyqtari i pezulluar nuk merr pjesë në shqyrtimin e çështjeve deri në heqjen e masës së pezullimit nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

4. Kryetari merr masa për caktimin e një relatori të ri për çështjet e caktuara gjyqtarit të pezulluar.

Neni 11
Drejtimi i Gjykatës Kushtetuese
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 12)

KREU II/2
ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 13)

Neni 12
Kompetencat e Kryetarit
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 14)

1. Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese drejtohet dhe organizohet nga Kryetari i saj dhe, në mungesë të tij, nga gjyqtari më i vjetër në detyrë, me përjashtim të rasteve kur çështja është në kompetencë të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

2. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:

a) përgatit, thërret e drejton seancat plenare të Gjykatës Kushtetuese;

b) përfaqëson Gjykatën Kushtetuese në marrëdhënie me të tretët;

c) bashkërendon punën midis gjyqtarëve;

ç) nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të vendimeve që nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët;

d) emëron dhe largon nga detyra personelin administrativ, si dhe merr masa disiplinore ndaj tij.

Neni 13
Kompetencat e Mbledhjes së Gjyqtarëve
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 15)

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:

a) përcakton drejtimet kryesore të shpenzimeve të mjeteve buxhetore;

b) informohet çdo 6 muaj me raporte për shpenzimet buxhetore;

c) vendos për strukturën organizative të Gjykatës Kushtetuese;

ç) vendos për numrin e nëpunësve të administratës, të Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe punonjësve të tjerë, si dhe kriteret profesionale që duhet të përmbushin dhe pagat e tyre;

d) miraton rregulloren për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, si dhe rregulloren e brendshme për veprimtarinë e administratës së Gjykatës Kushtetuese;

dh) emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm;

e) cakton kolegjet në fillim të çdo viti kalendarik, sipas Rregullores së Gjykatës Kushtetuese;

ë) shqyrton në shkallë të fundit ankimet e nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë për largimin nga detyra;

f) vendos për masat disiplinore ndaj këshilltarëve ligjorë.

Neni 14
Administrata e Gjykatës Kushtetuese
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 16)

1. Administrata e Gjykatës përbëhet nga nëpunësit civilë dhe punonjës të tjerë. Në ushtrimin e funksioneve të tij Kryetari asistohet nga Kabineti.

2. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil dhe emërohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me propozim të Kryetarit, nga radhët e juristëve me përvojë profesionale jo më pak se 10 vjet.

3. Ai shkarkohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve, me propozim të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, sipas rregullave të parashikuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve për këtë qëllim.

4. Sekretari i Përgjithshëm, nën autoritetin dhe sipas udhëzimeve të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, drejton veprimtarinë administrative të Gjykatës Kushtetuese.

5. Nëpunësit civilë të administratës së Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të shërbimit civil për aq sa nuk bien ndesh me këtë ligj dhe trajtohen financiarisht njëlloj si administrata e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

6. Të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm, nëpunësve civilë dhe të punonjësve të tjerë përcaktohen nga ky ligj dhe Rregullorja e Brendshme.

Neni 14/a
Njësia e Shërbimit Ligjor
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 17)

1. Pranë Gjykatës Kushtetuese funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbën bërthamën shkencore juridike të Gjykatës Kushtetuese. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese duke përfshirë: përgatitjen e çështjeve për gjykim, dhënien e opinioneve ligjore dhe përgatitjen e kërkimeve shkencore për çështjet gjyqësore që janë për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese, si dhe çdo detyrë tjetër që i caktohet nga Kryetari ose Mbledhja e Gjyqtarëve.

2. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë, të cilët emërohen nga Kryetari, nga radhët e juristëve që plotësojnë kriteret për të qenë gjyqtarë, prokurorë ose juristë me përvojë jo më pak se 10 vjet si lektorë të së drejtës, avokatë ose nëpunës të lartë të administratës publike. Jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magjistratëve. Këshilltari ligjor që vjen nga radhët e juristëve përfiton pagë të barabartë me "pagën bruto fillestare" të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Kryetarit, i cili për çdo çështje gjyqësore cakton këshilltarin ligjor, duke marrë për bazë përvojën profesionale dhe ekspertizën ligjore të tij, sipas Rregullores së Gjykatës Kushtetuese. Numri i këshilltarëve ligjorë caktohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

4. Këshilltarët ligjorë mbajnë përgjegjësi disiplinore. Masat disiplinore vendosen nga Mbledhja e Gjyqtarëve, sipas rregullores.

5. Këshilltarët ligjorë i nënshtrohen rregullave të parashikuara në këtë ligj, Rregullores së Brendshme të Gjykatës Kushtetuese dhe ligjit për statusin e magjistratit, për aq sa ai gjen zbatim.

Neni 15
Garantimi i rendit

1. Për mbajtjen e rendit dhe ruajtjen e saj, Gjykata Kushtetuese ka të drejtën e disponimit të forcave policore që vihen në shërbim të saj.

2. Numri dhe detyrat e këtyre forcave policore miratohen nga Ministri i Rendit Publik me propozimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

KREU III
STATUSI I GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Neni 16
Imuniteti
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 18)

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi personal ose keqdashje.

Neni 16/a
Papajtueshmëria
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 19)

1. Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik dhe shkencor për zhvillimin e doktrinës. Kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme parashikohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit nuk pajtohet me qenien anëtar në një parti politike apo pjesëmarrjen në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike, si dhe me veprimtari të tjera të papajtueshme me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

2. Gjyqtari i sapozgjedhur merr masat për shmangien e çdo situate papajtueshmërie brenda 10 ditëve nga betimi.

3. Në rast se anëtari i Gjykatës Kushtetuese gjatë ushtrimit të detyrës ndodhet në një situatë papajtueshmërie, ai menjëherë merr masa për shmangien e saj. Në rast të kundërt, gjejnë zbatim rregullimet e nenit 10 e në vijim të këtij ligji.

Neni 17
Paga

1. Paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

2. Paga e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese është 20 për qind më e lartë se paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

3. Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ulen dhe as të preken.

Neni 18
Të drejta të tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese
(shtuar fjalia e dytë e pikës 3 me ligjin 45/2021, neni 3)

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet:

a) të kenë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës, kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë për rrethana serioze ose çmohet se është e domosdoshme. Organet përkatëse, të ngarkuara me ruajtjen e personaliteteve të larta, janë të detyruara t'i përgjigjen çdo kërkese të bërë në këtë drejtim;

b) të përfitojnë leje të pagueshme vjetore 40 ditë. Leja vjetore bëhet gjatë muajit gusht-shtator;

c) të përfitojnë falas Fletoren Zyrtare, gazeta dhe revista juridike;

ç) të përfitojnë në mënyrë të barabartë po ato të drejta që gëzojnë deputetët, sipas neneve 16 pika 1, 19, 20, 23, 25 dhe 26 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit".

2. Koha e qëndrimit në detyrë e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e përmendura në Kushtetutë dhe në këtë ligj.

3. Në përfundim të mandatit, me përjashtim të rastit kur shkarkohet nga detyra sipas procedurave të përcaktuara në ligj, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese caktohet në një detyrë tjetër të barabartë ose të përafërt, si dhe përfiton pagesë kalimtare dhe/ose pension suplementar, sipas legjislacionit në fuqi. Në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Neni 19
Marrëdhëniet protokollare

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e saj kanë status të veçantë protokollar.

2. Në marrëdhëniet protokollare Kryetari i Gjykatës Kushtetuese vjen menjëherë pas Kryeministrit, ndërsa gjyqtarët e saj barazohen në trajtimin protokollar me ministrin.

3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ftohen të marrin pjesë në delegacionet zyrtare, ceremonitë, pritjet dhe veprimtaritë e ndryshme të karakterit kulturor, shoqëror dhe sportiv, sipas protokollit të përcaktuar në këtë nen.

KREU IV
PARIME TË GJYKIMIT KUSHTETUES

Neni 20
Shqyrtimi kolegjial

Shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet kolegjialisht. Vendimi merret vetëm nga ata gjyqtarë që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.

Neni 21
Procesi publik
(ndryshuar pika 1 me ligjin nr.99/2016, neni 20)

1. Shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet në seancë plenare publike ose mbi bazë të dokumenteve. Në çdo rast vendos Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve.

2. Gjykata Kushtetuese mund ta përjashtojë publikun nga seanca plenare ose një pjesë të tij, me arsyetimin e mbrojtjes së moralit publik, të rendit publik, të sigurisë kombëtare, të së drejtës së jetës private ose të së drejtave vetjake.

Neni 22
Përdorimi i gjuhës shqipe
(ndryshuar pjesërisht pika 2 me ligjin nr.99/2016, neni 21)

1. Në shqyrtimin e çështjeve përdoret gjuha shqipe.

2. Pjesëmarrësit në gjykim, që nuk dinë gjuhën shqipe, përdorin gjuhën

e tyre. Ata marrin dijeni për të gjithë zhvillimin e procesit me anë të përkthyesit, që si rregull sigurohet nga Gjykata Kushtetuese me kërkesë të palës.

Neni 23
Procesi gojor
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 22)

Neni 24
Mbrojtja në gjykimin kushtetues
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 23)

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Kur çështja kalon për gjykim dhe objekt kërkese është një ligj ose akt normativ, kërkuesi përfaqësohet në gjykim me avokat ose përfaqësues ligjor të specializuar.

Neni 25
Paanshmëria në gjykimin kushtetues
(*ndryshuar titulli me ligjin nr.99/2016, neni 24)*

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e çështjeve është i paanshëm dhe bazohet në kryerjen e detyrave të tij vetëm në Kushtetutë dhe në ligj.

2. Në veprimtarinë e tij, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese merr pjesë me cilësinë e tij vetjake dhe nuk përfaqëson asnjë organ shtetëror, organizatë shoqërore, parti ose shoqatë politike, grup etnik ose social.

Neni 26
Publikimi i vendimit përfundimtar dhe hyrja e tij në fuqi
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 25)

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese publikohen në Fletoren Zyrtare, si dhe në mjete të tjera të informimit publik. Publikimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese bëhet jo më vonë se 15 ditë nga depozitimi i tyre për këtë qëllim në Qendrën e Botimeve Zyrtare. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.

2. Vendimet, si rregull, hyjnë në fuqi ditën e publikimit, përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj. Kur vendimi sjell pasoja për të drejtat kushtetuese të individit, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi ditën e shpalljes së tij. Në këtë rast, vendimi shoqërohet me një arsyetim të përmbledhur, ndërsa vendimi i arsyetuar

plotësisht publikohet brenda 30 ditëve.

3. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të aktit të shfuqizuar prej saj ndaj kërkuesit në çështjen gjyqësore deri në kohën kur vendimi fillon efektet.

4. Gjykata Kushtetuese përgatit dhe publikon përmbledhje periodike të vendimeve të saj.

KREU V
PARAQITJA DHE SHQYRTIMI PARAPRAK I KËRKESËS

Neni 27
Përmbajtja e kërkesës
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 26)

1. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese paraqitet nga kërkuesi ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij. Në rast se kërkuesi ka zgjedhur të përfaqësohet nga një avokat, ai i bashkëngjit kërkesës aktin e përfaqësimit. Në një rast të tillë të gjitha njoftimet e Gjykatës i drejtohen përfaqësuesit të kërkuesit.

2. Kërkesa paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm, në aq kopje sa janë pjesëmarrësit në gjykim dhe duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e Gjykatës Kushtetuese;

b) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuesit dhe/ose të përfaqësuesit;

c) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vendbanimin ose vendqëndrimin e subjekteve të interesuara dhe/ose të përfaqësuesve;

ç) objektin e kërkesës dhe bazën ligjore;

d) parashtrimin e shkaqeve dhe shkeljet e natyrës kushtetuese të pretenduara;

dh) dokumentet, provat, apo materiale të tjera që shoqërojnë kërkesën;

e) kopje të noterizuara të të gjitha vendimeve objekt kërkese, si dhe të ankimeve dhe rekurseve të paraqitura në instancat e tjera gjyqësore;

ë) nënshkrimin e kërkuesit ose të përfaqësuesit të tij, si dhe aktin e përfaqësimit të këtij të fundit.

3. Kërkesa mund të paraqitet dorazi ose me postë. Në rast të dërgimit të kërkesës me postë, data e paraqitjes së saj konsiderohet data e dorëzimit në zyrën postare. Në rast se kërkesa është dërguar gabimisht në një institucion tjetër dhe kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pas përfundimit të afatit ligjor, kërkesa konsiderohet e paraqitur në afat në rast se provohet se kjo ka ndodhur në mirëbesim.

4. Kërkesa që plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, regjistrohet në regjistrin e posaçëm që mbahet nga Drejtoria Gjyqësore pranë Gjykatës Kushtetuese.

5. Kërkesa që nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, konsiderohet e paplotë dhe nuk regjistrohet në regjistrin e kërkesave. Drejtoria Gjyqësore njofton kërkuesin që brenda 10 ditëve të bëjë plotësimet e nevojshme. Në rast se kërkuesi nuk e paraqet kërkesën të plotësuar ose brenda afatit të caktuar nga Drejtoria Gjyqësore, kërkesa arkivohet.

6. Kërkesa e regjistruar në regjistrin e kërkesave i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili merr masat për caktimin me short të relatorit të çështjes, sipas Rregullores së Gjykatës.

Neni 28
Shpenzimet gjyqësore
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 27)

1. Shpenzimet e procesit gjyqësor para Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregulla ve të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore.

2. Kur Gjykata Kushtetuese vendos pranimin e ankimit individual kushtetues, ajo mundtë shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi.

Neni 29
Dokumente që i bashkëlidhen kërkesës
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 28)

Neni 30
Afati i paraqitjes së kërkesës
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 29)

Neni 31
Shqyrtimi paraprak i kërkesës
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 30)

1. Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji, i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori.

2. Kur kërkesa, megjithëse është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, nuk është e plotë për ndonjë shkak të ndryshëm nga ata që parashikohen në nenin 27, të këtij ligji, Kolegji ia kthen kërkuesit për plotësim, duke dhënë shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit të saj. Kur kërkesa paraqitet e plotësuar brenda afatit të përcaktuar për korrigjimin e të metave, kalon përsëri për shqyrtim paraprak në kolegj. Në këtë rast si datë e paraqitjes së kërkesës konsiderohet data e paraqitjes së saj për herë të parë në gjykatë. Në rast se kërkesa paraqitet në gjykatë brenda afatit të përcaktuar për korrigjimin e të metave, por e paplotësuar, kolegji vendos moskalimin për gjykim.

3. Kur kërkesa nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 31/a, pika 2, të këtij ligji, kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare. Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve.

4. Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton themelin e çështjes në këtë fazë.

5. Ankesat, lutjet dhe çdo korrespondencë tjetër që nuk përmban elementet e kërkesës, sipas nenit 27, të këtij ligji, regjistrohen në regjistër të veçantë dhe për to veprohet administrativisht.

Neni 31/a
Moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 31)

1. Vendimi për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare nga kolegji merret njëzëri, ndërsa nga Mbledhja e Gjyqtarëve merret me shumicën e votave.

2. Moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur:

a) kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;

b) kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet;

c) kërkesa është paraqitur nga një person i paautorizuar;

ç) vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;

d) kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion;

dh) kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur;

e) kërkesa është haptazi e pabazuar.

Neni 31/b
Heqja dorë nga kërkesa
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 31)

1. Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes.

2. Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese arsyeton vendimin për mospranimin e heqjes dorë.

Neni 31/c
Abuzimi me të drejtën për të paraqitur kërkesë
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 31)

1. Gjykata Kushtetuese, kur konstaton se kërkuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor paraqet kërkesë abuzive ose të përsëritur, për të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse ajo është shqyrtuar një herë nga Gjykata Kushtetuese, ose kur konstatohet se kërkuesi ose përfaqësuesi ligjor kanë fshehur ose shtrembëruar fakte dhe rrethana që lidhen me çështjen, urdhëron gjobitjen e tij në shumën nga 100 000 – 500 000 lekë. Kur Gjykata konstaton se ndodhet përpara rasteve të falsifikimit të dokumenteve ose ndonjë vepre tjetër penale, ajo njëkohësisht ia dërgon materialet për hetim prokurorisë.

2. Vendimi, në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, merret nga Mbledhja e Gjyqtarëve, me propozim të Kryetarit ose të relatorit të çështjes.

3. Gjoba e vendosur nga Mbledhja e Gjyqtarëve është titull ekzekutiv.

KREU VI
FUNKSIONIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Neni 32
Shqyrtimi në seancë plenare
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 32)

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton çështjet në seancë plenare me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë rast të jo më pak se të dy të tretave të tyre.

2. Rregullat mbi seancën plenare të zhvilluar me dyer të mbyllura caktohen me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

3. Gjatë zhvillimit të seancës respektohen rregullat e solemnitetit dhe të sigurisë, të cilat përcaktohen në Rregulloren e Gjykatës.

4. Regjistrimet radiofonike, televizive, audio ose video nga përfaqësues të medias gjatë seancës plenare lejohen vetëm me pëlqimin e gjykatës, në varësi të çështjes konkrete.

Neni 33
Thirrja dhe drejtimi i seancës plenare
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 33)

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese thërret dhe drejton seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese. Nëse Kryetari është në pamundësi për të marrë pjesë në gjykim, ai cakton gjyqtarin më të vjetër në detyrë për të kryesuar seancën.

2. Kryesuesi i seancës plenare ushtron këto detyra:

a) merr masa për hetimin e plotë dhe të paanshëm të rrethanave të çështjes;

b) orienton diskutimet mes palëve dhe shmang çdo debat të panevojshëm për çështjen;

c) ndërpret palët pjesëmarrëse kur diskutimi i tyre nuk ka lidhje me çështjen ose nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese;

ç) u heq të drejtën e fjalës palëve nëse diskutimi i tyre është arbitrar, fyes dhe në kundërshtim me rregullat e etikës dhe moralit.

3. Kryesuesi i seancës mund të urdhërojë largimin e personave nga salla kur pjesëmarrësit në gjykim nuk zbatojnë urdhërimet e kryesuesit të seancës, si

dhe kur nuk tregojnë respekt për trupin gjykues dhe Kushtetutën.

4. Seanca, si rregull, zhvillohet pa ndërprerje. Në raste të veçanta, kryesuesi i seancës, pas marrjes së mendimit të anëtarëve të trupit gjykues, mund të ndërpresë seancën kur është e nevojshme.

Neni 34
Të drejtat e gjyqtarit në gjykimin kushtetues

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë:

a) të marrë pjesë në shqyrtimin e çdo çështjeje, me përjashtim të rasteve kur ndalohet nga ligji;

b) të njihet me përmbajtjen dhe gjithë materialet e çështjes në shqyrtim;

c) gjatë shqyrtimit, t'u drejtojë pyetje e të kërkojë shpjegime nga pjesëmarrësit në gjykim, si dhe nga personat e thirrur si dëshmitarë ose ekspert;

ç) të marrë pjesë në bisedimet përfundimtare dhe të shfaqë lirisht mendimin e tij për mënyrën e përfundimit të çështjes që shqyrtohet.

Neni 35
Detyrat e gjyqtarit në gjykimin kushtetues

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese duhet:

a) të përgatisë çështjen për gjykim, si dhe të marrë masat e duhura për zhvillimin e seancës plenare;

b) të votojë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes;

c) të ruajë sekretin e diskutimeve dhe të votimit.

Neni 36
Heqja dorë nga shqyrtimi i çështjes
(ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016)

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese kërkon heqjen dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur:

a) ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi;

b) ka deklaruar publikisht qëndrimin e tij ndaj çështjes;

c) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim vihet në dyshim paanshmëria e tij;

ç) paanshmëria e tij vihet në dyshim për shkaqe të tjera.

2. Kur objekt shqyrtimi është një ligj ose akt normativ, i cili mund të ketë efekte edhe për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, heqja dorë e tij ose kërkesa për përjashtim për këtë shkak nuk pranohet.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, gjyqtari, brenda një afati të arsyeshëm, i paraqet me shkrim kërkesën për heqjen dorë nga çështja e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa për heqje dorë ose për përjashtimin nga gjykimi shqyrtohet menjëherë nga Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila vendos për pranimin ose jo të saj.

Neni 37
Përjashtimi i gjyqtarit

1. Pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit në çdo fazë të zhvillimit të gjykimit kur ekziston një nga rastet e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji dhe gjyqtari nuk heq dorë nga shqyrtimi i çështjes.

2. Për përjashtimin e gjyqtarit vendos shumica e gjyqtarëve që marrin pjesë në shqyrtimin e çështjes. Gjyqtari, për të cilin kërkohet përjashtimi, pasi dëgjohet nuk merr pjesë në votim. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, gjyqtari quhet i përjashtuar.

Neni 38
Njoftimi, paraqitja e dokumenteve dhe pjesëmarrja në seancë plenare
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 35)

1. Njoftimi për orën dhe datën e zhvillimit të seancës plenare, publike ose mbi bazë të dokumenteve, bëhet nga Drejtoria Gjyqësore, si rregull, 30 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare, me përjashtim të rasteve kur Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe.

2. Njoftimi i kërkuesit, subjektit të interesuar ose përfaqësuesit të tyre ose, sipas rastit, i dëshmitarit, ekspertit apo personave të tjerë, pjesëmarrja e të cilëve është e nevojshme për zhvillimin efektiv të gjykimit kushtetues, bëhet me shkresë zyrtare, me fletëthirrje postare, me telegram, si dhe përmes e-mail-it nëse palët kanë rënë dakord për këtë mënyrë njoftimi në momentin e depozitimit të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese.

3. Kur ndonjëri nga pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues nuk ka një vendqëndrim të saktë ose ndodhet me qëndrim të përhershëm jashtë shtetit, njoftimi bëhet me letërporosi, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile dhe me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese, të

paktën 30 ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare.

4. Mosnjoftimi i rregullt shkakton shtyrjen e seancës plenare, duke caktuar një datë tjetër për zhvillimin e saj, si dhe duke bërë njoftimet përkatëse.

5. Kur kërkuesi, subjekti i interesuar ose përfaqësuesit e tyre, megjithëse janë njoftuar, nuk paraqiten në seancë plenare ose nuk dërgojnë dokumente shtesë, seanca plenare zhvillohet në mungesë.

6. Kur seanca zhvillohet mbi bazë dokumentesh, mosparaqitja brenda afatit të përcaktuar dhe pa shkaqe të përligjura e parashtrimeve nga kërkuesi dhe e prapësimeve nga subjekti/et i/e interesuara passjell zhvillimin e gjykimit vetëm mbi bazën e kërkesës dhe/ose dokumenteve shoqëruese të saj të paraqitura në momentin e regjistrimit.

Neni 39
Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues

1. Pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë:

a) Subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij.

b) Subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet.

c) Organi që ka nxjerrë aktin.

ç) Organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë.

2. Në rastet kur pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë organe shtetërore, ato përfaqësohen nga drejtuesit e tyre dhe në mungesë nga persona të autorizuar me shkrim.

3. Përfaqësues të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues mund të jenë avokatët, të cilët pajisen me prokurë ose caktohen si të tillë me deklarim në seancë plenare.

4. Dhoma Kombëtare e Avokatisë cakton listën e avokatëve që mund të marrin pjesë në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 40
Thirrja e ekspertit

1. Me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të thërrasë me cilësinë e ekspertit persona që kanë njohuri të posaçme në fushën e shkencës, teknikës ose artit për konstatimin dhe sqarimin e fakteve që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

2. Eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të dëgjohet edhe në seancë plenare.

Neni 41
Thirrja e dëshmitarit

Kur shihet e domosdoshme për sqarimin e fakteve që lidhen me çështjen në shqyrtim, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të thërrasë e të pyesë në seancë plenare persona me cilësinë e dëshmitarit.

Neni 42
Kërkimi i dokumenteve dhe detyrimi për t'i paraqitur ato
(ndryshuar titulli dhe shtuar pika 3 me ligjin nr.99/2016, neni 36)

1. Kur shihet e domosdoshme, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të kërkojë dokumente të cilat kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

2. Dokumentet e kërkuara administrohen në seancë plenare.

3. Çdo organ shtetëror, person fizik ose juridik, ka detyrimin t'i vërë në dispozicion Gjykatës Kushtetuese dokumente, të dhëna e njoftime kur këto kërkohen e çmohen të nevojshme për shqyrtimin e çështjes.

Neni 43
Zhvillimi i seancës plenare

Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare ndjek këto rregulla:

a) Deklarohet çelja e seancës plenare nga kryesuesi i saj.

b) Verifikohet paraqitja e pjesëmarrësve.

c) Verifikohet legjitimiteti i pjesëmarrësve ose i përfaqësuesve të tyre.

ç) Pyeten pjesëmarrësit nëse kanë kërkesa paraprake dhe vendoset për to.

d) Lexohet kërkesa nga gjyqtari relator.

dh) Ftohen pjesëmarrësit të parashtrojnë kërkesat dhe kundërshtimet, duke filluar nga subjekti që ka paraqitur kërkesën.

e) Pjesëmarrësit në proces japin shpjegime ose bëjnë sqarime për pyetjet e gjyqtarëve.

ë) Administrohen provat dhe ftohen pjesëmarrësit të japin mendime për përmbajtjen e tyre.

f) Ftohen pjesëmarrësit të bëjnë kërkesat përfundimtare.

g) Deklarohet nga kryesuesi mbyllja e seancës plenare dhe tërheqja për vendim.

Neni 43/a
Procedura gjatë zhvillimit të seancës publike
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 37)

1. Personat e pranishëm në sallën e gjyqit duhet të respektojnë solemnitetin e Gjykatës. Ata duhet t'i binden kërkesave të kryesuesit të seancës për mbajtjen e qetësisë.

2. Mbarëvajtja e seancës gjyqësore garantohet nga një punonjës i gjykatës. Kërkesat e tij për ruajtjen e rendit ose për zbatimin e udhëzimeve të kryesuesit të seancës janë të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në proces.

Neni 43/b
Të drejtat e pjesëmarrësve në seancë gjyqësore
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 37)

1. Pjesëmarrësit në procesin e gjykimit para Gjykatës Kushtetuese kanë këto të drejta:

a) të njihen me dokumentet e dosjes, të marrin ekstrakte ose fotokopje të tyre;

b) të marrin pjesë në shqyrtimin e provave;

c) të paraqesin prova;

ç) t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit, dëshmitarëve, ekspertëve e specialistëve;

d) të paraqesin kërkesa;

dh) të japin shpjegime me shkrim ose me gojë;

e) të paraqesin përfundimet e tyre;

ë) të kundërshtojnë kërkesat e palëve të tjera, përfundimet dhe shpjegimet e tyre, si dhe të paraqesin pretendime përfundimtare.

2. Kërkuesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërkimit ose heqjen dorë nga kërkesa.

Neni 44
Riçelja e seancës plenare

1. Nëse pas mbylljes të seancës plenare çmohet e domosdoshme sqarimi i rrethanave plotësuese, të cilat kanë rëndësi të veçantë për çështjen në shqyrtim, vendoset riçelja e saj.

2. Vendimi për riçeljen e seancës plenare merret me shumicë votash nga gjyqtarët që kanë qenë të pranishëm në seancën plenare.

3. Vendimi për riçeljen e seancës plenare u njoftohet pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në të dhe t'u jepet fjala nëse e kërkojnë, për të bërë shpjegime që i çmojnë në interes të tyre.

Neni 44/a
Shtyrja e seancës
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 38)

Gjykata mund të shtyjë shqyrtimin e çështjes nëse ajo e vlerëson të nevojshme paraqitjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve të fushës, marrjen e provave të tjera, hetimin e mëtejshëm të çështjes ose formimin e plotë të trupit gjykues. Shqyrtimi i çështjes rifillon nga momenti i ndërprerjes.

Neni 44/b
Pezullimi i gjykimit
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 38)

1. Nëse Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjes, vendos të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj ose të kërkojë amicus curia nga organizma të tjerë, ajo vendos pezullimin e shqyrtimit të çështjes.

2. Seanca rihapet menjëherë pas marrjes së opinionit këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ose amicus curia. Opinioni i marrë u njoftohet palëve bashkë me datën e seancës.

Neni 45
Pezullimi i ligjit ose aktit
(ndryshuar titulli dhe shtuar pika 5 me ligjin nr.99/2016, neni 39)

1. Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të

Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

2. Vendimi për masën e pezullimit i njoftohet organit përkatës që ka nxjerrë ligjin ose aktin, si dhe bëhet publikimi i tij.

3. Gjykata Kushtetuese në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, me vendim në seancën plenare, mund të heqë masën e pezullimit.

4. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet në vendimin përfundimtar për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit.

5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në çdo rast jepet i arsyetuar dhe publikohet menjëherë.

Neni 46
Procesverbali i seancës plenare
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 40)

Neni 47
Afati i fillimit të shqyrtimit të çështjes
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 41)

1. Shqyrtimi i çështjeve nga kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve përfundon brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton afate të tjera. Në çdo rast bisedimet dhe marrja e vendimit nga kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve bëhet mbi bazën e projektvendimit të përgatitur nga relatori.

2. Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare bëhet pasi të jenë depozituar paraprakisht nga palët të gjitha materialet e nevojshme për gjykim, si dhe çështja të jetë përgatitur në tërësi nga relatori i çështjes. Relatori i çështjes paraqet në bisedime projektvendimin përkatës, mbi të cilin votojnë të gjithë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në votim.

3. Vendimi përfundimtar shpallet i arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i seancës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 48
Kufijtë e shqyrtimit të çështjes

1. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të.

2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, vendos për çdo rast Gjykata Kushtetuese.

KREU VII
PROCEDURAT E VEÇANTA

Procedura për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjeve ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare

Neni 49
Subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 42)

1. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit.

2. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin vetëm të respektimit të procedurës së parashikuar nga Kushtetuta, sipas nenit 131, pika 2, dhe nenit 177, të Kushtetutës, e kanë Presidenti i Republikës dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve.

3. Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe:

a) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

b) organet e qeverisjes vendore, kur pretendojnë se u janë cenuar të drejtat e tyre të parashikuara në Kushtetutë ose pozita e tyre kushtetuese;

c) komisionerët e krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, kur gjatë veprimtarisë së tyre konstatojnë se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;

ç) Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë kushtetuese të tyre ose pozitën juridike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;

d) organet e bashkësive fetare, partitë politike, organizatat, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre;

dh) gjykatat e të gjitha niveleve, kur gjatë gjykimit të një çështjeje konstatojnë se ligji ose akti normativ bie ndesh me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare;

e) individët, kur pretendojnë se u cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara në Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për këtë qëllim, si dhe kur akti që kundërshtojnë është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij.

4. Subjektet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre.

Neni 50
Afati i paraqitjes së kërkesës
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 43)

1. Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d", të nenit 49, të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.

2. Kërkesat për kushtetutshmërinë e ligjit për rishikimin e Kushtetutës, në aspektin procedural, mund të paraqiten brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.

3. Gjykatat mund ta paraqesin kërkesën në çdo kohë, kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore konkrete, sipas nenit 145, pika 2, të Kushtetutës, çmojnë antikushtetutshmërinë e ligjit ose të aktit normativ.

4. Individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit.

Neni 51
(numërtuar pika 1 dhe shtuar pika 2 me ligjin nr.99/2016, neni 44)

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese vlerëson:

a) përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative;

b) formën e ligjeve dhe të akteve normative;

c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre.

2. Kur një ligj ose akt normativ ose pjesë të tij, që janë objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, shfuqizohen ose ndryshohen para se Gjykata Kushtetuese të marrë vendim, gjykimi pushohet, me përjashtim të rasteve kur ajo çmon se gjykimi duhet të vazhdojë për shkak të një interesi publik ose shtetëror.

Neni 51/a
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 45)

1. Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të çështjes vendos:

a) rrëzimin e kërkesës;

b) pranimin tërësisht ose pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ.

2. Në çdo rast Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit shprehet edhe për efektin e vendimit dhe pasojat e tij.

Procedurat mbi pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën

Neni 52
(ndryshuar pika 2 dhe fjalia e dytë e pikës 3 me ligjin nr.99/2016, neni 46)

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit.

2. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje për shqyrtimin e këtyre çështjeve vetëm me kërkesë të subjekteve të parashikuara në nenin 134, shkronjat "a", "b", "c", e "ç", të Kushtetutës. Gjykata mund të vihet në lëvizje edhe nga subjektet e parashikuara në shkronjat "d", "dh" "e", "ë" 'f" "g" "gj", "h" dhe "i", të Kushtetutës, për çështje që lidhen me interesat e tyre.

3. Në rast se çështja ka kaluar në seancë plenare, pezullohen procedurat për ratifikimin e marrëveshjes. Shqyrtimi i kërkesës përfundon brenda tre muajve nga data e paraqitjes së saj.

4. Në rast se Gjykata Kushtetuese vendos papajtueshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën, ajo nuk mund të ratifikohet.

Neni 52/a
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 47)

1. Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të çështjes vendos:

a) deklarimin e marrëveshjes ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën dhe lejimin e ratifikimit të saj nga Kuvendi.

b) deklarimin e marrëveshjes ndërkombëtare të papajtueshme me Kushtetutën dhe ndalimin e ratifikimit të saj nga Kuvendi.

2. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese u njoftohet menjëherë Presidentit, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave dhe dërgohet për publikim në Fletoren Zyrtare.

Neni 53
Marrëveshjet ndërkombëtare të miratuara para hyrjes në fuqi të Kushtetutës
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 48)

1. Marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe që janë të papajtueshme me të, mund të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese vetëm nga Këshilli i Ministrave.

2. Në rast se Gjykata Kushtetuese konstaton se marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar me ligj përmban dispozita që bien në kundërshtim me Kushtetutën, ajo vendos shfuqizimin e aktit të ratifikimit të saj.

Procedurat lidhur me mosmarrëveshjet e kompetencave

Neni 54

1. Në mbështetje të nenit 131 shkronja "ç" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese shqyrton konfliktet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore dhe kur mosmarrëveshja ka lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

2. Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe sipas rastit kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta.

3. Kërkesa para Gjykatës Kushtetuese ngrihet nga subjektet në konflikt

ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti.

4. Çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre, përbëjnë bazat për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

Neni 55

Kërkesa për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve paraqitet brenda 6 muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

Neni 56

1. Gjykata Kushtetuese vendos se cili organ i pushtetit ka në kompetencë të tij zgjidhjen e çështjes konkrete, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja .

2. Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.

Procedura për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike

Neni 57
Subjektet kërkuese
(shtuar titulli dhe ndryshuar pjesërisht pika 1 me ligjin nr.99/2016, neni 49)

1. Për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit dhe të jo më pak se një të pestës së deputetëve, të Avokatit të Popullit dhe të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Kërkesa mund të paraqitet në çdo kohë në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 58
Kufijtë e shqyrtimit
(shtuar titulli me ligjin nr.99/2016, neni 50)

Gjykata Kushtetuese shqyrton dhe vendos:

a) nëse partia ose organizata politike është krijuar në përputhje me dispozitat kushtetuese;

b) nëse veprimtaria e partisë ose e organizatës politike përputhet me Kushtetutën.

Neni 59

Kur Gjykata Kushtetuese çmon se ka të dhëna që veprimtaria e mëtejshme e një partie ose organizate politike cenon rendin kushtetues ose interesat shtetërorë apo publikë, sipas rastit, me vendim të veçantë të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare, mund të vendosë pezullimin e veprimtarisë së partisë ose të organizatës politike deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Neni 60
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese
(shtuar titulli me ligjin nr.99/2016, neni 51)

1. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se krijimi i një partie ose organizate politike vjen në kundërshtim me Kushtetutën, ajo shfuqizon aktin e krijimit.

2. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se veprimtaria e një partie ose organizate politike vjen në kundërshtim me Kushtetutën, ajo vendos sipas rastit ndalimin e kësaj veprimtarie ose urdhëron çregjistrimin e saj.

Procedurat për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij

Neni 61
Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese
(shtuar titulli me ligjin nr.99/2016, neni 52)

1. Gjykata Kushtetuese për deklarimin e shkarkimit të Presidentit të Republikës vihet në lëvizje me vendimin e Kuvendit që ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra.

2. Vendimi i Kuvendit duhet të përmbajë një përshkrim të argumentuar të shkeljes së rëndë të Kushtetutës ose të krimit të rëndë, si dhe të shoqërohet me provat përkatëse.

3. Gjykata Kushtetuese, një kopje të vendimit të Kuvendit dhe të provave përkatëse, ia dërgon Presidentit të Republikës, i cili ka të drejtë të japë me shkrim sqarimet që i çmon të nevojshme.

Neni 62
Zhvillimi i seancës
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 53)

1. Gjykata Kushtetuese për kalimin e çështjes në seancë plenare vendos me shumicën e anëtarëve të saj. Në këtë rast zhvillohet seancë plenare publike.

2. Në seancën plenare ftohet të marrë pjesë Presidenti i Republikës, i cili mund të përfaqësohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, si edhe Kuvendi. Gjykata Kushtetuese, sipas rastit, vendos të thërrasë edhe persona të tjerë në gjykim.

3. Mungesa në seancën plenare e Presidentit të Republikës ose e përfaqësuesit të tij pa arsye nuk përbën shkak për moszhvillimin e gjykimit.

Neni 63
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 54)

1. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën ose ka kryer një krim të rëndë, deklaron shkarkimin e tij nga detyra. Në këtë rast vendimi i Gjykatës Kushtetuese hyn në fuqi ditën e shpalljes dhe publikohet menjëherë në Fletoren Zyrtare.

2. Kur Gjykata Kushtetuese nuk arrin në përfundimin se Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën ose ka kryer një krim të rëndë, ajo vendos shfuqizimin e vendimit të Kuvendit.

3. Dorëheqja e Presidentit të Republikës nga detyra ose përfundimi i mandatit të tij, pas fillimit të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese, nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit të çështjes.

4. Kur vendoset deklarimi i shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, ai nuk përfiton trajtimet e veçanta të parashikuara për funksionarët e lartë.

5. Rregullat e përcaktuara në nenin 61, pikat 1, 2 dhe 3, zbatohen edhe në rastin e vërtetimit përfundimisht të faktit të pamundësisë së përhershme në ushtrimin e detyrës nga Presidenti i Republikës. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese vendos vërtetimin e faktit të pamundësisë për ushtrimin e detyrës ose rrëzon vendimin e Kuvendit.

Zgjedhshmëria dhe papajtueshmëria me ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës

Neni 64
Shqyrtimi i çështjes

(shtuar titulli dhe ndryshuar pikat 1 dhe 2 me ligjin nr.99/2016, neni 55)

1. Për çështjet që lidhen me zgjedhjen e Presidentit të Republikës, zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të tij, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të jo më pak se një të pestës së deputetëve ose të partive politike.

2. Në rastin e procedurës së zgjedhjes dhe zgjedhshmërisë, Gjykata Kushtetuese vendos shfuqizimin e vendimit të Kuvendit ose rrëzimin e kërkesës.

3. Në rastin e papajtueshmërisë për ushtrimin e detyrës, Gjykata Kushtetuese vendos deklarimin e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës ose rrëzimin e kërkesës.

Neni 65

(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 56)

Procedura për shqyrtimin e zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit

Neni 66
Subjektet kërkuese

(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 57)

1. Për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit ose të partive politike.

2. Për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit ose të një të pestës së deputetëve.

3. Gjykata Kushtetuese verifikon, sipas Kushtetutës, zgjedhjen e deputetëve, me kërkesë të partisë politike ose të kandidatit të pavarur për deputet.

Neni 66/a
Afatet e kërkesës
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 58)

1. Kërkesa për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve paraqitet në Gjykatën Kushtetuese brenda 3 muajve nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë.

2. Kërkesa për papajtueshmëri të funksionit të deputetit mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese për sa kohë vazhdon mandati i deputetit, por jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të mandatit dhe jo më vonë se 3 muaj nga konstatimi i papajtueshmërisë.

3. Gjykata Kushtetuese në këto raste përfundon shqyrtimin e çështjes brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Neni 67
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese
(shtuar titulli me ligjin nr.99/2016, neni 59)

1. Në rastet kur Gjykata Kushtetuese verifikon zgjedhshmërinë e deputetëve, ajo vendos, sipas rastit, rrëzimin e kërkesës ose shfuqizimin e aktit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për zgjedhshmërinë ose papajtueshmërinë e deputetit, Gjykata Kushtetuese, vendimin e saj ia dërgon Kuvendit.

Procedurat lidhur me referendumin
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 60)

Neni 67/a
Subjektet kërkuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 60)

1. Kuvendi, kur ndodhet në kushtet e nenit 150, pika 2, dhe 177, të Kushtetutës, ose grupi nismëtar që përfaqëson 50 mijë shtetas me të drejtë vote, kanë të drejtë t'i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese për të kryer verifikimin paraprak të kushtetutshmërisë së çështjes së shtruar për referendum.

2. Gjykata Kushtetuese vendos brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Neni 67/b
Shqyrtimi i çështjes
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 60)

1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kushtetutshmërisë së çështjeve të shtruara për referendum, Gjykata Kushtetuese vlerëson vlefshmërinë formale dhe materiale të çështjes së shtruar.

2. Gjykata Kushtetuese nuk mund të kontrollojë rëndësinë e çështjeve të veçanta apo kushtetutshmërinë e aktit që do t'i nënshtrohet referendumit.

Neni 67/c
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 60)

1. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Kushtetuese vendos:

a) deklarimin si të pajtueshme me Kushtetutën të çështjes së shtruar për referendum dhe lejimin e zhvillimit të referendumit;

b) deklarimin si të papajtueshme me Kushtetutën të çështjes së shtruar për referendum.

2. Në kushtet kur gjen zbatim shkronja "b", e këtij neni, referendumi nuk zhvillohet.

Neni 67/ç
Verifikimi i rezultatit përfundimtar të referendumit
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 60)

1. Brenda 10 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar të referendumit, subjektet e parashikuara në nenin 134, shkronjat "e", "f", "gj" dhe "h", të Kushtetutës, kur çështja lidhet me interesat e tyre, ose grupi nismëtar për zhvillimin e referendumit kanë të drejtë të kërkojnë verifikimin e këtij rezultati nga Gjykata Kushtetuese.

2. Gjykata Kushtetuese jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Në raste të veçanta Gjykata Kushtetuese mund të vendosë shtyrjen e afatit me jo më shumë se 30 ditë.

Neni 67/d
Shqyrtimi i çështjes
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 60)

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton bazueshmërinë e pretendimeve të natyrës kushtetuese dhe që kanë të bëjnë me ushtrimin e së drejtës së votës

nga shtetasit që kanë marrë pjesë në referendum, vlefshmërinë e procesit referendar, si dhe procesin e shpalljes së rezultatit të referendumit.

2. Kur Gjykata Kushtetuese vlerëson si të nevojshëm rinumërimin e votave, ajo urdhëron Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të kryejë një procedurë të tillë.

3. Pas kryerjes së procedurës, sipas pikës 2, të këtij neni, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i njofton rezultatin Gjykatës Kushtetuese.

Neni 67/dh
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 60)

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Kushtetuese vendos:

a) rrëzimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të rezultatit përfundimtar të referendumit;

b) shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin e ligjit si të pandryshuar ose të shfuqizuar;

c) shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin e çështjes ose projektligjit të rëndësisë së veçantë si të miratuar ose jo;

ç) përsëritjen e referendumit.

Procedurat e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjeve të kërkuara nga gjykatat

Neni 68
Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese
(shtuar titulli me ligjin nr.99/2016, neni 61)

1. Kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

2. Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojnë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cenuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij.

Neni 69
Shqyrtimi i çështjes
(shtuar titulli me ligjin nr.99/2016, neni 62)

1. Gjykata Kushtetuese, kur konstaton se çështja nuk është e plotë dhe në përputhje me nenin 68 të këtij ligji, ia kthen atë gjykatës që e ka dërguar. Kjo e fundit detyrohet të plotësojë materialet brenda 1 muaji nga data e mbërritjes.

2. Kur materialet e dosjes janë të plota dhe në përputhje me nenin 68, Gjykata Kushtetuese cakton datën e seancës për shqyrtimin e çështjes, duke njoftuar gjykatën dhe thirrur subjektet e interesuara.

Neni 70
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 63)

1. Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjeve të parashikuara në nenet 68 e 69, të këtij ligji, dhe për arsye që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e një ligji konkret, publikon faktin se çështja është nën shqyrtimin e saj.

2. Kur çështja e paraqitur nga Gjykata e Lartë kalon për gjykim në seancë plenare, gjykatat e tjera pezullojnë çështjet në gjykim, për të cilat gjen zbatim ligji i kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese.

3. Në rastet kur Gjykata Kushtetuese e shfuqizon ligjin si antikushtetues, vendimin e saj ia njofton Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.

Procedura për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 64)

Neni 71
E drejta për të ushtruar ankimin kushtetues individual
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 65)

1. Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kritereve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji.

2. Objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, sipas nenit 49, pika 3, të këtij ligji.

3. Gjykata Kushtetuese shqyrton përfundimisht ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas nenit 140, pika 4, dhe 148/d, të Kushtetutës.

Neni 71/a
Kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 66)

1. Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur:

a) kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion;

b) kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit;

c) pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin;

ç) shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.

2. Përveç kritereve të parashikuara në pikën, 1 të këtij neni, gjejnë zbatim rregullimet e parashikuara në këtë ligj për shqyrtimin paraprak.

Neni 71/b
Shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 66)

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton nëse akti, pjesërisht ose tërësisht, është në përputhje me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Gjykata Kushtetuese mund të shprehet edhe për dispozita të tjera që nuk janë objekt i kërkesës, në rast se çmon se kanë lidhje me çështjen në gjykim.

2. Kur Gjykata Kushtetuese shqyrton kushtetutshmërinë e një akti dhe arrin në përfundimin se ai bazohet mbi një ligj ose akt normativ antikushtetues, gjykata vendos njëkohësisht edhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ.

3. Në rastet kur gjen zbatim pika 2, e këtij neni, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk shtrihen ndaj akteve që kanë përfunduar efektet ose vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë.

4. Gjykata Kushtetuese e shqyrton kërkesën brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 71/c
Detyrimet që rrjedhin nga vendimmarrja e gjykatave ndërkombëtare
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 66)

1. Për qëllimet e këtij ligji, gjykatat ndërkombëtare janë ato gjykata, juridiksioni i të cilave shtrihet ndaj shtetit shqiptar, si pasojë e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

2. Nëse një gjykatë ndërkombëtare konstaton se Republika e Shqipërisë ka shkelur detyrimin që rrjedh nga një marrëveshje ndërkombëtare dhe, si rrjedhojë, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi fizik ose juridik nëpërmjet një ligji ose akti normativ, Gjykata Kushtetuese, me kërkesë, mund të shfuqizojë ligjin ose aktin normativ nëse konstaton se nuk ka mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtat e cenuara.

3. Nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur më parë mbi një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesit gjyqësor.

4. Kërkesa për rihapje të procesit para Gjykatës Kushtetuese paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Ajo duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, si dhe kërkimet konkrete. Kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit dhe shfuqizimin e aktit.

5. Kërkesa për rihapje të procesit nuk pranohet nëse:

a) pasojat e cenimit të të drejtave dhe lirive themelore nuk ekzistojnë më;

b) gjykata ndërkombëtare ka dhënë një dëmshpërblim, pa e shoqëruar me rihapje të procesit (just satisfaction);

c) cenimi është mënjanuar nga një rregullim i ri ligjor ose forma të tjera.

6. Gjykata Kushtetuese, kur pranon kërkesën, vendos:

a) shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe pranimin e kërkesës;

b) shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe njëkohësisht të aktit që ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesit dhe detyrimin e organit kompetent të nxjerrë një akt të ri ose detyrimin e organit të mos veprojë, sipas rastit.

Neni 71/ç
Shqyrtimi i kërkesave për tejzgjatje të procesit para Gjykatës Kushtetuese
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 66)

1. Kushdo që është palë në një proces që zhvillohet para Gjykatës Kushtetuese ose palë në një proces gjyqësor të pezulluar, si rrjedhojë e një kontrolli incidental ose shqyrtimi të kushtetutshmërisë së ligjit të iniciuar nga subjekte të tjera, të parashikuara në nenin 134, të Kushtetutës, dhe pretendon se gjykimi është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm, ka të drejtë të kërkojë shpërblim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese, nëse konstatohet se nga tejzgjatja e procesit atij i janë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të parashikuara nga Kushtetuta.

2. Në çdo rast, pavarësisht pasojave, kërkuesi nuk mund të paraqesë kërkesë pa kaluar të paktën një vit nga fillimi i shqyrtimit të çështjes.

3. Gjykata Kushtetuese, në çdo rast, vlerëson natyrën e procesit dhe të çështjes, si dhe rrethanat që kanë ndikuar në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese. Ajo vendos për masën e dëmshpërblimit, duke iu referuar pasojave që i kanë ardhur kërkuesit nga tejzgjatja e procesit para saj.

4. Nëse Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se gjykimi është zgjatur tej afatit, pa shkak të arsyeshëm, atëherë ajo dëmshpërblen kërkuesin deri në masën 100 000 lekë për çdo vit vonesë.

Neni 71/d
Shqyrtimi i kërkesave sipas nenit 179/1 të Kushtetutës
(shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 66)

1. Gjykata Kushtetuese, me kërkesë të jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit, shqyrton rastet e parashikuara nga neni 179/1 i Kushtetutës.

2. Gjykata Kushtetuese në këtë rast shqyrton nëse ndodhet në kushtet e mosveprimit të organeve të ngarkuara nga Kushtetuta apo ligji për konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të zyrtarit të zgjedhur, të emëruar apo funksionarit të lartë publik.

3. Gjykata Kushtetuese në fund të shqyrtimit vendos:

a) rrëzimin e kërkesës;

b) konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik.

KREU VIII
VENDIMET E GJYKATES KUSHTETUESE

Neni 72
Marrja e vendimit dhe shpallja e tij
(ndryshuar pika 6 me ligjin nr.99/2016, neni 67)

1. Bisedimet si dhe votimi i vendimit bëhen pa praninë e personave të tjerë.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Abstenimi nuk lejohet.

3. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes.

4. Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces. Mungesa e tyre nuk pengon shpalljen e tij.

5. Vendimi jepet "Në Emër të Republikës së Shqipërisë".

6. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese shpallet i arsyetuar. Në raste të veçanta që kanë të bëjnë me çështje të rëndësisë publike, Gjykata Kushtetuese mund të njoftojë dispozitivin e vendimit menjëherë pas marrjes së tij dhe shpall vendimin e arsyetuar brenda 5 ditëve. Në këtë rast, vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij bashkë me arsyetimin, përveç rasteve kur gjykata vendos ndryshe.

7. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar.

8. Gjyqtari që mbetet në pakicë ka të drejtë të arsyetojë mendimin e tij që i bashkohet vendimit dhe botohet bashkë me të.

9. Kopje të vendimit mund t'u jepen pjesëmarrësve në proces me kërkesën e tyre, kundrejt tarifës së caktuar.

Neni 73
Shtyrja e bisedimit dhe votimit
(shtuar pika 4 me ligjin nr.99/2016, neni 68)

1. Kur ndonjëri prej gjyqtarëve që ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes mungon në bisedime ose në votim, Mbledhja e Gjyqtarëve nuk zhvillohet dhe shtyhet për një datë tjetër.

2. Në qoftë se edhe pas kësaj, pjesëmarrja e gjyqtarit nuk mund të

sigurohet brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vendos përfundimisht për çështjen, kur formohet shumica absolute e anëtarëve të saj.

3. Në rast se kjo shumicë nuk formohet dhe ekziston mundësia për përfshirjen në këtë gjykim të gjyqtarëve të tjerë, që më parë nuk kanë marrë pjesë në të, seanca riçelet dhe shqyrtimi i çështjes fillon nga e para.

4. Kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

Neni 74
Refuzimi i kërkesës
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 69)

Neni 75
Mosndryshimi i vendimit

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, pas votimit, konsiderohet i marrë dhe nuk mund të ndryshohet.

Neni 76
Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 70)

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim.

2. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi, përveç rasteve të parashikuara ndryshe nga ky ligj.

3. Gjykata Kushtetuese, në çdo rast, shprehet edhe për efektet e vendimit të saj.

4. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që vendimi për shfuqizimin e një akti të prodhojë pasoja në një datë tjetër të ndryshme nga hyrja e tij në fuqi. Në këtë rast Kuvendi apo çdo institucion tjetër bën ndryshimet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në përputhje me pjesën arsyetuese të tij.

5. Kur Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të një çështjeje, konstaton se ka boshllëk ligjor, si rrjedhojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative për të drejtat dhe liritë themelore të individit, ajo, veç të tjerave, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar.

6. Vendimet e gjykatave të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga momenti i marrjes së tyre. Çështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i së cilës është shfuqizuar.

7. Vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm:

a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;

b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë;

c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar.

Neni 77
Efektet juridike të vendimeve gjyqësore
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 71)

Neni 78
Njoftimi i vendimit

Kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj.

Neni 79
Vendimi interpretues
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 72)

Neni 80
Saktësimi dhe plotësimi i vendimit
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 73)

1. Gjykata Kushtetuese ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit.

2. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Gjykata Kushtetuese merr vendim, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 81
Ekzekutimi i vendimeve
(ndryshuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr.99/2016, neni 74)

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim.

2. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore.

3. Gjykata Kushtetuese, në varësi të llojit të vendimit dhe kur është e nevojshme, mund të caktojë në pjesën urdhëruese organin e ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit.

4. Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 82
Mbarimi i mandatit dhe përtëritja
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 75)

Neni 83
Përjashtimi nga taksat dhe rregullimi i shërbimeve e shpenzimeve
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 76)

Neni 84
Detyrimi për të dhënë dokumente
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 77)

Neni 85
Detyrimi për publikim i njoftimeve
(shfuqizuar me ligjin nr.99/2016, neni 78)

Neni 86
Zbatimi i ligjit të ri
(ndryshuar me ligjin nr.99/2016, neni 79)
(shtuar pika 5 me ligjin 45/2021, neni 4)

1. Shqyrtimi i shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 10, të këtij ligji, për një periudhë 9-vjeçare nga hyrja në fuqi

e këtij ligji, do të bëhet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Këshilltarët ligjorë që janë emëruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, nëse përfundojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, sipas nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Këshilltarët ligjorë që ndjekin karrierën e magjistratit u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për statusin e magjistratit. Këshilltarët e tjerë ligjorë u nënshtrohen rregullave të parashikuara në këtë ligj dhe në ligjin për statusin e magjistratit, për aq sa ai gjen zbatim. Numri i tyre përcaktohet në përputhje me strukturën e Njësisë së Shërbimit Ligjor.

3. Për kërkesat dhe çështjet që janë në shqyrtim datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 50, pika 4, 71, 71/a, 71/b, 71/c dhe 71/ç, të këtij ligji, për të cilat zbatimi do të fillojë në datën 1 mars 2017.

4. Përtëritja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese deri në vitin 2022 do të bëhet sipas skemës së parashikuar më poshtë:

a) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2016, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi.

b) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2025.

c) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2019, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi.

ç) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2028.

d) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2022, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë.

5. Deri në emërimin e të paktën tre të katërtave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, por, në çdo rast, jo më vonë se data 31.12.2023, mbledhja e posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, sipas pikës 3 të nenit 7/ç të

këtij ligji, është e vlefshme nëse marrin pjesë të paktën gjysma e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Neni 87
Shfuqizimi i ligjit

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji nr.8373, datë 15.7.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Neni 88

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2561, datë 22.02.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Rexhep Meidani

LIGJ
Nr. 98/2016

PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË*

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave në lidhje me:

a) organizimin dhe funksionimin e sistemit te gjykatave ne Republikën e Shqipërisë

b) kompetencat dhe madhësitë e gjykatave;

c) organizimin e brendshëm të gjykatave;

ç) funksionimin e administratës së gjykatës;

d) statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë.

2. Ky ligj zbatohet për çdo gjykatë me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatë të posaçme të krijuar me ligj.

* Ndryshuar me Ligji nr. 46 datë 23.03.2021

Neni 2
Përkufizime
(Ndryshuar shkronja (e) me Ligjin nr. 46/2021)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Administrimi gjyqësor" është tërësia e veprimtarive që synojnë organizimin dhe sigurimin e funksionimit të shërbimeve në mbështetje të sistemit gjyqësor.

b) "Administrata gjyqësore" është struktura dhe tërësia e veprimtarive që synojnë organizimin dhe sigurimin e funksionimit të gjykatave.

c) "Çështje urgjente" është çështja për të cilën dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 14 ditëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.

ç) "Degë e gjykatës" i referohet nënndarjes gjeografike të gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, e cila përbën një njësi administrative me gjykatën.

d) "Këshilltar ligjor" është këshilltari që ushtron funksionin e tij në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

dh) "Ndihmësmagjistrat" është gjyqtari i komanduar për të ndihmuar gjyqtarët në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese ose prokurorët e komanduar për të ndihmuar Prokurorin e Përgjithshëm, në trajtimin e çështjeve, në veçanti, kryerjen e kërkimit ligjor dhe përgatitjen e opinioneve me shkrim për çështje ligjore materiale ose procedurale.

e) "Ndihmës ligjor" është ndihmësi që ushtron funksionin e tij në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit.

ë) "Nëpunës civil gjyqësor " është personi, i cili ushtron funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor.

f) "Përdorues i gjykatës" është çdo person, i cili përdor shërbimet e gjykatës.

g) "Përshkrimi i punës" përcakton qëllimin e punës, përgjegjësitë kryesore të punës dhe detyrat kryesore që kryhen nga nëpunësi civil gjyqësor ose punonjësi i gjykatës.

gj) "Punonjës i gjykatës" është personi që kryen veprimtari të mirëmbajtjes,

transportit, të ruajtjes dhe veprimtari të tjera në shërbime mbështetëse të gjykatës, që nuk kryhen nga nëpunësit civilë gjyqësorë.

h) "Seksioni", në kuptim të këtij ligji, përfshin edhe Kolegjet e Gjykatës së Lartë, të cilat në këtë ligj referohen me termin kolegj.

i) "Sistemi gjyqësor" përbëhet nga të gjitha gjykatat, me përjashtim të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nga organet e qeverisjes së gjyqësorit.

j) "Shërbim civil gjyqësor" është trupa e nëpunësve civilë gjyqësorë, që ushtron funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor.

Neni 3
Llojet e gjykatave

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.

2. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykata me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe gjykata me juridiksion të përgjithshëm të apelit. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë mund të kenë degë.

3. Gjykata të posaçme janë:

a) gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit;

b) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

4. Gjykata e Lartë gjykon çështje të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm.

Neni 4
Parimet e ushtrimit të pushtetit gjyqësor

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet në emër të republikës, në përputhje me Kushtetutën, me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

2. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.

3. Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksionit dhe vendimmarrjes, janë të pavarur dhe të paanshëm.

4. Në ushtrimin e pushtetit gjyqësor çdo gjykatë ndihmohet nga administrata gjyqësore, e cila përfshin shërbimet e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe shërbime të tjera mbështetëse.

5. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, administrata gjyqësore respekton pavarësinë e gjyqtarëve, duke shmangur çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor.

6. Çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor sjell përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 5
Aksesi në gjykata

1. Çdo person trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim nga gjykatat.

2. Çdo person ka akses të barabartë në gjykatë, si dhe ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij ligjore, siç parashikohet me ligj.

3. Seanca gjyqësore është publike, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

4. Gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase.

Neni 6
Konflikti i interesit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, nëpunësit civilë gjyqësorë janë të detyruar të shmangin çdo konflikt interesi, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave.

Neni 7
Parimi i bashkëpunimit

1. Administrimi gjyqësor është detyrë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Gjykatës, kryetarit të gjykatës, kancelarit, kategorive të ndryshme të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe çdo institucioni tjetër të përcaktuar me ligj.

2. Të gjitha organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, bashkëpunojnë për të garantuar që pushteti gjyqësor të jetë i pavarur, efikas, i besueshëm dhe transparent.

Neni 8
Parimet e shërbimit civil gjyqësor

1. Veprimtaria e shërbimit civil gjyqësor rregullohet me ligj dhe bazohet mbi parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve efiçente dhe të aksesueshme për çdo person.

2. Statusi i nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor mbështetet në parimin e garantimit të qëndrueshmërisë, bazuar në meritë dhe zhvillimin transparent të karrierës.

Neni 9
Zbatimi i ligjeve të tjera

Dispozitat e këtij ligji plotësohen me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit "Për nëpunësin civil", përveç rasteve dhe për aq sa në këtë ligj nuk parashikohet ndryshe.

KREU II
KOMPETENCAT DHE MADHËSIA E GJYKATAVE

SEKSIONI I
KOMPETENCAT TOKËSORE DHE JURIDIKSIONALE TË GJYKATAVE

Neni 10
Kompetencat tokësore të Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjykata e Lartë e ka selinë në Tiranë.

Neni 11
Kompetencat tokësore të Gjykatës së Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar organizohen dhe funksionojnë për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë.

Neni 12
Kompetencat tokësore të Gjykatës Administrative të Apelit

Gjykata Administrative e Apelit organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë.

Neni 13
Kompetencat tokësore të gjykatave të tjera

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor bën vlerësimin e organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo pesë vjet.

2. Në rast se nga vlerësimi rezulton se harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbush objektivat, parimet dhe kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë hartojnë një propozim të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave.

3. Përpara se të miratojnë propozimin e përbashkët, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë marrin mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Financave dhe këshillohen me palë të tjera të interesuara.

4. Procesi për caktimin ose caktimi rishtas i rretheve gjyqësore dhe i kompetencave tokësore të gjykatave kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në vlerësimin e plotë të situatës dhe duke marrë në konsideratë objektivat, parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, dhe nevojën për vazhdimësi të shërbimeve gjyqësore, transferimin e personelit dhe organizimin e logjistikës.

5. Propozimi i përbashkët i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrit të Drejtësisë për hartën gjyqësore i përcillet për miratim Këshillit të Ministrave nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 14
Objektivat për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave

Kompetencat tokësore caktohen duke synuar përmbushjen në mënyrë të ekuilibruar të objektivave të mëposhtëm:

a) garantimin e aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën;

b) uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike;

c) rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.

Neni 15
Parimet dhe kriteret për përcaktimin e kompetencave tokësore

1. Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në rrethe gjyqësore, që është njësia ku funksionon një gjykatë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Një rreth gjyqësor mund të mbulojë një ose më shumë njësi të pushtetit vendor.

2. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të apelit dhe gjykatat e posaçme i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore mbi të paktën dy rrethe gjyqësore.

3. Rrethet gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave caktohen duke marrë parasysh, në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme, kriteret e mëposhtme:

a) ndarjen administrative territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike;

b) ngarkesën në gjykata, në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, efiçencën e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, burimet njerëzore në dispozicion, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

4. Me qëllim rritjen e efiçencës dhe për të siguruar specializimin në gjykata, numri minimal i gjyqtarëve do të jetë:

a) gjykata e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, së paku shtatë gjyqtarë;

b) gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, së paku dhjetë gjyqtarë;

c) gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të shkallës së parë përbëhen nga së paku 16 gjyqtarë;

ç) gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të apelit përbëhen nga së paku 11 gjyqtarë.

5. Secili gjyqtar që ushtron funksionin në gjykata me juridiksion të përgjithshëm ose në gjykata administrative duhet të ketë një numër mesatar të çështjeve gjyqësore në vit, jo më të ulët se mesatarja e çështjeve

gjyqësore për gjyqtar në vit në të njëjtën shkallë gjykimi, në tri vitet e fundit.

Neni 16
Kompetencat juridiksionale të gjykatave

Kompetencat juridiksionale të gjykatave parashikohen nga ligjet procedurale.

SEKSIONI II
DEGËT E GJYKATAVE

Neni 17
Degët e gjykatave
(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 5 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Gjykata e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm mund të ushtrojë funksionin në selinë kryesore dhe, nëse është e nevojshme, në një ose disa degë të gjykatës.

2. Degët e gjykatave janë të përhershme dhe të përkohshme.

3. Degët e përhershme e ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme jashtë selisë kryesore të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

4. Degët e përkohshme e ushtrojnë funksionin në intervale kohore të rregullta jashtë selive kryesore të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 20 të këtij ligji e në vijim.

5. Degët e gjykatave gjykojnë çështje civile dhe penale që gjykohen nga një gjyqtar i vetëm. Gjykimi i çështjeve tregtare nuk është pjesë e kompetencës së shqyrtimit gjyqësor nga degët e gjykatave.

Neni 18
Krijimi i degëve të gjykatës

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të krijojë një degë brenda territorit të gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm ose bashkimin e degëve në juridiksionin e gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm ose degës së saj. Krijimi i një dege ose bashkimi i tyre bëhet pas këshillimit me Ministrin e Drejtësisë, me Prokurorin e Përgjithshëm, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Ministrin e Financave.

2. Krijimi i degëve të gjykatës bëhet sipas procedurës, parimeve, objektivave dhe kritereve të përcaktuara në nenet 13, pika 4, 14 dhe 15 të këtij ligji.

3. Degët e përhershme të gjykatës përbëhen nga jo më pak se tre gjyqtarë. Secili prej tyre duhet të ketë një numër mesatar të çështjeve gjyqësore në vit jo më të ulët se sa numri mesatar i çështjeve gjyqësore për gjyqtar në vit në të njëjtën shkallë gjykimi në Shqipëri në tri vitet e fundit.

Neni 19
Caktimi i gjyqtarëve në degët e gjykatave

1. Gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm shërbejnë si gjyqtarë në selinë kryesore të gjykatës ose në degën përkatëse të gjykatës. Caktimi i gjyqtarëve në degë të gjykatës është çështje e organizimit të brendshëm të gjykatës.

2. Gjyqtarët caktohen në bazë të pëlqimit të tyre.

3. Nëse asnjë gjyqtar nuk jep pëlqimin për caktimin në degë të gjykatës, Këshilli i Gjykatës i cakton ata me short çdo dy vjet.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara në lidhje me procedurën dhe kriteret për caktimin e gjyqtarëve në degët e gjykatës, duke mos përfshirë në organizimin e shortit gjyqtarët me kualifikim dhe performancë të lartë, si dhe me përvojë të gjatë profesionale.

Neni 20
Rregulla të tjera për degët e gjykatës

Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për krijimin dhe funksionimin e degëve të gjykatës, si dhe kriteret dhe procedurat për caktimin e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të gjykatës në degët e përhershme dhe të përkohshme jashtë selisë kryesore të gjykatës.

SEKSIONI III
NUMRI I GJYQTARËVE

Neni 21
Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve

në Republikën e Shqipërisë bashkë me propozimin për buxhetin e sistemit gjyqësor, sipas procedurës së caktuar me ligj.

2. Përpara se të miratojë propozimin, Këshilli i Lartë Gjyqësor merr mendimin e Këshillave të Gjykatës, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe këshillohet me palë të tjera të interesuara, sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

3. Procesi i përcaktimit të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve mbështetet në objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, si dhe kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në vlerësime të plota të kritereve të administratës gjyqësore, siç përcaktohen nga neni 15 pika 3, shkronja "b", e këtij ligji.

Neni 22
Numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr vazhdimisht ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, me qëllim përmirësimin e efiçencës së gjykatave ose zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përgatit dhe publikon brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e efiçencës së gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

3. Të paktën çdo pesë vjet Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë dhe nëse është e nevojshme rishikon numrin e gjyqtarëve pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Gjykatës.

4. Procesi i përcaktimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë mbështetet në objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, me qëllim sigurimin e ngarkesës së ekuilibruar të punës së gjithë gjyqtarëve në Shqipëri. Procesi kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në analizën e raporteve vjetore dhe efiçencës së masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet vjetore, sipas pikës 2 të këtij neni.

KREU III
ORGANIZIMI I BRENDSHËM I GJYKATAVE

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR TË GJITHA GJYKATAT

Neni 23
Krijimi i seksioneve dhe trupave gjykuese në gjykata

1. Për të mundësuar specializimin, gjykata mund të organizohet në seksione kur kjo është e nevojshme, bazuar në kritere objektive, në veçanti në numrin e gjyqtarëve në gjykatë, llojin dhe numrin e çështjeve në të paktën tri vitet e fundit në atë gjykatë. Seksionet e gjykatave përbëhen nga së paku gjashtë gjyqtarë.

2. Trupat gjykuese në çdo gjykatë krijohen sipas rregullave të parashikuara në ligjin procedural.

3. Caktimi i gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues bëhet duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe fushën e tyre të interesit.

4. Pas marrjes së mendimit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, Këshilli i Gjykatës mund të krijojë një ose më shumë seksione në gjykatë. Këshilli i Gjykatës, pasi ka caktuar gjyqtarët në degë, nëse ka të tilla, krijon trupat gjykues dhe më pas cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues.

5. Vendimet e Këshillit të Gjykatës, të marra sipas rregullave të parashikuara në pikën 4, të këtij neni, rishikohen, të paktën çdo dy vjet dhe sa herë është e nevojshme, me qëllim zëvendësimin e gjyqtarëve që nuk janë më në detyrë në atë gjykatë, caktimin e gjyqtarëve të caktuar rishtazi, të transferuar ose të ngritur në detyrë në gjykatë, në seksione dhe trupa gjykues.

6. Në rast se gjyqtari duhet zëvendësuar përkohësisht në ushtrimin e detyrës në trupin gjykues, trupi gjykues plotësohet nga gjyqtarë të trupave të tjerë gjykues të të njëjtit seksion. Zëvendësimi i përkohshëm i gjyqtarëve bëhet me short.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën e krijimit të seksioneve, trupave gjykues dhe caktimin e gjyqtarëve në to.

Neni 24
Trupat gjykues
(Ndryshuar me Ligjin nr. 46/2021)

Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe gjykata e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të shkallës së parë dhe të apelit gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, ose me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, sipas parashikimeve të ligjeve procedurale, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

Neni 25
Ndarja e çështjeve gjyqësore me short

1. Ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, i cili realizohet në rrugë elektronike, bazuar në parimet e transparencës dhe të objektivitetit.

2. Kancelari i gjykatës mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të hollësishme për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short, të cilat në veçanti përcaktojnë:

a) programin për organizimin e shortit, me qëllim që të disponojë karaktere dhe parametra të mjaftueshëm, të cilët sigurojnë standardet më të larta të transparencës dhe të kapaciteteve të gjurmimit;

b) mënyrën transparente të dokumentimit të përgatitjes së shortit;

c) afatet e organizimit të shortit dhe mënyrën e njoftimit paraprak të tij;

ç) kriteret për sigurimin e ndarjes së drejtë të çështjeve ndërmjet gjyqtarëve;

d) rastet dhe kriteret e rindarjes së çështjeve me short, kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara;

dh) kritere transparente dhe objektive për procedurën e përjashtimit të gjyqtarëve nga shorti për shkak të ngarkesës ose për shkak të angazhimit të gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor;

e) kritere transparente dhe objektive për ndarjen e çështjeve në rast mosfunksionimi të sistemit elektronik të çështjeve.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht inspektime të ndarjes së çështjeve me short. Ai kontrollon raportet e sistemit elektronik të paktën një herë në vit.

Neni 26
Kryetari dhe zëvendëskryetari i gjykatës
(Ndryshuar fjalia e dytë e pikës 3; fjalia e tretë e pikës 4; shtuar pika 5/1 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Kryetari i një gjykate zgjidhet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe ka kompetencat e përcaktuara sipas këtij ligji.

2. Në mungesë të kryetarit, kompetencat e tij ushtrohen nga zëvendëskryetari.

3. Zëvendëskryetari duhet të ketë të paktën pesë vjet përvojë profesionale si gjyqtar, nga të cilat të paktën tre vjet në të njëjtën shkallë. Zëvendëskryetari zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve ndërmjet gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në atë gjykatë për një mandat trevjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje.

4. Vendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e zëvendëskryetarit merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Të gjithë gjyqtarët me funksionin e gjyqtarit ose ndihmësmagjistratit në atë gjykatë, në momentin e votimit janë anëtarë dhe kanë për detyrë të votojnë. Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve që ushtrojnë detyrën në gjykatë. Në rast të një rezultati të barabartë të kandidatëve, përparësi ka gjyqtari me përvojën më të gjatë profesionale si gjyqtar.

5. Rezultatet e votimit ruhen në një listë me renditjen e kandidatëve për tre vjet nga data e votimit. Në rast se zëvendëskryetari është në pamundësi për të ushtruar detyrën ose përfundon veprimtarinë si gjyqtar i asaj gjykate për çfarëdo arsye, gjyqtari përkatës vijues me numrin më të madh të votave në listë e zëvendëson atë.

5/1. Në rastet kur nuk konkurron asnjë nga gjyqtarët që plotësojnë kriterin e përvojës minimale profesionale, ose kur asnjë nga gjyqtarët e gjykatës nuk e ka këtë përvojë, zëvendëskryetari i gjykatës zgjidhet ndërmjet gjyqtarëve të tjerë, që ushtrojnë funksionin në atë gjykatë, për një mandat njëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të hollësishme për procedurën e zgjedhjes së zëvendëskryetarit.

Neni 27
Përbërja e këshillave të gjykatës

1. Në çdo gjykatë ngrihet dhe funksionon Këshilli i Gjykatës.

2. Këshilli i Gjykatës përbëhet nga tre anëtarët e mëposhtëm, përveç kur parashikohet ndryshe në pikat 3 dhe 4 të këtij neni:

a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës;

b) zëvendëskryetari i gjykatës;

c) kancelari i gjykatës.

3. Në rastet kur Këshilli i Gjykatës vendos për çështje të tjera të ndryshme nga ato disiplinore në lidhje me kancelarin, ai përbëhet nga:

a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës;

b) zëvendëskryetari i gjykatës;

c) gjyqtari i renditur më pas, i zgjedhur në përputhje me parashikimet e nenit 26, pika 5, të këtij ligji.

4. Në rastet kur Këshilli i Gjykatës vepron si komision disiplinor në procedimin ndaj nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, ai përbëhet nga:

a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës;

b) zëvendëskryetari i gjykatës;

c) një nëpunës i lartë civil gjyqësor i Këshilli të Lartë Gjyqësor, i caktuar nga ky i fundit.

5. Nëse Këshilli i Gjykatës për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk e siguron përbërjen e përcaktuar, sipas parashikimeve të pikave 3 dhe 4, të këtij neni, atëherë kryetari i gjykatës së apelit me juridiksion të përgjithshëm vepron si anëtar zëvendësues në Këshillin e Gjykatës.

Neni 28
Funksionimi i Këshillit të Gjykatës

1. Këshilli i Gjykatës drejtohet nga kryetari.

2. Mbledhja e Këshillit të Gjykatës thirret nga kryetari pa vonesë në çdo rast që këshilli duhet të përmbushë një detyrë të përcaktuar nga ky ligj,

me iniciativë të tij ose me kërkesë të motivuar me shkrim të cilitdo anëtar të këshillit. Kryetari, të paktën tri ditë përpara mbledhjes, njofton anëtarët për kohën, vendin dhe rendin e ditës, duke u dërguar atyre materialet dhe projektvendimet që do të shqyrtohen.

3. Kur në rendin e ditës përfshihet marrja e një vendimi, materiali duhet të përmbajë projektvendimin bashkë me arsyetimin ligjor të propozuar.

4. Në raste të veçanta, me kërkesë të cilitdo anëtar dhe me pëlqimin e të gjithë anëtarëve, Këshilli i Gjykatës, mund të diskutojë dhe të vendosë për një çështje, e cila nuk është përfshirë në rendin e ditës.

5. Mbledhjet e Këshillit të Gjykatës regjistrohen dhe regjistrimi zbardhet brenda pesë ditëve nga zhvillimi i mbledhjes. Saktësia e zbardhjes konfirmohet nga të gjithë anëtarët, nëpërmjet nënshkrimit të procesverbalit.

6. Këshilli i Gjykatës, pas shqyrtimit të projektakteve, vendos:

a) miratimin e tij;

b) miratimin me ndryshime, të cilat pasqyrohen menjëherë në tekstin e projektaktit;

c) përgatitjen e një projektakti të ri, për të vendosur lidhur me të, në mbledhjen e ardhshme.

7. Vendimet e Këshillit të Gjykatës merren me shumicën e votave të anëtarëve, të cilët duhet të jenë të gjithë të pranishëm në mbledhje. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Gjykatës.

8. Përmbledhja e procesverbalit, e cila pasqyron pikat kryesore të diskutimit për çdo temë të rendit të ditës dhe vota e secilit anëtar publikohen në faqen zyrtare të gjykatës. Anëtarët mbajnë përgjegjësi për votimin e tyre në lidhje me mënyrën e ushtrimit të detyrave si anëtar i Këshillit të Gjykatës.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës.

Neni 29
Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës
(Shtuar fjalia e dytë e pikës 1 *me Ligjin nr. 46/2021)*

1. Mbledhja e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës thirret rregullisht dhe kryesohet nga kryetari i gjykatës. Në mbledhje marrin pjesë të gjithë gjyqtarët që ushtrojnë detyrën. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e gjyqtarëve.

2. Kryetari siguron që mbledhja të zhvillohet me regjistrim audio dhe të mbahet procesverbal për diskutimet e zhvilluara. Regjistrimi audio dhe procesverbali i mbledhjes i zbardhur ruhet për të paktën dhjetë vjet dhe i vihet në dispozicion gjyqtarëve të gjykatës, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Akses mund t'u jepet personave dhe institucioneve të tjera të interesuara, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Kryetari njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor për datën dhe rendin e ditës së mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve kur diskutohet analiza vjetore e gjykatës, të paktën dy javë më parë. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të vendosë për të marrë pjesë në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve përmes anëtarëve të tij si vëzhgues.

4. Kryetari mund të ftojë në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve, nëpunës civilë gjyqësorë në detyrë ose që kryejnë praktikën profesionale, ose palë të tjera të interesuara.

SEKSIONI II
DISPOZITA TË VEÇANTA PËR GJYKATËN E LARTË

Neni 30
Analogjia e dispozitave të tjera

Rregullimet e parashikuara në nenet e seksionit I të këtij kreu aplikohen për aq sa gjejnë zbatim edhe për Gjykatën e Lartë, përveç kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

Neni 31
Kolegjet dhe trupat gjykues të Gjykatës së Lartë

(Ndryshuar fjalia e dytë e pikës 2, fjalia e dytë e pikës 3, fjalia e dytë e pikës 4 dhe pika 5; Shfuqizuar fjalia e fundit e pikës 3 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ.

Kryetari i kolegjit zgjidhet nga anëtarët e tij me shumicë të thjeshtë votash për periudhën njëvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Kolegji Civil shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. Kolegji Civil gjykon në kolegj me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Në rastet e gjykimeve

për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore Kolegji Civil gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.

3. Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar për çështje penale, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. Kolegji Penal gjykon në kolegj me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Në rastet e gjykimeve për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore Kolegji Penal gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.

4. Kolegji Administrativ shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave administrative. Kolegji Administrativ gjykon me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet, me përjashtim të rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, që kanë shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ, si dhe gjykimeve në seancë gjyqësore për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë.

5.Trupi gjykues kryesohet nga kryetari i kolegjit dhe në mungesë të tij nga gjyqtari relator. Në rastin kur në trup gjykues është kryetari i gjykatës, ai kryesohet nga ky i fundit.

Neni 32
Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë
(Ndryshuar pika 2 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara për çështje civile, penale ose administrative, të cilat, me vendim të një prej trupave gjykues ose të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, paraqiten për shqyrtim për ndryshimin e praktikës gjyqësore.

2. Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë çështjet kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar sipas rregullave të caktuara në legjislacionin procedural civil, penal dhe administrativ në fuqi.

Neni 33
Përbërja dhe gjykimi në Kolegje të Bashkuara

1. Kolegjet e Bashkuara kryesohen nga Kryetari i Gjykatës së Lartë ose në mungesë të tij nga zëvendëskryetari.

2. Kolegjet e Bashkuara gjykojnë kur në to marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

3. Vendimi merret me shumicën e votave të gjyqtarëve që marrin pjesë në

gjykim. Në rast të një numri të barabartë votash, votimi bëhet sërish dhe nëse numri është sërish i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

4. Kur Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara, sipas nenit 32, pika 1, e këtij ligji, krahas relatorit të çështjes në trupin gjykues që ka paraqitur çështjen, caktohet me short edhe një relator tjetër nga një tjetër trup gjykues që ka të bëjë me interpretimin e së njëjtës çështje. Relatorët, në mënyrë të pavarur, përgatisin relatimin e tyre mbi interpretimin e ligjit, gjendjen e praktikës gjyqësore, qëndrimet e doktrinës juridike dhe i paraqesin ato përpara Kolegjeve të Bashkuara.

Neni 34
Njësia e Shërbimit Ligjor

(Ndryshuar shkronja (b) e pikës 6; shfuqizuar shkronja (e) e pikës 6 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Pranë Gjykatës së Lartë funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor.

2. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë duke përfshirë:

a) analizimin e praktikës gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim;

b) analizimin e çështjes dhe përmbledhjen e procedurës;

c) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtari.

3. Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Kryetarit të Gjykatës, i cili për çdo çështje gjyqësore cakton këshilltarin ligjor, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre.

4. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

5. Këshilltarët ligjorë jomagjistratë emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj. Këshilltari ligjor që vjen nga radhët e juristëve përfiton pagë të barabartë me "pagën bruto fillestare" të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

6. Këshilltari ligjor jomagjistrat duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë diplomuar në drejtësi në nivelin "Master shkencor", të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) përvojë profesionale jo më pak se 5 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;

c) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare;

ç) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit Europian;

d) aftësi të shkrimit dhe arsyetimit ligjor;

dh) të mos ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme;

7. Këshilltari ligjor dhe ndihmësmagjistrati u nënshtrohen rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesave ashtu si magjistrati.

8. Këshilli i Gjykatës përfshin në projektbuxhetin që paraqet në Këshillin e Lartë Gjyqësor propozimin për numrin e këshilltarëve ligjorë.

9. Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve miraton rregulla të detajuara për numrin e këshilltarëve ligjorë dhe funksionimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor.

Neni 35
Qendra e dokumentacionit

1. Qendra e dokumentacionit bën:

a) sigurimin e publikimit të menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;

b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë;

c) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave

të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave.

2. Qendra e dokumentacionit punon nën mbikëqyrjen e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

3. Vendimet e trupave gjykues të Gjykatës së Lartë, bashkë me mendimin e pakicës, publikohen në Buletinin Periodik të Gjykatës, në përputhje me ligjin "Për Qendrën e Botimeve Zyrtare".

4. Vendimet e Gjykatës së Lartë për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore publikohen në Fletoren Zyrtare të radhës.

KREU IV
FUNKSIONIMI I ADMINISTRIMIT GJYQËSOR

SEKSIONI I
KOMPETENCAT E ORGANEVE TË ADMINISTRIMIT GJYQËSOR

Neni 36
Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në kompetencë organizimin dhe funksionimin e shërbimeve, të cilat lidhen me administrimin gjyqësor, sipas kompetencave të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Neni 37
Kompetencat e kryetarit të gjykatës

Kryetari i gjykatës ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ushtron këto detyra:

a) përfaqëson gjykatën në marrëdhënie me të tretët;

b) në fillim të çdo viti miraton një listë, e cila përditësohet kur është e nevojshme, që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, siç përcaktohet me ligj, sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;

c) mban kontakt me grupet e kontrollit të institucioneve të tjera

shtetërore, njihet me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijon atyre mundësi për ushtrimin e detyrës;

ç) mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve;

d) mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe kërkon fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre;

dh) kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jogjyqësore nëpërmjet kancelarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj;

e) thërret, përgatit dhe drejton mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve dhe të Këshillit të Gjykatës, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj;

ë) udhëzon dhe mbikëqyr kancelarin;

f) verifikon ankesat, heton shkeljet disiplinore dhe propozon fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelarit;

g) kryen veprimet dhe merr vendime që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç parashikohet në këtë ligj;

gj) garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në veçanti në lidhje me masat që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore;

h) garanton qasjen dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit dhe rregullave të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë";

i) ushtron çdo detyrë tjetër që lidhet me veprimtaritë jogjyqësore të gjykatës, siç përcaktohet me ligj ose vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 38
Kompetencat e Këshillit të Gjykatës

Këshilli i Gjykatës ka kompetencat e mëposhtme:

a) miraton përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve të

shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës;

b) merr vendime në lidhje me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç përcaktohet në këtë ligj;

c) miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë;

ç) miraton strukturën e gjykatës dhe cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues pasi merr mendimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, duke ndjekur rregullat e përgjithshme të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;

d) shqyrton ankesa në lidhje me çështje të infrastrukturës së gjykatës, shërbimet ndihmëse në gjykatë dhe çështje të tjera që nuk lidhen me ushtrimin e detyrave të administratës gjyqësore dhe i raporton Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi ankesat dhe masat e marra në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;

dh) vlerëson dhe shqyrton projektbuxhetin e përgatitur nga nëpunësi i financës përpara paraqitjes në Këshillin e Lartë Gjyqësor;

e) jep informacion, mendime ose raporte të kërkuara nga institucione shtetërore sipas ligjit;

ë) bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor për çështje që lidhen me formimin fillestar dhe vazhdues të gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë;

f) organizon rregullisht takime me përdoruesit e gjykatës për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë;

g) miraton rregulla të veçanta të gjykatës për çështje të ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë;

gj) ushtron detyra të tjera të caktuara me ligj.

Neni 39
Kompetencat e kancelarit

1. Kancelari është përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor dhe në veçanti ka kompetencat e mëposhtme:

a) është anëtar me të drejtë vote në Këshillin e Gjykatës, në përputhje me nenin 27, dhe i Komisionit të Ristrukturimit, sipas pikës 6, të nenit 66, të këtij ligji;

b) kryen veprime dhe merr vendime që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë siç parashikohet në këtë ligj;

c) mbikëqyr procesin e organizimit dhe dokumentimit të ndarjes së çështjeve me short;

ç) emëron, drejton, mbikëqyr dhe shkarkon punonjësit e gjykatës;

d) mbikëqyr mirëmbajtjen e godinës së gjykatës.

2. Pas këshillimit me Kryetarin e Gjykatës, kancelari është përgjegjës për:

a) funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit dhe mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të saktë të të dhënave;

b) dorëzimin e raporteve periodike për gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve Këshillit të Lartë Gjyqësor;

c) raportimin pa vonesë Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi nevojat dhe përditësimet e nevojshme të funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve;

ç) udhëzimin dhe mbikëqyrjen e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës;

d) i siguron Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë qasje në të dhënat statistikore për aq sa u nevojitet këtyre institucioneve në ushtrimin e kompetencave të tyre të caktuara me ligj;

dh) kryen çdo detyrë, siç përcaktohet me ligj ose siç autorizohet nga kryetari.

Neni 40
Kompetencat e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të gjykatës

Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve mblidhet rregullisht, të paktën një herë në muaj. Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) zgjedh një gjyqtar si zëvendëskryetar me shumicën e votave nga

radhët e gjyqtarëve të gjykatës;

b) diskuton dhe jep mendim për raportin vjetor të gjykatës;

c) diskuton çështje të natyrës juridike, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave të tjera, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktet e kontrollit dhe inspektimit të ushtruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe akte përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe çdo çështje tjetër në lidhje me gjykatën në tërësi;

ç) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

SEKSIONI II
ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 41
Organizimi i administratës gjyqësore

1. Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme:

a) shërbime gjyqësore, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që kryhen nga këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë;

b) shërbime administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore;

c) shërbime mbështetëse, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupit gjykues dhe kryesuesit të seancës, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me rregullin dhe sjelljen e përshtatshme gjatë seancës gjyqësore, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës.

2. Veprimtaritë që duhet të kryhen rregullisht për secilin nga këto shërbime përcaktohen në përshkrimin standard të punës, të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 42
Ndihmësit ligjorë të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit
(Ndryshuar titulli i nenit, pika 1 dhe pika 10; shtuar pika 1/1; me Ligjin nr. 46/2021)

1. Pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit mund të funksionojë Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

1/1. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton numrin e ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë duke u bazuar në domosdoshmërinë e tyre për mbarëvajtjen e punës në gjykatë, pasi ka vlerësuar kriteret e përcaktuara në nenin 15, pika 3, shkronja "b", të këtij ligji, llojin dhe natyrën e çështjeve për t'u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë, si dhe pas marrjes së mendimit të Këshillit të Gjykatës, ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave. Numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

2. Ndihmësi ligjor në veçanti:

a) analizon praktikën gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim;

b) përpunon çështjen dhe përgatit çështje të thjeshta standarde me shkallë kompleksiteti të ulët për marrjen e vendimit nga gjyqtari;

c) kryen detyra të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtari ose siç parashikohet në ligj.

3. Kryetari përcakton detyrat për ndihmësin ligjor, duke mbajtur parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tij, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet ndihmësve ligjorë.

4. Gjyqtari i caktuar me short për çështjen mund t'i japë udhëzime ndihmësit ligjor kur është e nevojshme. Ndihmësi ligjor është i lidhur vetëm me udhëzimet e dhëna nga gjyqtari i caktuar me short për çështjen. Çdo udhëzim për interpretimin dhe zbatimin e ligjit duhet të jetë në formë të shkruar dhe është pjesë e dosjes.

5. Gjatë përpunimit dhe përgatitjes së çështjes për vendim, ndihmësi ligjor i ushtron detyrat:

a) në mënyrë të pavarur, në bazë të vlerësimit të fakteve dhe në përputhje me një kuptim të ndërgjegjshëm të ligjit, pa asnjë ndikim të jashtëm, nxitje, presion kërcënim ose ndërhyrje, direkte ose

indirekte, nga asnjë dhe për asnjë arsye;

b) me paanshmëri, pa favorizime dhe pa paragjykime.

6. Gjyqtari i caktuar me short e tërheq dosjen gjyqësore nga ndihmësi ligjor nëse e vlerëson të nevojshme, sipas kompleksitetit të çështjes që lidhet me faktet, me zbatimin e ligjit ose nëse kjo është e nevojshme në përshtatje me rëndësinë e vendimit. Në këtë rast gjyqtari harton një dokument me shkrim që përmban arsyet për tërheqjen e çështjes, i cili është pjesë e dosjes.

7. Ndihmësi ligjor i dorëzon pa vonesë dosjen e çështjes gjyqtarit.

8. Gjyqtari procedon me çështjen më tej nëse:

a) gjyqtari do të tërheqë çështjen;

b) zbulon çështje faktike ose ligjore, të cilat, sipas kompleksitetit ose vështirësisë së çështjes, duhet të përpunohen nga një gjyqtar.

9. Ndihmësi ligjor, ndihmësi magjistrat ose jomagjistrat u nënshtrohen rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesave ashtu si magjistrati.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për kushtet dhe kriteret profesionale që duhet të përmbushin ndihmësit ligjorë në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, llojin dhe natyrën e detyrave të ndihmësve ligjorë, llojin dhe natyrën e çështjeve për t'u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë, për kriteret dhe procedurat për ndarjen e çështjeve me short, si dhe vlerëson rregullisht ngarkesën e punës së ndihmësve ligjorë dhe siguron një numër të përshtatshëm të tyre për çdo gjykatë.

Neni 43
Kryesekretari

1. Kryesekretari ka në kompetencë bashkërendimin, organizimin dhe ndarjen e punës së zyrës së sekretarisë nën drejtimin e kancelarit të gjykatës.

2. Kryesekretari ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) lëshon vërtetime për të dhënat e kërkuara nga palët nga regjistrat në gjykatë;

b) nënshkruan të gjitha aktet procedurale që kërkojnë njoftime procedurale, siç janë:

i. vendimet gjyqësore që bëhen përfundimtare;

ii. vendime përfundimtare dhe të ndërmjetme që dërgohen për ekzekutim;

iii. ekstrakte dhe fotokopje të njësuara me origjinalin të akteve të gjykatës;

iv. të gjitha aktet e tjera të nxjerra nga gjykata, krahas nënshkrimit të personit që i ka përgatitur;

c) çdo detyrë tjetër e përcaktuar me ligj.

3. Veprimtari të tjera, të cilat kryhen rregullisht nga kryesekretarët, renditen në përshkrimet standarde të punës, miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 44
Sekretari gjyqësor

1. Sekretari gjyqësor kryen detyra procedurale, në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi.

2. Sekretari gjyqësor ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme:

a) vërteton aktet e gjykatës dhe lëshon vërtetime apo kopje të njësuara me origjinalin të akteve procedurale gjyqësore. Kur përdoren pajisje regjistrimi apo pajisje që kryejnë funksione të ngjashme, sekretari garanton që regjistrimi ose riprodhimi është origjinal dhe i paprekur;

b) është përgjegjës për krijimin e dosjeve dhe ndihmon gjyqtarin për mbajtjen e dosjeve sipas një rregulli të caktuar, si dhe për regjistrimin dhe zbatimin e urdhrave të shpallur apo të nxjerrë nga gjykatat dhe gjyqtarët;

c) ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe për regjistrimet në regjistra dhe ndihmon në mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;

ç) ndihmon në çështje që lidhen me mbajtjen e dosjeve personale;

d) bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave gjyqësore;

dh) ndihmon në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kritereve të

përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave;

e) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

3. Veprimtari të tjera, të cilat kryhen rregullisht nga sekretarët gjyqësorë, renditen në përshkrimet standarde të punës, miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 45
Shërbimi financiar

Shërbimi financiar ushtron dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga ligji "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligji "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar", si dhe aktet në zbatim të tyre.

Neni 46
Marrëdhëniet me publikun

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që:

a) t'i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara;

b) t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;

c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik;

ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit", në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore;

d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

2. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

3. Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun

pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme.

4. Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun si koordinator, në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

5. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun.

Neni 47
Shërbimi i teknologjisë së informacionit

Shërbimet e teknologjisë së informacionit sigurojnë:

a) mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

b) ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës.

Neni 48
Shërbimi i arkivit gjyqësor

1. Shërbimi i arkivit gjyqësor mban dhe administron dokumentacionin gjyqësor, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera gjyqësore, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërorë.

2. Shërbimi i arkivit gjyqësor bashkëpunon me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit gjyqësor, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit.

Neni 49
Rregulli dhe siguria në gjykata

1. Rregulli dhe siguria në gjykata rregullohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Këshilli i Ministrave, pasi merr mendimin e Këshilli të Lartë Gjyqësor, përcakton kriteret dhe procedurat për garantimin e rregullit dhe sigurisë në gjykata.

KREU V
STATUSI I NËPUNËSVE CIVILË GJYQËSORË

SEKSIONI I
KUALIFIKIMI I NËPUNËSVE CIVILË GJYQËSORË

Neni 50
Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë
(Ndryshuar shkronja (c) e pikës 1 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë:

a) kancelari;

b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë;

c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit;

ç) kryesekretari;

d) sekretari gjyqësor;

dh) nëpunësi i financës dhe buxhetit;

e) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me median.

2. Statusi i nëpunësve civilë gjyqësorë rregullohet nga ky ligj.

Neni 51
Punonjësit e tjerë gjyqësorë

Marrëdhënia e punës e punonjësve të tjerë në gjykatë rregullohet nga Kodi i Punës.

Neni 52
Formimi profesional

1. Formimi profesional i nëpunësve civilë gjyqësorë garantohet nëpërmjet përfshirjes së tyre në programet e mëposhtme:

a) programin e formimit fillestar, mbi bazën e të cilit nëpunësit civilë gjyqësorë që pranohen në shërbimin civil gjyqësor trajnohen brenda periudhës së provës së tyre;

b) programin e formimit vazhdues, i cili kryhet nga nëpunësit në detyrë të shërbimit civil gjyqësor.

2. Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat dhe institucione të tjera kryen formimin fillestar dhe vazhdues të kancelarëve, këshilltarëve ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësve të tjerë ligjorë, si dhe përgatit kurrikulën për formimin fillestar për kancelarin për një periudhë prej të paktën tre muajsh dhe për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë për një periudhë prej të paktën nëntë muajsh, sipas kushteve të vendosura në ligjin "Për organet e qeverisjes të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat dhe institucione të tjera kryen formimin profesional fillestar dhe vazhdues të nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë dhe përgatit kurrikulën për formimin fillestar të tyre për një periudhë prej të paktën një muaji.

4. Shkolla e Magjistraturës miraton rregulla më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për gjithë nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.

Neni 53
Vlerësimi kualifikues për kancelar, këshilltar dhe ndihmës ligjor
(Ndryshuar shkronja (a) e pikës 4; shtuar fjalia e dytë e pikës 9 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Shkolla e Magjistraturës ofron formim fillestar për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë dhe, të paktën çdo tre vjet, për kancelarët.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi merr mendimin e kryetarëve të gjykatave, përcakton numrin e vendeve të lira për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë për vitin e ardhshëm dhe për kancelarët për tri vitet e ardhshme.

3. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara pranë gjithë gjykatave, në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka për detyrë:

a) të verifikojë plotësimin nga kandidatët të kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës, si dhe të pasurisë dhe figurës;

b) të përcaktojë listën e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit.

5. Shkolla e Magjistraturës:

a) zhvillon provimin e pranimit;

b) vlerëson dhe publikon rezultatet e provimit të pranimit;

c) përcakton kandidatët me pikët më të larta që duhet të pranohen në programin e formimit fillestar;

ç) organizon dhe zbaton programin e formimit fillestar.

6. Kandidatët e pranuar në programin e formimit fillestar janë të detyruar të ndjekin rregullisht programin dhe të respektojnë rregulloren e Shkollës së Magjistraturës.

7. Në përfundim të formimit fillestar Shkolla e Magjistraturës organizon provimin përfundimtar.

Kandidatët që marrin jo më pak se 70 për qind të pikëve totale në provimin përfundimtar, vlerësohen se kanë kaluar me sukses programin e formimit fillestar.

8. Në përputhje me pikën 7, të këtij neni, Shkolla e Magjistraturës rendit kandidatët fitues, sipas numrit të pikëve që kanë marrë. Lista e kandidatëve fitues miratohet nga Shkolla e Magjistraturës, publikohet në faqen zyrtare të saj, dhe i paraqitet Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të hollësishme për mënyrën e përllogaritjes së numrit të kandidatëve që pranohen në programin e formimit fillestar dhe verifikimin e kandidatëve që pranohen në provimin e pranimit. Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve ndiqen të njëjtat rregulla si dhe për kandidatët për formimin fillestar për magjistratë sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

10. Shkolla e Magjistraturës miraton rregulla më të hollësishme për procedurën dhe vlerësimin e provimit të pranimit dhe provimit përfundimtar.

11. Nëpunësi civil gjyqësor në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të përmbushë edhe kërkesat dhe kushtet shtesë të parashikuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Republikën e Shqipërisë".

Neni 54
Vlerësimi kualifikues i nëpunësve civilë gjyqësorë

1. Pranimi në shërbimin civil gjyqësor i nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë bëhet sipas rregullave të këtij neni nëpërmjet një konkurrimi të hapur.

2. Pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, sipas nenit 57, të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor, jo më vonë se tri javë nga marrja e njoftimit për vendin e lirë, shpall konkurrimin e hapur në faqen zyrtare të tij dhe i kërkon kancelarit ta shpallë edhe në faqen zyrtare të gjykatës.

3. Njoftimi përmban informacion për vendin e lirë, afatin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumentacionin shoqërues, procedurën e kandidimit dhe vendin ku paraqitet kërkesa dhe dokumentacioni. Afati për paraqitjen e kërkesës së kandidimit nuk mund të jetë më pak se dy javë nga data e njoftimit.

4. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të publikuara në njoftim;

b) vlerësimi i kandidatëve.

5. Verifikimi paraprak bëhet nga kancelari, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i Pranimit në gjykatë.

6. Komisioni i Pranimit rendit kandidatët fitues me më shumë pikë dhe që kanë marrë më shumë se 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, në listën e kandidatëve fitues, referuar më poshtë si "lista e kandidatëve".

7. Këshilli i Lartë i Gjyqësor miraton me vendim rregulla të hollësishme për vlerësimin paraprak, krijimin, përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Pranimit, si dhe për procedurën e vlerësimit.

Neni 55
Kritere të përgjithshme për pranimin

1. Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe në provimin e pranimit për kancelarët, këshilltarët ose ndihmësit ligjorë në Shkollën e Magjistraturës, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, të parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil" dhe kërkesat e veçanta të parashikuara nga ky ligj.

2. Për pranimin në shërbimet e gjykatave të posaçme për gjykimin e

veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e sigurimit, të caktuara me ligj të veçantë, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar nga kandidati dhe familjarët e afërm të kandidatit.

Neni 56
Kritere të veçanta për pranimin e nëpunësve civilë gjyqësorë
(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 2 dhe shkronja (b) e pikës 2 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Për t'u pranuar në provimin e pranimit për formimin fillestar për kancelar, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta si vijon:

a) të jenë diplomuar në drejtësi ose ekonomi në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) të kenë përvojë profesionale mbi tetë vjet, nga të cilat së paku tre vjet në pozicione administruese ose pesë vjet në sistemin gjyqësor.

2. Për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta:

a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin "Master shkencor", të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose nëorganizatat ndërkombëtare.

3. Për pozicionin e këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, kandidatët duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 34, pika 6, të këtij ligji.

4. Për pozicionin e kryesekretarit, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta:

a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin "Master profesional" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet përvojë pune si sekretar gjyqësor.

5. Për pozicionin e sekretarit gjyqësor, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta:

a) të jenë diplomuar në drejtësi;

b) të kenë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

6. Për pozicionin e nëpunësit zbatues duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

7. Për pozicionin drejtues të buxhetit, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta:

a) të jenë diplomuar në shkenca ekonomike, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet në fushën e kontabilitetit dhe/ose menaxhimit të buxhetit.

8. Për pozicionet drejtuese si nëpunës civil gjyqësor në fusha të tjera të shërbimeve administrative të gjykatës, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta:

a) të jenë diplomuar në drejtësi, ekonomi ose teknologji e informacionit ose shkenca komunikimi/gazetari, ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) të kenë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

SEKSIONI II
PRANIMI I NËPUNËSVE CIVILË GJYQËSORË

Neni 57
Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë

1. Plotësimi i vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor bëhet sipas kësaj radhe:

a) fillimisht vendi i lirë i ofrohet një nëpunësi civil gjyqësor, i regjistruar

në listën e nëpunësve civilë gjyqësorë, ose ata të cilët kanë të drejtë të rikthehen ose të transferohen, sipas dispozitës për efektet e pezullimit të ligjit "Për nëpunësin civil" ose për transferimin;

b) nëse vendi nuk mund të plotësohet sipas procedurës së referuar në shkronjën "a", plotësimi bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele;

c) nëse vendi nuk mund të plotësohet sipas procedurës së referuar në shkronjën "a" ose "b", plotësimi bëhet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

2. Nëpunësit e shërbimit civil gjyqësor të një kategorie të caktuar kanë të drejtë të aplikojnë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele për pozicionet e së njëjtës kategori të një gjykate tjetër.

3. Nëpunësit e shërbimit civil gjyqësor të një kategorie të caktuar, të cilët plotësojnë kriteret për një kategori më të lartë, kanë të drejtë të aplikojnë nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në pozicionin e një kategorie më të lartë brenda së njëjtës gjykatë ose në një gjykate tjetër.

4. Kancelari njofton menjëherë dhe pa vonesë Këshillin e Lartë Gjyqësor për vendin e lirë të krijuar në gjykatë ose që mund të krijohet në të ardhmen, në çdo rast, jo më vonë se dy javë pas marrjes së informacionit.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pa vonesë, vë në dijeni Këshillin e Gjykatës për nëpunësit civilë gjyqësorë të regjistruar në listën e nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas pikës 1 të këtij neni. Këshilli i Gjykatës i ofron vendin kandidatit të regjistruar në listën përkatëse.

6. Në rast se vendi i lirë nuk mund të plotësohet nga një procedurë e tillë, Këshilli i Lartë Gjyqësor shpall fillimin e procedurave për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë. Këshilli i Lartë Gjyqësor njofton të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, nëpunësit e shërbimit civil gjyqësor të kategorive më të ulëta, të cilët plotësojnë kriteret për kategorinë përkatëse më të lartë, për vendet e lira dhe hapjen e procedurave për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë.

7. Njoftimi shpallet në të gjitha gjykatat. Ai përmban informacion për vendin e lirë, afatin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumentacionin shoqërues, procedurën e shqyrtimit të kërkesës dhe vendin ku paraqitet kërkesa dhe dokumentacioni. Afati për paraqitjen e kërkesës për kandidim nuk mund të jetë më pak se dy javë nga data e njoftimit.

8. Kërkesa për kandidim paraqitet pranë Këshillit të Gjykatës që ka njoftuar vendin e lirë.

9. Këshilli i Gjykatës shqyrton kërkesat, bazuar në dokumentacionin e paraqitur. Në rastin e lëvizjes paralele, Këshilli i Gjykatës mund të zhvillojë një intervistë. Në rastin e ngritjes në detyrë, zhvillimi i intervistës nga Këshilli i Gjykatës me kandidatët është i detyrueshëm.

10. Këshilli i Gjykatës, në rastin e paraqitjes së dy ose më shumë kërkesave për të njëjtin pozicion, i rendit kandidatët sipas radhës së kritereve të mëposhtme:

a) rezultateve të vlerësimit të punës, në rast rezultatesh të njëjta Këshilli i Gjykatës krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta;

b) viteve të përvojës profesionale në pozicionin përkatës;

c) viteve të përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës.

11. Këshilli i Gjykatës përzgjedh dhe njofton kandidatin brenda dy javëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesës për kandidim.

12. Këshilli i Gjykatës, në të cilin pranohet një nëpunës civil gjyqësor i ri, sipas këtij neni, brenda pesë ditëve nga përzgjedhja e kandidatit, njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor për rezultatet e procedurës së lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton me vendim rregulla më të detajuara për procedurat për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë.

Neni 58
Emërimi në shërbimin civil gjyqësor

1. Pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, Këshilli i Lartë Gjyqësor fillon procedurën e pranimit për emërimin e kandidatëve për vendet të mbetura të lira për kancelar, ndërsa Këshilli i Gjykatës fillon procedurën e pranimit për emërimin e kandidatëve për vendet e tjera të lira të nëpunësve civilë gjyqësorë.

2. Kandidatët fitues, të përcaktuar në përputhje me listën e Shkollës së Magjistraturës për renditjen e kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë ose në përputhje me renditjen e bërë nga Komisioni i Pranimit, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtë të zgjedhin të

emërohen në çdo pozicion të kategorisë, për të cilin është zhvilluar konkurrimi. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Gjykatës emërojnë kandidatët në pozicionin e zgjedhur, sipas neneve 59 dhe 60 të këtij ligji.

3. Lista e kandidatëve fitues, e krijuar nga Shkolla e Magjistraturës, në përputhje me pikën 7, të nenit 53, të këtij ligji, të paemëruar ende, sipas pikës 2, të këtij neni, është e vlefshme për një periudhë katërvjeçare nga shpallja e fituesve. Lista e krijuar nga Komisioni i Pranimit, në përputhje me pikën 6, të nenit 54, të këtij ligji, e kandidatëve fitues të paemëruar ende, sipas pikës 2, të këtij neni, është e vlefshme për një periudhë dyvjeçare nga shpallja e fituesve. Nëse gjatë kësaj periudhe organizohet një konkurs tjetër për të njëjtën kategori, kandidatët fitues të listave, që nuk janë emëruar ende, renditen sërish sipas rezultatit përfundimtar.

4. Vendet e lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme, mund të plotësohen nga kandidatët fitues të paemëruar ende, sipas renditjes së tyre në listën e përcaktuar në pikën 3, të këtij neni. Në çdo rast, ky proces realizohet me pëlqimin e kandidatëve fitues dhe nuk cenon të drejtat që ata gëzojnë, sipas pikës 3 të këtij neni. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Gjykatës bëjnë emërimin e përkohshëm, respektivisht, për kancelarin, këshilltarin, ndihmësin ligjor dhe nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë, pas marrjes së pëlqimit të tyre.

5. Çdo emërim në pozicione të shërbimit civil gjyqësor, në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të hollësishme për procedurën në zbatim të këtij neni.

Neni 59
Emërimi i kancelarit, këshilltarit ligjor dhe ndihmësit ligjor

1. Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

2. Për vendin e lirë për kancelar, këshilltar ose ndihmës ligjor, pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, kandidatët e renditur në listën e kandidatëve për pozicionin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor, të publikuar nga Shkolla e Magjistraturës, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor zgjedh kandidatin për kancelar, këshilltar ose ndihmës ligjor, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme sipas kësaj radhe:

a) renditjen në listën e kandidatëve;

b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kanditatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë;

c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor arsyeton dhe publikon në faqen zyrtare vendimin për rezultatet e procedurës së emërimit. Vendimi i arsyetuar u njoftohet të gjithë kandidatëve. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të ankimojnë vendimin në gjykatën kompetente.

Neni 60
Emërimi i nëpunësve civilë gjyqësorë të tjerë

1. Organi kompetent për emërimin e nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës.

2. Për vendet e lira për nëpunësit civilë gjyqësorë të tjerë, pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, kandidatët e renditur në listën e kandidatëve nga Komisionet e Pranimit, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë pranë Këshillit të Gjykatës.

3. Këshilli i Gjykatës fton kandidatët për intervistë dhe zgjedh kandidatin për vendin e lirë përkatës në shërbimin civil gjyqësor, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme, sipas kësaj radhe:

a) renditjen në listën e kandidatëve;

b) çdo karakteristikë të veçantë të kanditatit në lidhje me vendin e lirë;

c) vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.

4. Këshilli i Gjykatës arsyeton dhe publikon vendimin për rezultatet e procedurës së emërimit. Vendimi i arsyetuar i njoftohet të gjithë kandidatëve. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të ankimojnë vendimin në gjykatën kompetente.

Neni 61
Emërimi paraprak

1. Nëpunësi i shërbimit civil gjyqësor merr emërimin paraprak në shërbimin civil gjyqësor me kusht që vendimi i emërimit të mos cenohet nga një vendim gjyqësor.

2. Në rast se nuk bëhet ankim brenda afatit kundër vendimit të organit kompetent për emërimin e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor, vendimi bëhet përfundimtar dhe emërimi konsiderohet përfundimtar që nga data e mbarimit të afatit të ankimit ndaj këtij vendimi.

3. Në rast se bëhet ankim dhe vendimi gjyqësor përfundimtar lë në fuqi vendimin e emërimit, emërimi konsiderohet përfundimtar, duke filluar nga dita e njoftimit të vendimit gjyqësor te nëpunësi civil gjyqësor i emëruar.

4. Në rast se gjykata e cenon vendimin e emërimit, organi kompetent përkatës rivlerëson sipas rregullave të vlerësimit të gjitha kërkesat e kandidatëve në përputhje me këtë ligj dhe merr një vendim të ri pas dhënies së vendimit përfundimtar të gjykatës. Emërimi paraprak konsiderohet i përfunduar në datën e vendimit të organit kompetent, i cili rishikon vendimin e emërimit, duke pasur parasysh vendimin përfundimtar të gjykatës. Kandidatët e emëruar paraprakisht dhe të sapoemëruar njoftohen në datën e dhënies së vendimit.

5. Viti i parë i shërbimit gjatë periudhës së emërimit paraprak konsiderohet si periudhë prove, sipas nenit 62 të këtij ligji.

6. Këshilli i Gjykatës njofton pa vonesë Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi rezultatin e procesit të pranimit, duke përfshirë ankimet e bëra dhe çdo vendim gjyqësor përfundimtar.

7. Në rast se organi kompetent vendos të ndërpresë marrëdhënien e punës për nëpunësin civil gjyqësor të emëruar paraprakisht, gjatë periudhës së provës, sipas nenit 62, të këtij ligji, ai njofton kandidatët e tjerë që kanë paraqitur kërkesë për vendin përkatës. Këta kandidatë mund të mbështesin kërkesën e tyre edhe në rastin kur ka mbaruar afati i listës së kandidatëve në të cilën ata janë përfshirë. Në rastet kur kandidatët kanë paraqitur ankim, ky ankim konsiderohet i tërhequr. Organi kompetent fton të gjithë kandidatët e tjerë nga lista përkatëse e kandidatëve për të paraqitur kërkesë për kandidim për vendin përkatës.

Neni 62
Periudha e provës

1. Personi, i cili në momentin e emërimit nuk gëzon statusin e nëpunësit të shërbimit civil gjyqësor, i nënshtrohet periudhës së provës, e cila zgjat një vit nga data e njoftimit të vendimit të emërimit paraprak.

2. Gjatë periudhës së provës, nëpunësi civil gjyqësor kryen detyrat nën kujdesin e një nëpunësi të vjetër civil gjyqësor të së njëjtës kategori ose të një kategorie më të lartë.

3. Në fund të periudhës së provës, organi kompetent, ku është emëruar nëpunësi i shërbimit civil gjyqësor, vendos:

a) konfirmimin e nëpunësit civil gjyqësor;

b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në gjashtë muaj, nëse për arsye të justifikuara, ka qenë i pamundur vlerësimi i nëpunësit civil gjyqësor;

c) moskonfirmimin e nëpunësit civil gjyqësor.

4. Vendimi, sipas parashikimeve të pikës 3, të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve individuale të punës.

5. Këshilli i Gjykatës i përcjell vendimin Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda tri ditëve për emërimet që janë në kompetencën e tij. Këshilli i Lartë Gjyqësor regjistron vendimet e marra, sipas këtij neni, në Regjistrin Qendror të Personelit brenda dhjetë ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 63
Dosja dhe Regjistri Qendror i Personelit

1. Kancelari i çdo gjykate krijon dhe administron dosjen individuale për çdo nëpunës civil gjyqësor dhe punonjësi të administratës së gjykatës. Dosja individuale përmban të dhëna profesionale për çdo nëpunës civil gjyqësor dhe punonjës të administratës, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me shërbimin civil gjyqësor ose marrëdhënien e punës.

2. Kancelari i çdo gjykate reflekton në Regjistrin Qendror të Personelit, të krijuar dhe administruar nga Departamenti i Administratës Publike, sipas parashikimeve të ligjit "Për nëpunësin civil" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, të dhënat profesionale për çdo nëpunës civil gjyqësor dhe punonjës të administratës, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me shërbimin civil gjyqësor, ose marrëdhënien e punës, si dhe informacionin për strukturën dhe organikën e gjykatës përkatëse.

3. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e administratorit të Regjistrit Qendror të Personelit, është i detyruar t'i sigurojë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave aksesin e plotë dhe të nevojshëm mbi të dhënat e gjykatave në këtë regjistër.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton me vendim rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, sipas pikës 1, të këtij neni, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe përdorimit të të dhënave.

5. Të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë të administratës gjyqësore kanë akses të pakufizuar në dosjen e tyre personale, e cila përmban të dhëna në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

SEKSIONI III
TË DREJTAT, DETYRIMET, VLERËSIMI I PUNËS, TRANSFERIMI

Neni 64
Të drejtat dhe detyrat e nëpunësit civil gjyqësor
(Shfuqizuar pika 10 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Nëpunësit civilë gjyqësorë gëzojnë të drejta dhe u nënshtrohen detyrimeve, sipas dispozitave të parashikuara në kapitullin e të drejtave dhe detyrimeve në shërbimin civil të ligjit "Për nëpunësin civil", përveç kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Nëpunësit civilë gjyqësorë kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Këshillit të Gjykatës në Gjykatën Administrative të Apelit.

3. Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për emërimin e kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë ankimohen në përputhje me ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

4. Këshilli i Ministrave miraton me vendim:

a) rregulla mbi strukturën dhe rritjen e pagave për nëpunësit civilë gjyqësorë, përmes së cilës, skema e pagës duhet të jetë së paku e njëjtë me atë të kategorive përkatëse të nëpunësit civil;

b) rregullat mbi kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës. Në përcaktimin e këtyre rregullave duhet të sigurohet që nëpunësi i shërbimit civil gjyqësor të trajtohet në mënyrë të barabartë me nëpunësin e shërbimit civil.

5. Kancelari kandidat merr një shpërblim të barabartë me 50 për qind të pagës fillestare si kancelar gjatë kursit të formimit fillestar. Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendim përcakton tri kategoritë e kancelarëve, në përputhje me ngarkesën dhe nivelin e çdo gjykate. Niveli më i lartë i pagës së kancelarit barazohet me "pagën për funksion" të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme, niveli i mesëm barazohet me "pagën për funksion" të

drejtorit të drejtorisë dhe niveli më i ulët me "pagën për funksion" të përgjegjësit të sektori në nivel ministrie.

6. Këshilltari dhe ndihmësi ligjor kandidat merr një shpërblim të barabartë me 50 për qind të pagës fillestare si këshilltar dhe ndihmës ligjor gjatë kursit të formimit fillestar. Ndihmësi ligjor, pas emërimit përfiton pagë, e cila është e njëjtë me pagën e funksionit të drejtorit të drejtorisë në ministri.

7. Kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë kandidatë detyrohen të kthejnë të gjithë shpërblimin e marrë brenda tre vjetëve në rast se kandidati përjashtohet ose largohet nga shkolla ose në rast se kandidati nuk kërkon të caktohet në një pozicion brenda një viti nga përfundimi i arsimimit në Shkollën e Magjistraturës.

8. Kandidati detyrohet të kthejë 50 për qind të shpërblimit të marrë, brenda tre vjetëve nga përfundimi i arsimimit në Shkollën e Magjistraturës nëse:

a) kandidati nuk ka mundur të përmbushë kërkesat për t'u emëruar sipas nenit 53 të këtij ligji;

b) mandati i kancelarit, këshilltarit ose ndihmësit ligjor përfundon përpara plotësimit të të paktën pesë viteve në ushtrimin e detyrës.

9. Për shkaqe shëndetësore ose për shkaqe të tjera të justifikuara, miratuar me vendim nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, detyrimi për kthimin e shumës së përfituar të bursës së shkollimit, sipas parashikimeve të pikës 8, të këtij neni, nuk zbatohet për kandidatin.

Neni 65
Vlerësimi i veprimtarisë

1. Veprimtaria e çdo nëpunësi civil vlerësohet periodikisht të paktën çdo dy vjet, nga data e fillimit të ushtrimit të detyrës në vendin përkatës, sipas këtyre kritereve:

a) njohuritë profesionale dhe aftësitë teknike;

b) përkushtimi në punë;

c) etika në punë.

2. Kryetari i gjykatës njofton nëpunësin civil gjyqësor për fillimin e procesit të vlerësimit dhe i kërkon atij vetëvlerësimin dy muaj para përfundimit të periudhës dyvjeçare të vlerësimit. Nëpunësit civilë gjyqësorë bëjnë vetëvlerësimin brenda dy javëve nga data e marrjes së njoftimit përkatës. Nëpërmjet vetëvlerësimit, nëpunësi civil gjyqësor

përshkruan veprimtaritë, identifikon nevojat për trajnim, sugjeron përmirësim të kushteve të punës dhe masa për zhvillimin e tij/saj profesional, identifikon dobësitë dhe përparësitë në lidhje me çdo kriter vlerësimi.

3. Kryetari i gjykatës njofton të gjithë eprorët të paraqesin, brenda dy javëve nga data e njoftimit, mendim me shkrim për punën e nëpunësit civil gjyqësor, sipas kritereve të vlerësimit.

4. Nëpunësi civil gjyqësor që vlerësohet dhe eprori paraqesin aktet e vlerësimit te kryetari i gjykatës, i cili është përgjegjës për të hartuar projektraportin e vlerësimit, brenda katër javëve pas njoftimit të nëpunësit civil gjyqësor. Me finalizimin e projektraportit të vlerësimit, nëpunësi civil gjyqësor njoftohet dhe ka të drejtë të ketë akses në dosjen e vlerësimit.

5. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtën të kundërshtojë me shkrim projektraportin e vlerësimit, brenda dy javëve nga marrja e tij.

6. Kryetari i gjykatës i paraqet Këshillit të Gjykatës projektvendimin e vlerësimit, projektraportin e vlerësimit, së bashku me vetëvlerësimin, mendimin me shkrim të të gjithë mbikëqyrësve dhe, sipas rastit, çdo kundërshtim, sipas pikës 5 të këtij neni.

7. Këshilli i Gjykatës mund të vendosë të dëgjojë nëpunësin civil gjyqësor që vlerësohet dhe të diskutojë rastin, duke vendosur në përfundim vlerësimin me një nga këto nivele:

a) “Shumë mirë”;

b) “Mirë”;

c) “Kënaqshëm”;

ç) “Jokënaqshëm”.

8. Këshilli i Gjykatës arsyeton rregullisht me shkrim vendimin dhe njofton nëpunësin civil gjyqësor brenda tri ditëve nga marrja e tij.

9. Në rast se vendimi i Këshillit të Gjykatës cakton vlerësimin më pak se “mirë”, nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin në gjykatën kompetente vetëm për çështje të ligjit për shkak të moszbatimit të njëjtë të tij.

10. Në rastin e një nëpunësi civil gjyqësor në periudhë prove, veprimtaria e tij vlerësohet për një periudhë prej gjashtë muajsh.

11. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton me vendim rregulla të mëtejshme për treguesit e kritereve që lidhen me kriteret e vlerësimit, burimet dhe procedurën e vlerësimit.

Neni 66
Transferimi i nëpunësve civilë gjyqësorë

1. Dispozitat e parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil" për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm aplikohen për aq sa gjejnë zbatim, përveçse kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Transferimi mund të zbatohet vetëm brenda shërbimit civil gjyqësor. Nëpunësi civil gjyqësor mund edhe të transferohet përkohësisht për nevojat e gjykatës ose shtetit, në pozicionet që i përshtaten profilit të punës, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është anëtare ose në një institucion ndërkombëtar.

3. Këshilli i Gjykatës, në të cilën nëpunësi civil gjyqësor transferohet, është kompetent për dhënien e vendimit të transferimit. Në rast transferimi në institucione të ndryshme nga gjykata, organi kompetent që vendos për transferimin është Këshilli i Gjykatës në të cilën është i punësuar nëpunësi civil gjyqësor. Në rastin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor, organi kompetent që vendos për transferimin është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

4. Këshilli i Gjykatës njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor në rastet kur nëpunësi civil gjyqësor kërkon transferimin në një institucion tjetër të shërbimit civil gjyqësor për shkak të:

a) arsyeve mjekësore ose gjatë shtatzënisë;

b) paaftësisë shëndetësore;

c) shmangies së një situate të vazhdueshme të konfliktit të interesit.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor regjistron nëpunësin civil gjyqësor në listë deri në sistemimin e tij/saj në një pozicion të përshtatshëm. Dispozitat për efektet e pezullimit zbatohen për aq sa është e mundur.

6. Në rast të mbylljes ose riorganizimit të strukturës së gjykatës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ngre Komisionin e Ristrukturimit, sipas ligjit "Për nëpunësin civil". Komisioni i Ristrukturimit drejtohet nga një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kryetarët dhe kancelarët e gjykatave që i nënshtrohen procedurës së riorganizimit.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton me vendim rregulla më të hollësishme për procedurën e transferimit.

SEKSIONI IV
PEZULLIMI DHE PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 67
Pezullimi nga shërbimi civil gjyqësor

1. Dispozitat e parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil" për pezullimin nga shërbimi civil, aplikohen për nëpunësit civilë gjyqësorë për aq sa gjejnë zbatim, përveçse kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Organi kompetent për deklarimin e pezullimit është Këshilli i Lartë Gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor dhe Këshilli i Gjykatës për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.

3. Në rast pezullimi, sipas një kërkese të motivuar për shkak të një interesi tjetër të ligjshëm të nëpunësit civil gjyqësor, organi kompetent mund të vendosë pezullimin për një periudhë deri në dy vjet, në përputhje me rregullat e nxjerra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 68
Efektet e pezullimit

1. Gjatë periudhës së pezullimit, nëpunësi civil gjyqësor nuk përfiton pagë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Nëpunësi civil gjyqësor përfiton pagën e plotë kur pezullohet vetëm në këto raste:

a) në rastin e procedimit disiplinor;

b) në rastin ku pezullimi është vendosur si masë ndaluese nga gjykata;

c) nëse krijohet një situatë e vazhdueshme konflikti interesi që deklarohet në kohën dhe mënyrën e duhur, sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, deri në transferimin përfundimtar në një pozicion tjetër;

ç) gjatë ndjekjes së programit të formimit fillestar.

3. Nëpunësi civil gjyqësor duhet të kthejë shumën prej 50 për qind të pagës së përfituar gjatë periudhës së pezullimit, bazuar në një procedurë të papërfunduar disiplinore ose penale në rastet kur:

a) është larguar nga detyra me vendim përfundimtar, në kuadër të procedimit disiplinor përkatës;

b) është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale në çështjen përkatëse, me vendim përfundimtar.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të hollësishme për efektet e pezullimit.

Neni 69
Përgjegjësia disiplinore

1. Organi kompetent për propozimin e masave disiplinore është:

a) kancelari i gjykatës për nëpunësit civilë gjyqësorë që ushtrojnë detyrën në gjykatën përkatëse, me përjashtim të këshilltarit dhe ndihmësit ligjor;

b) kryetari i gjykatës për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor.

2. Organi kompetent për të caktuar masat disiplinore është:

a) Këshilli i Lartë Gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor;

b) Këshilli i Gjykatës për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.

3. Rregullimet e parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil", për përgjegjësinë disiplinore, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim për nëpunësit civilë gjyqësorë, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

4. Përveç shkeljeve disiplinore të renditura në ligjin "Për nëpunësin civil", kancelari mban përgjegjësi edhe për mënyrën e ushtrimit të detyrave si anëtar i Këshillit të Gjykatës, si dhe për votimin haptazi në kundërshtim me faktet ose ligjin.

Neni 70
Afatet e parashkrimit

1. Me kalimin e afatit dyvjeçar nga data në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, hetimet për shkeljen e pretenduar ndaj nëpunësit civil gjyqësor nuk mund të fillojnë.

2. Afati i parashkrimit fillon në momentin e përfundimit të shkeljes.

3. Afati i parashkrimit ndërpritet nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se nëpunësi civil gjyqësor mund të jetë përfshirë në një shkelje tjetër të së njëjtës natyrë të kryer brenda afatit të parashkrimit. Në këtë rast, afati fillon në momentin e përfundimit të shkeljes së re. Në çdo rast, parashkrimi nuk zgjatet më shumë se një vit.

4. Pavarësisht parashikimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, shkelje që njëkohësisht janë vepra penale, kanë të njëjtin afat parashkrimi sipas parashikimeve në Kodin Penal.

5. Afati i parashkrimit pezullohet gjatë kohës së procedimit penal, procedurës civile ose procedurës administrative në lidhje me të njëjtin nëpunës civil gjyqësor, nëse e njëjta shkelje është objekt i këtyre procedurave.

6. Me fillimin e hetimit, afati i parashkrimit nuk vazhdon të ecë më. Hetimi fillon sipas këtij neni në datën e marrjes së ankesës ose në atë të marrjes së informacionit që justifikon fillimin e hetimit kryesisht nga organi i lartë hetues.

Neni 71
Afatet për fillimin e hetimit

1. Organi kompetent për propozimin e masës disiplinore vendos për arkivimin e ankesës ose fillimin e hetimit për shkeljen e pretenduar, brenda gjashtë muajve nga marrja e ankesës ose nga marrja e informacionit dhe fakteve të rëndësishme.

2. Organi kompetent i paraqet propozimin organit kompetent për caktimin e masës disiplinore ose miraton me vendim mbylljen e hetimit brenda gjashtë muajve nga vendimi për fillimin e hetimit.

3. Organi kompetent për propozimin e masave disiplinore mund të vendosë shtyrjen e afatit gjashtëmujor të hetimit, sipas pikës 2, të këtij neni, edhe me gjashtë muaj të tjerë, në rastet e mëposhtme:

a) kur nëpunësi civil gjyqësor është i sëmurë ose kur nuk mund të paraqitet për shkaqe të justifikuara;

b) kur vendoset zgjerimi i hetimit ose kur ndryshon shkaku ligjor i hetimit;

c) në raste të tjera komplekse.

4. Në rast se pas përfundimit të afatit të hetimit, të përcaktuar në pikën 2 ose 3, të këtij neni, zbulohen prova të reja, të cilat tregojnë në mënyrë të arsyeshme se shkelja ka ndodhur, organi kompetent rihap hetimin, me kusht që afati i parashkrimit të mos ketë përfunduar, sipas përcaktimeve të nenit 70, pikat 1 dhe 4, të këtij ligji. Organi kompetent paraqet propozimin për caktimin e masës disiplinore ose miraton me vendim mbylljen e hetimit brenda gjashtë muajve nga vendimi për rifillimin e hetimit.

5. Në rast se organi kompetent, nuk vepron brenda afateve të parashikuara në pikat 2 deri 4, të këtij neni, nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të ankimojë mosveprimin administrativ në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

6. Afatet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të pezullohen sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij ligji.

Neni 72
Fillimi i hetimit disiplinor

1. Kushdo mund të paraqesë ankesë ndaj nëpunësit civil gjyqësor.

2. Kushdo që mbikëqyr nëpunësin civil gjyqësor ose çdo organ publik me kompetenca kontrolli administrativ, financiar ose auditimi, mund t'i drejtohet me shkresë organit kompetent, sipas nenit 69, pika 1, të këtij ligji, për fillimin e hetimit disiplinor, duke i parashtruar pretendimet për shkelje të detyrimeve të nëpunësve civilë gjyqësorë së bashku me provat.

3. Organi kompetent, sipas parashikimeve të nenit 69, pika 1, të këtij ligji, verifikon pretendimet.

Nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, sipas të cilave vlerësohet se shkelja ka ndodhur, organi kompetent duhet të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar. Nëse vlerësohet e nevojshme, organi kompetent mbledh prova të tjera, merr në pyetje dëshmitarë ose pyet mbikëqyrësit për konstatimet e tyre.

4. Nëse nuk ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të vlerësuar se shkelja ka ndodhur, organi kompetent e arkivon ankesën ose kërkesën që është haptazi e pabazuar.

5. Organi kompetent, i përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, përgatit raportin e hetimit, i cili përmbledh faktet, listën e provave dhe rëndësinë e tyre, si dhe konkluzionet që argumentojnë nëse këto fakte mund të përbëjnë shkelje të detyrimeve të nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas ligjit "Për nëpunësin civil".

6. Organi kompetent, i përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, i paraqet propozim për caktimin e masës disiplinore ose propozim për mbylljen e hetimit organit kompetent, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 69, të këtij ligji.

Neni 73
Të drejtat e nëpunësit civil gjyqësor gjatë hetimit disiplinor

1. Organi kompetent, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 69, të

këtij ligji, njofton nëpunësin civil gjyqësor për arkivimin ose fillimin e hetimit disiplinor, duke i dhënë informacion për pretendimet dhe provat përkatëse, si dhe duke e informuar atë për të drejtat e tij.

2. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të njihet me dosjen disiplinore, të përfaqësohet nga i përfaqësuari, sipas parashikimeve në ligjin "Për nëpunësin civil", të paraqesë deklaratë dhe prova brenda një muaji nga marrja e njoftimit për vendimin e arkivimit dhe fillimit të hetimit.

3. Organi kompetent njofton nëpunësin civil gjyqësor dhe kërkuesin ose organin që e ka drejtuar kërkesën, lidhur me vendimin për mbylljen e hetimit.

Neni 74
Procedura disiplinore

1. Organi kompetent, sipas pikës 2, të nenit 69, të këtij ligji, e rrëzon kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, nëse nuk janë paraqitur shkaqe për kërkesën, nëse ka arsye për mbylljen e hetimit ose nëse në momentin e fillimit të hetimit afati i parashkrimit ka kaluar.

2. Në raste të tjera, organi kompetent, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 69, të këtij ligji, cakton seancën dëgjimore jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së kërkesës për caktimin e masës disiplinore.

3. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të dëgjohet, të paraqesë deklarata dhe prova të tjera, si dhe të përfaqësohet.

4. Organi kompetent, sipas pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, paraqet përfundimet e hetimit gjatë seancës disiplinore.

5. Organi kompetent, sipas pikës 2, të nenit 69, të këtij ligji, shqyrton dhe vendos për propozimin.

Neni 75
Kriteret për caktimin e masave disiplinore

1. Në rast se provohet shkelja disiplinore, organi kompetent, sipas nenit 69, pika 2, të këtij ligji cakton një masë disiplinore, sipas parashikimeve të ligjit "Për nëpunësin civil", duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe parimin e proporcionalitetit.

2. Në caktimin e masës, merren parasysh rrethanat rënduese në vijim kur:

a) shkelja kryhet më shumë se një herë;

b) shkelja ka zgjatur në kohë;

c) shkelja kryhet për shkak të motiveve diskriminuese;

ç) shkelja kryhet për motive të tjera të dobëta, të paraqitura para organit kompetent, të cilat duhen ndëshkuar;

d) nëpunësi civil gjyqësor nxit të tjerët të kryejnë shkelje ose veprime të paligjshme;

dh) shkelja kryhet duke shfrytëzuar dobësitë e të tjerëve;

e) ekziston çdo rrethanë tjetër, për të cilën organi kompetent çmon se rëndon shkeljen e kryer.

3. Në caktimin e masës, duhet të merren parasysh rrethanat lehtësuese në vijim:

a) nëpunësi civil gjyqësor e kryen shkeljen për herë të parë;

b) nëpunësi civil gjyqësor ka vepruar nën ndikimin e një pale të tretë, për shkak të besimit ose frikës;

c) shkelja e nëpunësit civil gjyqësor ka pasur ndikim të pakët, duke marrë parasysh në tërësi rrethanat e çështjes;

ç) nëpunësi civil gjyqësor bashkëpunon në hetimin dhe procedimin disiplinor, duke përfshirë dhe rastet kur pranon shkeljen e kryer ose jep informacione që ndihmojnë në hetimin dhe procedimin disiplinor;

d) nëpunësi civil gjyqësor ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga shkelja ose ka ndihmuar për të zhdukur ose pakësuar pasojat e saj;

dh)shkelja ka ndodhur shumë kohë më parë;

e) ekziston çdo rrethanë tjetër që organi kompetent e çmon se lehtëson shkeljen e kryer.

Neni 76
Pezullimi i hetimeve dhe procedurës disiplinore

1. Organi kompetent, sipas këtij ligji, duhet të pezullojë hetimin ose procedurën disiplinore nëse janë duke u kryer procedura penale, administrative ose civile:

a) në të cilat, njëra nga palët është nëpunësi civil gjyqësor që i atribuohet shkelja;

b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte.

2. Hetimi ose procedura disiplinore pezullohet deri në dhënien e vendimit gjyqësor përfundimtar.

3. Kërkuesi, nëpunësi civil gjyqësor përkatës, gjykatat dhe prokuroritë duhet të njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykatat dhe prokuroritë e interesuara duhet të dorëzojnë pa vonesë çdo vendim që është marrë për procedurat përkatëse.

4. Vendimi përfundimtar për pafajësinë ose rrëzimin e kërkimeve ndaj nëpunësit civil gjyqësor, në kuadër të një procesi penal, administrativ ose civil nuk përjashton hetimin ose caktimin e përgjegjësisë disiplinore të nëpunësit civil gjyqësor.

5. Organi kompetent u referohet vetëm fakteve, mbi të cilat bazohet vendimi përfundimtar, dhe jo dënimit ose pafajësisë së dhënë në vendim.

6. Pezullimi i hetimeve ose procedurës disiplinore ndërpret afatet e parashkrimit, të parashikuara në nenin 70, dhe afatet për organin kompetent, të parashikuara në nenin 71 të këtij ligji.

7. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

Neni 77
Pezullimi nga detyra gjatë hetimit ose procedimit disiplinor

1. Nëse ekzistojnë shkaqe për të vlerësuar se ushtrimi i detyrave nga nëpunësi civil gjyqësor, ndaj të cilit ka filluar hetimi ose procedura disiplinore, mund të dëmtojë procedurën disiplinore ose mund të dëmtojë rëndë ushtrimin e duhur të detyrave nga ky nëpunës, organi kompetent, sipas pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, i paraqet organit kompetent kërkesën për pezullim.

2. Organi kompetent kryesisht e pezullon nëpunësin civil gjyqësor, sipas parashikimeve të nenit 69, pika 2, të këtij ligji ose me kërkesë, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, ose merr çdo masë tjetër të përshtatshme dhe proporcionale.

3. Pezullimi mund të vendoset për një periudhë deri në 90 ditë, vetëm në rastet e shkeljeve të rënda dhe kur vazhdimi i ushtrimit të detyrës mund të paragjykojë hetimin e çështjes, shërbimin ose imazhin ose dinjitetin e funksionit.

4. Pezullimi ekzekutohet në mënyrë që të sigurojë garantimin e dinjitetit personal dhe profesional të nëpunësit civil gjyqësor.

Neni 78
E drejta për ankim

Nëpunësi civil gjyqësor përkatës, si dhe organi kompetent, sipas pikës 1, të nenit 69, të këtij ligji, kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimit për çështje disiplinore.

Neni 79
Regjistrimet disiplinore

1. Vendimet përfundimtare për masat disiplinore mbahen në dosjen personale të nëpunësit civil gjyqësor dhe regjistrohen në Regjistrin Qendror të Personelit.

2. Vendimi përfundimtar për masën disiplinore dhe regjistrimi i saj hiqen nga dosja personale dhe fshihen nga regjistri, kryesisht ose me kërkesë të nëpunësit civil gjyqësor nga Këshilli i Gjykatës dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas afateve të përcaktuara në ligjin "Për nëpunësin civil".

SEKSIONI V
NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

Neni 80
Ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor

1. Ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil", përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Me përjashtim të rasteve të tjera, të parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil", marrëdhënia në shërbimin civil gjyqësor përfundon nëpërmjet lirimit, në rastin e emërimit në funksionin e ministrit, zëvendësministrit, zyrtarit të emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave apo funksionarë të kabinetit.

3. Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron detyrën.

Neni 81
Regjistrimi në Regjistrin Qendror të Personelit

Këshilli i Gjykatës, brenda tri ditëve nga marrja e njoftimit të dorëheqjes ose nga marrja e njoftimit për shkakun ligjor të ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor, i cili regjistron vendimin në Regjistrin Qendror të Personelit.

Neni 82
Rregulla të hollësishme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të hollësishme për procedurën për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

SEKSIONI I

Neni 83
Statusi i kancelarëve në detyrë

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda gjashtë muajve nga krijimi i tij, verifikon plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe bën verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kancelarëve në detyrë.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor paraqet kërkesë për informacion për verifikimin e të dhënave dhe çdo shkaku tjetër përjashtues, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokurorisë, organeve publike financiare, Byrosë Kombëtare të Hetimit, shërbimeve shtetërore informative, si dhe çdo organi disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e mëparshme të punës të kancelarit. Nëse vlerësohet e nevojshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të kërkojë informacione shtesë nga institucione të tjera.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton një raport të arsyetuar me shkrim, bazuar në rezultatet e deklaratave të pasurisë, të vlerësimit të figurës, si dhe në përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të parashikuara në këtë ligj për kancelarin në detyrë.

4. Nëse kancelari në detyrë nuk e kalon me sukses verifikimin e pasurisë, të figurës, kushteve dhe kritereve ligjore, sipas ligjit, marrëdhëniet e punës të tij ndërpriten pasi vendimi i këshillit bëhet i formës së prerë. Kancelari në detyrë në gjykatë ka të drejtë të dëgjohet, të paraqesë deklarata dhe prova të tjera, si dhe të përfaqësohet.

5. Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i ankimueshëm, brenda dy javëve nga njoftimi i tij, sipas parashikimeve në ligjin "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë".

6. Kancelari në detyrë, i cili përmbush kërkesat ligjore, sipas këtij neni, merr pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës për vlerësimin profesional të tij. Në këtë rast, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëron kancelarin në detyrë brenda një jave nga publikimi i rezultateve të provimit.

7. Në rastin kur kancelari në detyrë nuk merr të paktën 70 për qind të pikëve totale, ai vlerësohet si i papërshtatshëm për pozicionin dhe i ndërpriten marrëdhëniet e punës në funksionin e kancelarit. Në këtë rast, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër në administratën e gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale.

8. Rregullat e parashikuara në nenet 87 dhe 88, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për kritere të tjera që lidhen me specifikat e funksionit të kancelarit, si dhe për procedurat që ndiqen, me qëllim zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 83/1
Përvoja profesionale e zëvendëskryetarit të gjykatës
(Shtuar me Ligjin nr. 46/2021)

Përjashtimisht, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit, kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së shkallës së parë duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar, ndërsa kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së apelit duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar i gjykatës së apelit.

Neni 84
Statusi i nëpunësit civil në detyrë në Gjykatën e Lartë

1. Brenda afatit 6-mujor nga krijimi i Këshillit të Gjykatës, Këshilli i

Gjykatës vlerëson plotësimin e kritereve formale të punonjësve në detyrë për pozicionin që kryejnë, sipas këtij ligji, me përjashtim të kancelarëve dhe ndihmësve ligjorë.

2. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale, nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës. Rregullimet e parashikuara në nenin 85, të këtij ligji, lidhur me njoftimin dhe ankimin, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

3. Për kancelarin e gjykatës, zbatohen rregullimet e parashikuara në nenin 83 të këtij ligji.

4. Ndihmësi ligjor magjistrat dhe këshilltari/ndihmësi ligjor jomagjistrat janë subjekt i dispozitave kalimtare të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve".

5. Rregullimet e parashikuara në nenin 88, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për kritere të tjera që lidhen me specifikat e pozicionit të nëpunësve civilë, si dhe për procedurat që ndiqen me qëllim zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 85
Statusi i punonjësve të tjerë në detyrë në gjykata
(Shtuar pika 2/1 me Ligjin nr. 46/2021)

1. Gjykata ngre Këshillin e Gjykatës brenda katër muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Brenda afatit 6-mujor nga krijimi i Këshillit të Gjykatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson plotësimin e kritereve formale të punonjësve në detyrë për pozicionin që kryejnë, sipas këtij ligji, me përjashtim të kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës.

2/1. Për sekretarët gjyqësorë në detyrë, që kanë mbi 3 vjet përvojë pune në

këtë pozicion dhe janë me arsim të lartë, kriteri i diplomimit në drejtësi nuk përbën shkak për të mos njohur statusin e nëpunësit gjyqësor civil, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tij në punë.

3. Punonjësi në detyrë në gjykatë ka të drejtë të dëgjohet, të paraqesë deklarata dhe prova të tjera, si dhe të përfaqësohet.

4. Kancelari i njofton vendimin me shkrim të arsyetuar të Këshillit të Gjykatës, të gjithë punonjësve të gjykatës brenda dy javëve nga data e vendimit të Këshillit të Gjykatës.

5. Brenda dy javëve nga njoftimi, sipas parashikimit në pikën 4, të këtij neni, mund të bëhet ankim ndaj vendimit të Këshillit të Gjykatës në gjykatën kompetente.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara për kritere të tjera që lidhen me specifikat e pozicionit të nëpunësve civilë, si dhe për procedurat me qëllim zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 86
Dispozitë e veçantë për të punësuarit në Gjykatat e Krimeve të Rënda

1. Të punësuarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda duhet të plotësojnë kushtet e sigurimit, të caktuara me ligj të veçantë, përfshirë dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake dhe për familjarët e afërm të tyre. Ndaj tyre zbatohen parashikimet e neneve 85 dhe 87 të këtij ligji.

2. Këshillat e gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar krijohen brenda dy javëve pas krijimit të gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Këshillat e gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar konfirmojnë të punësuarit në detyrë nëpërmjet një vendimi të shkruar, sipas parashikimeve të nenit 85, të këtij ligji, nëse i punësuari në detyrë në gjykatë, si dhe familjarët e afërm të tij, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, brenda dy javëve nga krijimi i gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

3. Në rastet kur i punësuari ose nëpunësi civil në detyrë nuk konfirmohet nga Këshilli i Gjykatës, bazuar në arsye të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, atëherë dosja e punonjësit të gjykatës i përcillet Këshillit të Lartë

Gjyqësor, me qëllim vlerësimin e mundësive ekzistuese nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për sistemimin në një pozicion të lirë në një tjetër gjykatë, zyrë prokurorie, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë ose në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale të pozicionit të punës, dhe vetëm nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës.

4. Parashikimet e këtij neni nuk janë në kundërshtim me zbatimin e parashikimeve të nenit 88 të këtij ligji.

Neni 87
Vazhdimi ose përfundimi i kontratës së punës

1. Në rast se nuk bëhet ankim brenda afatit të parashikuar, vendimi i Këshillit të Gjykatës për statusin e punonjësit në detyrë në gjykatë bëhet përfundimtar dhe kontrata e punësimit e punonjësit në detyrë, statusi i të cilit konsiderohet ai i nëpunësit civil gjyqësor, përfundon efektet në datën e fundit të afatit të ankimit. Punonjësit e tjerë në gjykatë vazhdojnë të konsiderohen si të punësuar në përputhje me kontratën e punësimit, bazuar në Kodin e Punës.

2. Në rast se bëhet ankim, vendimi për statusin e nëpunësit në detyrë të gjykatës bëhet përfundimtar me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rast të njohjes së statusit të nëpunësit civil gjyqësor nga gjykata, kontrata e punësimit të nëpunësit përkatës në detyrë përfundon në ditën e njoftimit të vendimit gjyqësor përfundimtar. Punonjësit e tjerë në gjykatë, ankimi i të cilëve nuk është njohur, vazhdojnë të konsiderohen si të punësuar, në përputhje me kontratën e punësimit, bazuar në Kodin e Punës.

3. Punonjësit në detyrë, periudha e provës së të cilëve nuk ka përfunduar në datën kur bëhet përfundimtar vendimi për statusin e tyre, i nënshtrohen periudhës së provës, sipas kontratës së tyre të punësimit. Dispozitat e këtij ligji për vlerësimin e punës dhe për vendimin në fund të periudhës së provës zbatohen për çdo nëpunës civil gjyqësor në provë.

Neni 88
Regjistri Qendror i Personelit

1. Kancelari reflekton në Regjistrin Qendror të Personelit, të dhënat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 63, të këtij ligji, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi të ligjit.

2. Kancelari i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda tri javëve, vendimin e Këshillit të Gjykatës, në përputhje me nenin 85, të këtij ligji, informacion nëse është paraqitur ankim brenda afatit kohor dhe

informacion të nevojshëm për Regjistrin Qendror të Personelit, në përputhje me nenin 63 të këtij ligji. Këshilli i Lartë Gjyqësor regjistron statusin e nëpunësit në detyrë në administratën gjyqësore, brenda një jave pasi është dhënë vendimi gjyqësor i formës së prerë.

3. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor regjistron statusin e kancelarëve në detyrë, nëpunësve civilë në detyrë në Gjykatën e Lartë, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë në detyrë dhe punonjësve të tjerë në administratën gjyqësore.

Neni 89
Kompetencat tokësore të degëve të gjykatës

1. Brenda 18 muajve nga krijimi i tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton përkohësisht degët e gjykatave, derisa vendimi për rrethet gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Lartë Gjyqësor mban parasysh numrin e gjyqtarëve për gjykatë dhe mesataren e çështjeve gjyqësore për gjyqtar në gjykatë, me qëllim shmangien, për aq sa është e mundur, të gjykatave me numër më të vogël minimal të gjyqtarëve me mesatare më të ulët ngarkese në punë, siç parashikohet në këtë ligj.

2. Bazuar në parimet, objektivat dhe kriteret e përcaktuara në nenin 13, pika 3, nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të përcaktojë se cila degë gjykate funksionon si e përhershme dhe cila si e përkohshme, si dhe përcakton rregulla të detajuara për funksionimin e degëve.

Neni 90
Numri i gjyqtarëve për gjykatë

Derisa të merret një vendim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për numrin e gjyqtarëve për gjykatë, në përputhje me këtë ligj, numri i gjyqtarëve për gjykatë mbetet siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

SEKSIONI II
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 91
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Lartë Gjyqësor të hartojë dhe të miratojë aktet nënligjore, në përputhje me këtë ligj, jo më vonë se 6 muaj nga krijimi i

tij, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të hartojë dhe të miratojë aktet nënligjore, në përputhje me këtë ligj, jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, jo më vonë se 6 muaj nga miratimi i këtij ligji, të hartojë dhe të miratojë aktet nënligjore që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenin 64 të këtij ligji.

4. Të gjitha aktet nënligjore, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 92
Shfuqizime

1. Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të:

a) nenit 18, pikat 1 dhe 3, shkronja "b", të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të cilat shfuqizohen katër muaj pas ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor;

b) nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, e cila shfuqizohet 18 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

c) nenit 18, pika 4, i ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, e cila shfuqizohet me zgjedhjen e zëvendëskryetarit;

ç) neneve 26 dhe 27, për pagat e gjyqtarëve, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, të cilat shfuqizohen pasi të jetë vënë në zbatim sistemi i ri i pagave dhe përfitimeve, sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Ligji nr. 8588, datë 15.3.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të:

a) nenit 7, shkronjat "b", "d", "dh" dhe "e", të cilat shfuqizohen 4 muaj pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

b) nenit 8, për përzgjedhjen e zëvendëskryetarit, i cili shfuqizohet menjëherë me ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 93
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
Ilir META

Miratuar në datën 6.10.2016

LIGJ
Nr. 115/2016

PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË*

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA I

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i rregullimit të këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe rregullave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 2
Parimet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë

Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efiçencës.

* Shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.41, datë 16.5.2017 dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017;
Ndryshuar me Ligjin nr. 47, datë 18.7.2019.

PJESA II
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KREU I
PËRBËRJA DHE ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

SEKSIONI 1
ANËTARËT E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE STATUSI I TYRE

Neni 3
Përbërja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe mandati i anëtarëve

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor është organ kolegjial i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë. Gjashtë prej anëtarëve të Këshillit janë gjyqtarë nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor. Pesë anëtarët e tjerë të Këshillit janë juristë të përzgjedhur nga radhët e avokatëve, të pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë, të Shkollës së Magjistraturës dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile.

2. Anëtarët gjyqtarë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve.

3. Anëtarët jogjyqtarë që zgjidhen nga radhët e avokatëve, trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe shoqërisë civile zgjidhen nga Kuvendi, bazuar në një proces vlerësimi paraprak të kushteve dhe kritereve ligjore, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

4. Përveç rasteve kur vërtetohen kushtet për ndërprerjen e parakohshme të mandatit, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor qëndron në detyrë për 5 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme.

Neni 4
Statusi i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka statusin e magjistratit, sipas rregullave të parashikuara nga ligji "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

2. Anëtari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

3. Anëtari gjyqtar i Këshillit nuk i nënshtrohet vlerësimit etik dhe profesional të veprimtarisë gjatë kohës së shërbimit si anëtar. Performanca e tij gjatë kohës së shërbimit si anëtar i Këshillit mbahet parasysh në rast të transferimit ose promovimit, sipas parashikimeve të ligjit që rregullon statusin e gjyqtarit dhe prokurorit.

4. Anëtari gjyqtar, në përfundim të mandatit, kthehet në vendin e mëparshëm të punës. Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ose i gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme i pezullohet mandati si gjyqtar gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Anëtari gjyqtar i Këshillit nuk mund të transferohet, të ngrihet në detyrë ose të delegohet gjatë 3 viteve pas përfundimit të mandatit.

5. Anëtari jogjyqtar, i cili përpara emërimit punonte me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose, në pamundësi, në një detyrë të barasvlershme me të.

Neni 5
Shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor
(*Shfuqizuar me Vendimin e GJK nr. 41/ 2017 ; Ndryshuar me Ligjin nr.47/2019*)

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:

a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor;

b) gjatë ushtrimit të funksionit, nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë.

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi ose sjellja e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor konsiderohet shkelje disiplinore ose një çështje e veprimtarisë profesionale, në çdo rast merret parasysh:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshtësia e veprimit ose mosveprimit;

c) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe

ç) çdo situatë që është jashtë kontrollit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor.

Neni 5/1
Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit
(*Shtuar me Ligjin nr. 47/2019*)

Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga pjesëmarrja në mbledhjen plenare ose në mbledhjet e komisioneve, kur është e detyrueshme sipas ligjit, nëse anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka dijeni ose duhet të kishte dijeni për rrethana të tilla;

b) paraqitja e kërkesës për heqje dorë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse ky veprim:

   i. nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;

   ii. bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për subjektin e procedurës administrative, ose synon shmangien e përgjegjësisë ligjore si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor apo caktimin e çështjes një anëtari tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

   iii. nuk kryhet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun;

c) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një anëtari tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

ç) mospërmbushja e pajustifikuar ose e përsëritur e funksioneve;

d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që sjell përfitime të padrejta ose dëmtim të subjektit të procedurës administrative;

e) angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë anëtarit, ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

ë) mungesa e pajustifikuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;

f) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor;

g) mosnjoftimi i Kryetarit të Këshillit, si dhe autoriteteve kompetente, sipas ligjit, mbi ndërhyrjet ose forma të tjera të ndikimit nga magjistratët, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektet e tjera;

gj) shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

h) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve, sipas legjislacionit në fuqi;

i) mosnjoftimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

j) mosrespektimi i detyrimeve ligjore, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

k) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 5/2
Shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit
(*Shtuar me Ligjin nr. 47/2019*)

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

a) përdorimi i pozicionit të anëtarit të Këshillit për krijimin e përfitimeve të pajustifikuara për veten ose për të tretët;

b) ushtrimi i veprimtarive jashtë funksionit, me pagesë, duke mos respektuar rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

c) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me anëtarin e Këshillit, ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;

ç) përfitimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dhuratave, favoreve,

premtimeve ose trajtimit preferencial të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit të ushtruar ose për shkak të përdorimit të pozitës si anëtar i Këshillit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;

d) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e anëtarit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

Neni 5/3
Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale
(*Shtuar me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë veprime, mosveprime ose sjellje, për të cilat anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është dënuar me vendim të formës së prerë dhe që, sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuara nga gjykata.

2. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprimet, mosveprimet ose sjelljet, sipas pikës 1, të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është rehabilituar ose ka përfituar nga falja apo amnistia.

3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" zbatohen për aq sa është e nevojshme.

Neni 6
Procedura disiplinore
(*Ndryshuar pika 4 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Gjykata Kushtetuese vendos pezullimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në rastet e parashikuara në Kushtetutë.

4. Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të këtij ligji, ligjit "Për Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

SEKSIONI 2
ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

NËNSEKSIONI I
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE GJYQTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Neni 7
Zgjedhja e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kushtet për t'u zgjedhur

1. Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve zgjedh 6 anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas raportit të mëposhtëm:

a) tre prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të shkallës së parë. Së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë jashtë Tiranës;

b) dy prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të apelit. Së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të apelit jashtë Tiranës;

c) një prej të zgjedhurve është gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

2. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) në kohën e kandidimit, të kenë ushtruar funksionin e gjyqtarit për të paktën 10 vjet;

b) në kohën e kandidimit, nuk duhet të jenë kryetarë të një gjykate ose anëtarë të organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata gjyqtarësh, sindikata gjyqtarësh etj.;

c) të jenë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale;

ç) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

e) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;

ë) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të parashikuar në ligjin "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

3. Çdo gjyqtar i Gjykatës së Lartë, që plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, ka të drejtë të kandidojë.

4. Çdo gjyqtar i shkallës së parë dhe i apelit, që plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 10 kolegëve nga e njëjta shkallë e gjyqësorit, ka të drejtë të kandidojë.

Neni 8
Mbështetja e kandidatëve

1. Kryetari i Gjykatës së Lartë miraton modelin e deklaratës individuale për dhënien e mbështetjes kandidatëve për anëtarë të Këshillit.

2. Një gjyqtar nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat për çdo vend vakant.

Neni 9
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 4 muaj nga data e mbarimit të mandatit të anëtarëve gjyqtarë në detyrë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kryetari i Gjykatës së Lartë shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga gjyqtarët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Kuvendi mund t'i drejtojë Kryetarit të Gjykatës së Lartë një kujtesë lidhur me detyrimet e tij, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe çdo informacion tjetër që e gjykon të nevojshëm, për datën e fillimit të procesit për

përzgjedhjen e kandidatëve dhe kalendarin e veprimeve.

3. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare dhe elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet që duhet të shoqërojnë atë.

4. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe i dërgohet të gjithë gjyqtarëve në adresën elektronike zyrtare.

Neni 10
Paraqitja dhe shqyrtimi i shprehjes së interesit

1. Brenda 15 ditëve nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, gjyqtarët e interesuar shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike të përmendur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit ose në adresën postare të Gjykatës së Lartë.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin të paktën dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) deklaratat individuale të gjyqtarëve që i kanë mbështetur, të nënshkruara rregullisht;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

d) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;

dh) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;

e) informacion mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që

ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton dhe vë në dispozicion të të interesuarve një formular tip për dhënien e këtij informacioni;

ë) listën e personave të lidhur, të përcaktuar në ligjin për "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Neni 11
Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore

1. Brenda 7 ditëve nga dita kur mbyllet afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit, nën përgjegjësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, administrata e Gjykatës së Lartë verifikon plotësimin e kushteve nga kandidatët, sipas përcaktimeve të nenit 7, pikat 2 dhe 4, të këtij ligji, dhe shpall zyrtarisht kandidaturat në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

2. Vendimi për përjashtimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 7, pikat 2 dhe 4, merret nga Komisioni i Kualifikimit, i përbërë nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe dy gjyqtarë të tjerë të Gjykatës së Lartë të zgjedhur me short nga radhët e atyre që nuk kandidojnë. Shorti për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit organizohet nën përgjegjësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

3. Kandidatët e përjashtuar njoftohen menjëherë, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

4. Në qoftë se nuk ka kandidatë për një ose më shumë nga nivelet e gjyqësorit që duhet të përfaqësohen në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të nenit 147, të Kushtetutës dhe të këtij ligji, Kryetari i Gjykatës së Lartë bën një thirrje të dytë jo më vonë se 3 ditë nga dita kur shpallen kandidaturat në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Në këtë rast afati për paraqitjen e shprehjeve të interesit është 15 ditë nga dita e shpalljes së thirrjes së dytë.

5. Në qoftë se edhe pas thirrjes së dytë nuk paraqiten kandidatë nga shkallët e papërfaqësuara të gjyqësorit, zgjedhja e tyre bëhet me short nga radhët e gjyqtarëve që kanë kandiduar për vendin vakant. Çdo kandidat që përmbush kriteret për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit dhe kriteret për t'u ngritur në detyrë ose për t'u transferuar në shkallët e papërfaqësuara të gjyqësorit, ka të drejtë të kandidojë për vendin vakant përkatës.

Neni 12
Ankimet kundër vendimeve të përjashtimit

1. Ankimet kundër vendimeve për përjashtimin e kandidatëve për shkelje të rënda procedurale, bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e depozitimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Komisioni i Kualifikimit, sipas nenit 11 të këtij ligji.

Neni 13
Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Jo më vonë se dy muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, Kryetari i Gjykatës së Lartë thërret Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve të të gjitha niveleve për të zgjedhur anëtarët e Këshillit.

2. Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, i dërgohet secilit gjyqtar në adresën elektronike zyrtare dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme.

3. Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit tregon datën, vendin dhe orën e mbledhjes.

4. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, zgjedhja e anëtarëve të Këshillit është pika e vetme në rendin e ditës së Mbledhjes së Përgjithshme.

Neni 14
Kuorumi

1. Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor është e detyrueshme.

2. Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

3. Numri i pjesëmarrësve në Mbledhjen e Përgjithshme shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

Neni 15
Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme nga anëtarët

1. Në qoftë së në përfundim të afatit të parashikuar në nenin 13, pika 1, të këtij ligji, nuk është thirrur ende Mbledhja e Përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ajo mund të thirret menjëherë nga një e dhjeta e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

2. Kërkesa e tyre për thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme dorëzohet në administratën e Gjykatës së Lartë.

3. Me paraqitjen e kërkesës, Kancelari i Gjykatës së Lartë njofton menjëherë gjyqtarët, duke përcaktuar në njoftim datën, vendin dhe orën e mbledhjes. Njoftimi i dërgohet secilit gjyqtar në adresën elektronike zyrtare.

Neni 16
Procesi i votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Votimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve është i fshehtë dhe individual.

2. Jo më vonë se 2 ditë nga data e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit, Kryetari i Gjykatës së Lartë miraton fletën tip të votimit, e cila përmban emrat e kandidatëve të regjistruar.

3. Procesi i votimit është i hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interesim për të ndjekur procesin. Vëzhguesit autorizohen paraprakisht nga Kryetari i Gjykatës së Lartë. Ministri i Drejtësisë ose persona të autorizuar prej tij, 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, mund të marrin pjesë si vëzhgues në Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor pa autorizim paraprak.

4. Për administrimin e procesit të votimit krijohet komisioni i votimit, i përbërë nga 3 ndihmësmagjistratë të Gjykatës së Lartë të zgjedhur me short. Shorti për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit organizohet nën përgjegjësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

5. Përpara fillimit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit shumëfishojnë

dhe nënshkruajnë paraprakisht një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e gjyqtarëve që janë të pranishëm në mbledhje. Në rast të dëmtimit të një ose disa fletëve të votimit, komisioni nënshkruan një numër fletësh votimi të barabartë me fletët e dëmtuara dhe shkatërron në praninë e pjesëmarrësve fletët e dëmtuara.

6. Në administrimin e procesit të votimit komisioni i votimit ndihmohet nga administrata e Gjykatës së Lartë.

7. Me propozim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve mund të miratojë rregulla më të hollësishme për procesin e votimit dhe për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit, në fillim të mbledhjes.

Neni 17
Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit

1. Në përfundim të procesit të votimit, nën përgjegjësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, anëtarët e komisionit të votimit hapin kutitë në prani të të gjithë gjyqtarëve që marrin pjesë në mbledhje, numërojnë votat dhe shpallin rezultatin paraprak të zgjedhjeve.

2. Fletët e votimit ndahen në vota të vlefshme ose në vota të pavlefshme. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit;

b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;

c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;

ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;

d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;

dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

3. Votat që gjykohen të pavlefshme rivlerësohen në fund të procesit të numërimit. Në rast mosmarrëveshjeje mes anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave, vendimet merren në fund të procesit të rivlerësimit me shumicën e votave. Votat që gjykohen të vlefshme në fund të procesit të rivlerësimit u shtohen kandidatëve përkatës.

4. Në përfundim të procesit të votimit dhe të numërimit të votave, anëtarët e komisionit të votimit hartojnë dhe miratojnë një procesverbal, i cili tregon numrin e pjesëmarrësve, numrin total të votave të hedhura, numrin e votave të hedhura për secilën kategori kandidatësh, numrin e votave të pavlefshme, nëse ka të tilla, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve fitues. Rastet e mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

5. Në fund të procesit të votimit quhen të zgjedhur kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në qoftë se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash, fituesi përcaktohet me short midis tyre.

6. Procesverbali origjinal që tregon numrin e pjesëmarrësve në Mbledhjen e Përgjithshme, numrin e votave dhe rezultatin e numërimit të votave, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të votimit, i dërgohet menjëherë Gjykatës së Lartë.

7. Vendimet me rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve, çdo vendim i ndërmjetëm dhe procesverbalet nënshkruhen bashkërisht nga anëtarët e komisionit të votimit. Vendimet njoftohen publikisht në fund të Mbledhjes së Përgjithshme dhe shpallen zyrtarisht në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme. Vendimi për shpalljen e fituesve botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 18
Ankimet kundër vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme

1. Ankimet për shkelje të procedurës që lidhen me thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme, në verifikimin e pjesëmarrjes, të votimit dhe numërimit të votave, të konstatimit dhe shpalljes së votave të pavlefshme dhe të shpalljes së rezultatit gjatë Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

2. Gjykata Administrative e Apelit merr vendim brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Gjykata mund të vendosë përsëritjen e zgjedhjeve vetëm në qoftë se shkeljet procedurale të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vërtetohen dhe janë të tilla që kanë ndikuar ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Në rast se Gjykata Administrative e Apelit vendos përsëritjen e zgjedhjeve, ato zhvillohen jo më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

NËNSEKSIONI II
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NGA AVOKATIA

Neni 19
Verifikimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga avokatia dhe kushtet për t'u zgjedhur

1. Kuvendi zgjedh 2 anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga parashikimet e këtij neni.

2. Për verifikimin paraprak të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët dhe për vlerësimin paraprak të integritetit moral e profesional të tyre, krijohet një Komision i Pavarur *Ad Hoc,* sipas parashikimeve të nenit 23 të këtij ligji.

3. Avokatët që kandidojnë për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë "Master i shkencave", ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të kenë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

c) të jenë avokatë të licencuar sipas ligjit;

ç) të kenë shlyer rregullisht të gjitha detyrimet tatimore dhe financiare ndaj Dhomës së Avokatisë;

d) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist, nga të cilat të paktën 10 vitet e fundit të kenë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje;

dh) të jenë licencuar për të ushtruar profesionin pranë Gjykatës së Lartë dhe/ose Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve të ligjit "Për profesionin e avokatit";

e) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

ë) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos kenë mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publi ke ose pozicione drejtuese në partitë politike;

g) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë";

gj) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;

h) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar;

i) të mos jenë larguar nga detyra të mëparshme si gjyqtar, prokuror ose oficer i Policisë Gjyqësore me masë disiplinore;

j) të mos jenë kandidatë të propozuar nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, si dhe nga shoqëria civile.

4. Avokatët që mbajnë pozicione drejtuese në dhomat e avokatisë ose në organet drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata, grupime dhe sindikata avokatësh, japin dorëheqjen nga këto pozicione drejtuese nëse zgjidhen anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 20
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve avokatë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall vendet vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga avokatët që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 19 të këtij ligji. Shpallja bëhet në faqen zyrtare të Kuvendit, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të Avokatit të Popullit dhe në të paktën një gazetë me tirazhin më të lartë.

2. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda

të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare dhe elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet që duhet të shoqërojnë atë.

Neni 21
Paraqitja e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, avokatët e interesuar shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar Avokatit të Popullit.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike të përmendur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit dhe/ose në adresën postare të Avokatit të Popullit.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin nëse zgjidhen;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për integritetin e personave qe zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

ç) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut të vitit 1991;

d) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;

dh) dokumente konfirmuese nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, që vërtetojnë se kandidati plotëson kushtet e parashikuara në shkronjat "c" deri në "e", të nenit 19, të këtij ligji;

e) çdo dokument tjetër që vërteton plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 19 të këtij ligji.

Neni 22
Shqyrtimi i shprehjes së interesit

1. Për marrjen në dorëzim të shprehjeve të interesit dhe të dokumentacionit shoqërues të kandidatëve, mbahet një procesverbal, i cili tregon numrin dhe llojin e dokumenteve të paraqitura nga kandidatët. Procesverbali firmoset nga kandidati dhe përfaqësuesi i

zyrës së protokollit të Avokatit të Popullit.

2. Avokati i Popullit, brenda 5 ditëve nga paraqitja e shprehjeve të interesit dhe dokumentacionit shoqërues, verifikon nëse dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët është i plotë.

3. Nëse dokumentacioni i kandidatëve nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në Kushtetutë dhe në nenin 19, të këtij ligji, si dhe të kritereve profesionale e morale, sipas nenit 34, të këtij ligji, Avokati i Popullit i kërkon kandidatit të bëjë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë, i përcillet kandidatit me shkresë zyrtare ose në adresën elektronike të deklaruar, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit nga Avokati i Popullit.

4. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues, ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor, nuk pezullon procesin e regjistrimit përfundimtar të kandidatëve dhe të dokumentacionit shoqërues. Në këtë rast, vlerësimi i kandidatit bëhet mbi dokumentacionin e dosjes së administruar nga Avokati i Popullit.

5. Data në të cilën plotësohet dokumentacioni i kërkuar, ose afati i përcaktuar për plotësimin, konsiderohet dhe dita e paraqitjes dhe regjistrimit të kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues në zyrën e Avokatit të Popullit. Paraqitja përfundimtare dokumentohet me një numër regjistrimi nga zyra e protokollit të Avokatit të Popullit.

Neni 23
Përbërja e Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve

1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor përbëhet nga:

a) Avokati i Popullit;

b) Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;

c) dy avokatë, më i riu dhe më i vjetri në moshë ndër avokatët që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që nuk kandidojnë dhe që janë angazhuar gjatë 5 viteve të fundit në mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës ose në Shkollën e Avokatisë;

ç) një anëtar rregullt i Akademisë së Shkencave nga shkencat shoqërore.

2. Avokati i Popullit është Kryetari i Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*. Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është zëvendëskryetar i komisionit.

3. Pjesëmarrja në mbledhjen e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor është e detyrueshme. Anëtarët që mungojnë zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues, të cilët zgjidhen sipas parashikimeve të nenit 25 të këtij ligji.

4. Mbledhja e komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Neni 24
Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*

1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* është organ i pavarur që bën verifikimin paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale e morale dhe renditjen e avokatëve që kandidojnë për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* i përmbush funksionet e tij duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe me qëllimin për të siguruar cilësi sa më të lartë profesionale dhe morale në përbërjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* kryen procedurë të përbashkët për verifikimin paraprak të dy kategorive të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rast të krijimit të vendeve vakante për këshillat në të njëjtën kohë.

Neni 25
Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*

1. Jo më vonë se 2 ditë nga dita e paraqitjes së shprehjeve të interesit dhe regjistrimit të kandidatëve, Avokati i Popullit i kërkon Dhomës Kombëtare të Avokatisë listën e avokatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 19, shkronjat "c" deri në "e", për të qenë anëtarë të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*, sipas parashikimeve të nenit 23, pika 1, të këtij ligji. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dërgon listën brenda 5 ditëve nga data e kërkesës.

2. Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të listës së avokatëve për plotësimin e kritereve të parashikuara në nenin 19, të këtij ligji, fton më të riun në moshë dhe më të vjetrin në moshë ndër ta që të shërbejnë si anëtarë

të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*. Nëse një ose të dy avokatët e ftuar nuk pranojnë të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*, Avokati i Popullit kryen të njëjtën procedurë me kandidatët që pasojnë në listë, sipas kriterit të moshës. Avokati i Popullit cakton edhe 2 anëtarë zëvendësues, sipas së njëjtës procedurë dhe në bazë të të njëjtit kriter.

3. Avokati i Popullit jo më vonë se 2 ditë nga dita e shprehjes së interesit i kërkon Akademisë së Shkencave dërgimin e listës me emrat e anëtarit dhe anëtarit zëvendësues për Komisionin e Pavarur *Ad Hoc*.

4. Jo më vonë se 5 ditë nga dita e dërgimit të shkresës së Avokatit të Popullit, Akademia e Shkencave i dërgon Avokatit të Popullit listën me emrat e anëtarëve, të cilët zgjidhen me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Akademisë së Shkencave.

5. Në rast se në përfundim të afatit të parashikuar në këtë nen, Avokati i Popullit nuk ka ushtruar përgjegjësitë e tij, ato ushtrohen nga zëvendëskryetari i Komisionit *Ad Hoc*. Mosushtrimi i kompetencave, sipas këtij neni, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, përbën shkelje disiplinore për Avokatin e Popullit.

Neni 26
Thirrja e mbledhjes së Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*

1. Jo më vonë se 10 ditë nga dita e paraqitjes së shprehjeve të interesit dhe regjistrimit të kandidatëve Avokati i Popullit thërret mbledhjen e Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*.

2. Thirrja e mbledhjes së komisionit bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve në adresën elektronike të deklaruar dhe me postë.

3. Thirrja e mbledhjes tregon datën, vendin dhe orën e mbledhjes.

4. Në rast se në përfundim të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, Avokati i Popullit nuk ka ushtruar përgjegjësitë e tij, ato ushtrohen nga Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Neni 27
Vendi i takimit dhe mbështetja administrative

1. Mbledhja e Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* thirret nga Avokati i Popullit sa herë është e nevojshme.

2. Mbledhjet e komisionit janë të mbyllura.

3. Mbledhjet e komisionit zhvillohen në zyrat e Avokatit të Popullit.

4. Avokati i Popullit siguron mbështetjen e nevojshme organizative, administrative dhe financiare për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Komisionit *Ad Hoc,* të parashikuara në nenin 24 të këtij ligji.

Neni 28
Konflikti i interesit dhe papajtueshmëria

1. Anëtari i komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të Komisionit *Ad Hoc,* lidhur me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës, të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe të mos marrë pjesë në marrjen e vendimit për çështjen përkatëse.

2. Anëtari i komisionit nuk mund të marrë pjesë në verifikimin paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në qoftë se midis tij dhe kandidatit ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme:

a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese;

b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; ose

c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerk.

Neni 29
Heqja dorë

1. Anëtari i komisionit *Ad Hoc* është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në procesin për verifikimin paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në rastet e mëposhtme:

a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me kandidatin, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën;

b) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/ bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me kandidatin.

2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga kryetari i komisionit. Në rast se konflikti i interesit ose papajtueshmëria prek

kryetarin e komisionit, vendimi për pranimin e dorëheqjes pranohet nga zëvendëskryetari.

Neni 30
Përjashtimi dhe zëvendësimi i anëtarit

1. Kandidatët mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* nga pjesëmarrja në verifikimin paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve morale e profesionale dhe renditjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë përpara datës së mbledhjes së komisionit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenet 28 dhe 29, të këtij ligji, dhe kur anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes.

2. Vendimi për përjashtimin e anëtarit merret nga kryetari i komisionit. Në rast se kërkohet përjashtimi i kryetarit vendimi merret nga zëvendëskryetari.

3. Kur anëtari i përjashtuar, i dorëhequr ose që mungon është Avokati i Popullit ai zëvendësohet nga komisioneri i Avokatit të Popullit më i vjetër në moshë.

4. Kur anëtari i përjashtuar, i dorëhequr ose që mungon është Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ai zëvendësohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

5. Kur anëtari i përjashtuar, i dorëhequr ose që mungon, është një prej anëtarëve të tjerë të komisionit, ai zëvendësohet nga anëtari zëvendësues, sipas kritereve të parashikuara në nenin 25 të këtij ligji.

Neni 31
Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore

1. Jo më vonë se 45 ditë nga dita kur përfundon afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* verifikon plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij për verifikimin paraprak të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët, komisioni ndihmohet nga administrata e Avokatit të Popullit.

2. Për kontrollin e integritetit të kandidatëve, kryetari i komisionit i përcjell menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme formularët e vetëdeklarimit, të plotësuar nga kandidatët, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Prokuroria e Përgjithshme kryen

verifikimet brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve.

3. Për kontrollin e kushteve të tjera ligjore, kryetari i komisionit dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës.

4. Për kontrollin e plotësimit të kushteve të parashikuara nga shkronjat "c" deri në "e", të nenit 19, të këtij ligji, nëse është e nevojshme, kryetari i komisionit i drejtohet Dhomës Kombëtare të Avokatisë për saktësimin e informacionit të deklaruar nga kandidati.

5. Me përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak, komisioni shpall menjëherë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit, të Kuvendit dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Në të njëjtën kohë, komisioni i komunikon individualisht kandidatëve, rezultatin e verifikimit të të dhënave të deklaruara.

6. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale, për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

Neni 32
Ankimet kundër vendimeve të përjashtimit të kandidatëve

1. Ankimet kundër vendimeve për përjashtimin e kandidatëve, vetëm për shkelje të rënda procedurale, bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë;

3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Komisioni i Pavarur *Ad Hoc,* sipas nenit 33 të këtij ligji.

Neni 33
Fillimi dhe afati për zhvillimin e procedurës së vlerësimit paraprak dhe renditjes së kandidatëve

1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc,* pas shpalljes zyrtarisht të kandidaturave, të cilat plotësojnë kushtet ligjore, mblidhet menjëherë për vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve dhe bën renditjen e tyre jo më vonë se 10 ditë nga dita e mbledhjes.

2. Kandidatët, të cilët kanë fituar të drejtën për të kandiduar me vendim të gjykatës, sipas nenit 32, të këtij ligji, vlerësohen bashkë me kandidatët e tjerë.

3. Këshilli qëndron i mbledhur deri në përfundim të procesit të vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve.

Neni 34
Kriteret profesionale dhe morale për renditjen e kandidatëve

1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre profesionale bazuar në:

a) rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon;

b) vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës;

c) rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë;

ç) ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit.

2. Komisioni bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre morale bazuar në:

a) reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve;

b) cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikmëria në ushtrimin e detyrave, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, etika profesionale, përdorimi i të gjitha mjeteve të ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave të personave që përfaqësohen prej tij;

c) angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

3. Komisioni bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre organizative, drejtuese dhe menaxheriale bazuar në:

a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;

b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësitë e komunikimit;

ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore ose multikulturore;

d) aftësitë e përfaqësimit në publik.

4. Krahas kritereve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, në vlerësimin e kandidatëve mbahen parasysh edhe:

a) mbajtja e titujve akademikë;

b) kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;

c) njohja e gjuhëve të huaja.

5. Komisioni interviston kandidatët dhe angazhon ekspertë për verifikimin e aftësive të tyre, sidomos për të verifikuar nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja.

6. Në zbatim të dispozitave të këtij kreu, Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* miraton rregulla për detajimin e mëtejshëm të kritereve dhe për caktimin e peshës specifike të tyre në renditjen e kandidatëve.

7. Në marrjen e vendimeve për renditjen e kandidatëve, komisioni vepron sipas kritereve të parashikuara në pikat 1 deri në 5, të këtij neni, dhe harton një raport ku arsyeton renditjen e kandidatëve.

Neni 35
Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve

1. Kryetari Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante. Lista me emrat e renditur të kandidatëve dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, si dhe raporti i vlerësimit regjistrohen në regjistrin e protokollit të Kuvendit të Shqipërisë. Asaj i bashkëngjiten kopjet origjinale, ose të noterizuara, të dokumentacionit të çdo kandidati, së bashku me inventarin e dosjes së tij.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga dita e

paraqitjes së listës dhe dokumentacionit shoqërues, të regjistruar sipas pikës 1, të këtij neni, verifikon, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 19 i këtij ligji. Sekretari i Përgjithshëm përjashton kandidatët, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj.

3. Nëse dokumentacioni i kandidatit nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të kritereve profesionale e morale, sipas nenit 19, pika 3, të këtij ligji, Sekretari i Përgjithshëm i kërkon kandidatit që brenda 5 ditëve të bëjë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë i dërgohet kandidatit në adresën elektronike të deklaruar.

4. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor, nuk pezullon procesin e regjistrimit përfundimtar në Kuvend të listës së kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues të saj.

5. Data në të cilën plotësohet dokumentacioni i kërkuar, ose afati i përcaktuar për plotësimin, konsiderohet dhe dita e paraqitjes dhe regjistrimit të listës së kandidatëve të dhe dokumentacionit shoqërues në Kuvend. Paraqitja përfundimtare dokumentohet me një numër regjistrimi nga zyra e protokollit në Kuvend.

6. Sekretari i Përgjithshëm vlerëson kriteret profesionale e morale vetëm për kandidatët të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Vlerësimi i kritereve profesionale e morale të kandidatëve nga Sekretari i Përgjithshëm bëhet sipas kritereve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji.

7. Sekretari i Përgjithshëm, në përfundim të procedurës së parashikuar në pikat 2 dhe 6, të këtij neni, harton dokumentet e mëposhtme:

a) një listë me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

b) një listë me emrat e kandidatëve, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Lista e kandidatëve të përjashtuar përmban emrat e tyre dhe arsyet e përjashtimit për secilin;

c) një raport me shkrim, ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kritereve profesionale e morale nga secili kandidat, mbështetur në procesin e zhvilluar dhe raportin e përgatitur nga Komisioni i Pavarur *Ad Hoc*.

8. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, në mënyrë individuale dhe të arsyetuar për përjashtimin në adresën e tyre elektronike të deklaruar.

9. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, brenda ditës së nesërme nga dita e hartimit të dokumenteve të parashikuara në pikën 7, të këtij neni, listat, së bashku me raportin e parashikuar në pikën 7, shkronja "c", të këtij neni, si dhe dokumentacionin për secilin kandidat. Listat dhe raporti bëhen publikë në faqen zyrtare të Kuvendit jo më vonë se 10 ditë pas regjistrimit të listës së kandidatëve në Kuvend.

10. Në zbatimin e detyrave të parashikuara në pikat 1 deri në 6, të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet nga shërbimet e Kuvendit.

11. Jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës nga Sekretari i Përgjithshëm, komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision me 5 deputetë, prej të cilëve 3 caktohen nga radhët e shumicës parlamentare dhe 2 nga radhët e pakicës parlamentare, për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve. Vendimi për krijimin e nënkomisionit cakton kryetarin e nënkomisionit nga radhët e anëtarëve që përfaqësojnë shumicën parlamentare dhe nënkryetarin e nënkomisionit nga radhët e anëtarëve që përfaqësojnë pakicën parlamentare. Në rastet kur njëra nga palët nuk cakton përfaqësuesit e saj në nënkomision, komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore krijon nënkomisionin me deputetë nga grupet e tjera parlamentare, duke ruajtur raportet ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare. Në rast se nuk është i mundur përsëri krijimi i nënkomisionit, atëherë krijohet nënkomisioni vetëm me përfaqësuesit e shumicës parlamentare, por në çdo rast me jo më pak se 3 deputetë.

12. Kryetari i nënkomisionit thërret mbledhjen e nënkomisionit ditën e nesërme të punës pas ditës së krijimit të tij. Pjesëmarrja në mbledhjet e nënkomisionit është e detyrueshme. Mbledhjet zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Në qoftë se një ose disa anëtarë të nënkomisionit nuk marrin pjesë në mbledhje, nënkomisioni i vazhdon punimet me anëtarët që janë të pranishëm. Në këtë rast, nënkomisioni zgjedh anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor me short nga lista e parashikuar në pikën 7, shkronja "a", të këtij neni.

13. Nënkomisioni, me të paktën 4 vota, mund të vendosë që kandidatët e përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm të përfshihen në listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, nënkomisioni bën publik në faqen zyrtare të Kuvendit arsyetimin e këtij vendimi. Nënkomisioni bashkon në një listë të vetme listën e kandidatëve që përmbushin kriteret të përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm dhe kandidatin ose kandidatët e përfshirë nga nënkomisioni, sipas kësaj pike, në qoftë se ka të tillë. Lista e përftuar në këtë mënyrë konsiderohet lista e kandidatëve për votim.

14. Në përfundim të procedurës së parashikuar në pikën 13, të këtij neni, nënkomisioni përzgjedh kandidatin për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor përmes një proçedure votimi të hapur ku votohet me radhë për të gjithë kandidatët sipas rendit alfabetik. Konsiderohen të miratuar ata kandidatë që marrin të paktën 4 vota të anëtarëve të nënkomisionit. Në rast se në përfundim të procesit të votimit, asnjë nga kandidatët nuk ka marrë minimumin e 4 votave, kandidati zgjidhet me short. Në short përfshihen ata kandidatë të cilët janë pjesë e listës për votim sipas parashikimeve të pikës 13 të këtij neni. Në rast se asnjë vendim nuk është marrë sipas parashikimeve të pikës 13, në short përfshihen ata kandidatë të cilët janë pjesë e listës të parashikuar në pikën 7, shkronja "a", të këtij neni.

15. Jo më vonë se 3 ditë nga krijimi i tij, nënkomisioni përmbledh në një listë 2 kandidatët e përzgjedhur nga avokatia, 2 kandidatët nga radhët e pedagogëve dhe kandidatin nga shoqëria civile dhe ia dërgon atë Kryetarit të Kuvendit përmes kryetarit të nënkomisionit. Lista e kandidatëve shoqërohet me një raport mbi rezultatin e vlerësimit të kritereve profesionale e morale të kryer nga nënkomisioni.

16. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me dy të tretat e të gjithë anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, nënkomisioni miraton një listë të re, sipas procedurës së parashikuar në pikat 12, 13 dhe 14, të këtij neni, brenda 2 ditëve nga votimi në seancë plenare. Kandidatët e listës së parë nuk përjashtohen nga procesi i përzgjedhjes në nënkomision në raundin e dytë. Lista e re i paraqitet Kryetarit të Kuvendit dhe hidhet në votim në seancën më të afërt të Kuvendit, por jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e listës. Kuvendi miraton listën e kandidatëve me dy të tretat e të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej dy të tretave edhe në votimin e dytë, nënkomisioni miraton një listë të re, sipas procedurës së parashikuar në pikat 12, 13 dhe 14, të këtij neni, brenda 2 ditëve nga votimi i fundit në seancë plenare. Kandidatët e listës së dytë

nuk përjashtohen nga procesi i përzgjedhjes në nënkomision në raundin e tretë. Lista e re i paraqitet Kryetarit të Kuvendit dhe hidhet në votim në seancën më të afërt të Kuvendit por jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e listës. Kuvendi miraton listën e kandidatëve me dy të tretat e të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej dy të tretave edhe në votimin e tretë, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur.

17. Vendimi i Kuvendit për miratimin e listës së kandidatëve botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

18. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga avokatia, Kuvendi zgjedh menjëherë një anëtar të ri nga lista e kandidatëve për votim, sipas pikës 13 të këtij neni. Në këtë rast zbatohen procedurat dhe afatet e parashikuara në pikën 14, të këtij neni, pasi verifikohet gatishmëria e kandidatëve për të shërbyer në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

19. Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend miraton një rregullore për organizimin dhe funksionimin e nënkomisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor e cila përmban rregulla për mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të nënkomisionit, metodën e votimit në nënkomision, shortin, verifikimin e gatishmërisë së kandidatëve, sipas pikës 15 të këtij neni.

NËNSEKSIONI III
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Neni 36
Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës

1. Kuvendi zgjedh 2 anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

2. Kandidatët e propozuar, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale si jurist;

c) në kohën e kandidimit, të jenë pedagogë me kohë të plotë jo më pak se 5 vjet në fakultetin e drejtësisë të një institucioni të arsimit të lartë (IAL) ose pedagogë të brendshëm ose të jashtëm jomagjistratë në Shkollën e Magjistraturës;

ç) të jenë personel akademik të kategorisë "profesor" ose "lektor";

d) në kohën e kandidimit të mos jenë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës

dh) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

e) të mos kenë qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ë) të mos kenë mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;

f) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

g) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve inteligjente;

gj) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

3. Secili prej institucioneve të arsimit të lartë që kanë në përbërje të tyre si njësi kryesore fakultete të drejtësisë, të akredituar sipas rregullave të legjislacionit në fuqi, përzgjedh jo më shumë se 3 kandidatë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë, me kushtin që të mos jenë propozuar nga radhët e avokatëve ose nga radhët e organizatave të shoqërisë civile.

4. Shkolla e Magjistraturës përzgjedh jo më shumë se një kandidat nga radhët e pedagogëve me kohë të plotë, jomagjistrat në detyrë, dhe pedagogëve me kohë të pjesshme me kushtin që të mos jenë magjistratë në detyrë, avokatë ose të punësuar me kohë të plotë në organizatat e shoqërisë civile.

5. Secili prej anëtarëve të personelit akademik të IAL-ve që plotëson kushtet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 3 pedagogëve nga personeli akademik me të drejtë vote, ka të drejtë të kandidojë.

6. Secili prej pedadogëve të Shkollës së Magjistraturës, që plotëson kushtet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 3 pedagogëve me të drejtë vote, ka të drejtë të kandidojë.

7. Rektori i IAL-it dhe Drejtori i Shkollës së Magjistraturës miratojnë formularët tip për dhënien e mbështetjes kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Formulari tip nënshkruhet nga anëtari i personelit akademik ose pedagogu i Shkollës së Magjistraturës me të drejtë vote që vendos të mbështesë kandidatin. Anëtari i personelit akademik ose pedagogu i Shkollës së Magjistraturës me të drejtë vote mund të mbështesë vetëm një kandidat.

8. Të gjithë anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë, përfshirë edhe personelin e kategorisë "asistent lektor", dhe të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesshme që nuk janë magjistratë në detyrë të Shkollës së Magjistraturës kanë të drejtë të mbështesin kandidatë dhe të votojnë për përzgjedhjen e kandidatëve nga institucionet përkatëse.

Neni 37
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall vendet vakante në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme.

2. Jo më vonë se 7 ditë nga shpallja e vendeve vakante, rektori i institucionit të arsimit të lartë që ka fakultet drejtësie dhe Drejtori i Shkollës së Magjistraturës shpallin thirrjet për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga anëtarët e personelit akademik dhe nga pedagogët e Shkollës së Magjistraturës që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 36, pika 2, të këtij ligji.

3. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të IAL-it, të fakulteteve të drejtësisë, të Shkollës së Magjistraturës dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve të personelit akademik dhe secilit prej pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës në adresën elektronike.

4. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën

postare dhe elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet që duhet të shoqërojnë atë.

5. Mosshpallja e thirrjes në afatin ligjor përbën shkelje disiplinore për rektorin e IAL-it dhe Drejtorin e Shkollës së Magjistraturës.

Neni 38
Shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga Ministri i Drejtësisë

1. Në qoftë se, në përfundim të afatit të përmendur në pikën 2, të nenit 37, të këtij ligji, rektori i IAL-it, në përbërjen e të cilit ka fakultet drejtësie, ose Drejtori i Shkollës së Magjistraturës nuk kanë shpallur thirrjen për paraqitjen e shprehjes të interesit, shpallja bëhet menjëherë nga Ministri i Drejtësisë.

2. Në këtë rast shpallja bëhet përmes njoftimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe i dërgohet në adresën elektronike secilit anëtar të personelit akademik të fakultetit të drejtësisë të IAL-it dhe secilit pedagog të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 39
Paraqitja dhe trajtimi i shprehjes së interesit

1. Brenda 15 ditëve nga shpallja e thirrjes për pranimin e shprehjeve të interesit, pedagogët e interesuar shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar, sipas rastit, dekanit të fakultetit ose Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës. Një kopje e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues, i dërgohet, sipas rastit, rektorit të IAL-it dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike ose postare të përmendur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit me letër të porositur ose në adresën elektronike zyrtare, sipas rastit, të dekanit të fakultetit, ose të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

ç) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë";

d) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimit sekret.

dh) çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore, të parashikuara në nenin 36 të këtij ligji.

Neni 40
Verifikimi i plotësimit të kritereve ligjore

1. Brenda 7 ditëve nga dita kur mbyllet afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit, dekanati i fakultetit të drejtësisë mblidhet në një mbledhje të posaçme për të verifikuar plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët.

2. Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore dhe i mbështetjes është çështja e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së dekanatit.

3. Mbledhja e dekanatit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve. Mosmarrja pjesë pa shkak të arsyeshëm në mbledhjen e dekanatit për verifikimin e kritereve ligjore dhe të mbështetjes për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor përbën shkelje disiplinore për anëtarët e dekanatit.

4. Mbledhja e dekanatit merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

5. Anëtarët e dekanatit, të cilët kandidojnë, nuk marrin pjesë në mbledhje dhe nuk votojnë. Në rastin e kandidimit të dekanit, detyrat e tij kryhen prej një nga zëvëndesdekanët.

6. Në përfundim të mbledhjes dekani shpall zyrtarisht kandidaturat përmes afishimit në këndin e njoftimeve të universitetit ose të fakultetit të drejtësisë ose në një vend tjetër të dukshëm dhe i përcjell rektorit të IAL-it listën e kandidatëve të shoqëruar me një raport që shpjegon plotësimin ose mosplotësimin e kushteve nga secili kandidat.

7. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, në mënyrë individuale dhe të arsyetuar për shkaqet e skualifikimit.

8. Rregullat e parashikuara në pikat 1 deri në 7, të këtij neni, zbatohen edhe për verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore nga kandidatët e Shkollës

së Magjistraturës. Në këtë rast, përgjegjësitë e parashikuara nga ky nen për dekanatin e fakultetit ushtrohen nga mbledhja e Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës. Përgjegjësitë e parashikuara në pikën 6, të këtij neni, për dekanin e fakultetit ushtrohen nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës. Lista me kandidatët i përcillet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 41
Ankimet kundër vendimeve të përjashtimit

1. Ankimet kundër vendimeve të dekanatit ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës për përjashtimin e kandidatëve për shkelje të rënda procedurale bëhen përkatësisht pranë rektorit të IAL-it dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit.

2. Rektori i IAL-it dhe Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës vendosin brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit.

Neni 42
Përzgjedhja e kandidatëve nga fakultetet e drejtësisë dhe nga Shkolla e Magjistraturës

1. Jo më vonë se 80 ditë para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, dekani i secilit fakultet thërret mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik për të përzgjedhur kandidatin e atij fakulteti. Dekani i fakultetit të drejtësisë njofton menjëherë dhe zyrtarisht rektorin e IAL-it për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik.

2. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik të fakultetit për përzgjedhjen e kandidatit bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të IAL-it, si dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve të personelit akademik në adresën elektronike.

3. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik të fakultetit për përzgjedhjen e kandidatit tregon datën, vendin dhe orën e mbledhjes.

4. Përzgjedhja e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor është pika e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik.

5. Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

6. Mosthirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik në afatin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, përbën shkelje disiplinore për dekanin e fakultetit.

7. Rregullat e parashikuara në pikat 1 deri në 6, të këtij neni, për përzgjedhjen e kandidatëve nga fakultetet ose departamentet e drejtësisë zbatohen edhe për përzgjedhjen e kandidatëve nga Shkolla e Magjistraturës. Në këtë rast, përgjegjësitë e parashikuara nga ky nen për dekanin e fakultetit ushtrohen nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës. Përgjegjësitë e parashikuara nga ky nen për Asamblenë e Personelit Akademik ushtrohen nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës.

Neni 43
Kuorumi

1. Pjesëmarrja në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor është e detyrueshme.

2. Mbledhja e Asamblesë së Personelit Akademik ose e Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës për përzgjedhjen e kandidatëve zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

3. Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

Neni 44
Procesi i votimit

1. Votimi për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Asambleja e Personelit Akademik të fakultetit është i fshehtë dhe individual.

2. Procesi i votimit është i hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interesim për të ndjekur procesin. Vëzhguesit autorizohen paraprakisht nga rektori i IAL-it.

3. Për administrimin e procesit të votimit krijohet një komision votimi i përbërë nga anëtarë të personelit akademik që nuk kandidojnë. Komisioni i votimit ndihmohet në ushtrimin e funksioneve të tij nga administrata e fakultetit.

4. Ministri i Drejtësisë, 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore, njëri prej të cilëve i përket opozitës, rektori i IAL-it

ose persona të autorizuar prej tyre, mund të marrin pjesë si vëzhgues në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit në nivel fakulteti pa autorizim paraprak.

5. Jo më vonë se 2 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik, rektori i IAL-it miraton fletën tip të votimit, e cila përmban emrat e kandidatëve të regjistruar.

6. Përpara fillimit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit shumëfishojnë dhe nënshkruajnë paraprakisht një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e anëtarëve të asamblesë së personelit akademik që janë të pranishëm. Në rast të dëmtimit të një ose disa fletëve të votimit, komisioni nënshkruan një numër fletësh votimi të barabartë me fletët e dëmtuara dhe shkatërron në praninë e pjesëmarrësve fletët e dëmtuara.

7. Secili prej anëtarëve të Asamblesë së Personelit Akademik tërheq një fletë votimi, e plotëson atë në dhomën e fshehtë të votimit dhe e hedh në kutinë e votimit. Vota quhet e vlefshme kur ajo shpreh qartë vullnetin për të mbështetur vetëm 1 kandidat.

8. Rregullat e parashikuara në pikat 1 deri në 7, të këtij neni, për procesin e votimit nga Asambleja e Personelit Akademik të fakultetit zbatohen edhe për procesin e votimit nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës. Në këtë rast, përgjegjësitë e parashikuara nga pikat 2 dhe 5, të këtij neni, për rektorin e IAL-it ushtrohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues. Në rastin e zgjedhjeve në Shkollën e Magjistraturës krijohet një komision votimi, i cili zgjidhet me short nga anëtarët e Këshillit Pedagogjik. Komisioni i votimit ndihmohet në ushtrimin e funksioneve të tij nga administrata e Shkollës së Magjistraturës. Në rast pamundësie, anëtarët e komisionit të votimit zëvendësohen nga anëtarë të tjerë të Këshillit Pedagogjik të zgjedhur me short.

9. Ministri i Drejtësisë ose persona të autorizuar prej tij, 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore, njëri prej të cilëve i përket opozitës, mund të marrin pjesë si vëzhgues në mbledhjen e Këshillit Pedagogjik për përzgjedhjen e kandidatit të Shkollës së Magjistraturës pa autorizim paraprak të kryetarit të këshillit.

Neni 45
Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit

1. Në përfundim të procesit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit hapin kutinë në prani të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik që marrin pjesë në mbledhje. Njëri nga anëtarët e komisionit të votimit lexon me zë të lartë rezultatin e

secilës fletë votimi dhe rezultatin e votimit.

2. Votat që gjykohen të pavlefshme rivlerësohen në fund të procesit të numërimit. Në rast mosmarrëveshjeje mes anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave, vendimet merren në fund të procesit të rivlerësimit me shumicën e votave. Votat që gjykohen të vlefshme në fund të procesit të rivlerësimit u shtohen kandidatëve përkatës.

3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit;

b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;

c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;

ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;

d) nuk është e qartë se për për cilin kandidat është votuar;

dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

4. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave, anëtarët e komisionit të votimit hartojnë një procesverbal, i cili tregon numrin pjesëmarrësve, të votave të hedhura, numrin e votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve të përzgjedhur. Rastet e mosmarrëveshjeve për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

5. Në përfundim të procesit të votimit quhen të përzgjedhur kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në qoftë se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash, fituesi përcaktohet me short midis tyre.

6. Procesverbali origjinal, që tregon numrin e pjesëmarrësve në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, numrin e votave dhe rezultatin e numërimit të votave, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të votimit, i dërgohet menjëherë, sipas rastit, rektorit të IAL-it ose Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

7. Vendimet me rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve, çdo

vendim i ndërmjetëm dhe procesverbali nënshkruhen nga anëtarët e komisionit të votimit. Vendimet njoftohen publikisht në përfundim të mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 46
Ankimet kundër vendimeve të Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik

1. Ankimet për shkelje procedurale që lidhen me thirrjen e mbledhjes, verifikimin e pjesëmarrjes, të votimit, numërimit të votave, të konstatimit dhe shpalljes e pavlefshmërisë dhe shpalljen e rezultatit gjatë mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik për IAL-et ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës bëhen pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Gjykata mund të vendosë përsëritjen e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik dhe të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës vetëm në qoftë se shkeljet procedurale, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vërtetohen se janë të tilla që kanë ndikuar ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Në rast se Gjykata Administrative e Apelit vendos përsëritjen e zgjedhjeve, ato zhvillohen jo më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Neni 47
Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik nga rektori i IAL-it

1. Në qoftë së në përfundim të afatit të përmendur në nenin 42, pika 1, të këtij ligji, dekani i fakultetit të drejtësisë nuk ka thirrur mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, thirrja e mbledhjes bëhet nga rektori i IAL-it.

2. Në këtë rast, thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik për përzgjedhjen e kandidatit bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të IAL-it, si dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve të personelit akademik në adresën elektronike.

3. Mosthirrja e mbledhjes përbën shkelje disiplinore për dekanin e fakultetit të drejtësisë.

Neni 48
Thirrja e mbledhjes së posaçme të drejtuesve të institucioneve për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve

1. Jo më vonë së 60 ditë para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit thërret një mbledhje të posaçme, në të cilën marrin pjesë Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, rektorët e IAL-ve që ofrojnë programe studimi në drejtësi dhe dekanët e fakulteteve të drejtësisë. Thirrja botohet në faqen zyrtare të Kuvendit dhe u dërgohet personalisht në adresën elektronike të gjithë subjekteve të sipërpërmendura.

2. Thirrja e mbledhjes së posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve tregon datën, vendin dhe orën e mbledhjes.

3. Zgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor është pika e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së posaçme.

4. Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e posaçme shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

5. Përpara votimit, kandidatët e përzgjedhur nga IAL-et dhe kandidatët e përzgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës paraqesin platformat e tyre përpara mbledhjes së posaçme.

6. Mbledhja e posaçme e drejtuesve të institucioneve kryen procedurë të përbashkët për të dy kategoritë e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rast të krijimit të vendeve vakante për Këshillat në të njëjtën kohë.

Neni 49
Kuorumi

1. Pjesëmarrja në mbledhjen e posaçme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor është e detyrueshme.

2. Mbledhja e posaçme për zgjedhjen e kandidatëve zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

3. Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e posaçme shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

Neni 50
Procesi i votimit

1. Votimi për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë

Gjyqësor nga mbledhja e posaçme është i fshehtë dhe individual.

2. Mbledhja e posaçme voton për të gjithë kandidatët e përzgjedhur paraprakisht nga IAL-et dhe Shkolla e Magjistraturës.

3. Përfaqësuesit e IAL-ve publike dhe të Shkollës së Magjistraturës votojnë për kandidatët nga IAL-et publike dhe Shkolla e Magjistraturës. Përfaqësuesit e IAL-ve jopublike votojnë për kandidatët nga IAL-et jopublike.

4. Procesi i votimit është i hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interesim për të ndjekur procesin. Vëzhguesit autorizohen paraprakisht nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

5. Për administrimin e procesit të votimit krijohet një komision votimi, i përbërë nga trupa e pedagogëve të IAL-ve publike, jopublike dhe Shkollës së Magjistraturës që nuk kandidojnë. Komisioni i votimit ndihmohet në punën e tij nga administrata e Kuvendit.

6. Ministri i Drejtësisë ose persona të autorizuar prej tij, 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, mund të marrin pjesë si vëzhgues në procesin e votimit pa autorizim paraprak.

7. Jo më vonë se 2 ditë përpara datës së mbledhjes së posaçme, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit miraton 2 tipa fletësh votimi. Njëra fletë tip përmban emrat e të gjithë kandidatëve të propozuar nga IAL-et publike dhe nga Shkolla e Magjistraturës. Fleta tjetër përmban emrat e të gjithë kandidatëve të propozuar nga IAL-et jopublike.

8. Përpara fillimit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit shumëfishojnë dhe nënshkruajnë paraprakisht një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e anëtarëve të pranishëm. Në rast të dëmtimit të një ose disa fletëve të votimit, komisioni nënshkruan një numër fletësh votimi të barabartë me fletët e dëmtuara dhe shkatërron në praninë e pjesëmarrësve fletët e dëmtuara.

9. Secili prej pjesëmarrësve tërheq një fletë votimi, e plotëson atë në dhomën e fshehtë të votimit dhe e hedh në kutinë e votimit. Vota quhet e vlefshme kur ajo shpreh qartë vullnetin për të mbështetur vetëm 1 kandidat.

Neni 51
Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit

1. Në përfundim të procesit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit

hapin kutinë në prani të të gjithë pjesëmarrësve në mbledhje. Njëri nga anëtarët e komisionit të votimit lexon me zë të lartë rezultatin e secilës fletë votimi dhe rezultatin e votimit.

2. Votat që gjykohen të pavlefshme rivlerësohen nga komisioni i votimit në fund të procesit të numërimit. Në rast mosmarrëveshjeje mes anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave, vendimet merren në fund të procesit të rivlerësimit me shumicën e votave. Votat që gjykohen të vlefshme në fund të procesit të rivlerësimit u shtohen kandidatëve përkatës.

3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit;

b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;

c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;

ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;

d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;

dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

4. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave, anëtarët e komisionit të votimit hartojnë një procesverbal, i cili tregon numrin e votave të hedhura, numrin e votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla, numrin e votave për secilën kategori kandidatësh, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve të përzgjedhur. Rastet e mosmarrëveshjeve për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

5. Quhen të përzgjedhur 7 kandidatët nga IAL-et publike ose Shkolla e Magjistraturës dhe 3 kandidatët nga IAL-et jopublike që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në qoftë se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash, fituesi përcaktohet me short midis tyre. Në qoftë se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm nga IAL-et jopublike për të plotësuar kuotat e parashikuara në këtë pikë, vendet e mbetura bosh plotësohen nga kandidatët e IAL-ve publike.

6. Vendimi për shpalljen e kandidaturave shpallet në faqen zyrtare të Kuvendit.

7. Procesverbali origjinal, që tregon numrin e pjesëmarrësve në mbledhjen e posaçme të rektorëve dhe dekanëve dhe rezultatin e numërimit të votave, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të votimit, i përcillet zyrtarisht Kuvendit.

8. Krahas listës me emrat e kandidatëve të përzgjedhur, mbledhja e posaçme harton një raport të vlerësimit të shkallës së përmbushjes së kritereve etike e profesionale të kandidatëve. Vlerësimi i kritereve etike dhe profesionale të kandidatëve bëhet duke zbatuar, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, kërkesat e nenit 34 të këtij ligji.

Neni 52
Ankimet kundër vendimeve të mbledhjes së posaçme

1. Ankimet për shkelje të procedurës që lidhen me thirrjen e mbledhjes, verifikimin e pjesëmarrjes, të votimit dhe numërimit të votave, të konstatimit dhe shpalljes së votave të pavlefshme dhe të shpalljes së rezultatit gjatë mbledhjes së posaçme bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Kuvendit.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Gjykata mund të vendosë përsëritjen e mbledhjes së posaçme vetëm në qoftë se shkeljet procedurale, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vërtetohen dhe janë të tilla që kanë ndikuar ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Në rast se Gjykata Administrative e Apelit vendos përsëritjen e zgjedhjeve, ato zhvillohen jo më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Neni 53
Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës

1. Kandidatët e përzgjedhur nga mbledhja e posaçme, sipas parashikimeve të nenit 48 dhe raporti i vlerësimit, sipas nenit 51, pika 8, të këtij ligji, i përcillen Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit në një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante. Lista dhe raporti i vlerësimit regjistrohen në regjistrin e protokollit të Kuvendit të Shqipërisë. Asaj i bashkëngjiten kopjet

origjinale, ose të noterizuara, të dokumentacionit të çdo kandidati, së bashku me inventarin e dosjes së tij.

2. Rregullat e parashikuara në nenin 35, nga pika 2 deri në pikën 19, të këtij ligji, zbatohen edhe për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë gjyqësor nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës.

NËNSEKSIONI IV
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR QË PËRFAQËSON SHOQËRINE CIVILE

Neni 54
Zgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor që përfaqëson shoqërinë civile dhe kushtet për t'u zgjedhur

1. Kuvendi zgjedh 1 anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, të regjistruara sipas legjislacionit përkatës, të cilët punojnë në fushën e sistemit të drejtësisë ose të të drejtave të njeriut dhe që kanë zbatuar projekte në këtë fushë të paktën 5 vitet e fundit.

2. Kandidatët nga shoqëria civile duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave", ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të kenë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) ë kenë të paktën 15 vite përvojë pune në profesion si jurist;

ç) të kenë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut;

d) në kohën e kandidimit, të jenë të punësuar ose të angazhuar për të paktën 5 vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme pa ndërprerje, në një organizatë të shoqërisë civile për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut;

dh) në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit për të paktën 2 vjet, me përjashtim të atyre të angazhuar në organizata ose klinika që ofrojnë ndihmën ligjore falas ose për funksion të organizatës;

e) të mos jenë kandidatë të propozuar nga avokatia ose trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë;

ë) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike, gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit;

g) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë";

gj) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;

h) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

3. Përfaqësuesit nga radhët e organizatave të shoqërisë civile japin dorëheqjen nga çdo pozicion drejtues ose zbatues në këto organizata, nëse zgjidhen anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Ka të drejtë të kandidojë, çdo anëtar i organizatës së shoqërisë civile që plotëson kushtet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 3 organizatave të shoqërisë civile, që punojnë në fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit miraton formularin tip për dhënien e mbështetjes kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga shoqëria civile. Formulari tip nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i secilës prej organizatave të shoqërisë civile, të cilat vendosin të mbështesin një koleg.

Neni 55
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarit nga shoqëria civile në Këshillin e Lartë Gjyqësor në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga kandidatët e shoqërisë civile që janë të interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit.

2. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Kuvendit.

3. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare dhe elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet që duhet të shoqërojnë atë.

Neni 56
Paraqitja dhe shqyrtimi i shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për pranimin e shprehjeve të interesit, anëtarët e shoqërisë civile shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar Avokatit të Popullit.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike ose postare të shprehur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin, të paktën, dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

ç) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

d) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;

dh) çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 54, pika 2, të këtij ligji.

4. Emrat e kandidatëve nga shoqëria civile dhe kopjet origjinale, ose të noterizuara, të dokumentacionit të paraqitur prej tyre, regjistrohen në regjistrin e protokollit të Avokatit të Popullit.

5. Zyra e protokollit të Avokatit të Popullit merr në dorëzim shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatëve dhe u jep atyre një vërtetim shkresor për dorëzimin e shprehjes së interesit dhe të dokumentacionit shoqërues.

6. Avokati i Popullit, brenda 5 ditëve nga regjistrimi i kandidatëve dhe i dokumentacionit shoqërues, verifikon nëse dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët është i plotë. Nëse dokumentacioni i kandidatit nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të kritereve profesionale e morale, sipas nenit 54, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, Avokati i Popullit i kërkon kandidatit që brenda 5 ditëve të bëjë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë i dërgohet kandidatit në adresën elektronike të deklaruar, brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit nga Avokati i Popullit.

7. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues, ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor, nuk pezullon procesin e regjistrimit përfundimtar të kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues të tyre. Në këtë rast, vlerësimi i kandidatit bëhet mbi dokumentacionin e dosjes së depozituar dhe administruar nga Avokati i Popullit.

8. Data në të cilën plotësohet dokumentacioni i kërkuar, ose afati i përcaktuar për plotësimin, konsiderohet dita e paraqitjes dhe regjistrimit të kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues në Institucionin e Avokatit të Popullit. Paraqitja përfundimtare dokumentohet me një numër regjistrimi nga zyra e protokollit tek Avokati i Popullit.

9. Avokati i Popullit, jo më vonë se 10 ditë nga dita e regjistrimit të kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues, sipas pikës 5, të këtij neni, merr në shqyrtim dhe verifikon përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të çdo kandidature të parashikuara në Kushtetutë dhe në nenin 54, të këtij ligji, me anë të një procesi të hapur edhe publik.

10. Brenda 3 ditëve, nga dita e shpalljes së njoftimit për dorëzimin e shprehjeve të interesit për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga shoqëria civile, Avokati i Popullit publikon thirrjen për shprehje interesi

për anëtar të komisionit të shoqërisë civile për verifikimin paraprak nga organizatat e shoqërisë civile, sipas përcaktimit të nenit 54, pika 1, të këtij ligji. Thirrja publikohet në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit, si dhe në një nga gazetat me tirazhin më të lartë. Njoftimi u dërgohet të gjitha organizatave të shoqërisë civile në adresat e elektronike të tyre zyrtare. Shprehja e interesit duhet të paraqitet nga organizatat e shoqërisë civile brenda 7 ditëve dhe duhet të përmbajë dokumentacionin përkatës që vërteton plotësimin e kritereve që parashikohen në nenin 54, pika 1, e këtij ligji, dhe ato të parashikuara në këtë pikë.

11. Avokati i Popullit verifikon brenda 10 ditëve plotësimin e kritereve nga organizatat që kanë shprehur interesin për të qenë pjesë e komisionit të verifikimit paraprak të shoqërisë civile. Në rast se më shumë se 5 organizata që kanë shprehur interesin plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 10 të këtij neni, mbledhja e parë e këtij komisioni përzgjedh me votim të fshehtë organizatat që do të jenë anëtare të këtij komisioni. Pesë organizatat që do të marrin më shumë vota, konsiderohen të përzgjedhura si anëtare të komisionit të shoqërisë civile. Në rast të barazimit të votave, votimi përsëritet midis organizatave me vota të njëjta.

12. Kryetari i komisionit të shoqërisë civile për verifikimin paraprak zgjidhet nga vetë komisioni. Organizata e shoqërisë civile përfaqësohet nga përfaqësuesi i saj ligjor. Anëtari zëvendësues i këtij komisioni është zëvendësi i tij me autorizim nga përfaqësuesi ligjor.

13. Mosushtrimi i kompetencave, sipas këtij ligji, nga Avokati i Popullit brenda afateve të përcaktuara, përbën shkelje disiplinore dhe në çdo rast është Kryetari i Këshillit të Emërimeve të Drejtësisë, që ushtron kompetencat e parashikuara në këtë nen brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar për Avokatin e Popullit në këtë ligj.

14. Në rastet e konfliktit të interesit, papajtueshmërisë ose heqjes dorë të anëtarit të komisionit, rregullimet ligjore të parashikuara në nenet 28 dhe 29, të këtij ligji, do të aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

15. Komisioni i shoqërisë civile kryen procedurë të përbashkët për verifikimin paraprak të dy kategorive të kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rast të krijimit të vendeve vakante për Këshillat në të njëjtën kohë.

Neni 57
Verifikimi paraprak i plotësimit të kushteve ligjore nga komisioni i shoqërisë civile pranë Avokatit të Popullit

1. Komisioni i shoqërisë civile për verifikimin paraprak verifikon nëse

kandidatët e shoqërisë civile për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor i plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, sipas parashikimeve ligjore të nenit 54 të këtij ligji.

2. Me përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak, komisioni i shoqërisë civile bën menjëherë publike emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit dhe atë të Kuvendit. Komisioni i shoqërisë civile u komunikon individualisht kandidatëve, rezultatin e verifikimit të plotësimit ose jo të kushteve ligjore, si dhe shkaqet e përjashtimit të tyre.

3. Ankimet kundër vendimit për përjashtimin e kandidatëve vetëm për shkelje të rënda proeduriale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kontestuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga komisioni i shoqërisë civile, sipas këtij neni.

4. Komisioni i shoqërisë civile bën verifikimin paraprak të kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve dhe i rendit në listë, sipas parashikimeve të nenit 34, të këtij ligji. Komisioni i shoqërisë civile organizon seancë publike me secilin kandidat që plotëson kriteret formale ligjore. Kandidatët nëpërmjet seancës publike shpalosin platformën e tyre. Procesi i dëgjesave publike është i hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interes për të ndjekur procesin.

5. Anëtarët e komisionit të shoqërisë civile votojnë në mënyrë individuale dhe të fshehtë për mënyrën e renditjes së kandidatëve.

6. Komisioni i shoqërisë civile e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

Neni 58
Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile

1. Kryetari komisionit të shoqërisë civile i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit një listë me emrat e jo më shumë se 10 kandidatëve që kanë marrë më shumë pikë, por në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante. Lista dhe raporti i vlerësimit regjistrohen në regjistrin e protokollit të Kuvendit. Listës i bashkëngjitet një kopje origjinale, ose e

noterizuar, e dokumentacionit të çdo kandidati të përzgjedhur, së bashku me inventarin e dosjes së tij.

2. Rregullat e parashikuara në nenin 35, të këtij ligji, nga pika 2 deri në pikën 19, zbatohet edhe për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile.

KREU II
ORGANIZIMI DHE MBLEDHJA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

SEKSIONI 1
ORGANIZIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Neni 59
Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhen në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve. Ata qëndrojnë në detyrë deri në përfundim të mandatit si anëtarë të Këshillit.

2. Kryetari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

3. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) është përgjegjës për mirëfunksionimin e Këshillit dhe zbatimin me efiçencë të detyrave të tij, në përputhje me ligjin;

b) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjen e Këshillit;

c) mbikëqyr dhe drejton administratën e Këshillit;

ç) përfaqëson Këshillin në marrëdhëniet me të tretët;

d) siguron bashkëpunimin me institucionet e tjera;

dh) raporton para Kuvendit për gjendjen në sistemin gjyqësor dhe merr masat për publikimin e raportit;

e) propozon kryetarët e komisioneve të përhershme dhe cakton kryetarët e komisioneve të përkohshme të Këshillit;

ë) ushtron çdo detyrë tjetër që i jepet me ligj.

Neni 60
Zëvendëskryetari

Zëvendëskryetari ushtron të gjitha kompetencat e Kryetarit në mungesë dhe në pamundësi të këtij të fundit, si dhe në rastet e pamundësisë së përkohshme të Kryetarit.

Neni 61
Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor
(*Shfuqizuar me Vendimin e GJK nr. 41/ 2017; Ndryshuar me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;

b) vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;

d) drejton dhe kujdeset për veprimtarinë në administratën e gjykatave;

dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe atë të gjykatave;

e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;

ë) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me ndikim të përgjithshëm detyrues për të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, personat privatë dhe organet publike;

f) miraton aktet për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit;

g) miraton Kodin e Etikës së Këshillit;

gj) shqyrton, sipas rastit, vendimet e komisioneve;

h) miraton udhëzime jodetyruese;

i) miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e administratës së Këshillit;

j) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për funksionimin e tyre.

3. Në mbledhjen plenare marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose komisionit, për çështje të mëposhtme të rendit të ditës:

a) në rast vendimi për çështje disiplinore, kur anëtari ka paraqitur tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor;

b) nëse si anëtar i komisionit ka marrë vendim për një çështje disiplinore, të parashikuar në pikën 13, të nenit 62, të këtij ligji.

4. Komisionet kryejnë veprimtari të tjera në përputhje me rregulloren e brendshme.".

Neni 62
Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë veprimtarinë dhe marrin vendime në fushat e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të kësaj të fundit, sipas nenit 61 të këtij ligji.

2. Pasi zgjedh Kryetarin, Këshilli merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues. Në çdo rast një anëtar gjyqtar mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar gjyqtar. Një anëtar jogjyqtar mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar jogjyqtar. Procedura dhe kritere më të hollësishme për marrjen e këtij vendimi rregullohen nga Këshilli.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në përbërje komisionet e përhershme si më poshtë:

a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;

b) Komisioni Disiplinor;

c) Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale;

ç) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

4. Çdo Komision përbëhet nga tre anëtarë. Pranë çdo komisioni caktohen edhe 2 anëtarë zëvendësues. Caktimi i anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të komisioneve bëhet duke mbajtur parasysh nevojën për të garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës dhe respektimin

e kërkesave dhe të raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë, të parashikuara në pikat 5 deri në 12, të këtij neni, dhe, për aq sa është e mundur, preferencat e anëtarëve.

5. Një anëtar i Këshillit mund të jetë anëtar në jo më shumë se 2 komisione të përhershme. Një anëtar i Këshillit nuk mund të jetë kryetar në më shumë së 1 komision të përhershëm. Ky rregull nuk zbatohet për anëtarët zëvendësues dhe për komisionet *ad hoc.*

6. Komisionet zgjedhin kryetarët përkatës në mbledhjen e tyre të parë me shumicë votash dhe bazuar në propozimin e Kryetarit të Këshillit. Kryetari i Këshillit është kryetar i komisioneve ku ai merr pjesë.

7. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

8. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit përbëhet nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar.

9. Komisioni Disiplinor përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.

10. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.

12. Anëtarët e komisioneve i ushtrojnë funksionet e tyre pranë komisioneve për dy vite e gjysmë nga dita e zgjedhjes. Në përfundim të kësaj kohe përbërja e komisioneve ndryshohet sipas procedurës të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

13. Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit. Vendimet e komisionit të përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelohen para mbledhjes plenare të Këshillit.

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të krijojë komisione të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta.

15. Komisionet vendosin me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.

16. Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

Neni 63
Relatori

1. Në të gjitha rastet kur mbledhja plenare ose komisionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor shqyrtojnë dhe miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, njëri nga anëtarët e komisionit shërben si relator.

2. Secili nga anëtarët e komisionit, përfshirë edhe kryetarin e komisionit, mund të jetë relator. Relatori caktohet me short, duke marrë parasysh ngarkesën dhe aftësitë e secilit anëtar sipas procedurës dhe rregullave më të hollësishme të miratuara nga Këshilli. Kyetari i Këshillit nuk mund të jetë relator.

3. Relatori kujdeset për zhvillimin e procedimit administrativ individual dhe sidomos për sa më poshtë:

a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga subjektet e procedurës administrative;

b) përgatitjen e projektaktit administrativ;

c) `koordinimin me kryetarin e komisionit për përgatitjen e mbledhjes së komisionit;

ç) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

d) njoftimet për subjektet e procedimit administrativ.

4. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori ndihmohet nga personeli administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 64
Angazhimi i gjyqtarëve në punët e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të angazhojë si ekspertë për çështje ose fusha të caktuara edhe gjyqtarët në detyrë. Gjyqtarët në detyrë i ofrojnë shërbimet e tyre vullnetarisht dhe pa pagesë.

Neni 65
E drejta për të kërkuar informacion

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor duke i vënë në dispozicion informacione ose dokumente, të cilat i nevojiten Këshillit për ushtrimin e funksioneve të tij.

2. Çdo organ publik, person fizik ose juridik paraqitet ose dërgon përfaqësues në mbledhjet plenare ose të komisioneve të Këshillit për të paraqitur prova dhe dëshmuar në lidhje me çdo çështje që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

SEKSIONI 2
MBLEDHJA PLENARE E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Neni 66
Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mblidhet sa herë është e nevojshme, por jo më pak se 1 herë në muaj.

2. Kryetari i Këshillit vendos për datën dhe orarin e mbledhjeve.

3. Kryetari mund të thërrasë mbledhje të tjera kur ai vlerëson se ato janë të nevojshme për veprimtarinë e Këshillit.

4. Mbledhja e Këshillit mund të thirret edhe me kërkesën e jo më pak se 3 anëtarëve të Këshillit, të cilët përcaktojnë në kërkesë edhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Kryetari vendos datën dhe orarin e mbledhjes jo më vonë se 7 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

5. Kryetari siguron respektimin e procedurave për njoftimin me shkrim të çdo anëtari jo më vonë se 7 ditë përpara çdo mbledhjeje të Këshillit.

6. Njoftimi shoqërohet me rendin e ditës, projektvendimet që propozohet të merren gjatë mbledhjes, së bashku me çdo të dhënë, projektakt, këshillë ligjore, si dhe çdo informacion apo dokument tjetër, i cili do të merret në shqyrtim në mbledhje apo i cili u shërben diskutimeve në mbledhje.

7. Rregullat e parashikuara në pikën 6, të këtij neni, nuk përbëjnë pengesë për të miratuar kërkesa për ndryshimin e përmbajtjes së një projektvendimi që shoqëron rendin e ditës.

8. Çdo vendim i Këshillit, që përbën akt administrativ individual në lidhje

me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, nënshkruhet nga çdo anëtar i pranishëm në mbledhje, siç është rënë dakord. Refuzimi i një anëtari për të nënshkruar përmbajtjen e vendimit nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e aktit. Aktet e tjera nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit.

9. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinioni i tij t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit.

Neni 67
Rendi i ditës

1. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor vendos rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit.

2. Një çështje e caktuar i shtohet rendit të ditës kur kjo i kërkohet me shkrim Kryetarit jo më vonë se 4 ditë përpara mbledhjes nga të paktën 3 anëtarë të Këshillit.

3. Nëse të paktën 6 anëtarë të pranishëm në një mbledhje të Këshillit vendosin se një çështje, e cila nuk ishte përfshirë në rendin e ditës, duhet të diskutohet, si dhe t'i jepet zgjidhje në mbledhje, çështja i shtohet rendit të ditës.

Neni 68
Kuorumi dhe vendimmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor

1. Pjesëmarrja në mbledhjet plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor është e detyrueshme. Në çdo rast, kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor është kur në to marrin pjesë jo më pak se 7 anëtarë.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur.

3. Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhje, nuk mund të heqë dorë nga votimi, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë pengesa ligjore të tilla si konflikti i interesit ose pengesa të tjera në zbatim të këtij ligji, të ligjit për konfliktin e interesave ose të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Administrata mban shënim e regjistron votat e anëtarëve të Këshillit.

5. Kryetari është anëtari i fundit, i cili voton në lidhje me një çështje.

6. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

7. Çdo anëtar i Këshillit mban përgjegjësi për votën dhe ka të drejtë të bëjë një deklarim të shkurtër me gojë ose me shkrim për arsyet e votimit.

Neni 69
Dokumentimi i mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Kryetari është përgjegjës për të siguruar që administrata të marrë të gjitha masat e nevojshme që çdo mbledhje plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes:

a) regjistrimit audio;

b) procesverbalit me përmbledhjen e diskutimeve.

2. Regjistrimi audio i mbledhjes plenare bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes. Përpara publikimit, nën përgjegjësinë e kryetarit, administrata kujdeset për redaktimin e materialit, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

3. Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit pasi miratohet nga mbledhja plenare pasardhëse e Këshillit. Edhe në këtë rast, nën përgjegjësine e kryetarit, administrata kujdeset për të fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

4. Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit, administrata mban procesverbalin me përmbledhjen e diskutimeve të çdo mbledhjeje, duke shënuar të paktën informacionet e mëposhtme:

a) anëtarët e pranishëm në diskutim për çdo çështje të rendit të ditës;

b) çështjet e rendit të ditës, përfshirë çështjet e shtuara sipas nenit 67, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji;

c) dorëheqjet e anëtarëve të Këshillit dhe arsyetimet përkatëse;

ç) aspektet kryesore të çështjeve të diskutuara dhe propozimet për vendime;

d) rezultatin e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar; dhe

dh) vendimet.

5. Procesverbalet me draftin e përmbledhjes së diskutimeve të mbledhjes nënshkruhen nga kryetari dhe u vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve brenda 5 ditëve nga dita e mbledhjes.

6. Çdo anëtar i Këshillit që ishte i pranishëm në mbledhje mund të vërë në dukje pasaktësi në përmbajtjen e procesverbalit të përmbledhur dhe t'i kërkojë kryetarit, me anë të një kërkese me shkrim, korrigjimin e tij. Në qoftë se regjistrimi konfirmon pasaktësinë e zbardhjes, përmbledhja e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit korrigjohet në mënyrat e mëposhtme:

a) me urdhër të kryetarit, bazuar në kërkesën e paraqitur, sipas pikës 6 të këtij neni; ose

b) me vendim të Këshillit në mbledhjen pasuese.

7. Administrata merr masat që regjistrimet audio të mbledhjeve të Këshillit dhe procesverbali i përmbledhur të ruhen për jo më pak se 10 vjet, në përputhje me ligjin "Për arkivat".

Neni 70
Zbatimi me analogji i rregullave për komisionet e Këshillit

1. Rregullimet e neneve 66 deri 69, të këtij ligji, për thirrjen e mbledhjes, rendin e ditës, kuorumin, vendimmarrjen dhe dokumentimin e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatohen, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet përkatëse, edhe për mbledhjet e komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e komisioneve.

Neni 71
Marrëdhënia e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Ministrin e Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë koordinon zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore dhe të strategjisë sektoriale të sektorit të drejtësisë. Ministri i Drejtësisë është përgjegjës për përgatitjen e projektakteve ligjore në fushën e drejtësisë, për të cilat merr edhe mendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Ministri i Drejtësisë mund të paraqesë ankesë tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkelje disiplinore të pretenduara të gjyqtarëve, si dhe mund të kërkojë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në gjykata.

3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë në mbledhjen e përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Ministri i Drejtësisë ose persona të autorizuar prej tij mund të marrin pjesë si vëzhgues në Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të Asamblesë së Personelit Akademik dhe të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, mbledhjes së posaçme të drejtuesve të institucioneve për përzgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Ministrin e Drejtësisë për të siguruar përputhjen e planeve strategjike dhe buxhetore të sistemit gjyqësor, të miratuara nga Këshilli me politikat shtetërore dhe strategjinë sektoriale të sektorit të drejtësisë.

6. Ministri i Drejtësisë mund të ushtrojë të drejtat e mësipërme personalisht ose përmes një një përfaqësuesi të autorizuar me shkrim prej tij.

7. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Ministri i Drejtësisë ka akses të plotë në të dhënat statistikore që rezultojnë nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të trajtuara nga gjykatat.

SEKSIONI 3
KONFLIKTI I INTERESAVE

Neni 72
Konflikti i interesit

Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhjen e komisionit ose në mbledhjen plenare, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, është i detyruar për sa më poshtë:

a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;

b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;

c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.

Neni 73
Papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim

Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari, si në komisionin disiplinor,

ashtu dhe në mbledhjen plenare, kur ai ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen që është objekt i procedimit disiplinor për shkak të cilësisë si gjyqtar, prokuror, inspektor, dëshmitar, përfaqësues i palëve, ekspert ose në çdo cilësi tjetër.

Neni 74
Papajtueshmëria për shkak lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie

Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari, për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, transferimin dhe komandimin e një gjyqtari dhe as të jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një gjyqtari, si dhe në çdo procedim tjetër administrativ që lidhet me statusin e një gjyqtari ose të funksionarëve të tjerë të sistemit gjyqësor, statusi i të cilëve administrohet nga Këshilli, në qoftë se midis tyre ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme:

a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese;

b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave;

c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerk.

Neni 75
Heqja dorë

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari, për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, transferimin ose komandimin e një gjyqtari dhe as të jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një gjyqtari, si dhe nga çdo procedim tjetër administrativ që lidhet me statusin e një gjyqtari ose të funksionarëve të tjerë të sistemit gjyqësor, statusi i të cilëve administrohet nga Këshilli, në rastet e mëposhtme:

a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet ose promovohet, transferohet ose komandohet, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën;

b) kur mbrojtësi a përfaqësuesi i subjektit të procedimit administrativ është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij;

c) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet apo promovohet, transferohet ose komandohet;

ç) kur ai ose ndonjë nga të afërmit e tij ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij është dëmtuar nga veprimet ose aktet e subjektit të procedimit, të cilat janë bërë shkas për fillimin e procedimit disiplinor;

d) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit/bashkëjetuesit ka bërë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesën, hetimi i së cilës ka çuar në fillimin e procedimit disiplinor.

2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

Neni 76
Përjashtimi i anëtarit
(*Shfuqizuar pika 2 me Vendimin e GJK nr. 78/ 2017 ; Ndryshuar pika 2 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Gjyqtari ose nëpunësi civil i proceduar ose përfaqësuesi ligjor i tij, ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative vetëm në fazën paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75, të këtij ligji, dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes.

2. Vendimi për përjashtimin e një anëtari nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose komision merret nga Këshilli, sipas rregullave të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji. Kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Këshillit, mbledhja kryesohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit.

SEKSIONI 4
ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Neni 77
Administrata e Këshillit

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor funksionon administrata, e cila ndihmon në realizimin e misionit dhe të funksioneve të Këshillit.

2. Administrata e Këshillit drejtohet nga Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe raporton rregullisht tek ai.

3. Anëtarët e personelit të Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civil, sipas përcaktimeve të ligjit "Për nëpunësin civil" ose janë gjyqtarë të komanduar pranë Këshillit, sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

4. Ligji "Për nëpunësin civil" zbatohet për personelin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

5. Nëpunësit civilë mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit ose të komisioneve, si dhe të kërkojnë fjalën pa të drejtë vote.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor punëson punonjës administrativë, në bazë të rregullave të parashikuara në Kodin e Punës.

Neni 78
Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor është funksionari më i lartë administrativ i Këshillit.

2. Sekretari i Përgjithshëm rekrutohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil".

3. Drejtuesi i njësisë për çështje të përgjithshme juridike zëvendëson Sekretarin e Përgjithshëm në rastet e mungesës ose pamundësisë së përkohshme të këtij të fundit.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit ose zëvendësuesi i tij kanë të drejtë të njihen me çdo dokument që shqyrtohet nga mbledhjet e komisioneve ose nga mbledhja e Këshillit, të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen e Këshillit, si dhe të propozojnë futjen e çështjeve që lidhen me aspekte administrative dhe të personelit në agjendat e tyre.

Neni 79
Organizimi i administratës

1. Administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor ndahet, së paku, në njësitë e mëposhtme:

a) njësi mbështetëse për çështje të përgjithshme juridike;

b) njësi mbështetëse pranë secilit komision të përhershëm të Këshillit;

c) njësi mbështetëse për administrimin e buxhetit të Këshillit dhe të buxhetit gjyqësor;

ç) zyra e Këshilltarit të Etikës;

d) njësi mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet;

dh) njësi mbështetëse për teknologjinë e informacionit;

e) njësi mbështetëse për trajnimin e gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë.

2. Në lidhje me administratën, Këshilli vendos për sa më poshtë:

a) strukturën e administratës dhe të secilës njësi;

b) krijimin e njësive të tjera organizative brenda administratës;

c) përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të të gjitha njësive organizative të administratës dhe të pozicioneve individuale;

ç) rregullat procedurale, sipas të cilave vepron administrata në mënyrë të atillë që të sigurojë mbështetje efikase dhe efektive për Këshillin dhe komisionet e tij.

Neni 80
Konflikti i interesave

1. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" mbi paanësinë e administratës publike zbatohen për personelin administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Kryetari i Këshillit është përgjegjës për marrjen e vendimeve për përjashtimin nga vendimmarrja ose konfirmimin e nëpunësve civilë në rast të shfaqjes së konfliktit të interesit.

KREU III
FUNKSIONET E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Neni 81
Planifikimi strategjik

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me Ministrin e Drejtësisë, harton, miraton dhe zbaton një plan strategjik për sistemin gjyqësor, në përputhje me objektivat e të këtij ligji, dhe në koordinim me strategjinë e sektorit të drejtësisë.

2. Plani strategjik, në përputhje kohore me strategjinë e sektorit të ministrisë, duhet:

a) të përcaktojë misionin dhe vlerat kryesore të gjyqësorit;

b) të analizojë profilin e gjyqësorit;

c) të caktojë çështje strategjike;

ç) të përcaktojë prioritete;

d) të përcaktojë monitorimin, kuadrin vlerësues dhe raportues për strategjinë.

3. Plani strategjik duhet të shoqërohet me planin e veprimit, përfshirë objektivat operacionalë, veprimtaritë, ndikimin financiar dhe ndikime të tjera, si dhe treguesit e arritjeve.

Neni 82
Raportimi publik dhe para Kuvendit

1. Këshilli Lartë Gjyqësor raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit. Raporti përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij, si dhe përmban rekomandimet për përmirësimet e nevojshme.

2. Raporti i përcillet Kuvendit jo më vonë se data 1 maj e çdo viti. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Këshillit, si dhe me çdo mënyrë tjetër që vlerësohet e përshtatshme nga Këshilli.

3. Këshilli i përgjigjet kërkesës së Kuvendit për të paraqitur raportin dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me të.

4. Rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për raportin vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë të detyrueshme për

t'u marrë parasysh nga Këshilli për aq sa nuk cenojnë pavarësinë e këtij institucioni.

5. Këshilli raporton në çdo rast tjetër që e vlerëson të nevojshme ose me kërkesë të Kuvendit.

Neni 83
Etika gjyqësore

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për miratimin e standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre. Në veçanti Këshilli ushtron detyrat e mëposhtme:

a) bën publike standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së gjyqtarëve;

b) rishikon herë pas here rregullat dhe, kur është e nevojshme, i ndryshon ato;

c) analizon shkallën e zbatimit/respektimit të rregullave të etikës dhe raporton publikisht për gjetjet.

2. Këshilli cakton një Këshilltar për Etikën nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe që ka përvojë dhe njohuri mbi çështje të etikës. Këshilltari për Etikën shërben për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Për shkak të nevojave të punës, Këshilli mund të vendosë që Këshilltari për Etikën të shërbejë me kohë të plotë. Në këtë rast Këshilli ndjek procedurën e komandimit për të caktuar Këshilltarin e Etikës.

4. Këshilltari për Etikën kryen detyrat e mëposhtme:

a) jep këshilla, me kërkesë të çdo gjyqtari, për sjelljen më të përshtatshme, brenda dhe jashtë gjykatës, për çështje të diskutueshme të etikës;

b) mund të kërkojë mendimin e Këshillit për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me sjelljen e gjyqtarëve në mënyrë të përgjithshme, por jo lidhur me persona të caktuar;

c) harton, publikon dhe përditëson vazhdimisht një manual informues, i cili përmban pyetje dhe përgjigje mbi dilemat etike, bazuar në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe vendimet relevante të Këshillit;

ç) kujdeset, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm mbi çështje të etikës;

d) raporton me shkrim, jo më pak se një herë në vit, përpara Këshillit lidhur me veprimtarinë e tij.

5. Paga e Këshilltarit për Etikën përcaktohet në bazë të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

6. Këshilltari për Etikën ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit, duke mos i dhënë asnjë informacion strukturave të organeve të qeverisjes së gjyqësorit që ushtrojnë kompetenca inspektimi dhe vlerësimi.

7. Këshilli siguron mbështetjen e nevojshme me burime njerëzore dhe financiare për të mundësuar veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën.

Neni 84
Përcaktimi i kompetencave territoriale dhe madhësia e gjykatave

Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen funksionet në lidhje me përcaktimin e kompetencave territoriale dhe të madhësisë së gjykatave në bazë të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor.

Neni 85
Rekrutimi, emërimi i gjyqtarëve dhe propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë

1. Këshilli Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë në pajtim me këtë ligj dhe ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe emëron gjyqtarët pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës.

2. Këshilli i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Gjykatës së Lartë përcaktohen në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 86
Zhvillimi i karrierës dhe disiplina

Në zbatim të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për çështjet e mëposhtme në lidhje me të gjithë gjyqtarët, përveç gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese:

a) emërimin;

b) caktimin në pozicion;

c) tranferimin;

ç) ngritjen në detyrë;

d) komandimin dhe riemërimin;

dh) vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale;

e) vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin;

ë) çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj.

Neni 87
Qëndrimet publike

Këshilli, me nismë ose bazuar në kërkesat e gjyqtarëve, mund të bëjë deklarata publike në mbrojtje të gjyqtarëve të veçantë kur gjykon se të drejtat e tyre njerëzore rrezikohen të shkelen për shkak të kryerjes së detyrës, ose se kryerja e funksioneve të tyre ligjore po rrezikohet ose mund të rrezikohet si rezultat i veprimeve ose qëndrimeve të çdo subjekti publik ose privat.

Neni 88
Trajnimi vazhdues i gjyqtarëve

Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe kryen detyrat e mëposhtme:

a) mban lidhje me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve;

b) këshillon Shkollën e Magjistraturës rreth programit të trajnimit vazhdues për gjyqtarët;

c) vendos mbi kërkesat e gjyqtarëve për trajnimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;

ç) monitoron dhe raporton publikisht në lidhje me efektivitetin e trajnimeve;

d) kryen çdo detyrë tjetër që i jepet me ligj në fushën e trainimit të gjyqtarëve.

Neni 89
Administrimi i gjykatave

Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:

a) harton dhe ndjek zbatimin e politikave për administrimin gjyqësor;

b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë;

c) miraton rregullat e brendshme standarde të gjykatës.

Neni 90
Burimet njerëzore në gjykata

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata. Në veçanti Këshilli kryen detyrat e mëposhtme:

a) hedh të dhënat dhe përditëson Regjistrin Qendror të Personelit për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit administrativë të gjykatave;

b) publikon dhe shpall konkurrim të hapur për vendet e lira në shërbimin civil gjyqësor, si dhe fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele.

c) emëron kancelarin e gjykatës dhe ndihmësit ligjorë, si dhe merr masa disiplinore ndaj tyre;

ç) miraton dhe përditëson rregullat e procedurës që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç përcaktohet në ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";

d) cakton përfaqësuesin e tij në Këshillin e Gjykatës, sipas parashikimeve të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";

dh) bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për formimin fillestar dhe të vazhdueshëm të kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe ligjit "Për organizimin e

pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";

e) kujdeset për trainimin fillestar dhe të vazhdueshëm ligjor të nëpunësve civilë gjyqësor, me përjashtim të kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";

ë) miraton Kodin e Etikës për nëpunësit civilë gjyqësorë pas konsultimit me këshillat e gjykatave;

f) kujdeset për mirëadministrimin e pasurive të paluajtshme të gjykatave në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe këshillin e gjykatës;

g) ngre komisionin e ristrukturimit në rastet e mbylljes ose ristrukturimit të gjykatave;

gj) kujdeset për krijimin dhe funksionimin e sistemit të arkivimit gjyqësor, si dhe menaxhimin dhe administrimin e tij;

h) ushtron çdo kompetencë tjetër të parashikuar në ligj.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor informohet nga gjykatat për çdo të dhënë të nevojshme për përmbushjen e përgjegjësive të tij.

Neni 91
Qasja në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun. Në këtë kuadër, Këshilli kryen detyrat e mëposhtme:

a) krijon, zhvillon, dhe mirëmban një portal elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi, përfshirë informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik;

b) bën të mundur që secila gjykatë të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe t'i lejohet të publikojë në të të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore;

c) merr masa që publiku dhe palët e interesuara të informohen mbi veprimtarinë e gjykatave, si dhe për çështje të veçanta gjyqësore;

ç) miraton dhe përditëson, pas konsultimit me këshillat e gjykatave, udhëzuesit standard të shtypit.

2. Këshilli cakton një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli. Në ato raste kur komunikimi me publikun nuk mund të kryhet prej tij, shërbimi kryhet nga shërbimi i shtypit i Këshillit.

4. Shkolla e Magjistraturës ofron trajnim për anëtarët e Këshillit, gjyqtarët për mediat, administratën e Këshillit dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun.

5. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen bazuar në parimet e së drejtës për qasje në informacion, duke pasur parasysh mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionin dhe prezumimin e pafajësisë.

Neni 92
Sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit

1. Këshilli i Ministrave miraton rregulla për politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, që ndër të tjera parashikojnë:

a) masat mbrojtëse, të cilat sigurojnë vetëm akses të organeve të sistemit të drejtësisë, përveç rasteve kur të dhënat janë me natyrë statistikore ose kur parashikohet ndryshe në ligj;

b) sigurimin e asksesit të plotë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të dhënat që përmbajnë të gjithë sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me Këshillin e Lartë Gjyqësor, gjykatat, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe zyrat e prokurorisë;

c) garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetin, si dhe mundësinë e çdo personi për të pasur një proces të rregullt gjyqësor ose mundësinë e një autoriteti publik për kryerjen e një hetimi penal;

ç) për organizimin dhe funksionimin e qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë pranë njërit prej institucioneve të drejtësisë dhe të përcaktojë kompetencat saj.

2. Në përputhje me politikat e përgjithshme në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me

qendrën e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë është përgjegjës për:

a) zhvillimin ose pjesëmarrjen në zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në gjykata;

b) menaxhimin, koordinimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në gjykata;

c) përcaktimin e sistemit të zbatueshëm të sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit të çështjeve dhe kujdeset që sistemi të përdoret në çdo gjykatë;

ç) përcaktimin e rregullave për funksionimin, dhe sigurinë e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura dhe të ruajtura nga sistemi;

d) mirëmbajtjen e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit të çështjeve, në përputhje me rregullat e parashikuara në shkronjën "b" të këtij neni;

dh) ofrimin e asistencës teknike për gjykatat në përdorimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve;

e) përmirësimin periodik të sistemit, për të siguruar zbatimin e kërkesave funksionale të gjykatave, të vetë Këshillit dhe të organeve të tjera brenda sistemit të drejtësisë, si dhe për të reflektuar ndryshimet në ligjet procedurale;

ë) sigurimin e saktësisë dhe sigurisë së të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

f) garantimin që sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit të të dhënave gjeneron informacione statistikore, të cilat janë të nevojshme për punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të organeve të tjera dhe që përputhen me standardet europiane për treguesit e punës së gjyqësorit, të tilla si norma e evadimit të çështjeve, numri i çështjeve për gjyqtar, kohëzgjatja mesatare e çështjeve dhe kohëzgjatja e çështjeve në proces në raport me kohëzgjatjen mesatare etj.;

g) përcaktimin e rregullave për përdorimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, njësimin e futjes së të dhënave dhe për saktësinë e të dhënave.

Neni 93
Opinione mbi legjislacionin

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin, që mund të ndikojë në punën e gjyqësorit dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e Këshillit.

2. Në veçanti, Këshilli ushtron detyrat e mëposhtme:

a) shqyrton funksionimin e rregullave të procedurës gjyqësore civile, penale ose administrative;

b) bën rekomandime për ndryshimin e rregullave të procedurës gjyqësore civile, penale ose administrative;

c) jep përgjigje për kërkesat e ardhura nga ministrat për të dhënë mendim mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin gjyqësor ose gjykatat; dhe

ç) mund të japë mendim mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin gjyqësor ose gjykatat, duke ia drejtuar një ministri ose ndonjë organi tjetër.

3. Këshilli i propozon Ministrit të Drejtësisë ushtrimin e nismës për ndryshime ligjore në lidhje me çdo çështje që është nën përgjegjësinë e tij.

Neni 94
Rregullat e brendshme të gjykatave

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregullat standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave.

2. Rregullat standarde të gjykatave përmbajnë norma në lidhje me strukturën e gjykatave, efiçiencën dhe cilësinë e drejtësisë që jepet në këto gjykata.

3. Rregullat standarde për strukturën përmbajnë të paktën rregullimet e mëposhtme:

a) organigrama standarde për gjykatat e të gjitha niveleve;

b) përshkrime standarde të detyrave dhe përgjegjësive për secilën kategori të punonjësve të gjykatave.

4. Rregullat standarde për efiçiencën e drejtësisë përfshijnë parashikime

për:

a) afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, përfshirë, kur është e mundur, edhe afatet për fazat kryesore të procedurës, për ekzekutimin e vendimeve, duke mbajtur parasysh organizimin gjyqësor dhe normat procedurale;

b) rregulla standarde që do të përdoren nga gjykatat për përcaktimin e afateve kohore, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve, me qëllimin për të përmirësuar në vijimësi sistemin e menaxhimit të çështjeve;

c) veprimet standarde që duhet të ndërmerren në rastet kur shqyrtimi i çështjeve i tejkalon afatet;

ç) rregulla standarde për monitorimin e kohëzgjatjes së pezullimeve që vijnë si rezultat i mosveprimit nga palët ose gjykatat;

d) rregulla standarde për monitorimin dhe shpërndarjen e të dhënave për personelin e gjykatave dhe të gjithë përdoruesit e gjykatave;

dh) udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore;

e) udhëzues për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve;

ë) udhëzues për monitorimin e shtyrjeve të seancave gjyqësore;

f) modele për vendimet gjyqësore;

g) udhëzues për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audiovizive në procesin gjyqësor;

gj) udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe marrjen e provave në gjykata;

h) krijimi i mekanizmave për zgjidhjen e problemeve funksionale dhe shpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës midis gjyqtarëve dhe gjykatave.

5. Rregullat standarde për cilësinë e drejtësisë përfshijnë ndër të tjera domosdoshmërisht edhe rregullimet e mëposhtme:

a) zhvillimi i vrojtimeve për vlerësimin e shërbimeve të gjykatave nga përdoruesit e tyre;

b) zhvillimi, testimi dhe përdorimi i treguesve për cilësinë e shërbimeve gjyqësore;

c) masa për përmirësimin e cilësisë së punës të ekspertëve gjyqësorë;

ç) masa për përmirësimin e qasjes në drejtësi.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të kryejë studime pilot në bashkëpunim me gjykatat, me qëllim rritjen e cilësisë dhe efiçiencës se gjykatave.

Neni 95
Buxheti vjetor i Këshillit dhe i gjykatave

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe sistemi gjyqësor financohen nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

2. Buxheti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sistemit gjyqësor është pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjislacionin përkatës.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të tij në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor merr pjesë në mbledhjen e Kuvendit ku diskutohet projektbuxheti i sistemit gjyqësor;

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbikëqyrjen e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 96
Zbatimi i buxhetit gjyqësor

1. Në zbatim të kompetencave të parashikuara në nenin 95 të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen detyrat e mëposhtme:

a) ndihmon gjykatat në hartimin e projektbuxheteve të tyre vjetore;

b) mbledh dhe analizon të dhëna mbi zbatimin e buxhetit dhe të ardhurat e siguruara nga gjykatat;

c) mbikëqyr dhe këshillon gjykatat mbi teknikat dhe procedurat e përshtatshme dhe efiçiente që lidhen me menaxhimin financiar të tyre;

ç) vendos standarde të praktikave më të mira dhe objektiva të performancës, në lidhje me administrimin financiar të gjykatave;

d) siguron trajnim për stafin gjyqësor mbi menaxhimin financiar të gjykatave;

dh) ndërmerr projekte me synimin për të përmirësuar menaxhimin financiar të gjykatave;

e) merr hapa të tjerë për të lehtësuar gjetjen e fondeve të mjaftueshme dhe të vazhdueshme për gjykatat;

ë) bashkëpunon dhe kërkon fonde nga agjencitë e tjera vendase dhe ndërkombëtare në lidhje me funksionet e Këshillit.

2. Për të zbatuar detyrat, e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si pjesë përbërëse dhe funksionale e Këshillit krijohet njësia e administrimit të buxhetit gjyqësor.

3. Njësia e administrimit të buxhetit gjyqësor ka këto kompetenca kryesore:

a) studion dhe përcakton nevojat për buxhet të të gjitha hallkave të gjyqësorit në bashkëpunim me sektorët financiarë të gjykatave të të gjitha niveleve;

b) përpunon treguesit financiarë që kanë lidhje me kërkesat dhe veprimtarinë e gjykatave;

c) kontrollon përdorimin e fondeve që u janë dhënë gjykatave sipas destinacioneve.

4. Lidhur me veprimtarinë e njësisë së administrimit të buxhetit gjyqësor Këshilli ushtron këto kompetenca:

a) miraton projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm të propozuar nga njësia për çdo nivel të gjykatave dhe ia dërgon atë për shqyrtim organit kompetent për shqyrtim dhe miratim, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit përkatës;

b) auditon dhe monitoron përdorimin fondeve të akorduara dhe analizon kërkesat e gjykatave për fonde që mund të lindin gjatë vitit buxhetor.

5. Fondet në dispozicion të Këshillit dhe të gjykatave përdoren për këto qëllime:

a) për pagat dhe sigurimet shoqërore të anëtarëve dhe personelit të Këshillit, si dhe të gjyqtarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave;

b) për plotësimin e nevojave për shpenzimet operative të Këshillit dhe të gjykatave, si dhe për veprimtari të tjera gjyqësore;

c) për ndërtimin ose meremetimin e godinave, si dhe për investime të tjera;

ç) për mbulimin e shpenzimeve të gjykatave, lidhur me dhënien e ndihmës së detyrueshme juridike në rastet e parashikuara në dispozitat ligjore të veçanta.

KREU IV
AKTET DHE RREGULLAT PROCEDURALE

Neni 97
Aktet e Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të funksioneve të tij, nxjerr aktet e mëposhtme:

a) akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore;

b) akte administrative kolektive në lidhje me statusin e të gjithë gjyqtarëve ose zyrtarëve të administratës gjyqësore;

c) akte normative nënligjore, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me efekt të përgjithshëm detyrues mbi të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, personat privatë dhe organet publike;

ç) akte për miratimin e rregullave të brendshme procedurale. Në veçanti, rregullat procedurale mund të përfshijnë dispozita në lidhje me koordinimin e veprimtarisë së komisioneve, angazhimin e ekspertëve në punën e Këshillit, shpërndarjen dhe ndarjen e përgjegjësive të administratës, kuorumin e nevojshëm për mbledhjet e komisioneve, rregulla për publikimin e informacioneve për procedimet e Këshillit etj.;

d) udhëzime jodetyruese.

2. Në asnjë rast, Këshilli nuk mund të japë udhëzime në lidhje me zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore konkrete ose të një grupi çështjesh.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.

Neni 98
Njoftimi dhe botimi i akteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Njoftimi i akteve administrative individuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë, bëhet në një ose disa nga format e mëposhtme:

a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;

b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;

c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.

2. Aktet administrative individuale të Këshillit, në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë, bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Njoftimi i akteve administrative kolektive, në lidhje me statusin e të gjithë gjyqtarëve ose zyrtarëve të administratës gjyqësore, bëhet nëpërmjet botimit në faqen zyrtare të Këshillit. Këto akte hyjnë në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit.

4. Aktet normative nënligjore botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit dhe në Fletoren Zyrtare. Ato hyjnë në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare. Nëse akti normativ nënligjor ndryshon një akt tjetër, akti i ndryshuar botohet në formë të konsoliduar në faqen zyrtare të Këshillit.

5. Ky nen zbatohet edhe për aktet e nxjerra nga komisionet e Këshillit.

Neni 99
Procedura e rishikimit

1. Në rastet kur një akt administrativ individual është nxjerrë nga komisioni, subjektet e interesuara kanë të drejtë të kërkojnë anulimin, ndryshimin ose plotësimin nga mbledhja plenare e Këshillit.

2. Kërkesa për rishikim bëhet me shkrim. Ajo dorëzohet jo më vonë se 10 ditë nga dita e njoftimit të palës së interesuar, në përputhje me kërkesat e këtij neni.

3. Kërkesa mund të bazohet në arsyet e mëposhtme:

a) vendimi është bazuar në gabime materiale dhe të faktit;

b) ka ndodhur një gabim i rëndë procedural.

4. Kërkuesi nuk mund të paraqesë pretendime ose fakte të reja gjatë shqyrtimit të çështjes nga mbledhja plenare e Këshillit, me përjashtim të rasteve kur subjekti i interesuar provon se nuk ishte dhe nuk mund të ishte në dijeni të këtyre fakteve më parë.

5. Mbledhja plenare e Këshillit shqyrton dhe vendos mbi të gjitha kërkesat brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes.

6. Kërkesa nuk pranohet nëse ajo nuk është paraqitur brenda afatit dhe në formën e kërkuar sipas këtij ligji. Kërkuesit njoftohen për mospranimin dhe shkaqet e mospranimit të kërkesës së tyre për rishikim.

7. Këshilli, në këto raste, i zhvillon mbledhjet me dyer të mbyllura. Përjashtimisht, Këshilli mund të zhvillojë dëgjesa me subjektet e procedimit kur kjo është e nevojshme, si rezultat i fakteve të reja, sipas pikës 4 të këtij neni.

8. Në bazë të konkluzionit të shqyrtimit të kërkesës për rishikim, Këshilli duhet të përcaktojë nëse kërkesa për rishikim duhet të pranohet ose të rrëzohet. Në rast pranimi, Këshilli miraton një vendim administrativ të ndryshuar. Ndryshimet mund të bëhen vetëm për aq sa kërkohen nga subjekti i interesuar.

9. Këshilli mund të anulojë një akt administrativ individual edhe me nismën e tij kur vërtetohen kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

Neni 100
Ankimi i vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor
(*Ndryshuar pika 1 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese.

2. Aktet administrative me efekt të përgjithshëm detyrues i nënshtrohen kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe kontrollit të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me ligjin.

PJESA III
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KREU I
PËRBËRJA DHE ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

SEKSIONI 1
ANËTARËT E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË DHE STATUSI I TYRE

Neni 101
Përbërja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe mandati i anëtarëve

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organ kolegjial, i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë. Gjashtë prej anëtarëve të Këshillit janë prokurorë nga të gjitha nivelet e prokurorisë. Pesë anëtarët e tjerë të Këshillit janë juristë joprokurorë, të përzgjedhur nga radhët e avokatëve, të pedagogëve të drejtësisë dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile.

2. Anëtarët prokurorë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve të të gjitha niveleve.

3. Anëtarët joprokurorë që zgjidhen nga radhët e avokatëve, trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe shoqërisë civile zgjidhen nga Kuvendi, bazuar në një proces vlerësimi paraprak të kushteve dhe kritereve ligjore, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

4. Përveç rasteve kur vërtetohen kushtet për ndërprerjen e parakohshme të mandatit, anëtari i Këshillit të Lartë i Prokurorisë qëndron në detyrë për 5 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme.

Neni 102
Statusi i anëtarëve të Këshillit të Lartë i Prokurorisë

1. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka statusin e magjistratit, sipas dispozitave të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

2. Anëtari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

3. Anëtari prokuror i Këshillit nuk i nënshtrohet vlerësimit etik dhe profesional të veprimtarisë gjatë kohës së shërbimit si anëtar. Performanca gjatë kohës së shërbimit si anëtar i Këshillit merret në konsideratë në rast të transferimit ose promovimit, sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

4. Anëtari prokuror, në përfundim të mandatit, kthehet në vendin e mëparshëm të punës. Mandati i prokurorit të posaçëm pezullohet gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Anëtari prokuror i Këshillit nuk mund të transferohet, të ngrihet në detyrë ose të delegohet gjatë 3 viteve pas përfundimit të mandatit.

5. Anëtari joprokuror, që përpara emërimit punonte me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose, në pamundësi, në një detyrë të barasvlershme me të.

Neni 103
Shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë
(*Shfuqizuar me Vendimin e GJK nr. 41/ 2017; Ndryshuar me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:

a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ose dëmtojnë besimin e publikut te prokuroria;

b) gjatë ushtrimit të funksionit, nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë.

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi ose sjellja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë konsiderohet shkelje disiplinore ose një çështje e veprimtarisë profesionale, në çdo rast merret parasysh:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshtësia e veprimit ose mosveprimit;

c) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe

ç) çdo situatë që është jashtë kontrollit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e prokurorisë.”.

Neni 103/1
Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit
(*Shtuar me Ligjin nr. 47/2019*)

Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga pjesëmarrja në mbledhjen plenare ose në mbledhjet e komisioneve, kur është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka dijeni ose duhet të kishte dijeni për rrethana të tilla;

b) paraqitja e kërkesës për heqje dorë të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nëse ky veprim:

   i. nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;

   ii. bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për subjektin e procedurës administrative ose synon shmangien e përgjegjësisë ligjore si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë apo caktimin e çështjes një anëtari tjetër të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

   iii. nuk kryhet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun;

c) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një anëtari tjetër të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

ç) mospërmbushja e pajustifikuar ose e përsëritur e funksioneve;

d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që sjell përfitime të padrejta ose dëmtim të subjektit të procedurës administrative;

e) angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë anëtarit, ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

ë) mungesa e pajustifikuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij

ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;

f) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

g) mosnjoftimi i Kryetarit të Këshillit, si dhe autoriteteve kompetente, sipas ligjit, mbi ndërhyrjet ose forma të tjera të ndikimit nga magjistratët, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektet e tjera;

gj) shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

h) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve, sipas legjislacionit në fuqi;

i) mosnjoftimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

j) mosrespektimi i detyrimeve ligjore, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

k) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 103/2
Shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit
(*Shtuar me Ligjin nr. 47/2019*)

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

a) përdorimi i pozicionit të anëtarit të Këshillit për krijimin e përfitimeve të pajustifikuara për veten ose për të tretët;

b) ushtrimi i veprimtarive jashtë funksionit, me pagesë, duke mos respektuar rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

c) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me anëtarin e Këshillit, ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;

ç) përfitimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimit preferencial të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit të ushtruar ose për shkak të përdorimit të pozitës si anëtar i Këshillit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;

d) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e anëtarit dhe dëmton besimin e publikut te prokuroria, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

Neni 103/3
Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale
(*Shtuar me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë veprime, mosveprime ose sjellje, për të cilat anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është dënuar me vendim të formës së prerë dhe që, sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut te prokuroria, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuara nga gjykata.

2. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprimet, mosveprimet ose sjelljet, sipas pikës 1 të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është rehabilituar ose ka përfituar nga falja apo amnistia.

3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" zbatohen për aq sa është e nevojshme.

Neni 104
Procedura disiplinore
(*Ndryshuar pika 4 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Prokurorisë hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bazë të procedurave dhe rregullave të këtij ligji, ligjit, të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Gjykata Kushtetuese vendos pezullimin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rastet e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

4. Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

SEKSIONI 2
ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

NËNSEKSIONI I
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE PROKURORË TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Neni 105
Zgjedhja e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe kushtet për t'u zgjedhur

1. Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve të të gjitha niveleve zgjedh 6 anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas raportit të mëposhtëm:

a) tre prej të zgjedhurve janë prokurorë të shkallës së parë. Së paku 1 prej tyre është prokuror në një prokurori pranë gjykatës të shkallës së parë jashtë Tiranës;

b) dy prej të zgjedhurve janë prokurorë të prokurorive pranë gjykatave të apelit, duke përfshirë edhe Prokurorinë e Posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Së paku 1 prej tyre është prokuror në një prokurori pranë një gjykate apeli jashtë Tiranës;

c) një prej të zgjedhurve është prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) në kohën e kandidimit, të kenë ushtruar funksionin e prokurorit për të paktën 10 vjet;

b) në kohën e kandidimit, nuk duhet të jenë drejtues të një zyre

prokurorie ose anëtarë të organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata prokurorësh, sindikata prokurorësh etj.;

c) të jenë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në dy vlerësimet e fundit të etikës dhe veprimtarisë profesionale;

ç) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

e) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;

ë) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

3. Çdo prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme që plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, ka të drejtë të kandidojë.

4. Çdo prokuror i shkallës së parë dhe i apelit që plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 10 kolegëve nga e njëjta shkallë e prokurorisë ka të drejtë të kandidojë.

Neni 106
Mbështetja e kandidatëve

1. Prokurori i Përgjithshëm miraton modelin e deklaratës individuale për dhënien e mbështetjes kandidatëve për anëtarë të Këshillit.

2. Një prokuror nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat për çdo vend vakant.

Neni 107
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve prokurorë në detyrë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i

Përgjithshëm shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga prokurorët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Kuvendi mund t'i drejtojë Prokurorit të Përgjithshëm një kujtesë lidhur me detyrimet e tij, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe çdo informacion tjetër që e gjykon të nevojshëm, për datën e fillimit të procesit për përzgjedhjen e kandidatëve dhe kalendarin e veprimeve.

3. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare dhe elektronike, ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit, dhe dokumentet që duhet të shoqërojnë atë.

4. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme dhe u dërgohet të gjithë gjyqtarëve në adresën elektronike zyrtare.

Neni 108
Paraqitja dhe shqyrtimi i shprehjes së interesit

1. Brenda 15 ditëve nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, prokurorët e interesuar shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike të përmendur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit ose në adresën postare të Prokurorisë së Përgjithshme.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin të paktën dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkruara rregullisht;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

d) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;

dh) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;

e) informacion mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton dhe vë në dispozicion të të interesuarve një formular tip për dhënien e këtij informacioni;

ë) listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Neni 109
Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore

1. Brenda 7 ditëve nga dita kur mbyllet afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit, nën përgjegjësinë e Prokurorit të Përgjithshëm, administrata e Prokurorisë së Përgjithshme verifikon plotësimin e kushteve nga kandidatët, sipas përcaktimeve të nenit 105, pikat 2 dhe 4, të këtij ligji, dhe shpall zyrtarisht kandidaturat në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Vendimi për përjashtimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 105, pikat 2 dhe 4, të këtij ligji, merret nga komisioni i kualifikimit, i përbërë nga Prokurori i Përgjithshëm dhe dy prokurorë të tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme, të zgjedhur me short nga radhët e atyre që nuk kandidojnë. Shorti për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të kualifikimit organizohet nën përgjegjësinë e Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Kandidatët e përjashtuar njoftohen menjëherë, me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

4. Në qoftë se nuk ka kandidatë për një ose më shumë nga nivelet e prokurorisë që duhet të përfaqësohen në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, sipas përcaktimeve të nenit 149, të Kushtetutës, dhe të këtij ligji, Prokurori i Përgjithshëm bën një thirrje të dytë jo më vonë se 3 ditë nga dita kur shpallen kandidaturat në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë rast afati për paraqitjen e shprehjeve të interesit është 15 ditë nga dita e shpalljes së thirrjes së dytë.

5. Në qoftë se edhe pas thirrjes së dytë nuk paraqiten kandidatë nga shkallët e papërfaqësuara të prokurorisë, zgjedhja e tyre bëhet me short nga radhët e prokurorëve që kanë kandiduar për vendin vakant. Çdo kandidat që përmbush kriteret për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit dhe kriteret për t'u ngritur në detyrë ose për t'u transferuar në shkallët e papërfaqësuara të prokurorisë, ka të drejtë të kandidojë për vendin vakant përkatës.

Neni 110
Ankimet kundër vendimeve të përjashtimit

1. Ankimet kundër vendimeve për përjashtimin e kandidatëve vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e depozitimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë

3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga komisioni i kualifikimit, sipas nenit 109 të këtij ligji.

Neni 111
Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Jo më vonë se dy muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në detyrë, Prokurori i Përgjithshëm thërret Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve të të gjitha niveleve për të zgjedhur anëtarët e Këshillit.

2. Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, i dërgohet secilit prokuror në adresën elektronike zyrtare dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme.

3. Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme të prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit tregon datën, vendin dhe orën e mbledhjes.

4. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, zgjedhja e anëtarëve të Këshillit është pika e vetme në rendin e ditës së Mbledhjes së Përgjithshme.

Neni 112
Kuorumi

1. Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është e detyrueshme.

2. Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të prokurorëve.

3. Numri i pjesëmarrësve në Mbledhjen e Përgjithshme shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

Neni 113
Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme nga anëtarët

1. Në qoftë se në përfundim të afatit të parashikuar në nenin 111, pika 1, të këtij ligji, nuk është thirrur ende Mbledhja e Përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ajo mund të thirret menjëherë nga një e dhjeta e numrit të përgjithshëm të prokurorëve.

2. Kërkesa e tyre për thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme dorëzohet në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme.

3. Me paraqitjen e kërkesës, Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme njofton menjëherë prokurorët, duke përcaktuar në njoftim datën, vendin dhe orën e mbledhjes. Njoftimi i dërgohet secilit prokuror në adresën elektronike zyrtare.

Neni 114
Procesi i votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Votimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve është i fshehtë dhe individual.

2. Jo më vonë se 2 ditë para datës së e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit, Prokurori i Përgjithshëm miraton fletën tip të votimit, e cila përmban emrat e kandidatëve të regjistruar.

3. Procesi i votimit është i hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interesim për të ndjekur procesin. Vëzhguesit autorizohen paraprakisht nga Prokurori i Përgjithshëm. Ministri i Drejtësisë ose një person i autorizuar prej tij dhe 2 anëtarë të komisioni të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri nga të cilët i përket opozitës,

mund të marrin pjesë si vëzhgues në Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë pa autorizim paraprak nga Prokurori i Përgjithshëm.

4. Për administrimin e procesit të votimit krijohet komisioni i votimit, i përbërë nga 3 prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme të zgjedhur me short. Shorti për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit organizohet nën përgjegjësinë e Prokurorit të Përgjithshëm.

5. Përpara fillimit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit shumëfishojnë dhe nënshkruajnë paraprakisht një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e prokurorëve që janë të pranishëm në mbledhje. Në rast të dëmtimit të një ose disa fletëve të votimit, komisioni nënshkruan një numër fletësh votimi të barabartë me fletët e dëmtuara dhe shkatërron në praninë e pjesëmarrësve fletët e dëmtuara.

6. Në administrimin e procesit të votimit komisioni i votimit ndihmohet nga administrata e Prokurorit të Përgjithshëm.

7. Me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve mund të miratojë rregulla më të hollësishme për procesin e votimit dhe zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit, në fillim të mbledhjes.

Neni 115
Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit

1. Në përfundim të procesit të votimit, nën përgjegjësinë e Prokurorit të Përgjithshëm, anëtarët e komisionit të votimit hapin kutitë në prani të të gjithë prokurorëve që marrin pjesë në mbledhje, numërojnë votat dhe shpallin rezultatin paraprak të zgjedhjeve.

2. Fletët e votimit ndahen në vota të vlefshme ose në vota të pavlefshme. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit;

b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;

c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;

ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;

d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;

dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

3. Votat që gjykohen të pavlefshme rivlerësohen në fund të procesit të numërimit. Në rast mosmarrëveshjeje mes anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave, vendimet merren në fund të procesit të rivlerësimit me shumicën e votave. Votat që gjykohen të vlefshme në fund të procesit të rivlerësimit u shtohen kandidatëve përkatës.

4. Në përfundim të procesit të votimit dhe të numërimit të votave, anëtarët e komisionit të votimit hartojnë dhe miratojnë një procesverbal, i cili tregon numrin e pjesëmarrësve, numrin total të votave të hedhura, numrin e votave të hedhura për secilën kategori kandidatësh, numrin e votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve fitues. Rastet e mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

5. Në fund të procesit të votimit quhen të zgjedhur kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në qoftë se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash, fituesi përcaktohet me short midis tyre.

6. Procesverbali origjinal, që tregon numrin e pjesëmarrësve në Mbledhjen e Përgjithshme, numrin e votave dhe rezultatin e numërimit të votave, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të votimit, i dërgohet menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm.

7. Vendimet me rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve, çdo vendim i ndërmjetëm dhe procesverbali nënshkruhen bashkërisht nga anëtarët e komisionit të votimit. Vendimet njoftohen publikisht në fund të mbledhjes së përgjithshme dhe shpallen zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme. Vendimi për shpalljen e fituesve botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 116
Ankimet kundër vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme

1. Ankimet për shkelje të procedurës që lidhen me thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme, verifikimin e pjesëmarrjes, të votimit dhe numërimit

të votave, të konstatimit dhe shpalljes së votave të pavlefshme dhe të shpalljes së rezultatit gjatë Mbledhjes së Përgjithshme të prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Gjykata mund të vendosë përsëritjen e zgjedhjeve vetëm në qoftë se shkeljet procedurale të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vërtetohen dhe janë të tilla që kanë ndikuar ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Në rast se Gjykata Administrative e Apelit vendos përsëritjen e zgjedhjeve, ato zhvillohen jo më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

NËNSEKSIONI II
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA AVOKATIA

Neni 117
Verifikimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga avokatia dhe kushtet për t'u zgjedhur

1. Kuvendi zgjedh 2 anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga parashikimet e këtij neni.

2. Për verifikimin paraprak të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët dhe për vlerësimin paraprak të integritetit moral e profesional të tyre, krijohet një Komision i Pavarur *Ad Hoc,* sipas parashikimeve të nenit 121 të këtij ligji.

3. Avokatët që kandidojnë për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave", ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të

kenë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) të jenë avokatë të licencuar sipas ligjit;

ç) të kenë shlyer rregullisht të gjitha detyrimet tatimore dhe ato financiare ndaj Dhomës së Avokatisë;

d) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesionin e juristit, nga të cilat të paktën 10 vitet e fundit të kenë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje;

dh) të jenë licencuar për të ushtruar profesionin pranë Gjykatës së Lartë ose Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve të ligjit "Për profesionin e avokatit";

e) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

ë) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos kenë mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike;

g) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

gj) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi të inteligjencës;

h) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

i) të mos jenë larguar nga detyra të mëparshme si gjyqtar, prokuror ose oficer i Policisë Gjyqësore me masë disiplinore;

j) të mos jenë kandidatë të propozuar nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, si dhe nga shoqëria civile.

4. Avokatët që mbajnë pozicione drejtuese në dhomat e avokatisë ose në organet drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata, grupime dhe

sindikata avokatësh, japin dorëheqjen nga këto pozicione drejtuese në qoftë se zgjidhen anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 118
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve avokatë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall vendet vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit për avokatët që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 117 të këtij ligji. Shpallja bëhet në faqen zyrtare të Kuvendit, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të Avokatit të Popullit dhe të paktën në një gazetë me tirazhin më të lartë.

2. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare dhe elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet që duhet të shoqërojnë atë.

Neni 119
Paraqitja e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, avokatët e interesuar shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar Avokatit të Popullit.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike të përmendur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit dhe/ose në adresën postare të Avokatit të Popullit.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

ç) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut të vitit 1991;

d) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimit sekret;

dh) dokument konfirmues për plotësimin e kushteve nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë që tregon se kandidati i plotëson kushtet e parashikuara në shkronjat "c" deri në "e", të nenit 117, të këtij ligji;

e) çdo dokument tjetër që vërteton plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 117 të këtij ligji.

Neni 120
Shqyrtimi i shprehjes së interesit

1. Për marrjen në dorëzim të shprehjeve të interesit dhe të dokumentacionit shoqërues të kandidatëve mbahet një procesverbal, i cili tregon numrin dhe llojin e dokumenteve të paraqitura nga kandidatët. Procesverbali firmoset nga kandidati dhe përfaqësuesi i zyrës së protokollit të Avokatit të Popullit.

2. Avokati i Popullit, brenda 5 ditëve nga paraqitja e shprehjeve të interesit dhe dokumentacionit shoqërues, verifikon nëse dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët është i plotë.

3. Nëse dokumentacioni i kandidatëve nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në Kushtetutë dhe në nenin 117, të këtij ligji, si dhe të kritereve profesionale e morale, sipas nenit 132, të këtij ligji, Avokati i Popullit i kërkon kandidatit të bëjë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë, i përcillet kandidatit me shkresë zyrtare ose në adresën elektronike të deklaruar brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit nga Avokati i Popullit.

4. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor nuk pezullon procesin e regjistrimit përfundimtar të kandidatëve dhe të dokumentacionit shoqërues. Në këtë rast, vlerësimi i kandidatit bëhet mbi dokumentacionin e dosjes së administruar nga Avokati i Popullit.

5. Data në të cilën plotësohet dokumentacioni i kërkuar, ose afati i përcaktuar për plotësimin, konsiderohet dhe dita e paraqitjes dhe regjistrimit të kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues në zyrën e Avokatit të Popullit. Paraqitja përfundimtare dokumentohet me një numër regjistrimi nga zyra e protokollit të Avokatit të Popullit.

Neni 121
Përbërja e Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve

1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë përbëhet nga:

a) Avokati i Popullit;

b) Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;

c) dy avokatë, më i riu dhe më i vjetri në moshë ndër avokatët që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që nuk kandidojnë dhe që janë angazhuar gjatë 5 viteve të fundit në mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës ose në Shkollën e Avokatisë.

ç) një anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave nga shkencat shoqërore.

2. Avokati i Popullit është kryetari i Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*. Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është zëvendëskryetar i komisionit.

3. Pjesëmarrja në mbledhjen e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të prokurorisë është e detyrueshme. Anëtarët që mungojnë zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues, të cilët zgjidhen sipas parashikimeve të nenit 123 të këtij ligji.

4. Mbledhja e komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Neni 122
Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit të Pavarur Ad Hoc

1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* është organ i pavarur që bën verifikimin paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale e morale dhe renditjen e avokatëve që kandidojnë për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* i përmbush funksionet e tij duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe me qëllimin për të siguruar cilësi sa më të lartë profesionale dhe morale në përbërjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* kryen procedurë të përbashkët për verifikimin paraprak të dy kategorive të kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rast të krijimit të vendeve vakante për Këshillat në të njëjtën kohë.

Neni 123
Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*

1. Jo më vonë se 2 ditë nga dita e paraqitjes së shprehjeve të interesit dhe regjistrimit të kandidatëve, Avokati i Popullit i kërkon Dhomës Kombëtare të Avokatisë listën e avokatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 117, shkronjat "c" deri në "e", për të qenë anëtarë të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc,* sipas parashikimeve të nenit 121, pika 1, të këtij ligji. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dërgon listën brenda 5 ditëve nga data e kërkesës.

2. Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të listës së avokatëve për plotësimin e kritereve të parashikuara në nenin 117, të këtij ligji, fton më të riun në moshë dhe më të vjetrin në moshë ndër ta që të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc.* Nëse një ose të dy avokatët e ftuar nuk pranojnë të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc,* Avokati i Popullit kryen të njëjtën procedurë me kandidatët që pasojnë në listë, sipas kriterit të moshës. Avokati i Popullit cakton edhe 2 anëtarë zëvendësues, sipas së njëjtës procedurë dhe në bazë të të njëjtit kriter.

3. Avokati i Popullit, jo më vonë se 2 ditë nga dita e shprehjes së interesit, i kërkon Akademisë së Shkencave dërgimin e listës me emrat e anëtarit dhe anëtarit zëvendësues për Komisionin e Pavarur *Ad Hoc*.

4. Jo më vonë se 5 ditë nga dita e dërgimit të shkresës së Avokatit të Popullit, Akademia e Shkencave i dërgon Avokatit të Popullit listën me emrat e anëtarëve, të cilët zgjidhen me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Akademisë së Shkencave.

5. Në rast se në përfundim të afatit të parashikuar në këtë nen, Avokati i Popullit nuk ka ushtruar përgjegjësitë e tij, ato ushtrohen nga zëvendëskryetari i Komisionit *Ad Hoc*. Mosushtrimi i kompetencave, sipas këtij neni, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, përbën shkelje disiplinore për Avokatin e Popullit.

Neni 124
Thirrja e mbledhjes të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*

1. Jo më vonë se 10 ditë nga dita e paraqitjes së shprehjeve të interesit dhe regjistrimit të kandidatëve Avokati i Popullit thërret mbledhjen e Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*.

2. Thirrja e mbledhjes së komisionit bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve në

adresën elektronike të deklaruar dhe me postë.

3. Thirrja e mbledhjes tregon datën, vendin dhe orën e mbledhjes.

4. Në rast se në përfundim të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, Avokati i Popullit nuk ka ushtruar përgjegjësitë e tij, ato ushtrohen nga Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Neni 125
Vendi i takimit dhe mbështetja administrative

1. Mbledhja e Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* thërritet nga Avokati i Popullit sa herë është e nevojshme.

2. Mbledhjet e komisionit janë të mbyllura.

3. Mbledhjet e komisionit zhvillohen në zyrat e Avokatit të Popullit.

4. Avokati i Popullit siguron mbështetjen e nevojshme organizative, administrative dhe financiare për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Komisionit *Ad Hoc* të parashikuara në nenin 122 të këtij ligji.

Neni 126
Konflikti i interesit dhe papajtueshmëria

1. Anëtari i komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të Komisionit *Ad Hoc* lidhur me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës, të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe të mos marrë pjesë në marrjen e vendimit për çështjen përkatëse.

2. Anëtari i komisionit nuk mund të marrë pjesë në verifikimin paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në qoftë se midis tij dhe kandidatit ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme:

a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese;

b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; ose

c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerk.

Neni 127
Heqja dorë

1. Anëtari i Komisionit *Ad Hoc* është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në procesin për verifikimin paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në rastet e mëposhtme:

a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me kandidatin, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën;

b) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/ bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me kandidatin.

2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga kryetari i komisionit. Në rast se konflikti i interesit ose papajtueshmëria prek kryetarin e komisionit, vendimi për pranimin e dorëheqjes pranohet nga zëvendëskryetari.

Neni 128
Përjashtimi dhe zëvendësimi i anëtarit

1. Kandidatët mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* nga pjesëmarrja në verifikimin paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve morale e profesionale dhe renditjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë përpara datës së mbledhjes së komisionit kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenet 126 dhe 127, të këtij ligji, dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes.

2. Vendimi për përjashtimin e anëtarit merret nga kryetari i komisionit. Në rast se kërkohet përjashtimi i kryetarit, vendimi merret zëvendëskryetari.

3. Kur anëtari i përjashtuar, i dorëhequr ose që mungon është Avokati i Popullit, ai zëvendësohet nga komisioneri i Avokatit të Popullit më i vjetër në moshë;

4. Kur anëtari i përjashtuar, i dorëhequr ose që mungon është Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ai zëvendësohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

5. Kur anëtari i përjashtuar, i dorëhequr ose që mungon është një prej anëtarëve të tjerë të komisionit, ai zëvendësohet nga anëtari zëvendësues, sipas kritereve të parashikuara në nenin 123 të këtij ligji.

Neni 129
Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore

1. Jo më vonë se 45 ditë nga dita kur përfundon afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* verifikon plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij për verifikimin paraprak të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët, komisioni ndihmohet nga administrata e Avokatit të Popullit.

2. Për kontrollin e integritetit të kandidatëve, kryetari i komisionit i përcjell menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme formularët e vetëdeklarimit, të plotësuar nga kandidatët, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" nëse është e nevojshme. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve.

3. Për kontrollin e kushteve të tjera ligjore, kryetari i komisionit dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës.

4. Për kontrollin e plotësimit të kushteve të parashikuara nga shkronjat "c" deri në "e", të nenit 19, të këtij ligji, nëse është e nevojshme, kryetari i komisionit i drejtohet Dhomës Kombëtare të Avokatisë për saktësimin e informacionit të deklaruar nga kandidati.

5. Me përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak, komisioni shpall menjëherë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit, të Kuvendit dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Në të njëjtën kohë, komisioni i komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit të të dhënave të deklaruara.

6. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale, për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

Neni 130

Ankimet kundër vendimeve të përjashtimit të kandidatëve

1. Ankimet kundër vendimeve për përjashtimin e kandidatëve vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kontestuar.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Komisioni i Pavarur *Ad Hoc*, sipas nenit 131 të këtij ligji.

Neni 131
Fillimi dhe afati për zhvillimin e procedurës së vlerësimit paraprak dhe renditjes së kandidatëve

1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc,* pas shpalljes zyrtarisht të kandidaturave, të cilat plotësojnë kushtet ligjore, mblidhet menjëherë për vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve dhe bën renditjen e tyre jo më vonë se 10 ditë.

2. Kandidatët, të cilët kanë fituar të drejtën për të kandiduar me vendim të gjykatës, sipas nenit 130, të këtij ligji, vlerësohen bashkë me kandidatët e tjerë.

3. Këshilli qëndron i mbledhur deri në përfundim të procesit të vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve.

Neni 132
Kriteret profesionale dhe morale për renditjen e kandidatëve

1. Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre profesionale bazuar në:

a) rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon;

b) vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës;

c) rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë;

ç) ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit.

2. Komisioni bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre morale bazuar në:

a) reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve;

b) cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, etika profesionale, përdorimi i të gjitha mjeteve të ligjshme për mbrojtjen në besnikëri të të drejtave të personave që përfaqësohen prej tij;

c) angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

3. Komisioni bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre organizative, drejtuese dhe menaxheriale bazuar në:

a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;

b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësitë e komunikimit;

ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore ose multikulturore;

d) aftësitë e përfaqësimit publik.

4. Krahas kritereve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, në vlerësimin e kandidatëve mbahen parasysh edhe:

a) mbajtja e titujve akademikë;

b) kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;

c) njohja e gjuhëve të huaja.

5. Komisioni interviston kandidatët dhe angazhon ekspertë për verifikimin e aftësive të tyre, sidomos për të verifikuar nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja.

6. Në zbatim të dispozitave të këtij kreu, Komisioni i Pavarur *Ad Hoc* miraton rregulla për detajimin e mëtejshëm të kritereve dhe për caktimin e peshës specifike të tyre në renditjen e kandidatëve.

7. Në marrjen e vendimeve për renditjen e kandidatëve komisioni vepron sipas kritereve të parashikuara në pikat 1 deri në 5, të këtij neni, dhe harton një raport ku arsyeton renditjen e kandidatëve.

Neni 133
Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve

1. Kryetari i Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante. Lista me emrat e renditur të kandidatëve dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, si dhe raporti i vlerësimit regjistrohen në regjistrin e protokollit të Kuvendit. Asaj i bashkëngjiten kopjet origjinale, ose të noterizuara, të dokumentacionit të çdo kandidati, së bashku me inventarin e dosjes së tij.

2. Rregullat e parashikuara në nenin 35, të këtij ligji, nga pika 2 deri në pikën 19, zbatohet edhe për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve.

NËNSEKSIONI III
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Neni 134
Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës

1. Kuvendi zgjedh 2 anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

2. Kandidatët e propozuar, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale si jurist;

c) në kohën e kandidimit, të jenë pedagogë me kohë të plotë jo më pak se 5 vjet në fakultetin e drejtësisë të një institucioni të arsimit të lartë ose pedagogë të brendshëm ose pedagogë të jashtëm jomagjistratë në Shkollën e Magjistraturës;

ç) të jenë personel akademik të kategorisë "profesor" ose "lektor";

d) në kohën e kandidimit, të mos jenë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;

dh) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

e) të mos kenë qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ë) të mos kenë mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;

f) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

g) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve inteligjente;

gj) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

3. Secili prej institucioneve të arsimit të lartë, që kanë në përbërje të tyre si njësi kryesore fakultete të drejtësisë të akredituara sipas rregullave të legjislacionit në fuqi, përzgjedh jo më shumë se 3 kandidatë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë, me kushtin që të mos jenë propozuar nga radhët e avokatëve ose nga radhët e organizatave të shoqërisë civile.

4. Shkolla e Magjistraturës përzgjedh jo më shumë se një kandidat nga radhët e pedagogëve me kohë të plotë, jomagjistrat në detyrë, dhe pedagogëve me kohë të pjesshme, me kushtin që të mos jenë magjistratë në detyrë, avokatë ose të punësuar me kohë të plotë në organizatat e shoqërisë civile.

5. Secili prej anëtarëve të personelit akademik të IAL-it, që plotëson kushtet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 3 pedagogëve nga personeli akademik me të drejtë vote, ka të drejtë të kandidojë.

6. Secili prej pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës që plotëson kushtet

e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 3 pedagogëve me të drejtë vote, ka të drejtë të kandidojë.

7. Rektori i IAL-it dhe Drejtori i Shkollës së Magjistraturës miratojnë formularët tip për dhënien e mbështetjes kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Formulari tip nënshkruhet nga anëtari i personelit akademik ose pedagogu i Shkollës së Magjistraturës me të drejtë vote që vendos të mbështesë kandidatin. Anëtari i personelit akademik ose pedagogu i Shkollës së Magjistraturës me të drejtë vote mund të mbështesë vetëm një kandidat.

8. Të gjithë anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë, përfshirë edhe personelin e kategorisë "asistent lektor", dhe të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesshme që nuk janë magjistratë në detyrë të Shkollës së Magjistraturës, kanë të drejtë të mbështesin kandidatë dhe të votojnë për përzgjedhjen e kandidatëve nga institucionet përkatëse.

Neni 135
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall vendet vakante në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme.

2. Jo më vonë se 7 ditë nga shpallja e vendeve vakante, rektori i institucionit të arsimit të lartë që ka fakultet drejtësie dhe Drejtori i Shkollës së Magjistraturës shpallin thirrjet për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga anëtarët e personelit akademik dhe nga pedagogët e Shkollës së Magjistraturës që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 134, pika 2, të këtij ligji.

3. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të IAL-it, të fakulteteve të drejtësisë, të Shkollës së Magjistraturës dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve të personelit akademik dhe secilit prej pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës në adresën elektronike.

4. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare dhe elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet që duhet të shoqërojnë atë.

5. Mosshpallja e thirrjes në afatin ligjor përbën shkelje disiplinore për rektorin e IAL-it dhe Drejtorin e Shkollës së Magjistraturës.

Neni 136
Shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga Ministri i Drejtësisë

1. Në qoftë se, në përfundim të afatit të përmendur në pikën 2, të nenit 135, të këtij ligji, rektori i IAL-it, në përbërjen e të cilit ka fakultet drejtësie, ose Drejtori i Shkollës së Magjistraturës nuk kanë shpallur thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit, shpallja bëhet menjëherë nga Ministri i Drejtësisë.

2. Në këtë rast shpallja bëhet përmes njoftimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe i dërgohet në adresën elektronike secilit anëtar të personelit akademik të fakultetit të drejtësisë të IAL-it dhe secilit pedagog të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 137
Paraqitja dhe trajtimi i shprehjes së interesit

1. Brenda 15 ditëve nga shpallja e thirrjes për pranimin e shprehjeve të interesit, pedagogët e interesuar shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar, sipas rastit, dekanit të fakultetit ose Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës. Një kopje e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues, i dërgohet, sipas rastit, rektorit të IAL-it dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike ose postare të përmendur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit me letër të porositur ose në adresën elektronike zyrtare, sipas rastit, të dekanit të fakultetit, ose të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

c) formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;

ç) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë";

d) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimit sekret.

dh) çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 134 të këtij ligji.

Neni 138
Verifikimi i plotësimit të kritereve ligjore

1. Brenda 7 ditëve nga dita kur mbyllet afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit, dekanati i fakultetit të drejtësisë mblidhet në një mbledhje të posaçme për të verifikuar plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët.

2. Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore dhe i mbështetjes është çështja e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së dekanatit.

3. Mbledhja e dekanatit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve. Mosmarrja pjesë pa shkak të arsyeshëm në mbledhjen e dekanatit për verifikimin e kritereve ligjore dhe të mbështetjes për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë përbën shkelje disiplinore për anëtarët e dekanatit.

4. Mbledhja e dekanatit merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

5. Anëtarët e dekanatit, të cilët kandidojnë, nuk marrin pjesë në mbledhje dhe nuk votojnë. Në rastin e kandidimit të dekanit, detyrat e tij kryhen nga një prej zëvendësdekanëve.

6. Në përfundim të mbledhjes dekanati shpall zyrtarisht kandidaturat përmes afishimit në këndin e njoftimeve të universitetit ose të fakultetit të drejtësisë ose në një vend tjetër të dukshëm dhe i përcjell rektorit të IAL-it listën e kandidatëve të shoqëruar me një raport që shpjegon plotësimin ose mosplotësimin e kushteve nga secili kandidat.

7. Kandidatët e përjashtuar njoftohen menjëherë me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e skualifikimit.

8. Rregullat e parashikuara në pikat 1 deri në 7, të këtij neni, zbatohen edhe për verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore nga kandidatët e Shkollës së Magjistraturës. Në këtë rast, përgjegjësitë e parashikuara nga ky nen për dekanatin e fakultetit, ushtrohen nga mbledhja e Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës. Përgjegjësitë e parashikuara në pikën 6 të këtij neni për dekanin e fakultetit ushtrohen nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës. Lista me kandidatët i përcillet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 139
Ankimet kundër vendimeve të përjashtimit

1. Ankimet kundër vendimeve të dekanatit ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës për përjashtimin e kandidatëve për shkelje të rënda procedurale bëhen përkatësisht pranë rektorit të IAL-it dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit.

2. Rektori i IAL-it dhe Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës vendosin brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit.

Neni 140
Përzgjedhja e kandidatëve nga fakultetet e drejtësisë dhe nga Shkolla e Magjistraturës

1. Jo më vonë se 80 ditë para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në detyrë, dekani i secilit fakultet thërret mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik për të përzgjedhur kandidatët e atij fakulteti. Dekani i fakultetit të drejtësisë njofton menjëherë dhe zyrtarisht rektorin e IAL-it për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik.

2. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik të fakultetit për përzgjedhjen e kandidatit bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të IAL-it, si dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve të personelit akademik në adresën elektronike.

3. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik të fakultetit për përzgjedhjen e kandidatit tregon datën, vendin dhe orën e mbledhjes.

4. Përzgjedhja e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është pika e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik.

5. Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

6. Mosthirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik në afatin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, përbën shkelje disiplinore për dekanin e fakultetit.

7. Rregullat e parashikuara në pikat 1 deri në 6, të këtij neni, për përzgjedhjen e kandidatëve nga fakultetet ose departamentet e drejtësisë, zbatohen edhe për përzgjedhjen e kandidatëve nga Shkolla e

Magjistraturës. Në këtë rast, përgjegjësitë e parashikuara nga ky nen për dekanin e fakultetit ushtrohen nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës. Përgjegjësitë e parashikuara nga ky nen për Asamblenë e Personelit Akademik ushtrohen nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës.

Neni 141
Kuorumi

1. Pjesëmarrja në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik ose Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është e detyrueshme.

2. Mbledhja e Asamblesë së Personelit Akademik ose e Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës për përzgjedhjen e kandidatëve zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

3. Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

Neni 142
Procesi i votimit

1. Votimi për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Asambleja e Personelit Akademik të fakultetit është i fshehtë dhe individual.

2. Procesi i votimit është i hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interesim për të ndjekur procesin. Vëzhguesit autorizohen paraprakisht nga rektori i IAL-it.

3. Për administrimin e procesit të votimit krijohet një komision votimi, i përbërë nga anëtarë të personelit akademik që nuk kandidojnë. Komisioni i votimit ndihmohet në ushtrimin e funksioneve të tij nga administrata e fakultetit.

4. Ministri i Drejtësisë, 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, rektori i IAL-it ose persona të autorizuar prej tyre, mund të marrin pjesë si vëzhgues në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit në nivel fakulteti pa autorizim paraprak.

5. Jo më vonë se 2 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik, rektori i IAL-it miraton fletën tip të votimit, e cila

përmban emrat e kandidatëve të regjistruar.

6. Përpara fillimit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit shumëfishojnë dhe nënshkruajnë paraprakisht një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e anëtarëve të asamblesë së personelit akademik që janë të pranishëm. Në rast të dëmtimit të një ose disa fletëve të votimit, komisioni nënshkruan një numër fletësh votimi të barabartë me fletët e dëmtuara dhe shkatërron në praninë e pjesëmarrësve fletët e dëmtuara.

7. Secili prej anëtarëve të asamblesë së personelit akademik tërheq një fletë votimi, e plotëson atë në dhomën e fshehtë të votimit dhe e hedh në kutinë e votimit. Vota quhet e vlefshme kur ajo shpreh qartë vullnetin për të mbështetur vetëm 1 kandidat.

8. Rregullat e parashikuara në pikat 1 deri në 7, të këtij neni, për procesin e votimit nga Asambleja e Personelit Akademik të fakultetit zbatohen edhe për procesin e votimit nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës. Në këtë rast, përgjegjësitë e parashikuara nga pikat 2 dhe 5, të këtij neni, për rektorin e IAL-it ushtrohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues. Në rastin e zgjedhjeve në Shkollën e Magjistraturës, krijohet një komision votimi, i cili zgjidhet me short nga anëtarët e Këshillit Pedagogjik. Komisioni i votimit ndihmohet në ushtrimin e funksioneve të tij nga administrata e Shkollës së Magjistraturës. Në rast pamundësie, anëtarët e komisionit të votimit zëvendësohen nga anëtarë të tjerë të Këshillit Pedagogjik të zgjedhur me short.

9. Ministri i Drejtësisë ose persona të autorizuar prej tij dhe 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, mund të marrin pjesë si vëzhgues në mbledhjen e Këshillit Pedagogjik për përzgjedhjen e kandidatit të Shkollës së Magjistraturës pa autorizim paraprak të Kryetarit të Këshillit.

Neni 143
Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit

1. Në përfundim të procesit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit hapin kutinë në prani të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik që marrin pjesë në mbledhje. Njëri nga anëtarët e komisionit të votimit lexon me zë të lartë rezultatin e secilës fletë votimi dhe rezultatin e votimit.

2. Votat që gjykohen të pavlefshme rivlerësohen në fund të procesit të numërimit. Në rast mosmarrëveshjeje mes anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave, vendimet merren në fund të procesit të rivlerësimit me shumicën e votave. Votat që gjykohen të vlefshme në

fund të procesit të rivlerësimit u shtohen kandidatëve përkatës.

3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit;

b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;

c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;

ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;

d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;

dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

4. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave, anëtarët e komisionit të votimit hartojnë një procesverbal, i cili tregon numrin e pjesëmarrësve, të votave të hedhura, numrin e votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve të përzgjedhur. Rastet e mosmarrëveshjeve për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

5. Në përfundim të procesit të votimit quhen të përzgjedhur kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në qoftë se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash, fituesi përcaktohet me short midis tyre.

6. Procesverbali origjinal që tregon numrin e pjesëmarrësve në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, numrin e votave dhe rezultatin e numërimit të votave, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të votimit, i dërgohet menjëherë, sipas rastit, rektorit të IAL-it ose Kryetarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

7. Vendimet me rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve, çdo vendim i ndërmjetëm dhe procesverbali nënshkruhen nga anëtarët e komisionit të votimit. Vendimet njoftohen publikisht në përfundim të mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 144
Ankimet kundër vendimeve të Asamblesë së Personelit Akademik ose të Këshillit Pedagogjik

1. Ankimet për shkelje të procedurës që lidhen me thirrjen e mbledhjes, verifikimin e pjesëmarrjes, të votimit, numërimit të votave, të konstatimit dhe shpalljes e pavlefshmërisë dhe shpalljen e rezultatit gjatë mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik për IAL-et ose të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, bëhen pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Gjykata mund të vendosë përsëritjen e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik dhe të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës vetëm në qoftë se shkeljet procedurale të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vërtetohen se janë të tilla që kanë ndikuar ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Në rast se Gjykata Administrative e Apelit vendos përsëritjen e zgjedhjeve, ato zhvillohen jo më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Neni 145
Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik nga Rektori i IAL

1. Në qoftë se në përfundim të afatit të përmendur në nenin 140, pika 1, të këtij ligji, dekani i fakultetit të drejtësisë nuk ka thirrur mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrja e mbledhjes bëhet nga rektori i IAL-it.

2. Në këtë rast, thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Personelit Akademik për përzgjedhjen e kandidatit bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të IAL-it, si dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve të personelit akademik në adresën elektronike.

3. Mosthirrja e mbledhjes përbën shkelje disiplinore për dekanin e fakultetit të drejtësisë.

Neni 146
Thirrja e mbledhjes së posaçme të drejtuesve të institucioneve për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve

1. Jo më vonë së 60 ditë para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit thërret një mbledhje të posaçme, në të cilën marrin pjesë Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, rektorët e IAL-ve që ofrojnë programe studimi në drejtësi dhe dekanët e fakulteteve të drejtësisë ose drejtuesit e departamenteve të drejtësisë. Thirrja botohet në faqen zyrtare të Kuvendit dhe u dërgohet personalisht në adresën elektronike të gjithë subjekteve të sipërpërmendura.

2. Thirrja e mbledhjes së posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve tregon datën, vendin dhe orën e mbledhjes.

3. Zgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është pika e vetme në rendin e ditës së mbledhjes së posaçme.

4. Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e posaçme shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

5. Përpara votimit, kandidatët e përzgjedhur nga IAL-et dhe kandidatët e përzgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës paraqesin platformat e tyre përpara mbledhjes së posaçme.

6. Mbledhja e posaçme e drejtuesve të institucioneve kryen procedurë të përbashkët për të dy kategoritë e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rast të krijimit të vendeve vakante për Këshillat në të njëjtën kohë.

Neni 147
Kuorumi

1. Pjesëmarrja në mbledhjen e posaçme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është e detyrueshme.

2. Mbledhja e posaçme për zgjedhjen e kandidatëve zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

3. Numri i pjesëmarrësve në mbledhjen e posaçme shënohet në një listë emërore të nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

Neni 148
Procesi i votimit

1. Votimi për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga mbledhja e posaçme është i fshehtë dhe individual.

2. Mbledhja e posaçme voton për të gjithë kandidatët e përzgjedhur paraprakisht nga IAL-et dhe Shkolla e Magjistraturës.

3. Përfaqësuesit e IAL-ve publike dhe të Shkollës së Magjistraturës votojnë për kandidatët nga IAL-et publike dhe Shkolla e Magjistraturës. Përfaqësuesit e IAL-ve jopublike votojnë për kandidatët nga IAL-et jopublike.

4. Procesi i votimit është i hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interesim për të ndjekur procesin. Vëzhguesit autorizohen paraprakisht nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

5. Për administrimin e procesit të votimit krijohet një komision votimi, i përbërë nga trupa e pedagogëve të IAL-ve publike, jopublike dhe Shkollës së Magjistraturës që nuk kandidojnë. Komisioni i votimit ndihmohet në punën e tij nga administrata e Kuvendit.

6. Ministri i Drejtësisë ose persona të autorizuar prej tij dhe 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, mund të marrin pjesë si vëzhgues në procesin e votimit pa autorizim paraprak.

7. Jo më vonë se 2 ditë përpara datës së mbledhjes së posaçme, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit miraton 2 tipa fletësh votimi. Njëra fletë tip përmban emrat e të gjithë kandidatëve të propozuar nga IAL-et publike dhe nga Shkolla e Magjistraturës. Fleta tjetër përmban emrat e të gjithë kandidatëve të propozuar nga IAL-et jopublike.

8. Përpara fillimit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit shumëfishojnë dhe nënshkruajnë paraprakisht një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e anëtarëve të pranishëm. Në rast të dëmtimit të një ose disa fletëve të votimit, komisioni nënshkruan një numër fletësh votimi të barabartë me fletët e dëmtuara dhe shkatërron në praninë e pjesëmarrësve fletët e dëmtuara.

9. Secili prej pjesëmarrësve tërheq një fletë votimi, e plotëson atë në dhomën e fshehtë të votimit dhe e hedh në kutinë e votimit. Vota quhet e vlefshme kur ajo shpreh qartë vullnetin për të mbështetur vetëm 1 kandidat.

Neni 149
Numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit

1. Në përfundim të procesit të votimit, anëtarët e komisionit të votimit hapin kutinë në prani të të gjithë pjesëmarrësve në mbledhje. Njëri nga anëtarët e komisionit të votimit lexon me zë të lartë rezultatin e secilës fletë votimi dhe rezultatin e votimit.

2. Votat që gjykohen të pavlefshme rivlerësohen nga komisioni i votimit në fund të procesit të numërimit. Në rast mosmarrëveshjeje mes anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave, vendimet merren në fund të procesit të rivlerësimit me shumicën e votave. Votat që gjykohen të vlefshme në fund të procesit të rivlerësimit u shtohen kandidatëve përkatës.

3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga komisioni i votimit;

b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;

c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;

ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;

d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;

dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

4. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave, anëtarët e komisionit të votimit hartojnë një procesverbal, i cili tregon numrin e votave të hedhura, numrin e votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla, numrin e votave për secilën kategori kandidatësh, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve të përzgjedhur. Rastet e mosmarrëveshjeve për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

5. Quhen të përzgjedhur 7 kandidatët nga IAL-et publike ose Shkolla e Magjistraturës dhe 3 kandidatët nga IAL-et jopublike që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në qoftë se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash, fituesi përcaktohet me short midis tyre. Në qoftë se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm nga IAL-et jopublike për të plotësuar kuotat e parashikuara në këtë pikë, vendet e mbetura bosh plotësohen nga kandidatët e IAL-ve publike.

6. Vendimi për shpalljen e kandidaturave shpallet në faqen zyrtare të Kuvendit.

7. Procesverbali origjinal që tregon numrin e pjesëmarrësve në mbledhjen e posaçme të rektorëve dhe dekanëve dhe rezultatin e numërimit të votave, i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të votimit, i përcillet zyrtarisht Kuvendit.

8. Krahas listës me emrat e kandidatëve të përzgjedhur, mbledhja e posaçme harton një raport të vlerësimit të shkallës së përmbushjes së kritereve etike e profesionale të kandidatëve. Vlerësimi i kritereve etike dhe profesionale të kandidatëve bëhet duke zbatuar, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, kërkesat e nenit 132 të këtij ligji.

Neni 150
Ankimet kundër vendimeve të mbledhjes së posaçme

1. Ankimet për shkelje të procedurës, që lidhen me thirrjen e mbledhjes, verifikimin e pjesëmarrjes, të votimit dhe numërimit të votave, të konstatimit dhe shpalljes së votave të pavlefshme dhe të shpalljes së rezultatit gjatë mbledhjes së posaçme, bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Kuvendit.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Gjykata mund të vendosë përsëritjen e mbledhjes së posaçme vetëm në qoftë se shkeljet procedurale të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vërtetohen dhe janë të tilla që kanë ndikuar ose mund të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Në rast se Gjykata Administrative e Apelit vendos përsëritjen e zgjedhjeve, ato zhvillohen jo më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Neni 151
Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës

1. Kandidatët e përzgjedhur nga mbledhja e posaçme, sipas parashikimeve të nenit 146 dhe raporti i vlerësimit, sipas nenit 149, pika 8 të këtij ligji, i përcillen Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit në një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante. Lista dhe raporti i vlerësimit regjistrohen në regjistrin e protokollit të

Kuvendit. Asaj i bashkëngjiten kopjet origjinale, ose të noterizuara, të dokumentacionit të çdo kandidati, së bashku me inventarin e dosjes së tij.

2. Rregullat e parashikuara në nenin 35, nga pika 2 deri në pikën 19, të këtij ligji, zbatohen edhe për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës.

NËNSEKSIONI IV
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE

Neni 152
Zgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që përfaqëson shoqërinë civile dhe kushtet për t'u zgjedhur

1. Kuvendi zgjedh 1 anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, të regjistruara sipas legjislacionit përkatës, të cilat punojnë në fushën e sistemit të drejtësisë ose të të drejtave të njeriut dhe që kanë zbatuar projekte në këtë fushë të paktën 5 vitet e fundit.

2. Kandidatët nga shoqëria civile duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave", ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të kenë marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) të kenë të paktën 15 vite përvojë pune në profesion si jurist;

ç) të kenë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut;

d) në kohën e kandidimit të jenë të punësuar ose të angazhuar për të paktën 5 vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme pa ndërprerje, në një organizatë të shoqërisë civile për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut.

dh) në kohën e kandidimit të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit për të paktën 2 vjet, me përjashtim të atyre

të angazhuar në organizata ose klinika që ofrojnë ndihmën ligjore falas për funksion të organizatës;

e) të mos jenë kandidatë të propozuar nga avokatia ose trupa e pedagogëve të drejtësisë;

ë) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike, gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit;

g) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të shërbimeve të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

gj) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;

h) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

3. Përfaqësuesit nga radhët e organizatave të shoqërisë civile japin dorëheqjen nga çdo pozicion drejtues ose zbatues në këto organizata, nëse zgjidhen anëtarë të Këshillit të Lartë Prokurorisë.

4. Ka të drejtë të kandidojë çdo anëtar i organizatës së shoqërisë civile që plotëson kushtet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe që siguron mbështetjen e së paku 3 organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit miraton formularin tip për dhënien e mbështetjes kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga shoqëria civile. Formulari tip nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i secilës prej organizatave të shoqërisë civile, të cilat vendosin të mbështesin një koleg.

Neni 153
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarit

nga shoqëria civile në Këshillin e Lartë të Prokurorisë në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga kandidatët e shoqërisë civile që janë të interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit.

2. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Kuvendit.

3. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare dhe elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet që duhet të shoqërojnë atë.

Neni 154
Paraqitja dhe shqyrtimi i shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e thirrjes për pranimin e shprehjeve të interesit, anëtarët e shoqërisë civile shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar Avokatit të Popullit.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike ose postare të shprehur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin, të paktën, dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

c) formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

ç) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

d) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;

dh) çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 152, pika 2, të këtij ligji.

4. Emrat e kandidatëve nga shoqëria civile dhe kopjet origjinale, ose të

noterizuara, të dokumentacionit të paraqitur prej tyre regjistrohen në regjistrin e protokollit të Avokatit të Popullit.

5. Zyra e protokollit të Avokatit të Popullit merr në dorëzim shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatëve dhe u jep atyre një vërtetim shkresor për dorëzimin e shprehjes së interesit dhe të dokumentacionit shoqërues.

6. Avokati i Popullit, brenda 5 ditëve nga regjistrimi i kandidatëve dhe i dokumentacionit shoqërues, verifikon nëse dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët është i plotë. Nëse dokumentacioni i kandidatit nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të kritereve profesionale e morale, sipas nenit 152, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, Avokati i Popullit i kërkon kandidatit që brenda 5 ditëve të bëjë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë i dërgohet kandidatit në adresën elektronike të deklaruar, brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit nga Avokati i Popullit.

7. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor nuk pezullon procesin e regjistrimit përfundimtar të kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues të tyre. Në këtë rast, vlerësimi i kandidatit bëhet mbi dokumentacionin e dosjes së depozituar dhe administruar nga Avokati i Popullit.

8. Data në të cilën plotësohet dokumentacioni i kërkuar, ose afati i përcaktuar për plotësimin, konsiderohet dita e paraqitjes dhe regjistrimit të kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues në Institucionin e Avokatit të Popullit. Paraqitja përfundimtare dokumentohet me një numër regjistrimi nga zyra e protokollit tek Avokati i Popullit.

9. Avokati i Popullit, jo më vonë se 10 ditë nga dita e regjistrimit të kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues, sipas pikës 5, të këtij neni, merr në shqyrtim dhe verifikon përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të çdo kandidature, të parashikuara në Kushtetutë dhe në nenin 54, të këtij ligji, me anë të një procesi të hapur edhe publik.

10. Brenda 3 ditëve nga dita e shpalljes së njoftimit për dorëzimin e shprehjeve të interesit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga shoqëria civile, Avokati i Popullit publikon thirrjen për shprehje interesi për anëtar të komisionit të shoqërisë civile për verifikimin paraprak nga organizatat e shoqërisë civile, sipas përcaktimit të nenit 152, pika 1, të këtij ligji. Thirrja publikohet në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit, si dhe në një nga gazetat me tirazhin më të lartë. Njoftimi u dërgohet të

gjitha organizatave të shoqërisë civile në adresat e elektronike të tyre zyrtare. Shprehja e interesit duhet të paraqitet nga organizatat e shoqërisë civile brenda 7 ditëve dhe duhet të përmbajë dokumentacionin përkatës që vërteton plotësimin e kritereve që parashikohen në nenin 54, pika 1, të këtij ligji, dhe ato të parashikuara në këtë pikë.

11. Avokati i Popullit verifikon brenda 10 ditëve plotësimin e kritereve nga organizatat që kanë shprehur interesin për të qenë pjesë e komisionit të verifikimit paraprak të shoqërisë civile. Në rast se më shumë se 5 organizata që kanë shprehur interesin plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 10, të këtij neni, mbledhja e parë e këtij komisioni përzgjedh me votim të fshehtë organizatat që do të jenë anëtare të këtij komisioni. Pesë organizatat që do të marrin më shumë vota, konsiderohen të përzgjedhura si anëtare të komisionit të shoqërisë civile. Në rast të barazimit të votave, votimi përsëritet midis organizatave me vota të njëjta.

12. Kryetari i komisionit të shoqërisë civile për verifikimin paraprak zgjidhet nga vetë komisioni. Organizata e shoqërisë civile do të përfaqësohet nga përfaqësuesi i saj ligjor. Anëtari zëvëndësues i këtij komisioni është zëvendësi i tij me autorizim nga përfaqësuesi ligjor.

13. Mosushtrimi i kompetencave, sipas këtij ligji, nga Avokati i Popullit brenda afateve të përcaktuara përbën shkelje disiplinore dhe në çdo rast është Kryetari i Këshillit të Emërimeve të Drejtësisë që ushtron kompetencat e parashikuara në këtë nen brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar për Avokatin e Popullit në këtë ligj.

14. Në rastet e konfliktit të interesit, papajtueshmërisë ose heqjes dorë të anëtarit të komisionit, rregullimet ligjore të parashikuara në nenet 126 dhe 127, të këtij ligji, do të aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

15. Komisioni i shoqërisë civile kryen procedurë të përbashkët për verifikimin paraprak të dy kategorive të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në rast të krijimit të vendeve vakante për Këshillat në të njëjtën kohë.

Neni 155
Verifikimi paraprak i plotësimit të kushteve ligjore nga komisioni i shoqërisë civile pranë Avokatit të Popullit

1. Komisioni i shoqërisë civile për verifikimin paraprak verifikon nëse kandidatët e shoqërisë civile për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë i plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, sipas parashikimeve të nenit 152 të këtij ligji.

2. Me përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak, komisioni i shoqërisë civile bën menjëherë publike emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit dhe atë të Kuvendit. Komisioni i shoqërisë civile u komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit të plotësimit ose jo të kushteve ligjore, si dhe shkaqet e përjashtimit të tyre.

3. Ankimet kundër vendimit për përjashtimin e kandidatëve vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kontestuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga komisioni i shoqërisë civile, sipas këtij neni.

4. Komisioni i shoqërisë civile bën verifikimin paraprak të kritereve profesionale dhe morale dhe i rendit në listë, sipas parashikimeve të nenit 132 të këtij ligji. Komisioni i shoqërisë civile organizon seancë publike me secilin kandidat që plotëson kriteret formale ligjore. Kandidatët nëpërmjet seancës publike shpalosin platformën e tyre. Procesi i dëgjesave publike është i hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit e tjerë që shprehin interes për të ndjekur procesin.

5. Anëtarët e komisionit të shoqërisë civile votojnë në mënyrë individuale dhe të fshehtë për mënyrën e renditjes së kandidatëve.

6. Komisioni i shoqërisë civile e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale, për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

Neni 156
Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile

1. Kryetari komisionit të shoqërisë civile i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit një listë me emrat e jo më shumë se 10 kandidatëve që kanë marrë më shumë pikë, por në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante. Lista dhe raporti i vlerësimit regjistrohen në regjistrin e protokollit të Kuvendit të Shqipërisë. Listës i bashkëngjitet një kopje origjinale, ose e noterizuar, e dokumentacionit të çdo kandidati të përzgjedhur, së bashku me inventarin e dosjes së tij.

2. Rregullat e parashikuara në nenin 35, të këtij ligji, nga pika 2 deri në

pikën 19, zbatohet edhe për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile.

KREU II
ORGANIZIMI DHE MBLEDHJA E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

SEKSIONI 1
ORGANIZIMI I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Neni 157
Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë
(*Ndryshuar shkronja (dh) pika 3 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Kryetari dhe Zëvëndëskryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhen në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve joprokurorë me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve. Ata qëndrojnë në detyrë deri në përfundim të mandatit si anëtar i Këshillit.

2. Kryetari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

3. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) është përgjegjës për mirëfunksionimin e Këshillit dhe zbatimin me efiçencë të detyrave të tij, në përputhje me ligjin;

b) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjen e Këshillit;

c) mbikëqyr dhe drejton administratën e Këshillit;

ç) përfaqëson Këshillin në marrëdhëniet me të tretët;

d) siguron bashkëpunimin me institucionet e tjera;

dh) raporton para Kuvendit për gjendjen në prokurori dhe merr masat për publikimin e raportit;

e) propozon kryetarët e komisioneve të përhershme dhe cakton kryetarët e komisioneve të përkohshme të Këshillit;

ë) ushtron çdo detyrë tjetër që i jepet me ligj.

Neni 158
Zëvendëskryetari

Zëvendëskryetari ushtron të gjitha kompetencat e Kryetarit në mungesë dhe në pamundësi të këtij të fundit, si dhe në rastet e pamundësisë së përkohshme të Kryetarit.

Neni 159
Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë
(*Shfuqizuar me Vendimin e GJK nr. 41/ 2017; Ndryshuar me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen plenare ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;

b) vendos masa disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;

c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;

d) propozon dhe administron buxhetin e tij;

dh) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e prokurorisë;

e) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me ndikim të përgjithshëm detyrues për të gjithë prokurorët;

ë) miraton aktet për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit;

f) miraton Kodin e Etikës së Këshillit;

g) shqyrton, sipas rastit, vendimet e komisioneve;

gj) miraton udhëzime jodetyruese;

h) miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e administratës së Këshillit;

i) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për funksionimin e tyre.

3. Në mbledhjen plenare marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose komisionit për çështje të mëposhtme të rendit të ditës:

a) në rast vendimi për çështje disiplinore, kur anëtari ka paraqitur tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor;

b) nëse si anëtar i komisionit ka marrë vendim për një çështje disiplinore, të parashikuar në pikën 13, të nenit 160, të këtij ligji.

4. Komisionet kryejnë veprimtari të tjera në përputhje me rregulloren e brendshme.

Neni 160
Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë veprimtarinë dhe marrin vendime në fushat e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të kësaj të fundit, sipas nenit 159 të këtij ligji.

2. Pasi zgjedh Kryetarin, Këshilli merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues. Në çdo rast një anëtar prokuror mund të zëvendësohet vetëm nga një anëtar tjetër prokuror. Një anëtar joprokuror mund të zëvendësohet vetëm nga një anëtar tjetër joprokuror. Procedura dhe kritere më të hollësishme për marrjen e këtij vendimi rregullohen nga Këshilli.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka në përbërje komisionet e përhershme si më poshtë:

a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit;

b) Komisioni Disiplinor;

c) Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale;

ç) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

4. Çdo komision përbëhet nga tre anëtarë. Pranë çdo komisioni caktohen edhe 2 anëtarë zëvendësues. Caktimi i anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të komisioneve bëhet duke mbajtur parasysh nevojën për të

garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës dhe respektimin e kërkesave dhe të raporteve midis anëtarëve prokurorë dhe joprokurorë, të parashikuara në pikat 5 deri në 12 të këtij neni.

5. Një anëtar i Këshillit mund të jetë anëtar në jo më shumë se 2 komisione të përhershme. Një anëtar i Këshillit nuk mund të jetë kryetar në më shumë së 1 komision të përhershëm. Ky rregull nuk zbatohet për anëtarët zëvendësues dhe për komisionet *ad hoc*.

6. Komisionet zgjedhin kryetarët përkatës në mbledhjen e tyre të parë me shumicë votash dhe bazuar në propozimin e Kryetarit të Këshillit. Kryetari i Këshillit është kryetar i komisioneve ku ai merr pjesë.

7. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

8. Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit përbëhet nga 2 anëtarë joprokurorë dhe 1 anëtar prokuror.

9. Komisioni Disiplinor përbëhet nga 2 anëtarë prokurorë dhe 1 anëtar joprokuror.

10. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale përbëhet nga 2 anëtarë prokurorë dhe 1 anëtar joprokuror.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përbëhet nga 2 anëtarë prokurorë dhe 1 anëtar joprokuror;

12. Anëtarët e komisioneve i ushtrojnë funksionet e tyre pranë komisioneve për dy vite e gjysmë nga dita e zgjedhjes. Në përfundim të kësaj kohe përbërja e komisioneve ndryshohet, sipas procedurës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

13. Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, krijohet një komision i përkohshëm, i përbërë nga 2 anëtarë joprokurorë dhe 1 anëtar prokuror. Përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit. Vendimet e komisionit të përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelohen para mbledhjes plenare të Këshillit.

14. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të krijojë komisione të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta.

15. Komisionet vendosin me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.

16. Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

Neni 161
Relatori

1. Në të gjitha rastet kur mbledhja plenare ose komisionet e tij shqyrtojnë dhe miratojnë akte administrative individuale, në lidhje me statusin profesional të prokurorëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës së prokurorisë, njëri nga anëtarët e komisionit shërben si relator.

2. Secili nga anëtarët e komisionit, përfshirë edhe kryetarin e komisionit, mund të jetë relator. Relatori caktohet me short duke marrë parasysh ngarkesën dhe aftësitë e secilit anëtar, sipas procedurës dhe rregullave më të hollësishme të miratuara nga Këshilli. Kryetari i Këshillit nuk mund të jetë relator.

3. Relatori kujdeset për zhvillimin e procedimit administrativ individual dhe sidomos për sa më poshtë:

a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga subjektet e procedurës administrative;

b) përgatitjen e projektaktit administrativ;

c) koordinimin me kryetarin e komisionit për përgatitjen e mbledhjes së komisionit;

ç) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

d) njoftimet për subjektet e procedimit administrativ.

4. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori ndihmohet nga personeli administrativ i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 162
Ekspertët

Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të angazhojë si ekspertë për çështje ose fusha të caktuara edhe prokurorët në detyrë. Prokurorët në detyrë i ofrojnë shërbimet e tyre vullnetarisht dhe pa pagesë.

Neni 163
E drejta për të kërkuar informacion

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik bashkëpunon me Këshillin e Lartë të Prokurorisë duke i vënë atij në dispozicion informacione ose dokumente, të cilat i nevojiten Këshillit për ushtrimin e funksioneve të tij.

2. Çdo organ publik, person fizik ose juridik, paraqitet ose dërgon përfaqësues në mbledhjet plenare ose të komisioneve të Këshillit për të paraqitur prova dhe dëshmuar në lidhje me çdo çështje që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

SEKSIONI 2
MBLEDHJA E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Neni 164
Thirrja e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mblidhet sa herë është e nevojshme, por jo më pak se 1 herë në muaj.

2. Kryetari i Këshillit vendos për datën dhe orarin e mbledhjeve.

3. Kryetari mund të thërrasë mbledhje të tjera kur ai vlerëson se ato janë të nevojshme për veprimtarinë e Këshillit.

4. Mbledhja e Këshillit mund të thirret edhe me kërkesën e jo më pak se 3 anëtarëve të Këshillit, të cilët përcaktojnë në kërkesë edhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Edhe në këtë rast Kryetari vendos datën dhe orarin e mbledhjes jo më vonë se 7 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

5. Kryetari siguron respektimin e procedurave për njoftimin me shkrim të çdo anëtari jo më vonë se 7 ditë përpara çdo mbledhjeje të Këshillit.

6. Njoftimi shoqërohet me rendin e ditës, projektvendimet që propozohet të merren gjatë mbledhjes, së bashku me çdo të dhënë, projektakt, këshillë ligjore, si dhe çdo informacion apo dokument tjetër, i cili do të merret në shqyrtim në mbledhje, apo i cili i shërben diskutimeve në mbledhje.

7. Rregullat e parashikuara në pikën 6, të këtij neni, nuk përbëjnë pengesë për të miratuar kërkesa për ndryshimin e përmbajtjes së një projektvendimi që shoqëron rendin e ditës.

8. Çdo vendim i Këshillit që përbën akt administrativ individual, në

lidhje me statusin profesional të prokurorëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës, nënshkruhet nga çdo anëtar i pranishëm në mbledhje, siç është rënë dakord. Refuzimi i një anëtari për të nënshkruar përmbajtjen e vendimit nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e aktit. Aktet e tjera nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit.

9. Në rastet ku Këshilli merr vendime administrative individuale, në lidhje me statusin profesional të prokurorëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës së prokurorisë, anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinioni i tij t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit.

Neni 165
Rendi i ditës

1. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë vendos rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit.

2. Një çështje e caktuar i shtohet rendit të ditës kur kjo i kërkohet me shkrim Kryetarit jo më vonë se 4 ditë përpara mbledhjes nga të paktën 3 anëtarë të Këshillit.

3. Nëse të paktën 6 anëtarë të pranishëm në një mbledhje të Këshillit vendosin se një çështje, e cila nuk ishte përfshirë në rendin e ditës, duhet të diskutohet, si dhe t'i jepet zgjidhje në mbledhje, çështja i shtohet rendit të ditës.

Neni 166
Kuorumi dhe vendimmarrja në Këshillin e Lartë Prokurorisë

1. Pjesëmarrja në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është e detyrueshme. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është kur në to marrin pjesë jo më pak se 7 anëtarë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur.

3. Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhje, nuk mund të heqë dorë nga votimi, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë pengesa ligjore të tilla si konflikti i interesit ose pengesa të tjera në zbatim të këtij ligji, të ligjit për konfliktin e interesave ose të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Administrata mban shënim e regjistron votat e anëtarëve të Këshillit.

5. Kryetari është anëtari i fundit, i cili voton në lidhje me një çështje.

6. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

7. Çdo anëtar i Këshillit mban përgjegjësi për votën dhe ka të drejtë të bëjë një deklarim të shkurtër me gojë ose me shkrim për arsyet e votimit.

Neni 167
Dokumentimi i mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Kryetari është përgjegjës për të siguruar që administrata të marrë të gjitha masat e nevojshme që çdo mbledhje plenare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes:

a) regjistrimit audio;

b) procesverbalit me përmbledhjen e diskutimeve.

2. Regjistrimi audio i mbledhjes plenare bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes. Përpara publikimit, nën përgjegjësinë e Kryetarit, administrata kujdeset për redaktimin e materialit, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të prokurorëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

3. Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit pasi miratohet nga mbledhja plenare pasardhëse e Këshillit. Edhe në këtë rast, nën përgjegjësinë e Kryetarit, administrata kujdeset për të fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të prokurorëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

4. Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Kryetarit, administrata mban procesverbalin me përmbledhjen e diskutimeve të çdo mbledhjeje, duke shënuar të paktën informacionet e mëposhtme:

a) anëtarët e pranishëm në diskutim për çdo çështje të rendit të ditës;

b) çështjet e rendit të ditës, përfshirë çështjet e shtuara, sipas nenit 165, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji;

c) dorëheqjet e anëtarëve të Këshillit dhe arsyetimet përkatëse;

ç) aspektet kryesore të çështjeve të diskutuara dhe propozimet për vendime;

d) rezultatin e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar; dhe

dh) vendimet.

5. Procesverbalet me draftin e përmbledhjes së diskutimeve të mbledhjes nënshkruhen nga Kryetari dhe u vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve brenda 5 ditëve nga dita e mbledhjes.

6. Çdo anëtar i Këshillit që ishte i pranishëm në mbledhje mund të vërë në dukje pasaktësi në përmbajtjen e procesverbalit të përmbledhur dhe t'i kërkojë Kryetarit, me anë të një kërkese me shkrim, korrigjimin e tij. Në qoftë se regjistrimi konfirmon pasaktësinë e zbardhjes, përmbledhja e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit korrigjohet në mënyrat e mëposhtme:

a) me urdhër të Kryetarit, bazuar në kërkesën e paraqitur, sipas pikës 6 të këtij neni;

b) me vendim të Këshillit në mbledhjen pasuese.

7. Administrata merr masat që regjistrimet audio të mbledhjeve të Këshillit dhe procesverbali i përmbledhur të ruhen për jo më pak se 10 vjet, në përputhje me ligjin "Për arkivat".

Neni 168
Zbatimi me analogji i rregullave për komisionet e Këshillit

1. Rregullimet e neneve 164 deri 167, të këtij ligji, për thirrjen e mbledhjes, rendin e ditës, kuorumin, vendimmarrjen dhe dokumentimin e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë zbatohen, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet përkatëse, edhe për mbledhjet e komisioneve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Këshilli i Lartë të Prokurorisë miraton rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e komisioneve.

Neni 169
Marrëdhënia e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Ministrin e Drejtësisë
(Shfuqizuar pika 5 me Vendimin nr. 41/2017 të Gjykatës Kushtetuese)

1. Ministri i Drejtësisë koordinon zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore dhe të strategjisë sektoriale të sektorit të drejtësisë. Ministri i Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e projektakteve ligjore në fushën e drejtësisë penale pasi ka marrë mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Ministri i Drejtësisë mund të paraqesë ankesë tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkelje disiplinore të pretenduara të prokurorëve, si dhe

mund të kërkojë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në Prokurorinë e Përgjithshme ose në zyrat e prokurorisë.

3. Ministri i Drejtësisë ose përfaqësues të tij mund të marrin pjesë si vëzhgues në Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të Asamblesë së Personelit Akademik dhe të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, mbledhjes së posaçme të drejtuesve të institucioneve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në mbledhjen e përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë bashkëpunon me Ministrin e Drejtësisë për të siguruar përputhjen e planeve strategjike dhe buxhetore të sistemit të prokurorisë, të miratuara nga Këshilli me politikat shtetërore dhe strategjinë sektoriale të sektorit të drejtësisë.

5. Ministri i Drejtësisë mund të ushtrojë të drejtat e mësipërme personalisht ose përmes një përfaqësuesi të autorizuar prej tij me shkrim.

6. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Ministri i Drejtësisë ka akses të plotë në të dhënat statistikore që rezultojnë nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të trajtuara nga zyrat e prokurorisë.

Neni 170
Bashkëpunimi ndërinstitucional i aktorëve të sistemit të drejtësisë

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të paktën 1 herë në vit, organizojnë mbledhje të përbashkëta për shkëmbimin e përvojave, për unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjeve, lidhur me ushtrimin e funksioneve dhe organizimit të tyre, si dhe të çështjeve të përgjithshme të lidhura me funksionimin e sistemit të drejtësisë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të dërgojë përfaqësues në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështje me interes të përbashkët dhe anasjelltas.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, të praktikës së punës dhe shkëmbimin e përvojës, lidhur me çështjet e statusit të magjistratëve.

4. Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës së Posaçme për gjykimin e veprave penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurori i Përgjithshëm ftohen të marrin pjesë në këto mbledhje të përbashkëta.

SEKSIONI 3
KONFLIKTI I INTERESAVE

Neni 171
Konflikti i interesit

Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhjen e komisionit ose në mbledhjen plenare, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, është i detyruar për sa më poshtë:

a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;

b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;

c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.

Neni 172
Papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim

Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një prokurori, si në komisionin disiplinor, ashtu dhe në mbledhjen plenare, kur ai ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen që është objekt i procedimit disiplinor, për shkak të cilësisë si gjyqtar, prokuror, inspektor, dëshmitar, përfaqësues i palëve, ekspert ose në çdo cilësi tjetër.

Neni 173
Papajtueshmëria për shkak lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie

Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një prokurori, për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, transferimin dhe komandimin e një prokurori dhe as të jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një prokurori, si dhe në çdo procedim tjetër administrativ që lidhet me statusin e një prokurori ose të funksionarëve të tjerë të sistemit, statusi i të cilëve administrohet nga Këshilli, në qoftë se midis tyre ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme:

a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese;

b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; ose

c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerk.

Neni 174
Heqja dorë

1. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një prokurori, për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, transferimin ose komandimin e një prokurori, të mos jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një prokurori, si dhe të heqë dorë nga çdo procedim tjetër administrativ që lidhet me statusin e një prokurori ose të funksionarëve të tjerë të sistemit të prokurorisë, statusi i të cilëve administrohet nga Këshilli në rastet e mëposhtme:

a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet ose promovohet, transferohet ose komandohet, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën;

b) kur mbrojtësi a përfaqësuesi i subjektit të procedimit administrativ është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij;

c) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet apo promovohet, transferohet ose komandohet;

ç) kur ai ose ndonjë nga të afërmit e tij ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij është dëmtuar nga veprimet ose aktet e subjektit të procedimit, të cilat janë bërë shkas për fillimin e procedimit disiplinor;

d) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit/bashkëjetuesit ka bërë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesën, hetimi i së cilës ka çuar në fillimin e procedimit disiplinor.

2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep Kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

Neni 175
Përjashtimi i anëtarit
(*Ndryshuar pika 2 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Prokurori ose nëpunësi civil i proceduar ose përfaqësuesi i tij ligjor, ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative vetëm në fazën paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 174, të këtij ligji, dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes.

2. Vendimi për përjashtimin e një anëtari nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose komision merret nga Këshilli, sipas rregullave të parashikuara në nenin 171 të këtij ligji. Kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Këshillit, mbledhja kryesohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit.

SEKSIONI 4
ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Neni 176
Administrata e Këshillit

1. Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë funksionon administrata, e cila ndihmon në realizimin e misionit dhe të funksioneve të Këshillit.

2. Administrata e Këshillit drejtohet nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe raporton rregullisht tek ai.

3. Anëtarët e personelit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë statusin e nëpunësit civil, sipas përcaktimeve të ligjit "Për nëpunësin civil", ose janë prokurorë të komanduar pranë Këshillit, sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

4. Ligji "Për nëpunësin civil" zbatohet mbi personelin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

5. Nëpunësit civilë mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit ose të komisioneve, si dhe të kërkojnë fjalën pa të drejtë vote.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë punëson punonjës administrativë në bazë të rregullave të parashikuara në Kodin e Punës.

Neni 177
Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është funksionari më i lartë administrativ i Këshillit.

2. Sekretari i Përgjithshëm rekrutohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil".

3. Drejtuesi i njësisë për çështje të përgjithshme juridike zëvendëson Sekretarin e Përgjithshëm në rastet e mungesës ose pamundësisë së përkohshme të këtij të fundit.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit ose zëvendësuesi i tij kanë të drejtë të njihen me çdo dokument që shqyrtohet nga mbledhjet e komisioneve ose nga mbledhja e Këshillit, të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen e Këshillit, si dhe të propozojnë futjen e çështjeve që lidhen me aspekte administrative dhe të personelit në agjendat e tyre.

Neni 178
Organizimi i administratës

1. Administrata e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ndahet, së paku, në njësitë e mëposhtme:

a) njësi mbështetëse për çështje të përgjithshme juridike;

b) njësi mbështetëse pranë secilit komision të përhershëm të Këshillit;

c) njësi mbështetëse për administrimin e buxhetit të Këshillit;

ç) zyra e Këshilltarit të Etikës;

d) njësi mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet;

dh) njësi mbështetëse për teknologjinë e informacionit;

e) njësi mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë.

2. Në lidhje me administratën, Këshilli vendos për sa më poshtë:

a) strukturën e administratës dhe të secilës njësi;

b) krijimin e njësive të tjera organizative brenda administratës;

c) përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të të gjitha njësive organizative të administratës dhe të pozicioneve individuale;

ç) rregullat procedurale, sipas të cilave vepron administrata, në mënyrë të atillë që të sigurojë mbështetje efikase dhe efektive për Këshillin dhe komisionet e tij.

Neni 179
Konflikti i interesave

1. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit për konfliktin e interesave mbi paanësinë e administratës publike zbatohen për personelin administrativ të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Kryetari i Këshillit është përgjegjës për marrjen e vendimeve për përjashtimin nga vendimmarrja ose konfirmimin e nëpunësve civilë në rast të shfaqjes së konfliktit të interesit.

KREU III
FUNKSIONET E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Neni 180
Planifikimi strategjik

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në bashkëpunim me Ministrin e Drejtësisë, harton, miraton dhe zbaton një plan strategjik për sistemin e prokurorisë, në përputhje me objektivat e këtij ligji dhe në koordinim me strategjinë e sektorit të drejtësisë.

2. Plani strategjik, në përputhje kohore me strategjinë e sektorit të ministrisë, duhet:

a) të përcaktojë misionin dhe vlerat kryesore të prokurorisë;

b) të analizojë profilin e sistemit të prokurorisë;

c) të caktojë çështje strategjike;

ç) të përcaktojë prioritete;

d) të përcaktojë monitorimin, kuadrin vlerësues dhe raportues për strategjinë.

3. Plani strategjik duhet të shoqërohet me planin e veprimit, përfshirë objektivat operacionalë, veprimtaritë, ndikimin financiar dhe ndikime të tjera, si dhe treguesit e arritjeve.

Neni 181
Raportimi publik dhe para Kuvendit

1. Këshilli Lartë i Prokurorisë raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjatë vitit të mëparshëm kalendarik jo më pak se një herë në vit. Raporti përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij, si dhe përmban rekomandimet për përmirësimet e nevojshme.

2. Raporti i përcillet Kuvendit jo më vonë se data 1 maj e çdo viti. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Këshillit, si dhe me çdo mënyrë tjetër që vlerësohet e përshtatshme nga Këshilli.

3. Këshilli i përgjigjet kërkesës së Kuvendit për të paraqitur raportin dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me të.

4. Rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë të detyrueshme për t'u marrë parasysh nga Këshilli, për aq sa nuk cenojnë pavarësinë e këtij institucioni.

5. Këshilli raporton në çdo rast tjetër që e vlerëson të nevojshme ose me kërkesë të Kuvendit.

Neni 182
Etika e prokurorit

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për miratimin e standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes të prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre. Në veçanti Këshilli ushtron detyrat e mëposhtme:

a) bën publike standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve;

b) rishikon herë pas here rregullat dhe, kur është e nevojshme, i ndryshon ato;

c) analizon shkallën e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës dhe raporton publikisht për gjetjet.

2. Këshilli cakton një Këshilltar për Etikën nga radhët e prokurorëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë prokuror të Prokurorisë së Përgjithshme dhe që ka përvojë dhe njohuri mbi çështje të etikës. Këshilltari për Etikën shërben për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Për shkak të nevojave të punës, Këshilli mund të vendosë që Këshilltari për Etikën të shërbejë me kohë të plotë. Në këtë rast Këshilli ndjek

procedurën e komandimit për të caktuar Këshilltarin e Etikës.

4. Këshilltari për Etikën kryen detyrat e mëposhtme:

a) jep këshilla, me kërkesë të çdo prokurori, për sjelljen më të përshtatshme, brenda dhe jashtë prokurorisë ose gjykatës, për çështje të diskutueshme të etikës;

b) mund të kërkojë mendimin e Këshillit për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me sjelljen e prokurorëve në mënyrë të përgjithshme, por jo lidhur me persona të caktuar;

c) harton, publikon dhe përditëson vazhdimisht një manual informues, i cili përmban pyetje dhe përgjigje mbi dilemat etike, bazuar në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe vendimet relevante të Këshillit;

ç) kujdeset, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm mbi çështje të etikës;

d) raporton me shkrim, jo më pak se një herë në vit, përpara Këshillit lidhur me veprimtarinë e tij.

5. Paga e Këshilltarit për Etikën përcaktohet në bazë të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

6. Këshilltari për Etikën ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit, duke mos i dhënë asnjë informacion strukturave të organeve të qeverisjes së prokurorisë që ushtrojnë kompetenca inspektimi dhe vlerësimi.

7. Këshilli siguron mbështetjen e nevojshme me burime njerëzore dhe financiare për të mundësuar veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën.

Neni 183
Rekrutimi, emërimi i prokurorëve dhe propozimi i kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm

1. Këshilli Lartë i Prokurorisë bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për rekrutimin e kandidatëve për prokurorë, në pajtim me këtë ligj dhe ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe emëron prokurorët pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës.

2. Këshilli i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

3. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm

përcaktohen në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 184
Zhvillimi i karrierës dhe disiplina

Në zbatim të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për çështjet e mëposhtme, në lidhje me të gjithë prokurorët:

a) emërimin;

b) caktimin në pozicion;

c) transferimin;

ç) ngritjen në detyrë;

d) komandimin dhe riemërimin;

dh) vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale;

e) vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin;

ë) çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

Neni 185
Qëndrimet publike

Këshilli, me nismë ose bazuar në kërkesat e prokurorëve, mund të bëjë deklarata publike në mbrojtje të prokurorëve të veçantë kur gjykon se të drejtat e tyre njerëzore rrezikohen të shkelen për shkak të kryerjes së detyrës ose se kryerja e funksioneve të tyre ligjore po rrezikohet ose mund të rrezikohet si rezultat i veprimeve ose qëndrimeve të çdo subjekti publik ose privat.

Neni 186
Trajnimi vazhdues i prokurorëve

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe kryen detyrat e mëposhtme:

a) mban lidhje me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të prokurorëve;

b) këshillon Shkollën e Magjistraturës rreth programit të trajnimit vazhdues për prokurorët;

c) vendos mbi kërkesat e prokurorëve për trajnimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;

ç) monitoron dhe raporton publikisht në lidhje me efektivitetin e trajnimeve;

d) kryen çdo detyrë tjetër që i jepet me ligj në fushën e trajnimit të prokurorëve.

Neni 187
Opinione mbi legjislacionin

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin që mund të ndikojë në punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e Këshillit.

2. Në veçanti, Këshilli ushtron detyrat e mëposhtme:

a) shqyrton funksionimin e rregullave të procedurës gjyqësore penale;

b) bën rekomandime për ndryshimin e rregullave të procedurës gjyqësore penale;

c) jep përgjigje për kërkesat e ardhura nga ministrat për të dhënë mendim mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin e prokurorisë dhe të drejtësisë në përgjithësi;

ç) mund të japë mendim mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin e prokurorisë dhe atë të drejtësisë në përgjithësi, duke ia drejtuar një ministri ose ndonjë organi tjetër.

3. Këshilli i propozon Ministrit të Drejtësisë ushtrimin e nismës për ndryshime ligjore në lidhje me çdo çështje që është nën përgjegjësinë e tij.

Neni 188
Buxheti vjetor i Këshillit

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe sistemi i prokurorisë financohen nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

2. Buxheti vjetor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjislacionin përkatës.

KREU IV
AKTET DHE RREGULLAT PROCEDURALE

Neni 189
Aktet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në ushtrim të funksioneve të tij, nxjerr aktet e mëposhtme:

a) akte administrative individuale, në lidhje me statusin profesional të prokurorëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore;

b) akte administrative kolektive, në lidhje me statusin e të gjithë prokurorëve ose zyrtarëve të administratës gjyqësore;

c) akte normative nënligjore, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me efekt të përgjithshëm detyrues mbi të gjithë prokurorët, administratën e prokurorisë, personat privatë dhe organet publike;

ç) akte për miratimin e rregullave të brendshme procedurale. Në veçanti, rregullat procedurale mund të përfshijnë dispozita në lidhje me koordinimin e veprimtarisë së komisioneve, angazhimin e ekspertëve në punën e Këshillit, shpërndarjen dhe ndarjen e përgjegjësive të administratës së Këshillit, kuorumin e nevojshëm për mbledhjet e komisioneve, rregulla për publikimin e informacioneve për procedimet e Këshillit etj.;

d) udhëzime jodetyruese.

2. Në asnjë rast, Këshilli nuk mund të japë udhëzime në lidhje me zgjidhjen e një çështjeje konkrete ose të një grupi çështjesh;

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast apo situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.

Neni 190
Njoftimi dhe botimi i akteve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Njoftimi i akteve administrative individuale të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në lidhje me statusin e prokurorëve ose nëpunësve civilë të prokurorisë, bëhet në një ose disa nga format e mëposhtme:

a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;

b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;

c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.

2. Aktet administrative individuale të Këshillit, në lidhje me statusin e prokurorëve ose nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë, bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Njoftimi i akteve administrative kolektive, në lidhje me statusin e të gjithë prokurorëve ose nëpunësve civilë, bëhet nëpërmjet botimit në faqen zyrtare të Këshillit. Këto akte hyjnë në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit.

4. Aktet normative nënligjore botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit dhe në Fletoren Zyrtare. Ato hyjnë në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare. Nëse akti normativ nënligjor ndryshon një akt tjetër, akti i ndryshuar botohet në formë të konsoliduar në faqen zyrtare të Këshillit.

5. Ky nen zbatohet edhe për aktet e nxjerra nga komisionet e Këshillit.

Neni 191
Procedura e rishikimit

1. Në rastet kur një akt administrativ individual është nxjerrë nga komisioni, subjektet e interesuara kanë të drejtë të kërkojnë anulimin, ndryshimin ose plotësimin nga mbledhja plenare e Këshillit.

2. Kërkesa për rishikim bëhet me shkrim. Ajo dorëzohet jo më vonë se 10 ditë nga dita e njoftimit të palës së interesuar, në përputhje me kërkesat e këtj neni.

3. Kërkesa mund të bazohet në arsyet e mëposhtme:

a) vendimi është bazuar në gabime materiale dhe të faktit;

b) ka ndodhur një gabim i rëndë procedural.

4. Kërkuesi nuk mund të paraqesë pretendime ose fakte të reja gjatë shqyrtimit të çështjes nga mbledhja plenare e Këshillit, me përjashtim të rasteve kur subjekti i interesuar provon se nuk ishte dhe nuk mund të ishte në dijeni të këtyre fakteve më parë.

5. Mbledhja plenare e Këshillit shqyrton dhe vendos mbi të gjitha kërkesat brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes.

6. Kërkesa nuk pranohet nëse ajo nuk është paraqitur brenda afatit dhe në formën e kërkuar sipas këtij ligji. Kërkuesit njoftohen për mospranimin dhe shkaqet e mospranimit të kërkesës së tyre për rishikim.

7. Këshilli i zhvillon mbledhjet me dyer të mbyllura. Përjashtimisht Këshilli mund të zhvillojë dëgjesa me subjektet e procedimit kur kjo është e nevojshme, si rezultat i fakteve të reja, sipas pikës 4 të këtij neni.

8. Në bazë të konkluzionit të shqyrtimit të kërkesës për rishikim Këshilli duhet të përcaktojë nëse kërkesa për rishikim duhet të pranohet ose të rrëzohet. Në rast pranimi, Këshilli miraton një vendim administrativ të ndryshuar. Ndryshimet mund të bëhen vetëm për aq sa kërkohen nga subjekti i interesuar.

9. Këshilli mund të anulojë një akt administrativ individual edhe me nismën e tij kur vërtetohen kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

Neni 192
Ankimi i vendimeve të Këshillit
(*Ndryshuar fjalia e parë pika 1 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese.

2. Aktet administrative me efekt të përgjithshëm detyrues i nënshtrohen kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe kontrollit të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me ligjin.

PJESA IV
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 193
Objekti i kreut

Ky kre përcakton parimet, procedurat dhe rregullimet e nevojshme për

ushtrimin e funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, statusin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe statusin e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 194
Objekti i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

2. Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Inspektori vihet në lëvizje bazuar në:

a) ankimin me shkrim çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar;

b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë;

c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm;

ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore;

dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.

3. Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Neni 195
Zbatimi i ligjeve të tjera

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë udhëhiqet nga parimet dhe ndjek procedurat e parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Neni 196
Pavarësia

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur.

2. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në funksionet e Inspektorit për kryerjen e verifikimeve të ankesave, hetimeve dhe inspektimeve, ose në lidhje me ndonjë subjekt të caktuar shkakton përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 197
Buxheti dhe struktura e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është person juridik publik, i cili ka buxhetin e vet të pavarur, i cili është pjesë e Buxhetit të Shtetit të miratuar nga Kuvendi.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përgatit projektbuxhetin e Zyrës së Inspektorit dhe ia paraqet atë Këshillit të Ministrave. Në rastet kur projektbuxheti i Zyrës së Inspektorit që paraqitet nga Këshilli i Ministrave në Kuvend është i ndryshëm nga projektbuxheti i propozuar nga Inspektori i Lartë, projektbuxheti i propozuar nga Inspektori i vihet në dispozicion Kuvendit. Inspektori i Lartë ka të drejtë të marrë pjesë në procedurat parlamentare për të mbrojtur projektbuxhetin e propozuar prej tij.

3. Në buxhetin e Zyrës së Inspektorit mund të përfshihen edhe të ardhura të tjera, përfshirë edhe fonde nga donatorët, me kushtin që të mos ketë konflikt interesi midis dhuruesit dhe veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit.

4. Organizimi, struktura dhe numri i punonjësve të Zyrës së Inspektorit përcaktohen nga Kuvendi, me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KREU II
STATUSI I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Neni 198
Inspektori i Lartë i Drejtësisë

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është drejtuesi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ai ka pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron funksionet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 199
Kushtet e emërimit

1. Inspektor i Lartë i Drejtësisë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave", ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;

ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;

d) nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

ë) nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

2. Këshilli për Emërimet në Drejtësi i rendit kandidatët për postin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, në bazë të kritereve objektive të parashikuara në nenin 240 të këtij ligji.

Neni 200
Papajtueshmëritë

Funksioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është i papajtueshëm me:

a) çdo funksion tjetër publik;

b) çdo veprimtari tjetër profesionale, që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademike dhe shkencore;

c) anëtarësimin në një parti politike ose pjesëmarrjen në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike;

ç) çdo pozicion drejtues ose anëtarësi në organet drejtuese të organizatave fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizatë tjetër, me përjashtim të angazhimit në organizata, i cili diktohet për shkak të funksionit;

d) çdo veprimtari private, në kuadrin e subjekteve tregtare, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, si dhe profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën "ç" të këtij neni;

dh) çdo veprimtari tjetër që, sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", është e papajtueshme me detyrën e magjistratit.

Neni 201
Përzgjedhja dhe zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga Kuvendi nga radhët e kandidatëve të përzgjedhur dhe të renditur nga Këshilli për Emërimet në Drejtësi.

2. Këshilli për Emërimet në Drejtësi përzgjedh kandidatët për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas rregullave të mëposhtme:

a) Këshilli për Emërimet shpall publikisht vendin vakant, duke

treguar në shpallje afatin e kandidimit, dokumentet që duhen paraqitur, kushtet e zgjedhshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes;

b) çdo kandidat, që i përgjigjet shpalljes publike, paraqet të paktën dokumentet e mëposhtme:

i. jetëshkrimin e përditësuar;

ii. një deklaratë personale motivimi, ku shpjegon arsyen e kandidimit dhe objektivat që synon të ndjekë nëse emërohet;

iii. një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë";

iv. një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi sekret;

v. formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

vi. çdo dokument tjetër, që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore të parashikuara në këtë ligj;

c) Këshilli për Emërimet në Drejtësi, pa vonesë, dhe në çdo rast jo më vonë se 3 muaj përpara mbarimit të mandatit të Inspektorit në detyrë, shpall thirrjen për paraqitjen e kandidaturave;

ç) Kuvendi mund t'i drejtojë Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi një kujtesë lidhur me detyrimet e Këshillit, sipas këtij neni, dhe çdo informacion tjetër që e gjykon të nevojshëm, për datën e fillimit të procesit për përzgjedhjen e kandidatëve dhe kalendarin e veprimeve;

d) Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pa vonesë, dhe në çdo rast jo më vonë se 1 muaj nga përfundimi i afatit të kandidimit, shqyrton nëse kandidaturat e paraqitura plotësojnë kushtet e emërimit, sipas nenit 199 pika 1, të këtij ligji;

dh) në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit, procedura fillon menjëherë dhe mbyllet brenda 2 muajve nga data e fillimit;

e) Këshilli i Emërimeve në Drejtësi lejon kandidimin e kandidatëve që plotësojnë kushtet formale, si dhe i rendit kandidatët në listë sipas

kritereve të parashikuara në nenin 240 të këtij ligji.

ë) lista e renditjes së kandidatëve të vlefshëm dhe arsyet e përjashtimit të kandidaturave, në qoftë se ndodh, publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe i përcillen Kuvendit brenda tre ditëve;

f) nëse Kuvendi nuk arrin shumicën e kërkuar për asnjë prej kandidatëve brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar.

Neni 202
Betimi dhe fillimi i detyrës

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përpara se të fillojë detyrën, betohet sipas formulës: "Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale".

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë betohet përpara Kuvendit të Shqipërisë në një ceremoni publike.

Neni 203
Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

2. Pas përfundimit të mandatit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në qoftë se në kohën e zgjedhjes punonte me kohë të plotë në sektorin publik, ka të drejtën të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose, në pamundësi, në një detyrë të barasvlershme me të.

3. Në qoftë se në kohën e zgjedhjes Inspektori i Lartë ishte gjyqtar ose prokuror, ai kthehet në pozicionin e gjyqtarit ose të prokurorit të apelit.

Neni 204
Kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Në zbatim të funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) përfaqëson Zyrën e Inspektorit në marrëdhëniet me të tretët;

b) siguron bashkëpunimin e Zyrës së Inspektorit me organet e tjera publike dhe subjektet private në ushtrim të funksioneve të tij;

c) nxjerr urdhra të përgjithshëm me natyrë administrative ose

procedurale për mbarëvajtjen dhe metodën e punës, për koordinimin e punës midis inspektorëve, ose midis tyre dhe organeve të tjera publike, për garantimin e kuptimit dhe zbatimit uniform të ligjit në lidhje me verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe inspektimin, për garantimin e zbatimit të rregullave etike e profesionale nga inspektorët dhe personeli administrativ dhe për çdo çështje tjetër me natyrë të përgjithshme, pasi merr mendimin e mbledhjes së inspektorëve;

ç) nxjerr udhëzime jodetyruese në lidhje me çështje konkrete të trajtuara nga inspektorët;

d) jo më pak se një herë në vit raporton në Kuvend për punën e Zyrës së Inspektorit në vitin pararendës;

dh) miraton planin vjetor të inspektimeve institucionale e tematike;

e) përcakton kriteret për kualifikimet dhe kërkesat e tjera për pozicionin e inspektorëve dhe të personelit administrativ, në përputhje me këtë ligj, ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin "Për nëpunësin civil";

ë) mbikëqyr dhe udhëheq metodologjikisht punën e inspektorëve;

f) heton shkeljet disiplinore të inspektorëve;

g) thërret dhe drejton Mbledhjen e Përgjithshme të inspektorëve;

gj) thërret dhe drejton mbledhjet e Komitetit të Emërimeve dhe të Vlerësimit të Inspektorëve;

h) mbikëqyr dhe drejton administratën e Zyrës së Inspektorit;

i) bën shpërndarjen e punës tek inspektorët dhe vendos zëvendësimin e tyre në bazë të kritereve objektive dhe transparente, duke mbajtur parasysh ngarkesën, përvojën, kualifikimet dhe pengesat e mundshme ligjore të inspektorëve;

j) miraton projektvendimet e inspektorëve;

k) kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar me ligj.

2. Inspektorët, personeli administrativ i Zyrës së Inspektorit dhe çdo subjekt tjetër i interesuar mund të kërkojnë shfuqizimin e urdhrave të përgjithshëm të Inspektorit të Lartë pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

3. Urdhrat e përgjithshëm të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të

parashikuara në pikën 1, shkronja "c", të këtij neni, bëhen publikë në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit.

4. Udhëzimet jodetyruese të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të parashikuara në pikën 1, shkronja "ç", të këtij neni, bëhen gjithnjë në formë shkresore. Në qoftë se inspektori, të cilit i drejtohet udhëzimi, nuk bie dakord me të, ai informon me shkrim Inspektorin e Lartë duke dhënë shpjegimet përkatëse. Udhëzimet e Inspektorit të Lartë, objeksionet e inspektorit dhe argumentet e mëtejshme të Inspektorit të Lartë bëhen pjesë e dosjes përkatëse.

5. Në ushtrim të funksioneve të tij, Inspektori i Lartë mund t'i delegojë me shkrim kompetenca të caktuara inspektorëve të veçantë ose drejtorëve të njësive administrative të Zyrës së Inspektorit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative për delegimin.

Neni 205
Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë

1. Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron të gjitha kompetencat e Inspektorit të Lartë në mungesë të këtij të fundit, ose kur vendi i tij është përkohësisht i lirë, me përjashtim të kompetencës së parashikuar në nenin 204, pika 1, shkronja "c", të këtij ligji.

2. Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë brenda 30 ditëve nga zgjedhja e këtij të fundit, pasi ka marrë mendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të inspektorëve, midis inspektorëve me të paktën 3 vjet përvojë pune si inspektor dhe që janë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin e fundit të performancës profesionale dhe etike si inspektor.

3. Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë për një periudhë dyvjeçare me të drejtë riemërimi.

4. Në rast se Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë ka pengesë ligjore në ushtrimin e detyrave të tij, ndëshkohet me një masë disiplinore ose largohet nga puna si inspektor, ai zëvendësohet menjëherë, sipas kritereve, procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë nen.

5. Mbledhja e Përgjithshme e inspektorëve, me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miraton me vendim rregulla më të hollësishme mbi procedurën e zgjedhjes së Zëvendësinspektorit dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencave prej tij.

Neni 206
Mbarimi i mandatit

1. Mandati i Inspektorit të Lartë mbaron sipas parashikimeve të nenit 147/dh të Kushtetutës.

2. Në ato raste kur mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbaron për shkak të paaftësisë mendore ose fizike së tij për të përmbushur detyrat funksionale, verifikimi i paaftësisë mendore ose fizike të tij bëhet sipas procedurës së përcaktuar nga ligji "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, jo më vonë se 3 muaj përpara mbarimit të mandatit për shkak pensioni ose përfundimi të afatit 9-vjeçar, njofton me shkrim Kuvendin dhe Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për vendin vakant.

4. Në rastet e tjera të mbarimit të mandatit, njoftimi për vendin vakant përcillet menjëherë pranë Kuvendit dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë.

5. Mbarimi i mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deklarohet me vendim të Mbledhjes së Përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 207
Shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shkarkohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese, nëse vërtetohet se ka kryer një ose disa prej shkeljeve të mëposhtme profesionale dhe etike:

a) neglizhencë të rëndë në ushtrimin e detyrave;

b) mosrespektim haptazi të ligjit dhe të fakteve në ushtrimin e detyrave, si pasojë e neglizhencës së rëndë dhe të pajustifikuar;

c) neglizhencë të rëndë në drejtimin e Zyrës së Inspektorit dhe në mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektorëve;

ç) kryerja e një veprimtarie, që konsiderohet me ligj e papajtueshme me funksionin zyrtar;

d përhapja, në kundërshtim me ligjin dhe me neglizhencë të rëndë, e informacionit konfidencial të përftuar gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar;

dh) kryerja e sjelljeve që diskreditojnë rëndë dinjitetin e institucionit, të tilla si përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çdo lloji, të cilat i jepen, qoftë edhe përmes veprimeve të ligjshme, për shkak të funksionit ose si rrjedhojë e ushtrimit të funksionit, shkelje të tjera të ligjit, qoftë edhe të kryera nga pakujdesia, në veçanti ato që lidhen me detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të konfliktit të interesave;

e) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 208
Hetimi i shkeljeve disiplinore

1. Kuvendi heton shkeljet e dyshuara disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bazë të rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe në Rregulloren e Kuvendit.

2. Afati i parashkrimit për fillimin e hetimit të shkeljes disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është 5 vjet nga momenti i përfundimit të shkeljes. Pas fillimit të hetimit, afati nuk parashkruhet. Afati i parashkrimit ndërpritet nëse Inspektori i Lartë kryen një shkelje tjetër të të njëjtit lloj brenda këtij afati. Në këtë rast, afati i parashkrimit llogaritet duke filluar nga momenti i përfundimit të shkeljes së re. Nëse shkeljet disiplinore përbëjnë njëkohësisht edhe vepër penale, zbatohet afati i parashkrimit të veprave penale, sipas parashikimeve të Kodit Penal, me kushtin që afati i parashkrimit, i parashikuar në Kodin Penal, të jetë më i gjatë se 5 vjet.

3. Procedimi disiplinor pezullohet nëse për të njëjtat fakte, të kryera nga i njëjti person, ka filluar një procedim gjyqësor penal, civil ose administrativ, gjer në përfundimin e shqyrtimit të çështjes. Vendimi për pezullimin nuk mund të ankimohet. Gjatë periudhës së pezullimit nuk mund të kryhet asnjë veprim i procedurës disiplinore. Pas zhdukjes së shkakut të pezullimit, procedimi disiplinor fillon nga veprimi procedural që po kryhej në kohën e pezullimit. Në hetimin e shkeljeve disiplinore të Inspektorit të Lartë, Kuvendi merr parasysh faktet e vërtetuara me vendimin e gjykatës. Vendimi përfundimtar i gjykatës në favor të Inspektorit të Lartë nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedimit disiplinor nga Kuvendi.

4. Në përfundim të hetimit parlamentar, komisioni hetimor parlamentar merr vendim për pushimin e procedimit disiplinor kur provat janë të

pamjaftueshme për të provuar shkeljen disiplinore, kur çështja ka qenë objekt i një procedimi të mëparshëm disiplinor, të mbyllur me vendim përfundimtar, kur çështja është parashkruar dhe kur Inspektori i Lartë nuk është më në detyrë ose i kërkon Gjykatës Kushtetuese shkarkimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese vendos sipas ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë pezullohet nga detyra me vendim te Gjykatës Kushtetuese në rastet e parashikuara në nenin 147/e, pika 4, të Kushtetutës.

KREU III
INSPEKTORËT E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Neni 209
Kushtet për emërimin e inspektorit

1. Jo më pak se gjysma e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë magjistratë, të cilët komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

2. Inspektorët e tjerë emërohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas këshillimit me Komitetin e Emërimit dhe të Vlerësimit të Inspektorëve, në bazë të një procedure përzgjedhëse të hapur, konkurruese dhe të planifikuar, në analogji, për aq sa është e mundur, me rregullat e ligjit "Për nëpunësin civil".

3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve përbëhet nga 3 inspektorë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të përzgjedhur me short, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në nenin 212 të këtij ligji. Anëtarët e komitetit qëndrojnë në detyrë për 1 vit.

4. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve verifikon përmbushjen e kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve për inspektorë. Komiteti, pasi përjashton nga konkurrimi kandidatët që nuk plotësojnë kushtet ligjore, rendit kandidatët e tjerë, sipas meritës, duke zbatuar, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, kërkesat e nenit 240 të këtij ligji.

5. Kandidatët për inspektorë, të cilët vijnë nga radhët e magjistratëve, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) në kohën e kandidimit, plotësojnë kushtet për t'u emëruar në

Gjykatën e Lartë ose në Prokurorinë e Përgjithshme;

b) në kohën e kandidimit, nuk janë kryetarë të një gjykate ose drejtues të një zyre të prokurorisë dhe as anëtarë të organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata ose sindikata magjistratësh etj.;

c) janë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale;

ç) nuk kanë masë disiplinore në fuqi;

d) nuk janë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) në kohën e kandidimit, nuk kanë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", dhe të afërm të shkallës së parë që punon si inspektor në Zyrën e Inspektorit e Lartë të Drejtësisë.

6. Kandidatët për inspektorë, të cilët nuk janë magjistratë, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;

b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;

c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;

ç) në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;

d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;

e) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish- Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991;

ë) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;

f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

Neni 210
Statusi i inspektorëve

1. Inspektorët magjistratë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përfitojnë pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të gjykatës së apelit.

2. Inspektorët jomagjistratë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gëzojnë statusin e nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese.

Neni 211
Rekrutimi i inspektorëve

1. Inspektorët magjistratë komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë për një periudhe 5-vjeçare me të drejtë riemërimi vetëm një herë. Të drejtën e riemërimit e gëzojnë vetëm ata inspektorë, të cilët janë vlerësuar të paktën "shumë mirë" gjatë kohës së shërbimit si inspektorë. Magjistratët e komanduar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mund të kthehen në çdo kohë në funksionet e tyre të mëparshme me kërkesën e tyre ose të Inspektorit të Lartë, sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të rastit kur ndaj tyre merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

2. Inspektorët e tjerë emërohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bazë të një procedure përzgjedhëse dhe konkurruese të hapur dhe të planifikuar. Jo më vonë se 3 muaj nga krijimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë miraton rregulla më të hollësishme për procedurën e përzgjedhjes, konkurrimit dhe emërimit të inspektorëve jomagjistratë. Rregullat e miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë zbatohen, për aq sa është e mundur, me rregullat e ligjit "Për nëpunësin civil".

Neni 212
Vlerësimi i etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve

1. Veprimtaria profesionale dhe etika e inspektorit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vlerësohet nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit. Tre anëtarët e komisionit dhe 2 anëtarë zëvendësues zgjidhen me short, brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik, nga radhët e inspektorëve që janë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në 2 vlerësimet e fundit etiko-profesionale si inspektorë ose magjistratë dhe që nuk kanë radhën për t'u vlerësuar atë vit.

2. Procedura dhe rregullat e vlerësimit miratohen me vendim të Inspektorit të Lartë duke zbatuar, për aq sa është e mundur, dispozitat e ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë" në lidhje me vlerësimin etiko-profesional të magjistratëve. Jo më vonë se 3 muaj nga data e krijimit të Zyrës së Inspektorit, Inspektori miraton sistemin e vlerësimit të performancës për inspektorët.

Neni 213
Shkeljet disiplinore të Inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Rregullat e ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në lidhje me përgjegjësitë disiplinore të magjistratëve zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe për inspektorët.

2. Inspektori i Lartë heton shkeljet e dyshuara disiplinore të inspektorëve në bazë të rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Vendimet disiplinore merren nga një komision i posaçëm disiplinor me 3 anëtarë. Tre anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe 2 anëtarë zëvendësues zgjidhen me short, brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik, nga radhët e inspektorëve që janë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në 2 vlerësimet e fundit etiko-profesionale si inspektorë ose magjistratë. Anëtarët e Komisionit Disiplinor qëndrojnë në detyrë për 1 vit.

4. Vendimet për vendosjen e masave disiplinore për inspektorët që shërbejnë si anëtarë të Komisionit Disiplinor merren nga Komisioni Disiplinor pa praninë e anëtarit të akuzuar.

Neni 214
Detyrat e inspektorëve

1. Inspektorët i ushtrojnë detyrat e tyre në emër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në ushtrim të detyrave të tyre, inspektorët kryejnë verifikime dhe hetime administrative rreth shkeljeve të pretenduara disiplinore të subjekteve të parashikuara në nenin 194, pika 1, të këtij ligji, mbledhin të dhëna dhe vlerësojnë çdo informacion ose akt që çmojnë se është ose mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e detyrës, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Inspektorët kanë të drejtë të hyjnë në ambientet ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet e procedimit disiplinor, të inspektojnë, të kopjojnë, shumëfishojnë dhe marrin çdo informacion ose dokument të nevojshëm për kryerjen e detyrës.

4. Inspektorët mund të kërkojnë nga çdo person fizik a juridik ose institucion publik informacion, dokumente, dëshmi me gojë ose me shkrim mbi çdo çështje që lidhet me objektin e verifikimit, hetimit ose inspektimit që është duke u kryer.

5. Çdo person fizik ose juridik ose institucion publik është i detyruar që:

a) të bashkëpunojë me inspektorët në procedurën e verifikimit, hetimit, të inspektimit;

b) të japë akses, në përputhje me pikën 2 të këtij neni;

c) të respektojë kërkesat e pikës 3 të këtij neni.

6. Në përfundim të procedurës së verifikimit, hetimit të shkeljes ose inspektimit, inspektori harton projektvendimin përkatës dhe ia dorëzon atë menjëherë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

7. Inspektori i Lartë shqyrton projektvendimet e inspektorëve për të verifikuar respektimin e kërkesave lidhur me formën, plotësinë e përmbajtjes, përkimin e vendimit me praktikën e punës të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të gjykatave dhe vendos:

a) miratimin e projektvendimit dhe dërgimin e tij pranë organit disiplinor;

b) kthimin e projektvendimit me propozimin për të bërë korrigjimet dhe plotësimet e nevojshme, sipas kërkesave të kësaj pike;

c) ndryshimin e projektvendimit në rast se inspektori nuk bie dakord me propozimin e Inspektorit të Lartë. Në këtë rast, projektvendimi i inspektorit i bashkëngjitet vendimit përfundimtar të Inspektorit të Lartë.

8. Në programimin dhe zhvillimin e inspektimeve, inspektori vepron me nismë të tij.

KREU IV
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Neni 215
Administrata e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë organizohet dhe funksionon administrata, e cila ndihmon në realizimin e misionit dhe të

funksioneve të zyrës.

2. Administrata e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili raporton para Inspektorit të Lartë.

3. Personeli administrativ i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka statusin e nëpunësit civil, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për nëpunësin civil.

4. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë punëson punonjës administrativë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

Neni 216
Sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit

1. Në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bashkëpunim me qendrën e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, është përgjegjës për:

a) zhvillimin ose pjesëmarrjen në sistemin elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për menaxhimin, koordinimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit, si dhe për përcaktimin e sistemit të zbatueshëm të menaxhimit elektronik të çështjeve;

b) përcaktimin e rregullave për krijimin, funksionimin, ndërveprimin dhe sigurinë e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura dhe të ruajtura nga sistemi;

c) mirëmbajtjen e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit të çështjeve, në përputhje me rregullat e parashikuara në shkronjën "b" të këtij neni;

ç) përmirësimin periodik të sistemit, për të siguruar zbatimin e kërkesave funksionale të inspektimit dhe të organeve të tjera brenda sistemit të drejtësisë, si dhe për të reflektuar ndryshimet në ligjet procedurale;

d) sigurimin që sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit të të dhënave gjeneron informacione statistikore, të cilat janë të nevojshme për punën e Inspektorit të Lartë dhe të organeve të tjera;

dh) sigurimin e saktësisë dhe sigurisë së të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

e) përcaktimin e rregullave për përdorimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, njësimin e futjes së të dhënave dhe për saktësinë e të dhënave.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët e tjerë kanë qasje të plotë në sistemin e menaxhimit të çështjeve të gjykatave, të zyrave të prokurorisë dhe të këshillave dhe në sistemet e regjistrimit audio dhe video.

PJESA V
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 217
Objekti i kreut

Ky kre përcakton parimet, rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, paraqitjen e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, shqyrtimin e kandidaturave, renditjen e tyre dhe dërgimin e kandidaturave për rekrutimin përfundimtar në organin e emërtesës.

Neni 218
Funksioni dhe përgjegjësitë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organ i pavarur që verifikon përmbushjen e kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i përmbush funksionet e tij duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe me qëllimin për të siguruar cilësi sa më të lartë profesionale dhe morale në përbërjen e organeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 219
Selia dhe mbështetja administrative

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mblidhet sa herë është e nevojshme.

2. Selia e Këshillit është Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë.

3. Gjykata e Lartë siguron mbështetjen e nevojshme organizative, administrative dhe financiare për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të parashikuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj.

KREU II
PËRBËRJA E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Neni 220
Përbërja, mandati i anëtarëve dhe zëvendësimi
(*Ndryshuar pika 3 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë si më poshtë:

a) dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese;

b) një gjyqtar i Gjykatës së Lartë;

c) një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme;

ç) dy gjyqtarë nga gjykatat e apelit;

d) dy prokurorë nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit;

dh) një gjyqtar nga gjykatat administrative.

2. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi qëndrojnë në detyrë për 1 vit nga data 1 janar e çdo viti kalendarik.

3. Në rast pamundësie ose të konfliktit të interesit, anëtarët zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues sipas rregullave të përcaktuara në aktet e Këshillit.

Neni 221
Kushtet dhe kriteret për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit dhe procedurat e përzgjedhjes
(Ndryshuar shkronja (a) pika 1, shfuqizuar shkronjat (ç) dhe (d) pika 1, ndryshuar shkronja (dh) pika 1 me Ligjin nr. 47/2019)

1. Mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm ata magjistratë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, në momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) në kohën e hedhjes së shortit magjistrati që ushtron detyrën pranë gjykatave administrative, gjykatave të apelit, prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 10 vjet.

b) nuk ka një masë disiplinore në fuqi;

c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;

dh) magjistrati është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në 2 vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, nëse janë të disponueshme.

e) magjistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ë) magjistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

2. Kandidatët që nuk plotësojnë një nga këto kushte përjashtohen nga shorti.

3. Jo më vonë se data 15 nëntor e çdo viti kalendarik, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë verifikojnë nëse kandidatët për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dhe i paraqesin Presidentit të Republikës dhe Kuvendit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet.

4. Lista me kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet bëhen publike në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.

5. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit. Ata mund të ankohen brenda 5 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

7. Presidenti i Republikës, në prani të Avokatit të Popullit, përzgjedh anëtarët e Këshillit me short midis datës 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përveç anëtarëve të parashikuar në pikën 1, të nenit 220, të këtij ligji, Presidenti i Republikës zgjedh edhe një anëtar zëvendësues nga secili institucion në të njëjtin short.

8. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të përzgjedhë anëtarët e Këshillit deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit, në prani të Avokatit

të Popullit, i përzgjedh ata brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik.

9. Presidenti i Republikës, miraton rregulla të mëtejshme për zhvillimin e procedurës së shortit, të cilat, në çdo rast, duhet t'u përmbahen parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit.

10. Rezultatet e shortit dhe përmbledhja e procesverbalit të procesit të shortit bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të internetit të Presidentit të Republikës.

11. Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit.

Neni 222
Konflikti i interesit

Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të Këshillit lidhur me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës, të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe të mos marrë pjesë në votimin çështjes përkatëse.

Neni 223
Papajtueshmëria

Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk mund të marrë pjesë në verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kritereve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, në qoftë se midis tij dhe kandidatit ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme:

a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese;

b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; ose

c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerk.

Neni 224
Heqja dorë

1. Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në procesin për verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kritereve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për

anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë në rastet e mëposhtme:

a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me kandidatin, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën;

b) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/ bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me kandidatin.

2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep Kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

Neni 225
Përjashtimi dhe zëvendësimi i anëtarit
(*Ndryshuar pika 1 me Ligjin nr. 47/2019*)

1. Kandidatët mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kritereve profesionale dhe renditjen jo më vonë se 3 ditë nga data e mbledhjes së Këshillit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenet 222, 223 dhe 224, të këtij ligji, dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes.

2. Vendimi për përjashtimin e anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Këshillit, vendimi merret nga zëvendëskryetari.

3. Anëtari i përjashtuar ose i dorëhequr zëvendësohet nga anëtari zëvendësues nga i njëjti institucion.

KREU III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Neni 226
Kryetari

1. Anëtari i Gjykatës së Lartë është kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

2. Kryetari i Këshillit ushtron këto funksione:

a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit;

b) përfaqëson Këshillin në marrëdhëniet me të tretët;

c) siguron mbështetjen administrative, organizative dhe financiare të Gjykatës së Lartë për funksionimin e Këshillit;

ç) harton dhe bën publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë raportin vjetor mbi veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;

d) siguron që mbledhja e Këshillit të regjistrohet në sistemin audio dhe që një përmbledhje e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit mbahet dhe bëhet publik në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Përmbledhja e procesverbalit u vihet në dispozicion anëtarëve të Këshillit përpara se të bëhet publike. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve ka dyshime për saktësinë e përmbledhjes së procesverbalit, Kryetari i Këshillit urdhëron ballafaqimin e përmbledhjes me regjistrimin audio dhe ndryshimin e saj në qoftë se dyshimi i anëtarit rezulton i justifikuar;

dh) siguron dokumentimin e mbledhjes se këshillit dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;

e) nënshkruan aktet e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes dhe ia përcjell ato organit të emërtesës;

ë) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

Neni 227
Zëvendëskryetari

1. Anëtari më i vjetër në moshë nga Gjykata Kushtetuese është Zëvendëskryetari i Këshillit.

2. Zëvendëskryetari ushtron të gjitha funksionet e Kryetarit në mungesë ose pamundësi të këtij të fundit.

Neni 228
Relatori

1. Për verifikimin paraprak të plotësimit të kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale nga kandidatët, si dhe për renditjen e tyre, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi cakton me short një relator për pozicionet vakante në çdo institucion.

2. Shorti për caktimin e relatorit organizohet përmes sistemit të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë.

3. Përjashtimisht, në qoftë se sistemi elektronik nuk funksionon, shorti mund të kryhet manualisht. Këshilli miraton rregulla më të detajuara për të

bërë të mundur që procedura e shortit për caktimin e relatorit t'u përmbahet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit.

4. Rezultati i shortit për relatorin bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

5. Për zhvillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit dhe renditjes, relatori kryen detyrat e mëposhtme:

a) shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidatët;

b) kërkon kontrollin e pasurisë së kandidatëve dhe verifikimin e rekordeve penale dhe disiplinore të tyre;

c) përgatitjen e projektaktit të verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve;

ç) koordinimin me kryetarin për përgatitjen e mbledhjes së Këshillit;

d) përgatitjen e komunikatës për mediat;

dh) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

6. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij, relatori ndihmohet nga personeli administrativ i Gjykatës së Lartë.

Neni 229
Mënyra e ushtrimit të veprimtarisë dhe vendimmarrjes

1. Këshilli e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë kre, të cilat, plotësohen, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, nga rregullat e parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale. Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit është e detyrueshme. Anëtarët që mungojnë zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.

3. Këshilli vendos me shumicën e votave në prani të të paktën pesë anëtarëve.

4. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në procesin e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore dhe të vlerësimit të kritereve profesionale e morale kërkon informacione nga institucione të tjera.

5. Në përfundim të procesit të verifikimeve, sipas pikës 4, të këtij neni, Këshilli interviston kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, bën renditjen e tyre sipas kritereve të parashikuara në nenin 240, të këtij ligji, dhe harton një raport ku arsyeton këtë renditje.

Neni 230
Personeli administrativ

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi miraton një rregullore të brendshme për administrimin e brendshëm të tij.

2. Kryetari i Këshillit, në bashkëpunim më Kryetarin e Gjykatës së Lartë, cakton, nga radhët e personelit administrativ të Gjykatës së Lartë, një numër të arsyeshëm punonjësish administrativë për të lehtësuar përmbushjen e detyrave të Këshillit.

3. Për nevojat e punës së tij, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi krijon dhe përdor një sistem të administrimit të çështjeve. Këshilli mbledh dhe përpunon të dhënat në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 231
Regjistri zyrtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi sigurohet që Këshilli të ketë në çdo kohë një regjistër zyrtar, në të cilin regjistrohen së paku informacionet e mëposhtme:

a) emrat e kandidatëve dhe institucionet ku ata propozohet të emërohen;

b) institucionet propozuese;

c) dokumentacioni i depozituar prej kandidatëve dhe/ose prej institucioneve propozuese;

ç) dokumentacioni i ardhur nga institucionet shtetërore që bëjnë verifikimin e pasurisë dhe të rekordeve penale e disiplinore të kandidatëve, si dhe letërkëmbimi zyrtar mes tyre dhe Këshillit;

d) aktet përfundimtare të Këshillit për verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve;

dh) letërkëmbimi zyrtar mes Këshillit dhe Kuvendit ose Presidentit të Republikës.

Neni 232
Publikimi i akteve

1. Lista e kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur, e shoqëruar me arsyetimin përkatës për përjashtimin tyre, lista e kandidatëve që vijojnë konkurrimin dhe renditja e tyre publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

2. Të gjitha aktet e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes për secilin kandidat, të miratuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, të shoqëruara me shpjegimet dhe arsyetimet përkatëse si dhe me një përmbledhje të procesverbalit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje.

Neni 233
Transparenca

1. Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura. Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit.

2. Përfaqësues të autorizuar të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

3. Këshilli komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat, e cila informon së paku për:

a) kohën e mbledhjes;

b) pjesëmarrjen;

c) kandidatët, jetëshkrimin e përditësuar të tyre, pozicionet për të cilat ata kandidojnë dhe institucionet propozuese;

ç) një shpjegim të shkurtër të procedurave dhe të metodës së ndjekur për verifikimin kushteve ligjore dhe të kritereve të përdorura për renditjen e kandidatëve;

d) aktin përfundimtar të verifikimit dhe renditjes së kandidatëve.

KREU IV
VERIFIKIMI I KUSHTEVE LIGJORE

Neni 234
Subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi

1. Presidenti i Republikës i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Presidenti i Republikës, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Presidentit.

2. Kryetari i Kuvendit i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Kuvendi, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Kuvendit.

3. Kryetari i Gjykatës së Lartë i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Gjykata e Lartë, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të gjykatës.

4. Kandidatët për Inspektor të Lartë të Drejtësisë i paraqesin Këshillit të Emërimeve në Drejtësi një shprehje interesi të nënshkruar dhe të shoqëruar me dokumentet e parashikuara në nenin 201, pika 2, shkronja "b", të këtij ligji.

Neni 235
Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë së kandidatëve

1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë.

2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë

dhe të vërtetësisë së deklarimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij.

3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit rezultatet e kontrollit.

4. Me përfundimin e procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar.

Neni 236
Deklarimi dhe kontrolli i integritetit të kandidatëve

1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për vetëdeklarimin, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

2. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e formularëve për vetëdeklarimin, të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

3. Vetëdeklarimet e kandidatëve bëhen publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

4. Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi përcjell menjëherë formularët e vetëdeklarimit në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila kryen verifikimet brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve.

5. Me përfundimin e procedurës së verifikimit, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit të të dhënave të deklaruara, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit.

Neni 237
Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore

1. Jo më vonë se 35 ditë nga mbërritja e listave të kandidatëve dhe dokumenteve që i shoqëron ato, Këshilli për Emërimet në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore të parashikuara në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në nenin 234, pika 1, të këtij ligji.

2. Për këtë qëllim Këshilli dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës.

3. Me përfundimin e procedurës së verifikimit, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit të kushteve ligjore, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit.

Neni 238
Ankimet kundër vendimeve për ndalimin e kandidimit

1. Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 240 të këtij ligji.

KREU V
VLERËSIMI DHE RENDITJA E KANDIDATËVE

Neni 239
Fillimi dhe afati për zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve

1. Jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i procedurës së verifikimit, sipas parashikimeve të neneve 234 deri në 238, të këtij ligji, Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi thërret mbledhjen e Këshillit.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bën vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve dhe bën renditjen e tyre jo më vonë se 10 ditë nga dita e mbledhjes.

3. Këshilli qëndron i mbledhur deri në përfundim të procesit të vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve.

Neni 240
Kriteret profesionale dhe morale për renditjen e kandidatëve

1. Këshilli bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre profesionale bazuar në:

a) rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon;

b) vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës;

c) rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë;

ç) ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesional dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit.

2. Këshilli bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre morale bazuar në:

a) reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve;

b) cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi;

c) angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

3. Këshilli bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre organizative, drejtuese dhe menaxheriale bazuar në:

a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;

b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësitë e komunikimit;

ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;

d) aftësitë e përfaqësimit publik.

4. Krahas kritereve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, në vlerësimin e kandidatëve mbahen parasysh edhe:

a) mbajtja e titujve akademikë;

b) kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;

c) njohja e gjuhëve të huaja.

5. Këshilli interviston kandidatët dhe angazhon ekspertë për verifikimin e aftësive të tyre, sidomos për të verifikuar nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja.

6. Në zbatim të dispozitave të këtij kreu, Këshilli miraton rregulla për detajimin e mëtejshëm të kritereve dhe për të përcaktuar peshën specifike të tyre në renditjen e kandidatëve.

7. Në marrjen e vendimeve për renditjen e kandidatëve Këshilli vepron sipas kritereve të parashikuara në pikat 1 deri në 5, të këtij neni, dhe harton një raport ku arsyeton këtë renditje.

KREU VI
PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Neni 241
Rastet e përgjegjësisë disiplinore të anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi mbajnë përgjegjësi disiplinore për shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës si anëtarë të Këshillit.

2. Procedimi disiplinor mund të fillojë në çdo kohë, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Neni 242
Shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit

Në veçanti, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi përbëjnë shkelje disiplinore:

a) mungesa, pa arsye të përligjura, në mbledhjet e Këshillit;

b) shkelja e rëndë e rregullave të solemnitetit gjatë mbledhjeve të Këshillit;

c) bërja publike e mendimeve që ka dhënë ose janë dhënë nga anëtarët e tjerë gjatë procesit të diskutimit të çështjes;

ç) mosmarrja pjesë në diskutimin e çështjes;

d) bërja e deklaratave publike dhe në media në lidhje me procedurat e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes, nëse ky veprim ka sjellë ose mund të sjellë cenimin e paanshmërisë së anëtarit ose të të drejtave të subjektit të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes;

dh) shkelja haptazi e ligjit, me dashje ose pakujdesi të rëndë, duke mos iu referuar ligjit të zbatueshëm ose fakteve të rëndësishme për verifikimin e kushteve ligjore, kritereve profesionale e morale dhe renditjen.

PJESA VI
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

KREU I
QËLLIMI DHE DETYRAT E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Neni 243
Statusi, autonomia dhe selia

1. Shkolla e Magjistraturës është institucion publik buxhetor dhe gëzon cilësinë e personit juridik.

2. Shkolla e Magjistraturës gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara në këtë ligj.

3. Qendra e Shkollës së Magjistraturës është në Tiranë.

Neni 244
Funksionet

1. Shkolla e Magjistraturës siguron formimin profesional të magjistratëve.

2. Formimi profesional përfshin programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe të formimit vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë.

3. Shkolla e Magjistraturës pranon në programin e formimit fillestar dhe

të formimit vazhdues të kandidatëve për magjistratë, në kuptim të pikës 2, të këtij neni, dhe në përputhje me ligjin "Për Avokaturën e Shtetit" kandidatë për pozicionet në Avokaturën e Shtetit.

4. Shkolla e Magjistraturës pranon, në vitin e parë të trajnimit fillestar dhe në programin e trajnimit të vazhduar, në kuptimin e pikës 2, të këtij neni, dhe në përputhje me ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", kandidatët për ndihmës ligjorë.

5. Rregulla më të detajuara që lidhen me parashikimet e pikave 3 dhe 4, të këtij neni, në veçanti lidhur me numrin e të trajnuarve në vit, kurset e trajnimit për këta të trajnuar dhe fondet përkatëse që do të bëhen të disponueshme nga institucionet ose donatorët e interesuar, rregullohen me marrëveshje ndërmjet Shkollës së Magjistraturës dhe institucionit të interesuar.

6. Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat dhe institucionet e tjera realizon trajnimin profesional fillestar dhe të vazhduar të kancelarëve, në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

7. Shkolla e Magjistraturës, bazuar në detyrimin e përcaktuar me ligj, ose me kërkesë të institucioneve të interesuara, në varësi të kapaciteteve që ka, fondeve përkatëse të bëra të disponueshme nga institucionet e interesuara ose donatorët, mund të bashkëpunojë për aktivitetet e formimit profesional për nëpunësit civilë të gjyqësorit, nëpunësit civilë të prokurorisë ose të profesioneve të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë. Shkolla e Magjistraturës, sipas rastit, mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për trajnimin e tyre.

Neni 245
Buxheti

Buxheti i Shkollës së Magjistraturës i shërben kryerjes së veprimtarisë dhe funksionimit të saj. Buxheti përfshin:

a) pagat dhe përfitimet e personelit mësimdhënës të brendshëm dhe të jashtëm dhe të personelit administrativ, si dhe shpërblimet për ekspertët e trajnimit vazhdues, specialistët dhe përgjegjësit e stazheve;

b) bursat e shkollimit të kandidatëve për magjistratë;

c) shpenzime operative;

ç) shpenzime kapitale;

d) të ardhurat e veta nga regjistrimet, botimet etj.;

dh) veprimtari të tjera, të miratuara nga Këshilli Drejtues në kuadrin e qëllimit të shkollës.

KREU II
DREJTIMI DHE ORGANIZIMI I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Neni 246
Organet drejtuese

Organet drejtuese të Shkollës së Magjistraturës janë:

a) Këshilli Drejtues;

b) Drejtori i Shkollës;

c) Këshilli Pedagogjik;

ç) Komisioni Disiplinor.

Neni 247
Përbërja dhe mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka këtë përbërje:

a) Kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili kryen njëkohësisht funksionin e Kryetarit të Këshillit Drejtues;

b) Prokurori i Përgjithshëm, i cili kryen njëkohësisht funksionin e Zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues;

c) Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

ç) Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

d) një gjyqtar dhe një prokuror me përvojë, që caktohen, sipas rastit, përkatësisht nga mbledhja e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Anëtarët e zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të Këshillit të

Lartë Gjyqësor ose anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

dh) dy përfaqësues të caktuar nga Ministri i Drejtësisë;

e) Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

ë) Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

f) një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me përvojë të spikatur në fushën juridike;

g) Drejtori i Shkollës së Magjistraturës;

gj) përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues, si dhe dy pedagogë të brendshëm të e Shkollës së Magjistraturës;

h) dy studentë nga vite akademike të ndryshme të zgjedhur me votim të fshehtë nga asambleja e kandidatëve për magjistratë që ndjekin formimin fillestar.

2. Anëtarët e Këshillit Drejtues, sipas shkronjave "d", "dh" dhe "f", të këtij neni, qëndrojnë në këtë detyrë për një afat katërvjeçar, përveç rasteve kur nuk ushtrojnë më funksionin ose detyrën, që motivon caktimin e tyre si anëtarë të Këshillit.

Neni 248
Detyrat, mbledhjet dhe vendimmarrja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ka këto detyra:

a) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për zbatimin e procedurave për rekrutimin e kandidatëve që do të ndjekin studimet në Shkollën e Magjistraturës, bazuar në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

b) ndjek zbatimin e kritereve të përcaktuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" për pranimin e kandidatëve që do të ndjekin programin e formimit fillestar dhe shpall listën përfundimtare të tyre;

c) bën emërimin dhe largimin nga detyra të stafit mësimdhënës, me propozimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit Drejtues, ose të Drejtorit të Shkollës;

ç) përcakton, brenda buxhetit, strukturën organizative dhe kriteret e emërimit të personelit administrativ;

d) miraton dhe ndjek zbatimin e rregullores të shkollës dhe të programit vjetor të veprimtarive të saj;

dh) miraton, me propozimin e drejtorit, programet e formimit dhe programet e çdo lënde ose kursi të Trajnimit Fillestar, pedagogët përgjegjës dhe ngarkesën e tyre;

e) propozon projektbuxhetin dhe shqyrton raportet e drejtorit për realizimin e buxhetit dhe shpenzimet e të ardhurave;

ë) paraqet një raport vjetor përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për rezultatet e arritura dhe drejtimet e punës për të ardhmen;

f) miraton programin tematik dhe kalendarin e aktiviteteve të Trajnimit Vazhdues, si edhe listën e trajnuesve/ekspertëve të këtij programi, duke siguruar lehtësitë për Shkollën e Magjistraturës në përditësimin e tij me tema te reja dhe, sipas rastit, ndryshime në kalendar;

g) miraton marrëveshjet që lidh Shkolla e Magjistraturës për realizimin e trajnimeve të grupeve të tjera;

gj) cakton nga pedagogët e brendshëm, si anëtarë të Komisionit Disiplinor të Shkollës, Prokurorin dhe Zëvendësprokurorin për Disiplinën për një afat trevjeçar dhe të parinovueshëm.

2. Këshilli Drejtues mblidhet së paku një herë në tre muaj. Koha, vendi dhe çështjet e rendit të ditës së mbledhjes caktohen nga kryetari. Të drejtën për të kërkuar mbledhjen e Këshillit Drejtues dhe përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës e kanë edhe jo më pak se tre anëtarë të Këshillit ose Drejtori i Shkollës. Këshilli mblidhet jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e kërkesës me shkrim.

3. Mbledhjet janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicë votash dhe, kur votat janë të barabarta, përcaktuese është vota e kryetarit. Vendimet merren me votim të hapur, mbështetur në ligjin "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

4. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, rregullat dhe procedurat e parashikuara në ligjin "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" zbatohen për organizimin e mbledhjeve dhe vendimmarrjen e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Neni 249
Kushtet për emërimin e Drejtorit të Shkollës

Drejtor i Shkollës së Magjistraturës emërohet shtetasi shqiptar që përmbush së bashku këto kushte ligjore:

a) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

b) të ketë punuar si gjyqtar ose prokuror për jo më pak se 10 vjet ose si jurist për jo më pak se 15 vjet;

c) të ketë jo më pak se 10 vjet mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës nga marrja e gradës shkencore "Doktor" ose jo më pak se 5 vjet mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës nga marrja e titullit shkencor "Profesor", ose jo më pak se 15 vjet mësimdhënie si pedagog i brendshëm ose pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës;

ç) të mos jetë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;

d) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

Neni 250
Emërimi, statusi dhe qëndrimi në detyrë i Drejtorit të Shkollës

1. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës emërohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës, me konkurrim të hapur dhe të bazuar në meritë, mbi bazën e dokumentacionit, për një mandat 4-vjeçar me të drejtë riemërimi, vetëm një herë.

2. Në rastet kur Drejtori i Shkollës së Magjistraturës përzgjidhet nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve që plotësojnë kushtin e nenit 249, të këtij ligji, emërimi bëhet vetëm pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas kërkesës së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

3. Gjatë kohës së qëndrimit në funksion, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Funksioni i Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër publik, anëtarësimin në partitë politike apo pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre, ose kryerjen e çdo veprimtarie tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies dhe veprimtarive me natyrë shkencore.

4. Periudha e ushtrimit të funksionit të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës njihet si periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtar ose prokuror,

për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

5. Gjyqtarët ose prokurorët, që shërbejnë në funksionin e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, me kërkesë të tyre, rikthehen në vendet e punës që u ruhen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Neni 251
Detyrat e Drejtorit të Shkollës

1. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës ka këto detyra:

a) përfaqëson Shkollën e Magjistraturës në marrëdhënie me të tretët;

b) harton dhe propozon në bashkëpunim me Këshillin Pedagogjik, projektin e rregullores së shkollës, projektprogramin vjetor të veprimtarive të saj, si dhe ndryshimin e tyre;

d) zbaton detyrat që burojnë nga ligjet dhe nga vendimet e Këshillit Drejtues dhe bashkëpunon me institucionet, të cilave u raporton sipas këtij ligji;

ç) kërkon fonde nga shteti, donacione nga burime të tjera të ligjshme dhe administron në mënyrë të pavarur të ardhurat, sipas drejtimeve kryesore të përcaktuara nga Këshilli Drejtues, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 249 të këtij ligji;

d) merr masa për publikimin e literaturës dhe të teksteve;

dh) drejton trupin pedagogjik, bashkërendon punën me ta, drejton punën për përgatitjen e planit mësimor e të programeve mësimore të çdo lënde, duke ia propozuar Këshillit Drejtues për miratim, si dhe kontrollon zbatimin e tyre dhe cilësinë e mësimdhënies;

e) i propozon Këshillit Drejtues kandidatët për pedagogë të jashtëm dhe trajnuesit e programit të formimit vazhdues, sipas kritereve të caktuar në këtë ligj;

ë) bashkëpunon me gjykatat, prokuroritë dhe institucionet e sistemit të drejtësisë, me qëllim vlerësimin e nevojave të trajnimit vazhdues, si dhe kujdeset për mbarëvajtjen e programit të trajnimit vazhdues të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve të shtetit, nëpunësve civilë gjyqësorë, si dhe profesioneve të tjera, sipas rastit.

2. Drejtori i Shkollës, në bashkëpunim me Këshillin Pedagogjik, i

propozon Këshillit Drejtues, emërimin ose shkarkimin nga detyra të personelit mësimdhënës dhe të kancelarit. Lirimi nga detyra i personelit të brendshëm dhe të jashtëm mësimdhënës bëhet vetëm pasi të jetë paraqitur propozimi i arsyetuar nga Komisioni Disiplinor dhe të merret mendimi edhe i Këshillit Pedagogjik të Shkollës. Vlerësimi i kandidatëve për magjistratë për stafin mësimdhënës e shoqëron këtë proces.

3. Drejtori emëron ose shkarkon nga detyra punonjësit e personelit administrativ të shkollës, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

4. Nën autoritetin e drejtorit, kancelari i shkollës realizon veprimtarinë financiaro-administrative të institucionit.

Neni 252
Kushtet për largimin nga detyra të Drejtorit të Shkollës

1. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës lirohet nga detyra, nga Këshilli Drejtues kur:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandatin 4-vjeçar dhe nuk rizgjidhet;

c) jep dorëheqjen;

ç) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;

d) shkarkohet sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni;

2. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës shkarkohet nga Këshilli Drejtues nëse:

a) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

b) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij gjatë ushtrimit të detyrës;

c) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit Drejtues nëse:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

4. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës mund të pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit Drejtues nëse ndaj tij fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

5. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë.

Neni 253
Përbërja dhe detyrat e Këshillit Pedagogjik

1. Këshilli Pedagogjik kryesohet nga Drejtori i Shkollës dhe ka në përbërje:

a) personelin mësimdhënës të brendshëm dhe titullarët e lëndëve kryesore, me karakter formues e profesional, të përcaktuar nga Këshilli Drejtues;

b) një gjyqtar dhe një prokuror, që janë zgjedhur si anëtarë të Këshillit Drejtues.

2. Detyrat dhe rregullat për funksionimin e Këshillit Pedagogjik janë:

a) merr pjesë në përgatitjen e planit mësimor të Formimit Fillestar dhe programit tematik të Formimit Vazhdues;

b) jep mendim për hartimin e listës së trajnerëve të jashtëm dhe pedagogëve të brendshëm të shkollës, duke shqyrtuar çdo propozim që drejtori i përcjell Këshillit Drejtues;

c) analizon, pas një procesi transparent e gjithëpërfshirës, raportet e vlerësimit të punës së trajnerëve dhe pedagogëve nga kandidatët për magjistratë e stafi mësimdhënës dhe i përcjell Këshillit Drejtues mendimin për vijimësinë e ushtrimit të detyrës prej tyre;

ç) merr pjesë, në përputhje me këtë ligj, në shqyrtimin e procesit disiplinor të inicuar ndaj personelit mësimdhënës;

d) shqyrton, pas një procesi transparent e gjithëpërfshirës, propozimin e drejtorit për t'ia përcjellë Këshillit Drejtues, emrat e pedagogëve dhe trajnerëve të rinj që i shtohen stafit akademik të Shkollës së Magjistraturës;

dh) shqyrton dhe miraton rekomandimet e asamblesë së kandidatëve për cikle speciale leksionesh në fusha specifike të së drejtës, etikës, sociologjisë dhe psikologjisë juridike, si dhe përpunon orientime për veprimtarinë praktike të kandidatëve gjatë stazhit paraprofesional dhe profesional;

e) bën vlerësimin përfundimtar të kandidatëve të programit të Formimit Fillestar të vitit të parë dhe vitit të dytë, mbi bazën e rezultateve të arritura gjatë periudhës dyvjeçare të vitit teorik dhe stazhit paraprofesional;

ë) ndjek në vazhdimësi zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues në veprimtarinë akademike të shkollës.

Neni 254
Mbledhjet dhe vendimmarrja e Këshillit pedagogjik

1. Këshilli Pedagogjik mblidhet me kërkesën e Drejtorit të Shkollës.

2. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit Pedagogjik është më shumë se gjysma e anëtarëve. Këshilli Pedagogjik i merr vendimet me votim të hapur dhe me shumicë votash. Kur votat janë të barabarta, përcaktuese është vota e kryetarit.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, rregullat dhe procedurat e parashikuara në ligjin "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", zbatohen për organizimin e mbledhjeve dhe vendimmarrjen e Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës.

KREU III
DISIPLINA

Neni 255
Përgjegjësia disiplinore

Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, pedagogët e brendshëm dhe kandidatët për magjistratë mbajnë përgjegjësi për shkeljet disiplinore, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloren e brendshme të shkollës.

Neni 256
Hetimi disiplinor

1. Prokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja "gj", kryen verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara të kandidatëve për magjistratë. Në rast parandalimi ose konflikti të interesave ai përfaqësohet nga Zëvendësprokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja "gj", të këtij ligji.

2. Kancelari i Shkollës së Magjistraturës kryen verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara të nëpunësve civilë të Shkollës së Magjistraturës. Në rast parandalimi ose konflikti të interesave ai përfaqësohet nga një prej pedagogëve të brendshëm me përvojën më të gjatë, që nuk është anëtar i Këshillit Drejtues.

3. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës kryen verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara të pedagogëve të brendshëm. Në rast parandalimi ose konflikti të interesave ai përfaqësohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë me përvojën më të gjatë profesionale si gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë me përvojën më të gjatë profesionale si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, përveç kryetarit, kryen verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës. Në rast parandalimi ose konflikti të interesave ai përfaqësohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë, i dyti për nga përvoja më e gjatë profesionale si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, përveç kryetarit.

Neni 257
Komisioni Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor që kryen procedimin disiplinor dhe cakton masën disiplinore është i pavarur dhe i nënshtrohet vetëm ligjit.

2. Në rastin e procedimit disiplinor ndaj kandidatit për magjistrat, Komisioni Disiplinor përbëhet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës si kryetar, një gjyqtar dhe një prokuror të zgjedhur në përputhje me nenin 247, pika 1, shkronja "d", të këtij ligji, si anëtarë të Këshillit Drejtues, dhe dy kandidatë për magjistratë të zgjedhur me votë të fshehtë nga asambleja e kandidatëve për magjistratë.

3. Në rastin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësve civilë, Komisioni Disiplinor përbëhet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës si kryetar, një gjyqtar dhe një prokuror të zgjedhur në përputhje me nenin 247, pika 1, shkronja "d", të këtij ligji, si anëtarë të Këshillit Drejtues, dhe dy përfaqësues të nëpunësve civilë të përzgjedhur me short, me përjashtim të personit në fjalë.

4. Në rastin e procedimit disiplinor ndaj pedagogëve të brendshëm dhe ndaj Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, Komisioni Disiplinor është Këshilli Drejtues, përveç drejtorit, dhe i njëjti rregull, për aq sa mund të zbatohet, pedagogu i brendshëm.

Neni 258
Hetimi dhe procedimi disiplinor

1. Organi kompetent për hetimin disiplinor dhe procedimin disiplinor zbaton, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, dispozitat e kreut V për përgjegjësinë disiplinore të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Vendimi i organit kompetent për hetimin, në lidhje me arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit mund të ankimohet në gjykatën administrative të shkallës së parë.

3. Vendimet e Komisionit Disiplinor dhe të Këshillit Drejtues mund të ankimohen në gjykatën administrative të shkallës së parë.

4. Këshilli Drejtues miraton rregulla më të detajuara për zbatimin e dispozitave për hetimin dhe procedimin disiplinor të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

5. Vendimet në lidhje me përgjegjësinë disiplinore bëhen pjesë e dosjes personale të tyre.

Neni 259
Shkeljet disiplinore

1. Drejtori i Shkollës dhe pedagogët e brendshëm kryejnë shkelje disiplinore nëse:

a) veprojnë me neglizhencë në kryerjen e detyrës profesionale, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni;

b) nuk marrin parasysh ligjin ose faktet, si rezultat i një neglizhence të rëndë të pajustifikueshme, veprimi të qëllimshëm ose paaftësie të dukshme;

c) çdo rast tjetër të pajustifikueshëm të sjelljeve ose veprimeve gjatë ushtrimit të detyrës ose detyrave të jashtme, që e diskrediton institucionin, ose dëmton rëndë besimin e publikut tek institucioni.

2. Një neglizhencë në kryerjen e detyrës profesionale duhet të konsiderohet si shkelje disiplinore vetëm nëse gabimet në ofrimin e shërbimit janë qartësisht përtej asaj që mund të pritet normalisht nga një pedagog i zakonshëm. Për përcaktimin e kufirit ndërmjet çështjeve të performancës, nga njëra anë, dhe shkeljeve disiplinore, nga ana tjetër, do të merren veçanërisht në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

a) shkalla e neglizhencës;

b) shpeshtësia e ndodhjes së disavantazheve/të metave;

c) pozicioni brenda sistemit;

ç) probabiliteti dhe intensiteti i dëmit që vjen nga sjellja;

d) situatat që janë jashtë kontrollit të pedagogut dhe që mund të shpjegohen në mënyrë të arsyeshme nga keqfunksionimi i sistemit në tërësi.

3. Në këtë nen, referenca ndaj veprimit përfshin edhe referencën ndaj mosveprimit.

Neni 260
Masat disiplinore ndaj drejtorit ose pedagogëve të brendshëm

1. Masat disiplinore që Komisioni Disiplinor mund t'i propozojë Këshillit Drejtues për drejtorin ose pedagogët e brendshëm janë:

a) vërejtje me paralajmërim;

b) vërejtje publike;

c) ulje në pagë deri në një maksimum prej 40 për qind, për një periudhë që nuk e kalon një vit;

ç) pezullim nga detyra me pagesën e një page minimale, siç përcaktohet në aktet nënligjore, për një periudhë specifike nga tre muaj deri në një vit;

d) largimin nga detyra.

2. Rregullimet e parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

3. Ndaj vendimit të Këshillit Drejtues bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë.

Neni 261
Masat disiplinore ndaj kandidatëve për magjistratë

1. Shkeljet disiplinore, që mund të kryhen nga kandidatët për magjistratë, përcaktohen hollësisht në rregulloren e shkollës. Masat disiplinore, që jepen për këto shkelje ndaj kandidatëve për magjistratë, janë:

a) vërejtje;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) transferim nga vendi i praktikës profesionale;

ç) ulje të "bursës së shkollimit" deri në masën 30 për qind të shumës totale, për një periudhë nga 3 deri në 6 muaj;

d) përjashtim nga shkolla.

2. Masat disiplinore, të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" jepen nga Drejtori i Shkollës, kurse ato të parashikuara në shkronjat "ç", dhe "d", të pikës 1, këtij neni, jepen nga Komisioni Disiplinor, me propozimin e Drejtorit të Shkollës, ose të jo më pak se 3 prej anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

3. Asnjë masë disiplinore nuk mund të jepet pa u dëgjuar më parë personi që procedohet.

4. Masat disiplinore, të dhëna nga Drejtori i Shkollës, mund të ankimohen në Komisionin Disiplinor, kurse ato të dhëna nga ky i fundit mund të ankimohen në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë të Tiranës brenda 10 ditëve nga data e komunikimit. Ankimi i bërë nuk e pezullon zbatimin e masës disiplinore për vitin e parë dhe të dytë.

5. Masa disiplinore nuk mund të jepet kur ka kaluar 1 vit nga kryerja e shkeljes.

6. Masat disiplinore, të dhëna sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij neni, shlyhen pas një viti nga data e dhënies së tyre. Masat disiplinore, të dhëna sipas shkronjave "c" dhe "ç" shlyhen pas dy vjetëve nga data e dhënies së tyre.

7. Rregullat e hollësishme për procedimin disiplinor të kandidatëve për magjistratë caktohen nga rregullorja e shkollës, e cila publikohet në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës.

8. Procedimi disiplinor për kandidatët për magjistratë gjatë periudhës së praktikës profesionale të vitit të tretë bëhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

9. Procedurat dhe vendimet e marra për procedimin disiplinor të kandidatëve për magjistratë pasqyrohen në dosjen e tyre personale.

KREU IV
FUNKSIONIMI I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Neni 262
Regjistrimi i konkurrentëve

1. Thirrja për aplikime, procesi i regjistrimit për konkurrim në Shkollën e Magjistraturës dhe vlerësimi paraprak për plotësimin e kritereve kryhen sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Kandidati duhet të dorëzojë, së bashku me dokumentacionin e kërkuar për regjistrim, një deklarim nëse zgjedh profilin e gjyqtarit ose të prokurorit. Në rast se aplikanti ka zgjedhur më shumë se një profil, atëherë dosja me dokumentacionin e aplikimit do të përcillet në Këshillin e Lartë Gjyqësor ose në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

3. Procedurat e konkursit zhvillohen sipas parashikimeve të këtij ligji.

4. Testimi ka për qëllim vlerësimin e figurës së kandidatit për magjistrat dhe zhvillohet sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"," dhe të nenit 266 të këtij ligji. Procesi i vlerësimit të integritetit zhvillohet në bazë të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

5. Viti akademik hapet të hënën e parë të muajit tetor dhe mbaron jo më vonë se fundi i korrikut të vitit pasardhës.

Neni 263
Programi i formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë

1. Formimi fillestar i kandidatëve për magjistratë përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

a) një vit program teorik që synon të rrisë njohuritë në lëndë të ndryshme të së drejtës;

b) një vit program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë dhe prokurorë nën kujdesin e shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori me kualifikim të lartë;

c) një vit praktikë profesionale që do të organizohet sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Programi i trajnimit, i parashikuar sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, është i përbashkët për të gjithë kandidatët dhe organizohet, ndiqet e drejtohet nga Shkolla e Magjistraturës. Viti i praktikës paraprofesionale zhvillohet sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror.

Neni 264
Zgjedhja dhe emërimi i pedagogëve, përgjegjësve për programet e trajnimit dhe kancelarit

1. Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm emërohen nga Këshilli Drejtues me propozim të drejtorit ose të anëtarëve të Këshillit Drejtues, pas një procesi transparent e gjithëpërfshirës të bazuar në meritë dhe në një proces konkurrues.

2. Pedagogët e brendshëm zgjidhen nga radhët e juristëve më të shquar me eksperiencë mbi 15-vjeçare si juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe me eksperiencë mësimdhënëse si pedagogë të brendshëm në sistemin universitar ose si pedagogë të jashtëm e të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, me eksperiencë mbi 10 vjet.

3. Pedagogët e brendshëm gëzojnë të gjitha të drejtat dhe privilegjet e gjyqtarit të gjykatës së apelit.

4. Për lëndët kryesore mund të aktivizohen edhe pedagogë të jashtëm, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, për pedagogët e brendshëm. Nëse kandidati për pedagog i jashtëm vjen nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve në detyrë, të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të plotësojë kriteret e të qenit 10 vjet gjyqtar ose prokuror dhe me eksperiencë mësimdhënie universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi 5 vjet. Në raste përjashtimore për lëndët specifike me karakter teknik mund aktivizohen specialistë të atyre fushave.

5. Pedagogët, për lëndët që zhvillojnë vetë, duhet të ndjekin edhe kurset dhe seminaret për trajnimin e trajnerëve që zhvillohen periodikisht nga shkolla apo institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

6. Përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues zgjidhen nga Këshilli Drejtues nga radhët e pedagogëve të brendshëm të shkollës.

7. Kancelari i Shkollës së Magjistraturës emërohet nga Këshilli Drejtues dhe gëzon të drejtat dhe privilegjet e kancelarit të gjykatës së apelit.

Neni 265
Pedagogët gjyqtarë ose prokurorë

1. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës mund t'i kërkojë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë që gjyqtarë ose prokurorë në detyrë të komandohen si pedagogë të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, bazuar në procedurën e përcaktuar në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Gjyqtari ose prokurori që shërbejnë në funksionin e pedagogut të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës, me kërkesë të tij, qëndron në detyrë si pedagog i brendshëm, për një periudhë deri në 5 vjet, përveç rasteve kur jep dorëheqjen ose largohet nga detyra.

3. Periudha e ushtrimit të funksioneve si pedagog i brendshëm njihet si periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtar a prokuror, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore.

4. Me mbarimin e komandimit, gjyqtarët ose prokurorët, që punojnë si pedagogë të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, duhet të kenë të drejtë të kthehen në pozicionin e tyre të mëparshëm, në përputhje me ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 266
Konkurrimi dhe pranimi i kandidatëve për magjistratë

1. Aplikantët i nënshtrohen konkursit, i cili zhvillohet nën monitorim. Testimi i dijeve gjatë konkursit të pranimit bëhet së paku me shkrim.

2. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, pasi merr mendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Ministrit të Drejtësisë, miraton rregulla të hollësishme, të qarta, transparente dhe objektive për kriteret dhe procedurat që do të ndiqen në vlerësimin e njohurive dhe aftësive të konkurrentëve, sipas profileve të kërkuara prej tyre dhe për mënyrën e korrigjimit të provimeve.

3. Konkursi organizohet me dy faza, që pasohen nga një vlerësim psikologjik dhe i shëndetit mendor. Faza e parë është me natyrë kualifikuese dhe kryhet nëpërmjet një vlerësimi elektronik.

4. Pas kalimit të vlerësimit elektronik, kandidatët futen në fazën e dytë të konkurrimit, që zhvillohet së paku me shkrim para një komisioni të përbërë, sipas rastit, nga 5 deri në 7 anëtarë, të caktuar nga Këshilli Drejtues, nga të cilët 2 deri në 3 janë pedagogë të brendshëm dhe 3 deri në

4 janë pedagogë të jashtëm, me eksperiencë mësimdhënieje në Shkollën e Magjistraturës mbi 5 vjet. Pedagogët e jashtëm nuk mund të jenë dy herë në mënyrë të njëpasnjëshme anëtarë të komisionit.

5. Kandidatët që kualifikohen në fazën e dytë kalojnë në një vlerësim psikologjik dhe të shëndetit mendor që kryhet nga një komision i ngritur nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë. Ky komision përbëhet nga dy psikologë dhe dy mjekë psikiatër. Një pedagog i brendshëm i Shkollës së Magjistraturës merr pjesë si vëzhgues në mbledhjet e këtij komisioni gjatë gjithë vlerësimit.

6. Në përfundim të dy fazave të konkurrimit dhe pas kryerjes së vlerësimit psikologjik dhe të shëndetit mendor, Shkolla e Magjistraturës përgatit listën e kandidatëve të renditur sipas rezultatit të testimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, si dhe në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

7. Mënyra e organizimit të konkurrimit në të dy fazat, rregullat e hollësishme që ndiqen për kryerjen e vlerësimit psikologjik dhe të shëndetit mendor, që zbatohet edhe gjatë viteve të shkollimit, procedurat që ndjekin dhe vlerësimi që kryejnë komisionet përkatëse, si dhe aspektet teknike të veprimtarisë së tyre përcaktohen në rregulloren e shkollës.

8. Konkurrentët kanë të drejtën e ankimit me shkrim pranë Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e testimit, vetëm për shkelje të karakterit procedural.

9. Lista e konkurrentëve i dërgohet respektivisht Këshillit të Lartë Gjyqësor, për konkurruesit që kanë zgjedhur profilin e gjyqtarit në fazën e aplikimeve dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për konkurruesit që kanë zgjedhur profilin e prokurorit.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kryejnë verifikimin e pasurisë dhe të figurës së konkurrentëve, në përputhje me ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe i dërgojnë Shkollës së Magjistraturës listën përfundimtare të kandidatëve të pranuar.

11. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës publikon për secilin profil një listë konkurrentësh. Me nënshkrimin e marrëveshjes së regjistrimit, e cila parashikon të drejtat dhe përgjegjësitë për frekuentimin e programit të formimit fillestar, kandidati për magjistrat konsiderohet i regjistruar në Shkollën e Magjistraturës.

12. Kandidatët e pranuar janë të detyruar të frekuentojnë rregullisht

programin dhe të respektojnë rregulloren e shkollës.

Neni 267
Bursa e shkollimit të kandidatëve për magjistratë

Kandidatët, gjatë periudhës së ndjekjes së programit të formimit fillestar, marrin një bursë shkollimi. Skema e përllogaritjes së kësaj burse, si dhe të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrjen e tij parashikohen në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 268
Vlerësimi i formimit fillestar për kandidatët për magjistratë

1. Vlerësimi i të gjithë komponentëve të vitit të parë dhe të vitit të dytë, mbi pikët e grumbulluara për çdo lëndë, ose element të programit të formimit fillestar dhe në tërësi, si dhe vlerësimi i provimit përfundimtar që organizohet pas vitit të dytë, bëhen nga komisionet përkatëse dhe Këshilli Pedagogjik, sipas një renditjeje të pikëzuar me 5 shkallë:

a) "shkëlqyeshëm";

b) "shumë mirë";

c) "mirë";

ç) "mjaftueshëm";

d) "pamjaftueshëm".

2. Provimi përfundimtar bëhet me shkrim dhe organizohet me katër raste praktike nga fushat e mëposhtme:

a) pjesa e parë - E drejta private (civile, familjare e punës, tregtare) dhe e drejta procedurale civile;

b) pjesa e dytë - E drejta penale dhe procedurale penale;

c) pjesa e tretë - E drejta administrative materiale dhe e drejta procedurale administrative;

ç) pjesa e katërt - E drejta publike (kushtetuese, të drejtat e njeriut, ndërkombëtare, legjislacioni i BE-së etj.).

3. Provimi përfundimtar vlerësohet nga një komision i përbërë nga gjashtë anëtarë, nga të cilët katër anëtarë nga radhët e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së Magjistraturës dhe nga një anëtar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

4. Rregulla më të detajuara që lidhen me provimin përfundimtar përcaktohen në rregulloren e shkollës.

5. Nuk lejohet ridhënia e provimeve të vitit të parë dhe të dytë, si dhe e provimit përfundimtar, me qëllim përmirësimin e rezultateve.

6. Frekuentimi i çdo provimi në datën e caktuar nga Shkolla e Magjistraturës për kandidatët e vitit akademik, është i detyrueshëm, përveçse në rastet kur paraqiten arsye të përligjura dhe objektive. Dhënia e provimit në këto raste, për efekt të ruajtjes së sekretimit, kryhet me kandidatët e vitit pasardhës.

7. Vlerësimi "pamjaftueshëm" i marrë dy herë radhazi, të paktën në dy lëndë ose në provimin përfundimtar, passjell, sipas rastit, humbjen e së drejtës për vijimin e studimeve në Shkollën e Magjistraturës. Rregulla më të detajuara të ridhënies së provimit për këtë rast përcaktohen me rregulloren e Shkollës së Magjistraturës.

8. Rregullat, skema e renditjes dhe procedurat më të detajuara të vlerësimit të komponentëve të vitit të parë dhe të dytë të programit të formimit fillestar, si dhe të provimit përfundimtar përcaktohen në rregulloren e Shkollës së Magjistraturës.

Neni 269
Vlerësimi i praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë

1. Vlerësimi i veprimtarisë gjatë praktikës profesionale të vitit të tretë të programit të formimit fillestar kryhet sipas parashikimit të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve pas vitit të tretë të programit të trajnimit fillestar bëhet nga Këshilli Pedagogjik, në bazë të rezultateve të provimeve të vitit të parë, të stazhit paraprofesional dhe të provimit përfundimtar, sipas sistemit me 5 shkallë, mbi bazën e një renditjeje përfundimtare të tyre me pikë.

3. Këshilli Drejtues i Shkollës harton një propozim për vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë dhe programin e udhëheqësve, vlerësimin e performancës së stazhit profesional, si dhe një raport për rezultatet e vlerësimit të vitit të parë, të vitit të dytë dhe të provimit përfundimtar.

4. Drejtori i Shkollës përcjell vendimin e Këshillit Pedagogjik, ku janë bashkuar sipas një renditjeje me pikë vlerësimet me 5 shkallë të dy viteve të para, të provimit përfundimtar dhe të praktikës profesionale të vitit të tretë, Këshillit Drejtues të Shkollës, Këshillit të Lartë të Gjyqësorit

për kandidatët për gjyqtarë, si dhe Këshillit të Lartë të Prokurorëve, për kandidatët për prokurorë.

Neni 270
Kategoritë e vlerësimit të kandidatëve për magjistratë

1. Vlerësimi i kandidatëve për magjistratë bëhet sipas kategorive që vijojnë:

a) "shkëlqyeshëm", në rast të një performance etike dhe profesionale jashtëzakonisht të mirë;

b) "shumë mirë", në rast të një performance etike dhe profesionale mbi mesataren;

c) "mirë", në rast të një performance etike dhe profesionale mesatare;

ç) "pranueshëm", në rast të një performance etike dhe profesionale nën mesataren;

d) "i paaftë", në rast të një performance etike dhe profesionale jashtëzakonisht të dobët.

2. Vlerësimi i përgjithshëm "shkëlqyeshëm" jepet vetëm nëse detyra e magjistratëve është "e shkëlqyer" për të katër kriteret, sipas parashikimeve të nenit 71, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Vlerësimi i përgjithshëm "shumë mirë" jepet vetëm nëse detyra e magjistratëve është të paktën "shumë e mirë" për tre kritere dhe "e mirë" për kriterin e ngelur. Në çdo rast, kriteret "aftësi profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit" dhe "etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit" duhen vlerësuar të paktën "shumë mirë".

4. Në rast se aftësitë e magjistratëve vlerësohen "mirë" në dy kritere, dhe "pranueshëm" në kriteret e ngelura, magjistrati vlerësohet përgjithësisht "mirë". I njëjti rregull zbatohet edhe për barazimin e vlerësimit të kritereve midis kategorive "pranueshëm' dhe "i paaftë", përveç rastit kur pika 3 e këtij neni parashikon ndryshe. Në çdo rast, kriteret "aftësi profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit" dhe "etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit" duhen vlerësuar të paktën "shumë mirë".

5. Vlerësimi i përgjithshëm "i paaftë" jepet në rastet që vijojnë:

a) nëse detyra e magjistratëve vlerësohet si "e paaftë" në tre kriteret e parashikuara në shkronjat "b", "c" dh "ç", të nenit 71, të ligjit nr.

96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

b) nëse detyra e magjistratëve vlerësohet si "e paaftë" në kriteret "aftësi profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit" dhe "etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit", dhe jo më tepër se "mirë" në dy kriteret e tjera.

Neni 271
Emërimi i magjistratëve

Emërimi i magjistratëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës pas përfundimit me sukses të programit të formimit fillestar bëhet në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 272
Formimi vazhdues

1. Gjyqtarët dhe prokurorët i nënshtrohen formimit vazhdues sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, harton dhe organizon programin e formimit të vazhdueshëm.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, miratojnë pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimin vazhdues, sipas programit të përcaktuar të formimit vazhdues dhe ia dërgojnë Shkollës së Magjistraturës në fillim të vitit akademik.

4. Shkolla e Magjistraturës, për raste të veçanta dhe përjashtimore, për të mos penguar procesin e trajnimit, nisur nga nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve për trajnim, të ndryshimeve të legjislacionit dhe problemeve të praktikës, me kërkesë të tyre, ose me iniciativën e vet, mund të përditësojë programin tematik dhe listat e pjesëmarrësve në trajnimin vazhdues. Shkolla e Magjistraturës, në këtë rast, vë në dijeni Këshillin e Lartë Gjyqësore dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për miratimin e listave, përjashtimisht nga rregulli i pikës 2 të këtij neni.

5. Gjyqtarët dhe prokurorët, që marrin pjesë në formimin vazhdues, pajisen me certifikatë, të lëshuar nga Drejtori i Shkollës.

Neni 273
Konkurrimi, formimi fillestar dhe vazhdues i avokatëve të shtetit

1. Aplikantët për avokatë shteti i nënshtrohen të njëjtit konkurrim si kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë.

2. Programi i trajnimit fillestar të avokatëve të shtetit është dyvjeçar, nga të cilët viti i parë dhe viti i dytë është i njëjtë me programin e formimit fillestar të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.

3. Praktika paraprofesionale organizohet në bazë të rregullave të parashikuara në një rregullore të posaçme të miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës.

4. Kandidatët për avokatë shteti i nënshtrohen provimit përfundimtar të studimeve në Shkollën e Magjistraturës.

5. Avokatët e shtetit në detyrë ndjekin aktivitetet e programit të formimit vazhdues, sipas temave, afateve dhe listës së miratuar nga Avokati i Shtetit në marrëveshjen e përbashkët me Shkollën e Magjistraturës.

Neni 274
Konkurrimi, formimi fillestar dhe vazhdues i këshilltarëve ligjorë të gjykatave dhe prokurorive

Konkurruesit për kandidatë për këshilltarë ligjorë të gjykatave dhe prokurorive, që parashikojnë kushtet e parashikuara në ligj, i nënshtrohen të njëjtit konkurrim si konkurruesit për gjyqtarë dhe prokurorë.

Neni 275
Administrata e Shkollës së Magjistraturës

1. Pranë Shkollës së Magjistraturës vepron administrata, e cila ndihmon në realizimin e misionit dhe funksioneve të shkollës.

2. Administrata e Shkollës së Magjistraturës drejtohet nga kancelari, i cili përgjigjet para Drejtorit të Shkollës.

3. Personeli administrativ i Shkollës së Magjistraturës ka statusin e nëpunësit civil, në bazë të dispozitave të ligjit "Për nëpunësin civil".

4. Shkolla e Magjistraturës punëson punonjës administrativë, sipas rregullave të Kodit të Punës.

PJESA VII
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

KREU I
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Neni 276
Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, gjyqtarët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor paraqesin pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit një kërkesë ku shprehin interesin për të kandiduar dhe dokumentacionin që kërkohet për rivlerësimin, sipas ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Në rast se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk është krijuar ende, kërkesa depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

2. Brenda të njëjtit afat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, gjyqtarët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor i paraqesin Kryetarit të Gjykatës së Lartë dokumentacionin përkatës, sipas nenit 10 të këtij ligji. Kryetari i Gjykatës së Lartë vë në dispozicion të gjyqtarëve të interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit formularët tip të parashikuar nga shkronjat "b", "c" dhe "e", të nenit 10, të këtij ligji.

3. Brenda 7 ditëve nga paraqitja e dokumentacionit, sipas nenit 10, të këtij ligji, Kryetari i Gjykatës së Lartë verifikon përmbushjen e kritereve ligjore, sipas procedurave të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji. Në rast se kandidati nuk i plotëson kriteret, Kryetari i Gjykatës së Lartë njofton kandidatin dhe Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

4. Brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1, të këtij neni, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bën rivlerësimin e gjyqtarëve që kandidojnë. Gjyqtari, i cili, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk e kalon procedurën e rivlerësimit përjashtohet nga procesi i kandidimit, edhe kur ndaj vendimit të komisionit është ushtruar ankim. Zgjedhja e kandidatëve vazhdon pa pjesëmarrjen e këtij kandidati.

5. Jo më vonë se 3 ditë pas përfundimit të procedurës së rivlerësimit,

Komisioni i Pavarur i Rivlerësimit i përcjell Kryetarit të Gjykatës së Lartë listën me emrat e kandidatëve gjyqtarë që e kaluan me sukses procedurën e rivlerësimit.

6. Brenda 3 ditëve nga data e mbërritjes së listës nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kryetari i Gjykatës së Lartë thërret mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë të Këshillit përfundon brenda 20 ditëve nga data e thirrjes.

7. Anëtari i zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, një nga anëtarët që vjen nga gjykatat e apelit, i zgjedhur me short, si dhe një nga anëtarët që vjen nga gjykatat e shkallës së parë, i zgjedhur me short, shërbejnë vetëm për një mandat 3-vjeçar.

8. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, strukturat përgjegjëse për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë jomagjistratë të Këshillit të Lartë Gjyqësor fillojnë veprimet dhe procedurat e parashikuara nga ky ligj për përzgjedhjen e kandidatëve. Procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve përfundojnë brenda 4 muajve.

9. Nëse Kryetari i Gjykatës së Lartë nuk e thërret Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 3 ditëve pas përfundimit të procedurës së rivlerësimit të kandidatëve, mbledhjen e thërret një e dhjeta e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve. Në këtë rast mbledhjen e drejton gjyqtari më i vjetër në moshë i Gjykatës së Lartë.

10. Mosthirrja e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose tejkalimi i afatit për thirrjen e saj, si dhe mosfillimi i procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor përbëjnë shkelje disiplinore për subjektet e parashikuara në pikat 8 dhe 9 të këtij neni.

11. Deri në krijimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, detyrat e Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas neneve 23 deri në 31 dhe neneve 33 dhe 34, të këtij ligji, ushtrohen nga një prej kryetarëve të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë të zgjedhur me short.

Neni 277
Krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë qëndrojnë në detyrë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Mandati i anëtarëve përfundon në ditën kur zgjidhet anëtari i fundit i Këshillit të Lartë Gjyqësor, por në çdo

rast jo më vonë se 8 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet në ditën kur anëtari i fundit i tij zgjidhet nga autoritetet kompetente. Anëtari jomagjistrat më i vjetër në moshë, i zgjedhur nga Kuvendi, përgatit dhe thërret mbledhjen e parë të Këshillit të Lartë Gjyqësor jo më vonë se 3 ditë pas datës së zgjedhjes së të gjithë anëtarëve.

3. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhen në mbledhjen e parë. Pas zgjedhjes së tyre, kryetari kryeson mbledhjen. Në mbledhjen e parë Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton një vendim deklarues, i cili përmban datën e krijimit të Këshillit.

4. Në ditën e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të gjitha dosjet dhe dokumentacioni në administrim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i kalon Këshillit të Lartë Gjyqësor nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kryeinspektorit.

5. Jo më vonë se 1 muaj nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sistemet aktuale të teknologjisë së informacionit, përfshirë edhe kontratat në fuqi për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e këtyre sistemeve, si dhe çdo dokument tjetër teknik ose juridik kalojnë në dorëzim dhe përgjegjësi të Këshillit nga drejtoria përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor bëhet palë në kontratat ekzistuese *ex lege*.

Neni 278
Ngritja e strukturave administrative dhe organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Nëpunësit civilë dhe punonjësit e Këshillit të Lartë Drejtësisë do të qëndrojnë në detyrë për një periudhë kalimtare deri 6 muaj pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Brenda afatit 6-mujor nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli vlerëson plotësimin e kritereve formale të punonjësve në detyrë për pozicionin që kryejnë, sipas këtij ligji. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër brenda administratës së Këshillit, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale, nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës.

3. Punonjësit e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor qëndrojnë në detyrë për një periudhë kalimtare deri 6 muaj pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Rregullimet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni,

zbatohen edhe për këtë kategori punonjësish.

4. Punonjësi në detyrë ka të drejtë të dëgjohet, të paraqesë deklarata dhe prova të tjera, të përfaqësohet dhe të drejtën e ankimit.

5. Derisa sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të jetë plotësisht funksional, Këshilli i Lartë Gjyqësor mundëson menaxhimin e çështjeve gjyqësore me mjete të tjera.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara për kritere të tjera që lidhen me specifikat e pozicionit të nëpunësve civilë, si dhe për procedurat, me qëllim zbatimin e unifikuar të standardeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Neni 279
Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, prokurorët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Prokurorisë paraqesin pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit një kërkesë ku shprehin interesin për të kandiduar dhe dokumentacionin që kërkohet për rivlerësimin, sipas ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Në rast se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk është krijuar ende, kërkesa depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

2. Brenda të njëjtit afat të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, prokurorët e interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë i paraqesin Prokurorit të Përgjithshëm dokumentacionin përkatës, sipas nenit 108 të këtij ligji. Prokurori i Përgjithshëm vë në dispozicion të prokurorëve të interesuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit formularët tip, të parashikuar nga shkronjat "b", "c" dhe "e", pika 3, të nenit 108, të këtij ligji.

3. Brenda 7 ditëve nga paraqitja e dokumentacionit, sipas nenit 108, të këtij ligji, Prokurori i Përgjithshëm verifikon përmbushjen e kritereve ligjore, sipas procedurave të parashikuara në nenin 109 të këtij ligji. Në rast se kandidati nuk i plotëson kriteret, Prokurori i Përgjithshëm njofton kandidatin dhe Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

4. Brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1, të këtij neni, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bën rivlerësimin e prokurorëve që kandidojnë. Prokurori, i cili, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk e kalon procedurën e rivlerësimit, përjashtohet nga procesi i kandidimit, edhe kur ndaj vendimit të komisionit është ushtruar ankim. Zgjedhja e kandidatëve vazhdon pa pjesëmarrjen e këtij kandidati.

5. Jo më vonë se 3 ditë pas përfundimit të procedurës së rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm listën me emrat e kandidatëve prokurorë që e kaluan me sukses procedurën e rivlerësimit.

6. Brenda 3 ditëve nga data e mbërritjes së listës nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Prokurori i Përgjithshëm thërret Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve prokurorë të Këshillit përfundon brenda 20 ditëve nga data e thirrjes.

7. Anëtari i zgjedhur nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, një nga anëtarët që vjen nga prokuroritë e apelit, i zgjedhur me short, si dhe një nga anëtarët që vjen nga prokuroritë e shkallës së parë i zgjedhur me short, shërbejnë vetëm për një mandat 3-vjeçar.

8. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, strukturat përgjegjëse për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë jomagjistratë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë fillojnë veprimet dhe procedurat e parashikuara nga ky ligj për përzgjedhjen e kandidatëve. Procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve përfundojnë brenda 4 muajve.

9. Nëse Prokurori i Përgjithshëm nuk e thërret Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë brenda 3 ditëve pas përfundimit të procedurës së rivlerësimit të kandidatëve, mbledhjen e thërret menjëherë një e dhjeta e anëtarëve.

10. Mosthirrja e Mbledhjes së Përgjithshme të prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ose tejkalimi i afatit për thirrjen e saj, si dhe mosfillimi i procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarët joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë përbëjnë shkelje disiplinore për subjektet e parashikuara në pikat 8 dhe 9 të këtij neni.

11. Deri në krijimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, detyrat e Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas neneve 121 deri në 129 dhe neneve 131 dhe 132, të këtij ligji, ushtrohen nga një prej kryetarëve të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë të zgjedhur me short.

Neni 280
Krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet në ditën kur anëtari i fundit i tij zgjidhet nga autoritetet kompetente. Anëtari jomagjistrat më i vjetër në moshë, i zgjedhur nga Kuvendi, përgatit dhe thërret mbledhjen e parë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë jo më vonë se 3 ditë pas datës së zgjedhjes së të gjithë anëtarëve.

2. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhen në mbledhjen e parë. Pas zgjedhjes së tyre, Kryetari kryeson mbledhjen. Në mbledhjen e parë Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton një vendim deklarues, i cili përmban datën e krijimit të Këshillit.

Neni 281
Ngritja e strukturave administrative dhe organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Marrëdhëniet e punës të nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të tjera rregullohen sipas parashikimeve kalimtare të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregulla më të detajuara për kritere të tjera që lidhen me specifikat e pozicionit të nëpunësve civilë, si dhe për procedurat, me qëllim zbatimin e unifikuar të standardeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Derisa sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të jetë plotësisht funksional, Këshilli i Lartë i Prokurorisë mundëson menaxhimin e çështjeve gjyqësore me mjete të tjera.

KREU III
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Neni 282
Zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Gjyqtari ose prokurori ose subjektet e tjera, të cilët i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit dhe që janë të interesuar për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda një muaji nga krijimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i paraqesin komisionit një shkresë ku shprehin interesin për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

si dhe dokumentacionin për rivlerësimin, sipas ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Në rast se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk është krijuar ende, kërkesa depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Rivlerësimi i tyre bëhet me përparësi menjëherë me krijimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Çdo jurist tjetër i interesuar për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i dorëzon aplikimin për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili kryen vlerësimin e kandidatëve, mbështetur edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për aq sa është e mundur, për zbatimin e parashikimeve dhe procedurave të ligjit "Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Në rast se kandidatët e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nuk lejohen të kandidojnë me vendim të shkallës së parë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ata konsiderohen të papërshtatshëm për t'u zgjedhur, edhe kur ndaj vendimit është paraqitur ankim. Vlerësimi dhe renditja e kandidatëve nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bëhet pa pjesëmarrjen e këtij kandidati. Në rast se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është krijuar, edhe kandidatët, procesi i rivlerësimit të të cilëve nuk ka përfunduar në datën 1 shkurt 2017, përjashtohen nga procesi i zgjedhjes.

4. Pasi të gjithë kandidatët e përshtatshëm kanë kaluar procesin e rivlerësimit me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe i përcjell dosjen, me qëllim kryerjen e vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve.

5. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nis pa vonesë, por jo më vonë se data 1 shkurt 2017, procedurën për vlerësimin për përmbushjen e kritereve dhe renditjen e të gjithë kandidatëve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe e përfundon këtë procedurë brenda 10 ditëve. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i përcjell Kuvendit pa vonesa raportin.

Neni 283
Krijimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Brenda 1 muaji nga krijimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, magjistratët e interesuar për pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i dorëzojnë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit një kërkesë, me anë të së cilës shprehin interesin për kandidim, si dhe dokumentacionin për rivlerësimin, sipas ligjit për

rivlerësimin. Rivlerësimi i tyre bëhet me përparësi.

2. Çdo jurist tjetër i interesuar për pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda 1 muaji nga krijimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë, dorëzon aplikimin pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe bën verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet kërkesë për informacion për verifikimin e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 38, të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe çdo shkaku tjetër përjashtues, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokurorisë, organeve publike financiare, Byrosë Kombëtare të Hetimit, shërbimeve shtetërore informative, si dhe çdo organi disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e mëparshme të punës të kandidatit. Nëse vlerësohet e nevojshme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë informacione shtesë nga institucione të tjera.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë për kandidatin jomagjistrat bën vlerësimin e aftësive profesionale dhe morale, sipas kritereve të parashikuara për pozicionin e inspektorit.

6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë miraton një raport të arsyetuar me shkrim, bazuar në rezultatet e deklaratave të pasurisë, të vlerësimit të figurës, si dhe në përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të parashikuara në këtë ligj për kandidatin.

7. Pas emërimit të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, përcakton një strukturë të zyrës me numrin minimal të anëtarëve të stafit dhe fillon marrjen në punë të nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të nevojshëm për fazën fillestare, si dhe kërkon, nëse është e nevojshme, komandimin e magjistratëve, me qëllim sigurimin e të paktën 16 inspektorëve për fazën fillestare të 6 muajve pas krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Struktura përfundimtare përcaktohet brenda 6 muajve pas krijimit të zyrës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

8. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të konsiderohet e krijuar ditën e parë të muajit që vjen pas emërimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Kuvendi. Nëse kjo ditë është më pak se një javë pas emërimit, dita e parë e muajit pasardhës do të konsiderohet dita e

krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

9. Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pushon së zhvilluari veprimtaria e inspektimit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe përfundon mandati i Kryeinspektorit.

10. Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryeinspektori dhe inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët janë magjistratë, si dhe prokurorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve pranë Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme do të konsiderohen si inspektorë të Zyrës së Inpektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë 6-mujore nga data e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë. Në përfundim të kësaj periudhe ata do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë nëse plotësojnë kërkesat dhe kriteret për inspektor sipas parashikimeve të këtij ligji. Në këtë rast, mandati i tyre si inspektorë fillon me emërimin si inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose Prokurorinë e Përgjithshme. Në rast se ata nuk i përmbushin kërkesat dhe kriteret, ata kanë të drejtën e rikthimit në pozicionin e mëparshëm 6 muaj pas krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose të marrin pjesë në procedurat e transferimit dhe lëvizjes paralele, sipas rregullave të parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

11. Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të gjitha dosjet disiplinore në proces hetimi nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë të Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme kalojnë nga Kryeinspektori, drejtoritë përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme në përgjegjësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Çdo ankesë, në kuptim të këtij ligji, për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve i drejtohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KREU IV
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Neni 284
Krijimi i Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë

1. Prokurori i Përgjithshëm harton një listë me emrat e të gjithë prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive në nivel

apeli, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe ia dërgon atë menjëherë Presidentit të Republikës.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Drejtësisë harton një listë me emrat e të gjithë gjyqtarëve të gjykatave të apelit dhe të gjyqtarëve të gjykatës administrative të shkallës së parë, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe ia dërgon atë menjëherë Presidentit të Republikës.

3. Kryetari i Gjykatës së Lartë harton një listë me emrat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe ia dërgon atë menjëherë Presidentit të Republikës.

4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese harton një listë me emrat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe ia dërgon atë menjëherë Presidentit të Republikës.

5. Në rast se një ose disa nga institucionet e përmendura në pikat 1 - 4, të këtij neni, nuk e paraqesin listën, Presidenti i Republikës e harton listën vetë në bashkëpunim me Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Mosparaqitja e listës përbën shkelje disiplinore për subjektet e përmendura në pikat 1 - 4 të këtij neni.

6. Presidenti i Republikës organizon shortin për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të përkohshëm të emërimeve në drejtësi pa vonesë. Procedurat e shortit dokumentohen nga Presidenti i Republikës. Procedurat e shortit zhvillohen në prani të Avokatit të Popullit, i cili harton dhe bën publik një raport monitorimi mbi procedurën e shortit.

7. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi zgjidhen në përputhje me nenin 179, pika 11, të Kushtetutës.

8. Presidenti i Republikës boton një relacion për procesin e zgjedhjes në faqen zyrtare të Presidencës. Avokati i Popullit publikon raportin monitorues në faqen zyrtare të tij.

9. Anëtarët e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen rivlerësimit me përparësi.

KREU V
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

Neni 285
Shkolla e Magjistraturës

1. Brenda 30 ditëve nga konstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhen anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues, të cilët do të plotësojnë vendet që krijohen për efekt të këtij ligji. Me zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, këta janë edhe anëtarë të Këshillit Drejtues.

2. Drejtori dhe pedagogët e brendshëm të Shkollës së Magjistraturës qëndrojnë në detyrë, përveç rasteve kur nuk kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit ose largohen nga detyra bazuar në shkaqe të tjera të ligjshme.

3. Në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Shkolla e Magjistraturës ngarkohet me organizimin e një konkursi jashtë radhe për pranimin e 25 kandidatëve për magjistratë, respektivisht për vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018. Ndarja e profilit si gjyqtar dhe prokuror për kandidatët fitues për secilin vitin akademik do të jetë 15 gjyqtarë dhe 10 prokurorë, në rast të mungesës se një marrëveshjeje ndërmjet Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm ose ndërmjet institucioneve kompetente të tjera, që duhet të arrihet jo më vonë se 4 javë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Viti akademik 2016-2017 në Shkollën e Magjistraturës fillon pas përfundimit të konkursit, por, në çdo rast, jo më vonë se 4 javë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Konkursi i pranimit për vitin akademik 2017-2018 do të zhvillohet në muajin prill 2017, sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 286
Verifikimi i kandidatëve për anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Për emërimet e para për anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në përfundim të procedurës së përcaktuar në pikën 5, të nenit 35, dhe në nenet 53 dhe 58, të këtij ligji, i përcjell menjëherë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit një kopje të dokumentacionit të depozituar dhe administruar për çdo kandidat në Kuvendin e Shqipërisë.

3. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit vlerëson kandidatët brenda 7 ditëve nga dita e regjistrimit të listës së kandidatëve, dhe i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit listën e kandidatëve që:

a) plotësojnë kushtet e parashikuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj, si dhe kriteret morale dhe profesionale; si dhe

b) listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë ato.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në listat e kandidatëve që i përcjell komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, sipas shkronjave "a" dhe 'b", të pikës 7, pikës 8, të nenit 35, si dhe neneve 53 dhe 58, të këtij ligji, reflekton vlerësimin e përcjellë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, sipas pikës 3 të këtij neni. Një kopje e listave të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, sipas pikës 3, të këtij neni, i vihet në dispozicion edhe komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend.

5. Procedurat dhe rregullat e parashikuara në nenet 35, 53 dhe 58, të këtij ligji, për dokumentacionin, vlerësimin, zgjedhjen dhe votimin e anëtarëve jogjyqtarë, zbatohen edhe për emërimin për herë të parë të anëtarëve jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 287
Verifikimi i kandidatëve për anëtarët joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Për emërimet e para për anëtarët joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në përfundim të procedurës së përcaktuar në pikën 5, të nenit 133, dhe në nenet 151 dhe 156, të këtij ligji, i përcjell menjëherë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit një kopje të dokumentacionit të depozituar dhe administruar për çdo kandidat në Kuvendin e Shqipërisë.

3. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit vlerëson kandidatët brenda

7 ditëve nga dita e regjistrimit të listës së kandidatëve dhe i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit listën e kandidatëve që:

a) plotësojnë kushtet e parashikuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj, si dhe kriteret morale dhe profesionale, si dhe

b) listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë ato.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në listat e kandidatëve që i përcjell komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, sipas shkronjave "a" dhe 'b", të pikës 7, pikës 8, të nenit 133, si dhe neneve 151 dhe 156, të këtij ligji, reflekton vlerësimin e përcjellë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, sipas pikës 3 të këtij neni. Një kopje e listave të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, sipas pikës 3, të këtij neni, i vihet në dispozicion edhe komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend.

5. Procedurat dhe rregullat e parashikuara në nenet 133, 151, 156, të këtij ligji, për dokumentacionin, vlerësimin, zgjedhjen dhe votimin e anëtarëve joprokurorë, zbatohen edhe për emërimin për herë të parë të anëtarëve joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KREU VI
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 288
Ngritja e Komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit

1. Jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi krijon një komision të pavarur për monitorimin e proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes së emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë.

2. Komisioni i pavarur miraton rregullat e veprimtarisë së tij. Komisioni ndihmohet në ushtrimin e funksioneve të tij nga administrata e Kuvendit.

3. Komisioni i pavarur bën koordinimin midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë parashikimet ligjore të këtij ligji, si dhe ndjek ecurinë e zbatimit të parashikimeve ligjore nga institucionet respektive, të parashikuara në ligj, brenda afateve ligjore të parashikuara.

4. Komisioni raporton pranë komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend dhe para Kuvendit për ecurinë e zbatimit të

ligjit sa herë është e nevojshme.

5. Veprimtaria e komisionit të pavarur zhvillohet në ambientet e Kryesisë së Kuvendit.

Neni 289
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të të nxjerrë akte nënligjore që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga pikat 3 dhe 4 të neni 278 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi i këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të nenit 281 të këtij ligji.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi i këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga pika 3 e nenit 283 të këtij ligji.

4. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 5 muajve nga hyrja në fuqi i këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga pika 4 e nenit 283 të këtij ligji.

5. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë rregulla për politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, të parashikuara në nenin 92 të ligjit.

Neni 290
Shfuqizime

1. Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rregullave që lidhen me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që i referohet ushtrimit të kompetencave sipas nenit 160 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, shfuqizohet në tërësi menjëherë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Ligji nr. 77/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare" shfuqizohet.

4. Ligji nr. 8363, datë 1.7.1998, "Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor", shfuqizohet me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Ligji nr. 8136, datë 31.7.1996, "Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 291

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A RI
Ilir META

Miratuar në datën 3.11.2016

LIGJ
Nr. 96/2016

PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË*

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me:

a) të drejtat dhe detyrimet e tyre;

b) pranimin dhe emërimin e tyre;

c) zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre;

ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre;

d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre;

2. Sipas parashikimeve të këtij ligji, statusi gëzohet ligjërisht nga një

---

* Vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese
Ndryshuar me Ligjin nr. 48, datë 18.07.2019;
Ndryshuar me Ligjin nr. 15, datë 12.02.2020;
Ndryshuar me Ligjin nr. 50, datë 23.03.2021;
Ndryshuar me Ligji nr.33, datë 25.5.2023;

person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Çështje pa palë ndërgjyqëse" për qëllim të vlerësimit etik dhe profesional është çdo çështje gjyqësore e regjistruar në gjykatë, e paraqitur në formën e kërkesës, me të cilën nuk kërkohet zgjidhja në themel e një mosmarrëveshjeje. Në këto çështje përfshihen çështjet civile dhe çështjet administrative pa palë kundërshtare, çështjet administrativo-penale dhe masat e sigurimit.

b) "Dokument ligjor" për qëllim të vlerësimit të aftësive profesionale nënkupton çdo dokument të përgatitur nga personi gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, si vendim gjykate, kërkesë për gjykim, raport/relacion, padi, mendim/opinion ligjor, si dhe akte të tjera që provojnë kapacitetet profesionale të personit.

c) "Ditë" janë ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune.

ç) "Nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike" do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës, pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose ministrit, që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit.

d) "Gjyqtar relator" është gjyqtari i caktuar me short në cilësinë e relatorit të trupit gjykues për gjykimin e një çështjeje gjyqësore.

dh) "I diplomuar" është personi, i cili është përfshirë në listën e renditjes së të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës, por nuk është emëruar ende si magjistrat.

e) "I emëruar" është personi, i cili është diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe është emëruar si magjistrat nga Këshilli ose një ish-gjyqtar ose prokuror që është riemëruar nga Këshilli, por nuk është caktuar ende në pozicion;

ë) "Këshillat" janë:

i. Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili është organi që merret me çështje që lidhen me gjyqtarët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magjistratë që ndjekin Shkollën e Magjistraturës, me qëllim që të bëhen gjyqtarë;

ii. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi që merret me çështje që lidhen me prokurorët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magjistratë që ndjekin Shkollën e Magjistraturës, me qëllim që të bëhen prokurorë.

f) "Koha mesatare e vendimit gjyqësor" është treguesi mesatar i kohës për arsyetimin e të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit të vendimit në sekretari.

g) "Kryetar" i referohet kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, përfshirë Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme.

gj) "Magjistrat" është gjyqtari, me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetarët në kuptim të shkronjës "g" të këtij neni.

h) "Ndihmësmagjistrat" është gjyqtari i komanduar për të ndihmuar gjyqtarët në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese, si dhe prokurori i komanduar për të ndihmuar Prokurorin e Përgjithshëm, në trajtimin e çështjeve. Për këtë qëllim, veprimtaria e tyre përfshin, në veçanti, kryerjen e kërkimit ligjor dhe përgatitjen e opinioneve me shkrim për çështje ligjore materiale ose procedurale.

i) "Ndryshimi i strukturës administrative ose kompetencave tokësore të gjykatës ose prokurorisë" është:

- ndryshimi i rretheve gjyqësore dhe kompetencave territoriale, sipas parashikimeve të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", me vendim të Këshillit të Ministrave;

- ndryshimi i numrit të magjistratëve për çdo gjykatë ose prokurori me vendim të Këshillave, bazuar në një analizë afatgjatë të nevojave.

j) "Paga bruto fillestare", në kuptim të këtij ligji, përfaqëson pagën referuese bazë dhe shtesën e pagës në grup.

k) "Periudha e vlerësimit" është periudha, gjatë së cilës bëhet vlerësimi etik dhe profesional i magjistratit.

l) "Rendimenti i përfundimit të çështjeve" për një magjistrat është raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara prej tij me numrin e çështjeve gjyqësore të caktuara brenda një viti kalendarik.

ll) "Skema e vlerësimit" i referohet tërësisë së rregullave të vlerësimit etik dhe profesional, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.

m) "Standardet minimale të afatit" janë afate orientuese, brenda të cilave një çështje duhet të përfundojë. Këshillat miratojnë dhe rishikojnë standardet minimale të afatit, në mënyrë të veçantë për lloje të ndryshme çështjesh, duke vlerësuar natyrën, kompleksitetin dhe sasinë e çështjeve të regjistruara në gjykatë ose në prokurori, si dhe infrastrukturën e gjykatës ose të prokurorisë.

n) "Vendimi jopërfundimtar" është vendimi, i cili nuk e zgjidh çështjen në themel, si vendimi për pushimin e një kërkese ose vendimi për përfundimin ose për mbylljen e procedurës për shkaqe formale.

nj) "Veprimtari jashtë funksionit" është veprimtari e paguar ose e papaguar, e cila nuk përfshihet në veprimtarinë e gjyqtarëve ose prokurorëve, në veprimtarinë administrative që kryhen nga magjistrati, sipas parashikimeve të ligjit ose që kërkohen nga një person ose institucion përgjegjës.

o) "Vlerësues" është çdo person i përfshirë në përgatitje dhe vendimmarrje, me qëllim të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional.

p) Shprehja "nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike" do të thotë që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të parashikuara në statutin e partisë politike.

PJESA II
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E MAGJISTRATËVE

KREU I
VLERAT THEMELORE DHE TË DREJTAT
DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME

Neni 3
Vlerat themelore

1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye.

3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij.

4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime.

5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbajtje dhe maturi.

Neni 4
Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes

1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare.

2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar:

a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij;

b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë;

c) statusin e funksionit të magjistratit.

3. Në përputhje me parashikimet e këtij neni, Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes.

4. Secili Këshill emëron magjistratin si këshilltarin e etikës, sipas parashikimeve të ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet për formimin vazhdues

1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit.

2. Magjistrati duhet:

a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës.

3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë:

a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve;

b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.

4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë:

a) të përshtatshme për funksionin e tij;

b) të organizuara dhe certifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.

5. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për ndjekjen e programeve të formimit vazhdues, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, mbulohen me fonde nga buxheti i parashikuar për këtë qëllim të Shkollës së Magjistraturës, si dhe nga burime të tjera financiare, të paracaktuara për këto veprimtari. Këshilli mund të mbulojë nga buxheti i tij shpenzimet

e udhëtimit dhe të qëndrimit për ndjekjen e trajnimeve të organizuara nga çdo institucion trajnimi, i njohur nga Këshilli.

6. Këshillat bashkëpunojnë me Shkollën e Magjistraturës për analizën e nevojave për trajnim, zhvillimin e kurrikulave dhe programeve trajnuese. Këshillat miratojnë rregulla më të hollësishme për përshtatshmërinë dhe përmbajtjen e programeve të formimit vazhdues, shërbimet lehtësuese të lejuara, si dhe për procedurën e pajisjes me leje për ndjekjen e këtyre trajnimeve.

KREU II
PAPAJTUESHMËRITË, KUFIZIMET DHE VEPRIMTARITË E TJERA

Neni 6
Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit

1. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me:

a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike;

b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar.

2. Kryetari njofton Këshillin në rast se ka dyshime të bazuara për të besuar se një magjistrat i gjykatës ose prokurorisë përkatëse nuk i përmbush kërkesat e kësaj dispozite.

Neni 7
Kufizimet për shkak të funksionit

1. Gjatë ushtrimit të funksionit, magjistrati nuk duhet:

a) të bëjë publike të dhëna ose informacione për çështjet që i janë caktuar;

b) të bëjë publike mendimet që ka dhënë gjatë hetimeve ose seancave gjyqësore, përveç rasteve kur mendimi është publikuar nëpërmjet një vendimi;

c) të bëjë deklarata publike që mund të krijojnë përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar në një çështje të caktuar.

2. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, nuk e ndalojnë magjistratin të ushtrojë përgjegjësitë si magjistrat shtypi, lidhur me marrëdhëniet me publikun në gjykata dhe në prokurori.

3. Magjistrati nuk mund të marrë pjesë në grevë.

4. Magjistratit i ndalohet:

a) të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit;

b) të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;

c) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në fuqi;

ç) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar;d) të jetë ekspert në gjykatat vendase ose arbitër në arbitrazhin tregtar.

5. Kryetari njofton Këshillin në rast se ka dyshim të arsyeshëm për të besuar që një magjistrat i gjykatës ose prokurorisë përkatëse nuk plotëson kriteret e parashikuara në këtë dispozitë.

Neni 8
Papajtueshmëria ambientale
(*Shfuqizuar me Vendimin nr. 34/2017 të GjK dhe Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë.

2. Këshillat, gjatë emërimit, transferimit, apo ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi

i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efiçenca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë.

3. Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme:

a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni;

b) nëse gjyqtari që kërkon të caktohet në një gjykatë administrative të shkallës së parë, ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një gjyqtar tjetër, që ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe anasjelltas;

c) nëse gjyqtari që kërkon të caktohet në seksionin civil të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një gjyqtar tjetër, që ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën e shkallës së parë, si dhe anasjelltas;

ç) nëse magjistrati që kërkon të caktohet në seksionin penal të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në prokurorinë në juridiksion të kësaj gjykate, ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një magjistrat tjetër që ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në seksionin penal të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën dhe prokurorinë e shkallës së parë, si dhe anasjelltas.

4. Magjistrati nuk mund të caktohet në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme nëse një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, ushtron funksionin në këto struktura.

5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për emërim, transferim, apo ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Nëse papajtueshmëria ambientale lind gjatë ushtrimit të funksionit, apo është krijuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, rregullat e parashikuara në këtë nen nuk zbatohen. Në këtë rast, me pëlqimin e tij, magjistrati mund të caktohet në një seksion tjetër.

7. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurat e zbatimit të këtij neni.

Neni 9
Veprimtaritë jashtë funksionit

(*Shfuqizuar fjalia e fundit e shkronjës (c) pika 1, pikat 7 dhe 8 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar pikat 7 dhe 8 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Magjistrati lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit, vetëm nëse këto veprimtari:

a) janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;

b) nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;

c) nuk bien ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçiente të funksioneve.

ç) nuk bien ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës;

d) në rast se shpërblimi për veprimtaritë jashtë funksionit përfshin çdo lloj dhe formë pagese, shpërblim financiar ose kompensim, të cilat nuk tejkalojnë rregullat e zakonshme të tregut;

dh) nuk janë të papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohen sipas këtij ligji.

2. Me përjashtim të botimeve shkencore ose trajnimeve, magjistrati ndalohet të përdorë titullin e magjistratit në veprimtaritë jashtë funksionit, si dhe merr masa që palët e treta të mos e përdorin titullin e tij në këto veprimtari.

3. Magjistrati mund të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.

4. Magjistrati, para se të fillojë kryerjen e një veprimtarie të paguar jashtë funksionit, sipas përcaktimeve të këtij neni, duhet të njoftojë Këshillin dhe t'i paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që:

a) përshkruan natyrën dhe kohëzgjatjen e këtyre veprimtarive;

b) vërteton masën e shpërblimit të këtyre veprimtarive;

c) evidenton ngarkesën në punë në gjykatë ose prokurori, ngarkesën totale të punës në gjykatë ose prokurori, si dhe përmbushjen në kohë të detyrave përgjatë 12 muajve të mëparshëm.

5. Magjistrati merr miratimin e Këshillit përkatës, përpara se të pranojë kryerjen e veprimtarive të paguara jashtë funksionit.

6. Këshilli vendos brenda tri javëve nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit të plotë dhe jep miratimin nëse veprimtaria dhe çdo shpërblim për kryerjen e saj janë në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Në rast se Këshilli brenda afatit 3-javor nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit të plotë nuk shprehet me vendim, nuk njofton të interesuarin, si dhe nuk merr vendimin për zgjatjen e afatit, kërkesa konsiderohet e aprovuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

7. Magjistrati, pa cenuar afatet e përcaktuara dhe ushtrimin në mënyrë efiçente të funksioneve, mund të marrë pjesë në veprimtari të papaguara jashtë funksionit, pa miratimin e Këshillit, vetëm në rastet kur:

a) vepron si përfaqësues i gjyqësorit ose prokurorisë;

b) merr pjesë në aktivitete për çështje të lidhura me sistemin gjyqësor ose të prokurorisë dhe bën deklarata publike të përgjithshme në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete;

c) merr pjesë në diskutime për çështje të ligjit.

8. Magjistrati raporton, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, në Këshill, për veprimtaritë e papaguara jashtë funksionit, ku ka qenë i përfshirë në vitin paraardhës.

9. Brenda muajit janar të çdo viti, Këshillat publikojnë në faqen zyrtare, si dhe i dërgojnë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe organeve të administratës tatimore një raport me shkrim të arsyetuar për veprimtaritë jashtë funksionit të paguara të magjistratëve, duke përcaktuar pagesën ose shpërblimin e përfituar gjatë vitit paraardhës dhe vlerën përkatëse të tregut. Institucionet përkatëse bashkëpunojnë me Këshillat për përcaktimin e vlerave normale të tregut.

10. Bazuar në parimin e barazisë dhe të proporcionalitetit, Këshilli miraton rregulla të detajuara për veprimtaritë jashtë funksionit.

Neni 10
Liria e organizimit dhe e shprehjes

1. Magjistratët kanë të drejtë të themelojnë shoqata ose organizata dhe të marrin pjesë në to, me qëllim:

a) mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre;

b) ngritjen e tyre profesionale.

2. Shoqatat ose organizatat e magjistratëve në ushtrimin e aktivitetit nuk duhet të bien ndesh me kompetencat e institucioneve të drejtësisë.

KREU III
PAGA DHE PËRFITIMET E TJERA FINANCIARE DHE SHOQËRORE

Neni 11
Parimet e caktimit të pagës dhe përfitimeve financiare të magjistratit

(Ndryshuar shkronja (a) pika 3 me Ligjin nr. 50/2021)

1. Paga e magjistratit dhe përfitimet e tjera financiare duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre.

2. Paga e magjistratit caktohet në bazë të kritereve të mëposhtme:

a) shkalla e gjykatës ose prokurorisë ku magjistrati ushtron funksionin;

b) vjetërsia në ushtrimin e funksionit;

c) fusha e veçantë e kompetencës lëndore në të cilën magjistrati ushtron funksionin;

ç) pozicioni drejtues.

3. Përfitimet e tjera financiare përfshijnë:

a) kompensim për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm;

b) shpërblim për aftësi;

c) pension shtetëror suplementar, sipas parashikimit të këtij ligji dhe legjislacionit për pensionet shtetërore suplementare;

ç) çdo përfitim tjetër, duke u bazuar në kushtet e veçanta të punës ose gjendjen personale dhe atë familjare të magjistratit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 12
Caktimi i pagës së magjistratit

(Ndryshuar shkronja (d), pika 5 me Ligjin nr.15/2020 dhe shkronjat (a) dhe (d) pika 5 me Ligjin nr. 50/2021; Ndryshuar shkronja "a" e pikës 5 me ligjin nr. 33/2023, datë 25.3.2023)

1. Paga e magjistratit caktohet sipas përkatësisë së magjistratit në grupin dhe nivelin e pagës.

2. Paga e magjistratit ndahet sipas grupeve të pagave (G), bazuar në këto tregues:

a) magjistrati që ushtron funksionin në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ ose prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë (G1);

b) magjistrati që ushtron funksionin në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, prokuroritë pranë gjykatave së apelit, magjistratët që ushtrojnë funksionin në gjykatën e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar shkalla e parë (G2);

c) magjistrati që ushtron funksionin në Gjykatën e Lartë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, ashtu si dhe magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe Prokurorinë e Posaçme (G3).

3. Shtesa për vjetërsi në ushtrimin e funksionit llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Në rastin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të emëruar nga radhët e juristëve që nuk vijnë nga karriera gjyqësore, për efekt të përcaktimit të vjetërsisë së ushtrimit në detyrë, shtesa për vjetërsi llogaritet në mënyrë të barasvlershme me atë të 15 vjetëve karrierë gjyqësore.

5. Paga mujore bruto e magjistratit përbëhet nga elementet si vijon:

a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë;

b) shtesa për pagën në grup, e cila është shuma që rezulton nga

shumëzimi i pagës referuese bazë me koeficientin në përqindje, sipas funksionit që magjistrati ushtron, referuar pikës 2, të këtij neni, përkatësisht:

i. G1 90 për qind;

ii. G2 98 për qind;

iii. G3 106 për qind;

c) shtesa për vjetërsi, e llogaritur mbi pagën referuese bazë, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni;

ç) shtesa për pozicionin drejtues, e përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji;

d) shtesë për vështirësi pune, në masën 80 për qind të pagës bruto fillestare, për magjistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Neni 13
Pagat e magjistratëve të komanduar dhe ndihmësmagjistratëve

1. Me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe, magjistratët e komanduar, të cilët kanë ushtruar më parë funksionin e magjistratit, vazhdojnë të marrin pagën në përputhje me kriteret e karrierës dhe vjetërsisë për funksionet e kryera më parë.

2. Me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe, për magjistratët e komanduar, të cilët nuk kanë ushtruar më parë funksionin e magjistratit, zbatohen rregullat për caktimin e pagës së magjistratit të shkallës së parë.

3. Në rastet kur për pozicionet e komanduara zbatohet një skemë e veçantë pagash, magjistrati, përfiton pagën sipas kësaj skeme të veçantë gjatë komandimit. Pas mbarimit të mandatit të komandimit, magjistrati paguhet në bazë të pagës së pozicionit në të cilin kthehet, transferohet, caktohet ose ngrihet në detyrë.

4. Magjistrati i komanduar merr pagën më të lartë ndërmjet dy pagave. Në rastet kur pozicioni i komanduar nuk paguhet nga buxheti gjyqësor ose i prokurorisë, paga e parashikuar për pozicionet e komanduara në institucione të tjera mbulohet nga buxheti i këtij institucioni, ndërsa diferenca në pagën përkatëse të magjistratit mbulohet nga buxheti gjyqësor ose i prokurorisë.

Neni 13/1
Paga e magjistratëve në skemë delegimi
(Shtuar me Ligjin nr. 50/2021)

1. Magjistrati në skemë delegimi përfiton 10 për qind shtesë page mbi pagën bruto fillestare të tij.

2. Magjistrati në skemë delegimi, që përmbush kriteret për t'u ngritur në detyrë në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme, si dhe përmbush kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, sipas pikës 3 të nenit 47 të këtij ligji, gjatë periudhës së delegimit në këto institucione përfiton shtesën për vështirësi pune sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji. Në rastet kur magjistrati delegohet për çështje të veçanta, ai përfiton shtesë të reduktuar për vështirësi pune, por jo më shumë se gjysma e shtesës sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji. Këshillat, pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse të financave, përcaktojnë rregulla të detajuara për masën e shtesës së reduktuar për vështirësi pune dhe mënyrën e llogaritjes së saj duke u bazuar në llojin, natyrën, kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e çështjeve për të cilat delegohen.

Neni 14
Paga e magjistratëve në pozicione drejtuese

1. Për ushtrimin e funksionit të kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, magjistrati përfiton 10 për qind shtesë page mbi pagën bruto fillestare të tij.

2. Për ushtrimin e funksionit të zëvendëskryetarit, kryetarit të seksionit, magjistratit të shtypit, këshilltarit të etikës ose të magjistratit udhëheqës, magjistrati përfiton 5 për qind shtesë page mbi pagën bruto fillestare të tij.

3. Këshillat miratojnë rregulla të hollësishme për kompensimin e shpenzimeve të magjistratëve të deleguar për të ushtruar funksionin e tyre në një degë të gjykatës dhe të prokurorisë.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregulla të hollësishme për kompensimin e punës jashtë orarit të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme të organizuar në raste të veçanta.

5. Për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ose funksione të tjera të magjistratëve, parashikuar në këtë ligj, do të ndiqen rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

Neni 15
Kompensimi i magjistratëve në skemën e delegimit
(Ndryshuar me Ligjin nr. 50/2021)

1. Magjistrati në skemën e delegimit i caktuar në një gjykatë ose prokurori, si dhe magjistratët e tjerë, kur transferohen përkohësisht ose caktohen përkohësisht për jo më shumë se 22 ditë pune, përfiton kompensim për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë gjykatës ose prokurorisë ku delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht. Shpenzimet e transportit llogariten në bazë të distancës më të shkurtër që rezulton ndërmjet gjykatës ose prokurorisë ku ai delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht me gjykatën ose prokurorinë ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose me vendbanimin e tij të përhershëm.

2. Magjistrati në skemën e delegimit, magjistrati i transferuar përkohësisht ose magjistrati i caktuar përkohësisht, kur delegohet, transferohet përkohësisht ose caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se periudha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfiton një kompensim mujor në masën e jo më shumë se 80 përqind të pagës referuese bazë. Ky 3 kompensim mbulon çdo shpenzim për qëndrimin dhe transportin e magjistratit në gjykatën ose prokurorinë ku magjistrati është deleguar, transferuar përkohësisht ose caktuar përkohësisht.

3. Magjistrati nuk përfiton kompensimet sipas këtij neni në rastet kur gjykata ose prokuroria ku ai delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht ndodhet në të njëjtin territor me gjykatën ose prokurorinë ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose në territorin e vendbanimit të tij të përhershëm.

4. Rregulla të detajuara për mënyrën e caktimit të kompensimit dhe masës së tij sipas këtij neni, përcaktohen nga Këshillat pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për financat

Neni 16
Shpërblimi për aftësi

1. Çdo vit, magjistratët, të cilët në vitin paraardhës kalendarik, në mënyrë të veçantë, kanë pasur vlerësimin më të lartë etik dhe profesional, marrin një shpërblim të barabartë me një pagë referuese bazë.

2. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara lidhur me shpërblimin, sipas pikës 1, të këtij neni, duke:

a) kufizuar të drejtën e përfitimit për 5 për qind të magjistratëve në vit, të vlerësuar gjatë vitit të kaluar kalendarik;

b) përcaktuar kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve që gëzojnë këtë të drejtë.

Neni 17
Kredi për shtëpi

1. Magjistrati ka të drejtë që një herë gjatë ushtrimit të funksionit të tij, pasi të ketë ushtruar jo më pak se tre vjet të detyrës, të përfitojë kredi për shtëpinë të financuar nga shteti, në shumën e vlerës mesatare të një apartamenti prej 50 m^2 në zonën e qendrës së qytetit ku magjistrati ushtron detyrën.

2. Për çdo anëtar të familjes, sipas parashikimeve të pikës 5, të këtij neni, i cili jeton në të njëjtën banesë me magjistratin, masa referuese e sipërfaqes së banesës shtohet me 10 m^2 për person. Në rast se në një familje, dy persona kanë të drejtë të përfitojnë kredi për shtëpi të subvencionuar nga shteti, do të përfitohet vetëm nga një prej tyre.

3. Banesa e blerë nëpërmjet kredisë lihet kolateral në bankë për sigurimin e kredisë.

4. Magjistrati ka të drejtën të gëzojë pronën për nevojat e tij, si dhe të familjes së tij për nevojat për strehim. Magjistrati ka të drejtë të shesë pronën gjatë kohës së amortizimit të kredisë dhe të blejë një banesë tjetër. Në rastet kur shuma e përfituar nga shitja është me e madhe se rritja e vlerës së tregut të pronës, atëherë diferenca do t'i kthehet shtetit. Magjistrati nuk ka të drejtë të japë me qira banesën e përfituar me kredi.

5. Magjistrati detyrohet t'i rimbursojë shtetit shumën e marrë dhe interesat e kredisë, në rast se ndaj tij është dhënë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

6. Në rastin kur magjistrati ose bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmija i tij nën moshën 18 vjeç ka në pronësi pasuri pa kolateral, që përmbush nevojat e strehimit, ose kur ata kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një pronë të tillë, nuk gëzon të drejtën për kredi për shtëpi, sipas këtij neni.

7. Këshilli i Ministrave miraton legjislacionin mbështetës për marrëveshjet me bankat për skemën e huamarrjes, në të cilën do të parashikohen kriteret dhe kushtet për kontratën e kredisë, si dhe detyrimet e shtetit lidhur me interesat e huamarrjes. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të detajuara për procedurën e dhënies së kredisë për shtëpi, si dhe kriteret

dhe kushtet që magjistrati përmbush në përputhje me parashikimet e këtij neni.

Neni 18
Rregulla të hollësishme për pagat dhe përfitimet e tjera financiare

Këshilli argumenton në mënyrë të detajuar në projektbuxhetin e tij kriteret dhe kushtet për shtesat dhe uljet e pagës.

Neni 19
Bursa e shkollimit për kandidatët magjistratë

1. Kandidati për magjistrat, i cili pranohet të ndjekë kursin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës përfiton bursë shkollimi sipas këtyre treguesve:

a) në vitin e parë 30 për qind të pagës bruto fillestare të tij;

b) në vitin e dytë 40 për qind të pagës bruto fillestare të tij;

c) në vitin e tretë 50 për qind të pagën bruto fillestare të tij.

2. Kandidati magjistrat që merr më shumë se 90 për qind të pikëve gjatë një viti akademik, sipas përcaktimeve të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përfiton në vitin pasues akademik një shtesë në masën 10 për qind të bursës së shkollimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Rregullat e nenit 22 aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

4. Kandidati për magjistrat është i detyruar të kthejë shumën e përfituar të bursës së shkollimit, brenda një viti, në rastet kur:

a) kandidati është përjashtuar ose ka lënë shkollën;

b) në rastet kur kandidati për magjistrat nuk kandidon për t'u emëruar në një pozicion brenda një viti nga përfundimi i formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

5. Kandidati magjistrat duhet të kthejë 50 për qind të shumës së përfituar të bursës së shkollimit që është marrë gjatë tri viteve të kursit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në rastet kur:

a) kandidati për magjistrat nuk plotëson kushtet e emërimit si magjistrat, sipas nenit 40 të këtij ligji;

b) mandati i magjistratit ka përfunduar përpara plotësimit të paktën të pesë viteve të ushtrimit të funksionit.

6. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, për shkaqe shëndetësore ose për shkaqe të tjera të justifikuara, miraton me vendim përjashtimin e kandidatit magjistrat nga detyrimi për kthimin e shumës së përfituar të bursës së shkollimit, sipas parashikimeve të pikës 4, të këtij neni, si dhe rastet e parashikuara në pikën 5, shkronja "b", të këtij neni.

Neni 20
Mbrojtja e veçantë e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij

1. Gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, magjistrati dhe familja e tij gëzojnë të drejtën të kenë mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre. Magjistrati që nuk e ushtron funksionin ose që ka dalë në pension gëzon këtë mbrojtje, në rast se e kërkon, si dhe në rast cenimi për shkak të ushtrimit të mëparshëm të funksionit të magjistratit.

2. Në rast se jeta, shëndeti dhe pasuria e magjistratit ose familja e tij janë në rrezik, shteti ofron mbrojtje të veçantë, si dhe mbrojtje fizike, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, pas konsultimit me Këshillat.

3. Dëmet e shkaktuara për jetën, shëndetin ose pasurinë e magjistratit ose familjes së tij/saj, shpërblehen nga shteti, në rast se këto dëme shkaktohen gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit ose për shkak të tij.

Neni 21
Pensioni suplementar dhe përfitimet e tjera

1. Magjistratët, përveç rasteve të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuara nga ligji "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e dytë, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të pikës 9, të nenit 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

2. Magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuara nga ligji "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e parë, sipas përcaktimit të shkronjës "b", të pikës 8, të nenit 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore

suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit". Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera, të parashikuar nga ligji për pensionet suplementare, të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e parë, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të pikës 8, të nenit 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

3. Magjistratët përfitojnë këtë pension suplementar dhe përfitime të tjera suplementare, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për pensionet shtetërore suplementare të funksioneve kushtetuese dhe punonjësve të shtetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 22
Paprekshmëria e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare të magjistratit
(Ndryshuar shkronja (ç) pika 1 me Ligjin nr. 50/2021)

1. Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit nuk mund të ulen, me përjashtim të rasteve kur:

a) ka situata të vështira financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare, duke marrë parasysh faktorët si vijon: një mospërputhje e qartë midis dinamikës së pagave të magjistratëve dhe dinamikës së pagave standarde në shërbimin civil; indeksi i pagesave, ashtu si dhe indeksi i çmimeve të konsumatorit. Këta faktorë është e nevojshme që të vlerësohen, për të gjetur balancën mes paprekshmërisë së pagës dhe nevojës për të shmangur marrjen e borxheve të reja;

b) magjistrati ushtron të drejtën për t'u kthyer nga një pozicion i mëparshëm më i lartë ose më i specializuar ose me mandat të kufizuar dhe me pagesë më të lartë;

c) magjistrati ka masë disiplinore;

ç) vlerësohet i pamjaftueshëm ose jepet masa disiplinore e uljes së përkohshme të pagës, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Magjistrati duhet të kthejë shumat e përfituara të pagës ose përfitimeve financiare nëse ka përfituar më shumë sesa është parashikuar në ligj.

KREU IV
LEJA DHE ULJA E KOHËS SË PUNËS

Neni 23
Pushimet vjetore
(*Shfuqizuar pika 10 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar pika 10 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Magjistrati gëzon të drejtën për pushime vjetore të paguara me kohëzgjatje 25 ditë pune.

2. Magjistrati që ushtron funksionin në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme, ka të drejtë të përfitojë pesë ditë pune shtesë leje vjetore.

3. Pushimet vjetore për magjistratin që autorizohet të punojë me kohë të pjesshme, zbriten në përpjesëtim me kohën e punës që kryen.

4. Në vitin kur magjistrati caktohet në pozicion ose largohet prej tij ose kur është me leje prindërore, gëzon të drejtën për pushime të pjesshme vjetore të paguara, të cilat përcaktohen në raport me kohëzgjatjen në funksion, si vijon:

a) 2 ditë pune leje për çdo muaj të plotë në funksion;

b) 2 ditë pune leje për një muaj jo të plotë, prej më shumë se 15 ditë pune;

c) 1 ditë pune leje për një muaj jo të plotë deri në 15 ditë pune.

5. Pushimet vjetore mund të merren njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së magjistratit dhe në përputhje me kërkesat e funksionit. Në çdo rast, pushimet duhet të përfshijnë një periudhë trejavore pa ndërprerje, gjatë muajit gusht, përveç kur kërkesat e ushtrimit të funksionit kërkojnë vazhdimin e aktiviteteve të gjykatës ose prokurorisë.

6. Magjistrati i sapocaktuar në pozicion përfiton pushime vjetore vetëm pasi ka ushtruar funksionin për një periudhë tremujore. Përjashtimisht, pushimet mund të miratohen para këtij afati, në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara.

7. Magjistrati që kalon sëmundje gjatë pushimeve vjetore, të cilat mund ta pengonin atë në ushtrimin e funksionit nëse nuk do të ishte me

pushime, përfiton shtyrje të kohëzgjatjes së pushimeve vjetore, të njëjtë me kohëzgjatjen e sëmundjes, me kushtin që kjo e fundit të vërtetohet me raport mjekësor.

8. Magjistrati që nuk merr pushimet e plota vjetore deri në fund të vitit përkatës kalendarik, për arsye që nuk lidhen me kërkesa të funksionit, mund të shtyjë kohëzgjatjen e mbetur të pushimeve në vitin pasardhës, me kushtin që kohëzgjatja e mbetur të jetë deri në pesë ditë. Leja e prapambetur mund të merret deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës. Magjistrati që nuk ka marrë pushimet e plota vjetore në kohën e largimit nga funksioni, përfiton kompensim në pagesë, të barabartë me një të tridhjetën e pagës që merrte para largimit, për çdo ditë pushimi të mbetur. Shuma e përllogaritur, sipas kësaj pike, zbritet nga pagesa që magjistrati duhet të përfitojë, në rast se në kohën e largimit nga funksioni ka marrë më shumë pushime vjetore sesa ka pasur të drejtë deri në atë moment.

9. Magjistrati që ndërpret pushimet vjetore për shkak të kërkesave të funksionit ose që i anulohen këto pushime, gëzon të drejtën për t'u kompensuar për të gjitha shpenzimet e kryera, veçanërisht shpenzimet e transportit, nëse ato vërtetohen me dokumentacionin e nevojshëm.

10. Magjistrati nuk mund të kryejë mungesa në detyrë, me përjashtim të rasteve të justifikuara, të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Kryetari, me vendim të arsyetuar me shkrim, zbret nga periudha e pushimit vjetor të të njëjtit vit ditët e mungesës së pajustifikuar. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e Kryetarit, në Këshill brenda 7 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit. Nëse zbritja nuk mund të realizohet, kryetari njofton Këshillin, i cili merr masa që magjistrati të mos paguhet për ditët që ka munguar.

11. Pushimet vjetore jepen nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se tre ditë i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre.

Neni 24
Pushimet e tjera

1. Përveç pushimeve vjetore, magjistrati gëzon të drejtën të marrë në përputhje me Kodin e Punës:

a) pushime të tjera;

b) leje prindërore.

2. Leja e veçantë miratohet nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Këshillat miratojnë lejen prindërore, pasi kanë marrë mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë.

3. Magjistrati mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 vjet për qëllime kualifikimi profesional dhe specializime në një institucion trajnimi, ose për arsye familjare ose shëndetësore. Leja e papaguar mund të merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme sipas kërkesës së magjistratit.

4. Këshillat mund të japin lejen e papaguar pasi kanë marrë mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë, nëse leja nuk bie ndesh me interesat kryesorë të funksionit dhe nuk vë në rrezik në tërësi përmbushjen e funksionit me efiçencë dhe në kohë, në gjykatë ose në prokurori.

5. Periudha e lejes së papaguar nuk merret në konsideratë për vjetërsinë në punë ose për efekt të përfitimeve të tjera.

6. Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.

Neni 25
Siguria dhe shëndeti në punë

Me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe, Këshillat, gjykatat dhe prokuroritë zbatojnë dispozitat e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

KREU V
TË DREJTAT E TJERA

Neni 26
Ulja e ngarkesës
(Shfuqizuar shkronja (b) e pikës 4 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK ; Ndryshuar shkronja (a) pika 1, shtuar shkronja (c) pika 1, ndryshuar shkronja (a) pika 3, shkronja (b) pika 4 me Ligjin nr. 48/2019)

1. Magjistrati ka të drejtë për ulje të ngarkesës së çështjeve, në rast nevoje, për një nga këto shkaqe:

a) arsye të përkohshme personale ose familjare për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet;

b) studime jashtë kursit të formimit vazhdues në Shkollën Magjistraturës, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në tre vjet;

c) kur angazhohet për shkak të funksionit të magjistratit edhe në detyra të tjera, kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

2. Ngarkesa e çështjeve mund të ulet deri në 75 për qind të ngarkesës, në varësi të rrethanave.

3. Këshillat mund të vendosin ulje të ngarkesës së çështjeve të magjistratit, pas marrjes së mendimit të kryetarit, nëse plotësohen këto kushte:

a) në rastet e parashikuara në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni, magjistrati kërkon ulje të ngarkesës në punë, nëse kjo nuk cenon interesat thelbësorë të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçente të funksioneve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse;

b) në rastin e parashikuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni:

i. kur studimet kanë si qëllim të rrisin aftësitë profesionale të magjistratit;

ii. kur ulja e ngarkesës nuk cenon interesat thelbësorë të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçiente të funksioneve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse.

4. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

a) procedurën që ndiqet për kërkesat për uljen e ngarkesës, veçanërisht detajimi për provat e duhura që duhet të paraqiten në mbështetje të një kërkese;

b) rregulla për uljen e pagës dhe të përfitimeve të tjera, kur magjistrati ndodhet në kushtet e parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit;

c) rregullat për uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera në rastet kur kërkesa pranohet, për arsyet e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit;

ç) rregullat për përcaktimin e kohëzgjatjes gjatë së cilës ulet ngarkesa;

d) rregulla të ndërmjetme për transferimin e një pjese të ngarkesës së magjistratit, në rastet kur kërkesa pranohet.

5. Ulja e pagës dhe përfitimeve të tjera nuk duhet të jetë më shumë se 75 për qind.

Neni 27
Pensioni i parakohshëm
(Shfuqizuar shkronja (c) pika 1, shtuar pikat 1/1 dhe 1/2 me Ligjin nr. 50/2021)

1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:

a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç;

b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit.

1/1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm edhe në rast se Këshilli vendos mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të pamundësisë fizike dhe mendore sipas nenit 67 të këtij ligji.

1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumën që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 64 të këtij ligji, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë për magjistratët që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni është 0.6 për qind në muaj.

2. Magjistrati që ushtron funksionin në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe Prokurorinë e Posaçme, gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm tre muaj më parë, për çdo vit të ushtrimit të funksionit në këto struktura.

3. Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës/prokurorisë.

4. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, në të cilat përcaktohet:

a) procedura që ndiqet për kërkesat për pension të parakohshëm dhe dokumentacionin mbështetës;

b) rregullat për mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm dhe përfitimeve të tjera, në rastet kur kërkesa pranohet.

PJESA III
ZHVILLIMI I KARRIERËS SË MAGJISTRATËVE

KREU I
REKRUTIMI I KANDIDATËVE MAGJISTRATË

Neni 28
Kriteret e pranimit në formimin fillestar
(Ndryshuar shkronjat (c), (ç), (d) dhe (dh) me Ligjin nr. 50/2021)

Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar;

b) është shtetas shqiptar;

c) ka përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose ka kryer me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj;

ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi sipas shkronjës "c" të këtij neni, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;

d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal;

dh) nuk është larguar nga detyra ose nuk i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;

ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

Neni 29
Thirrja për kandidatura

1. Në janar të çdo viti, Këshillat, pasi kanë kryer një analizë të nevojave, përcaktojnë dhe publikojnë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

2. Shkolla e Magjistraturës publikon thirrjen për kandidime për formimin fillestar, brenda një jave kalendarike nga data e publikimit të numrit maksimal të magjistratëve, sipas pikës 1, të këtij neni, nëpërmjet shpalljes së njoftimit:

a) në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Shkollës së Magjistraturës;

b) në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend.

Neni 30
Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve

1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti.

2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kritereve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit.

3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë

komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij.

5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 31
Provimi

1. Shkolla e Magjistraturës organizon provimin për pranimin në formimin fillestar në përputhje me rregullat që parashikon ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë". Provimi i pranimit zhvillohet në fund të muajit prill të çdo viti dhe është i hapur për të gjithë kandidatët e përfshirë në listën e kandidatëve, siç përcaktohet në procedurat e vlerësimit, të parashikuara në nenin 30 të këtij ligji.

2. Shkolla e Magjistraturës harton listën e renditjes e kandidatëve, sipas rezultateve të provimit, dhe publikon listën e miratuar, deri në datën 15 maj të çdo viti, duke treguar në listë numrin maksimal të kandidatëve të pranuar në formimin fillestar, në përputhje me vendimin e Këshillave, të marra sipas përcaktimeve të nenit 29 të këtij ligji.

3. Çdo kandidat ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 32
Verifikimi i pasurisë dhe figurës
(Ndryshuar pikat 2, 4 dhe 6, shtuar pikat 4/1 dhe 6/1 me Ligjin nr. 50/2021)

1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31 të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative,

çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

4. Në çdo rast Këshillat çmojnë, sipas bindjes së tyre, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur:

a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit;

b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;

ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.

5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

6. Kandidatët, të cilët nuk pranohen në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për shfuqizimin e vendimit të Këshillit ose rrëzimin e padisë brenda dy javëve nga paraqitja e tij. Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë.

6/1. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor rishikon vendimin në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

Neni 33
Praktika profesionale e kandidatëve magjistratë

1. Kandidatët gjyqtarë dhe kandidatët prokurorë kryejnë praktikën profesionale, përkatësisht, në gjykata dhe në prokurori, në vitin e tretë të formimit fillestar. Praktika profesionale zgjat 12 muaj, duke filluar në muajin korrik dhe përfundon në muajin qershor të vitit pasardhës.

2. Këshillat përcaktojnë gjykatat dhe prokuroritë e shkallës së parë, për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, bazuar në këto tregues:

a) disponueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve udhëheqës;

b) infrastrukturën e gjykatës dhe të prokurorisë;

c) disponueshmërinë e hapësirës dhe mjediseve të punës për kandidatët magjistratë;

ç) mundësinë për t'u njohur me një numër të madh ligjesh dhe shumëllojshmëri çështjesh gjatë praktikës profesionale.

3. Këshillat caktojnë një trupë magjistratësh udhëheqës, me një kohëzgjatje prej tre vjetësh, me të drejtë riemërimi. Çdo magjistrat udhëheqës duhet të përmbushë njëkohësisht këto kritere:

a) të ketë të paktën pesë vjet përvojë si gjyqtar ose prokuror;

b) të jetë vlerësuar në përputhje me këtë ligj, të paktën "shumë mirë" në vlerësimin e fundit etik dhe profesional;

c) të ketë përfunduar me sukses trajnimin për udhëheqës në tri vitet e fundit, në Shkollën e Magjistraturës;

ç) të mos ketë qenë subjekt i masave disiplinore;

d) të ketë respektuar afatet ligjore për hetimin apo gjykimin e çështjeve, të paktën në vitin paraardhës përpara se të caktohet si udhëheqës.

4. Këshilli cakton udhëheqës për secilin prej kandidatëve magjistratë, me qëllim që secili prej tyre:

a) të ketë udhëheqës të ndryshëm për secilën nga tri periudhat katërmujore të njëpasnjëshme;

b) të fitojë përvojë profesionale në fushat e së drejtës civile, penale dhe administrative;

c) të përfshihet sa më shumë që është e mundur në aspekte të punës së përditshme të magjistratit udhëheqës, pavarësisht nga fakti që nuk ushtron ende funksionin e magjistratit, duke përfshirë:

i. shpjegimet dhe diskutimet për çështjet e papërfunduara;

ii. pjesëmarrjen në seancat dëgjimore ose në marrjet në pyetje;

iii. aspektet në menaxhimin e çështjeve;

iv. përvojën në menaxhimin e dosjeve;

v. përgatitjen dhe diskutimin e projektvendimeve;

vi. përvojën në administratën e gjykatës ose prokurorisë;

vii. aspekte për standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve.

5. Magjistrati udhëheqës, të cilit i është caktuar një kandidat magjistrat përjashtohet nga hedhja e 10-të e shortit për ndarjen e çështjeve në gjykatën ose prokurorinë, pranë të cilës ushtron funksionin.

6. Magjistrati udhëheqës bën vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat magjistrat, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit, të përcaktuara në këtë ligj.

7. Gjatë praktikës profesionale, kandidati magjistrat gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat, 15 ditë pune merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin udhëheqës. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë jep pushimet vjetore, pasi konsultohet me magjistratin udhëheqës të tij.

8. Me propozim të Shkollës së Magjistraturës, Këshillat nxjerrin udhëzime për vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë së udhëheqjes.

9. Këshillat hartojnë rregulla të përbashkëta për caktimin e gjykatave,

prokurorive dhe magjistratëve udhëheqës për programin e praktikës profesionale, vlerësimin etik, profesional, si dhe cilësisë së kandidatëve magjistratë, me qëllim që të garantohet një formim sa më i mirë i tyre.

Neni 34
Verifikimi i pasurisë dhe figurës dhe renditja e kandidatëve magjistratë të diplomuar
(Ndryshuar titulli i nenit dhe pika 1, shtuar pika 1/1 me Ligjin nr. 50/2021)

1. Çdo vit, jo më vonë se në fund të muajit janar, Shkolla e Magjistraturës u dërgon Këshillave listën e kandidatëve që mund të diplomohen në përfundim të vitit akademik për verifikimin e pasurisë dhe figurës, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 32 të këtij ligji.

1/1. Çdo vit, deri në fund të muajit qershor, Shkolla e Magjistraturës publikon listën e kandidatëve magjistratë, të diplomuar në formimin fillestar gjatë atij viti.

2. Të diplomuarit renditen në listë, bazuar në rezultatet e provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, provimit përfundimtar, si dhe vlerësimet gjatë praktikës profesionale.

3. Shkolla e Magjistraturës harton dhe publikon kriteret për koeficientët e vlerësimit të praktikës profesionale dhe rezultatet e çdo provimi.

4. Të diplomuarit përfshihen përkatësisht në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë dhe në listën e të diplomuarve për kandidatët prokurorë. Kandidatët magjistratë renditen në listën e të diplomuarve në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

KREU II
EMËRIMI I MAGJISTRATËVE

Neni 35
Emërimi i kandidatit magjistrat të diplomuar
(Ndryshuar pika 2, shfuqizuar pika 3, ndryshuar shkronjat (a) dhe (b) pika 4 me Ligjin nr. 50/2021)

1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere:

a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme;

b) është vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna

gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar;

c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

2. I diplomuari që përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për shkaqe të justifikuara, jo më vonë se dy javë nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, mund të kërkojë që të emërohet si magjistrat në vitin pasardhës.

3. Brenda afatit njëmujor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, Këshillat:

a) emërojnë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, i cili përmbush kriteret e emërimit, ose refuzojnë të emërojnë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, por që nuk përmbush kriteret e emërimit;

b) lejojnë kandidatin që përmbush kriteret e emërimit për t'u emëruar në vitin pasardhës, pas paraqitjes së kërkesës sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Këshilli miraton rregulla të mëtejshme për arsyet e justifikuara për kandidimin në vitin pasardhës të mëvonshëm, sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni.

Neni 36
Riemërimi magjistrat i ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve
(Ndryshuar me Ligjin nr. 50/2021)

1. Ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët mund të kandidojnë për t'u riemëruar si magjistratë jo më vonë se dy javë pas shpalljes së vendeve të lira, sipas pikës 1 të nenit 39 të këtij ligji.

2. Këshillat shqyrtojnë kërkesat për t'u riemëruar në rast se numri i vendeve të lira është më i madh se numri i të diplomuarve që përmbushin kriteret e emërimit sipas nenit 35 të këtij ligji.

3. Këshillat mund të riemërojnë magjistratë, brenda numrit të vendeve të lira, kandidatët që:

a) përmbushin kriteret e shkronjave "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f" të nenit 28 të këtij ligji;

b) kanë ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 5 vjet në 15 vitet e fundit;

c) nuk kanë mbajtur funksione politike në administratën publike

ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit, përpara kërkesës për riemërim si magjistrat.

ç) kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe figurës, sipas rregullave të caktuara në nenin 32 të këtij ligji.

4. Këshillat vendosin të refuzojnë riemërimin kur kandidati nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve që mund të riemërohen si magjistratë në rastet kur numri i vendeve të lira është më i vogël se numri i kandidatëve që kanë kandiduar për t'u riemëruar dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Neni 37
Betimi
(Ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 3 me Ligjin nr. 15/2020)

1. Magjistrati, para fillimit të ushtrimit të funksionit, bën betimin si më poshtë:

"Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale".

2. Betimi i magjistratit bëhet me një ceremoni publike përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Këshilli organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e emërimit të magjistratëve.

3. Nëse magjistrati nuk është thirrur për të bërë betimin, pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, ai betohet me shkrim, sipas formulës së parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe ia dërgon atë të nënshkruar personalisht Këshillit. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Këshillit konsiderohet si data e betimit dhe e fillimit të ushtrimit të funksionit të magjistratit.

Neni 38
Dosjet personale dhe regjistri i magjistratëve
(Shtuar shkronja ç/1), pika 2 me Ligjin nr. 15/2020)

1. Këshillat krijojnë dhe administrojnë dosjet personale dhe regjistrin e magjistratëve. Regjistri i magjistratëve është një bazë unike e të dhënave profesionale dhe personale të magjistratit.

2. Dosja personale e magjistratit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën;

b) gjendjen civile, emrin dhe profesionin e bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve;

c) historinë e arsimimit;

ç) datën e emërimit;

ç/1) aktin e betimit sipas pikës 3 të nenit 37 të këtij ligji;

d) pjesëmarrjen në kurset e trajnimit;

dh) çdo të dhënë me natyrë disiplinore, penale dhe të dhënat e marra nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;

e) rezultatet e vlerësimit të veprimtarisë;

ë) ecurinë e detajuar të zhvillimit të karrierës;

f) datën dhe shkaqet e ndërprerjes së mandatit, sipas rastit.

3. Këshillat miratojnë rregulla të hollësishme për:

a) formatin e regjistrit dhe të dhënat që administrohen në të;

b) informacion shtesë që duhet të përfshihet në dosjet personale;

c) mënyrën e mbajtjes së dosjes personale dhe regjistrit;

ç) pjesët e dosjes personale dhe regjistrit që aksesohen nga publiku.

4. Këshillat mbledhin dhe përpunojnë të dhënat në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU III
CAKTIMI NË POZICION

Neni 39
Caktimi në pozicion i magjistratit të emëruar

(Ndryshuar pika 1, shkronja (b) pika 3, pika 4, shtuar pika 4/1 me Ligjin nr. 50/2021)

1. Brenda muajit qershor të çdo viti, pas përfundimit të procedurave të

transferimit paralel dhe ngritjes në detyrë, secili Këshill shpall vendet e lira për të emëruarit. Jo më vonë se dy javë nga shpallja e vendeve të lira, të emëruarit i bëjnë me dije Këshillit, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata ose prokurori në të cilat kërkojnë të caktohen.

2. Brenda muajit korrik të çdo viti, secili Këshill publikon vendimet e tij për caktimin e të emëruarve në pozicionet e lira për magjistrat.

3. Caktimi në pozicion i të emëruarit të sapo diplomuar në Shkollën e Magjistraturës është parësor dhe bazohet në:

a) renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, sipas nenit 34 të këtij ligji;

b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të emëruarit, sipas pikës 1 të këtij neni, duke e zbatuar, për aq sa është e mundur, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 3 të këtij neni.

4. Pas caktimit në pozicion të të emëruarve, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, Këshillat shpallin vendet e lira për caktimin në pozicion të magjistratëve të riemëruar sipas nenit 36 të këtij ligji.

4/1. Caktimi në pozicion i të riemëruarve sipas nenit 36 të këtij ligji bazohet:

a) së pari, në rezultatet e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligji;

b) së dyti, në rastin kur ka barazi në aftësitë profesionale, mbizotëron kriteri i përvojës profesionale, duke iu referuar viteve të përvojës në sistemin gjyqësor ose prokurorisë;

c) së treti, duke përmbushur preferencat në tri gjykata ose prokurori të deklaruara nga të riemëruarit, në respektim të përcaktimeve të bëra në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, për aq sa gjejnë zbatim

5. I emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysmë në administratën publike ose të ketë rezultate "shumë të mira" në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës.

Neni 40
Caktimi i përkohshëm në pozicione të komanduara të të emëruarve

1. Brenda afatit kohor të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 39, të këtij ligji, në rastin kur numri i kërkesave për t'u caktuar në pozicion është më i madh se numri i vendeve të lira për magjistrat, Këshillat e caktojnë të

emëruarin në një pozicion të komanduar në një institucion.

2. Në rastet kur i emëruari caktohet në një pozicion të komanduar në një institucion:

a) Këshillat i ofrojnë të emëruarit mundësinë e zgjedhjes për të paktën dy pozicione, sipas radhës së renditjes së tyre në listën e të diplomuarve;

b) i emëruari i caktuar në një pozicion të komanduar në një institucion duhet të marrë pjesë në procedurën e radhës të lëvizjes paralele në shkallën e parë, me qëllim që të caktohet sa më shpejt në një pozicion të lirë si magjistrat;

c) i emëruari i caktuar në një pozicion të komanduar në një institucion përfiton pagë dhe përfitime të tjera financiare të barabarta me ato që përfitojnë magjistratët e shkallës së parë.

3. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara për përcaktimin e kritereve, kushteve dhe procedurën e caktimit të të emëruarve në pozicione të komanduara, me qëllim që të sigurojnë që pozicioni për çdo të emëruar të jetë i përshtatshëm me profilin e magjistratit.

Neni 41
Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit
(*Ndryshuar pika 2 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. I emëruari duhet të pranojë pozicionin e ofruar në përputhje me nenet 39 dhe 40, të këtij ligji, duke përfshirë:

a) pozicionin që nuk është deklaruar në preferencat e tij;

b) pozicionin e komanduar.

2. I emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin për caktimin në pozicion brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit. Gjykata kompetente merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë.

3. Vendimi i Këshillit për caktimin e të emëruarit në pozicion, në përputhje me këtë nen, merr formë të prerë kur:

a) nuk është depozituar ankim brenda afateve të ankimit;

b) është depozituar ankim sipas afateve dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes ose rrëzimin e ankimit;

c) është depozituar ankim sipas afateve dhe mbi bazën e tij është dhënë vendim gjyqësor i formës së prerë.

4. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e caktimit në pozicion të të emëruarit, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

KREU IV
TRANSFERIMI

Neni 42
Parimet e transferimit

1. "Transferimi" është:

a) lëvizja në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori në një pozicion në një gjykatë ose prokurori tjetër të të njëjtit nivel;

b) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori, i cili është në të njëjtin nivel me pozicionin e mëparshëm;

c) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori të shkallës së parë, nëse magjistrati nuk ka pasur pozicione të mëparshme.

2. Transferimi bëhet në një pozicion të lirë të përhershëm ose të përkohshëm. Pozicioni është i lirë në mënyrë të përhershme vetëm nëse nuk ka magjistratë me të drejtën për t'u kthyer në atë pozicion. Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.

3. Një pozicion i lirë i përhershëm plotësohet me radhë si më poshtë:

a) nga magjistrati që ka të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli;

b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive;

c) nga magjistrati që transferohet për shkak të lëvizjes paralele;

ç) nga magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë.

4. Një pozicion i lirë në mënyrë të përkohshme plotësohet nga magjistrati që ka të drejtën për t'u kthyer. Gjatë periudhës, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, pozicioni përkohësisht i lirë plotësohet përkohësisht me radhë si më poshtë:

a) nga magjistrati që ka të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli;

b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive;

c) nga magjistrati që transferohet për shkak të lëvizjes paralele;

ç) nga magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë.

5. Magjistrati nuk transferohet pa pëlqimin e tij, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

6. Magjistrati nuk ulet në detyrë pa pëlqimin e tij në një pozicion më të ulët, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

7. Në rastin e transferimit të përkohshëm, magjistrati kthehet në pozicionin e mëparshëm me përfundimin e periudhës së transferimit.

8. Një gjyqtar nuk lejohet të transferohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

9. Në rast të hapjes së pozicioneve të lira në gjykatën e apelit administrativ, procedura e lëvizjeve paralele do të jetë e hapur vetëm për gjyqtarë që kanë punuar për të paktën për pesë vjet në 9 vitet e fundit si gjyqtar në çështjet administrative.

Neni 43
Procedura e lëvizjes paralele

(*Ndryshuar paragrafi (ii) pika 7 me Ligjin nr. 48/2019; Shfuqizuar shkronja (b) pika 2, ndryshuar pika 5, shkronja (a) nënparagrafi (i) pika 7, shkronja (a) pika 8, shkronjat (a) dhe (c) pika 12 me Ligjin nr. 50/2021)*

1. Në zbatim të nenit 42, pikat 3 dhe 4, të këtij ligji, Këshillat organizojnë, të paktën çdo 3 muaj, procedurën e lëvizjes paralele për çdo pozicion që:

a) është i lirë;

b) pritet të bëhet i lirë brenda 3 muajve.

2. Këshillat shpallin procedurën e lëvizjes paralele dhe i bëjnë thirrje për të kandiduar magjistratëve, të cilët plotësojnë këto kritere ligjore:

a) magjistrati që ushtron funksionin në gjykatë ose në prokurori të të njëjtit nivel me pozicionin e lirë;

b) magjistrati i komanduar që ka punuar më parë në gjykatë ose prokurori të të njëjtit nivel me pozicionin e lirë;

c) në lidhje me pozicionet e lira në nivel apeli, magjistrati në skemën e delegimit, që ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, të këtij ligji, i cili ka shërbyer për të paktën katër vjet në skemën e delegimit dhe gjatë kësaj periudhe është caktuar, të paktën për një vit, në një pozicion në nivel apeli.

3. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e lëvizjes paralele gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.

4. Në zbatim të pikës 2, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës;

b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;

c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

5. Pas shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.

6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ose nëse ka në fuqi një masë disiplinore.

7. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin magjistratët që përmbushin kërkesat, sipas rezultateve të mëposhtme:

a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke përfshirë edhe ato si magjistrat i komanduar, duke pasur parasysh:

   i. që përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit, që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, si anëtar i Kolegjit Zgjedhor që i ka mbaruar mandati ose çdo pozicion tjetër që ligji e përcakton si vlerë të shtuar, do të ketë përparësi;

   ii. në rastet e më shumë magjistratëve me të njëjtën nivel vlerësimi, magjistratët brenda grupit të magjistratëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshillat.

b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 7, të këtij neni, ka më shumë se një magjistrat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta magjistratë sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;

c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "b", të pikës 7, të këtij neni, ka më shumë se një magjistrat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta magjistratë sipas vjetërsisë si magjistrat.

8. Në rastet e lëvizjes paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime, sipas pikës 7, të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele hapet për magjistratët, të cilët nuk janë vlerësuar dy herë. Ata renditen duke u bazuar njëkohësisht:

a) në rezultatin e vlerësimit etik dhe profesional përkatës;

b) në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të këtij ligji.

9. Në rastet e lëvizjes paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime sipas pikës 8, të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele hapet për magjistratët, të cilët nuk janë vlerësuar ndonjëherë. Ata renditen sipas pikës 8, shkronja "b", të këtij neni.

10. Këshillat shpallin pozicione të lira për magjistratët, sipas renditjes së parashikuar në pikat 7, 8 dhe 9, të këtij neni, dhe në përputhje me rregullat e miratuara sipas pikës 12 të këtij neni.

11. Rregullat e nenit 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim edhe në këtë nen.

12. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

a) kriteret për vlerësimin ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional;

b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë;

c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta;

ç) zbatimin dhe përshtatjen e këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.

Neni 44
Transferimi pa pëlqim

(*Shfuqizuar shkronja (c) pika 1 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar pika 4 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Magjistratët transferohen pa pëlqim vetëm në këto raste:

a) në zbatim të masës disiplinore;

b) kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, pas kryerjes së një vlerësimi, bazuar në kritere objektive dhe transparente;

c) për shkak të mungesave të përkohshme të magjistratëve në gjykata dhe prokurori, të cilat nuk mund të plotësohen nga magjistratët që janë në skemën e delegimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 46 të këtij ligji.

2. Magjistrati, të cilit i suprimohet pozicioni, sipas shkronjës "b", pikës 1, të këtij neni:

a) transferohet në pozicion në strukturën e re të së njëjtës shkallë, që ka në kompetencë tokësore gjykatën ose prokurorinë, pranë të cilës magjistrati ka ushtruar më parë funksionin, ose kur kjo nuk është e mundur;

b) gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që është i lirë apo pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve nga momenti i shkurtimit të pozicionit, në gjykatë ose prokurori të të njëjtit nivel, të së njëjtës kompetencë lëndore.

3. Për shkak të mungesave të përkohshme të magjistratëve, sipas shkronjës "ç", pikës 1, të këtij neni, Këshilli cakton një magjistrat nga skema e delegimit ose transferon një magjistrat përkohësisht, sipas nenit 46 të këtij ligji.

4. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë në gjykatë vendimin për transferim pa pëlqim brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit. Shqyrtimi i ankimit në gjykatë nuk pezullon vendimin për transferim.

Neni 45
Magjistratët në skemën e delegimit
(*Ndryshuar pika 1 dhe pika 6, shtuar shkronja (c) pika 4 me Ligjin nr. 50/2021)*

1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t'u caktuar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill.

2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet.

3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t'u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.

4. Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie:

a) në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat;

b) në një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose Prokurori të Posaçme, nëse magjistrati përmbush kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe jep pëlqimin sipas kërkesës së pikës 3, të nenit 47, të këtij ligji; për hetimin ose gjykimin e një ose disa çështjeve të veçanta në një gjykatë ose prokurori, për të cilën magjistrati përmbush kërkesat. Në rastet kur caktohet për hetimin ose gjykimin e një ose disa çështjeve të veçanta në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të përmbushë kriteret, si dhe të japë pëlqimin sipas nenit 47 të këtij ligji. Delegimi për një çështje të veçantë kryhet kur gjyqtarët ose prokurorët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve.

5. Në pritje për t'u caktuar pranë një gjykate ose prokurorie, sipas

parashikimeve të këtij neni, magjistrati në skemën e delegimit shërben në strukturat administrative të Këshillave.

6. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë ka të drejtë t'i kërkojë Këshillit caktimin për një çështje ose për një periudhë të caktuar të magjistratit nga skema e delegimit në gjykatën ose prokurorinë përkatëse, duke paraqitur arsyet e nevojës për caktimin e magjistratit dhe të periudhës kohore të kërkuar.

7. Këshilli vlerëson kërkesën brenda 3 ditëve nga marrja e saj. Nëse Këshilli vlerëson se ka nevojë në gjykatën ose prokurorinë respektive, cakton magjistratin nga skema e delegimit, duke vlerësuar njëkohësisht:

a) plotësimin e kërkesave për pozicionin respektiv;

b) disponueshmërinë;

c) përvojën e veçantë profesionale të magjistratëve;

ç) caktimin në mënyrë të barabartë të magjistratëve në skemën e delegimit, në gjykatat apo prokuroritë e largëta.

8. Çdo Këshill miraton rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve, si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit.

Neni 46
Transferimi i përkohshëm

1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t'u transferuar ose për t'u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin magjistrati.

2. Në rastin kur asnjë magjistrat nuk jep pëlqimin për t'u transferuar përkohësisht, Këshilli i kërkon një magjistrati nga një gjykatë ose prokurori me ngarkesë më të ulët për t'u transferuar përkohësisht. Ky magjistrat duhet të jetë me përvojën më të pakët si magjistrat në atë gjykatë ose prokurori, si dhe duhet të përmbushë kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht. Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin magjistrati.

3. Për çështje voluminoze dhe komplekse, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund t'i kërkojë kryetarit të prokurorisë së shkallës së parë të japë pëlqimin për transferimin e prokurorëve me kualifikim të veçantë në zyrën e Prokurorisë së Posaçme, për të punuar me çështje të veçanta, për një periudhë të caktuar.

4. Para se të merret vendimi për transferimin, sipas pikës 3, të këtij neni, Kryetari i Prokurorisë së Posaçme kërkon mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për transferimin dhe kualifikimin e prokurorit përkatës. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të japë mendim jo të detyrueshëm të paktën tre ditë pas marrjes së kërkesës.

5. Prokurori përkatës që kërkohet të transferohet duhet të ketë jo më pak se pesë vite përvojë si prokuror, të japë pëlqimin për transferimin dhe respektimin e kushteve të sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin në Prokurorinë e Posaçme, sipas pikës 3, të nenit 47, të këtij ligji. Pas dhënies së pëlqimit nga kryetari i prokurorisë përkatëse, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme transferon prokurorin për periudhën për të cilën është rënë dakord. Prokurori gëzon të drejtën të marrë pagën më të lartë, vetëm gjatë periudhës së transferimit.

6. Magjistrati transferohet në mënyrë të përkohshme për një periudhë të caktuar, por në çdo rast nuk duhet të zgjasë më shumë se një vit.

KREU V
NGRITJA NË DETYRË

Neni 47
Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë
(*Ndryshuar shkronja (b) pika 2 me Ligjin nr. 50/2021)*

1. "Ngritja në detyrë" është kalimi nga:

a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë;

b) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme;

c) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie;

ç) një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.

2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kritere minimale për përvojën profesionale:

a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

c) për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se dhjetë vjet si prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.

3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

4. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse:

a) ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

b) përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese, të tilla si:

i. përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit;

ii. përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën në tre vjet më parë;

iii. njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

c) nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit.

Neni 48
Ngritja në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara
(Ndryshuar pika 1, paragrafi (ii) shkronja (a) pika 9 me Ligjin nr. 48/2019; Ndryshuar pika 6 dhe shkronjat (a) dhe (c) pika 14 me Ligjin nr. 50/2021)

1. Pozicionet në Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme dhe gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Pozicionet në gjykatat e tjera të apelit plotësohen nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, në përputhje me nenet 42 dhe 43 të këtij ligji.

2. Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, secili Këshill organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.

3. Këshillat shpallin procedurën e ngritjes në detyrë dhe bëjnë thirrje që të kandidojë:

a) magjistrati që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;

b) magjistrati i komanduar ose magjistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;

c) juristi i spikatur, sipas përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji.

4. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e ngritjes në detyrë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.

5. Në zbatim të pikës 3, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës;

b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;

c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.

7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.

9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh:

i. që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi;

ii. në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshillat;

b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;

c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës "b", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.

10. Këshillat vendosin të ngrenë në detyrë kandidatët e vlerësuar me pikët më të larta të arritura, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14, të këtij neni. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

11. Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e kritereve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14 të këtij neni.

12. Propozimi për emërimin është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. Këshilli bën publik vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në faqen e tij zyrtare. Vendimi i këshillave për moscaktimin në detyrë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorinë e Posaçme është i formës së prerë.

13. Ngritja në detyrë e gjyqtarit me renditjen më të lartë dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës.

14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

a) kriteret për vlerësimin ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional;

b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë;

c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta;

ç) zbatimin dhe përshtatjen e parashikimeve të këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.

Neni 49
Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë

1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet:

a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f", të nenit 28, të këtij ligji;

b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit.

3. Kandidati që ka njohuri të një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Europian ka përparësi në vlerësim.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon thirrjen për paraqitjen e kandidaturave, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikat 3 dhe 5, të nenit 48, të këtij ligji.

5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kritereve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson aftësitë profesionale të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke u bazuar në këta tregues:

a) ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë;

b) vlerësimin e punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion gjatë pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit;

c) rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër;

ç) aftësitë gjuhësore, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit.

7. Bazuar në vlerësimin e aftësive profesionale, Këshilli përgatit një listë vetëm me kandidatët e renditur me vlerësimin më mirë mes të gjithë kandidatëve, të cilët merren në pyetje në një seancë dëgjimore, për të marrë informacion lidhur me kriteret e parashikuara në pikën 8 të këtij neni.

8. Këshillat i rendisin kandidatët sipas vlerësimit të aftësive profesionale dhe intervistës, duke iu referuar:

a) së pari rezultateve të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të pikës 6 të këtij neni;

b) së dyti, në rastet e rezultateve të njëjta të vlerësimit të aftësive profesionale, viteve të eksperiencës profesionale të përshtatshme për pozicionin e lirë.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve. Propozimi duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kritereve ligjore prej tyre, si dhe duhet të pasqyrojë renditjen e kandidatëve, sipas kritereve të parashikuara në pikën 8 të këtij neni.

10. Vendimi i propozimit për emërim është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. Këshilli bën publik vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në faqen e tij zyrtare.

11. Gjyqtari me renditjen më të lartë emërohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës.

12. Këshilli miraton rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

a) kriteret për vlerësimin e përvojës në fusha të veçanta;

b) kriteret dhe procedurën për vlerësimin e aftësive profesionale;

c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta.

Neni 50
Emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm

Rregullat për procedurën dhe kriteret e emërimit të Prokurorit të Përgjithshëm parashikohen në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 51
Zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës së Lartë

1. Kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e

gjykatës për një periudhë 3-vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Kandidati, që të zgjidhet kryetar i gjykatës, duhet:

a) të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale në atë gjykatë;

b) të mos ketë masa disiplinore në fuqi;

c) të jetë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në dy vlerësimet e fundit etike dhe profesionale;

ç) gjyqtarët që caktohen sipas nenit 49, të këtij ligji, duhet të jenë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin e mëparshëm etik dhe profesional.

3. Mbledhja e përgjithshme e të gjithë magjistratëve të gjykatës do të drejtohet nga kryetari i gjykatës, në rastin e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni, dhe nga zëvendëskryetari, në rastin e parashikuar në shkronjën "b", të pikës 4, të këtij neni.

4. Kryetari i mbledhjes së përgjithshme fton të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret ligjore brenda një afati 10-ditor, për të kandiduar për t'u zgjedhur si kryetar:

a) të paktën dy muaj përpara datës së mbarimit të mandatit të kryetarit në detyrë;

b) të paktën brenda 10 ditëve pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit.

5. Kryetari i gjykatës njofton mbledhjen e përgjithshme, si dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kryetar, anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të paktën një muaj para mbarimit të mandatit. Mbledhja e përgjithshme zhvillohet të paktën dy javë para mbarimit të mandatit të kryetarit.

6. Zëvendëskryetari i gjykatës njofton mbledhjen e përgjithshme, si dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kryetar, anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të paktën dy javë pas kalimit të afatit të mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit. Mbledhja e përgjithshme zhvillohet të paktën një muaj pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit.

7. Vendimi për zgjedhjen e kryetarit duhet të merret me shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme.

8. Nëse në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk ka marrë numrin e

nevojshëm të votave, një votim i dytë mbahet menjëherë ndërmjet dy kandidaturave që kanë pasur numrin më të madh të votave. Nëse edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk merr numrin e nevojshëm të votave, magjistrati me numrin më të madh të votave konsiderohet i zgjedhur. Në rastet e një barazimi votash, ka përparësi magjistrati me përvojë profesionale më të gjatë si magjistrat.

9. Këshilli miraton rregulla të detajuara për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin, mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit.

Neni 52
Emërimi i kryetarëve të tjerë

1. Mandati i Kryetarit të gjykatave dhe prokurorive të tjera, me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm, është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Mandati i kryetarit të Prokurorisë së Posaçme është tre vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, kryetari i gjykatës ose prokurorisë me të drejtën e rizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat të dytë. Kur kryetari nuk kandidon për një mandat të dytë brenda afatit të përcaktuar, konsiderohet që ka dhënë dorëheqjen si kryetar në fund të mandatit.

3. Kur kryetari në detyrë kandidon për riemërim, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli përkatës, jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të parë, sipas rregullave të parashikuara në pikat nga 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

4. Kryetari riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse kalon me sukses verifikimin, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji, dhe nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar dhe magjistrat, është të paktën "shumë mirë".

5. Këshilli merr vendim jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit.

6. Në rastin kur kryetari jep dorëheqjen ose kur nuk i pranohet kërkesa për një mandat tjetër, Këshilli publikon shpalljen për vendin e lirë për pozicionin e kryetarit për kandidatët që i plotësojnë kriteret e ngritjes në detyrë, jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit në detyrë.

7. Thirrja për aplikim u drejtohet magjistratëve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse. Në rast se në gjykatën ose prokurorinë përkatëse,

një pozicion bëhet në mënyrë të përhershme i lirë nga dy muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit deri në tre muaj pas mbarimit të tij, thirrja për kandidim i drejtohet çdo magjistrati që plotëson kriteret për kryetar. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme thirrja për kandidim për kryetar u drejtohet vetëm prokurorëve të kësaj prokurorie.

8. Në zbatim të pikës 7, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

a) afatin e aplikimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes;

b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet aplikimit;

c) procedurën e aplikimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

9. Këshilli përkatës vlerëson në rast se kandidati i plotëson kriteret të parashikuara në pikën 6 të nenit 47. Ai kryen verifikim, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga ligji ose nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi.

10. Këshilli shqyrton aplikimet dhe rendit kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

a) së pari dy vlerësimet e mëparshme. Në rastet e më shumë kandidatëve me të njëjtën nivel vlerësimi, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;

b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 10, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;

c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "b", të pikës 10, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat.

11. Këshilli cakton në funksionin e kryetarit kandidatin më të mirë të listuar. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, për caktimin e të emëruarve të rinj në pozicion aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

12. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

a) kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magjistratëve me pikë të barabarta vlerësimi;

b) kriteret për matjen e aftësive organizative dhe drejtuese;

c) procedurën që ndiqet në rastin e rezultateve të barabarta.

KREU VI
KOMANDIMI

Neni 53
Parimet e komandimit të magjistratëve
(*Ndryshuar pikat 1 dhe 2, shtuar pika 8/1 me Ligjin nr. 50/2021)*

1. "Komandim" është lëvizja e magjistratit në një pozicion jomagjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë ose organizatë ndërkombëtare, pozicion i cili është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij.

2. "Institucioni në të cilin magjistrati komandohet", për pozicionin e ndihmësmagjistratit është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit si dhe organizatat ndërkombëtare.

3. Me përjashtim të rasteve të caktimit në pozicion të sapoemëruarve, magjistratët mund të komandohen vetëm me pëlqimin e tyre.

4. Magjistrati i komanduar ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si çdo magjistrat tjetër, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

5. Magjistrati nuk lejohet të komandohet në ato raste kur:

a) është në një pozicion me mandat të kufizuar;

b) është i komanduar.

6. Periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj.

7. Magjistrati duhet të shërbejë jo më pak se pesë vjet si magjistrat pas përfundimit të periudhës së komandimit.

8. Magjistrati nuk mund të komandohet për më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së tij.

8/1. Magjistrati që komandohet në një organizatë ndërkombëtare, me qëllim përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në atë organizatë, gëzon të njëjtin status me diplomatët, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

9. Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria e shkallës së parë në institucionin në të cilin magjistrati komandohet, llogaritet përvojë në profesion në shkallë të parë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria në shkallë të dytë, institucioni në të cilin magjistrati komandohet llogaritet si përvojë në profesion në shkallë të dytë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Ushtrimi i funksioneve drejtuese në institucionin në të cilin magjistrati komandohet vlerësohet si përvojë drejtuese.

10. Magjistratit të komanduar i bëhet vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet për anëtarët e tjerë të këtij institucioni, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Nivelet e këtij vlerësimi njihen si nivele vlerësimi në kuptim të këtij ligji.

11. Magjistratit, të cilit nuk i është bërë vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, ka të drejtën të vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidat jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49, të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim, me qëllim që të konkurrojë në kushte të njëjta me magjistratët e tjerë për pozicionet e lira.

12. Magjistrati, gjatë komandimit, ka përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucionit në të cilin magjistrati është komanduar. Në rastet kur institucioni në të cilin magjistrati është komanduar propozon shkarkimin e magjistratit si masë disiplinore, magjistrati i komanduar mund të kërkojë referimin e çështjes te Këshilli. Në këtë rast Këshilli shqyrton çështjen dhe zbaton procedurën disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji. Institucioni në të cilin është komanduar magjistrati merr pjesë në procedurën disiplinore me të drejtat dhe detyrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

13. Nëse çështja nuk është referuar në Këshill, institucioni në të cilin është komanduar magjistrati informon Këshillin për çdo vendim të ndërmarrë prej tij ndaj magjistratit të komanduar. Ankimi në gjykatë i vendimit për masë disiplinore të institucionit në të cilin është komanduar magjistrati pezullon zbatimin e vendimit.

Neni 54
Procedurat e komandimit

1. Çdo institucion, i parashikuar në nenin 53, pika 2, të këtij ligji, ku komandohet magjistrati mund të kërkojnë nga çdo Këshill komandimin e magjistratëve për një periudhë të përcaktuar, në çdo rast jo më shumë se pesë vjet.

2. Këshilli, pasi ka bërë vlerësimin e nevojave të tij, brenda dy javëve nga paraqitja e kërkesës për kandidatura nga institucionet, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 2, për plotësimin e pozicioneve të komanduara, shpall kërkesën për kandidatura për plotësimin e këtyre pozicioneve.

3. Këshillat pranojnë kandidaturat e magjistratëve, të cilët përmbushin kriteret specifike të pozicioneve që do të komandohen, nëpërmjet shpalljes, e cila publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes;

b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;

c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

4. Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin. Opinioni për çdo kandidat publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë, përjashtohet nga komandimi. Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të kandidimit, i dërgon institucionit në të cilin do të bëhet komandimi emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit përkatës.

5. Institucioni ku kryhet komandimi i magjistratëve vlerëson aplikimet dhe kërkon komandimin e magjistratit të përzgjedhur për një periudhë të caktuar kohe.

6. Këshilli merr vendim për komandimin e magjistratit brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij neni. Vendimi përcakton kushtet e komandimit.

7. Në rastin kur kërkesa paraqitet nga institucione të tjera nga ato të parashikuara në nenin 53, pika 2, të këtij ligji, Këshilli mund të komandojë magjistratin në këto institucione sipas rastit, nëse komandimi është në

interes publik dhe nuk cenon afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçente të funksioneve.

Neni 55
Komandimi i magjistratëve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Magjistratët që plotësojnë kriteret për t'u emëruar si magjistratë në Gjykatën e Lartë ose në Prokurorinë e Përgjithshme mund të komandohen në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Për procedurat e komandimit në plotësimin e pozicionit të inspektorit, Këshilli, përpara përgatitjes së opinionit, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 54, verifikon kandidatët sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

3. Magjistrati, i cili komandohet si inspektor, konsiderohet magjistrat i ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë.

4. Magjistrati mund të komandohet si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë pesëvjeçare. Pas mbarimit të periudhës pesëvjeçare, Inspektori ka të drejtën e rikomandimit, në rast se është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin etik dhe profesional si inspektor.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një inspektori, mund t'i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim, përfshirë dokumentet e nevojshme, për konfirmimin e inspektorit si i komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Këshilli konfirmon inspektorin nëse ai është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ka dhënë pëlqimin për konfirmimin. Kur kërkesa nuk është paraqitur në kohë, afati i pozicionit të komanduar si inspektor konsiderohet i mbaruar.

6. Inspektori ka të drejtën të caktohet në një pozicion në nivel apeli në fund të përfundimit të mandatit të komandimit në rast se është vlerësuar me vlerësimin "shumë mirë" në të gjitha vlerësimet etike dhe profesionale si inspektor.

Neni 56
Komandimi në pozicionet e ndihmësmagjistratit

1. Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme me mandat

pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.

2. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose i Gjykatës së Lartë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një ndihmësmagjistrati, mund t'i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistratit si i komanduar në Gjykatën Kushtetuese ose Gjykatën e Lartë. Këshilli konfirmon ndihmësmagjistratin nëse është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ndihmësmagjistrati ka dhënë pëlqimin për konfirmim.

3. Përcaktimet e pikës 2, të këtij neni, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim, për kërkesën respektive të Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Kur kërkesa nuk është paraqitur në kohë, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3, të këtij neni, afati i pozicionit të komanduar si ndihmësmagjistrat konsiderohet i mbaruar.

5. Ndihmësmagjistrati i caktuar në Gjykatën e Lartë dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme ka përgjegjësi disiplinore dhe vlerësohet sipas dispozitave të këtij ligji, të cilat aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

Neni 57
Përfundimi i kohëzgjatjes së komandimit

1. Afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar.

2. Me kërkesë të magjistratit të komanduar, Këshilli, pasi merr mendimin e institucionit ku është komanduar magjistrati, mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuara.

3. Vetëm në ato raste kur magjistrati ka kryer të gjithë periudhën e komandimit, Këshilli e konsideron me përparësi në lëvizjen paralele ose në procedurat e ngritjes në detyrë.

4. Magjistrati ka të drejtë që pas periudhës të komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj.

Neni 58
Rregulla të detajuara për komandimin

Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për komandimin, pasi kanë

marrë mendimin e institucioneve ku komandohen magjistratët, për të siguruar që përvoja profesionale e magjistratit të shërbejë në institucionet ku komandohet.

Këto rregulla parashikojnë:

a) kohëzgjatjen maksimale të çdo komandimi jo më shumë se pesë vjet dhe parashikime të ndryshme mund të përcaktohen për raste të ndryshme;

b) numrin maksimal të periudhave, gjatë të cilave magjistrati mund të komandohet, dhe parashikime të ndryshme mund të bëhen për raste të ndryshme;

c) njohjen e rezultateve të vlerësimit, në përputhje me parashikimet në këtë kre dhe rregullat për përshtatjen e parashikimeve për vlerësimin etik dhe profesional për pozicionet si ndihmësmagjistrat.

KREU VII
MANDATI I KUFIZUAR

Neni 59
Caktimi i përkohshëm

1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

a) caktimit në pozicione të tjera;

b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.

2. Pozicionet e përkohshme krijohen në rastet e mëposhtme:

a) të komandimit të magjistratit;

b) të transferimit ose ngritjes në detyrë me mandat të kufizuar të magjistratit ose kur një pozicion është përkohësisht i lirë;

c) të lejes prindërore ose lejes së papaguar;

ç) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.

3. Transferimet e përkohshme, në kuptim të nenit 46, të këtij ligji, nuk janë pozicione të përkohshme në kuptim të këtij neni.

4. Këshilli merr vendim për rastet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, si dhe përcakton datën e fillimit dhe datën e mbarimit të periudhës kohore, në të cilën pozicioni mund të plotësohet përkohësisht.

5. Në rastet kur magjistratit që ka pozicion të përhershëm, vendi i të cilit është përkohësisht i lirë, i ka mbaruar statusi, ose është caktuar, transferuar ose ngritur në detyrë në një pozicion tjetër të përhershëm, pozicioni i plotësuar përkohësisht konsiderohet i përhershëm. Magjistrati që është caktuar përkohësisht në këtë pozicion njoftohet për ndryshimin e pozicionit nga një pozicion i përkohshëm në të përhershëm.

6. Në rastet kur në një gjykatë ose prokurori krijohet një pozicion i lirë i përhershëm, çdo magjistrat që mban një pozicion të përkohshëm në atë gjykatë ose prokurori mund të kërkojë që pozicioni i tij të bëhet i përhershëm.

7. Këshilli vendos për ndryshimin e një pozicioni të përkohshëm përpara se të shpallë thirrjen për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë. Nëse ka disa magjistratë, të cilët kanë pozicion të përkohshëm, që kandidojnë për ndryshimin e pozicionit, kriteret e transferimit zbatohen për aq sa është e mundur. Pozicioni i përkohshëm që mbetet i lirë plotësohet me lëvizje paralele, ashtu si dhe me procedurën e ngritjes në detyrë.

8. Kur një pozicion është përkohësisht i lirë, ai mund të plotësohet vetëm përmes caktimit të përkohshëm të magjistratit. Kur magjistrati caktohet në një pozicion që është përkohësisht i lirë, ka të drejtë të kthehet në pozicionin e tij të mëparshëm, nëse ishte caktuar në atë pozicion në mënyrë të përhershme. Nëse magjistrati në pozicionin e mëparshëm ishte caktuar përkohësisht, ka të drejtë të kthehet në atë pozicion deri në përfundim të afatit të caktimit.

9. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për njoftimet dhe plotësimet e vendeve të lira të përkohshme.

Neni 60
E drejta e kthimit

1. Magjistrati me një pozicion të përhershëm, kur përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin, sipas parashikimit të nenit 59, të këtij ligji, pas mbarimit të periudhës së përkohshme ka të drejtë që të kthehet në pozicionin e mëparshëm të përhershëm.

2. Kur magjistrati ka të drejtën e kthimit, ai kthehet në pozicionin e mëparshëm të tij, përveç rasteve kur është transferuar sipas lëvizjes paralele ose është ngritur në detyrë në një pozicion të përhershëm.

3. Nëse nuk është i mundur kthimi në pozicionin e mëparshëm, për arsye të përfundimit para kohe të shkaqeve për të cilat magjistrati është caktuar në pozicionin e përkohshëm, atëherë ai caktohet përkohësisht në pozicionin më të parë që i korrespondon nivelit të pozicionit të mëparshëm, nëse ka vende të lira dhe nëse magjistrati plotëson kërkesat përkatëse të këtij pozicioni. Në rastet kur magjistrati nuk është caktuar ende në një pozicion të përhershëm, ai caktohet në një pozicion në shkallë të parë.

4. Nëse magjistrati nuk pranon të kthehet në pozicionin që i ofrohet, gëzon të drejtën për t'u caktuar në vendin tjetër të lirë, në të njëjtën shkallë me pozicionin e mëparshëm, nëse plotëson kërkesat përkatëse të këtij pozicioni.

5. Nëse magjistrati nuk pranon të kthehet për herë të dytë në pozicionin që i ofrohet, ai caktohet në një pozicion pa pëlqimin e tij.

6. Këshilli merr masat që kthimi i magjistratit, sipas këtij neni, të realizohet në kohë, menjëherë me mbarimin e afatit të periudhës së përkohshme.

7. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikat e këtij neni, magjistrati që është anëtar i Këshillit, përjashtohet nga konkurrimi në procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar i Këshillit, si dhe tre vjet nga mbarimi i këtij mandati.

Neni 61
Kufizimi i mandatit me ligj
(Ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 2/1, 2/2 dhe 2/3 me Ligjin nr. 15/2020)

1. Mandati i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është nëntë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm është shtatë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme është nëntë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Mandati i anëtarit të Gjykatës së Lartë që përzgjidhet mes juristëve të spikatur fillon në ditën e betimit. Këshilli i Lartë Gjyqësor organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e emërimit ose e shpalljes i emëruar. Nëse anëtari i Gjykatës së Lartë nuk thirret për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë të nënshkruar personalisht Këshillit të Lartë Gjyqësor. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor konsiderohet si dita e betimit dhe e fillimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Akti i betimit përfshihet në dosjen personale të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2/1. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm fillon në ditën e betimit. Ceremonia e betimit organizohet nga Kuvendi jo më vonë se 10 ditë nga data e zgjedhjes ose shpalljes i emëruar. Nëse Prokurori i Përgjithshëm nuk është thirrur për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Kuvendit dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Kuvendit konsiderohet si dita e betimit dhe e fillimit të detyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Akti i betimit përfshihet në dosjen personale të Prokurorit të Përgjithshëm.

2/2. Mandati i anëtarëve të Gjykatës së Lartë që ngrihen në detyrë nga radhët e gjyqtarëve fillon në datën e emërimit ose shpalljes i emëruar.

2/3. Mandati i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme fillon në datën e ngritjes së tyre në detyrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, mandati i të cilit ka mbaruar, vazhdon të mbajë funksionin deri në caktimin e gjyqtarit pasardhës, përveç rasteve të parashikuara në nenin 136, pika 5, të Kushtetutës.

4. Personat e listuar në pikën 1, të këtij neni, kanë të drejtë që pas mbarimit të mandatit të caktohen në një pozicion në nivel apeli.

5. Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë të Posaçme, jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit respektiv, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, dhe menjëherë në rastet e ndërprerjes së mandatit përpara afatit ligjor, njoftojnë Këshillin respektiv për pozicionin e lirë. Procedura që ndjek Këshilli për ngritjen në detyrë të pasardhësit përfundon jo më vonë se data e mbarimit të mandatit dhe, në rast të ndërprerjes përpara afatit ligjor, jo më vonë se dy muaj nga marrja e njoftimit.

Neni 62
E drejta për caktim në nivel apeli

1. Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, si Prokuror i Përgjithshëm ose në raste të tjera, ku ligji parashikon të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, magjistrati ka të drejtë për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion. Parashikimet e pikave 3 deri në 7, të nenit 60, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

2. Në rastin kur disa magjistratë kanë të drejtën e pozicionit në nivel apeli, sipas pikës 1, të këtij neni, magjistrati me rezultatet më të mira në

vlerësimin etik dhe profesional gëzon i pari të drejtën për pozicionin, si dhe e ka këtë të drejtë deri në tre zgjedhje.

3. Me mbarimin e periudhës së ushtrimit të funksionit në pozicionin e mëparshëm, magjistrati ka të drejtën të marrë pagën e pozicionit ku është caktuar.

Neni 63
Mbarimi i mandatit të kryetarit

1. Mandati i kryetarit është trevjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

2. Mandati i kryetarit mbaron menjëherë me mbarimin e periudhës për të cilën është caktuar.

3. Raste të tjera të mbarimit të mandatit të kryetarit janë:

a) kur mbaron statusi si magjistrat, për arsyet e listuara në nenin 64 të këtij ligji;

b) kur kandidon për pozicionin e anëtarit të Këshillit.

4. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit përkatës.

5. Në fund të mandatit si kryetar, ai ka të drejtë të vazhdojë të ushtrojë pozicionin si magjistrat në gjykatën ose prokurorinë përkatëse.

KREU VIII
MBARIMI I STATUSIT TË MAGJISTRATIT

Neni 64
Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit
(*Shfuqizuar pika 5 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar shkronja (c) pika 1, pika 4 dhe pika 5 me Ligjin nr. 48/2019; Ndryshuar shkronja (c) pika 1, pika 5 dhe pika 6 me Ligjin nr. 50/2021)*

1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji;

ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;

d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë del në pension në moshën 70 vjeç. Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë i mbaron mandati kur mbush moshën 70 vjeç, pavarësisht nga vitet e ushtrimit të funksionit në këtë pozicion.

3. Prokurori i Përgjithshëm del në pension në moshën 70 vjeç. Prokurorit të Përgjithshëm i mbaron mandati kur mbush 70 vjeç, pavarësisht nga vitet e ushtrimit të funksionit në këtë pozicion.

4. Mandati i Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme mbaron në fundin e muajit në të cilin mbush moshën 67 vjeç, pavarësisht viteve që ai ka qenë në detyrë në këtë pozicion.

5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.

6. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës. Mbarimi i mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorit të Prokurorisë së Posaçme deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës

Neni 65
Dorëheqja

1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 66
Pazgjedhshmëria dhe papajtueshmëria

1. Statusi i magjistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e pazgjedhshmërisë si vijon:

a) kur magjistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara, sipas nenit 28 të këtij ligji;

b) kur vendimi i emërimit është i pavlefshëm dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike, si dhe konsiderohet se nuk ekziston.

2. Statusi i magjistratit mbaron kur Këshilli vendos që ai nuk përmbush kushtet e papajtueshmërisë, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të këtij ligji.

3. Organi përgjegjës, kryetari dhe magjistrati njoftojnë menjëherë në mënyrë të pavarur Këshillin, për shkaqet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë që sjellin mbarimin e statusit të magjistratit. Në këto raste, magjistrati ndalon së ushtruari funksionin si magjistrat.

4. Këshill deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se 2 javë nga marrja e njoftimit për shkakun e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë.

5. Vendimi përcakton datën e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të pikës 1 ose 2 të këtij neni.

6. Çdo veprim i kryer nga magjistrati pas kësaj date është i pavlefshëm dhe konsiderohet që nuk sjell asnjë pasojë juridike, si dhe konsiderohet se nuk ekziston.

Neni 67
Pamundësia fizike dhe mendore e një magjistrati

1. Me marrjen dijeni, Këshilli heton rastet për pamundësi fizike dhe mendore të magjistratit, të cilat çojnë në largimin nga funksioni ose pezullimin e përkohshëm të magjistratit.

2. Këshilli autorizon një komision me ekspertë për të dhënë mendim të specializuar rreth pamundësisë së magjistratit.

3. Magjistrati ka të drejtë të ketë akses në dosje, të përfaqësohet nga

përfaqësuesi i tij dhe të dëgjohet.

4. Këshilli vendos pezullimin përkohësisht ose mbarimin e statusit të magjistratit nëse konkludon se kushtet fizike dhe mendore të magjistratit e bëjnë atë përkohësisht ose përgjithmonë të papërshtatshëm për funksionin.

5. Këshilli vendos kthimin e magjistratit të larguar nga funksioni, nëse provohet se pamundësia e tij nuk vazhdon më.

6. Magjistrati gëzon të drejtat e pensionit dhe përfitimet e tjera për largimin nga funksioni, sipas këtij neni.

7. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e Këshillit të dhënë, sipas parashikimeve të këtij neni.

PJESA IV
VLERËSIMI I MAGJISTRATIT

KREU I
PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 68
Qëllimi i vlerësimit të magjistratit

Qëllimi i vlerësimit etik dhe profesional të magjistratit është:

a) të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësitë profesionale të magjistratëve;

b) të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së magjistratëve;

c) të informojë vendimet e Këshillave në lidhje me vendimet e statusit të magjistratit, në funksion të zhvillimit të karrierës bazuar mbi meritë;

ç) të informojë Këshillat dhe Shkollën e Magjistraturës në lidhje me nevojat për trajnim të magjistratëve dhe për të lehtësuar planifikimin e trajnimit të tyre;

d) të identifikojë magjistratët që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale për sistemin e drejtësisë;

dh) të kontribuojë në përmirësimin e strukturës organizative të gjykatave

dhe prokurorive, si dhe të kushteve të punës të magjistratëve.

Neni 69
Parimet e vlerësimit

Sistemi i vlerësimit bazohet dhe zbatohet nëpërmjet këtyre parimeve:

a) parimi i pavarësisë, sipas të cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e magjistratit;

b) parimi i meritokracisë dhe i zhvillimit të karrierës, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së magjistratit kryhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale;

c) parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë kryhet nëpërmjet një procesi të shpejtë, me anë të procedurave të thjeshta dhe në afate kohore të arsyeshme për të siguruar të dhëna në kohën e duhur për karrierën e magjistratit;

ç) parimi i procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit në procedurën e vlerësimit respektohen standardet e procesit të rregullt ligjor për magjistratin, duke përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet, të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit, të drejtën për të marrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u mbrojtur, të drejtën për të pasur një akt vlerësimi të arsyetuar dhe të drejtën për t'u ankuar mbi aktin e vlerësimit;

d) parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të magjistratit që vlerësohet, si dhe të dhënat e tij personale, sipas legjislacionit në fuqi. Këto subjekte përjashtohen nga ky detyrim vetëm në rastet kur informacioni i jepet magjistratit që vlerësohet ose organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare.

Neni 70
Subjektet e vlerësimit
(*Ndryshuar fjalia e dytë pika 3 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Të gjithë magjistratët, përfshirë kryetarët e gjykatave dhe prokurorive, janë subjekt i vlerësimit të tyre etik dhe profesional, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

2. Kryetarët vlerësohen gjithashtu edhe për veprimtarinë e tyre si kryetar gjykate apo prokurorie.

3. Magjistratët, të cilët janë në skemën e delegimit, ose janë komanduar në Këshilla, Gjykatën e Lartë ose Prokurorinë e Përgjithshme vlerësohen sipas parashikimeve të këtij ligji. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për vlerësimin e magjistratëve në skemën e delegimit ose të komanduar.

4. Magjistratët, të cilët janë komanduar në struktura të tjera dhe ruajnë statusin e magjistratit, vlerësohen sipas sistemit të vlerësimit në strukturën ku janë komanduar.

KREU II
KRITERET, BURIMET DHE NIVELET E VLERËSIMIT

SEKSIONI I
VLERËSIMI I MAGJISTRATIT

Neni 71
Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi kryhet sipas kritereve të mëposhtme:

a) aftësive profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit;

b) aftësive organizative;

c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit;

ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Neni 72
Aftësitë profesionale të gjyqtarit

1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë

së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën.

3. Aspekti i arsyetimit ligjor të gjyqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.

4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Neni 73
Aftësitë profesionale të prokurorit

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsyetimit ligjor.

2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

3. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

4. Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

Neni 74
Aftësitë organizative

1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e magjistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.

2. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në

treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje.

3. Në rastin e gjyqtarit, aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

4. Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

5. Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore ose të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

Neni 75
Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

1. Me anë të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet aftësia e magjistratit për etikën në punë, integritetin dhe paanësinë.

2. Etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

3. Integriteti i magjistratit, në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, matet duke u bazuar në tregues të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit dhe/ose raportet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

4. Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë

edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

Neni 76
Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

1. Me anë të kriterit të aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

2. Aftësia e komunikimit të magjistratit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale. Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën "shumë mirë" ka përparësi në vlerësimin si magjistrat, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar.

3. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe shkëmbimit të njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

4. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera matet duke u bazuar në tregues të tillë si pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike.

5. Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar në informacionin e dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, në vlerësimin "shumë mirë" në rastet e përmbushjes së detyrimit ligjor për të marrë pjesë në formim vazhdues jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë vjetëve. Shkallët e tjera të vlerësimit përcaktohen me rend zbritës nga ky standard.

Neni 77
Burimet e vlerësimit

Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime:

a) dosja personale e magjistratit;

b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të këtij ligji;

c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91, të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara;

ç) vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore ose aktet e hartuara prej prokurorit dhe të përzgjedhura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve/akteve të hartuara dhe të përzgjedhura prej prokurorit nuk duhet të jetë më shumë se 2 në vit;

d) mendimi i kryetarit;

dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit;

e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në veprimtaritë trajnuese;

ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo;

f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;

g) kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;

gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të magjistratit.

Neni 78
Nivelet e vlerësimit

(Shfuqizuar pjesë nga pika 3 dhe fjalia e fundit shkronja (b) pika 5 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar pika 3 me Ligjin nr. 48/2019)

1. Vlerësimi i magjistratit kryhet sipas këtyre niveleve:

a) "Shkëlqyeshëm", në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;

b) "Shumë mirë", në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;

c) “Mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;

ç) “Mjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren.

d) “I pamjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

3. Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tri kritere dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe të prokurorisë” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë”.

4. Vlerësimi i përgjithshëm “mirë” jepet në rastin kur aftësitë e magjistratit vlerësohen “mirë” për dy kritere dhe “mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kritereve në nivelet “mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në pikën 3, të këtij neni. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore ose të prokurorisë” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” duhet të vlerësohen të paktën “shumë mirë”.

5. Vlerësimi i përgjithshëm “i pamjaftueshëm” jepet në këto raste:

a) kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kritere;

b) kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” dhe jo më shumë se “mirë” për dy kriteret e tjera.

SEKSIONI II
VLERËSIMI I VEPRIMTARISË SË KRYETARIT

Neni 79
Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të një gjykate ose prokurorie kryhet bazuar në këto kritere:

a) aftësitë drejtuese dhe organizative;

b) aftësitë e komunikimit.

Neni 80
Aftësitë drejtuese dhe organizative

1. Me anë të kriterit të aftësive drejtuese dhe organizative vlerësohen aftësitë e kryetarit për organizimin e qartë të veprimtarive administrative, si gjyqtar dhe prokuror, nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe aksesin dhe transparencën në gjykatë.

2. Në rastin e kryetarit të gjykatës, kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:

a) mirorganizimin e gjykatës në dhoma ose seksione;

b) ndarjen e trupave gjykues;

c) planifikimin e gjyqtarëve për çështje të natyrës urgjente;

ç) ndarjen e çështjeve me short;

d) zëvendësimin në kohë të gjyqtarëve që kanë pengesa në gjykim;

dh) zhvillimin e mbledhjeve tematike;

e) planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të gjykatës;

ë) mbikëqyrjen, me qëllim përmirësimin e informacionit në faqen zyrtare të gjykatës;

f) mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në gjykatë, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut, përfshirë edhe shenjat orientuese në gjykatë;

g) organizimin e trajnimeve për gjyqtarët ose punonjësit e gjykatës.

3. Në rastin e kryetarit të prokurorisë, kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:

a) mirorganizimin e prokurorisë në seksione;

b) planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente;

c) zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces;

ç) zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët;

d) planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë;

dh) mbikëqyrjen, për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë;

e) mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut;

ë) organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë.

4. Përfshirja e kryetarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e gjykatës ose të prokurorisë vlerësohet me përparësi në matjen e këtij kriteri.

Neni 81
Aftësitë komunikuese

Me anë të kriterit të aftësisë komunikuese vlerësohet aftësia e kryetarit për komunikim të qartë, në kohë dhe transparent. Ky kriter matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:

a) bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditi;

b) komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme.

Neni 82
Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarëve

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit bazohet në këto burime:

a) dosja personale e kryetarit;

b) vlerësimi i kryer nga kryetari, i cili përmbush, në mënyrë të njëjtë, kriteret e vlerësimit të kryer nga magjistrati;

c) raportet vjetore të kryetarit, ku pasqyrohen të dhënat e veprimtarisë financiare dhe procesverbalet e mbledhjeve vjetore të analizës së gjykatës ose prokurorisë, si dhe raporti përkatës i përfaqësuesit të Këshillit në këto mbledhje, duke përfshirë edhe regjistrimin audio;

ç) çdo urdhër ose vendim i kryetarit, i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e gjyqtarëve ose prokurorëve ose të administratës gjyqësore ose të prokurorisë;

d) të dhëna statistikore për funksionimin e gjykatës ose prokurorisë në pesë vitet e fundit;

dh) raportet e inspektimit të gjykatës ose prokurorisë nga institucionet shtetërore;

e) çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të kryetarit me publikun dhe të tretët;

ë) mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të prokurorisë ku ushtron funksionin kryetari i gjykatës ose mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin kryetari i prokurorisë;

f) informacioni me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e kryetarit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e gjykatës apo prokurorisë;

g) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj kryetarit në këtë cilësi, gjatë periudhës së vlerësimit;

gj) vendime përfundimtare për masa disiplinore, për shkak të pozicionit të kryetarit, të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;

h) kundërshtimet e kryetarit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;

i) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të kryetarit.

Neni 83
Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i veprimtarisë të kryetarit kryhet sipas këtyre niveleve:

a) "Shumë mirë", në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mbi mesataren;

b) "Mirë", në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mesatare;

c) "Mjaftueshëm", në rastin e veprimtarisë drejtuese nën mesatare.

2. Vlerësimi i përgjithshëm "shumë mirë" jepet nëse veprimtaria drejtuese

e kryetarit vlerësohet "shumë mirë" në të dyja kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm "mjaftueshëm" jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet "mjaftueshëm", të paktën në një prej kritereve. Në rastet e tjera, veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet "mirë".

KREU III
PROCEDURA E VLERËSIMIT

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 84
Periudha e vlerësimit

1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar.

2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat.

3. Kryetari vlerësohet të paktën një herë gjatë kohëzgjatjes së mandatit si kryetar. Në çdo rast, veprimtaria e kryetarit vlerësohet nga Këshilli të paktën gjashtë muaj para përfundimit të këtij mandati.

4. Magjistrati, i cili ushtron funksionin si anëtar i një Këshilli, nuk vlerësohet sipas parashikimeve të këtij ligji. Këshilli miraton rregulla të detajuara për vlerësimin e veprimtarisë gjatë funksionit në Këshill. Në rast të paraqitjes së kërkesës për transferim dhe ngritje në detyrë tre vjet pas këtij funksioni, Këshilli merr në konsideratë veprimtarinë e magjistratit gjatë funksionit si anëtar i Këshillit.

SEKSIONI II
FILLIMI I PROCEDURËS SË VLERËSIMIT

Neni 85
Programi dhe njoftimi i vlerësimit
(*Ndryshuar pika 1 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Këshilli, jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, miraton programin

që përcakton listën e magjistratëve dhe kryetarëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Në program përfshihen të paktën ata magjistratë, për të cilët përfundon ose ka përfunduar periudha e vlerësimit në vitin përkatës, me qëllim që të sigurohet në kohë vlerësimi etik dhe profesional i magjistratit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

2. Kryetarët dhe magjistratët, të cilët do të vlerësohen sipas programit të miratuar, sipas pikës 1, të këtij neni, njoftohen në kohën e duhur nga Këshilli.

3. Magjistrati kryen vlerësim etik dhe profesional të punës së tij, në kuptim të nenit 77, shkronja "ç", të këtij ligji, brenda tre javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Magjistrati duhet të dorëzojë vlerësimin etik dhe profesional të kryer prej tij, sipas pikës 3, të këtij neni, pranë kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin, brenda tre javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas këtij neni.

Neni 86
Vlerësimi i kryer nga magjistrati

1. Magjistrati kryen vlerësimin etik dhe profesional të punës së tij, sipas nenit 85, të këtij ligji, sipas formularit standard të vendosur nga Këshilli, nëpërmjet të cilit magjistrati:

a) vlerëson aktivitetin përkundrejt kritereve vlerësuese;

b) paraqet një analizë të të dhënave statistikore që lidhen me veprimtarinë e tij si magjistrat;

c) përshkruan masat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në vlerësimin e mëparshëm;

ç) përshkruan shkallën në të cilën janë përmbushur këta objektiva, duke dhënë edhe shpjegimin përkatës;

d) përshkruan objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm të tij;

dh) përshkruan nevojat për trajnim dhe rrethanat, të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional, dhe propozon zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

2. Në çdo rast, vlerësimi i kryer nga magjistrati duhet të shoqërohet me dy vendime gjyqësore ose dy akte të hartuara prej prokurorit, të përzgjedhura

prej tij, dokumentet që tregojnë angazhimin në veprimtaritë profesionale ndërinstitucionale gjatë periudhës së vlerësimit, trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës dhe çdo dokument tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale. Dokumentet për trajnimet jashtë Shkollës së Magjistraturës duhet të evidentojnë përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin.

Neni 87
Mendimi i kryetarit

1. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, ku ushtron funksionin magjistrati që vlerësohet, paraqet mendim për veprimtarinë e magjistratit, në përputhje me standardet e vendosura nga Këshilli.

2. Në mendimin e kryetarit përshkruhet veprimtaria e magjistratit dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari, sipas kritereve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit, të parashikuara në këtë ligj, duke u ndalur veçanërisht në ato kritere, për të cilat mendimi i kryetarit ndryshon nga vlerësimi i kryer nga magjistrati. Gjithashtu, në mendimin e kryetarit pasqyrohet një analizë e të dhënave statistikore të veprimtarisë së magjistratit.

3. Mendimi i kryetarit i njoftohet magjistratit brenda katër javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas nenit 85 të këtij ligji.

4. Brenda tri ditëve nga njoftimi i mendimit, magjistrati gëzon të drejtën për t'u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me kryetarin.

5. Kryetari zhvillon takimin me magjistratin brenda dy javëve nga data e depozitimit të kërkesës dhe merr masat për pasqyrimin e takimit në procesverbal, i cili i bashkëlidhet mendimit të kryetarit.

6. Jo më vonë se dy muaj nga data e njoftimit, sipas nenit 85, të këtij ligji, kryetari paraqet mendimin përfundimtar për veprimtarinë e magjistratit, i cili pasqyron edhe kundërshtimet e mundshme të magjistratit.

Neni 88
Dërgimi i akteve të vlerësimit nga kryetari

1. Kryetari i dërgon Këshillit aktet e vlerësimit të magjistratit, brenda dy muajve nga data e njoftimit, sipas nenit 85 të këtij ligji.

2. Aktet e vlerësimit përfshijnë:

a) vlerësimin e kryer nga magjistrati, dy vendime gjyqësore ose dy

akte të hartuara prej prokurorit, të përzgjedhura prej tij për çdo vit, si dhe çdo e dhënë tjetër e paraqitur nga magjistrati;

b) mendimin e kryetarit;

c) kundërshtimet e mundshme të magjistratit ndaj mendimit të kryetarit dhe procesverbalin e dëgjesës.

SEKSIONI III
ECURIA E PROCESIT TË VLERËSIMIT

Neni 89
Përgatitja e dokumentacionit

1. Këshilli miraton kriteret për caktimin e relatorit për çdo vlerësim, të zgjedhur në radhët e anëtarëve të Këshillit.

2. Këshillimbështetetngaadministrataetijnëpërgatitjenedokumentacionit të nevojshëm lidhur me periudhën e vlerësimit. Administrata e Këshillit përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve te relatori dhe kryen vetëm ato detyra që kërkohen për vlerësimin që kryhet nën drejtimin relatorit.

3. Magjistrati njoftohet me shkrim për relatorin dhe nëpunësin përgjegjës, të caktuar për vlerësimin e tij.

Neni 90
Krijimi i dosjes së vlerësimit

1. Brenda dy javëve nga marrja e akteve të vlerësimit, hapet dosja e vlerësimit, e cila përmban:

a) aktet e vlerësimit, të dërguara nga kryetari;

b) përmbledhje të të dhënave statistikore, në rastin e vlerësimit të gjyqtarëve, lidhur me:

i. numrin e çështjeve të gjykuara nga gjyqtari në cilësinë e relatorit, numrin e çështjeve të gjykuara në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, numrin e çështjeve për të cilat gjyqtari ka qenë përkohësisht i transferuar ose që ka ushtruar pozicionin në një gjykatë tjetër. Këto të dhëna kategorizohen sipas natyrës së çështjeve;

ii. kohën e gjykimit të çështjeve, duke e krahasuar me standardet

minimale kohore dhe numrin e çështjeve të gjykuara përtej afatit standard minimal, numrin e seancave gjyqësore për çdo çështje, rendimentin e gjyqtarit në përfundimin e çështjeve të gjyqtarit, si dhe kohën e arsyetimit të çdo vendimi;

iii. të dhënat e tjera statistikore të caktuara nga Këshilli.

c) përmbledhje të të dhënave statistikore në rastin e vlerësimit të prokurorëve, lidhur me:

i. numrin e çështjeve të mbyllura, të pezulluara ose të dërguara për gjykim, numrin e masave të sigurisë dhe urdhrat e ekzekutimit. Të dhëna të tilla duhet të kategorizohen sipas natyrës së çështjes;

ii. të dhëna lidhur me kohën për kryerjen e hetimeve paraprake dhe hetimin përfundimtar, duke e krahasuar me standardet minimale kohore dhe numrin e çështjeve të përfunduara përtej afatit standard minimal, numrin e rasteve të zgjatjes së afateve të hetimit, periudha e zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe respektimi i afateve të vendosura në vendimet gjyqësore;

iii. të dhëna të tjera statistikore të caktuara nga Këshilli;

ç) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit, për inspektimin e veprimtarisë së magjistratit ose të gjykatës apo të prokurorisë, si dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore të dhëna ndaj magjistratit, të cilat zbatohen gjatë periudhës së vlerësimit ose raporte të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;

d) numrin e çështjeve, në të cilat magjistrati është përjashtuar për shkak të konfliktit të interesit, me kërkesë të palëve;

dh) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim;

e) dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Shkolla e Magjistraturës.

2. Çdo akt i marrë gjatë procedurës së vlerësimit, sipas këtij ligji, përfshihet në dosje dhe listohet në një raport, i cili analizon në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar të dhënat.

3. Në çdo kohë, magjistrati ka të drejtën të ketë akses në dosjen e tij të vlerësimit dhe të marrë kopje të akteve apo ekstrakte të tyre.

Neni 91
Përzgjedhja e çështjeve për vlerësim
(*Ndryshuar pika 4 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Për vlerësimin etik dhe profesional të veprimtarisë së magjistratit përzgjidhen me short jo më shumë se 21 çështje të përfunduara nga magjistrati në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi. Për vlerësimin e përgjithshëm përzgjidhen 15 dosje, nga të cilat pesë dosje për çdo vit kalendarik të periudhës për të cilën bëhet vlerësimi, në rast të vlerësimit për një periudhë trevjeçare, dhe tri dosje për çdo vit kalendarik, në rast të vlerësimit për një periudhë pesëvjeçare. Pjesa tjetër e dosjeve përzgjidhet sipas kriterit të vonesës në afate, nga të cilat 5 për qind, por jo më shumë se gjashtë çështje nga numri i përgjithshëm, është vendosur përtej afateve standarde. Në rast se magjistrati mungon në detyrë për një periudhë më shumë se gjashtë muaj, numri i dosjeve të përzgjedhura do të ulet në mënyrë proporcionale me kohën.

2. Relatori përcakton dhomën dhe seksionin ku magjistrati ka ushtruar funksionin në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi dhe, në varësi të numrit të çështjeve për çdo kategori, përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen në mënyrë të barabartë për secilën kategori.

3. Në short përfshihen të gjitha çështjet, për të cilat magjistrati ka qenë relator i trupit gjykues ose prokuror, duke përfshirë edhe çështjet për të cilat magjistrati është transferuar përkohësisht në një gjykatë ose prokurori tjetër ose ka ushtruar detyrën në një pozicion tjetër. Në rastin e një prokurori, të paktën gjysma e çështjeve u referohet çështjeve që përfshijnë paraburgimin dhe një apelim.

4. Numri i çështjeve të përzgjedhura me short, të cilat janë përfunduar nga magjistrati me vendim jopërfundimtar, nuk duhet të kalojë 10 për qind të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përzgjedhura. Në rastin e prokurorit, çështjet e selektuara duhet të përfaqësojnë në mënyrë të barabartë vendimet në pushimin e çështjes dhe vendimet e lirimit pas arrestit me burg. Çështjet e përzgjedhura përtej këtij kufiri nuk vlerësohen, ndërkohë që shorti vazhdon për përzgjedhjen e çështjeve të kategorive të tjera.

5. Numri i çështjeve gjyqësore pa palë kundërshtare të gjykuara nga gjyqtari, të përzgjedhura me short, nuk duhet të kalojë 20 për qind të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përzgjedhura. Çështjet që përzgjidhen përtej këtij kufiri nuk vlerësohen, ndërkohë që shorti vazhdon për përzgjedhjen e çështjeve të kategorive të tjera.

6. Përzgjedhja e çështjeve me short realizohet pas fillimit të procedurës

së vlerësimit të magjistratit dhe konsiderohet pjesë e kësaj procedure, pavarësisht nga veprime të tjera.

7. Shorti zhvillohet me urdhër dhe nën mbikëqyrjen e një përfaqësuesi nga Këshilli, në përputhje me parashikimet e bëra në këtë nen. Shorti, i cili zhvillohet në gjykatën ose prokurorinë ku ushtron funksionet magjistrati, duhet të realizohet në mënyrë elektronike nga administrata gjyqësore.

8. Kryetari dhe kancelari marrin masat për t'i krijuar nëpunësit përgjegjës të gjitha kushtet e nevojshme për ushtrimin e detyrave.

Neni 92
Informacioni nga institucione të tjera

1. Relatori mbledh dhe përfshin në dosjen e vlerësimit informacionin lidhur me:

a) pjesëmarrjen në formimin vazhdues të magjistratit që i kërkohen Shkollës së Magjistraturës;

b) përfundimet e ankesave që i kërkohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

c) saktësinë dhe korrektësinë e deklarimit të pasurisë që i kërkohen Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit.

2. Shkolla e Magjistraturës, në cilësinë e institucionit përgjegjës për formimin vazhdues të magjistratit, dokumenton pjesëmarrjen e magjistratit në formimin vazhdues. Shkolla e Magjistraturës merr masat për të dërguar informacionin për pjesëmarrjen e magjistratit në formimin vazhdues, brenda dy javëve nga dita e depozitimit të kërkesës. Informacioni pasqyron numrin e trajnimeve në të cilat magjistrati është ftuar, temën dhe kohëzgjatjen e trajnimeve, nivelin e pjesëmarrjes së magjistratit dhe, nëse është e mundur, edhe nivelin e aktivizimit.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përcjell dokumentacionin për ankesat që janë regjistruar pranë këtij institucioni kundër magjistratit, gjatë periudhës në të cilën bëhet vlerësimi, duke evidentuar minimalisht informacionin lidhur me ankuesin, datën e ankesës, përmbledhje të shkurtër të veprimeve hetimore të ndërmarra dhe mënyrën e përfundimit të ankesës.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave përcjell një raport.

Neni 93
Projektraporti i vlerësimit

1. Relatori harton projektraportin e vlerësimit, brenda një muaji nga marrja e akteve të vlerësimit nga kryetari.

2. Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësitë e magjistratit. Analiza e të dhënave statistikore për rendimentin e përfundimit të çështjeve, kohëzgjatjen e gjykimeve dhe kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve ose në përfundimin e një çështjeje bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës.

3. Vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe mendimi i kryetarit verifikohen në raport me informacionin e marrë nga burime të tjera të vlerësimit.

4. Në çdo rast dhe në mënyrë të veçantë për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit, sipas neneve 72 dhe 73, të këtij ligji, duhet të shmanget gjithmonë ndërhyrja në pavarësinë e magjistratit.

5. Projektraporti i vlerësimit përmban:

a) të dhënat personale të magjistratit: arsimimi, vjetërsia, nivelet e mëparshme të vlerësimit, si dhe informacion të përgjithshëm për periudhën në të cilën bëhet vlerësimi, dhomën ose seksionin pranë së cilës ka ushtruar funksionin dhe për masat disiplinore që janë dhënë ndaj magjistratit në periudhën në të cilën bëhet vlerësimi;

b) të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit dhe analiza e tyre për vlerësimin e veprimtarisë së magjistratit, sipas kritereve të vlerësimit;

c) propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit;

ç) propozimin për trajnime ose rekomandime për hapat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar veprimtarinë e magjistratit.

6. Projektraporti i vlerësimit shoqërohet me raportin që përshkruan dhe analizon në mënyrë të detajuar të dhënat e mbledhura.

7. Projektraporti i vlerësimit është pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit.

Neni 94
E drejta e magjistratit për të kundërshtuar projektraportin e vlerësimit

1. Magjistrati njoftohet për projektraportin e vlerësimit, si dhe informohet për të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit.

2. Magjistrati ka të drejtë të kundërshtojë me shkrim projektraportin e vlerësimit brenda dy javëve nga data e marrjes së njoftimit. Magjistrati mund të paraqesë prova të reja, me përjashtim të vendimeve gjyqësore dhe akteve të hartuara prej prokurorit.

3. Magjistrati mund të kërkojë të dëgjohet gjatë seancës dëgjimore në Këshill. Përmbajtja e deklaratës me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.

Neni 95
Vendimi për vlerësimin
(Shfuqizuar pjesë nga pika 7 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar pika 5 dhe 7 me Ligjin nr. 48/2019)

1. Këshilli fton magjistratin që vlerësohet, si dhe persona të tjerë në seancë dëgjimore, nëse kjo kërkohet nga magjistrati ose nëse kjo është e nevojshme për të sqaruar faktet.

2. Këshilli urdhëron shtyrjen e seancës për jo më shumë se 30 ditë, nëse gjatë shqyrtimit të vlerësimit konstatohen gabime procedurale ose materiale ose nëse nevojiten prova të tjera që mund të ndikojnë në nivelin e vlerësimit dhe korrigjimi i këtyre gabimeve nuk mund të bëhet menjëherë, për shkak të nevojës për të marrë dokumente të tjera.

3. Këshilli, pasi shqyrton projektraportin e vlerësimit dhe duke u bazuar në përfundimet e seancës dëgjimore, vendos të miratojë ose të miratojë me ndryshime ose të kërkojë hartimin e një projektraportit të ri të vlerësimit nga anëtari relator.

4. Në rastet kur Këshilli vlerëson magjistratin me një nivel të ndryshëm ose bën një arsyetim të ndryshëm nga ai i propozuar në projektraportin e vlerësimit, atëherë pasqyron në vendim arsyet përkatëse. Raporti i vlerësimit që miratohet nga Këshilli është pjesë përbërëse e vendimit.

5. Në rast kur magjistrati vlerësohet "i pamjaftueshëm", magjistratit i ulet paga me dy për qind gjatë dy viteve kalendarike pas këtij vlerësimi.

6. Kur magjistrati ose kryetari vlerësohet "i pamjaftueshëm", Këshilli i dërgon raportin e vlerësimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

7. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e vlerësimit të Këshillit në gjykatën kompetente, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale.

8. Projektraporti i vlerësimit, çdo vendim i Këshillit dhe, sipas rastit, vendimet e mundshme gjyqësore duhet të përfshihen si pjesë e dosjeve individuale të magjistratit.

9. Këshilli publikon ekstrakte të raportit të vlerësimit dhe vendimit, të cilat pasqyrojnë të dhënat statistikore, analizën e të dhënave, nivelin e vlerësimit dhe arsyetimin për caktimin e këtij niveli. Ekstrakti publikohet duke respektuar të drejtën e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave. Në çdo rast, nga ekstrakti duhet të hiqet çdo informacion që mund të zbulojë identitetin e magjistratit.

Neni 96
Procedura e vlerësimit për kryetarët

1. Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarëve kryhet sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj.

2. Kryetari i paraqet Këshillit vlerësimin e kryer prej tij dhe çdo burim të përshtatshëm të vlerësimit të tij në Këshill, brenda tre javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas nenit 85 të këtij ligji.

3. Në procedurën e vlerësimit të veprimtarisë së kryetarit nuk zbatohen nenet 86, pika 2, 87, 88, pika 2, 90, pika 1, dhe 91 të këtij ligji.

Neni 97
Vlerësimi me kërkesë
(*Ndryshuar pika 6 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur.

2. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet për periudhën që përfshin vitin e fundit kalendarik. Këshilli miraton programin që përcakton magjistratët që vlerësohen, sipas kësaj procedure, para se të marrë vendimin për ngritjen në detyrë ose transferimin e magjistratit.

3. Në vlerësimin, sipas kësaj procedure, përzgjidhen me short gjashtë çështje të magjistratit për vlerësim të përgjithshëm, paraqiten dy vendime

gjyqësore ose akte të hartuara nga prokurori, si dhe vlerësohen jo më shumë se tre çështje, për të cilat magjistrati ka vendosur përtej afateve standarde.

4. Afati i përgatitjes së projektraportit të vlerësimit është dy muaj nga dita e dorëzimit të akteve të vlerësimit nga kryetari.

5. Këshilli vendos për vlerësimin e magjistratit në mbledhjen e radhës, pas njoftimit të magjistratit për projektraportin e vlerësimit.

6. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e Këshillit për vlerësim, në gjykatën kompetente, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale.

SEKSIONI IV
RAPORTIMI DHE TRANSPARENCA

Neni 98
Raporti i vlerësimit

1. Çdo vit kalendarik, Këshillat hartojnë raportin e vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të magjistratëve që kanë kryer në vitin paraardhës.

2. Raporti i vlerësimit publikohet në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

Neni 99
Raporti periodik për sistemin e vlerësimit

1. Çdo 3 vjet, Këshillat publikojnë një raport periodik për sistemin e vlerësimit, në të cilin pasqyrohet të paktën ky informacion:

a) përshkrim i përgjithshëm i vlerësimeve të kryera gjatë periudhës që mbulon ky raport;

b) analiza e përfundimeve të vlerësimit, duke identifikuar dobësitë dhe përparësitë e trupës së magjistratëve dhe të sistemit gjyqësor ose prokurorisë;

c) analiza e efikasitetit të rekomandimeve të miratuara në periudhën raportuese pararendëse;

ç) rekomandimet për masat që duhen marrë për të kapërcyer dobësitë e identifikuara.

2. Raporti periodik publikohet deri në fund të muajit mars të vitit që vjen pas periudhës që mbulohet nga ky raport.

PJESA V
PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, CIVILE DHE PENALE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 100
Parimet e procedimit disiplinor

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:

a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;

b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e "mosdënimit pa ligj";

c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;

ç) parimin e barazisë para ligjit;

d) prezumimin e pafajësisë;

dh) parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor;

e) parimin e proporcionalitetit;

ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit;

f) parimin e drejtësisë së hapur;

g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të

konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat duhet të marrin parasysh veçanërisht:

a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza;

b) rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

Neni 101
Shkeljet disiplinore
(*Shfuqizuar me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:

a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;

b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale.

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;

c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;

ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe

d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

Neni 102
Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit
(*Shfuqizuar me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:

a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla;

b) paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nëse ky veprim:

i. nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;

ii. bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synon shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magjistrat tjetër;

iii. nuk kryhet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun;

c) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një magjistrati tjetër;

ç) mospërmbushja e pajustifikuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;

d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustifikuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;

e) angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë magjistratit ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të magjistratit;

ë) vonesa e përsëritur dhe e pajustifikuar për fillimin e seancës gjyqësore ose zvarritje e hetimeve;

f) mungesa e pajustifikuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;

g) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë;

gj) moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;

h) mospërmbushja pa shkaqe të pajustifikuara e detyrimit për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me ligj;

i) mosnjoftimi nga magjistrati i kryetarit dhe Këshillit, si dhe autoriteteve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet ose format e tjera të ndikimit nga magjistratët e tjerë, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektet e tjera;

j) shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit të magjistratit ose që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar;

k) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij, sipas ligjit;

l) mospërmbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve;

ll) bërja publike e mendimeve që janë dhënë nga vetë magjistrati ose magjistratët e tjerë gjatë procesit që nuk kanë marrë ende formën e një akti të disponueshëm për publikun;

m) bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve për shtyp të magjistratit brenda kufijve të detyrës së tij;

n) mosnjoftimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit;

nj) mosnjoftimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit;

o) mosnjoftimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimeve të funksionit, dhe për çështje, për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magjistratit;

p) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Sipas parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, si më poshtë:

a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë;

b) parashtrimi i shtrembëruar i fakteve dhe rrethanave në mënyrë të dukshme në aktet e nxjerra;

c) nxjerrja e akteve të paarsyetuara ose që përmbajnë, në pjesën arsyetuese, vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar;

ç) nxjerrja e akteve, ku pjesa përshkruese - arsyetuese parashtron rrethana që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese ose që nuk kanë lidhje me të;

d) marrja e vendimeve qëllimisht të paarsyetuara, si rezultat i një interesi personal ose keqdashjes;

dh) shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore.

Neni 103
Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit
(*Shfuqizuar me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019)*

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:

a) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji;

b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;

c) ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit;

ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magjistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;

d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magjistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;

dh) raste të tjera të sjelljes që diskreditonpozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

Neni 104
Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale
(Shfuqizuar me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019)

1. Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale dhe që, sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuara nga gjykata.

2. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprime, mosveprime ose sjelljet, sipas pikës 1, të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose magjistrati është rehabilituar, ose ka përfituar nga falja apo amnistia.

3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për aq sa është e nevojshme.

Neni 105
Masat disiplinore

1. Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore:

a) vërejtje konfidenciale;

b) vërejtje publike;

c) ulje e përkohshme e pagës:

i. deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit;

ii. në rastin e magjistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës.

ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër;

d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;

dh) shkarkim nga detyra.

2. Në caktimin e masës disiplinore, Këshilli mund të vlerësojë çdo lloj pezullimi të mëparshëm sipas kreut V të kësaj pjese, që është vendosur gjatë procedurës përkatëse disiplinore, dhe mund të vendosë në mënyrë të përshtatshme një masë disiplinore më të lehtë ose që pezullimi është masa e përshtatshme dhe e mjaftueshme për shkeljen e kryer.

Neni 106
Vërejtje konfidenciale

1. Vërejtja konfidenciale është masë disiplinore jopublike, e njohur vetëm për magjistratin ndaj të cilit i jepet, e cila vërteton kryerjen e sjelljes së papërshtatshme të magjistratit.

2. Vërejtja konfidenciale përfshihet në dosjen personale të magjistratit dhe mbahet parasysh në rastin e kryerjes së shkeljeve të ngjashme disiplinore ose për vlerësimin etik dhe profesional.

3. Vërejtja konfidenciale jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes.

Neni 107
Vërejtje publike

1. Vërejtja publike është një formë e masave disiplinore publike që

deklaron publikisht kryerjen e sjelljes së papërshtatshme të magjistratit.

2. Vërejtja publike përfshihet në dosjen personale të magjistratit.

3. Vërejtja publike jepet për shkelje të lehta, të cilat janë bërë publike.

Neni 108
Ulja e përkohshme e pagës

Këshilli, kur vendos të ulë përkohësisht pagën e magjistratit deri në 40 për qind, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 115, të këtij ligji, për një periudhë jo më të gjatë se një vit, ose gjobën që i është caktuar, në masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës, vlerëson rëndësinë e çështjes dhe të gjitha rrethanat e saj. Ulja e përkohshme e pagës jepet në këto raste:

a) kur magjistratit i është dhënë vërejtje konfidenciale ose vërejtje publike për shkelje disiplinore të mëparshme;

b) kur masat më të lehta disiplinore janë të papërshtatshme për rrethanat e shkeljes disiplinore;

c) kur rrethanat e shkeljes nuk përbëjnë shkelje disiplinore shumë të rëndë dhe nuk është e përshtatshme një masë disiplinore më e rëndë.

Neni 109
Ulja në detyrë

1. Ulja në detyrë e magjistratit nga një gjykatë më e lartë në një gjykatë më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër, jepet në këto raste:

a) kur shkelja është e rëndë;

b) kur magjistrati shfaq sjellje që evidentojnë se aftësitë e tij nuk janë të përshtatshme për gjykatën më të lartë ose gjykatën e specializuar, ndërkohë që shkelja nuk e bën magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat.

2. Në rast uljeje në detyrë, sipas pikës 1, të këtij neni, magjistrati merr pagën e pozicionit të ulur në detyrë.

Neni 110
Pezullimi si masë disiplinore

Masa e pezullimit nga detyra e magjistratit, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, jepet vetëm në këto raste:

a) kur shkelja është e shumë e rëndë;

b) kur Këshilli çmon se, pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar.

Neni 111
Shkarkimi

1. Shkarkimi i magjistratit nga detyra jepet si masë disiplinore vetëm në këto raste:

a) kur shkelja është shumë e rëndë;

b) kur Këshilli çmon se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin e tij, për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi, për shkak të paaftësisë së rëndë dhe të dukshme, ose për shkak të një sjelljeje që kryhet të paktën me pakujdesi të rëndë, sipas nenit 101, shkronja "b", të këtij ligji, dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë.

2. Në rastin kur magjistrati i gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose i Prokurorisë së Posaçme përhap informacion sensitiv, si nga pakujdesia e rëndë, sipas nenit 101, shkronja "b", të këtij ligji, ose me dashje, ose kur kryen shkelje tjetër të rëndë, atij i jepet masa disiplinore e shkarkimit.

Neni 112
Masat disiplinore plotësuese
(*Shfuqizuar pika 1 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK)*

1. Këshilli, së bashku me masat të parashikuara në pikën 1, shkronjat "b", "c", nënndarja "i", "ç", "d", të nenit 105, të këtij ligji, mund të vendosë edhe një nga masat disiplinore plotësuese të mëposhtme:

a) ndjekjen e detyrueshme të trajnimeve profesionale të specifikuara,

sipas parashikimit në nenin 113 të këtij ligji;

b) largimin nga detyra e kryetarit.

Neni 113
Masa plotësuese për trajnim

Në mbështetje të nenit 112, pika 2, shkronja "a", të këtij ligji, Këshilli mund të vendosë masën disiplinore plotësuese të ndjekjes së detyrueshme të trajnimeve profesionale të specifikuara, nëse shkelja e kryer mund të korrigjohet nëpërmjet pjesëmarrjes në programet e detyrueshme të trajnimit. Në këtë rast, në vendim përcaktohet përmbajtja dhe kohëzgjatja e programit të detyrueshëm të trajnimit.

Neni 114
Largimi nga detyra e kryetarit

Këshilli mund të vendosë masën disiplinore plotësuese të largimit të magjistratit nga detyra e kryetarit dhe caktimin e tij si magjistrat, në rastet e shkeljeve të kryetarit, të cilat nuk justifikojnë vazhdimësinë e tij në funksione drejtuese, sipas parashikimeve të nenit 112, pika 2, shkronja "a", të këtij ligji.

Neni 115
Kriteret për caktimin e masës disiplinore

1. Në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, Këshilli merr parasysh këto kritere:

a) llojin dhe rrethanat e shkeljes;

b) shkallën e fajësisë dhe motivin;

c) pasojat e shkeljes;

ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit;

d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore;

dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen;

e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit;

ë) sjelljen e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit;

f) sjelljen e magjistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që

mban ndaj tij;

g) çdo çështje tjetër që Këshilli e konsideron të rëndësishme.

2. Këshilli, kur vendos masën disiplinore:

a) duhet të arsyetojë parimin e proporcionalitetit;

b) duhet të marrë parasysh çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese.

3. Rrethanat lehtësuese, sipas pikës 2, të këtij neni, janë:

a) kur magjistrati e kryen shkeljen për herë të parë;

b) kur magjistrati ka vepruar nën ndikimin e një pale të tretë, për shkak të besimit ose frikës;

c) duke marrë parasysh në tërësi rrethanat e çështjes, shkelja e magjistratit ka pasur ndikim të vogël;

ç) kur magjistrati bashkëpunon në hetimin dhe procedimin disiplinor, duke përfshirë dhe rastet kur pranon shkeljen e kryer ose jep informacione që ndihmojnë në hetimin dhe procedimin disiplinor;

d) kur magjistrati ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga shkelja ose ka ndihmuar në mënyrë aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e saj;

dh) koha që ka kaluar që nga kryerja e shkeljes;

e) kur ekziston çdo rrethanë tjetër, për të cilën Këshilli çmon se lehtëson shkeljen e kryer.

4. Rrethanat rënduese, sipas pikës 2, të këtij neni, janë:

a) kur shkelja kryhet më shumë se një herë, ose kur shkelja është kryer pas dhënies së një mase disiplinore për një shkelje të mëparshme;

b) kur shkelja është e vazhdueshme;

c) kur shkelja kryhet për shkak të motiveve diskriminuese;

ç) kur shkelja kryhet për motive të tjera të dobëta;

d) kur nxiten të tjerët për kryer shkelje ose veprime të paligjshme;

dh) kur shkelja kryhet duke shfrytëzuar dobësitë ose pozitën e cenueshme të të tjerëve;

e) kur ekziston çdo rrethanë tjetër, për të cilën Këshilli çmon se rëndon shkeljen e kryer.

Neni 116
Masat për shmangien e vonesave

1. Për magjistratin ose përfaqësuesin e tij, në rastet e deklarimit në mungesë, si dhe të procedimit disiplinor në mungesë të magjistratit, do të zbatohen rregullat procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale për aq sa këto rregulla gjejnë zbatim.

2. Në rastin kur magjistrati ose përfaqësuesi i tij, dëshmitari, eksperti ose përkthyesi cenojnë dinjitetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose të Këshillit, ose kryejnë ndonjë veprim, që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën, autoriteti kompetent paralajmëron magjistratin dhe e udhëzon mbi pasojat e kësaj sjelljeje. Në rast se sjellja vazhdon, autoriteti kompetent e dënon me gjobë deri në 100 000 lekë subjektin shkelës. Përsëritja e sjelljes përbën shkak për dhënien sërish të dënimit me gjobë dhe, nëse vlerësohet e përshtatshme, për fillimin e hetimit disiplinor ose penal.

3. Vendimi për dënimin me gjobë përbën titull ekzekutiv. Shërbimi përmbarimor ngarkohet me ekzekutimin e vendimit përkatës.

4. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim brenda 24 orëve nga marrja dijeni e tij. Ankimi shqyrtohet nga Këshilli, në rast se gjoba vendoset nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe nga gjykata kompetente, në rast se gjoba vendoset nga Këshilli.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ose Këshilli i njoftojnë vendimin për dënimin me gjobë Dhomës Kombëtare të Avokatisë ose institucioneve përgjegjëse për ekspertët ose përkthyesit.

KREU II
PROCEDURAT HETIMORE

Neni 117
Afatet e parashkrimit

1. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse një ankesë, sipas nenit 119, të këtij ligji, paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas nenit 124, të këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit.

2. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer.

3. Nëse magjistrati kryen shkelje tjetër të së njëjtës natyrë brenda afatit të parashkrimit, afati zgjatet deri në një vit.

4. Pavarësisht parashikimeve të pikave 1 dhe 3, të këtij neni, për shkeljet disiplinore që përbëjnë njëkohësisht vepra penale, afatet e parashkrimit përllogariten sipas parashikimeve të Kodit Penal, vetëm nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet.

Neni 118
Afatet e procedimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, brenda tre muajve nga marrja e ankesës.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të zgjasë afatin e hetimit, të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, për tre muaj të tjerë në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundjeje apo pamundësisë së magjistratit.

4. Në rastet kur, pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3, të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, Inspektori i Lartë i Drejtësisë riçel hetimin, me kushtin që nuk janë parashkruar afatet, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 4, të nenit 117, të këtij ligji.

5. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikat 1 deri në 4, të këtij neni, magjistrati ka të drejtën të ankimojë mosveprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës.

Neni 119
Ankesat

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik.

2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që një magjistrat ka kryer shkelje disiplinore, ankesa paraqitet tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë nga subjektet e mëposhtme:

a) Ministri i Drejtësisë;

b) një anëtar i vetëm i Këshillit;

c) kryetari i gjykatës ose i prokurorisë.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të shqyrtojë ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton ankuesin vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin dhe mbylljen e hetimit.

5. Ankesa paraqitet personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks.

6. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar.

7. Ankesa mund të përmbajë prova dhe burime të dhënash për faktet dhe rrethanat e pretenduara.

8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë publikon modelin e formularit të ankesës në faqen e tij zyrtare, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së ankesave.

Neni 120
Kriteret për pranueshmërinë e ankesës

1. Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme:

a) paraqitet në formën e përcaktuar, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni;

b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;

c) nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues.

ç) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;

d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore

nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;

dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

2. Ankesa paraqitet në formë të shkruar dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

a) gjenealitetet dhe adresën e ankuesit, si dhe nëse ankuesi kërkon konfidencialitetin e identitetit të tij;

b) përshkrim të rrethanave të faktit që pretendohen të kenë ndodhur;

c) emrin dhe mbiemrin e magjistratit, gjykatën ose prokurorinë, në të cilën magjistrati ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Neni 121
Shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme.

2. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos:

a) të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë kritere të parashikuara në pikën 1, të nenit 120, të këtij ligji;

b) të verifikojë ankesën;

c) të fillojë hetimin.

3. Në rastin kur vendoset të arkivohet ankesa, vendimi për arkivimin i njoftohet ankuesit dhe magjistratit brenda afatit të parashikuar në pikën

4, të nenit 119, të këtij ligji. Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

Neni 122
Verifikimi i ankesës

1. Për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t'i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë ose të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

4. Në rast se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet.

5. Vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Neni 123
Vendimi i fillimit të hetimit me nismë të ankuesit

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për fillimin e hetimit, pavarësisht zhvillimit të një procesi gjyqësor apo administrativ në lidhje me të njëjtat fakte.

3. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit i njoftohet ankuesit, magjistratit dhe Këshillit. Vendimi duhet të përmbajë të paktën:

a) emrin e inspektorëve të ngarkuar me hetimin;

b) objektin e hetimit, duke treguar shkeljen e dyshuar;

c) parashtrimin e rrethanave të faktit të pretenduara;

ç) provat e mbledhura;

d) periudhën kohore përkatëse për hetimin;

dh) parashtrimin e të drejtave të magjistratit në lidhje me hetimin disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të dorëzuar parashtresë dhe dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga marrja e vendimit.

4. Në rastet kur shkelja ka të bëjë me sjellje ose veprime të përsëritura, objekti i hetimit, sipas pikës 3, shkronja "b", të këtij neni, përmban sjelljet e magjistratit në rastet e tjera, në lidhje me të njëjtën situatë brenda periudhës kohore të përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit, në mënyrë që të verifikohet nëse janë vërejtur sjellje të tilla apo të përsëritura.

Neni 124
Fillimi i hetimeve me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat "b", "ç", "d" dhe "dh".

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos me vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit me iniciativën e tij, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, zbatohen edhe në rastin e fillimit të hetimit me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 124/1
Verifikimi i pasurisë dhe figurës
(Shtuar me Ligjin nr. 15/2020)

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda një jave nga vendimi për fillimin e hetimeve, sipas nenit 123 dhe 124, të këtij ligji, kërkon informacion nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, Policia e Shtetit, organet e administratës tatimore dhe doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të magjistratit, si dhe çdo institucion tjetër kompetent për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkelje tjetër disiplinore.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë informacion shtesë nga institucionet e përmendura pikën 1, të këtij neni, si dhe nga çdo institucion tjetër publik apo subjekt privat.

3. Çdo institucion publik apo subjekt privat duhet të përmbushë kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në rast se nga verifikimi i pasurisë dhe figurës rezulton se ka dyshime të arsyeshme për kryerjen e ndonjë

shkeljeje tjetër disiplinore, përveç rastit kur shkelja përbën vepër penale, merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të nenit 125 të këtij ligji.

Neni 125
Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit

1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit, në zbatim të nenit 124 të këtij ligji.

2. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

Neni 126
Pezullimi i hetimeve
(*Ndryshuar pika 5 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:

a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati;

b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi.

2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.

3. Ankuesi, magjistrati, gjykata, prokuroria dhe Këshilli njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera i dërgojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit nuk pengon hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magjistratit.

5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117, i këtij ligji, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

Neni 127
Kërkesa për pezullimin e magjistratit

Në çdo fazë të procedurës së hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon Këshillin lidhur me faktet që sjellin pezullim të detyrueshëm të magjistratit, sipas parashikimeve në nenin 151, të këtij ligji, ose mund të kërkojë vetë pezullimin e magjistratit për arsyet e parashikuara në nenin 152 të këtij ligji.

Neni 128
Bashkimi i procedimeve hetimore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat.

Neni 129
Të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve gjatë hetimit

1. Magjistrati është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit, sipas nenit 123 ose 124, të këtij ligji, dhe i garantohet aksesi në dosjen e hetimit në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë nga magjistrati informacion, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton magjistratit të interesuar ose përfaqësuesit të tij, vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

Neni 130
Ecuria e hetimeve
(Ndryshuar pika 2 me Ligjin nr. 15/2020)

1. Objekti i hetimit tregon qartë elementet e shkeljes së pretenduar, sipas përcaktimeve në vendimin për fillimin e hetimit, sipas parashikimeve të nenit 123 të këtij ligji.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione publike apo subjekte private, dëshmitarë dhe/ose magjistrati, dhe ndërmerr veprime të nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.

3. Kur shkelja e pretenduar lidhet me çështje në proces në gjykatë ose në prokurori, hetimi duhet të jetë i tillë që të mos cenojë pavarësinë e magjistratit në gjykimin dhe hetimin e tyre dhe të mos konsiderohet si ndërhyrje. Në një rast të tillë Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

a) pezullon hetimet, sipas rasteve të parashikuara në nenin 126 të këtij ligji;

b) vazhdon me hetimin nëse shkelja e pretenduar ka të bëjë me fakte që nuk lidhen me ato për të cilat do të vendoset nga hetimi penal ose procesi penal, civil ose administrativ.

Neni 131
Kërkesat për marrjen në pyetje

1. Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se marrja në pyetje e magjistratit, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka për detyrë të sigurojë që seanca e marrjes në pyetje të regjistrohet në audio, sipas procedurës së mëposhtme:

a) personi që merret në pyetje duhet të informohet se seanca përkatëse do të regjistrohet në audio;

b) regjistrimi duhet të përmbajë gjenealitetet e personave që janë thirrur për t'u pyetur;

c) në rast ndërprerjeje të seancës së marrjes në pyetje, përpara se regjistrimi audio të përfundojë, regjistrohet ora, shkaku i ndërprerjes, si dhe ora e rifillimit të seancës;

ç) në përfundim të seancës, personi i marrë në pyejtje mund të saktësojë çdo gjë që ka deklaruar, si dhe të shtojë gjithçka që vlerëson. Më kërkesën e personit të marrë në pyetje, regjistrimi dëgjohet, si dhe regjistrohen korrigjimet dhe shpjegimet e tij në lidhje me deklarimet e mëparshme. Në mbarim të seancës së marrjes në pyetje regjistrohet ora e përfundimit të saj.

3. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje duhet të përmblidhet në procesverbal, si dhe mund të transkriptohet. Magjistrati nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio nëse është bërë i mundur.

4. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është bërë i mundur, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.

Neni 132
Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik duhet të zbatojë kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afateve kohore të arsyeshme, të përcaktuara nga inspektori në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj.

2. Nëse gjatë hetimit disiplinor të magjistratit ekzistojnë nevoja thelbësore dhe specifike për të marrë dokumente, informacione, regjistrime telefonike ose prova të tjera, të cilat mbrohen nga garancitë për konfidencialitet ose mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t'i kërkojë Gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, lëshimin e një urdhri për dhënien e informacionit të kërkuar për magjistratin.

3. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se magjistrati ka kryer shkeljen, si dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përsërit kërkesën, në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë gjobë deri në 100 000 lekë, si dhe njofton organin përgjegjës disiplinor.

5. Urdhri për vendosjen e gjobës është titull ekzekutiv. Shërbimi përmbarimor ngarkohet me ekzekutimin e vendimit përkatës.

6. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në Këshillin përkatës brenda 24 orëve nga marrja dijeni e tij.

Neni 133
Dokumentacioni i hetimit

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.

2. Procesverbali duhet të përmbajë:

a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit që kryen veprimin;

b) datën e kryerjes së veprimit;

c) subjektin dhe objektin e veprimit;

ç) pjesëmarrësit;

d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;

dh) nënshkrimin e inspektorit në fund të çdo faqeje, si dhe të personave që marrin pjesë në këto veprime;

3. Me përfundimin e hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:

a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit kompetent;

b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;

c) veprimet e kryera gjatë hetimit;

ç) përmbledhjen e deklaratave të magjistratit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve;

d) parashtrimin e fakteve të pranuara dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;

dh) analizën ligjore të fakteve të pranuara që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur;

e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.

Neni 134
Mbyllja e hetimit

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;

b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur

ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;

c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;

ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat "b" deri në "ç", të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji;

d) magjistrati ka vdekur.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet t'i njoftojë vendimin magjistratit të interesuar ose përfaqësuesit të tij ankuesit dhe Këshillit përkatës. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për mbylljen e hetimit, sipas pikës 1 të këtij neni. Vendimi tregon të drejtën e ankuesit për të ankimuar këtë vendim në Këshillin përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

3. Në rastet kur magjistrati ka dalë në pension, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin përfundimtar, i cili përmban përmbledhje të pretendimeve për shkeljen disiplinore, provat e mbledhura dhe konkluzionet. Raporti mbyll procesin hetimor, si dhe iu bëhet me dije palëve dhe Këshillit përkatës.

4. Faktet e zbuluara gjatë hetimit, të cilat nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor, por që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin etik dhe profesional, duhet t'i paraqiten Këshillit për shqyrtim të mëtejshëm.

Neni 135
Marrëveshje e përbashkët e pranimit

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit.

2. Palët mund të bien dakord për llojin e shkeljes disiplinore që magjistrati pranon, si dhe masën disiplinore të përshtatshme.

3. Palët hartojnë me shkrim dhe nënshkruajnë marrëveshjen, e cila dorëzohet në Këshillin përkatës.

4. Marrëveshja duhet të përmbajë:

a) përmbledhje të fakteve dhe shkeljes që pranon magjistrati;

b) masën disiplinore që palët kanë rënë dakord;

c) një deklaratë se magjistrati është i vetëdijshëm se marrëveshja duhet të miratohet nga Këshilli.

5. Këshilli përkatës pranon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse:

a) marrëveshja është nënshkruar nga të gjitha palët dhe përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;

b) nëse rezulton se magjistrati e ka kuptuar marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj, si dhe nëse ai ka dhënë pëlqimin me shkrim me vullnetin e tij të lirë;

c) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, të jenë në përputhje me këtë ligj.

6. Këshilli përkatës refuzon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse:

a) marrëveshja nuk nënshkruhet nga të gjitha palët ose nuk përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;

b) magjistrati i thirrur rregullisht nuk merr pjesë në seancë dhe nuk paraqet shkaqe të arsyeshme për mungesën e tij;

c) provat e mbledhura janë në kundërshtim haptazi me deklarimin e magjistratit për pranimin e kryerjes së shkeljes disiplinore;

ç) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, nuk janë në përputhje me këtë ligj;

d) magjistrati është detyruar të pranojë marrëveshjen;

dh) magjistrati tërheq pëlqimin për marrëveshjen.

7. Nëse Këshilli e pranon marrëveshjen, ajo do të konsiderohet si një vendim i formës së prerë i procedimit disiplinor, e cila nuk ankimohet.

8. Nëse Këshilli refuzon marrëveshjen, atëherë çdo pohim i bërë nga palët që lidhet me shkeljen disiplinore, në kuadër të hartimit të marrëveshjes, si dhe para Këshillit gjatë seancës për pranimin ose jo të marrëveshjes, nuk mund të përdoret në favor ose kundër këtyre palëve.

9. Nëse marrëveshja refuzohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të fillojë ose vazhdojë veprimet hetimore disiplinore ndaj magjistratit, brenda një muaji nga dita e refuzimit të kësaj marrëveshje.

10. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikën 9, të këtij neni, magjistrati ka të drejtë të ankimojë mosveprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës.

Neni 136
Dërgimi i çështjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Nëse gjatë procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë:

a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit;

b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.

2. Këshilli mund të dërgojë çështjen te Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në rastet e parashikuara në nenin 144 të këtij ligji.

Neni 137
Sistemi i menaxhimit të çështjeve

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon dhe administron një sistem të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore.

2. Sistemi duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) gjenealitetet dhe adresën e magjistratit nën hetim;

b) emrin dhe adresën e ankuesit, nëse është e mundur;

c) objektin e hetimit;

ç) të dhënat përkatëse mbi zhvillimin e hetimit;

d) informacion për arkivimin e ankesës, mbi mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor;

dh) informacion për vendimin e formës së prerë për masën disiplinore;

e) informacione të tjera, sipas rastit.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton dispozita të hollësishme për:

a) formatin dhe të dhënat që administrohen në regjistër;

b) informacionin shtesë që përfshihet në sistem;

c) mënyrën e mbajtjes së sistemit;

ç) informacionin e sistemit që është i hapur për publikun, si dhe informacion që është i aksesueshëm vetëm nga magjistrati nën hetim.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbledh dhe përpunon të dhënat në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

KREU III
FILLIMI I PROCEDIMIT DISIPLINOR

Neni 138
Fillimi i procedurës disiplinore
(Ndryshuar pika 1 me Ligjin nr. 15/2020)

1. Përveç parashikimeve të nenit 152, të këtij ligji, nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

2. Këshilli:

a) përcakton datën për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

b) njofton palët për datën e seancës dëgjimore të paktën 15 ditë para saj.

3. Këshilli mund të zgjasë afatin e parashikuar në pikën 2, shkronja "a", të këtij neni, deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat duhet të bëhen publike.

4. Këshilli:

a) shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen;

b) merr prova shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;

c) kur e konsideron të përshtatshme, thërret ekspertë ose i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të thërrasë ekspertë.

5. Këshilli mund t'i kërkojë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kryerjen e hetimeve të mëtejshme, duke specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen veprimet hetimore sipas kërkesës së Këshillit.

Neni 139
Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore

1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse:

a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të këtij ligji;

b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë;

c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat "ç" dhe "d";

ç) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar.

2. Dorëheqja e magjistratit nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor.

3. Këshilli mbyll procedimin disiplinor, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim. Ai njofton palët për shkaqet e mbylljes.

Neni 140
Bashkimi i procedimeve disiplinore

1. Kur Këshilli konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit magjistrat, mund të vendosë bashkimin e procedimeve.

2. Në raste kur një gjyqtar ose një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje, Këshillat vendosin bashkimin e procedimeve. Këshillat miratojnë rregulla të përbashkëta për bashkimin e procedimeve.

Neni 141
Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor
(*Shfuqizuar pjesë nga pika 1 dhe shkronjat (a), (b) dhe (c) pika 1 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar pika 1, shtuar pika 1/1 me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Gjatë procedurës disiplinore, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre. Brenda

pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës, Këshilli i siguron magjistratit kushtet për njohjen me dosjen dhe i vë në dispozicion kopje të dokumenteve.

1/1. E drejta e aksesit me dosjen mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm ndaj interesave të mëposhtëm:

a) të drejtave themelore të një personi tjetër; ose

b) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar; ose

c) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;

ç) barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së procesit gjyqësor.

E drejta e aksesit kufizohet për aq kohë sa ekzistojnë shkaqet e mësipërme. Në çdo rast, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka akses në dosje para se Këshilli të marrë vendimin.

2. Kur magjistrati njoftohet se ndaj tij ka filluar procedim disiplinor, duhet që t'i bëhen të ditura të drejtat:

a) për të paraqitur një parashtresë me shkrim në afatin e caktuar;

b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;

c) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;

ç) për të paraqitur dokumente;

d) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;

dh) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative;

e) për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore të tij/saj në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.

3. Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit të paraqesë të dhëna, dokumente ose çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

4. Palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të Këshillit brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 142
Seanca disiplinore

1. Seanca dëgjimore për procedimet disiplinore është publike.

2. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:

a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;

b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër;

c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.

3. Në seancë dëgjimore para Këshillit:

a) Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren;

b) magjistrati ose përfaqësuesi i tij paraqesin argumentet mbrojtëse.

4. Përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.

Neni 143
Shtyrja e seancës dëgjimore

Këshilli mund të shtyjë seancën kur e konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë, por jo më shumë se një muaj.

Neni 144
Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor

1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë:

a) të urdhërojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmujor;

b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk

është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të këtij ligji.

Neni 145
Pezullimi i procedimit disiplinor

Parashikimet ligjore gjatë procedimit disiplinor të nenit 126, të këtij ligji, do të aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

Neni 146
Vendimet e këshillit për çështjet e disiplinës

1. Këshilli merr çdo vendim në lidhje me:

a) angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre;

b) shtyrjet e seancave;

c) pranueshmërinë e provave;

ç) zgjidhjen e çështjes;

d) çdo çështje tjetër që Këshilli e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.

2. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli:

a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;

b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.

3. Këshilli nuk është i detyruar t'i qëndrojë masës disiplinore të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.

Neni 147
E drejta e ankimit për vendimet disiplinore

1. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka të drejtë të ankimojë çdo vendim të Këshillit për çështjet disiplinore në gjykatën kompetente.

KREU IV
EKZEKUTIMI DHE REGJISTRI I MASAVE DISIPLINORE

Neni 148
Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë

1. Këshillat marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e masave disiplinore dhe janë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të të gjitha masave që vendosen në procedimin disiplinor.

2. Këshillat sigurojnë zbatimin e masave disiplinore:

a) brenda një muaji në rastin e vërejtjes konfidenciale, vërejtjes publike ose uljes së përkohshme të pagës;

b) brenda dy javëve në rastin e uljes në detyrë;

c) brenda një jave në rastin e pezullimit ose shkarkimit nga detyra.

Neni 149
Publikimi i vendimeve disiplinore

1. Këshilli publikon brenda 2 javëve çdo vendim të formës së prerë për shkarkimin e magjistratëve në faqen zyrtare.

2. Këshilli publikon ekstrakte të çdo vendimi përfundimtar për çështje disiplinore, duke përcaktuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre, si dhe llojin e shkeljes disiplinore të kryer sipas këtyre fakteve. Botimi i ekstrakteve duhet të mbrojë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast në ekstrakt nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e magjistratit.

Neni 150
Regjistri disiplinor

1. Këshilli mban një regjistër për çështjet disiplinore të filluara ndaj magjistratëve, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime.

2. Këshilli mban të dhëna për të gjitha masat disiplinore në fuqi, përveç "vërejtjes konfidenciale". Masat e tjera disiplinore shuhen dhe fshihen nga regjistri pas kalimit të afateve të mëposhtme nga data e hyrjes në fuqi të masës disiplinore:

a) dy vjet për "vërejtjen publike" dhe trajnimin si masë disiplinore plotësuese;

b) tre vjet për uljen e përkohshme të pagës, për rastet kur paga ulet deri në shumën e pagës mujore;

c) katër vjet për uljet e përkohshme të pagës më të larta se shuma e pagës mujore dhe uljen në detyrë;

ç) pesë vite për pezullimin si masë disiplinore.

3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri.

KREU V
PEZULLIMI

Neni 151
Pezullimi i detyruar

1. Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

2. Pezullimi, sipas pikës 1, të këtij neni, zgjat:

a) gjatë periudhës së arrestit në burg ose arrestit në shtëpi, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni;

b) deri në pushimin e çështjes penale ose në dhënien e një vendimi të formës së prerë, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja "b", të këtij neni.

3. Kryetarët e gjykatave dhe të prokurorive, të cilët marrin vendimet përkatëse, detyrohen të njoftojnë Këshillin për faktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli, menjëherë pasi merr informacionet nga prokuroria ose gjykata, vendos pezullimin për shkak të ligjit të magjistratit.

Neni 152
Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor
(*Shfuqizuar me Vendimin nr. 34/2017 të GjK; Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019; Ndryshuar me Ligjin nr. 15/2020)*

1. Kur ka dyshim të arsyeshëm se vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton

rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen menjëherë një hetim paraprak për të verifikuar besueshmërinë e burimit të informacionit, sipas nenit 124, të këtij ligji, ose ankesës së paraqitur nga subjektet e përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji. Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon bindjen se burimi i informacionit ose ankesa është e besueshme, brenda 3 ditëve nga marrja e ankesës ose nga momenti që ka marrë dijeni për shkeljen e pretenduar, i paraqet Këshillit përkatës raport të arsyetuar, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura deri në atë moment për fillimin e një procedimi disiplinor dhe kërkesën për pezullimin e magjistratit nga detyra.

2. Këshilli, për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ose në nenin 138, të këtij ligji, pezullon magjistratin nga detyra, kur vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. Këshilli mund të kërkojë, informacion mbi shkeljen e pretenduar pranë çdo institucioni publik ose subjekti privat. Në rastin e procedimit disiplinor, sipas pikës 1, të këtij neni, Këshilli vendos menjëherë, por jo më vonë se tre ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, duke i dhënë mundësinë magjistratit për të parashtruar argumentet e tij në mbledhjen e Këshillit.

3. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin, sipas nenit 156 të këtij ligji.

4. Pavarësisht parashikimeve të nenit 138, pika 5, të këtij ligji, Këshilli, kur çmon se ka nevojë për hetime të mëtejshme për shkeljen disiplinore, i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë këto hetime, pa qenë nevoja për të specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen me përparësi hetime të mëtejshme për këto shkelje dhe i paraqet Këshillit raportin dhe dosjen e hetimit.

Neni 153
Fillimi i procedimit të pezullimit
(*Shfuqizuar shkronjat (c) dhe (ç) me Ligjin nr. 48/2019)*

Pezullimi nga detyra i magjistratit, në kuptimin e nenit 152, mund të vendoset nga një Këshill:

a) me nismën e vet;

b) me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

Neni 154
Njoftimet për Këshillin

1. Kryetari përkatës informon Këshillin menjëherë me marrjen dijeni të fakteve të renditura në nenet 151 dhe 152 të këtij ligji.

2. Autoritetet përgjegjëse njoftojnë menjëherë Këshillin kur:

a) magjistrati është në arrest në burg ose arrest shtëpie;

b) fillohen hetimet penale ndaj magjistratit;

c) magjistrati merr cilësinë e të pandehurit për një vepër penale;

ç) fillohen hetimet disiplinore.

Neni 155
Vendimet e pezullimit dhe ankimet

1. Vendimi për pezullimin nga detyra, sipas parashikimit të neneve 151 dhe 152, të këtij ligji, merret nga Këshilli brenda tre ditëve pas paraqitjes së kërkesës ose informacionit.

2. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në gjykatën kompetente.

3. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vendimin për pezullimin nga detyra të magjistratit.

Neni 156
Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit
(*Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Pezullimi i magjistratit, i parashikuar në nenet 151 dhe 152, të këtij ligji, vendoset për një periudhë të caktuar kohe dhe nuk mund të vazhdojë nëse arsyet e pezullimit, të parashikuara në këto nene, pushojnë së ekzistuari.

2. Këshilli kryesisht ose me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo të magjistratit mund të rishikojë pezullimin e parashikuar në nenet 151 dhe 152, të këtij ligji, dhe vendos sipas rastit:

a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;

b) revokimin e pezullimit; ose

c) lënien në fuqi të pezullimit.

Neni 157
Pezullimi i pagës dhe përfitimeve të tjera

1. Magjistrati përfiton pagë të plotë gjatë pezullimit, përveç kur parashikohet ndryshe nga përcaktimet e pikave të mëposhtme të këtij neni.

2. Nëse magjistrati dënohet për kryerjen e një vepre penale nga gjykata e shkallës së parë ose jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompetent, Këshilli mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50 për qind, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në gjykatën më të lartë.

3. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në favor të magjistratit, çdo shumë e mbajtur, sipas pikës 2, të këtij neni, i kthehet menjëherë magjistratit.

4. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në disfavor të magjistratit, shumat e mbajtura, sipas pikës 2, të këtij neni, vazhdojnë të mbahen derisa çështja penale ose disiplinore, për të cilën është vendosur pezullimi i përfitimit, të përfundojë me vendim të formës së prerë.

KREU VI
DETYRIMET PENALE DHE CIVILE

Neni 158
Përgjegjësia penale e magjistratëve

1. Magjistrati mund të ndiqet penalisht, sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

2. Prokuroria, në rast se fillon hetimet penale ndaj magjistratit, njofton menjëherë Këshillin respektiv.

Neni 159
Kufizimi i përgjegjësisë civile

Magjistrati nuk ka përgjegjësi civile për shkak të ushtrimit të funksionit, përveç rastit kur ka treguar të paktën pakujdesi të rëndë.

PJESA VI
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

KREU I
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 160
Organet kompetente në periudhën kalimtare

1. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj:

a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) merr vendim për caktimin në pozicion të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

c) vendos masa disiplinore, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji;

ç) pezullon gjyqtarët, sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj;

d) mbikëqyr trajnimin e gjyqtarëve, sipas këtij ligji dhe ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë";

dh) kryen vlerësimin e punës, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

e) vendos masa disiplinore për inspektorët, bazuar në aktet nënligjore në fuqi;

ë) vërteton ndërprerjen e emërimit, në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit;

f) transferon përkohësisht gjyqtarë për plotësimin e trupave gjyqësorë në gjykata.

2. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj:

a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) merr vendim për caktimin në pozicione të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

c) pezullon prokurorët, sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj;

ç) mbikëqyr trajnimin e prokurorëve, sipas këtij ligji dhe ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë;

d) kryen vlerësimin e punës, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të prokurorëve, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

dh) vërteton mbarimin e emërimit në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit.

3. Caktimi në pozicione të përhershme të magjistratëve, sipas parashikimeve të këtij ligji, do të kryhet me ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të vendosin caktimin në pozicione të përkohshme të magjistratëve për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë.

5. Deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm heton shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në procedurën dhe kriteret e pjesës V dhe dispozitës kalimtare të këtij ligji.

Neni 161
Dispozita kalimtare për magjistratët në Gjykatën e Lartë
(*Shfuqizuar pjesë nga pika 2 dhe pika 3 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK)*

1. Gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Lartë do të konsiderohet magjistrat, sipas këtij ligji.

2. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre, sipas mandatit të mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Shfuqizuar.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të zgjedhur nga Kuvendi, nga radhët e gjyqtarëve konsiderohen gjyqtarë të ngritur në detyrë, sipas këtij ligji. Gjyqtarët e zgjedhur nga Kuvendi nga radhët e juristëve konsiderohen anëtarë jogjyqtarë, sipas këtij ligji. Për plotësimin e vendeve vakante të krijuara zbatohet parashikimi i nenit 136, pika 3, të Kushtetutës lidhur me raportin e anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë.

Neni 162
Dispozita kalimtare për Gjykatat e Krimeve të Rënda
(*Shfuqizuar pjesë nga pika 1 dhe pjesë nga pika 6 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK)*

1. Gjyqtari në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ose Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda qëndron në pozicionin e tij deri në momentin e krijimit të gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton në mënyrë të përhershme gjyqtarët në detyrë në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me kërkesë të tyre, nëse:

a) gjyqtari kalon me sukses procesin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

b) përmbush kriteret për ngritjen në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 47 të këtij ligji;

c) gjyqtari, si dhe familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

3. Nëse ndaj gjyqtarit në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda ka

filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendim të formës së prerë, dy javë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton gjyqtarin përkohësisht në nivelin përkatës në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me kusht që ai, si dhe familjarët e afërm të tij të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

4. Në rast se ndaj gjyqtarit të caktuar përkohësisht, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendoset masë disiplinore, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", caktimi i përkohshëm i tij mbaron pavarësisht nëse është bërë ose jo ankim ndaj këtij vendimi.

5. Gjyqtarët në detyrë pranë gjykatave të krimeve të rënda do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Gjyqtari ka të drejtë të zgjedhë ndërmjet tre pozicioneve që janë të lira, sipas rregullave të parashikuara në nenin 60 të këtij ligji.

6. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë dhe të Apelit qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të gjykatës së posaçme, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ngre në detyrë pa vonesë gjyqtarët që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit në një pozicion të lirë në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me qëllim për të siguruar numrin minimal të gjyqtarëve të përcaktuar për këto gjykata në ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Neni 163
Dispozita kalimtare për prokurorët e Prokurorisë për Krimet e Rënda

1. Prokurori në detyrë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë ose të Apelit qëndron në pozicionin e tij deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin

"Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Këshilli i Lartë Prokurorisë cakton në mënyrë të përhershme prokurorët në Prokurorinë e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, në përputhje me parashikimet e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Neni 164
Dispozitat kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera
(*Shfuqizuar shkronja (a) pika 1 dhe pika 2 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK)*

1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse:

a) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 165
Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë

1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Ish-këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe pranë Gjykatës së Lartë, nëse ka të paktën pesë vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës, duke përfshirë të paktën tre vjet si këshilltar i gjyqtarit ose ndihmës ligjor në këto gjykata, mund të kërkojë t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

4. Subjektet e parashikuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë të drejtë:

a) të ndjekin programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës;

b) të caktohen brenda afatit 1-mujor pas përfundimit të programit të trajnimit për një vit për të kryer praktikë profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme, duke zbatuar parashikimet e nenit 33, të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim;

c) të përfitojnë gjatë periudhës dyvjeçare të trajnimit, të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, respektivisht pagë të barabartë me pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqtarit.

5. Ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në kuptim të pikës 4, të këtij neni, marrin pjesë në provimin përfundimtar në përmbyllje të vitit të tyre të parë në Shkollën e Magjistraturës. Ata caktohen për praktikë profesionale dhe vlerësohen gjatë saj, në përputhje me nenin 33 të këti

6. Në përfundim të trajnimit dyvjeçar, ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, renditen sipas rezultateve të provimit përfundimtar në fund të vitit të parë dhe të vlerësimit etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale. Ata përfshihen në listën e renditjes dhe emërohen si magjistratë, sipas parashikimeve të këtij ligji, nëse marrin të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme në provimin përfundimtar në fund të vitit të parë, si dhe janë vlerësuar të paktën "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale.

7. Shkolla e Magjistraturës miraton rregullat për procedurën dhe kushtet për pjesëmarrjen në provimin përfundimtar, kurrikulën dhe pjesëmarrjen në kurset e trajnimit.

8. Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në kuptim të këtij neni, nuk kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, marrëdhënia e punës së tyre mbaron në datën e fillimit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në zbatim të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH". I njëjti rregull zbatohet edhe për ata, të cilët nuk kanë përfunduar ende procesin e rivlerësimit, por kanë kaluar me sukses testimin e aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, në kuptim të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve". Në rast se institucioni për rivlerësimin merr vendim për masën e shkarkimit, ndërpritet ndjekja e programit të trajnimit dhe subjekti përjashtohet nga programi i trajnimit.

9. Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit në detyrë kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk ndjekin fushën e karrierës së magjistratit, kanë të drejtë për t'u caktuar në një pozicion si nëpunës civil në sistemin e prokurorisë ose nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tyre aktual dhe për të cilin përmbushin kriteret. Kërkesa për caktim në pozicion paraqitet respektivisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë brenda një muaji pas publikimit të rezultatit të testimit të Shkollës së Magjistraturës. Në këtë rast marrëdhënia e punës së ndihmësit ligjor, inspektorit dhe këshilltarit të gjyqtarit në detyrë mbaron në ditën e paraqitjes së kërkesës. Ky rregull nuk zbatohet për këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve ligjore.

Neni 166
Dispozitat kalimtare për ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë

1. Kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e rivlerësimit personat, të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për tre vjet, ose personat që kanë ushtruar funksionin e magjistratit për 9 vjet, në 20 vitet e fundit, duke përfshirë gjyqtarët në një Gjykatë Ndërkombëtare, Gjykatë të Lartë, Gjykatë Kushtetuese.

2. Kriteret që duhet të përmbushin subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni janë:

a) të mos jenë shkarkuar për shkelje disiplinore ose kryerjen e veprës penale;

b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;

c) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga sigurimi i shtetit para vitit 1990;

ç) të mos kenë qenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret.

3. Brenda dy viteve pas kalimit me sukses të procesit së rivlerësimit, subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, riemërohen si magjistratë. Ata kanë të drejtën për t'u caktuar në një pozicion për të cilin përmbushin kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe të kandidojnë në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicione për magjistratë ose për

pozicione të komanduara ose pozicione që mund të ushtrohen vetëm nga magjistratët.

4. Përvoja profesionale në institucionet e drejtësisë, në të cilat mund të komandohen magjistratët, sipas procedurave të këtij ligji, konsiderohet përvojë profesionale si magjistrat.

5. Në rast se subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nuk i janë nënshtruar vlerësimit etik dhe profesional, ata i nënshtrohen vlerësimit profesional, në kuptim të nenit 49 të këtij ligji.

6. Anëtari i Kolegjit të Apelit emërohet si gjyqtar në nivel apeli në përfundim të mandatit, përveç rasteve kur ndaj tij është dhënë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 167
Dispozita kalimtare për magjistratët e komanduar në institucione të tjera
(*Shfuqizuar pjesë nga shkronja (b) pika 3 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK)*

1. Për magjistratin e komanduar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen dispozitat e këtij ligji për aq sa është e mundur.

2. Magjistrati i komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të ligjit të mëparshëm, afati i komandimit të të cilit mbaron para krijimit të Këshillave, kthehet në vendin e mëparshëm të punës.

3. Koha e komandimit përfundon sipas afateve të përcaktuara në vendimin e komandimit të institucionit përkatës, përveç rasteve kur:

a) magjistrati kërkon brenda një muaji nga krijimi i Këshillave, që të mbarojë detyrën në pozicionin e komanduar përpara mbarimit të afatit;

b) ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

4. Nëse magjistrati kërkon përsëritjen e periudhës së komandimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosin sipas parashikimeve të këtij ligji.

5. Magjistrati i komanduar i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorive në Republikën e Shqipërisë".

Neni 168
Dispozita kalimtare për inspektorët me statusin e gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë
(*Shfuqizuar pjesë nga pika 2 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK)*

1. Inspektori dhe Kryeinspektori në detyrë, të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ata i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Inspektori vazhdon të ushtrojë detyrën e tij, sipas mandatit të mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Inspektori në detyrë, sipas këtij neni, mandati i të cilit mbaron para krijimit të Këshillave, ka të drejtë të kthehet në pozicionin e mëparshëm ose të vazhdojë në detyrë edhe 6 muaj pas krijimit të Këshillave. Ai ka të drejtë të kandidojë në procedurën për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë në kuptim të këtij ligji.

3. Inspektorët në detyrë, sipas këtij neni, që janë caktuar kryesisht për kryerjen e hetimeve disiplinore, vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe konsiderohen si të komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kohën e krijimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Inspektorët në detyrë, të cilët janë caktuar kryerisht për kryerjen e vlerësimin etik dhe profesional konsiderohen si të komanduar përkatësisht në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe përkatësisht në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke asistuar Këshillin në ushtrimin e funksionit për vlerësimin etik dhe profesional.

Neni 169
Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve
(*Shfuqizuar fjalia e fundit pika 5 dhe pika 6 me Vendimin nr. 34/2017 të GjK)*

1. Pjesa mbi të drejtat dhe detyrimet e magjistratit zbatohet menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë nen.

2. Magjistrati ka detyrim që, brenda 3 muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të marrë masat për të përmbushur kërkesat në lidhje me papajtueshmërinë dhe kufizimet në detyrë, sipas neneve 6 dhe 7 të këtij ligji.

3. Magjistrati informon për gjendjen e papajtueshmërisë ambientale brenda një muaji nga krijimi i Këshillave respektivë.

4. Magjistrati njofton për detyra jashtë funksionit, për të cilat duhet marrë leje, në përputhje me këtë ligj, brenda një jave nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nëse vazhdon të kryejë detyrën dhe kërkon leje pa vonesë për aktivitetet e ardhshme jashtë funksionit të tij.

5. Pjesa II, kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe për përfitime të tjera është i zbatueshëm për magjistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pavarësisht kësaj, në asnjë rast jo më shpejt se 1 janar 2019. Përjashtim nga ky rregull bëjnë magjistratët në institucionet për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilët përfitojnë pagat dhe përfitimet e tjera, sipas këtij ligji, me caktimin në mënyrë të përhershme në këtë pozicion.

Neni 170
Dispozitat kalimtare në lidhje me fazën e rekrutimit të kandidatëve magjistratë

1. Parashikimet e pjesës III, kreu I, të këtij ligji, do të zbatohen për procesin e pranimit për vitin akademik që fillon jo më vonë se 8 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Kriteri për kalimin e provimit të shtetit do të zbatohet për magjistratët kandidatë, të cilët kandidojnë për pranim në Shkollën e Magjistraturës, pas hyrjes në fuqi të ligjit që rregullon kriteret dhe procedurat e provimit të shtetit.

Neni 170/1
Caktimi i magjistratëve për çështje të veçanta
(*Shtuar me Ligjin nr. 50/2021)*

1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm dhe transferimi i përkohshëm i magjistratëve është i padobishëm për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, Këshillat mund të caktojnë një magjistrat për gjykimin ose hetimin e çështjeve të veçanta në një gjykatë ose prokurori të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionin në mënyrë të përhershme në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk ka një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh ose prokurorësh në një gjykatë ose prokurori; ose

b) kur gjyqtarët ose prokurorët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve.

2. Magjistrati që caktohet për një çështje të veçantë përfiton kompensim për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 15 të këtij ligji.

3. Këshillat përcaktojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për caktimin e magjistratëve për çështje të veçanta.

4. Këshillat nuk mund të caktojnë magjistratë për çështje të veçanta sipas këtij neni, pas përfundimit të afatit të caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve.

Neni 170/2
Caktimi i përkohshëm në pozicione të lira të përkohshme
(*Shtuar me Ligjin nr. 50/2021)*

1. Kur numri i të emëruarve të sapodiplomuar është më i madh se vendet e lira të shpalluara për ata, të emëruarit që nuk janë caktuar në një pozicion të lirë të përhershëm për magjistrat caktohen përkohësisht në një pozicion të lirë të përkohshëm.

2. Këshillat shpallin pozicionet e lira të përkohshme për të emëruarit e sapodiplomuar brenda një jave nga përfundimi i caktimit të të emëruarve në pozicionet e lira të përhershme.

3. Në rastet e caktimit të përkohshëm në një pozicion magjistrati:

a) Këshillat i ofrojnë të emëruarit mundësinë e zgjedhjes për të paktën dy pozicione, sipas radhës së renditjes së tyre në listën e të diplomuarve;

b) i emëruari i caktuar përkohësisht në një pozicion magjistrati duhet të marrë pjesë në procedurën e radhës së lëvizjes paralele në shkallën e parë, me qëllim që të caktohet sa më shpejt në një pozicion të lirë të përhershëm.

4. Këshillat nuk mund të caktojnë magjistratë përkohësisht në pozicione të lira të përkohshme, sipas këtij neni, pas përfundimit të afatit të caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve.

Neni 171
Dispozitë kalimtare për vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë përfundon vlerësimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit për periudhën 2007 – 2009 dhe 2010 – 2012, bazuar në rregullat ekzistuese para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit në këtë periudhë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë publikon një raport në pajtim me nenin 98, të këtij ligji, brenda tre muajve.

2. Menjëherë me ngritjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelimit, Këshillat duhet të mbështesin këto organe për realizimin e vlerësimit të aftësive profesionale, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", duke ndjekur udhëzimet dhe kërkesat e këtyre organeve. Dhënia e ndihmës për këto organe ka përparësi.

3. Në të njëjtën kohë me vlerësimin etik dhe profesional të periudhave 2007-2009, 2010 – 2012, Këshillat duhet të vlerësojnë magjistratët për periudhën e përcaktuar në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

4. Këshilli përzgjedh në mënyrë rastësore çështjet, në përputhje me parashikimet e nenit 91, të këtij ligji, dhe analizon dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit në zbatim të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Këshilli gjithashtu përzgjedh në mënyrë rastësore edhe 5 dosje të subjektit të rivlerësimit në prani të një Komisioni të Pavarur të Kualifikimit. Këshilli paraqet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të gjitha dokumentet së bashku me një raport analizues të dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti rivlerësimit, si dhe 5 dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore në respektim të kërkesave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Këshilli, me kërkesë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, paraqet dokumentacion të mëtejshëm. Këshilli ndjek listën, sipas radhës së kërkuar nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit.

5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për

aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës.

6. Vlerësimi etik dhe profesional i kryetarit në cilësinë e këtij funksioni do të realizohet në mënyrë të pavarur nga procesi i rivlerësimit dhe do të kryhet paralelisht. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, brenda tre muajve nga krijimi i tyre, miratojnë programin, duke listuar magjistratët që vlerësohen në cilësinë e kryetarit, në pajtim me këtë ligj. Në përgatitje të këtij programi do të mbahen parasysh raportet për punën e kryetarit, rishikuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 30/1, pika 4, të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar.

7. Periudha e vlerësimit pas vlerësimit etik dhe profesional të kryer në kuadër procesit të rivlerësimin do të jetë periudha e përcaktuar në nenin 84 të këtij ligji. Këshilli fillon procedurën për vlerësimin etik dhe profesional për periudhën respektive, brenda vitit kalendarik, që ndjek vitin e mëparshëm, i cili është mbuluar nga periudha e vlerësimit të mëparshëm.

8. Të dhënat statistikore përpunohen nga gjykata ose prokuroria ku ushtron detyrën magjistrati që do të vlerësohet, si dhe dërgohen nga kryetari te Këshilli përkatës, deri në momentin që Këshillat kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhënat e sakta dhe të sigurta statistikore në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe në prokurori. Të dhënat statistikore për magjistratin që është në proces vlerësimi i dërgohen Këshillit respektiv nga kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, në të cilën magjistrati ka ushtruar detyrën gjatë periudhës për të cilën kryhet vlerësimi. Këshilli përcakton me vendim kohën dhe procedurat e marrjes drejtpërdrejt të të dhënave statistikore nga sistemi.

9. Treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në mënyrë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve identifikohet dhe vlerësohet vetëm në lidhje me çështjet e zgjedhura me short.

10. Deri në përdorimin e shortit elektronik, shorti, sipas nenit 91, të këtij ligji, do të pasqyrohet në procesverbal, që do të nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit dhe bëhet pjesë e dosjes së vlerësimit.

Neni 172
Dispozita kalimtare për procedimet disiplinore

1. Hetimet disiplinore të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nga Ministria e Drejtësisë, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

dhe inspektorët në Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme përfundohen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas dispozitave në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Procedimet disiplinore të papërfunduara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose në Prokurorinë së Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kryhen brenda afatit 6-mujor pas hyrjes në fuqi e këtij ligji. Organet përgjegjëse, sipas nenit 160, të këtij ligji, zbatojnë rregullat procedurale të parashikuara në këtë ligj.

3. Për shkeljet disiplinore të parashikuara sipas këtij ligji, që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të tij, dhe që parashikoheshin si të tilla në kohën e kryerjes së tyre, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Organet kompetente për procedimin disiplinor zbatojnë parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm për magjistratin që ka kryer shkeljen disiplinore.

KREU II
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 173
Shfuqizime

1. Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të neneve si më poshtë:

a) neni 2, shkronjat "b", "ç", "d", "dh";

b) nenet 3, 4, 5, neni 6, pika 3, neni 7, pika 1, neni 8, pikat 1 dhe 2, nenet 9, 10, 11, 12, 13, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

2. Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", shfuqizohet në tërësi menjëherë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Deri në zbatimin e sistemit të ri të pagave dhe përfitimeve të tjera për magjistratët, që hyn në fuqi në datën 1 janar 2019, sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", do të qëndrojnë në fuqi dispozitat sa më poshtë:

a) rregullimet e parashikuara në nenet 26 dhe 27 për pagat e gjyqtarëve, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) rregullimet e parashikuara në nenin 22, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë";

c) rregullimet e parashikuara në nenin 9, të ligjit nr. 9110, datë 24.7.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda";

ç) rregullimet e parashikuara në nenin 52, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 174
Aktet nënligjore

1. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të miratojnë rregullat e detajuara, sipas parashikimeve dhe afateve të këtij ligji.

a) Brenda tre muajve nga krijimi i Këshillave, aktet që lidhen me aktivitete jashtë funksionit, krijimin e dosjeve personale, caktimin e përkohshëm në detyrë të të emëruarve të rinj në pozicione të komanduara, magjistratët në skemën e delegimit, ngritjen në detyrë në nivele më të larta ose të specializuara, emërimin e anëtarëve jogjyqtarë të Gjykatës së Lartë, emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe caktimet në pozicionet e përkohshme.

b) Brenda një viti nga krijimi i Këshillit, aktet e tjera.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi këtij ligji, në zbatim të neneve 17, pika 7, dhe 20, pika 2, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë të miratojë akte nënligjore, brenda tre muajve nga krijimi i tij, në zbatim të nenit 137, pika 3, të këtij ligji.

4. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të miratojë aktet nënligjore, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi këtij ligji.

5. Deri në miratimin e akteve nënligjore, parashikimet e këtij ligji do të zbatohen rast pas rasti.

6. Çdo akt nënligjor i miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohet për sa nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

Dispozitë kalimtare
(*Shtuar me Ligjin nr. 48/2019)*

1. Deri në miratimin nga Këshillat të akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të magjistratëve dhe të realizimit të procedurave të vlerësimit, sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, emërimi i kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, që sipas ligjit është parësor, nuk do të ndërvaret nga përfundimi i procedurave të transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë për magjistratët.

2. Për shpalljen e pozicioneve të lira për kandidatët për magjistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në çdo rast, Këshillat vlerësojnë mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë dhe, në veçanti, nevojat urgjente të gjykatave dhe prokurorive në këndvështrim të funksionalitetit të tyre.

3. Për procedurat e transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë të magjistratëve që kandidojnë gjatë kësaj periudhe kalimtare, Këshillat miratojnë dhe zbatojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të tyre; për kriteret e renditjes se magjistratëve me pikë të barabarta vlerësimi; për kriteret e vlerësimit të përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë dhe për procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta, të tilla që respektojnë objektivitetin, transparencën dhe efektivitetin e këtij procesi.

Neni 175
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miratuar në datën 06.10.2016

LIGJ
Nr. 95/2016

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR*

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është:

1. Përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësisë së Pavarur Hetimore, si organe kushtetuese, sipas pikës 4, të nenit 148, të Kushtetutës.

2. Përcaktimi i kushteve dhe procedura për emërimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

3. Përcaktimi i kompetencave lëndore parësore dhe të tjera të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme.

4. Përcaktimi i kushteve dhe kriteret shtesë që duhet të përmbushin shtetasit për t'u emëruar, transferuar apo për t'u ngritur në detyrë si

* Ndryshuar me Ligjin no 47/2021, date 23.3.2021

gjyqtarë ose punonjës pranë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorë dhe punonjës pranë Prokurorisë së Posaçme, si dhe për t'u punësuar pranë Njësisë së Pavarur Hetimore.

5. Përcaktimi i marrëdhënieve të Prokurorisë së Posaçme me institucione të tjera shtetërore, subjekte të tjera publike apo private, si dhe me publikun.

6. Organizimi dhe funksionimi i procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i ligjit është:

1. Garantimi i funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, si një prokurori e specializuar, për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 1, të nenit 148/dh, të Kushtetutës, në mënyrë efikase dhe të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.

2. Garantimi i funksionimit të Njësisë së Pavarur Hetimore për të hetuar veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe veprat e tjera penale të kryera vetëm nga subjektet e parashikuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.

Neni 3
Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Anëtar i afërt i familjes" nënkupton bashkëshortin/bashkëshorten, fëmijët mbi 18 vjeç dhe çdo person të lidhur nga gjaku apo martesa, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim.

2. "Drejtues të institucioneve shtetërore qendrore ose të pavarura" nënkupton Drejtorin e Policisë së Shtetit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të

Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Guvernatorin e Bankës Qendrore të Shqipërisë, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror.

3. "Gjyqtar" nënkupton çdo person që shërben si gjyqtar në çdo gjykatë të shkallës së parë, Gjykatë të Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjykatë apeli, Gjykatë të Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjykatë administrative apo Gjykatën e Lartë.

4. "Informacion sensitiv" nënkupton dokumentet elektronike ose fizike, fotografitë, regjistrimet, të dhënat, emrat ose çdo informacion tjetër me shkrim ose verbal, që merret gjatë apo si rrjedhojë e një hetimi penal, në përputhje me këtë ligj. Ky informacion nuk konsiderohet sensitiv pasi të jetë bërë publik, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

5. "Prokuror" nënkupton çdo prokuror në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës të parë, në prokuroritë pranë gjykatave të apeleve, në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

6. "Prokuror më i lartë" është titullari/drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

7. Termi "Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar" përdoret për t'iu referuar Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësisë së Posaçme Hetimore, e cila emërtohet "Byroja Kombëtare e Hetimit". Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar quhet shkurtimisht "SPAK".

8. "Vepra penale të lidhura me çështjen ose hetimin" nënkupton çdo vepër penale që është kryer me qëllim përgatitjen, mbështetjen, mundësimin, fshehjen ose shmangien e zbulimit të një shkeljeje penale që është në kompetencën kryesore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky përkufizim përfshin gjithashtu çdo shkelje penale që pengon hetimin e çështjes, kanos dëshmitarët, viktimat, gjyqtarët, prokurorët, hetuesit ose punonjësit, apo shkatërron ose i bën provat të papërdorshme në mënyra të tjera.

Neni 4
Prokuroria e Posaçme

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe

krimit të organizuar, dhe Gjykatës së Lartë, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj.

2. Prokuroria e Posaçme i kryen funksionet e saj në mënyrë të pavarur, nëpërmjet prokurorëve të posaçëm, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përputhje me këtë ligj.

Neni 5
Byroja Kombëtare e Hetimit

1. Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

2. Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj hetuesit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore sipas këtij ligji.

3. Drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, hetuesit dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore drejtohen dhe kontrollohen nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

Neni 6
Procedura e verifikimit të kushteve të sigurisë përpara emërimit në detyrë

1. Kandidati për gjyqtar dhe nëpunës civil gjyqësor në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për prokuror dhe personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme, dhe për drejtor dhe hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit duhet të plotësojë kushtet e sigurisë përpara se të caktohet apo punësohet në një nga këto pozicione. Asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë ose të punësohet pa plotësuar këto kushte. Të njëjtat kushte duhet të plotësohen nga çdo punonjës i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kryejnë funksione hetimore ose funksionet e të cilëve mbështesin drejtpërsëdrejti hetimin. Kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit janë:

a) kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës;

b) dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën kandidati plotëson dhe nënshkruan një deklaratë me shkrim, sipas shtojcave B1 dhe B2 të këtij ligji; si dhe

c) dhënia e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin

periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën anëtari i afërt i familjes plotëson dhe nënshkruan një deklaratë me shkrim, sipas shtojcës B3 të këtij ligji.

2. Kandidati, bashkë me kërkesën për aplikim, plotëson dhe dorëzon deklaratat e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit pranë institucioneve përkatëse të emërtesës. Nëse, gjatë 180 ditëve para se të paraqiste kërkesën, kandidati ka kaluar një kontroll të kryer prej Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë ky kriter do të konsiderohet si i përmbushur.

3. Kandidati plotëson deklaratën e kontrollit të figurës, sipas shtojcës A, të këtij ligji, dhe e dorëzon atë tek institucionet e emërtesës.

4. Kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes plotësojnë dhe nënshkruajnë vetëdeklarimin, sipas shtojcës B3, të këtij ligji, sipas së cilës, nëse caktohet në detyrë apo punësohet, telekomunikimet e tyre, si dhe llogaritë bankare do të jenë objekt vëzhgimi, si dhe heqin dorë nga e drejta e jetës private lidhur me këto komunikime, si dhe i dorëzojnë ato tek institucionet e emërtesës.

5. Gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit krijojnë Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve për të bërë verifikimin e kushteve të sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit, të përbërë nga:

a) dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, të zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit;

b) një gjyqtar të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit;

c) një punonjës i seksionit të hetimit financiar pranë Prokurorisë së Posaçme, i caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;

ç) një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i caktuar nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

6. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, pasi merr nga institucionet përkatëse të emërtesës deklaratat, sipas pikave 2, 3 dhe 4, të këtij neni, kryen verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën dhe, brenda 120 ditëve, i dorëzon institucionit të emërtesës një raport të hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe

pastërtinë e figurës, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës të paraqitur nga vetë kandidatët apo institucionet shtetërore, të cilat bëhen pjesë e dosjes së kandidatit, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, përveç dokumentacionit të paraqitur nga vetë kandidatët, mund të kërkojë të dhëna ose informacione zyrtare nga çdo institucion shtetëror në lidhje me kandidatët. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve u kërkon informacion institucioneve shtetërore, objekti i ligjshëm i veprimtarisë së të cilave lidhet me hetimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi pasurinë dhe figurën e individit, duke i caktuar detyra konkrete dhe afate për përmbushjen e tyre. Institucioni shtetëror përkatës është i detyruar që të paraqesë informacionin ose dokumentacionin e kërkuar brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Këto akte bëhen pjesë e dosjes së kandidatit dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat dhe informacionet zyrtare mund t'i vihen në dispozicion kandidatit, mbi bazën e një kërkese të arsyetuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar. Në rast se përhapja e informacionit apo dokumenteve cenon informacionin e klasifikuar sekret apo sigurinë publike, atëherë Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, pasi njihet me to, nuk i përfshin në dosjen individuale të kandidatit dhe është i detyruar të ruajë konfidencialitetin mbi përmbajtjen e tyre.

Neni 7
Procesi i aplikimit

1. Plotësimi i vendeve vakante pranë Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar bëhet i hapur dhe transparent.

2. Procesi i hapur dhe transparent përfshin si rregull:

a) aplikimin, që në mënyrë të qartë parashikon minimumin e kualifikimeve për pozicionin dhe numrin e vendeve vakante;

b) njoftimin për aplikim që:

- publikohet të paktën dy javë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të tyre në *website*-n e institucionit;

- specifikon afatin përfundimtar të aplikimit që është jo më pak se dy javë nga data e publikimit;

- specifikon informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për t'u dorëzuar bashkë me aplikimin;

- specifikon procedurën për aplikimet dhe se ku duhen dorëzuar ato;

c) rubrikën për vlerësimin e të gjithë aplikantëve bazuar në meritat e tyre;

ç) rubrikën që informon rreth komisionit dhe përbërjes të tij, që bën përzgjedhjen dhe rekomandimet;

d) informimin në kohën e duhur të aplikuesve rreth rezultateve të konkursit.

KREU II
KOMPETENCAT

Neni 8
Kompetenca lëndore parësore
(shfuqizuar togfjalëshi i fundit i pikës 1 me ligjin 47/2021, neni 1)

1. Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

2. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji, ose nëse ai zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit.

Neni 9
Kompetenca lëndore të tjera

1. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.

2. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe

goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

3. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

4. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë kompetenca mbi hetimet, çështjet dhe kërkesat e paraqitura në përputhje me këtë nen.

Neni 10
Juridiksioni penal

1. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e kanë vendndodhjen në Tiranë dhe e ushtrojnë juridiksionin e tyre penal në të gjithë territorin e Shqipërisë. Byroja Kombëtare e Hetimit mund të krijojë zyra të përkohshme ose të përhershme jashtë Tiranës, për të përmbushur qëllimin e saj.

2. Prokuroria e Posaçme ka juridiksion penal për hetimin dhe ndjekjen penale të çdo vepre të parashikuar nga nenet 8 dhe 9, të këtij ligji, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU III
PROKURORIA E POSAÇME

Neni 11
Prokuroria e Posaçme

1. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga drejtuesi i prokurorisë dhe nga prokurorët e posaçëm.

2. Dispozitat e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" zbatohen edhe për organizimin dhe veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme, përveçse kur ky ligj parashikon ndryshe.

3. Prokuroria e Posaçme ushtron funksionet përmes prokurorëve të posaçëm dhe sektorëve mbështetës në përputhje me këtë ligj. Hetuesit dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit drejtohen dhe kontrollohen nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

Neni 12
Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme

1. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me parashikimet e nenit 148/dh të Kushtetutës dhe legjislacionin në fuqi.

2. Kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme duhet të përmbushin parakushtet e sigurisë të nenit 6 të këtij ligji. Një kandidat nuk mund të caktohet në detyrë në Prokurorinë e Posaçme pa përmbushur parakushtet e sigurisë dhe kushtet e aftësive profesionale. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, përpara emërimit, sipas parashikimeve të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, administron, shqyrton dhe vlerëson edhe dokumentacionin e secilit kandidat të ardhur nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve. Kandidati, i cili merr një vlerësim negativ nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, bazuar në ligj dhe në prova, nuk mund të emërohet si prokuror në Prokurorinë e Posaçme. Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i formës së prerë.

3. Prokurorët emërohen në detyrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për një mandat nëntëvjeçar. Mandati pezullohet apo ndërpritet vetëm nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkon procedim disiplinor kundër prokurorit.

4. Në përfundim të mandatit të prokurorit të posaçëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë e kthen atë në pozicionin e tij të mëparshëm ose në pozicione të lira në zyra të tjera të sistemit të prokurorisë, duke marrë përparësi mbi kandidatët e tjerë.

Neni 13
Pavarësia e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme

1. Prokurorët e posaçëm, në ushtrimin e funksioneve të tyre, veprojnë dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Prokurorët e posaçëm zbatojnë udhëzimet e përgjithshme, të dhëna me shkrim nga prokurori më i lartë, sipas këtij ligji. Prokurori më i lartë nuk mund t'i japë udhëzime një prokurori të posaçëm lidhur me thelbin e hetimit apo çështjes.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm, të brendshëm apo të jashtëm, nga çdo autoritet publik a privat.

Neni 14
Përgjegjshmëria

Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, kur kanë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale, hetojnë dhe ndjekin penalisht prokurorë të Prokurorisë së Posaçme ose gjyqtarë të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Neni 15
Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet në përputhje me nenin 148/dh, pika 3, të Kushtetutës.

2. Drejtuesi Prokurorisë së Posaçme ushtron funksionet dhe kompetencat e mëposhtme:

a) është drejtues administrativ i punonjësve të Prokurorisë së Posaçme. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk i jep udhëzime një prokurori të posaçëm lidhur me thelbin e hetimeve apo çështjes penale të ndjekur prej tij;

b) u cakton çështje prokurorëve të posaçëm bazuar në specializimin e tyre;

c) koordinon punën e njësive që janë në kompetencë të tij me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, shërbimet e inteligjencës dhe autoritetet e tjera kompetente;

ç) i paraqet Ministrisë së Financave projektbuxhetin për Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit;

d) brenda datës 1 mars, i dorëzon Këshillit të Lartë të Prokurorisë një raport vjetor me shkrim mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme;

dh) thërret mbledhjen e Prokurorisë së Posaçme, kur është e nevojshme;

e) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim në lidhje me procedurat administrative, si dhe rregullore për funksionimin e Prokurorisë së Posaçme;

ë) pas konsultimit me Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe mbledhjes së prokurorëve të posaçëm, nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për Byronë Kombëtare të Hetimit, të cilat përmirësojnë marrëdhëniet e punës, efikasitetin apo garancitë mes dy strukturave;

f) miraton rregulloret e nxjerra nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit;

g) cakton, në mungesë të tij, një prokuror tjetër të posaçëm në rolin e Drejtuesit të Komanduar të Prokurorisë së Posaçme. Nëse kjo mungesë zgjat më shumë se 45 ditë, ose përsëritet vazhdimisht, Këshilli i Lartë i Prokurorisë komandon një prokuror të posaçëm si Drejtues të Prokurorisë së Posaçme për një periudhë kohore të përcaktuar, si dhe mban parasysh nëse mungesa e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme është e justifikuar apo përbën shkelje serioze të disiplinës.

Neni 16
Mbledhja e prokurorëve të posaçëm

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme thërret dhe drejton mbledhjen e prokurorëve të strukturës përkatëse, për të diskutuar çështje me rëndësi të veprimtarisë së prokurorisë.

2. Mbledhja e Prokurorëve të Posaçëm ka detyrat e mëposhtme:

a) jep mendim mbi rregulloren e brendshme administrative të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë së Posaçme dhe rregulloreve të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;

b) jep mendim lidhur me përshkrimet e punës të të gjitha kategorive të nëpunësve civilë dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme dhe aftësitë e personave në detyrë;

c) jep mendim për ngritjen e komisioneve të brendshme sipas nevojës;

ç) jep mendim mbi projektbuxhetin e prokurorisë përkatëse, përpara se të dërgohet në Kuvendin e Shqipërisë;

d) diskuton çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme, përfshirë ato që lidhen me personelin, disiplinën, sigurinë, si dhe çështje të tjera që garantojnë mbarëvajtjen e punës normale në këtë prokurori;

3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka detyrimin të thërrasë mbledhjen e prokurorëve të posaçëm, kur kjo kërkohet nga të paktën një e treta e trupës së prokurorëve.

Neni 17
Struktura e Prokurorisë së Posaçme

1. Prokuroria e Posaçme mbështetet nga personeli i këtyre sektorëve:

a) Kancelari;

b) Sektori i Dokumentacionit;

c) Sektori i Ekspertizës;

ç) Sektori i Hetimit Financiar;

d) Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetimet e Përbashkëta;

dh) Sektori për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm;

e) Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat.

2. Të gjithë kandidatët për personel të Prokurorisë së Posaçme duhet të përmbushin kushtet e sigurisë, sipas nenit 6 dhe kreut VIII të këtij ligji.

Neni 18
Kancelari

1. Kancelari i Prokurorisë së Posaçme, është nëpunësi civil më i lartë i Prokurorisë së Posaçme, i cili mbikëqyr veprimtarinë e personelit administrativ, administron mjediset e punës, dosjet, arkivin, shërbimet mbështetëse dhe financat e Prokurorisë. Kancelari përgjigjet para Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

2. Kancelari i Prokurorisë së Posaçme kryen funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm për Prokurorinë e Posaçme dhe është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditin e brendshëm të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të legjislacionit për menaxhimin buxhetor dhe financiar.

3. Kancelari i Prokurorisë së Posaçme barazohet në pagë me funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 19
Sektori i Dokumentacionit

1. Sektori i Dokumentacionit në Prokurorinë e Posaçme kryen këto detyra:

a) mbledh në mënyrë sistematike të dhëna për rastet e korrupsionit

dhe krimit të organizuar;

b) krijon dhe mban një bazë të dhënash që shërben si burim informacioni në procedimet për vepra penale, të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale;

c) i përcjell Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë të dhëna statistikore sipas kompetencave të tyre;

ç) kryen detyra të tjera të nevojshme për punën e zyrës.

2. Sektori i Dokumentacionit në Prokurorinë e Posaçme bashkëpunon me Arkivin Shtetëror për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit të Prokurorisë së Posaçme, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit.

Neni 20
Sektori i Ekspertizës

1. Prokuroria e Posaçme ka personel ekspertë që ndihmojnë në hetime dhe mund të dëshmojnë në gjyq.

2. Ekspertët duhet të jenë të specializuar në fusha të ndryshme për të ndihmuar Prokurorinë e Posaçme në ushtrimin e funksioneve të saj. Prokuroria ka të paktën një ekspert kontabël dhe një ekspert të teknologjisë së informacionit.

3. Ekspertët duhet minimalisht të kenë përfunduar studimet në nivelin "Master i shkencave" në fushën e tyre të ekspertizës.

4. Ekspertët duhet të kenë të paktën pesë vjet përvojë në fushën e tyre të ekspertizës.

5. Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë të kualifikuar sipas këtij neni, mund të japin ndihmesën e tyre, si ekspertë, në hetime apo të dëshmojnë.

Neni 20/1
(shtuar me ligjin 47/2021, neni 2)

1. Me qëllim funksionimin normal të bërthamës komanduese elektronike në Prokurorinë e Posaçme caktohen specialistë të fushës, të cilët gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore.

2. Paga e specialistit të bërthamës komanduese elektronike është e njëjtë me pagën e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, sipas përcaktimit të nenit 39/1 të këtij ligji.

3. Specialistët e bërthamës komanduese elektronike përfitojnë të njëjtin trajtim si punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas përcaktimit të nenit 40/1 të këtij ligji."

Neni 21
Sektori i Hetimit Financiar
(ndryshuar me me ligjin 47/2021, neni 2)

1. Sektori i Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme verifikon mjetet financiare dhe pasuritë e personave nën hetim dhe raporton rezultatet te prokurori i posaçëm kompetent.

2. Punonjësit e këtij sektori janë të diplomuar në drejtësi, financë apo në fusha të tjera përkatëse.

3. Punonjësit e këtij sektori gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore dhe duhet të kenë një eksperiencë pune jo më pak se dy vjet si oficerë të Policisë Gjyqësore.

4. Paga e punonjësve të këtij sektori është e njëjtë me pagën e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, sipas përcaktimit të nenit 39/1 të këtij ligji

5. Punonjësit e këtij sektori përfitojnë të njëjtin trajtim si punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas përcaktimit të nenit 40/1 të këtij ligji"

Neni 22
Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta

1. Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta në Prokurorinë e Posaçme është përgjegjës për koordinimin e punës së saj me autoritetet e shteteve të tjera. Sektori shërben si ndërlidhës me organet e huaja në shërbim të ecurisë së hetimeve apo hetimeve të përbashkëta.

2. Sektori drejtohet nga një prokuror i posaçëm, i caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për një periudhë trevjeçare.

3. Punonjësit e këtij sektori duhet të kenë diplomë masteri të nivelit të dytë në drejtësi ose arsim të lartë juridik të njësuar me të sipas ligjit për arsimin e lartë.

4. Ndërlidhësi duhet të ketë të paktën pesë vite përvojë në fushën e drejtësisë, si dhe duhet të zotërojë rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe angleze.

Neni 23
Detyrat e Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta

1. Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta:

a) bashkëpunon me autoritete kompetente të shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare;

b) cakton anëtarë në strukturat e përbashkëta hetimore, të krijuara në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose në bazë të një marrëveshje për një rast konkret, me qëllim hetimin, ndjekjen penale apo përfaqësimin në gjyq të veprave penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, në Republikën e Shqipërisë, në një ose më shumë shtete të tjera;

c) mbikëqyr hetimet e përbashkëta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, zbatimin e legjislacionit të brendshëm, si dhe respektimin e sovranitetit të Republikës së Shqipërisë;

ç) informon në lidhje me problemet e identifikuara apo çështjet e debatuara, të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve me organet kompetente të një shteti tjetërapo përfaqësuesve të tij, informon pa vonesë Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i cili, nëse është e nevojshme, kërkon mendimin ose ndihmën e ministrisë kompetente.

2. Për nevojat e hetimeve të përbashkëta, ndërlidhësi:

a) merr kërkesat e shteteve të tjera për të bërë hetime të posaçme për çështjen penale, ndërmerr veprimet e nevojshme para gjykatave kompetente dhe ofron ndihmë ligjore në procedime për vepra penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale;

b) mbikëqyr veprimtarinë e organit kompetent të shtetit të huaj, që është i autorizuar të veprojë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në rast të një çështjeje penale urgjente, për të garantuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të qytetarëve shqiptarë;

c) i dorëzon një raport përfundimtar Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për veprimet e kryera, sipas parashikimit të shkronjës "b", pika 2, të këtij neni. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të kërkojë praninë e një nëpunësi të huaj të autorizuar gjatë dorëzimit të raportit.

Neni 24
Koordinatori për Marrëdhëniet me Mediat

1. Koordinatori për Marrëdhëniet me Mediat në Prokurorinë e Posaçme kryen ndërlidhjen mes prokurorisë dhe mediave kombëtare e ndërkombëtare.

2. Koordinatori i Marrëdhënieve me Mediat është i vetmi person i autorizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për të komunikuar me mediat në emër të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me hetime apo çështje penale.

3. Koordinatori i Marrëdhënieve me Mediat duhet të jetë i diplomuar në një fushë që lidhet me detyrën dhe të ketë të paktën pesë vite përvojë pune në një organizatë mediatike apo si ndërlidhës shtypi i një agjencie publike ose një organizate ndërkombëtare.

4. Koordinatori i Marrëdhënieve me Mediat kryen këto detyra:

a) informon publikun për format e rrezikut, pasojat e korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe për metodat e instrumentet për parandalimin e tij;

b) nën drejtimin dhe bazuar në udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, informon publikun për punën e zyrës;

c) kryen detyra të tjera, bazuar në planin vjetor të punës së zyrës.

5. Punonjësit e marrëdhënieve me mediat duhet të zotërojnë rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Neni 25
Sektori për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm

1. Prokuroria e Posaçme ka një sektor që ofron shërbime për individët me status të posaçëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, përfshirë viktimat e krimeve, të cilët janë brenda kompetencave të kësaj prokurorie, si dhe për dëshmitarët në hetimet dhe çështjet e ndjekura nga kjo prokurori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Numri i koordinatorëve të këtij sektori është në varësi të numrit të çështjeve penale që hetohen nga Prokuroria e Posaçme, por në çdo rast ky numër nuk mund të jetë më pak se dy koordinatorë.

3. Koordinatorët duhet të kenë diplomë nga një universitet i licencuar në degët e psikologjisë ose sociologjisë ose fusha të tjera të posaçme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 26
Mbikëqyrja e punonjësve dhe ekspertëve

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe drejtuesit e sektorëve kryejnë mbikëqyrjen administrative të marrjes në punë, trajnimin, disiplinën dhe vlerësimin e punonjësve dhe ekspertëve të Prokurorisë së Posaçme, si dhe i caktojnë ata të punojnë me prokurorët.

2. Prokurorët e posaçëm mbikëqyrin çdo punonjës dhe ekspert në hetimet dhe çështjet që u janë caktuar.

3. Ekspertët japin mendime të bazuara në prova, fakte, ekspertizë dhe rezultate analizash.

Ata nuk mund të japin mendim për themelin e çështjes.

Neni 27
Përfaqësimi

1. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme i përfaqësojnë çështjet e tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe në Gjykatën e Lartë.

2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, kur e çmon të nevojshme, mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm të caktojë prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme për të përgatitur apo përfaqësuar akuzën në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ose në Gjykatën e Lartë, kur ekspertiza apo asistenca profesionale është e nevojshme në funksion të cilësisë së përfaqësimit.

KREU IV
BASHKËPUNIMI ME ORGANET E TJERA

Neni 28
Detyrimet e organeve të tjera shtetërore

1. Të gjitha organet e pushtetit shtetëror dhe të gjitha subjektet juridike, të cilat, në kryerjen e aktiviteteve të tyre, vijnë në dijeni për rrethana dhe të dhëna për vepra penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë të detyruar t'i referojnë këto rrethana ose të njoftojnë menjëherë Byronë Kombëtare të Hetimit ose Prokurorinë e Posaçme.

2. Të gjitha organet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit për hetimin e çështjeve penale, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e duhur për hetimin e veprave penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Organet shtetërore kanë detyrim të japin informacion brenda 24 orëve ose, në qoftë se baza e të dhënave ekziston, t'i japin akses të drejtpërdrejtë Prokurorisë së Posaçme. Ky akses vendoset në mënyrë të përhershme brenda një afati kohor të arsyeshëm, por jo më shumë se 6 muaj dhe vetëm në bazë të një kërkese me shkrim nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme drejtuar titullarit të institucionit shtetëror.

4. Parashikimet e bëra në pikën 3 të këtij neni nuk zbatohen për sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave që janë të certifikuara si sekret shtetëror. Aksesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.

Neni 29
Detyrimet e Policisë së Shtetit

1. Çdo punonjës i Policisë së Shtetit kur vjen në dijeni për kryerjen e një vepre penale të parashikuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, njofton menjëherë Byronë Kombëtare të Hetimit. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit nxjerr një rregullore mbi metodologjinë e informimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

2. Prokuroria e Posaçme, pas marrjes së njoftimit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, nëse vlerëson se është kryer një vepër penale në kompetencë të saj, fillon menjëherë procedimin penal për hetimin e çështjes. Prokuroria e Posaçme njofton pa vonesë policinë dhe prokurorinë përkatëse që ka qenë duke proceduar penalisht rastin deri në atë moment, duke kërkuar prej tyre deklarimin e moskompetencës lëndore dhe marrjen e akteve procedurale të përpiluara gjatë hetimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

3. Prokurori në Prokurorinë e Posaçme kur vlerëson se nuk ka të dhëna për veprën penale, për të cilën kjo prokurori është kompetente, ia raporton këtë fakt Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Drejtuesi i

Prokurorisë së Posaçme njofton ose i referon aktet zyrës përkatëse të prokurorisë që do të vazhdojë procedurën, si dhe njofton çdo strukturë tjetër.

4. Çdo oficer i Policisë së Shtetit, agjent apo oficer i Policisë Gjyqësore ekzekuton urdhrat e prokurorit të Prokurorisë së Posaçme ose vendimet e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për kontrolle ose arrestime, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, kur urdhri parashikon se ekzekutimi duhet të kryhet prej tij. Ata përmbushin edhe çdo detyrë apo kërkesë tjetër ligjore të urdhëruar nga një prokuror posaçëm ose nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

Neni 30
Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, nëse ekziston dyshim për pastrimin e produkteve të veprës penale të referuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale:

a) informon Prokurorinë e Posaçme për mjete financiare, të ardhura ose pasuri, për të cilat ka marrë dijeni në çfarëdo mënyre kur këto janë fituar përmes kryerjes së një vepre penale të parashikuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale;

b) kërkon që subjektet e detyruara për zbatimin e masave kundër pastrimit të produkteve të veprës penale të japin të gjitha të dhënat lidhur me transaksionet e bëra nga personat e dyshuar dhe t'ia dërgojnë menjëherë këto të dhëna Prokurorisë së Posaçme.

2. Me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave vë në dispozicion të gjitha të dhënat që disponon mbi transaksionet e personave të dyshuar për pastrim të produkteve të veprës penale dhe kryen kontrollet e nevojshme për të vërtetuar ekzistencën e këtyre transaksioneve.

3. Inspektorët shtetërorë të autorizuar për sekuestrimin e përkohshëm të objekteve, instrumenteve ose pasurive të dyshuara i dorëzojnë Prokurorisë së Posaçme, së bashku me njoftimin, një raport mbi veprimet e kryera dhe transkriptin e vendimit për konfiskim apo sekuestrim.

KREU V
BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

Neni 31
Byroja Kombëtare e Hetimit

1. Byroja Kombëtare e Hetimit është një strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që vepron vetëm nën drejtimin e Prokurorisë së Posaçme. Drejtori, Zëvendësdrejtori dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore.

2. Organizimi i brendshëm i Byrosë Kombëtare të Hetimit rregullohet nga urdhri i përbashkët i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

3. Byroja Kombëtare e Hetimit përbëhet nga drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit dhe punonjësit e administratës. Ajo ka gjithashtu në përbërje të saj shërbime të Policisë Gjyqësore, të përbëra nga oficerë të Policisë Gjyqësore, nga Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera përkatëse, të cilët janë nën drejtimin administrativ të Zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nën varësi procedurale hetimore të Prokurorisë së Posaçme. Punonjësit e shërbimeve mund të qëndrojnë në mjediset e Byrosë Kombëtare të Hetimit, ato të Policisë së Shtetit apo ato të institucioneve përkatëse, sipas nevojave të përcaktuara nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

4. Organizimi dhe funksionimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit rregullohet në përputhje me këtë ligj dhe urdhrat e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 32
Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Kandidatët për punonjës në Byrosë Kombëtare të Hetimit, përfshi drejtorin, zëvendësdrejtorin, hetuesit, punonjësit dhe oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore duhet të përmbushin kushtet e sigurisë, të përcaktuara në nenin 6 dhe kreun VIII të këtij ligji. Një kandidat nuk mund të emërohet në Byronë Kombëtare të Hetimit apo në shërbimet e Policisë Gjyqësore pranë saj, pa përmbushur kriteret dhe pa iu nënshtruar kushteve të sigurisë.

2. Kandidatët për drejtor apo hetues pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kushtet e pikës 1, të këtij neni, dhe përpara emërimit

duhet të kenë përfunduar programin e nevojshëm të trajnimit.

3. Kandidatët për oficerë të Policisë Gjyqësore të shërbimeve, të cilët përmbushin kushtet e pikës 1, të këtij neni, brenda 2 muajve nga emërimi, duhet të kenë përfunduar programin e nevojshëm të trajnimit.

Neni 33
Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit është përgjegjës për funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

2. Komisioni i përbërë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë të posaçëm me më shumë vite eksperiencë pune si prokuror, pas një procesi rekrutimi të hapur dhe transparent, rekomandojnë një kandidat për Drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili emërohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Drejtori emërohet për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë.

3. Kandidatët për Drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kushtet e sigurisë të nenit 6 të këtij ligji. Një kandidat nuk mund të caktohet në detyrë si Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit pa përmbushur kushtet e sigurisë dhe kushtet e aftësive profesionale.

4. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, pas përfundimit të mandatit, gëzon të drejtën të kthehet në pozicionin e mëparshëm ose të emërohet në një pozicion të të njëjtit nivel, me një gradë që i korrespondon atij funksioni.

5. Drejtori mbikëqyret nga një komision i përbërë prej tre prokurorësh të Prokurorisë së Posaçme, njëri prej të cilëve është drejtuesi i saj dhe dy të tjerët zgjidhen çdo vit me short.

6. Drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përzgjedh nga radhët e hetuesve një zëvendësdrejtor. Zëvendësdrejtori vepron në emër të drejtorit në mungesë të tij.

7. Drejtori cakton hetues për të drejtuar sektorë brenda Byrosë Kombëtare të Hetimit, në përputhje me urdhrin e përbashkët të nxjerrë në bazë të nenit 31, pika 2, të këtij ligji.

Neni 34
Kriteret e emërimit të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Kandidati për Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushë të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 6, pika 3, të nenit

37, si dhe pikat 2 dhe 3, të nenit 38, të këtij ligji. Ai duhet të plotësojë me sukses kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit për Byronë Kombëtare të Hetimit.

2. Kandidati për Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit mund të jetë personi që ka vetëm shtetësi shqiptare, që gëzon cilësi të larta profesionale dhe morale, dhe që plotëson këto kritere:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë të barasvlershme me "Master i shkencave", ose arsimin e lartë policor;

b) ka eksperiencë pune si prokuror, punonjës i Policisë së Shtetit apo Policisë Gjyqësore ose hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit;

c) ka përvojë pune të paktën 5 vjet në çështje që kanë të bëjnë me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda;

ç) nëse ka qenë apo është punonjës i Policisë së Shtetit, të ketë mbajtur për jo më pak se 3 vjet gradën "Komisar", "Kryekomisar", "Drejtues" apo "Drejtues i Parë";

d) të mos jetë në hetim apo gjykim për një vepër penale, të mos ndodhet në kushtet e pazgjedhshmërisë në një funksion publik, sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar, si dhe të nënshkruajë formularin e vetëdeklarimit në zbatim të atij ligji;

dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në partitë politike të paktën gjatë dhjetë viteve të fundit përpara momentit të kandidimit;

e) ka marrë vlerësim maksimal për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral, nëse i është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme, sipas legjislacionit në fuqi;

ë) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e "shkarkimit nga detyra", ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e kandidimit;

f) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi inteligjent;

g) në periudhën 29.11.1944 - 2.7.1991 të mos ketë qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor,

Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike, denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme;

gj) të japë pëlqimin për t'iu nënshtruar testit të poligrafit. Informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit mbahet në konsideratë gjatë procesit të përzgjedhjes.

3. Procedura e përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit garanton kandidimin e hapur, konkurrimin e ndershëm midis shumë kandidatëve, vlerësimin objektiv të përmbushjes së kushteve dhe kritereve, transparencën dhe standardet e tjera të procesit të rregullt ligjor. Përmbushja e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë nen provohet me dokumentacionin shoqërues të kërkesës, të depozituar nga kandidati, si dhe informacioneve zyrtare të marra nga institucione të tjera publike, përfshirë edhe informacionet konfidenciale në lidhje me kandidatët.

Neni 35
Lirimi, shkarkimi ose pezullimi nga detyra i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit lirohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:

a) i përfundon mandati;

b) jep dorëheqjen;

c) mbush moshën e pensionit.

2. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kur:

a) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;

b) për shkelje të Kushtetutës apo për shkelje të rëndë të ligjit gjatë kryerjes së detyrës;

c) për shkelje të rënda dhe shumë të rënda të disiplinës gjatë ushtrimit të funksioneve;

ç) kur dalin fakte të reja që janë verifikuar dhe janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për emërim.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pezullon Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit nëse ai bëhet subjekt i një hetimi penal. Pezullimi vazhdon për aq kohë sa do të ekzistojnë shkaqet e tij.

Neni 35/1
Paga e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit
(shtuar me ligjin 47/2021, neni 4)

1. Paga e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune.

2. Paga bazë është e barabartë me pagën bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Shtesë për vështirësi pune llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme"

Neni 36
Zëvendësdrejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Zëvendësdrejtori është përgjegjës për funksionimin e shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Zëvendësdrejtori është përgjegjës për funksionimin e vazhdueshëm të Byrosë Kombëtare të Hetimit gjatë çdo mungese të drejtorit.

2. Zëvendësdrejtori është hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe ka të paktën 3 vjet eksperiencë pune në hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda, si dhe duhet të ketë treguar aftësi drejtuese.

3. Zëvendësdrejtori emërohet nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas një procesi të hapur dhe transparent të përzgjedhjes, me mandat 4-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Zëvendësdrejtori, pas mbarimit të mandatit, gëzon të drejtën të kthehet

në pozicionin e mëparshëm si hetues.

5. Zëvendësdrejtori raporton te Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

6. Zëvendësdrejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kur:

a) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;

b) për shkelje të Kushtetutës apo për shkelje të rëndë të ligjit gjatë kryerjes së detyrës;

c) për shkelje të rënda dhe shumë të rënda të disiplinës gjatë ushtrimit të funksioneve;

ç) kur dalin fakte të reja që janë verifikuar dhe janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për emërimin e tij.

7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimin e përbashkët të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, pezullon Zëvendësdrejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit nëse ai bëhet subjekt i një hetimi penal. Pezullimi vazhdon për aq kohë sa do të ekzistojnë shkaqet e tij.

Neni 36/1
Paga e zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit
(shtuar me ligjin 47/2021, neni 5)

1. Paga e zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune.

2. Paga bazë është e barabartë me 80 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Shtesa për vështirësi pune llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme."

Neni 37
Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Hetuesi është punonjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili është përgjegjës për hetimin.

Ai gëzon statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore dhe kryen hetime vetëm nën drejtimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme.

2. Kandidati për hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit përzgjidhet pas një procesi rekrutimi, që mbështetet në praktikat më të mira të rekrutimeve konkurruese, të cilat parashikohen në një rregullore të hartuar dhe miratuar nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

3. Një kandidat mund të emërohet si hetues vetëm pasi të ketë përfunduar trajnimin përkatës dhe të ketë shfaqur aftësitë, që garantojnë kryerjen e detyrave sipas standardeve të kërkuara profesionale, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

4. Emërimi i hetuesit në Byronë Kombëtare të Hetimit bëhet nga drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

5. Hetuesi caktohet nga Drejtori i Byronë Kombëtare të Hetimit ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme që të punojë me një prokuror të Prokurorisë së Posaçme. Hetuesi nuk mund të caktohet në një detyrë tjetër pa pëlqimin e prokurorit të posaçëm apo të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 38
Kriteret për emërimin dhe largimin e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Kandidati për hetues në Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të plotësojë këto kritere:

a) është shtetas shqiptar;

b) ka arsim të lartë policor, në drejtësi apo kontabilitet, ose arsim të lartë në degë të tjera që kanë lidhje me misionin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, nga një universitet vendas apo i huaj;

c) ka një përvojë më shumë se 1-vjeçare pune në institucionet e zbatimit të ligjit ose në një fushë tjetër që lidhet me qëllimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit;

ç) të ketë plotësuar me sukses kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit për

Byronë Kombëtare të Hetimit.

2. Të gjithë kandidatët për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të kryejnë me sukses të gjitha fazat e mëposhtme të përzgjedhjes:

a) plotësimin e një aplikimi *online*, përfshirë një *curriculum vitae* elektronike dhe dokumentet mbështetëse, si dhe një deklaratë me shkrim mbi motivimin për t'u bërë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit;

b) një provim me shkrim e me gojë, ku përfshihen teste konjitive, të sjelljes dhe të arsyetimit logjik;

c) një provim të zgjeruar me shkrim që mat aftësitë e shkrimit të raporteve, si dhe nivelin e shkrimit e leximit;

ç) një intervistë nga një komision që mat aftësitë e komunikimit verbal, si dhe aftësinë për t'i komunikuar idetë me efiçencë;

d) një testim të aftësive fizike që mat forcën dhe rezistencën fizike;

dh) një hetim mbi verifikimin e figurës, i cili konfirmon se personi nuk është dënuar e nuk është shpallur më parë fajtor për vepra penale; dhe

e) të ketë dhënë pëlqimin për t'iu nënshtruar testit të poligrafit rreth integritetit të kandidatit. Informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit merret në konsideratë gjatë procesit të emërimit dhe atij të riemërimit.

3. Kandidati i pranuar i nënshtrohet një regjimi rigoroz trajnimi dhe arsimimi, me një sërë modulesh vlerësimi që duhen kaluar përpara se të certifikohet. Pasi është certifikuar si i trajnuar dhe i aftë, kandidati konsiderohet hetues.

4. Kursi i trajnimit dhe arsimimit, standardet profesionale dhe sistemet e vlerësimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit miratohen nga drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

5. Procedurat për shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe llojet e masave disiplinore përcaktohen në këtë ligj, si edhe në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

6. Të gjithë hetuesit janë të detyruar të marrin një notë kaluese në secilin prej testeve të përmendura në pikën 2, shkronjat "b" dhe "d", të këtij neni, si parakusht për t'iu rinovuar emërimi i tyre çdo dy vjet. Të gjithë hetuesit japin pëlqimin për t'iu nënshtruar një testi të poligrafit

rreth integritetit çdo dy vjet. Informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit merret në konsideratë gjatë procesit të riemërimit.

Neni 38/1
Paga e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit
(shtuar me ligjin 47/2021, neni 6)

1. Paga e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune.

2. Paga bazë është e barabartë me 60 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Shtesa për vështirësi pune llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.".

Neni 39
Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj shërbime të Policisë Gjyqësore. Qëllimi i tyre është të rrisin bashkëpunimin dhe komunikimin midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe institucioneve të tjera, si dhe të ndihmojnë në hetimet e Prokurorisë së Posaçme, që kryhen nga institucione të tjera.

2. Oficerët nga shërbimet e Policisë Gjyqësore konkurrojnë për të punuar pranë shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit për një periudhë pesëvjeçare. Gjatë këtij mandati, ata paguhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit, raportojnë tek zëvendësdrejtori dhe do të vlerësohen nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ata janë të pavarur prej institucionit të tyre dhe vendosen nën varësinë procedurale hetimore të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Në përfundim të këtij mandati, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dërgon vlerësimet tek institucioni prej të cilit ka ardhur oficeri i Policisë Gjyqësore. Oficeri i shërbimeve të Policisë Gjyqësore gëzon të drejtën të kthehet në pozicionin e mëparshëm ose të emërohet në një pozicion të të njëjtit nivel, me një gradë që i korrespondon atij funksioni.

3. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas nevojave, me pëlqimin e

Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përcakton numrin e pozicioneve të lira dhe kualifikimet për punonjësit e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Byroja Kombëtare e Hetimit organizon një proces aplikimi të hapur dhe transparent, në përputhje me nenin 7, të këtij ligji, për punonjësit e kualifikuar të drejtorive të Policisë së Shtetit, përgjegjëse për hetimin e krimit të organizuar, krimit ekonomik, trafikimit të narkotikëve, si dhe sektorëve të tjerë përkatës, si dhe institucioneve të tjera përkatëse me funksione të Policisë Gjyqësore. Shpallja e pozicionit të lirë përmban njoftimin se oficerët për në shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 6 dhe kreun VIII të këtij ligji. Aplikanti duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenin 6 dhe kreun VIII, përpara se ai të caktohet apo emërohet pranë shërbimeve të Policisë Gjyqësore.

4. Oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore qëndrojnë në zyrat e institucioneve nga ku ata kanë ardhur ose në zyrat e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit vendos për vendin se ku ata qëndrojnë.

5. Kur drejtori apo Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme e konsiderojnë të nevojshme, Byroja Kombëtare e Hetimit cakton hetues nga zyra e saj të vendosen pranë zyrave të Policisë së Shtetit ose institucioneve të tjera. Policia e Shtetit ose institucionet e tjera marrin përsipër të zbatojnë këtë vendim.

Neni 39/1
Paga e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore
(shtuar me ligjin 47/2021, neni 7)

1. Paga e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune

2. Paga bazë është e barabartë me 60 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Shtesa për vështirësi pune llogaritet në masën 50 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.”.

Neni 40
Statusi i Policisë Gjyqësore

1. Drejtori, Zëvendësdrejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore janë oficerë të Policisë Gjyqësore. Në ushtrimin e funksioneve të tyre drejtohen dhe kontrollohen nga prokurorët e posaçëm.

2. Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve punojnë dhe komunikojnë drejtpërsëdrejti me prokurorët e posaçëm.

3. Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit ruajnë sekretin e hetimeve penale, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 40/1
Trajtimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit
(shtuar me ligjin 47/2021, neni 8)

1. Drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përfitojnë të njëjtin trajtim që përfitojnë punonjësit e Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.

2. Trajtimi i punonjësve, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin të drejtën e pushimit vjetor dhe pushimeve të tjera të pagueshme, lejen pa të drejtë page, trajtimin financiar gjatë qëndrimit në punë, të drejtën për sigurim shëndetësor të veçantë, të drejtën për përfitim të kredisë me interesa të buta, kompensimin për strehim, sigurimin e jetës, mbrojtjen e veçantë, si dhe trajtimin e familjarëve të punonjësve që humbasin jetën për shkak të detyrës.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat, procedurat dhe kriteret për trajtimin e punonjësve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, me të njëjtin trajtim që përfitojnë punonjësit e Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.".

Neni 41
Largimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, pas përfundimit të trajnimit të nevojshëm dhe emërimit në detyrë, shërben për një periudhë jo më pak se shtatë vjet në Byronë Kombëtare të Hetimit, përveç rasteve kur ai shkarkohet sipas parashikimeve të këtij neni.

2. Punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nëse:

a) është dënuar për një vepër penale nga një gjykatë penale në Shqipëri apo në ndonjë vend tjetër;

b) është vlerësuar nga një komision mjekësh ekspertë si i paaftë nga ana shëndetësore për të qenë anëtar i Byrosë Kombëtare të Hetimit për të përmbushur detyrat dhe funksionet e parashikuara nga ky ligj;

c) në përfundim të një procedure disiplinore, e cila e ka gjetur punonjësin e Byrosë Kombëtare të Hetimit në shkelje të rregullave të zbatueshme të sjelljes profesionale në më shumë se tri raste, dhe ai vlerësohet si i papërshtatshëm profesionalisht për të ushtruar detyrat e tij;

ç) punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet edhe kur dalin dhe vërtetohen fakte të reja, të panjohura më parë, të cilat kanë lidhje me arsimimin, kualifikimet apo besueshmërinë e punonjësit, ose të cilat kanë lidhje dhe janë në mospërputhje me kriteret për emërimin e tij.

Neni 42
Oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen

1. Oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen është një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit me të paktën pesë vite përvojë si oficer i Policisë Gjyqësore.

2. Dy hetues emërohen me short për një mandat gjashtëmujor si oficer përgjegjës për monitorimin. Ky mandat nuk mund të përsëritet dy herë brenda një viti. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, në prani të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bën përzgjedhjen me short.

3. Një oficer përgjegjës, sipas pikës 2, të këtij neni, kryen vëzhgimin periodik të telekomunikimeve të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit dhe hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore, si dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Oficeri përgjegjës nuk ka përgjegjësi të tjera hetimore apo administrative.

4. Oficeri tjetër përgjegjës, sipas pikës 2, të këtij neni, kontrollon vëzhgimin periodik të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, sipas nenit 50, të këtij ligji. Oficeri përgjegjës ushtron gjithashtu edhe funksionin e ndërlidhësit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

5. Çdo muaj, një prokuror i posaçëm përzgjidhet me short për të shërbyer si prokuror i posaçëm i gatshëm. Prokurori i posaçëm i gatshëm drejton, kontrollon dhe monitoron oficerin përgjegjës në detyrë. Oficeri përgjegjës raporton çdo informacion që ngre dyshime të arsyeshme për veprimtari korruptive apo kriminale te prokurori i posaçëm i gatshëm. Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se prokurori i posaçëm është i përfshirë në veprimtarinë kriminale, atëherë oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë.

6. Oficeri përgjegjës, sipas pikës 3, të këtij neni, bën monitorim periodik të telekomunikimeve të pjesëtarëve të afërt të familjeve të personave të listuar në pikën 3 vetëm nëse:

a) ekziston dyshim i arsyeshëm se telefoni është përdorur nga personat e listuar në pikën 3 për të shmangur monitorimin periodik, apo për të shërbyer si ndërmjetës për njërin nga personat e listuar në pikën 3 të këtij neni;

b) monitorimi bëhet ndaj anëtarëve të afërt të familjes, të cilët kanë dhënë pëlqimin për monitorimin periodik, por jo ndaj anëtarëve të familjes nën 18 vjeç;

c) brenda 24 orëve përgatit një raport me shkrim që shpjegon bazat e dyshimit të arsyetuar dhe rezultatet e monitorimit të anëtarit të afërt të familjes dhe ia paraqet prokurorit të posaçëm të gatshëm. Nëse ai prokuror i posaçëm duket si i përfshirë në një veprimtari kriminale, atëherë, brenda 24 orëve, oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm pranë Prokurorisë së Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë;

ç) prokurori i posaçëm autorizon me shkrim vazhdimin e monitorimit të telefonit të pjesëtarit të afërt të familjes, nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm se telefoni është përdorur nga personat e listuar në pikën 3 për të shmangur monitorimin periodik, apo për të shërbyer si ndërmjetës për njërin nga personat e listuar në pikën 3 të këtij neni.

7. Oficeri përgjegjës, sipas pikës 3, të këtij neni, informon prokurorin e

posaçëm të gatshëm rreth informacionit që do të shërbejë si bazë për të arsyetuar një autorizim të gjykatës për përgjim.

8. Oficeri përgjegjës, sipas pikës 3, të këtij neni, ruan për një periudhë gjashtëmujore regjistra të telekomunikimeve, të cilat ngrenë dyshime të arsyeshme për veprimtari të papërshtatshme apo kriminale, por të gjitha regjistrimet apo shënimet e tjera i shkatërron brenda 3 ditëve. Një prokuror i posaçëm urdhëron me shkrim, ose gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar merr vendim me shkrim për ruajtjen e regjistrimeve që mund të ngrenë një dyshim të arsyeshëm për një aktivitet të papërshtatshëm ose kriminal.

9. Oficeri përgjegjës raporton shkelje të etikës së gjyqtarëve apo prokurorëve tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Neni 43
Marrëdhëniet e Byrosë Kombëtare të Hetimit me struktura të tjera policore

1. Drejtori është i autorizuar të firmosë marrëveshje me struktura të tjera policore për të përmirësuar efiçencën, kapacitetin operacional dhe shkëmbimin e informacionit.

2. Byroja Kombëtare e Hetimit bashkëpunon me Policinë e Shtetit, Shërbimin Informativ Shtetëror, Policinë Kufitare, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të gjitha institucionet e tjera përkatëse shtetërore për të realizuar në mënyrë të plotë dhe efektive ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Byroja Kombëtare e Hetimit ka akses në informacionin që përmbajnë bazat e të dhënave, përfshirë Sistemin e Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS).

4. Byroja Kombëtare e Hetimit është institucioni që ekzekuton urdhrat për përgjim të kërkuar nga Prokuroria e Posaçme dhe të autorizuara nga gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe ushtron detyra të tjera të parashikuara në pikat 3 dhe 6, të nenit 42, të këtij ligji, si dhe ka kapacitetet e veta për t'i kryer detyrat si më sipër.

KREU VI

PUNONJËSIT E GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE ORGANEVE TË SPECIALIZUARA TË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Neni 44
Statusi i punonjësve të shërbimit civil
(ndryshuar pika 2, me ligjin 47/2021, neni 9)

1. Punonjësit e administratës gjyqësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar u nënshtrohen dispozitave përkatëse të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Punonjësit e administratës së prokurorisë pranë Prokurorisë së Posaçme dhe punonjësit e administratës së Byrosë Kombëtare të Hetimit u nënshtrohen dispozitave përkatëse të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 44/1
Shpërblimi për vështirësi pune
(shtuar me ligjin 47/2021, neni 10)

1. Nëpunësi civil gjyqësor në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar përfiton shtesë për vështirësi pune në masën 50 për qind të pagës përkatëse.

2. Nëpunësi civil në prokurorinë e posaçme dhe në Byronë Kombëtare të Hetimit përfiton shtesë për vështirësi pune në masën 50 për qind të pagës përkatëse. Kanë të drejtë të përfitojnë shtesë për vështirësi pune në masën 50 për qind të pagës përkatëse edhe punonjësit e tjerë të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit, që duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit, sipas nenit 6 të këtij ligji."

Neni 45
Standardet e sjelljes së punonjësve

Punonjësit e administratës gjyqësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, punonjësit e administratës të Prokurorisë së Posaçme dhe punonjësit e administratës të Byrosë Kombëtare të Hetimit

u nënshtrohen këtyre kushteve të posaçme:

1. Janë të detyruar të bëjnë deklarim financiar vjetor në Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesave. Mosdeklarimi ose deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

2. Janë të detyruar t'i dorëzojnë oficerit përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit deklaratën sipas shtojcës A. Punonjësit kanë detyrimin e vazhdueshëm të përditësojnë deklaratën, sipas nevojës dhe të deklarojnë çdo konflikt interesi te kancelari, te gjyqtari apo te prokurori përkatës. Mosdorëzimi apo mospërditësimi i deklaratës apo deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

3. Kanë detyrimin e vazhdueshëm t'i deklarojnë drejtorit apo oficerit përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme çdo kontakt me persona, të cilët i kanosin, u ofrojnë ryshfet apo para për të marrë informacion ose në këmbim të veprimeve që kanë lidhje me një hetim apo çështje të zyrës. Mosdeklarimi i këtyre kontakteve ose deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

4. Kanë detyrimin e vazhdueshëm të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin e dëshmitarëve, provave, dokumenteve dhe të çdo informacioni tjetër në lidhje me hetimet e zyrës, me përjashtim të rasteve kur këto informacione janë bërë publike në përputhje me ligjin. Shkelja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

KREU VII
SIGURIA E MJEDISEVE DHE PERSONELIT

Neni 46
Siguria e mjediseve

1. Policia e Shtetit garanton në mënyrë të vazhdueshme sigurinë e mjediseve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Shërbimet e sigurisë të Policisë së Shtetit kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit të gjykatës përkatëse kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, respektivisht.

2. Rregullat e hollësishme mbi procedurat në lidhje me garantimin e sigurisë së këtyre institucioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47
Siguria e personelit

1. Në zbatim të dispozitave përkatëse të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit u sigurohet mbrojtja personale sipas kërkesës, si më poshtë:

a) kryetarët e gjykatave, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit mbrohen me shoqërim, me oficer e nënoficer;

b) gjyqtarët dhe prokurorët me shoqërim, me oficer.

2. Nëse kërkohet përkatësisht nga kryetari i gjykatës apo Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sigurohet mbrojtje për anëtarët e familjes, banesat dhe/ose eskortë për gjyqtarët dhe prokurorët.

3. Drejtorit, Zëvendësdrejtorit apo hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, për shkak të apo gjatë ushtrimit të detyrës, u sigurohet mbrojtje personale e jetës, shëndetit dhe pronës, nëse kërkohet nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

4. Rregullat e detajuara mbi procedurat e sigurisë, sipas kësaj dispozite, parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Oficerët e caktuar për sigurinë e gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, familjeve dhe banesave të tyre nuk zëvendësohen pa marrë paraprakisht miratimin e kryetarit të gjykatës, Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme apo Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

KREU VIII
KUSHTET E SIGURISË PËR BESIMIN DHE KONFIDENCIALITETIN

Neni 48
Heqja dorë nga të drejtat si kusht për caktimin në detyrë, emërimin dhe aksesin në informacion

1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në

gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen.

2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet.

3. Pas caktimit në detyrë apo punësimit, gjyqtarët dhe pozicionet e tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorët dhe pozicionet e tjera në Prokurorinë e Posaçme, drejtori, zëvendësdrejtori, hetues, oficerë të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit kanë nga një telefon celular, adresë poste elektronike dhe numër telefoni të dhënë nga gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar apo organet e strukturës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe bien dakord të përdorin vetëm ato numra telefoni dhe adresa poste elektronike. Ata nuk lejohen të përdorin asnjë formë tjetër komunikimi elektronik. Numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike i nënshtrohen kontrollit periodik nga oficeri përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

4. Gjyqtarët dhe pozicionet e tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorët dhe pozicionet e tjera në Prokurorinë e Posaçme, drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratën mbi llogaritë e tyre financiare, si dhe ato të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre, të dhënë në shtojcën C të këtij ligji. Deklarata dorëzohet tek oficeri përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Llogaritë financiare i nënshtrohen kontrollit periodik nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Të gjitha llogaritë e reja deklarohen brenda 3 ditëve.

Neni 49
Kontrolli periodik

1. Llogaritë financiare të kryetarëve të gjykatave, të gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë

së Posaçme, të drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si edhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre vëzhgohen në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 50 të këtij ligji. Telekomunikimet e kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve, drejtuesit, prokurorëve, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit mbikëqyren në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 51 të këtij ligji.

2. Oficeri përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave bashkërendojnë veprimtaritë e tyre dhe takohen, sipas nevojës, por jo më rrallë se një herë në muaj, për të diskutuar mbi veprimtari të dyshimta.

3. Oficeri përgjegjës i raporton prokurorit të posaçëm të gatshëm çdo informacion që mbështet një dyshim të arsyeshëm për korrupsion apo veprimtari kriminale. Nëse prokurori i posaçëm duket i përfshirë në veprimtarinë kriminale, atëherë oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë.

Neni 50
Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave cakton një punonjës të saj, në konsultim me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, për të mbikëqyrur llogaritë financiare të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre. Ky person është përgjegjës për kallëzimin e çdo vepre penale të mundshme dhe ka atributet e Policisë Gjyqësore. Ky pozicion i kalon një punonjësi tjetër me rotacion çdo dy vjet. Oficeri përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave mbikëqyret nga oficeri përgjegjës, sipas pikës 4, të nenit 42, të këtij ligji. Oficeri përgjegjës nuk ka përgjegjësi të tjera.

2. Oficeri përgjegjës kryen ruajtjen e të dhënave për gjashtë muaj dhe, në rast se nuk urdhërohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme t'i ruajë të dhënat për më gjatë, i shkatërron ato pas muajit të gjashtë. Ky person

është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës.

3. Oficeri përgjegjës shqyrton çdo muaj llogaritë financiare të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre.

4. Oficeri përgjegjës ka akses te deklarimet e pasurive dhe të lidhjeve, të bëra prej kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai ka edhe bashkëpunimin e Shërbimit Informativ Shtetëror.

5. Oficeri përgjegjës i raporton prokurorit të posaçëm të gatshëm çdo informacion që mbështet një dyshim të arsyeshëm lidhur me indiciet e mëposhtme. Nëse prokurori i posaçëm duket i përfshirë në veprimtarinë kriminale, atëherë oficeri përgjegjës i raporton cilitdo prej prokurorëve të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme, i cili duket se nuk është i përfshirë në veprimtarinë e dyshimtë:

a) transaksione të mëdha financiare;

b) modele të pazakonta transaksionesh financiare;

c) transaksione financiare nga burime të pazakonta apo kriminale;

ç) ekzistencë llogarish financiare, të cilat nuk janë deklaruar.

Neni 51
Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit

1. Oficeri përgjegjës në Byronë Kombëtare të Hetimit krijon një plan për shqyrtimin çdo muaj të komunikimeve telefonike, mesazheve apo postës elektronike të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, dhe të drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ky plan nuk u bëhet i ditur kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prokurorëve

të posaçëm, Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit apo kujtdo tjetër. Plani ndryshohet çdo tre muaj.

2. Oficeri përgjegjës ka akses në deklarimet e pasurive dhe të lidhjeve, të bëra prej kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai bashkëpunon edhe me Shërbimin Informativ Shtetëror.

3. Oficeri përgjegjës, nëse ka dyshim të arsyeshëm se një telefonatë, mesazh apo komunikim me postë elektronike është provë e korrupsionit, nxjerrjes së informacionit, komunikimit me organizata kriminale, ndikimit politik apo çfarëdo veprimi tjetër që mund të jetë në shkelje të Kodit Penal, ai ia raporton atë një prokurori të posaçëm të Prokurorisë së Posaçme, i cili nuk është i përfshirë në shkelje.

4. Oficeri përgjegjës i ruan të dhënat për 2 muaj dhe, në rast se nuk urdhërohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme t'i ruajë të dhënat për më gjatë, i shkatërron ato pas muajit të dytë. Ky person është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës.

5. Oficeri përgjegjës nuk dëgjon telefonatat që shkelin të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin. Nëse oficeri përgjegjës ka dyshim të arsyeshëm se ka ndodhur apo do të ndodhë një vepër penale dhe se vëzhgimi i asaj telefonate me persona që nuk kanë dhënë miratim paraprak do të japë prova për këtë vepër penale, ai do të kontaktojë menjëherë një prokuror të posaçëm të papërfshirë në shkelje për të marrë autorizim nga gjykata.

Neni 52
Mbrojtja e të dhënave

Të dhënat personale ruhen dhe përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 53
Raportimi i informacionit dhe provave

1. Çdo person, përfshirë oficerët përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, kanë të drejtën të raportojnë informacion apo prova të një shkeljeje të kryer nga një kryetar ose gjyqtar i gjykatave kundër korrupsionit

dhe krimit të organizuar, prokuror i Prokurorisë së Posaçme, drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer i shërbimeve të Policisë Gjyqësore ose pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose nga një punonjës te një prokuror i Prokurorisë së Posaçme, i cili nuk është i përfshirë në shkelje.

2. Bazuar në një raport, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, një prokuror i Prokurorisë së Posaçme nis një hetim kundër kryetarit ose secilit gjyqtar të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesit ose prokurorit të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose punonjësve, pa kërkuar miratim nga ndonjë autoritet tjetër.

Neni 54
Shkarkimi për shkeljen e kushteve të besimit dhe konfidencialitetit

1. Kur ka prova se një kryetar ose një gjyqtar i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, një drejtues ose prokuror i Prokurorisë së Posaçme ka nxjerrë informacion sensitiv, qoftë nga pakujdesia apo me qëllim, ai person mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

2. Kur ka prova se një punonjës i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokurorisë së Posaçme, ose drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore ose punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit ka nxjerrë informacion sensitiv, qoftë nga pakujdesia apo me qëllim, ai person mund të shkarkohet.

Neni 55
Aktet nënligjore

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit hartojnë dhe miratojnë aktet nënligjore në përputhje me këtë ligj brenda dy muajve nga momenti i krijimit dhe funksionimit të këtyre strukturave.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 46, dhe pikës 4, të nenit 47, të këtij ligji.

KREU IX
BUXHETI

Neni 56
Buxheti për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

1. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka një buxhet të pavarur që është pjesë e buxhetit të shtetit dhe parashikohet në një zë të veçantë të tij.

2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme harton projektbuxhetin e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

3. Buxheti i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në të cilin përfshihet buxheti i Prokurorisë së Posaçme, buxheti i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe buxheti i shërbimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, hartohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin përkatës të menaxhimit buxhetor e financiar.

4. Në rastin kur propozimi i projektbuxhetit të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nga Këshilli i Ministrave është i ndryshëm nga projektbuxheti i propozuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ky i fundit ka të drejtë të marrë pjesë në procedurat parlamentare për të mbrojtur projektbuxhetin e propozuar.

5. Në buxhetin e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mund të përfshihen edhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfshirë fonde nga donatorë ndërkombëtarë, të cilët nuk janë në konflikt interesi me veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

6. Fondet e marra në përputhje me pikën 5, të këtij neni, duhet të përdoren në përputhje me marrëveshjet e lidhura me donatorin ndërkombëtar dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

KREU X
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 57
Dispozita kalimtare
(shfuqizuar pikat 6,7,8 me ligjin nr. 35/2017; shtuar pika 14, me ligjin 47/2021, neni 11)

1. Dispozitat kalimtare për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda parashikohen në zbatim të dispozitave përkatëse të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Dispozitat kalimtare për prokurorët e Prokurorisë për Krimet e Rënda parashikohen në zbatim të dispozitave përkatëse të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme vendosen në ndërtesën aktuale të Gjykatës për Krimet e Rënda dhe Prokurorisë për Krimet e Rënda.

4. Byrosë Kombëtare të Hetimit i sigurohet një mjedis i përshtatshëm pune dhe pajiset brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Deri në fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e saj për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale apo subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, ushtrohet përkatësisht nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas kompetencës dhe juridiksionit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar". Ditën e fillimit të funksionit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet nën hetim apo gjykim i transferohen menjëherë për ndjekje kësaj prokurorie.

6.Shfuqizuar.

7. Shfuqizuar.

8. Shfuqizuar.

9. Një komision i përbërë nga ekspertë të drejtësisë penale, të caktuar nga misionet e Bashkimit Europian dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, do të japë udhëzime dhe këshilla për themelimin

dhe zhvillimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, për një periudhë 2-vjeçare, duke nisur nga momenti i themelimit të kësaj Byroje. Komisioni i Pavarur i Rishikimit vëzhgon në mënyrë aktive procesin e rekrutimit dhe trajnimit të punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe miraton materialet e trajnimit të hetuesve dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

10. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka buxhet fillestar të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të miratuar me ligj të posaçëm për buxhetin. Të gjitha buxhetet e mëvonshme përcaktohen në përputhje me nenin 56 të këtij ligji.

11. Përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në pikën 6, të nenit 6, dhe pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, për një periudhë 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, si dhe familjarëve të afërt të tyre, bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, dhe ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të funksionarëve të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë". Një gjyqtar apo prokuror, që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, konsiderohet se e përmbush kushtin e sigurisë, të parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji. Vetëm pas kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit, me vendim përfundimtar, ata mund të kualifikohen për t'u përzgjedhur si gjyqtar në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

12. Përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në pikën 5, të nenit 6, për një periudhë 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, rolin e Komisionit të Posaçëm lidhur me verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme, për Drejtor dhe për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe familjarët e afërm të tyre, e luan Komisioni i Posaçëm i përbërë nga:

a) dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, të zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit; dhe

b) një gjyqtar të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit.

13. Komisioni i Posaçëm, i ngritur sipas pikës 12, të këtij neni, e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të pikës 6, të nenit 6, dhe nenit 7 të këtij ligji.

14. Drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerët nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, punonjësit e sektorit të hetimit financiar, si dhe punonjësit e bërthamës komanduese elektronike përfitojnë pagën, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nga data e emërimit të tyre në detyrë

Neni 58
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miratuar në datën 6.10.2016

ANEKSI A
DEKLARATA PËR KONTROLLIN E FIGURËS

Ky dokument pranohet vetëm nëse:

- Është plotësuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, në dorëshkrim, me shkronja kapitale dhe pa korrigjime
- Nuk ka rubrika të paplotësuara, ose vendoset shënimi " nuk aplikohet" në rastet e nevojshme;
- Subjekti i rivlerësimit shkruan emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin në vendin e caktuar në fund te çdo faqeje;

PJESA 1
Subjekti i rivlerësimit

A. Të dhënat aktuale identifikuese

Emri	
Emri i babait	
Mbiemri	
Gjinia	
Data/muaji/viti i lindjes	
Vendi i lindjes	
Shteti i lindjes	
Shtetësia	
Numri personal si shënohet në kartën e identitetit	

B. Të dhëna identifikuese të përdorura më parë

Emri		
Emri i babait		
Mbiemri		

Gjinia		
Data/muaji/ viti i lindjes		
Vendi i lindjes		
Shteti i lindjes		
Shtetësia		
Numri personal si shënohet në kartën e identitetit		

C. Statusi Civil

i/e pamartuar	i/e martuar	i/e divorcuar	i/e ve	Bashkëjetues/e

Ç. Pasaporta dhe karta e identitetit:

	Numri i dokumentit	Data e lëshimit			Data e skadimit			Vendi i lëshimit	Autoriteti lëshues
		data	muaji	viti	data	muaji	viti		
Passport									
ID Identity Card									

D. A keni adresë e-mail?

Jo □

Po □» Jepni adresën zyrtare të e-mailit, e cila do të përdoret për qëllim njoftimi gjatë procesit;
Ju lutem jepni të gjithë adresat e tjera alternative të e-mailit;

DH. A keni numër telefoni fiks?

Jo □

Po □» Jepni numrin e telefonit së bashku me prefiksin;

E. **Numri/at e celularit që përdorni:**

PJESA 2
Të dhëna për vendin e banimit

A. Jepni informacion të saktë mbi adresën/at tuaja:

- Jepni adresën e plotë të vendbanimit aktual:

- A keni adresë tjetër vendbanimi? (adresë postare etj.)

Jo □

Po □» Jepni detaje

Adresa:

B. **Historiku i adresave tuaja të banimit, e fundit duke filluar nga 1.1.2012 (sipas rendit kronologjik):**

Përfshihen:

- Adresat tuaja brenda apo jashtë Shqipërisë;
- Adresat e vendeve në të cilat keni jetuar për arsye studimesh/ pune;
- Adresa të tjera tek të cilat keni jetuar përkohësisht;

Vendosni të gjithë historikun tuaj të adresave pa lënë periudha kohore boshe:

Data e fillimit		Data e largimit		Adresa e plotë (nr. i shtëpisë, emri i rrugës, qyteti, rrethi, qarku, njësia bashkiake, kodi postar)	Vendi/shteti
Muaji	Viti	Muaji	Viti		
_/_		Aktualisht			
_/_		_/_			
_/_		_/_			
_/_		_/_			
_/_		_/_			

PJESA 3
Të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet

A. Jepni detaje për arsimimin dhe të gjitha kualifikimet e kryera duke filluar nga shkolla e mesme:

Edukimi apo kualifikimet përfshijnë:

- shkollën e mesme

- shkollat verore

- specializimet, trajnimet e ndryshme

- kualifikimet e aftësisë

- teza/kërkime pasuniversitare

Data e fillimit		Data e përfundimit		Emri i plotë i institucionit ku keni ndjekur studimet (nuk lejohet përdorimi i shkurtimeve)	Titulli i fituar apo teza e mbrojtur	Gjendja	Adresa e plotë e institucionit	Vendi/ shteti
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
___/___		Aktualisht				□ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë		
___/___		___/___				□ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë		
___/___		___/___				□ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë		
___/___		___/___				□ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë		

PJESA 4
Të dhëna për punësimin

A. Jepni detaje për punësimin dhe për periudhën e papunësisë gjatë duke filluar nga 1.1.2012 pa lënë hapësira kohore të papërfshira:

Periudha punësimit përfshin:

Periudha e papunësisë përfshin:

- Të gjithë periudhën e paguar të punësimit

- Të gjitha hapësirat apo pauzat ndërmjet punësimit

- Vetëpunësimit/biznesit familjar, personal

- Interships

- Punë të papagueshme/vullnetare

Nëse nuk keni punuar asnjëherë shkruani "Nuk Aplikohet"

Data e fillimit		Data e përfundimit		Institucioni/ Operatori Ekonomik	Funksioni	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja e largimit
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
____/_____		Aktualisht						
____/_____		____/_____						
____/_____		____/_____						
____/_____		____/_____						
____/_____		____/_____						
____/_____		____/_____						

PJESA 5

Të dhëna rreth familjarëve dhe personave të afërt:

A. Emri i plotë i bashkëshortit/ bashkëshortes, Datëlindja, Vendlindja, Adresa aktuale, Punësimi aktual.

Emri	Datëlindja	Vendlindja	Adresa Aktuale	Punësimi Aktual

B. Fëmijët: Emrat e plotë, Datëlindjet, Vendlindjet, Adresat aktuale, Punësimi aktual.

Emri	Datëlindja	Vendlindja	Adresa Aktuale	Punësimi Aktual

C. Babai: Emri i plotë, Datëlindja, Vendlindja, Adresa aktuale, Punësimi aktual.

Emri	Datëlindja	Vendlindja	Adresa Aktuale	Punësimi Aktual

Ç. Nëna: Emri i plotë, Datëlindja, Vendlindja, Adresa aktuale, Punësimi aktual.

Emri	Datëlindja	Vendlindja	Adresa Aktuale	Punësimi Aktual

D. Të afërmit (vëllezërit, motrat, të afërm si rrjedhojë e lidhjeve martesore, nipër/ mbesa, gjyshërit, teze/ halla, dajë/ xhaxhai, kushërinj të parë, kushërinj të dytë): Emri i plotë, Datëlindja, Vendlindja, Adresa aktuale, Punësimi aktual.

Emri	Datëlindja	Vendlindja	Adresa Aktuale	Punësimi Aktual

PJESA 6
Të dhëna për sigurinë:

A. A jeni apo keni qenë të përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?

Po □ Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

B. A keni dijeni se një nga anëtarët e familjes tuaj është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?

Po □ Jo □

C. Nëse po, ju lutem jepni të dhënat e identitetit të familjarit tuaj, lidhjen tuaj familjare dhe të dhëna për veprat penale për të cilat është hetuar ose/dhe akuzuar, gjatë 10 viteve të fundit, nëse afate të tjera nuk janë parashikuar në ligjin për dekriminalizimin;

Me termin "familjar" do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë, personi i lidhur me detyrime birësimi ose që bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët;

Ç. A keni qenë ndonjëherë i ndaluar, i arrestuar, i dënuar për shkelje ligjore brenda ose jashtë shtetit?

Po □ Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime:

D. A keni pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një telefonatë, telekomunikim, takime, aktiviteti, vakti ose raste të tjera, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës?

Po □ Jo □

Nëse po, ju lutem jepni të dhënat e identitetit të personit, lidhjen tuaj me të dhe të dhëna për veprat penale për të cilat është hetuar ose/dhe akuzuar.

DH. Rendisni më poshtë takime, marrëdhënie ose kontakte të papërshtatshme me persona, të cilët në dijeninë tuaj, kanë qenë ose janë të arrestuar, të dënuar, apo të akuzuar publikisht për përfshirje në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës suaj të cilat nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës?

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

E. A keni pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar?

Po □ Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

Ë. Listoni më poshtë të gjitha shtetet në të cilat keni qenë gjatë 5 viteve të fundit, si dhe datat e përafërta të këtyre udhëtimeve:

Data		Destinacioni	Qëllimi
Prej	Në		

F. Listoni më poshtë të gjitha shtëpitë, apartamentet, shtëpitë e pushimit, automjetet, motoçikletat, anijet ose aeroplanët e të cilëve, kandidati, është pronar apo i gëzon* gjatë 5 viteve të fundit, dhe që nuk përfshihen në objektet të cilat përdoren me qëllim zyrtar ushtrimin e detyrës.

Në pronësi/ gëzim/ përdorim	Objekti	Qëllimi

**("E drejta e një personi për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë." Përfshirja e përkufizimi i gëzimit të sendit sipas Kodit Civil)*

Shënim: Në rast se nevojitet mund të përdorni letër shtesë.

D E K L A R A T Ë

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në deklaratën për kontrollin e figurës janë të sakta dhe të vërteta. Jam i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të pasjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

_____ më ___/___/____

Emër Atësi Mbiemër **Nënshkrimi**

D E K L A R A T Ë

Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale

Unë _____, i biri i/e bija e_____ dhe i/e _____ , i/e vitlindjes _____, lindur në _____ dhe banues/banuese në _____, me kombësi _____ dhe shtetësi _____, aktualisht me punë pranë _____, me detyrë_____, me vullnetin tim te lirë;

DEKLAROJ SE:

- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhet procedura e kontrollit të figurës.
- Jam dakord që të dhënat e mia personale të deklaruara në "Formularin e Kontrollit të Figurës",
- të trajtohen nga personat përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale për qëllimet e ligjshme.
- Jam i ndërgjegjshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të pasjellë shkarkimin nga detyra i subjektit të rivlerësimit sipas legjislacionit në fuqi.

_____ më ___/___/____

Emër Atësi Mbiemër **Nënshkrimi**

Shtojca B

DEKLARATA 1

VETËDEKLARIM

(i gjyqtarëve dhe prokurorëve)

Unë_____, i biri/ e bija e_____ dhe i/e _____, i/e datëlindjes_____, lindur në _____ dhe banues/ banuese në_____, me kombësi_____ dhe shtetësi_____, aktualisht i/e punësuar/emëruar pranë _____, me detyrë_____, me vullnetin tim të lirë;

DEKLAROJ SE:

- Jam i informuar se do të caktohem me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut.
- Jam i informuar dhe jam dakord se do të marr një telefon fiks zyrtar, një telefon celular, një numër celular dhe një adresë poste elektronike. Jam i informuar dhe jam dakord të bëj të ditur çdo numër tjetër telefoni dhe adresë e-mail personale. Jam dakord të përdor vetëm këto mjete komunikimi elektronik. Nëse gjatë një emergjence do të më duhet të përdor një mjet tjetër komunikimi elektronik, do t'ia raportoj këtë fakt Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit brenda 3 ditësh. Jam i informuar dhe jam dakord që këta numra telefoni dhe adresa të postës elektronike t'i nënshtrohen vëzhgimit nga Byroja Kombëtare e Hetimit, ku përfshihet leximi i e-maileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave.
- Jam i informuar dhe jam dakord të deklaroj llogaritë e mia financiare si dhe të deklaroj çdo llogari të re që mund të krijoj. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.
- Jam i informuar dhe jam dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, mund të përballem me masa disiplinore ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit tim. Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përftuar nga vëzhgimi mund të çojë në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale.

- Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme pa u ndikuar nga ndërhyrjet korruptive.
- Gjithashtu jam dakord që, në këmbim të këtyre kushteve, të kompensohem me një pagesë shtesë.

_____, më ___.___.20___

DEKLARUESI

(_____)

Shtojca B

DEKLARATA 2

VETËDEKLARIM

(i Kandidatëve për Pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, Kandidatët për Drejtor, Zëvendës Drejtor, Hetues, Oficer i Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe Pozicione të Tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi dhe Punonjësit e Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar)

Unë_____, i biri/ e bija e_____ dhe i/e _____, i/e datëlindjes_____, lindur në_____ dhe banues/ banuese në_____, me kombësi_____ dhe shtetësi _____, aktualisht i/e punësuar/emëruar pranë_____, me detyrë _____, me vullnetin tim të lirë;

Deklaroj se:

- Jam i informuar se do të caktohem me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut. Jam i informuar dhe jam dakord që gjatë punësimit tim të marr një telefon zyrtar fiks, një telefon celular, një numër celulari dhe një adresë poste elektronike. Jam i informuar dhe jam dakord të bëj të ditur çdo numër telefoni dhe adresa e-mail personale. Jam dakord të përdor vetëm këto mjete komunikimi elektronik. Nëse gjatë një emergjence do të më duhet të përdor një mjet tjetër komunikimi elektronik, do t'ia raportoj këtë fakt Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit.
- Jam i informuar dhe dakord që këta numra telefoni dhe adresa të postës elektronike t'i nënshtrohen vëzhgimit nga Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, ku përfshihet leximi i e-maileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave.
- Jam i informuar dhe dakord për të deklaruar llogaritë e mia financiare si dhe për të deklaruar çdo llogari të re që mund të krijoj. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.
- Jam i informuar dhe dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte,

mund të përballem me masa disiplinore ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit tim. Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përftuar nga vëzhgimi mund të çojë në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale.

- Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme pa u ndikuar nga ndërhyrjet korruptive.

_____, më ___.___.20___

DEKLARUESI

(_____)

Shtojca B

DEKLARATA 3

VETË DEKLARIM

(i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendës drejtorit, hetuesit, oficerit të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi)

Unë,_____, anëtar i afërt i familjes së _____ (_____)*, i/e datëlindjes_____, lindur në_____ dhe banues/ banuese në_____, me kombësi_____ dhe shtetësi _____, aktualisht i/e punësuar/ emëruar pranë_____, me detyrë_____, me vullnetin tim të lirë;

Deklaroj se:

- Jam i informuar se jam një anëtar i afërt i familjes së një personi i/e cili/cila do të caktohet me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut. Jam i informuar dhe jam dakord që gjatë punësimit të tij/saj telefonat e mi celularë dhe adresat e mia të postës elektronike do t'i bëhen të ditura (deklarohen) Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Jam i informuar dhe dakord që numrat e mi të telefonit dhe adresat e mia të postës elektronike do t'i nënshtrohen vëzhgimit nga Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, ku përfshihet leximi i e-maileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave.
- Jam i informuar dhe dakord për të deklaruar llogaritë e mia financiare si dhe për të deklaruar çdo llogari të re që mund të krijoj. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.
- Jam i informuar dhe dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, anëtari i afërt i familjes mund të përballet me masa disiplinore ndër

* Specifiko në këtë rubrikë marrëdhënien me subjektin deklarues, për shembull i biri/e bija, vëllai/motra, nëna/babai, bashkëshorti/bashkëshortja etj.

të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit të tij/saj.

- Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përftuar nga vëzhgimi mund të çojë në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale.
- Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme pa u ndikuar nga ndërhyrjet korruptive.
- Jam i informuar dhe dakord se, nëse nuk jam më një anëtar i afërt i familjes së një personi i/e cili/cila do të caktohet me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut ashtu siç parashikohet nga ligji, atëherë do të jetë detyrimi im të informoj menjëherë Oficerin Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave lidhur me këtë fakt si dhe të paraqes prova shkresore që vërtetojnë ndryshimin e këtij statusi.

_____, më ___.___.20___

DEKLARUESI

(_____)

Shtojca C

Deklarimi i llogarive financiare

(Për kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendës drejtor, hetues, oficer të shërbimeve të policisë gjyqësore, dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi, si dhe anëtarët e afërt të familjes)

A. Rendisni më poshtë llogaritë tuaja financiare dhe informacionin e kërkuar:

Numri i llogarisë financiare	Emri i mbajtësit të llogarisë	Institucioni Financiar	Shteti

B. Rendisni më poshtë llogaritë financiare të familjarëve tuaj dhe informacionin e kërkuar:

Numri i llogarisë financiare	Emri i mbajtësit të llogarisë	Institucioni Financiar	Shteti

_____, më_____.___._____

Emër, Mbiemër, Firma

LIGJ
Nr. 84/2016

PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81, 83, pika 1, dhe 179/b, pika 10, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton:

1. Parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët.

2. Metodologjinë, procedurat dhe standardet e rivlerësimit.

3. Organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit.

4. Rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të organeve të tjera

shtetërore dhe të publikut në procesin e rivlerësimit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ditë" nënkupton ditë kalendarike që llogariten sipas rregullave të përcaktuara në nenin 56 të Kodit të Procedurave Administrative.

2. "Dokument ligjor" është çdo dokument i përgatitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, në veçanti vendim, raport/relacion, kërkesë për gjykim penal, mendim/opinion ligjor, si dhe akte të tjera që provojnë aftësitë profesionale të tij.

3. "ILDKPKI" është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili organizohet dhe funksionon sipas ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë";

4. "Institucionet e rivlerësimit" janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe komisionerët publikë;

5. "Komisioni" është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i parashikuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të Kushtetutës.

6. "Kontakt i papërshtatshëm" është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

7. "Kolegji i Apelimit" është Kolegji i Posaçëm i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, i parashikuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të Kushtetutës.

8. "Krim i organizuar, trafikimi dhe korrup-sioni" përfshijnë veprat penale që sipas nenit 75/a të Kodit Procedurës Penale janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda, ose të çdo gjykate tjetër që mund të zëvendësojë atë në ushtrimin e këtyre kompetencave.

9. "Marrëdhënie biznesi" është çdo marrëdhënie profesionale ose tregtare, e cila lidhet me veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e këtij ligji dhe klientët e tyre, që, në çastin e vendosjes së saj, vlerësohet të jetë një marrëdhënie e vazhdueshme ose jo, sipas ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".

10. "Organ i vlerësimit të aftësive profesionale" është Inspektorati i

Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që funksionon sipas ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, struktura përkatëse e Prokurorisë së Përgjithshme ose institucionet që bëjnë vlerësimin profesional sipas ligjit.

11. "Pasuri" janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

12. "Periudha e rivlerësimit" është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë të cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji.

13. "Person i lidhur" është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit.

14. "Persona të tjerë të lidhur" janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

15. "Person i përfshirë në krimin e organizuar" është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur:

a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;

b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

16. “Subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushte-tutës.

17. Shprehja “nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike” do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendës-krye-ministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendës-kryeministrit, ose ministrit që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit.

18. Shprehja “nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike” do të thotë që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të parashikuara në statutin e partisë politike.

19. “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.

20. “Trust” është një marrëveshje mirëbesimi, ku pronësia mbahet nga i mirëbesuari për llogari të përfituesit, sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, si dhe nga legjislacioni ndërkombëtar.

21. “Vëzhgues ndërkombëtarë” janë personat e emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe të njoftuar, në përputhje me nenin B të Aneksit të Kushtetutës.

Neni 4
Objekti dhe parimet e procesit të rivlerësimit

1. Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tre kritereve:

a) vlerësimi i pasurisë;

b) kontrolli i figurës; dhe

c) vlerësimi i aftësive profesionale.

2. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.

3. Procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Kur çështja është gati për t’u shqyrtuar, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm.

4. Çështjet për rivlerësimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm do të trajtohen me përparësi në kohë nga institucionet e rivlerësimit.

5. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

6. Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

7. E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin "Mbi të drejtën e informimit", mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit.

KREU II
INSTITUCIONET

Neni 5
Institucionet e rivlerësimit

1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.

2. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar.

3. Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë:

a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit

të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

Neni 6
Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit

1. Anëtar i Komisionit dhe gjyqtar i Kolegjit të Apelimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

b) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të ketë marrë një vlerësim të lartë për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral të tij, nëse u është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme;

ç) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit;

d) ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose të mos ketë qenë subjekt i ndalimeve të parashikuara në ligjin "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë";

ë) nuk ka qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit përpara kandidimit;

f) nuk ka qenë anëtar i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtë-sisë, ose ekspert i caktuar nga partitë politike, si dhe Ministri i Drejtësisë;

g) nuk është më shumë se 65 vjeç;

gj) zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

2. Përmbushja e kritereve të mësipërme vlerësohet duke marrë në konsideratë në veçanti të dhënat si më poshtë:

a) titujt shkencorë në fushën e së drejtës;

b) përvojë të veçantë të kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës;

c) vjetërsinë në profesion;

ç) përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar;

d) notën mesatare jo më pak se 8, nëse ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit, dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

3. Kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, zbatohen edhe për zgjedhjen e komisionerit publik, me përjashtim të kërkesës për përvojën në punë, e cila duhet të jetë jo më pak se 10 vjet.

Neni 7
Paraqitja dhe shqyrtimi i aplikimeve për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit

1. Presidenti i Republikës shpall menjëherë thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit në faqen zyrtare të internetit, si dhe në dy gazeta me tirazhin më të lartë në vend. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare ku duhet të dorëzohet dhe listën e dokumenteve që duhet të shoqërojnë atë.

2. Afati për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues është 15 ditë.

3. Kërkesa e kandidatit regjistrohet në regjistrin e protokollit të Presidentit të Republikës. Kandidati pajiset me një dokument që vërteton numrin e

aplikimit, datën dhe listën e dokumenteve të paraqitura.

4. Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Në rast se kandidati nuk ka përcaktuar asnjë preferencë për vendin vakant, konsiderohet që ai aplikon për të gjithë vendet vakante. Bashkë-lidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 2 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

a) jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

b) kopje të noterizuara ose të njësuara të diplomës nga organi përkatës;

c) kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;

ç) një dokument të nënshkruar prej tij, me të cilin aplikuesi pranon kufizimet e posaçme për fshehtësinë në komunikimet elektronike gjatë kohëzgjatjes së mandatit si anëtar i institucioneve të rivlerësimit, sipas shtojcës 1 të këtij ligji.

5. Brenda 7 ditëve nga përfundimi i procesit të aplikimit, Presidenti i Republikës, pasi konsultohet me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, përpilon një listë me kandidatët të cilët plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion dhe një listë me kandidatët të cilët nuk i plotësojnë këto kritere. Operacioni ndërkombëtar i monitorimit monitoron këtë proces, duke pasur akses të plotë në dokumentacionin e të gjithë aplikantëve.

6. Presidenti i Republikës menjëherë ia përcjell Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit listat e përpiluara, sipas pikës 5, të këtij neni, dhe të gjitha dosjet individuale të kandidatëve, si dhe publikon listën e plotë të kandidatëve në faqen zyrtare të internetit, të grupuar sipas secilit pozicion. Në rast se Presidenti i Republikës nuk përfundon procesin brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e Aneksit të Kushtetutës, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

7. Një komision i përbërë nga të paktën tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit vlerëson kandidatët. Jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja e dy listave nga Presidenti i Republikës, ky komision, bazuar në vlerësimet e arsyetuara, lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, i dërgon rekomandimet Presidentit, i cili ia përcjell ato Kuvendit. Nëse Presidenti nuk e ushtron këtë kompetencë brenda 5 ditëve, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

Neni 8
Komisioni parlamentar *ad hoc* për verifikimin e kandidatëve

1. Kuvendi, brenda 3 ditëve nga marrja e listës së kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale, listës së kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale, dhe listës së rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, miraton krijimin dhe përbërjen e një komisioni *ad hoc* me gjashtë anëtarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare, si dhe procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve dhe realizimin e procesit të votimit, sipas këtij neni dhe nenit 9 të këtij ligji.

2. Kryetari i Kuvendit, brenda ditës së dorëzimit të listave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njofton datën dhe orën e mbledhjes së seancës plenare për krijimin dhe përbërjen e komisionit *ad hoc* të verifikimit të kandidatëve. Në këtë njoftim, Kryetari i Kuvendit i kërkon grupeve parlamentare të shumicës dhe pakicës parlamentare që të dërgojnë deri ditën e nesërme të njoftimit propozimet e tyre për përbërjen e këtij komisioni *ad hoc*. Kryetari i Kuvendit, brenda ditës së nesërme nga krijimi i komisionit *ad hoc*, i përcjell secilit prej anëtarëve të tij dokumentacionin për të gjithë kandidatët.

3. Komisioni *ad hoc*, pas zhvillimit të një seance dëgjimore me kandidatët, vendos:

a) të kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret formale tek lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale, me të paktën katër vota;

b) të kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve të rekomanduar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit tek lista e kandidatëve për votim, me të paktën pesë vota.

4. Lista për votim përmban kandidatët të cilët plotësojnë kriteret formale, përveç atyre që nuk janë rekomanduar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe që nuk janë miratuar me vendim të këtij komisioni *ad hoc*, sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Brenda dhjetë ditëve nga krijimi i tij, komisioni *ad hoc* i përcjell listën e hartuar sipas pikës 4 të këtij neni, komisioneve *ad hoc* përzgjedhëse. Dy listat e tjera nuk dërgohen për votim.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit merr masat e nevojshme për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarisë së komisionit *ad hoc* të verifikimit të kandidatëve.

7. Komisioni *ad hoc* funksionon bazuar në dispozitat e këtij ligji dhe, për aq sa është e mundur, sipas Rregullores së Kuvendit.

Neni 9
Komisionet parlamentare *ad hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve

1. Kuvendi, brenda 10 ditëve nga marrja e listës së kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale, listës së kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale, dhe listës së rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, mira-ton krijimin dhe përbërjen e dy komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes, të cilët përbëhen respektivisht nga:

a) 12 anëtarë, gjashtë të propozuar nga grupet parlamentare të shumicës dhe gjashtë nga grupet parlamentare të pakicës;

b) 6 anëtarë, tre të propozuar nga grupet parlamentare të shumicës dhe tre nga grupet parlamentare të pakicës.

2. Kryetari i Kuvendit, brenda 3 ditëve nga dita e dorëzimit të listave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njofton datën dhe orën e mbledhjes së seancës plenare për krijimin dhe përbërjen e dy komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve. Në këtë njoftim, Kryetari i Kuvendit i kërkon grupeve parlamentare të shumicës dhe pakicës parlamentare që të dërgojnë, brenda dy ditëve nga data e njoftimit, propozimet e tyre për përbërjen e të dy komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes.

3. Një deputet mund të jetë anëtar vetëm në njërin nga komisionet *ad hoc* të përzgjedhjes. Anëtarët e komisionit *ad hoc* të verifikimit të kandidatëve nuk kanë pengesë për të qenë edhe anëtarë në një nga komisionet *ad hoc* të për-zgjedhjes.

4. Brenda 30 ditëve nga konstituimi i tij, komisioni *ad hoc* i përzgjedhjes, zhvillon procedurën për votimin e kandidatëve. Në mbledhjen e parë të secilit komision *ad hoc* përzgjedhës miratohet kalendari i zhvillimit të seancave dëgjimore me kandidatët, si dhe ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për njoftimin e kandidatëve.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit merr masat e nevojshme për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarisë së komisionit *ad hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve.

6. Komisioni *ad hoc* funksionon bazuar në dispozitat e këtij ligji dhe, për aq sa është e mundur, në Rregulloren e Kuvendit.

Neni 10
Procesi i votimit në komisioni parlamentar *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve

1. Procedura e votimit bëhet nëpërmjet një sistemi elektronik që mundëson votimin e fshehtë, ku secili anëtar voton për një kandidat.

2. Secili prej anëtarëve të komisionit *ad hoc* të përzgjedhjes me 6 anëtarë përzgjedh nga lista e kandidatëve për votim një kandidat për gjyqtar të Kolegjit të Apelimit, pa debat dhe përmes një votimi të fshehtë elektronik, ku secili anëtar i komisionit voton vetëm për një kandidat.

3. Anëtarët e komisionit *ad hoc* marrin pjesë në të gjitha raundet e votimit deri në zgjedhjen përfundimtare të gjashtë gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit. Sistemi elektronik mundëson realizimin e këtij procesi votimi, duke prodhuar raportin elektronik për rezultatet e votimit, që garanton pamundësinë e identifikimit të votës.

4. Çdo anëtar i komisionit *ad hoc* duhet të votojë. Nëse një nga anëtarët nuk voton, votimi përsëritet edhe një herë. Nëse edhe gjatë votimit të dytë një nga anëtarët nuk voton, Kryetari i Kuvendit njoftohet për fillimin e procedurave për zëvendësimin e anëtarit të komisionit, i cili nuk ka votuar. Kuvendi zgjedh anëtarin e ri të komisionit *ad hoc*, duke respektuar përkatësinë e tij në grupet parlamentare, brenda 3 ditëve.

5. Komisioni *ad hoc* më pas përzgjedh gjyqtarin e shtatë nga kandidatët e mbetur të listës së kandidatëve përmes një votimi të thjeshtë, të fshehtë elektronik, ku kandidati me më shumë vota quhet i përzgjedhur. Në rast barazie të votave, fituesi përzgjidhet me short manual ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Procedurat e hedhjes së shortit pasqyrohen në procesverbal që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit *ad hoc*.

6. Procedura e parashikuar në pikën 5 të këtij neni zbatohet edhe për zgjedhjen e dy kandidatëve zëvendësues për pozicionin e gjyqtarit të Kolegjit të Apelimit.

7. Secili prej anëtarëve të komisionit *ad hoc* të përzgjedhjes me 12 anëtarë përzgjedh një kandidat për komisioner nga lista e kandidatëve për votim, pa debat dhe përmes një votimi të fshehtë elektronik, ku secili anëtar i komisionit voton vetëm për një kandidat. Rregullat e parashikuara në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, zbatohen edhe gjatë procedurës së votimit të komisionit *ad hoc* të përzgjedhjes me 12 anëtarë. Procedura e parashikuar në pikat 5 dhe 6, të këtij neni, zbatohet edhe për zgjedhjen e dy kandidatëve zëvendësues për pozicionin e komisioneve pranë Komisionit.

8. Komisioni përzgjedh më pas dy kandidatë nga lista e kandidatëve për votim për Komisioner Publik përmes një votimi ku dy kandidatët me më shumë vota quhen të përzgjedhur. Procedura e parashikuar në pikën 5, të këtij neni, zbatohet edhe për zgjedhjen e dy komisionerëve publikë, si dhe të dy kandidatëve zëvendësues për Komisioner Publik.

9. Nëse një kandidat ka aplikuar për më shumë se një funksion dhe është përzgjedhur në njërin prej funksioneve të votuar më parë në radhë, emri i tij hiqet automatikisht nga sistemi elektronik nga lista e kandidatëve për votim për funksionet që votohen më vonë në radhë.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, brenda dy ditëve nga përfundimi i procesit të votimit, harton listën përfundimtare të komisionerëve, gjyqtarëve dhe komisionerëve publikë të zgjedhur. Lista bashkë me rezultatet e votimit, të prodhuara nga sistemi elektronik, i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, i cili menjëherë cakton datën dhe orën e mbledhjes së seancës plenare, si dhe i përcjell të gjithë deputetëve këtë listë.

Neni 11
Votimi në seancë plenare

1. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve në bllok me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve.

2. Në rast se Kuvendi nuk e miraton listën e kandidatëve në bllok, sipas pikës 1, të këtij neni, Kryetari i Kuvendit ia kthen atë komisioneve *ad hoc* për përsëritjen e procesit të përzgjedhjes dhe dërgimin e një liste të dytë brenda 10 ditëve. Komisionet *ad hoc* të përzgjedhjes zbatojnë rregullat e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji.

3. Kuvendi, brenda 10 ditëve nga dërgimi i listës së dytë, mund ta rrëzojë në bllok listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve të tij. Në rast se lista nuk rrëzohet, kandidatët e përzgjedhur konsiderohen të zgjedhur.

4. Vendimi i Kuvendit për miratimin e listës së kandidatëve të zgjedhur botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

5. Në rast se lista rrëzohet nga Kuvendi, sipas pikës 3, të këtij neni, ngarkohen organet e parashikuara në këtë ligj të fillojnë procedurat për plotësimin e vendeve vakante, duke respektuar procedurat e parashikuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj.

KREU III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË RIVLERËSIMIT

Neni 12
Kryetari i Komisionit dhe i Kolegjit të Apelimit

1. Veprimtaria e Komisionit drejtohet nga Kryetari i tij dhe, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë i caktuar prej tij, me përjashtim të rasteve që ky ligj parashikon ndryshe.

2. Kryetari i Komisionit zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, për një periudhë 3-vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje.

3. Seanca për zgjedhjen e Kryetarit drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë. Në rast se ka më shumë se një kandidat dhe gjatë votimit asnjëri prej tyre nuk merr shumicën e parashikuar të votave, bëhet një votim i ri dhe pas këtij vijohet me votimin mes kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Nëse asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e votave ose votat janë ndarë në mënyrë të barabartë, Kryetari caktohet me short. Shorti organizohet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

4. Parashikimet e bëra në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, zbatohen edhe për Kryetarin e Kolegjit të Apelimit.

Neni 13
Kompetencat e Kryetarit të Komisionit dhe të Kolegjit të Apelimit

Kryetari ka këto kompetenca:

a) përgatit, thërret e drejton mbledhjen e anëtarëve;

b) përfaqëson Komisionin ose Kolegjin e Apelimit në marrëdhënie me të tretët;

c) bashkërendon punën në institucion;

ç) nënshkruan aktet e tjera të Komisionit ose Kolegjit të Apelimit, me përjashtim të vendimeve;

d) drejton shortin në rastet e përcaktuara në nenet 14, 15, 18, pika 4, të këtij ligji.

Neni 14
Organizimi i Komisionit

1. Komisioni organizohet në 4 trupa gjykuese të përbërë nga 3 anëtarë, të cilët caktohen me short. Anëtarët zëvendësues caktohen me short.

2. Shpërndarja e çështjeve në trupat gjykuese bëhet me short, ku përcaktohet edhe anëtari relator.

3. Trupi gjykues i Komisionit drejtohet nga kryesuesi i trupit gjykues, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të tij. Në mungesë të tij, trupa drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

4. Detyrat e kryesuesit të trupit gjykues janë:

a) të thërrasë dhe të kryesojë mbledhjet dhe seancat dëgjimore;

b) të bashkërendojë punën dhe të marrë masa për të garantuar zbardhjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm.

5. Relatori i çështjes ka këto detyra:

a) të përgatisë dosjen që diskutohet nga trupi gjykues;

b të ndërmarrë të gjitha procedurat për të garantuar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës gjykuese;

c) të marrë të gjitha masat për të hartuar dokumentacionin e nevojshëm, deri në përfundimin e çështjes;

ç) të kërkojë informacion shtesë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) të propozojë marrjen e një vendimi duke parashtruar arsyetimin.

Neni 15
Organizimi i Kolegjit të Apelimit

1. Kolegji i Apelimit gjykon në trupa gjykuese të përbërë nga 5 gjyqtarë, të cilët caktohen me short për çdo çështje.

2. Trupi gjykues i Kolegjit kryesohet nga kryesuesi, i cili caktohet më short së bashku me relatorin e çështjes.

3. Kryesuesi i trupit gjykues dhe relatori i çështjes ushtrojnë detyrat në përputhje me pikat 4 dhe 5, të nenit 14, të këtij ligji.

Neni 16
Përgjegjësia disiplinore e anëtarit të institucioneve të rivlerësimit

Anëtari i institucionit të rivlerësimit mban përgjegjësi disiplinore, veçanërisht për shkak të:

1. Mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, kur ka dyshime të arsyeshme për ekzistencën e rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit, sipas legjislacionit në fuqi dhe nëse anëtari është në dijeni të rrethanave të tilla.

2. Sjelljes, akteve dhe veprimeve të tjera të anëtarit, që krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim.

3. Mosnjoftimit të Kryetarit ose të organeve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet ose ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe subjekte të tjera.

4. Ndërhyrjeve ose çdo lloj ndikimi tjetër të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një anëtari tjetër.

5. Mospërmbushjes së pajustifikuar e në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur, përkatësisht të funksionit të tij.

6. Paraqitjes së kërkesës për heqje dorë dhe kryerjes së atyre veprimeve që nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj ose që bëhen në mënyrë të qëllimshme për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët, ose kur synojnë të shmangin anëtarin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes, ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga gjyqtarë të tjerë, ose kur dorëheqja jepet e vonuar megjithëse ka qenë në dijeni të faktit për të cilin jep dorëheqjen.

7. Shkeljes së përsëritur ose të rëndë të rregullave të solemnitetit dhe rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, si edhe me anëtarët ose personelin e institucioneve të rivlerësimit.

8. Vonesës dhe zvarritjes së përsëritur dhe të pajustifikuar të veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit.

9. Bërjes publike të mendimeve që ka dhënë vetë ose anëtarët e tjerë gjatë procesit që akoma nuk kanë marrë formën e një akti të bërë publik.

10. Shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, gjatë procesit ose kur

ky ka përfunduar, duke përfshirë publikimin dhe shpërndarjen, edhe për shkak të neglizhencës, të akteve ose informacioneve konfidenciale ose të akteve procedurale, që rrjedhin nga çështjet të cilat janë në proces hetimi ose gjykimi.

11. Bërjes së deklaratave publike dhe në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve të shtypit brenda kufijve të detyrës së tij.

12. Parashtrimit të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra.

13. Përdorimit të mandatit të anëtarit për të realizuar përftime të pajustifikuara vetjake ose për të tjerët.

14. Shoqërimit me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar penalisht, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose personave të cilët janë të afërm me gjyqtarët në lidhje gjaku ose me ligj, si dhe marrëdhëniet e biznesit të papërshtatshme me këta persona.

15. Përfitimit të padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdolloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit.

16. Sjelljes së papërshtatshme në përmbushjen e detyrimeve, në marrë dhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore dhe funksionarët e tyre, si dhe raste të tjera me sjellje të papërshtatshme të pajustifikuar.

17. Raste të tjera të parashikuara nga ky ligj.

Neni 17
Procedurat për shkarkimin e anëtarit të institucioneve të rivlerësimit

1. Në rast se ka të dhëna të mjaftueshme nga burime të besueshme se anëtari i institucioneve të rivlerësimit ka kryer një shkelje disiplinore, ndaj tij fillon hetimi disiplinor. Subjektet që mund të kërkojnë fillimin e hetimit disiplinor janë:

a) çdo komisioner për komisionerët;

b) çdo gjyqtar për gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit;

c) çdo vëzhgues ndërkombëtar për Komisionerin Publik, komisionerin dhe gjyqtarin e Kolegjit të Apelimit.

2. Kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor bëhet me shkrim te Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit ose Kolegjit të Apelimit, sipas rastit. Raportimet nga publiku për shkeljet disiplinore paraqiten pranë vëzhguesit ndërkombëtar.

3. Procedura hetimore disiplinore duhet të fillojë pa vonesë të arsyeshme nga konstatimi i shkeljes disiplinore. Në rast se anëtari i institucionit të rivlerësimit jep dorëheqjen nga detyra, procedura hetimore mbyllet pa një vendim përfundimtar.

4. Komisioni Disiplinor përbëhet nga 3 gjyqtarë të Kolegjit të Apelimit të zgjedhur me short, rast pas rasti, pa pjesëmarrjen e anëtarit që i nënshtrohet procedimit disiplinor sipas ligjit. Gjyqtari hetues zgjidhet me short ndërmjet të gjithë anëtarëve të Kolegjit të Apelimit, pa pjesëmarrjen e anëtarit që i nënshtrohet procedimit disiplinor. Shorti organizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Apelimit.

5. Gjyqtari hetues harton një raport mbi rezultatet e hetimit për shkeljen disiplinore dhe ia dërgon menjëherë për shqyrtim Komisionit Disiplinor.

6. Komisioni Disiplinor, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së raportit, vendos si më poshtë:

a) caktimin e një mase disiplinore në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve;

b) caktimin e një mase disiplinore dhe dërgimin e çështjes, sipas rastit, në Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme ose në Prokurorinë e Posaçme sipas nenit 148, pika 4, të Kushtetutës, nëse konstaton se shkelja disiplinore përbën edhe një vepër penale;

c) mosdhënien e masës disiplinore, nëse konstaton se nuk ka shkaqe për një masë të tillë.

7. Anëtari i institucionit të rivlerësimit që i nënshtrohet procedimit disiplinor ka të drejtë të informohet, mbrohet dhe dëgjohet gjatë procedimit disiplinor. Komisioni Disiplinor, në ushtrimin e funksioneve të tij, respekton në mënyrë të balancuar parimin e pavarësisë, paanësisë dhe besueshmërisë, si dhe të drejtën për respektimin e jetës private. Legjislacioni që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve mund të zbatohet për aq sa është e mundur.

Neni 18
Organizimi dhe administrimi i institucioneve të rivlerësimit

1. Institucionet e rivlerësimit kanë personel dhe pajisjet e nevojshme për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga ky ligj. Struktura organizative dhe klasifikimi i pagave për personelin e institucioneve të rivlerësimit miratohen nga Kuvendi, me propozimin e institucionit përkatës. Personeli i institucioneve të rivlerësimit përbëhet nga njësia e shërbimit ligjor dhe punonjësit administrativë.

2. Kolegji i Apelimit ndihmohet edhe nga strukturat mbështetëse të Gjykatës Kushtetuese.

3. Marrëdhënia e punësimit me punonjësit e institucioneve të rivlerësimit rregullohet sipas këtij ligji dhe Kodit të Punës.

4. Autoriteti përgjegjës për pranimin në punë të punonjësve është komiteti *ad hoc* që krijohet pranë çdo institucioni. Ai përbëhet nga 2 anëtarë të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit, përkatësisht sipas rastit, të zgjedhur më short, si dhe nga Komisioneri Publik më i vjetër në moshë. Për pranimin në punë të punonjësve pranë komisionerëve publikë, komiteti *ad hoc* përbëhet nga 2 komisionerët publikë dhe nga gjyqtari më i vjetër në moshë i Kolegjit të Apelimit.

Neni 19
Buxheti i institucioneve të rivlerësimit

1. Buxheti i institucioneve të rivlerësimit financohet nga Buxheti i Shtetit, në të cilin ato pasqyrohen si institucione të veçanta.

2. Institucionet e rivlerësimit propozojnë çdo vit projektbuxhetin e tyre në komisionin që mbulon çështjet ligjore pranë Kuvendit, që e paraqet për miratim në Kuvend, si pjesë integrale të Buxhetit të Shtetit.

3. Institucionet e rivlerësimit zbatojnë në mënyrë të pavarur buxhetin e tyre, të miratuar nga Kuvendi.

4. Institucionet kanë të drejtë të përdorin të ardhurat dytësore, të përfituara nga projektet ndërkombëtare, donacionet dhe botimet e tyre.

5. Kontrolli financiar i institucioneve të rivlerësimit kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 20
Sekretari i Përgjithshëm

1. Brenda 30 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Presidenti i Republikës publikon vendet vakante për dy sekretarët e përgjithshëm në faqen zyrtare të internetit të tij dhe në 2 gazetat me tirazhin më të lartë në vend. Personat e interesuar aplikojnë për këto vende brenda 20 ditëve pas publikimit. Presidenti i Republikës përgatit dosjet dhe ua përcjell institucioneve përkatëse, pasi ato të kenë filluar ushtrimin e funksioneve.

2. Procesi i rekrutimit bazohet në një procedurë të hapur dhe transparente për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga komiteti *ad hoc* i krijuar në institucionin përkatës.

3. Sekretari i Përgjithshëm është shtetasi shqiptar, i cili plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose në shkenca ekonomike me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi ose në shkenca ekonomike jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

b) ka pasur një përvojë pune në nivel menaxherial dhe drejtues, jo më pak se 10 vjet;

c) ndaj tij të mos të ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

ç) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

d) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

dh) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit.

4. Komiteti *ad hoc* vendos për zgjedhjen e kandidatit bazuar në dokumentet e paraqitura.

Neni 21
Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm

Sekretari i përgjithshëm ka këto detyra:

a) të përfaqësojë institucionin në marrëdhëniet me palët e treta, në rastet kur Kryetari përkatës i institucionit të rivlerësimit është në pamundësi për ta ushtruar këtë detyrë;

b) të administrojë regjistrin e dosjeve;

c) të organizojë dhe të drejtojë punën e përditshme të të gjithë personelit, me përjashtim të personelit këshillimor;

ç) të trajtojë çështjet në marrëdhëniet me publikun;

d) të organizojë punën për përgatitjen e raportit vjetor për shpenzimet financiare;

dh) të rekrutojë punonjësit administrativë, sipas Kodit të Punës;

e) çdo detyrë tjetër administrative që i ngarkohet nga Kryetari i institucionit përkatës të rivlerësimit.

Neni 22
Njësia e shërbimit ligjor

1. Pranë Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor që ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, në varësi të mbledhjes së komisionerëve ose gjyqtarëve.

2. Procesi i rekrutimit bazohet në një procedurë të hapur dhe transparente për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga komiteti *ad hoc* i krijuar në institucionin përkatës.

3. Këshilltari ligjor është shtetasi shqiptar, i cili plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

b) ka pasur një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;

ç) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

d) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

4. Këshilltari ekonomik është shtetasi shqiptar, i cili përmbush kriteret e mëposhtme:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematikë ose drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

b) ka pasur një përvojë pune në sektorin financiar jo më pak se 7 vjet;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;

ç) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;

d) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

Neni 23
Detyrat e këshilltarit

1. Këshilltari ligjor ka këto detyra:

a) studimi i dosjes dhe përgatitja e relacionit për çështjen;

b) kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga relatori i çështjes.

2. Këshilltari ekonomik ka këto detyra:

a) studimi i dosjes nga pikëpamja financiare/ekonomike dhe përgatitja e relacionit të çështjes, veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit;

b) kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga relatori i çështjes.

Neni 24
Marrëdhëniet me median

Institucionet e rivlerësimit caktojnë punonjës përgjegjës për komunikimin me publikun.

Neni 25
Mbrojtja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit dhe personelit vendas dhe ndërkombëtar

Anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, personat e lidhur me ta, personeli i institucioneve të rivlerësimit, si dhe personeli mbështetës i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e veçantë.

Neni 26
Deklarimi i pasurisë nga anëtarët e institucioneve të rivlerësimit

1. Anëtari i institucionit të rivlerësimit me fillimin e detyrës mbart detyrimin për të plotësuar deklaratën vjetore të pasurisë. Mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi i kësaj deklaratë përbën shkak për shkarkim nga detyra, sipas këtij ligji.

2. Anëtari i institucionit të rivlerësimit, Sekretari i Përgjithshëm, këshilltarët ekonomikë dhe ligjorë, si dhe personat e lidhur me to, çdo vit mbartin detyrimin të deklarojnë pasuritë deri tre vjet pas përfundimit të mandatit, në përputhje me ligjin "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

3. Anëtari i institucionit të rivlerësimit nuk i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës.

Neni 27
Garantimi i paanësisë

1. Anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaron dhe shmang çdo situatë konflikti interesi, në respektim të ligjit "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit". Çdo vendim i marrë në një situatë konflikti interesi, përveç pasojave ligjore në procesin e vendimmarrjes, përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji.

2. Në rast se anëtari i institucioneve të rivlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të

Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", ai njofton me shkrim menjëherë trupin gjykues. Përjashtimi i komisionerit, gjyqtarit ose Komisionerit Publik nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short.

3. Çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short.

Neni 28
Kushtet për garantimin e besueshmërisë dhe konfidencialitetit

1. Komunikimi elektronik i anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit monitorohet nga Njësia e Posaçme Hetimore e krijuar në bazë të nenit 148, pika 4, të Kushtetutës, kurse të ardhurat financiare të tyre monitorohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, sipas pëlqimit të dhënë prej tyre në nenin 7, pika 3, shkronja "ç", të këtij ligji, për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre.

2. Anëtari i institucionit të rivlerësimit dhe personeli i tyre trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Institucionet e rivlerësimit përjashtohen nga ky detyrim vetëm në rastet kur informacioni i jepet subjektit të rivlerësimit ose organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare.

Neni 29
Paga dhe përfitimet e anëtarëve dhe këshilltarëve

1. Anëtari i institucioneve të rivlerësimit ushtron detyrën me kohë të plotë.

2. Komisioneri dhe Komisioneri Publik marrin pagë dhe përfitime të tjera financiare në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.

3. Gjyqtari i Kolegjit të Apelimit merr pagë dhe përfitime të tjera financiare në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë".

4. Anëtarët e institucioneve të rivlerësimit përfitojnë një pagesë mujore shtesë për shkak të vështirësisë.

5. Këshilltari ligjor dhe ekonomik përfiton përkatësisht 80 për qind të pagës mujore përkatëse të anëtarit të institucionit të rivlerësimit. Ata përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështi-rësisë, sipas rastit.

6. Pas përfundimit të mandatit të institucioneve të rivlerësimit, këshilltari ligjor dhe ekonomik, me pëlqimin e tij/saj, ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kishte para zgjedhjes së tij/saj ose në një vend të përafërt në administratën publike.

KREU IV
VLERËSIMI I PASURISË

Neni 30
Objekti i vlerësimit të pasurisë

Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Neni 31
Fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë

1. Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.

2. ILDKPKI-ja fillon menjëherë procedurën e kontrollit në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4, si dhe nenit 33 të këtij ligji.

3. Subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit, për vlerësimin e pasurisë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të këtij ligji.

Neni 32
Deklarimi i pasurisë

1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.

3. Nëse subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur kanë pasuri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ai paraqet deklarimet bankare të viteve të fundit, të dhënat e fundit mbi regjistrimin e pasurisë ose dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurive që ndodhen jashtë shtetit.

4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.

Neni 33
Procedura e vlerësimit të pasurisë

1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklarimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë", ligjin "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe Kodin e Procedurave Administrative.

2. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, për qëllimet e rivlerësimit, mund të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar brenda ose jashtë vendit në përputhje me ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara Komisionit ose Kolegjit të Apelimit.

3. ILDKPKI-ja mundëson akses të plotë për vëzhguesit ndërkombëtarë, që të kërkojnë informacione, të konsultojnë, të kopjojnë dhe të hetojnë deklarimet e pasurive të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur me të, si dhe dokumentet shoqëruese.

4. ILDKPKI-ja kryen një procedurë të plotë kontrolli sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e depozitimit të deklaratës së pasurisë.

5. Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI- së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se:

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi;

b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

c) është kryer fshehje e pasurisë;

ç) është kryer deklarim i rremë;

d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

KREU V
KONTROLLI I FIGURËS

Neni 34
Objekti i kontrollit të figurës

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Neni 35
Fillimi i procedurës për kontrollin e figurës

1. Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

2. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar fillon menjëherë procedurën e kontrollit të figurës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4, si dhe të nenet 37 dhe 38 të këtij ligji.

3. Subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit, për kontrollin e figurës, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet formularit për deklarimin e kontrollit të figurës, sipas shtojcës 3 të këtij ligji.

Neni 36
Struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës

1. Institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ka të drejtë të caktojë një personel shtesë, për të kryer kontrollin e figurës për qëllim të këtij ligji. Personat që kryejnë kontrollin e figurës përmbushin standardet e zbatueshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të konfidencialitetit në detyrë.

2. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, krijojnë një grup pune për zbatimin e këtij ligji. Këto struktura mund të caktojnë personel për të mbështetur grupin e punës për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit.

3. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, me kërkesë të grupit të punës ose të institucioneve të rivlerësimit, ka të drejtë të komunikojë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e për-fshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar për qëllim të këtij ligji.

Neni 37
Detyrat e grupit të punës

Grupi i punës, gjatë procedurave të kontrollit të figurës, duhet t'u përmbahet kërkesave të përgjithshme si më poshtë:

a) verifikimi i saktë i identitetit në të shkuarën dhe të tashmen, për çdo individ;

b) verifikimi nëse ka tendenca kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar;

c) vlerësimi i përgjithshëm, nëse individi mund të vihet nën presion nga struktura kriminale;

ç) kontrolli nëse ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale;

Neni 38
Standardet e kontrollit e figurës

1. Kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme.

2. Kontrolli i figurës zhvillohet në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal, armiqësor dhe miqësor, të cilat mund të favorizojnë ose disfavorizojnë subjektin e rivlerësimit.

3. Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6, të këtij neni, dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë.

4. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur:

a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të

jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.

5. Rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar janë kur:

a) subjekti i rivlerësimit në mënyrë të besueshme parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara sipas pikës 4, të këtij neni;

b) marrëdhënia familjare e subjektit të rivlerësimit me personin e përfshirë në krimin e organizuar është e largët, ose ka kontakte familjare të rralla;

c) subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet dhe është distancuar prej tyre. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me kohëzgjatjen e kontakteve ose me perceptimin e arsyeve të veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit;

ç) subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni që personi është i përfshirë në krimin e organizuar, por nuk ka qenë në dijeni të faktit se ai do të ishte i pranishëm në një takim, ose është mashtruar për një takim të tillë. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;

d) kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;

dh) çdo rrethanë tjetër lehtësuese, e cila parashtrohet në mënyrë të besueshme nga subjekti i rivlerësimit.

6. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm janë kur:

a) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme;

b) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt, i cili përforcohet ose konsiderohet i besueshëm nga informacione të shërbimeve të fshehta dhe të besueshme;

c) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që konstatohet

nga informacioni përkatës i besueshëm dhe nga prova të tjera; në rast se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të tjera që janë renditur ose konstatuar sipas këtij paragrafi; në rast se ka prova të tjera për një përfitim, veprim ose pasojë nga kontakti që krijon një dyshim të arsyeshëm se informacioni i marrë është shpjegimi i vetëm i mundshëm.

7. Rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin, sipas të cilit formulari i deklarimit nuk është përfunduar plotësisht dhe me besueshmëri janë:

a) subjekti i rivlerësimit rendit në listë një kontakt, por data ose vendndodhja nuk është e saktë dhe kjo duket se është thjesht gabim ose ngatërresë;

b) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt, por ka qenë i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet e tjera dhe kjo mospërfshirje është thjesht gabim ose ngatërresë;

c) kontakti ka ndodhur në një vend me shumë njerëz dhe është i besueshëm fakti se kontakti nuk mund të mbahej mend ose mund të mendohej i parëndësishëm. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontaktit ose me faktorë të tjerë, sipas këtij paragrafi;

ç) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që ka të bëjë me një anëtar të familjes kur rrethanat e atij kontakti nuk mund të mbaheshin mend ose nuk ishin të rëndësishme. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontaktit ose me faktorë të tjerë, sipas këtij neni;

d) subjekti i rivlerësimit në mënyrë të besueshme parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara sipas pikës 6 të këtij neni;

dh) çdo rrethanë tjetër lehtësuese, e cila para-shtrohet në mënyrë të besueshme nga subjekti i rivlerësimit.

Neni 39
Procedura për kontrollin e figurës

1. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, në bashkëpunim me grupin e punës, brenda 60 ditëve nga konstituimi i grupit të punës, verifikon nëse informacioni është i saktë dhe nëse subjekti i rivlerësimit

ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim të afatit 60-ditor, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar mund t'i kërkojë Komisionit një zgjatje 30-ditore të afatit të verifikimit, në rast se është kërkuar informacion nga shtete të tjera.

2. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, pas përgatitjes nga grupi i punës të dokumentit/ raportit, ia paraqet atë Komisionit. Ky dokument/ raport përcakton nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi; nëse ka informacion në deklarimin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës. Ky dokument përmban informacion mbi kontaktet dhe kushtet e parashikuara në nenin 38 të këtij ligji. Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër.

KREU VI
VLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

Neni 40
Objekti i vlerësimit të aftësisë profesionale

Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.

Neni 41
Fillimi i procedurës për vlerësimin e aftësisë profesionale

1. Subjekti i rivlerësimit plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, dhe e dërgon pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale.

2. Subjekti i rivlerësimit, i parashikuar në nenin 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, ka të drejtë t'i paraqesë me shkrim Komisionit kërkesën për rivlerësimin e tij, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të këtij ligji.

3. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës.

4. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit.

Neni 42
Burimet për rivlerësimin e aftësisë profesionale

1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve. Prokurori i Përgjithshëm vlerësohet nëse ka përmbushur detyrat e parashikuara në nenin 8, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar për një periudhë 3-vjeçare nga fillimi i mandatit.

2. Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në:

a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe

b) rezultatet e testimit pranë Shkollën e Magjistraturës.

3. Inspektori rivlerësohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 36, datë 29.4.2015, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

4. Parashikimet e pikës 2, të këtij neni, zbatohen për ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe ish-ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet, si dhe për inspektorët që nuk janë magjistratë.

5. Ish-gjyqtari dhe ish-prokurori vlerësohen bazuar në burimet e mëposhtme:

a) 5 dokumente ligjore të përpiluara prej tij gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës;

b) raportet e vlerësimit të aftësive profesionale gjatë kohës që ka punuar;

c) në rast se për ish-gjyqtarin ose ish-prokurorin nuk ka raporte vlerësimi për aftësitë e tij profesionale, ai i nënshtrohet testimit pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas pikës 2, shkronja "b", të këtij neni, dhe dispozitave të ligjit që rregullon funksionimin e Shkollës së Magjistraturës.

Neni 43
Procedura për vlerësimin e aftësisë profesionale

1. Procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm.

2. Organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale rishikon dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit. Organi, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Ky raport i paraqitet Komisionit, menjëherë, por jo më vonë se 90 ditë nga dita e depozitimit të formularit të vetëvlerësimit profesional.

3. Subjekti i rivlerësimit dhe organet përkatëse garantojnë pajisjen e institucioneve të rivlerësimit me dokumentet e nevojshme. Nëse institucionet e rivlerësimit nuk marrin dokumentet e kërkuara, relatori i jep një afat prej 5 ditësh subjektit të rivlerësimit ose organit përkatës, për të plotësuar kërkesën. Në rastin e mosbashkëpunimit, subjektit të rivlerësimit i jepet vlerësim "i papërshtatshëm", kurse organi përkatës mban përgjegjësi sipas nenit 50, pika 6, të këtij ligji.

4. Nëse relatori vihet në dijeni nga shtetasit/ publiku ose burime të tjera në përputhje me nenin 49, të këtij ligji, mbi fakte të besueshme për punën e subjektit të rivlerësimit, ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

5. Në raste të veçanta, kur informacioni është i ndërlikuar ose i vështirë për t'u marrë, relatori mund të kërkojë nga Komisioni zgjatje të afatit të rivlerësimit.

Neni 44
Relacioni i rivlerësimit

Relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera,

si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve e tjera ligjore. Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë:

a) "I aftë", kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme;

b) "Me mangësi", kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv. Komisioni ka rekomanduar program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës për të plotësuar këto mangësi brenda një viti;

c) "I papërshtatshëm", kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës.

KREU VII
PROCEDURA E RIVLERËSIMIT

Neni 45
Rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes

1. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

2. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të këtij ligji. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit.

Neni 46
Njoftimi

1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, njoftimi bëhet në adresën elektronike private që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji.

3. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit.

4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 47
Të drejtat e subjektit të rivlerësimit

Të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35–40 dhe neneve 45–47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 48
Bashkëpunimi gjatë procesit të hetimit

Subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit, të cilët, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit.

Neni 49
Mjetet për kërkimin e provës

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelimit ka të drejtë:

a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2, të këtij ligji;

b) të mbledhë deklarata nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku;

c) të marrë dokumente të tjera shkresore, sipas formave të parashikuara në ligj ose dokumenteve të marra nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;

ç) të këqyrë dhe të kontrollojë sende të luajtshme ose të paluajtshme, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.

2. Deklarata e dhënë nga dëshmitari ose eksperti gjatë një procesi penal mund të përdoret në cilësinë e provës.

3. Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe

faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

4. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

5. Dokumentet dhe të dhënat e marra nga burimet e shteteve të tjera, në përputhje me këtë ligj, vlerësohen nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.

6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur:

a) marrja e provës duket se është e panevojshme;

b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit;

c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarritshëm;

ç) bëhet me qëllim zvarritjen e gjykimit;

d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.

7. Kërkesa për këqyrje mund të refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse vlerësohet se këqyrja është e panevojshme për zbulimin e së vërtetës.

8. Rregullat e përcaktuara në pikën 6, të këtij neni, zbatohen edhe për thirrjen e dëshmitarit, ftesa e të cilit do të duhet të bëhej jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

9. Refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit.

10. Gjetja, e paraqitur në formën e një deklarate, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelimit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit.

11. Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta. Mendimi mund të ndikojë në vendimmarrjen e Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit, por nuk ka vlerën e provës.

12. Refuzimi i kërkesës së vëzhguesit ndërkombëtar për të marrë prova bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit.

Neni 50
Aksesi në informacion

1. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit.

2. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të plotë në të gjitha të dhënat, pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 148, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në të dhënat që vijojnë:

a) për gjendjen gjyqësore të subjekteve të rivlerësimit;

b) në dosjet personale të subjekteve të rivlerësimit, të dhënat statistikore, dokumentet ligjore, dosjet e zgjedhura për vlerësim, vetë-vlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat mbi trajnimet, mbi ankesat ndaj personave që i nënshtrohen vlerësimit dhe rezultatet e verifikimit ankesave, si dhe mbi vendimet për masat disiplinore ndaj të vlerësuarve;

c) në të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme, ose të përfituara nga një akt noterial i paregjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për këtë qëllim, Komisioni ose Kolegji i Apelimit ka të drejtë të kërkojë informacion nga regjistri i pasurive të paluajtshme ose nga regjistri noterial shqiptar;

ç) në llogaritë bankare, të dhënat tatimore, bazat e të dhënave mbi automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi;

d) në të dhënat mbi të drejta ose interesa pasurorë të çdo lloji mbi një aset, qoftë ky i luajtshëm ose i paluajtshëm, i trupëzuar ose i patrupëzuar, material ose jomaterial, përfshirë dhe ato të evidentuara në formë elektronike ose numerike, duke përfshirë,

por pa u kufizuar, në instrumente të tilla si kreditë, çeqet e udhëtimit, çeqet bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit, si dhe çdo interes, dividend, e ardhur ose vlerë tjetër që buron prej tyre;

dh) në të dhënat mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtari tregtare ose veprimtari të tjera profesionale;

e) në të dhënat që provojnë ekzistencën e parave fizike ose mjeteve ose instrumenteve të tjera të tregut të parasë dhe/ose të pagesave, ku për- fshihen, por pa u shteruar, çeqet, dëftesat, certifikatat e depozitave, kartat e debitit ose të kreditit, kartat elektronike të pagesave, titujt, si dhe çdo dokument tjetër që vërteton ekzistencën e një detyrimi monetar ose një vlere tjetër të depozituar ose për t'i paguar subjektit një shumë korresponduese në para fizike ose në një formë tjetër;

ë) të dhënat që provojnë ekzistencën e trusteve ose marrëveshjeve të tjera të ngjashme.

3. Nëse të dhënat dhe informacioni mbi çështjet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, ruhen dhe administrohen në formë elektronike ose nëse përpunimi dhe përditësimi i tyre kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, institucioni publik ose personi juridik privat, që ushtron funksion publik, kanë detyrimin të pajisin Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit me kodet hyrëse të nevojshme për aksesimin e plotë të informacionit të nevojshëm për verifikim. Niveli i aksesimit për secilin rast bëhet nëpërmjet niveleve të sigurisë, të përcaktuara në varësi të funksionit dhe nevojës për informacion të Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit.

4. Me kërkesë të Komisionit ose Kolegjit të Apelimit, bankat e nivelit të dytë dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë aktivitete bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruara të japin informacion mbi depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur më të. Institucionet private rimbursohen nga institucionet e rivlerësimit për çdo kërkesë, duke përfshirë kërkesat në bazat e të dhënave dhe kopjet e dokumenteve të lëshuara.

5. Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave, sipas këtij neni, u nënshtrohen rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni ose Kolegji i Apelimit merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme ose aksidentale, si dhe nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona

të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në format elektronik, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale.

6. Brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, çdo organ shtetëror dhe ent publik detyrohet të bashkëpunojë me Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkë-punuar, asgjësimi, vonesat ose sjellja e papërshtatshme e procesit të verifikimit raportohen në zyrën e prokurorisë si vepër penale, sipas nenit 248, të Kodit Penal, dhe përbëjnë shkelje disiplinore.

7. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejtë të kërkojnë bashkë-punim ndërkombëtar brenda kuadrit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në rrugë diplomatike. Kërkesat trajtohen nga ministria përgjegjëse.

Neni 51
Përfundimet e bazuara në fakte

Në rast se subjekti i rivlerësimit nuk paraqet provat, sipas nenit 85, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe kur provat që disponojnë janë të paplota, Komisioni ose Kolegji i Apelimit mund të vendosin bazuar në provat që disponojnë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e tyre të brendshme.

Neni 52
Barra e provës

1. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit.

2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelimit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

3. Parashikimet e nenit 82 të Kodit të Procedurave Administrative nuk zbatohen.

Neni 53
Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve

1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë

drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim.

2. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kritereve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit.

3. Heqja dorë e personit nga raportimi nuk sjell pushimin e hetimit, nëse Komisioni ose Kolegji i Apelimit çmon se veprimi ose praktika e dyshuar përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht.

4. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit publikojnë një model denoncimi, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së informacionit nga publiku.

5. Të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë mbrohen automatikisht në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme, sipas standardeve të parashikuara në ligjin "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

Neni 54
Bashkëpunëtori i drejtësisë

1. Personi që ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale të korrupsionit me subjektin e rivlerësimit, ka të drejtë t'i drejtohet zyrës së prokurorisë kompetente për hetimin e veprave penale të korrupsionit, sipas legjislacionit penal.

2. Prokurori mund t'i japë statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë personit që shpreh vullnetin për të dhënë informacion të mjaftueshëm për praktikën korruptive ndërmjet tij dhe subjektit të rivlerësimit.

3. Personi ka të drejtë përfaqësohet nga mbrojtësi i tij ligjor.

4. Nëse arrihet marrëveshja e bashkëpunimit, bashkëpunëtori i drejtësisë duhet të japë informacion të plotë dhe pa asnjë rezervë ose kusht, për të gjitha faktet, ngjarjet dhe rrethanat që shërbejnë si prova vendimtare për zbulimin, hetimin dhe parandalimin e korrupsionit të subjekteve të rivlerësimit. Dëshmia e dhënë me shkrim nga bashkëpunëtori i drejtësisë përpara prokurorit, përbën një provë thelbësore për procesin e rivlerësimit dhe procese të tjera ligjore.

5. Bashkëpunëtori i drejtësisë nuk mund të ndiqet penalisht për veprat e korrupsionit që ka kryer me subjektin e rivlerësimit, sipas dëshmisë së

dhënë. Një kopje e dëshmisë dhe e marrëveshjes së bashkëpunimit i jepet bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe institucioneve të rivlerësimit.

6. Marrëveshja e bashkëpunimit mund të revokohet në rast se bashkëpunëtori i drejtësisë nuk dorëzon provat pranë institucioneve të rivlerësimit ose jep dëshmi të rreme, për të cilën mban përgjegjësi penale, sipas legjislacionit penal.

7. Subjekti i rivlerësimit që ka përfituar shumën, mbart detyrimin t'ia kthejë atë bashkëpunëtorit të drejtësisë, pavarësisht se ka shkelur ligjin. Subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet të ngrejë pretendimin se fitimi i ardhur për shkak të kësaj shume ka humbur gjatë kalimit të kohës. Kthimi i shumës mund t'u kërkohet drejtpërdrejt dhe çdo personi të lidhur me subjektin e rivlerësimit, nëse vërtetohet se atij i ka kaluar një vlerë më e madhe se 100 000 lekë pa shkak të ligjshëm, që nga 1.1.2006. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë të drejtë të paraqesin në gjykatë padi regresi ndaj personave të tretë që mund të kenë përfituar shumën përkatëse.

Neni 55
Seanca dëgjimore

1. Komisioni fton subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Vëzhguesit ndërkombëtarë njoftohen paraprakisht për zhvillimin e seancës dëgjimore.

2. Seanca dëgjimore e Komisionit është publike dhe zhvillohet në përputhje me nenin 20 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

3. Komisioni ka të drejtë të marrë në pyetje subjektin e rivlerësimit. Subjektit të rivlerësimit mund t'i drejtojë pyetje edhe vëzhguesi ndërkombëtar, nëse ai pranon të përgjigjet. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve. Pyetjet mund të përfshijnë njohuritë dhe aftësitë praktike në fushën e së drejtës, ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën vitin e fundit.

4. Komisioni ka të drejtë të kufizojë në mënyrë të arsyeshme kohën e parashikuar për t'u shprehur nga ana e subjektit të rivlerësimit.

5. Bisedimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit zhvillohen me dyer të mbyllura në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar. Vendimi i Komisionit merret me votim të hapur dhe me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të trupit gjykues. Nëse gjatë vendimmarrjes ka

qëndrime të ndryshme nga ai i shumicës, komisionieri i mbetur në pakicë arsyeton me shkrim mendimin e tij. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të shkruajë një mendim ndryshe/paralel që i bashkohet vendimit. Procesverbali i bisedimeve të çështjes mbahet nga personeli i regjistrit të Komisionit.

6. Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore.

7. Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.

Neni 56
Dorëheqja

1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

Neni 57
Vendimi i Komisionit

1. Relatori i çështjes arsyeton me shkrim vendimin e Komisionit.

2. Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese.

3. Hyrja e vendimit përmban:

a) emërtimin zyrtar të Komisionit;

b) trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësin administrativ;

c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë;

ç) emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesve të tij;

d) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij.

4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban:

a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues;

b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet;

c) raportin dhe rekomandimin e relatorit;

ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi.

5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban:

a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues;

b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore;

c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij.

Neni 58
Masat disiplinore

1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit:

a) konfirmimin në detyrë;

b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës;

c) shkarkimin nga detyra;

2. Në rast se subjektet e rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni mund të vendosë:

a) emërimin si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve;

b) refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.

Neni 59
Konfirmimi në detyrë

1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme:

a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

2. Parashikimi i paragrafit të mësipërm nuk zbatohet për rastin e parashikuar në nenin 61, pika 5, të këtij ligji.

3. Komisioni arsyeton në vendimin e tij se subjekti i rivlerësimit konsiderohet i përshtatshëm për të vazhduar ushtrimin e detyrës, duke shpjeguar arsyet e mosmarrjes së masës disiplinore.

4. Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim.

Organi kompetent fillon menjëherë shqyrtimin e shkaqeve, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.

Neni 60
Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit

1. Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhe 1-vjeçare i jepet subjektit të rivlerësimit nëse janë evidentuar mangësi në aftësitë e tij profesionale që mund të plotësohen.

2. Në rast se subjekti i rivlerësimit përfundon programin e trajnimit, Shkolla e Magjistraturës i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë rezultatet e provimit përfundimtar, duke u shprehur nëse mangësitë janë mënjanuar ose jo.

3. Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit brenda 10 ditëve të paraqesë një shpjegim me shkrim mbi arsyet e mospërfundimit me rezultate të kënaqshme të programit të trajnimit gjatë periudhës së pezullimit. Një kopje e këtij njoftimi i dërgohet vëzhguesit ndërkombëtar.

Neni 61
Shkarkimi nga detyra

Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste:

1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të.

2. Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës.

3. Kur rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.

4. Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.

5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

KREU VIII
APELIMI

Neni 62
Te drejtat e subjektit të rivlerësimit pas dhënies së vendimit të Komisionit

1. Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet *ex lege* nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimeve. Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.

2. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje. Ai është i detyruar të ofrojë një adresë elektronike alternative për vazhdimin e komunikimit me institucionet e rivlerësimit, gjatë gjithë procesit.

3. Në rastin kur mungon një adresë elektronike alternative, subjekti i rivlerësimit njoftohet në përputhje me nenin 52 të ligjit "Për organizimin

dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Neni 63
Paraqitja e ankimit

1. Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

2. Ankimi depozitohet pranë Komisionit që ka dhënë vendimin, sipas nenit 46 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

3. Rregullat për ankimin administrativ, parashikuar në nenin 128, të Kodit të Procedurave Administrative, nuk zbatohen.

Neni 64
Njoftimi i ankimit

Ankimi i njoftohet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 42, të këtij ligji, dhe nenin 52 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Neni 65
Procesi gjyqësor

1. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51, dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

2. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik, për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

3. Në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik, Kolegji i Apelimit e gjykon çështjen në seancë publike.

Neni 66
Vendimi i Kolegjit të Apelimit

1. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelimit vendos:

a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit;

b) ndryshimin e vendimit të Komisionit;

c) prishjen e vendimit të Komisionit.

2. Kolegji i Apelimit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

3. Vendimi i Kolegjit të Apelimit, që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm *ex lege*.

Neni 67
Rivendosja në afat e së drejtës për ankim

1. Nëse subjekti i rivlerësimit ose Komisioneri Publik nuk paraqesin ankimin brenda afatit, kanë të drejtë të kërkojnë rivendosjen në afat të ankimit pranë Komisionit, brenda 15 ditëve nga data që vihen në dijeni për shkakun e humbjes të së drejtës, por jo më vonë se data e vendimit të marrë nga Kuvendi, sipas nenit 179/b, pika 9, të Kushtetutës.

2. Kërkesa shqyrtohet nga Kolegji i Apelimit dhe mund të pranohet vetëm nëse ankimi nuk është paraqitur në kohë, për shkaqe legjitime dhe të arsyeshme.

KREU IX
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 68
Marrëdhëniet kalimtare midis institucioneve

1. Vlerësimet e aftësive profesionale, të kryera nga organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale në datën e fillimit të funksionimit të Komisionit dhe të Kolegjit të Apelimeve, u dorëzohen këtyre të fundit. Protokolli i dorëzimit të dokumenteve ligjore dhe raporteve, në lidhje me vlerësimet për aftësitë profesionale, nënshkruhen nga përfaqësuesi i organit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe një Komisioner i zgjedhur me short.

2. Për efekt të zbatimit të këtij ligji, ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të organizojë një konkurs jashtë radhe për pranimin e 25 kandidatëve për magjistratë (të ndarë në gjyqtarë dhe prokurorë), përkatësisht për secilin vit akademik 2016 – 2017 dhe 2017–2018.

3. Byroja e Kuvendit, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton për sistemin elektronik të votimit:

a) fondin limit të nevojshëm;

b) termat e referencës për zhvillimin e sistemit elektronik dhe ofrimit të shërbimit: si dhe

c) procedurat e nevojshme të prokurimit në përjashtim të rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi të prokurimit publik.

Kuvendi, brenda 25 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të garantojë fondet dhe të realizojë procedurat e nevojshme të prokurimit për sistemin elektronik të votimit, të parashikuar në nenin 10 të këtij ligji. Secili grup parlamentar cakton ekspertë për të mbikëqyrur ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik.

4. Ngarkohen organet përgjegjëse për marrjen e masave ligjore dhe administrative për zbatimin e këtij ligji menjëherë pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 69
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të marrë masat e nevojshme për të pajisur me zyrë institucionet e rivlerësimit, si dhe të krijojë kushtet e nevojshme të punës për zbatimin e gjithë kërkesave të këtij ligji.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të miratojë rregullat dhe procedurat e testimit, parashikuar në nenin 42, pika 2, shkronja "b", të këtij ligji.

3. Brenda 30 ditëve nga krijimi i institucioneve të rivlerësimit, mbledhja e anëtarëve të Komisionit, mbledhja e gjyqtarëve dhe mbledhja e komisionerëve publikë kanë detyrimin të miratojnë rregullat për veprimtarinë e institucioneve përkatëse të rivlerësimit.

4. Procedura për zhvillimin e shortit të përcaktuar në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, mira-tohet, sipas rastit, me vendim të mbledhjes së anëtarëve të Komisionit ose të gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit.

Neni 70
Mbarimi i institucioneve të rivlerësimit

1. Institucionet e rivlerësimit pushojnë së funksionuari sipas nenit 179/b, pika 9, të Kushte-tutës.

2. Përveç rasteve kur autorizohet ndryshe nga Kuvendi, mandati i vetëm që vazhdon është ai i Sekretarit të Përgjithshëm, i cili ka një personel të mjaftueshëm për të përmbushur detyrat.

Neni 71
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 30.8.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHTOJCA 1

DEKLARATA

"Për lejimin e monitorimit të komunikimeve elektronike dhe të ardhurave financiare"

Unë _____, i biri/e bija e _____dhe i/e _____, i/e datëlindjes _____lindur në _____

dhe banues në _____, me kombësi _____dhe shtetësi _____, aktualisht me punë pranë ___, me detyrë _____, me vullnetin tim të lirë;

Mbështetur e në zbatim:

D E K L A R O J S E:

të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;

- Unë kuptoj dhe pranoj se në rast se zgjidhem në një nga pozicionet e parashikuara në nenin 179/b, pika 5, dhe në Aneksin e Kushtetutës, gjatë ushtrimit të detyrës do të plotësoj deklaratën vjetore të pasurisë dhe do të jem subjekt i monitorimit sistematik të llogarive dhe transaksioneve financiare, si dhe komunikimeve elektronike që lidhen me ushtrimin e detyrës. Jam dakord që deklaratat e pasurisë të behen publike.
- Jam dakord që këto komunikime, duke përfshirë numrin e telefonit që kam në përdorim dhe adresa ose adresat e postës elektronike t'i nënshtrohen monitorimit nga Byroja Kombëtare e Hetimit, përfshirë leximin e postës elektronike, mesazheve tekst, dëgjimin e bisedave dhe formave të tjera të komunikimit elektronik, në përputhje me ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.
- Jap pëlqimin që Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të

Parave mund të kërkojë dhe të pajiset me të gjitha të dhënat e llogarive bankare dhe transaksioneve financiare nga bankat dhe institucionet financiare jobankare, në Shqipëri ose jashtë shtetit.

- Jam i informuar se mosrespektimi i kushteve të mësipërme mund të passjellë shkarkimin nga detyra, sipas ligjit.

_____, më ___.___.20___

D E K L A R U E S I

(_____)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al,
E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	

SHTOJCA 2

DEKLARATË E PASURISË

Plotësohet nga subjekti i rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë së tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë dhe çdo personi të përmendur në certifikatën familjare, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË

Emri	Atësia	Mbiemri

Funksioni

Institucioni dhe adresa

Data e emërimit në detyrë	Data e dorëzimit të deklaratës

Në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

A U T O R I Z O J:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Institucionet e rivlerësimit, vëzhguesit ndërkombëtarë të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time dhe personave të lidhur me mua.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

KUJDES ! KY ËSHTË DOKUMENT ZYRTAR DHE PASQYRIMI I TË DHËNAVE TË PAVËRTETA, TË PAPLOTA, E TË PASAKTA E BËN DEKLARATËN TË RREME DHE NDËSHKOHET PENALISHT.

Nënshkrimi i subjektit

"DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT" 1

Informacion në ndihmën tuaj

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjin "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

ILDPKI, bazuar në deklarimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë", ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative".

Deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit

- Dokumenti zyrtar "Deklaratë e pasurisë" duhet të plotësohet nga subjekti i rivlerësimit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare), bashkëjetuesit/es, burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit, përfshirë interesat privatë që i ka në pronësi ose në përdorim, sipas nenit 3, pikat 9 dhe 11, të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes, bashkëjetuesit/es është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, bashkëjetuesit/es me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Deklarata e Pasurisë plotësohet në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim.

- Subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e pasurisë të personave të lidhur.

Deklarimi i pasurisë nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit

- Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare), i cili mbart detyrimin për deklarim të pasurisë në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 9-13 e këtij dokumenti.
- Në çdo rast, personi i lidhur, është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës, AUTORIZIMI ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

Deklarimi i pasurisë nga persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit

- Persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 14, të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Personat e tjerë të lidhur nëse konfirmojnë këto marrëdhënie më subjektin e rivlerësimit, mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit të Pasurive të Paluajtshme.

“DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT” 2

Kujdes!

Të gjithë subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur (bashkëshorti/ ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare), të cilët bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklaratën e pasurisë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1,5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Sanksionet:

Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kujdes!

Të gjitha faqet e deklaratës duhet të nënshkruhen nga subjekti i rivlerësimit, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me “Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse” në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, info@hidaa.gov.al.

“DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT” 3

TË DHËNA PERSONALE TË SUBJEKTIT
DHE PERSONAVE TË LIDHUR

PËRBËRJA FAMILJARE E SUBJEKTIT SIPAS CERTIFIKATËS
SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr. Personal	Lidhja me subjektin	Gjendja Civile
					SUBJEKTI	

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile: **(Njësia Administrative Nr., Rruga, Pallati nr., Bashki/Komunë)**
Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni: (Njësia Administrative Nr., Rruga, Pallati nr., Bashki/Komunë)
Rrethi i personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të pikës 7 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republika e Shqipërisë” janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë trungut familjar) dhe çdo person i përmendur në certifikatën familjare.

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr. Personal	Lidhja me subjektin	Gjendja Civile
					Babai i subjektit	
					Nëna e subjektit	
					Babai i bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					Nëna e bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					I biri/e bija e ndarë nga prindërit	
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	

Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale.

Bashkëlidhur subjekti i rivlerësimit duhet të dorëzojë: fotokopje të letrës së njoftimit (Kartës së Identitetit) për vete, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore.

Për fëmijët e tjerë subjekti duhet të dorëzojë fotokopje të Pasaportës ose të Certifikatës personale.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit

"DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT" 4

DEKLARIMI I PASURIVE

Objekti i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluara ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11, të ligjit "Për rivlrësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

*** Neni 3, pikat 11 dhe 19, të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë";**

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, në pronësi dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit;

b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, të cilat janë në pronësi dhe në përdorim të subjekti të rivlerësimit;

c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;

ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;

d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj brenda dhe jashtë vendit;

*** Neni 4/1** i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë"; Subjekti që plotëson këtë deklaratë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1,5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i subjektit

“DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT” 5

ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE

Objekti i deklarimit: Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, licenca dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të subjektit, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore. Të ardhurat nga paga neto duke filluar që nga momenti i fillimit të detyrës deri ditën e deklarimit, të ardhura nga qiratë për vete dhe personat e lidhur në përputhje me nenin 3, pika

19, të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit. Të ardhurat nga paga neto duke filluar që nga momenti i fillimit të detyrës deri ditën e deklarimit, të ardhura nga qiratë për vete dhe personat e lidhur.	
Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij

Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i subjektit

“DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT” 6

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e deklarimit të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.
- Të dhënat për emra personash, ndaj të cilëve keni detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 8, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor.	
Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të rivlerësimit. (me shifra dhe me fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i subjektit

"DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT" 7

TË DHËNA KONFIDENCIALE

Të dhëna konfidenciale në lidhje me; pasuri private të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, detyrime financiare, burimet e origjinës së pasurive, identitetin e personit juridik ose fizik huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat me të cilët keni marrëdhënie interesi.	Nr. i regjistrit publik, Nr. kontratës noteriale, data/muaji/viti

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim:

Emër, Atësi, Mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me subjektin	Lloji i interesave privatë, vendndodhja e tyre.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit
Telefon privat e celular
Telefon zyre, faks, e-mail

“DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT” 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al,

E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	

DEKLARATË E PASURISË E PERSONIT TË LIDHUR

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë apo çdo person i përmendur në certifikatën familjare) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M

PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE

Në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokuroëve në Republikën e Shqipërisë”;

AUTORIZOJ:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe institucionet e rivlerësimit, vëzhguesit ndërkombëtar që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time dhe personave të lidhur me mua.

Shtetasi/sja _____,
Emër, Atësi, Mbiemër

bashkëshorti/ja ☐
fëmijë madhorë së bashku me prindërit ☐
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit ☐
bashkëjetuesi/ja ☐
përcakto tjetër.....

i/e Subjektit _____
Emër, Atësi, Mbiemër

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim ☐
Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim ☐

Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i personit të lidhur

"DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT" 9

DEKLARIMI I PASURIVE DHE BURIMI I KRIJIMIT

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë. Pjesa			
Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

***Objekti i deklarimit** sipas nenit 3, pikat 11 dhe 19, të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë";

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, që ndodhen në pronësi dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit;

b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publike dhe të drejtat reale mbi to, përfshirë edhe ato në përdorim;

c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;

ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;

d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

*** Neni 4/1** i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë";

Subjeki i rivlerësimit që plotëson këtë deklaratë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1,5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

“DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT” 10

ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE

- Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, licenca dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër.
- Të ardhurat nga paga neto duke filluar që nga momenti i fillimit të detyrës deri ditën e deklarimit, të ardhura nga qiratë disponuar veçmas.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit . Të ardhurat nga paga neto duke filluar që nga momenti i fillimit të detyrës deri ditën e deklarimit, të ardhura nga qiratë disponuar veçmas.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit . Të ardhurat nga paga neto duke filluar që nga momenti i fillimit të detyrës deri ditën e deklarimit, të ardhura nga qiratë disponuar veçmas.	
Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij

Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i personit të lidhur

“DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT” 11

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e deklarimit.
- Të dhënat për emra personash, ndaj të cilëve keni detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 13, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të de ty rimit (muaji/ viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor, si dhe dokumentet shoqërues që disponohen.	
Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të punës (me shifra dhe me fjalë

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i personit të lidhur

“DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT” 12

TË DHËNA KONFIDENCIALE

Të dhëna konfidenciale në lidhje me: pasuri private të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, detyrime financiare, burimet e origjinës së pasurive, identitetin e personit juridik ose fizik huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat me të cilët keni marrëdhënie interesi.	Nr. i regjistrit publik, Nr. kontratës noteriale, data/muaji/viti

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri,
Nënshkrimi i personit të lidhur

Nr. Personal i personit të lidhur

Adresa

Telefon privat e celular

Telefon zyre, faks, e-mail

"DEKLARATA E PASURISË PËR PROCESIN E RIVLERËSIMIT" 13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHTOJCA 3

DEKLARATA PËR KONTROLLIN E FIGURËS

Ky dokument pranohet vetëm nëse:

- Është plotësuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, në dorëshkrim, me shkronja kapitale dhe pa korrigjime.
- Nuk ka rubrika të paplotësuara.
- Subjekti i rivlerësimit shkruan emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin në vendin e caktuar në fund të çdo faqeje.

KAPITULLI I
SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

PJESA 1
TË DHËNA IDENTIFIKUESE

Ju lutem plotësoni të dhënat tuaja në mënyrë të saktë ashtu siç është shkruar në pasaportë, kartë identiteti, certifikatë të lëshuar nga gjendja civile.

Emri

Atësia

Mbiemri

Gjinia □ Femër □ Mashkull

Mbiemër tjetër i papërdorur

Data/Muaji/viti i lindjes _____/____/____

Vendi i lindjes

Shteti i lindjes

Shtetësia

Numri Personal (siç është në kartën e identitetit)

Statusi Civil:

i/e pamartuar	i/e martuar	i/e divorcuar	i/e ve	Bashkëjetues/e

A keni pasur emër tjetër më parë?

Jo □

Po □» Jepni detaje

A keni pasur shtetësi tjetër ose dyshtetësi?

Jo □

Po □» Jepni detaje

A keni adresë e-maili?

Jo □

Po □» Jepni adresën zyrtare të e-mailit, e cila do të përdoret për qëllim njoftimi gjatë procesit; Ju lutem jepni të gjitha adresat e tjera alternative të e-mailit;

A keni nr. Tel fiks?

Jo □

Po □» Jepni numrin e telefonit së bashku me prefiksin;

Numri/at e celularit që përdorni

PASAPORTA DHE KARTA E IDENTITETIT								
	Numri i Dokumentit	Data e lëshimit			Vlefshmëria			Vendi i Institucioni lëshimit lëshues
		Dita	Muaji	Viti	Dita	Muaji	Viti	
PASAPORTË								
KARTË IDENTITETI – ID								

PJESA 2

TË DHËNA PËR VENDIN E BANIMIT

Jepni informacion të saktë mbi adresën/at tuaja

Jepni adresën e plotë të vendbanimit aktual

A keni adresë tjetër vendbanimi? (adresë postare etj.)

Jo □

Po □ Jepni detaje

Adresa:

Historiku i adresave tuaja të banimit e fundit duke filluar nga 1.1.2012 (sipas rendit kronologjik)

Përfshihen: Adresat tuaja brenda apo jashtë Shqipërisë

Adresat e vendeve në të cilat keni jetuar për arsye studimesh/pune

Adresa të tjera tek të cilat keni jetuar përkohësisht

Vendosni të gjithë historikun tuaj të adresave pa lënë periudha kohore boshe.

Data e fillimit		Data e largimit		Adresa e plotë (nr. i shtëpisë, emri i rrugës, qyteti, rrethi, qarku, njësia bashkiake, kodi postar)	Vendi/Shteti
Muaji	Viti	Muaji	Viti		
__/_____		Aktualisht			
__/_____		__/_____			
__/_____		__/_____			
__/_____		__/_____			
__/_____		__/_____			

PJESA 3

TË DHËNAT PËR ARSIMIMIN DHE KUALIFIKIMET

Jepni detaje për arsimimin dhe të gjitha kualifikimet e kryera duke filluar nga shkolla e mesme

Edukimi apo kualifikimet përfshijnë:

- Shkollën e mesme
- shkollat verore
- specializimet, trajnimet e ndryshme
- kualifikimet e aftësisë
- teza/kërkime pasuniversitare

Data e fillimit		Data e përfundimit		Emri i plotë i institucionit ku keni ndjekur studimet (Nuk lejohet përdorimi i shkurtimeve)	Titulli i fituar apo teza e mbrojtur	Gjendja	Adresa e plotë e institucionit	Vendi/ Shteti
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
___/___		Aktualisht				□ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë		
___/___		___/___				□ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë		
___/___		___/___				□ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë		
___/___		___/___				□ përfunduar □ papërfunduar □ ndërprerë		

PJESA 4

TË DHËNA PËR PUNËSIMIN

Jepni detaje për punësimin dhe për periudhën e papunësisë gjatë duke filluar nga 1.1.2012 pa lënë hapësira kohore të papërfshira:

Periudha punësimit përfshin:

- Të gjithë periudhën e paguar të punësimit
- Vetëpunësimit/biznesit familjar, personal
- Interships
- Punë të papagueshme /vullnetare

Periudha e papunësisë përfshin:

- të gjitha hapësirat apo pauzat ndërmjet punësimit

Nëse nuk keni punuar asnjëherë shkruani "E paaplikueshme"

Data e fillimit		Data e përfundimit		Institucioni/ Operatori Ekonomik	Funksioni	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja e largimit
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
___/_____		Aktualisht						
___/_____		___/_____						
___/_____		___/_____						
___/_____		___/_____						
___/_____		___/_____						

PJESA 5
TË DHËNA PËR SIGURINË

a. A jeni përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?

Po □ Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

b. A keni dijeni se një nga anëtarët e familjes suaj është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?

Po □ Jo □

Nëse po, ju lutem jepni të dhënat e identitetit të familjarit tuaj, lidhjen tuaj familjare dhe të dhëna për veprat penale për të cilat është hetuar ose/dhe akuzuar;

Me termin "anëtar familjeje" do të kuptohet bashkëshortja/ bashkëshorti i tij, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë, personi i lidhur me detyrime birësimi ose që bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët;

c. A keni pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës?

Po □ Jo □

Nëse po, ju lutem jepni të dhënat e identitetit të personit, lidhjen tuaj me të dhe të dhëna për veprat penale për të cilat është hetuar ose/dhe akuzuar.

ç. A keni pasur kontakte të përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës tuaj?

Po □ Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

d. A jeni në dijeni që një nga anëtarët e familjes suaj ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar?

Po □ Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

e. A keni pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar?

Po □ Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

f. A keni dijeni se një person i lidhur sipas ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar?

Po □ Jo □

Nëse po ju lutem jepni shpjegime;

g. Gjate 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s?

Po □ Jo □

Nëse po, jepni detaje për periudhën kohore kur ka ndodhur, vendin dhe rrethanat;

h. A keni kërkuar azil politik në ndonjë shtet?

Po □ Jo □

Nëse po, jepni detaje për periudhën kohore kur ka ndodhur, vendin dhe rrethanat;

D E K L A R A T Ë

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në deklaratën për kontrollin e figurës janë të sakta dhe të vërteta.

Jam i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Tiranë më ____/___/____

Emër Atësi Mbiemër

Nënshkrimi

D E K L A R A T Ë

Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale

Unë_____,i biri i/e bija e_____dhe i/e_____,

i/e vitlindjes _____ , lindur në _____ dhe banues/

banuese në __, me kombësi _____dhe shtetësi _____,

aktualisht me punë pranë _____, me detyrë

, me vullnetin tim të lirë;

DEKLAROJ SE:

Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhet procedura e kontrollit të figurës në funksion të ligjit "Për rivlerësimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë".

Jam dakord që të dhënat e mia personale të deklaruara në "Formularin e Kontrollit të Figurës", të trajtohen nga personat përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale për qëllimet e ligjshme.

Jam i ndërgjegjshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

_____ , me ___.___.20___

D E K L A R U E S I

(_____)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHTOJCA 4

FORMULARI I VETËVLERËSIMIT PROFESIONAL

A. Të dhënat identifikuese

Ju lutem plotësoni të dhënat tuaja në mënyre të saktë ashtu siç është shkruar në pasaportë, kartë identiteti, apo certifikatë të lëshuar nga gjendja civile.

Emri:

Atësia:

Mbiemri:

Gjinia: □ Femër □ Mashkull

Data/muaji/viti i lindjes _____/_____/_____

Vendi i lindjes:

Shteti i lindjes: Shtetësia:

Numri Personal (sipas kartës së identitetit):

Adresa e e-mailit zyrtar:

Adresa e e-mailit privat:

Numër telefoni: Celular: _____ Fiks: _____

B. Të dhëna për punësimin

(Jepni detaje për punësimin dhe për periudhën e papunësisë gjatë 10 viteve të fundit pa lënë hapësira kohore të papërfshira)

Periudha punësimit përfshin: Periudha e papunësisë përfshin:

- Te gjithë periudhën e paguar punësimit
- të gjitha hapësirat apo pauza të ndërmjet punësimit
- Vetëpunësimit/biznesit familjar, personal
- Praktika të ndryshme
- Punë të papagueshme/vullnetare

Nëse nuk keni punuar asnjëherë shkruani "E paaplikueshme"

Data e fillimit		Data e përfundimit		Institucioni/ Operatori Ekonomik	Funksioni	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja e largimit
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
___/_____		Aktualisht						
___/_____		___/_____						
___/_____		___/_____						
___/_____		___/_____						
___/_____		___/_____						

C. Të dhëna për vetëvlerësimin profesional

(Vlerësimi i aktivitetit kryhet bazuar në kritereve vlerësuese të parashikuara në nenin 42 të këtij ligji).

1. Përshkrim i detyrave të kryera tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës:

a) Përcaktoni fushën e të drejtës në të cilën keni punuar kryesisht tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës:

b) Përcaktoni specializime në fushën e të drejtës (nëse ka):

2. Të dhënat statistikore që lidhen me veprimtarinë në përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit:

a) Numri i çështjeve të caktuara tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës:

b) Numri i çështjeve të përfunduara tre vitet e fundit të detyrës:

c) Numri i çështjeve të mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës:

3. Paraqitje e trajnimeve të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, si dhe të dokumenteve që vërtetojnë kryerjen e tyre. Dokumentet që vërtetojnë sa më sipër duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari.
4. Trajnime të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës. Dokumentet për trajnimet jashtë Shkollës së Magjistraturës duhet të evidentojnë përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin. Dokumentet që vërtetojnë sa më sipër duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari.

5. Rivlerësimi bazohet gjithashtu edhe në dokumentet ligjore, sipas nenit 3, pika 2, të këtij ligji. Subjekti i rivlerësimit duhet të përzgjedhë 3 (tre) dokumente ligjore të hartuara gjatë tre viteve të fundit të ushtrimit të detyrës, që ai ose ajo vlerëson të përshtatshme për t'u marrë në konsideratë në kuadër të vlerësimit profesional. Subjekti i rivlerësimit duhet të japë numrin e dosjes, të dhënat e palëve në gjykim (nëse ka), si dhe të bashkëlidhë një kopje të këtij dokumenti.

6. Lutemi të bashkëlidhni çdo dokument tjetër ligjor që vërteton veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, me qëllim marrjen parasysh gjatë procesit të rivlerësimit. Këto dokumente mund të përfshijnë çdo lloj tjetër dokumenti, me përjashtim të atyre të përmendur

në nenin 3, pika 2, të këtij ligji, që evidenton veprimtaritë profesionale dhe/ose trajnime të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Këto dokumente duhet të evidentohen në përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhënat për institucionin që ka organizuar aktivitetin.

D E K L A R A T Ë

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Tiranë më ___/___/____

Emër/mbiemër

Nënshkrimi

Udhëzime për plotësimin e formularit:

Ky dokument pranohet vetëm nëse:

- Është plotësuar nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- Nuk ka rubrika të paplotësuara;
- Subjekti i rivlerësimit shkruan emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin në vendin e përcaktuar në fund të çdo faqeje;
- Subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur të gjitha dokumentet e nevojshme.

LIGJ
Nr. 97/2016

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË*

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave në lidhje me:

a) organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë;

b) kushtet, kriteret dhe procedurat për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm;

c) marrëdhëniet e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm me institucionet e tjera shtetërore, me subjekte të tjera publike ose private dhe me publikun;

ç) funksionimin e administratës së prokurorisë;

d) statusin e nëpunësve civilë të prokurorisë.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si dhe për prokuroritë e specializuara që krijohen me ligj

* Ndryshuar me Ligjin Nr. 42, datë 23.03.2021;

të posaçëm, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligjet e posaçme.

Neni 2
Përkufizime
(shtuar shkronja "dh" me ligjin nr. 42/2021, neni 1)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Byroja Kombëtare e Hetimit" është njësia e posaçme hetimore, e parashikuar nga neni 148, paragrafi 4, i Kushtetutës.

b) "Drejtues i prokurorisë" është titullari/drejtuesi i çdo prokurorie, përfshirë Prokurorinë e Posaçme.

c) "Prokuror më i lartë" është:

i. Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe për prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe shkallës së parë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ii. drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së apelit për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë kësaj prokurorie;

iii. drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë kësaj prokurorie.

ç) "Prokuroria e Posaçme" është autoriteti përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit për veprat penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjet penale, sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës.

d) "Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm" janë prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë, pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të apelit dhe Prokuroria e Përgjithshme.

dh) "Këshilltar ligjor" është këshilltari që ushtron funksionin e tij në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme."

Neni 3
Objekti i veprimtarisë së prokurorisë

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria i ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur nëpërmjet prokurorëve.

KREU II
PARIMET THEMELORE TË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË PROKURORISË

Neni 4
Ligjshmëria e veprimtarisë

1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi.

2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.

Neni 5
Detyrueshmëria e ndjekjes penale

Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 6
Pavarësia e prokurorëve

1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashtrojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat.

Neni 7
Mbrojtja dhe statusi i prokurorit

1. Statusi i prokurorëve përcaktohet nga ligji "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Prokurorëve dhe familjarëve të tyre u garantohet mbrojtje e veçantë nga shteti në rast se, për shkak të ushtrimit të detyrës, u kërcënohen jeta, shëndeti, familja apo prona.

Neni 8
Objektiviteti dhe barazia

Prokurorët sigurojnë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, pronës, arsimimit, lindjes, aftësisë së kufizuar, origjinës shoqërore, përkatësisë prindërore ose për arsye të tjera.

Neni 9
Konfidencialiteti i të dhënave

1. Prokurorët dhe gjithë personeli i prokurorisë, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si edhe pas përfundimit të saj, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror për fakte për të cilat vijnë në dijeni, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

2. Prokurorisë nuk i lejohet të bëjë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

3. Prokurorëve u ndalohet të bëjnë deklarata ose të japin mendime për veprimtarinë e organeve të tjera.

Neni 10
Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale

Prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre dhe të sillen në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjin dhe rregullat e etikës.

Neni 11
Ushtrimi i funksioneve të prokurorisë vetëm nga prokurorët

1. Funksionet e prokurorisë ushtrohen vetëm nga prokurorët e Republikës së Shqipërisë, të emëruar sipas ligjit.

2. Delegimi i funksioneve të prokurorit tek autoritete të tjera është i ndaluar, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

3. Marrja përsipër e funksioneve të prokurorit nga autoritete të tjera është e ndaluar.

KREU III
STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I PROKURORISË

Neni 12
Struktura e prokurorisë

Prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor. Prokuroria e Posaçme rregullohet me ligj të veçantë. Pranë degëve të gjykatave nuk ngrihen degë të përhershme ose të përkohshme të prokurorisë.

Neni 13
Organizimi dhe drejtimi i prokurorisë

1. Prokuroria përbëhet nga:

a) Prokuroria e Përgjithshme;

b) Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të posaçëm;

c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;

ç) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

2. Drejtimi dhe përfaqësimi i prokurorisë, sipas këtij organizimi, bëhet, respektivisht, nga:

a) Prokurori i Përgjithshëm;

b) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;

c) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;

ç) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 14
Prokuroria e Përgjithshme

1. Prokuroria e Përgjithshme ka juridiksion mbi të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe e ka selinë në Tiranë.

2. Prokuroria e Përgjithshme përfaqëson çështjet përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të çështjeve të juridiksionit të Prokurorisë së Posaçme, dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

3. Funksionet e Prokurorisë së Përgjithshme ushtrohen nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 15
Prokuroria e Posaçme
(pika 1 ndryshuar me ligjin nr. 42, date 23.03.2021, neni 2)

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit për veprat penale të korrupsionit, krimit të organizuar, terrorizmit dhe çështjet penale, sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kushtet shtesë që prokurorët, nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të saj duhet të përmbushin, si dhe marrëdhëniet e saj me institucionet e tjera shtetërore dhe me subjekte të tjera publike ose private rregullohen sipas ligjit të posaçëm për organizimin dhe funksionimin e saj.

3. Konflikte të mundshme të kompetencave mes Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm zgjidhen nga ligji procedural penal.

Neni 16
Prokurorët pranë gjykatave të apelit

Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate apeli të juridiksionit të përgjithshëm ushtrohen nga prokurorët e apelit. Juridiksioni i tyre shtrihet në territorin e juridiksionit të gjykatës përkatëse.

Neni 17
Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë

Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ushtrohen nga prokurorët pranë gjykatës së shkallës së parë. Juridiksioni i tyre shtrihet në territorin e juridiksionit të gjykatës përkatëse.

Neni 18
Numri i përgjithshëm i prokurorëve

1. Numri i përgjithshëm i prokurorëve në juridiksionin e përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Posaçme propozohet përkatësisht nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe miratohet nga Kuvendi.

2. Numri i përgjithshëm i prokurorëve propozohet bazuar në:

a) raportin mbi ngarkesën e punës së prokurorëve, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e Këshillit të Ministrave për luftën e kriminalitetit gjatë tri viteve të fundit;

b) garantimin e veprimtarisë së prokurorisë dhe njëkohësisht sigurimin e aksesit të shtetasve në shërbimin e prokurorisë, rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve, uljen e shpenzimeve dhe përdorimin e të ardhurave në mënyrë efiçente.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në propozimin e numrit të prokurorëve, marrin paraprakisht mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Neni 19
Numri i prokurorëve për çdo prokurori

1. Prokurori i Përgjithshëm publikon, brenda muajit mars të çdo viti, raportin vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin kalendarik paraardhës, si dhe rekomandimet për përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së tyre.

2. Prokurori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, vlerëson, së paku çdo pesë vjet, numrin e prokurorëve për çdo prokurori dhe, nëse është e përshtatshme, ripërcakton numrin e tyre, pasi ka marrë mendimin e drejtuesve të prokurorive përkatëse.

3. Vendimi për përcaktimin e numrit të prokurorëve për çdo prokurori pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Posaçme duhet të marrë parasysh objektivat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 18, të këtij ligji, dhe të synojë garantimin e një ngarkese të balancuar pune për të gjithë prokurorët dhe prokuroritë e vendit.

Neni 20
Struktura e prokurorive

Struktura e prokurorive përcaktohet në rregulloren e organizimit të brendshëm të secilës prokurori, sipas strukturës standarde të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, brenda numrit të prokurorëve të miratuar nga Kuvendi dhe numrit total të punonjësve të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit.

Neni 21
Seksionet e prokurorive

1. Në çdo prokurori, për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme, drejtuesi i prokurorisë krijon seksione me jo më pak se tre prokurorë, pasi ka marrë mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve. Ngritja e tyre bazohet, ndër të tjera, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin, përhapjen dhe kategoritë e veprave penale, subjekteve, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit. Seksioni i posaçëm për të miturit ngrihet, në çdo rast, në prokuroritë pranë gjykatave në të cilat janë krijuar sipas ligjit seksionet përkatëse për gjykimin e të miturve.

2. Drejtuesi i seksionit emërohet nga drejtuesi i prokurorisë nga radhët e prokurorëve të seksionit, të cilët kanë të paktën 5 vjet përvojë si prokurorë, rezultate të mira në punë dhe aftësi organizative.

KREU IV
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

SEKSIONI I
KUSHTET DHE KRITERET PËR ZGJEDHJEN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 22
Kushtet ligjore për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm

1. Kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm duhet të plotësojnë kushtet e parashikuara nga neni 148/a, paragrafi 3, i Kushtetutës.

2. Për efekt të integritetit moral dhe profesional, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet si vijon:

a) të kalojnë me sukses verifikimin e plotë të pasurisë dhe figurës së tyre, sipas ligjit;

b) të plotësojnë kërkesat e ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

c) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

ç) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të asnjë shërbimi sekret;

d) të mos jenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) të mos jenë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos kenë masë disiplinore në fuqi.

Neni 23
Kriteret për vlerësimin e kandidatëve

1. Kandidatët që përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në nenin 22, të këtij ligji, vlerësohen dhe renditen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në këto kritere:

a) rezultatet e vlerësimit profesional të kandidatit në fushën e drejtësisë penale;

b) integriteti moral dhe profesional i kandidatit;

c) aftësitë organizative dhe drejtuese;

ç) vlerësimin e elementëve plotësuese, sipas nenit 27 të këtij ligji.

2. Në rastet kur kandidatët kanë të njëjtën meritë, vlerësohet vjetërsia në ushtrimin e profesionit dhe eksperienca profesionale.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, dhe në zbatim të parashikimeve të bëra në këtë seksion, miraton rregulla më të detajuara për:

a) mënyrën e organizimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve, sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj;

b) përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre;

c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta në procesin e vlerësimit.

Neni 24
Kriteret profesionale për renditjen e kandidatëve

Këshilli i Lartë i Prokurorisë kryen vlerësimin profesional të kandidatëve,

bazuar në aftësitë profesionale, njohuritë dhe kualifikimet ligjore të tyre, si vijon:

a) përvojën e punës për pozicionin për të cilin konkurron kandidati;

b) rezultatet e vlerësimit profesional dhe etik të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, apo rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e drejtësisë penale;

c) rezultatet e arritura gjatë studimeve në ciklin e lartë të arsimit, gjatë formimit fillestar dhe atij të vazhdueshëm në Shkollën e Magjistraturës, dhe në trajnime dhe kurse të certifikuara, brenda dhe jashtë vendit;

ç) rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e së drejtës penale;

d) punimet akademike, studimet shkencore, shkrimet dhe ligjëratat profesionale, botimet, pjesëmarrja në aktivitete shkencore, pjesëmarrja në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

Neni 25
Kriteret morale për renditjen e kandidatëve

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë kryen vlerësimin e integritetit moral dhe profesional të kandidatëve bazuar në:

a) reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve, si rezultat i sjelljes së tij në ushtrimin e funksioneve, dhe në veprimtaritë e kryera kur nuk është duke ushtruar funksionet e tij;

b) cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia dhe dinjiteti.

2. Rregullime të mëtejshme për zbatimin e këtyre kritereve përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas nenit 23 të këtij ligji.

Neni 26
Kriteret organizative dhe drejtuese për renditjen e kandidatëve

Këshilli i Lartë i Prokurorisë kryen vlerësimin e aftësive organizative dhe

drejtuese të kandidatit, sipas këtyre kritereve:

a) cilësisë së platformës dhe vizionit që paraqesin;

b) aftësive të provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, bazuar edhe në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësive të komunikimit;

ç) aftësive të të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore dhe/ose multikulturore;

d) aftësive të përfaqësimit publik.

Neni 27
Elemente plotësuese vlerësimi për renditjen e kandidatëve

Krahas kritereve të parashikuara në nenet 24, 25 dhe 26, të këtij ligji, në vlerësimin e kandidatëve mund të mbahen parasysh edhe:

a) mbajtja e titujve akademikë;

b) kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;

c) njohja e gjuhëve të huaja.

SEKSIONI II
PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT
TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 28
Organi përgjegjës për përzgjedhjen

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përzgjedh kandidaturat për Prokuror të Përgjithshëm, ndër ata që përmbushin kushtet e parashikuara në këtë ligj.

2. Këshilli, në përzgjedhjen e kandidaturave, zbaton rregullat e këtij seksioni. Rregulla më të detajuara për procedurën e përzgjedhjes miratohen me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 29
Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, jo më vonë se 4 muaj përpara mbarimit

të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm. Në rast të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, procedura fillon menjëherë.

2. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar ose me lajmërim në mediat audiovizive kombëtare.

3. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit përmban informacion lidhur me:

a) afatin brenda së cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit;

b) dokumentacionin që duhet të shoqërojë shprehjen e interesit;

c) kriteret, procedurën dhe metodologjinë e vlerësimit të kandidaturave;

ç) mënyrën dhe vendin e dorëzimit të kërkesave për kandidim.

Neni 30
Paraqitja e shprehjes së interesit

1. Brenda 30 ditëve nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit, kandidatët e interesuar shprehin interesin e tyre përmes një kërkese me shkrim drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të shoqëruar nga dokumentacioni që vërteton përmbushjen e kushteve dhe kritereve të parashikuara me ligj.

2. Shprehja e interesit mund të bëhet në adresën elektronike të përmendur në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit ose në adresën postare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kërkesat e depozituara prej kandidatëve publikohen menjëherë në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se emërohen;

c) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

ç) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë

bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimit sekret;

d) vetëdeklarimin, sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe një deklaratë të përditësuar të pasurive dhe të interesave financiarë.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur e vlerëson të nevojshme, kërkon informacion të mëtejshëm nga kandidati, nga organet publike ose punëdhënësi i kandidatit.

Neni 31
Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore

1. Brenda 45 ditëve nga dita kur mbyllet afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit, komisioni përgjegjës për emërimet/karrierën në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, verifikon plotësimin e kushteve nga kandidatët, sipas nenit 22, të këtij ligji, bazuar në parimin e barazisë para ligjit, ndalimit të diskriminimit dhe ndershmërisë në vlerësim.

2. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, si dhe të çdo shkaku tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshilli i Lartë i Prokurorisë kërkon informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillit për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshilli në kërkesën e tij.

3. Në përfundim të vlerësimit paraprak, komisioni harton listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe të kandidatëve të përjashtuar dhe ia paraqet atë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bashkë me raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga çdo kandidat dhe atë të grumbulluar, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë merr vendim për përjashtimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 22, të këtij ligji, dhe për lejimin e kandidimit të kandidatëve që i plotësojnë këto kushte.

5. Kandidatët e përjashtuar njoftohen në mënyrë të posaçme dhe të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

6. Ankimet kundër vendimeve për përjashtimin e kandidatëve bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 3 ditë nga dita e njoftimit të vendimit. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e depozitimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 32
Seanca dëgjimore

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë organizon seancë dëgjimore me kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, sipas nenit 31 të këtij ligji.

2. Kandidatët njoftohen me shkrim nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të paktën dhjetë ditë përpara datës së seancës dëgjimore.

Neni 33
Renditja e kandidatëve

Këshilli i Lartë i Prokurorisë merr vendim për miratimin e renditjes së kandidatëve, bazuar në rezultatet e vlerësimit të meritave të tyre, sipas nenit 23 të këtij ligji, dhe seancës dëgjimore dhe e publikon atë në faqen zyrtare të tij, së bashku me relacionin shpjegues përkatës. Relacioni shpjegon analizën dhe masën e përmbushjes për secilin kriter nga çdo kandidat, si dhe metodologjinë e ndjekur për vlerësimin e njëkohshëm dhe krahasimor të masës së përmbushjes së kritereve prej kandidatëve.

Neni 34
Ankimi

1. Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për propozimin e renditjes së tyre në listë, brenda tri ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi mund të bazohet vetëm në arsyetimin që kanë ndodhur gabime faktike ose procedurale, të cilat mund të kenë ndikuar në rezultatin e renditjes së kandidatëve. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda shtatë ditëve nga data e paraqitjes së ankimit. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton vetëm gabimet faktike ose procedurale, të cilat mund të kenë ndikuar në rezultatin e renditjes dhe nuk zëvendëson vlerësimin e kritereve me vlerësimin e saj. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet rekurs.

2. Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për renditjen e kandidatëve,

merr formë të prerë kur:

a) nuk është depozituar ankim brenda afateve të ankimit;

b) është depozituar ankim sipas afateve dhe gjykata ka vendosur pushimin apo rrëzimin e tij;

c) është depozituar ankim sipas afateve dhe mbi bazën e tij është shfuqizuar vendimi i Këshillit, me vendim të formës së prerë.

3. Në rastet kur gjykata pranon me vendim të formës së prerë ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ky i fundit rishikon vendimin e renditjes së kandidatëve brenda dy javëve nga marrja e vendimit të gjykatës, deri në masën e nevojshme në përputhje me gjetjet e gjykatës.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë publikon vendimin përfundimtar në faqen e internetit, duke përfshirë arsyetimin e vendimit, referuar verifikimit të kushteve ligjore, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve të kualifikuar në propozimin e emërimit.

Neni 35
Emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë i paraqet Kuvendit të Shqipërisë propozimin për të emëruar si Prokuror të Përgjithshëm tre kandidatët e renditur më lart në listë. Propozimi përfshin vendimin e arsyetuar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Prokurori i Përgjithshëm emërohet në përputhje me nenin 148/a të Kushtetutës.

Neni 36
Betimi dhe fillimi i detyrës

Prokurori i Përgjithshëm, përpara të se fillojë detyrën, bën betimin përpara Kuvendit të Shqipërisë në një ceremoni publike, sipas formulës: "Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale".

Neni 37
Statusi i Prokurorit të Përgjithshëm

Statusi i Prokurorit të Përgjithshëm përcaktohet në këtë ligj dhe në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

SEKSIONI III
KOMPETENCAT

Neni 38
Kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm

1. Prokurori i Përgjithshëm është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka përgjegjësi për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë.

2. Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

a) përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme;

b) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

c) siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm;

ç) propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm;

d) raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit;

dh) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për oficerët e Policisë Gjyqësore, në përputhje me këtë ligj;

e) përcakton strukturën e përgjithshme dhe rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe miraton organikën dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas përcaktimeve të nenit 20 të këtij ligji;

ë) përfaqëson prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët dhe ndihmën e ndërsjellë në çështje penale të juridiksionit të përgjithshëm;

f) kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë;

g) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Policisë Gjyqësore;

gj) kërkon fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore dhe ankesa ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore;

h) i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të ndjekjes penale, për hartimin e statistikës së njësuar në fushën e drejtësisë;

i) i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë inspektime tematike ose hetime për shkeljet individuale;

j) administron sistemin e përgjimeve, sipas legjislacionit në fuqi;

k) kryen detyra të tjera, të parashikuara në ligj.

3. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Prokurori i Përgjithshëm mund t'i delegojë me shkrim kompetenca të caktuara drejtorëve të drejtorive, drejtuesve të seksioneve ose prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas parashikimeve në këtë ligj ose në ligje të veçanta.

Neni 39
Zëvendësprokurori i Përgjithshëm

1. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm përfaqëson Prokurorinë e Përgjithshme, në mungesë dhe me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm ose kur vendi i tij është përkohësisht i lirë.

2. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm kryen vetëm detyrat që janë të nevojshme:

a) për funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe Policisë Gjyqësore;

b) për përfaqësimin e prokurorisë me të tretët.

3. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm zgjidhet, brenda 30 ditëve nga emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm, nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme me të paktën 10 vjet përvojë si prokuror dhe që janë vlerësuar "shumë mirë" në tre vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale.

4. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm emërohet nga Prokurori i Përgjithshëm, për një mandat dyvjeçar me të drejtë riemërimi, pasi ka marrë mendimin e mbledhjes së prokurorëve të prokurorisë. Mendimi i mbledhjes së prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme nuk është i detyrueshëm për Prokurorin e Përgjithshëm.

5. Në rast se Zëvendësprokurori i Përgjithshëm ka pengesë në ushtrimin e detyrave të tij ose për çfarëdo arsye pushon së vepruari si prokuror

në atë prokurori, ai zëvendësohet nga Prokurori i Përgjithshëm, sipas kritereve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

6. Prokurori i Përgjithshëm miraton me vendim rregulla më të hollësishme mbi procedurën e zgjedhjes së Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 40
Buxheti

1. Prokuroria ka buxhet të pavarur, si pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe parashikohet në një zë të veçantë të tij.

2. Buxheti i prokurorisë, në të cilin përfshihet buxheti i Prokurorisë së Përgjithshme, buxheti i prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe buxheti për Policinë Gjyqësore të seksioneve pranë prokurorisë hartohet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin përkatës të menaxhimit buxhetor e financiar.

3. Në rastin kur propozimi i buxhetit të prokurorisë nga Këshilli i Ministrave është i ndryshëm nga ai i propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm, ky i fundit ka të drejtë të marrë pjesë në procedurat parlamentare për të mbrojtur projektbuxhetin e propozuar.

4. Buxheti i Prokurorisë përfshin të ardhura nga donacione dhe çdo të ardhur tjetër të ligjshme.

5. Buxheti i Prokurorisë së Posaçme, mënyra e hartimit dhe zbatimit të tij rregullohen me ligjin përkatës.

KREU V
DREJTUESI I PROKURORISË

Neni 41
Drejtimi në prokurori

1. Prokuroritë drejtohen nga drejtuesi i prokurorisë.

2. Drejtuesi i prokurorisë emërohet në detyrë dhe ushtron kompetencat e tij sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë".

Neni 42
Kompetencat e drejtuesit në drejtimin e prokurorisë

Drejtuesi i prokurorisë ushtron këto detyra:

a) organizon punën dhe merr masat e nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë;

b) përfaqëson prokurorinë në marrëdhënie me të tretët;

c) organizon shpërndarjen e çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente, që përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me këtë ligj;

ç) krijon grupe hetimore për çështje të veçanta;

d) organizon diskutime për çështje të natyrës profesionale;

dh) mbikëqyr disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve;

e) bashkërendon punën me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Policinë Gjyqësore;

ë) bashkërendon punën me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës për çështje që lidhen me karrierën dhe rritjen profesionale të prokurorëve;

f) mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e administratës së prokurorisë për veprimtaritë që nuk lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale, në rast se nuk është parashikuar ndryshe me ligj;

g) garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm;

gj) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Policisë Gjyqësore nën juridiksionin e tij;

h) siguron përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori;

i) kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori;

j) miraton rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë dhe, në raste të justifikuara, përshtat strukturën standarde të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm me nevojat e prokurorisë dhe specializimin e personave në detyrë;

k) mbikëqyr respektimin e etikës së prokurorit dhe planifikimin e

punës së tyre, si dhe përmbush angazhimet ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore;

l) informon çdo tre muaj Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit.

Neni 43
Kompetencat në ushtrimin e ndjekjes penale

Drejtuesi i prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale:

a) koordinon veprimtarinë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete;

b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji;

c) jep urdhra të detyrueshëm për Policinë Gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve;

ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake;

d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj;

dh) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 44
Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë

1. Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë përfaqëson prokurorinë në rast mungese dhe me autorizim të drejtuesit ose kur vendi i tij mbetet përkohësisht i lirë.

2. Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë kryen vetëm detyrat që janë të nevojshme:

a) për funksionimin e prokurorisë;

b) për përfaqësimin e prokurorisë me të tretët;

c) për çdo detyrë tjetër të përcaktuar në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë emërohet nga radhët e drejtuesve të seksioneve, të cilët:

a) janë vlerësuar "shumë mirë" në tre vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale;

b) kanë të paktën pesë vjet përvojë si prokuror, nga të cilët të paktën tre vjet në të njëjtin nivel.

4. Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë emërohet për një mandat dyvjeçar, me të drejtë riemërimi, nga drejtuesi i prokurorisë, pasi të ketë marrë mendimin e mbledhjes së prokurorëve të prokurorisë. Mendimi i mbledhjes së prokurorëve nuk është i detyrueshëm për drejtuesin.

5. Në rast se zëvendësdrejtuesi nuk mund të ushtrojë detyrat e tij ose për çfarëdo arsye pushon së vepruari si prokuror në atë prokurori, zëvendësohet sipas kritereve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

6. Prokurori i Përgjithshëm miraton rregulla më të detajuara për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë.

KREU VI
ORGANIZIMI I BRENDSHËM I VEPRIMTARISË SË PROKURORISË

SEKSIONI I
MARRËDHËNIET BRENDA STRUKTURËS SË PROKURORISË

Neni 45
Pavarësia procedurale e prokurorëve

1. Prokurorët ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, gjatë hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim.

2. Zëvendësimi i prokurorit të çështjes lejohet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.

Neni 46
Udhëzimet e përgjithshme të detyrueshme

1. Prokurorët më të lartë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim, të cilat janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme i nënshtrohen vetëm

udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

2. Udhëzimet e përgjithshme, sipas këtij neni, mund të jenë të natyrës administrative ose procedurale.

3. Prokurori i Përgjithshëm mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme:

a) për koordinimin e punës ndërmjet prokurorive të ndryshme apo mes tyre dhe Policisë Gjyqësore, të përfshira në hetime të përbashkëta, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale;

b) për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale, bazuar në vendimet gjyqësore;

c) për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, për luftën kundër kriminalitetit;

ç) për raste të tjera që nuk kanë lidhje me çështje konkrete.

4. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejtojnë, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas nenit 43, shkronja "dh", të këtij ligji. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk mund të nxjerrë udhëzime që haptazi vijnë në kundërshtim me udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.

5. Udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesve të prokurorive publikohen në faqen e internetit të prokurorisë.

Neni 47
Kundërshtimi i udhëzimeve të përgjithshme

1. Prokurori mund të kundërshtojë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme, duke bërë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

2. Prokurori është i detyruar të ndjekë udhëzimet e ankimuara, me përjashtim të rastit kur vlerëson se ato janë haptazi në kundërshtim me ligjin.

3. Prokurori nuk mban përgjegjësi për ankimin dhe moszbatimin e udhëzimit, përveçse kur vepron haptazi në kundërshtim me ligjin dhe vepron me keqdashje ose pakujdesi të rëndë.

Neni 48
Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete

1. Udhëzime për çështje konkrete mund të jepen nga:

a) Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme;

b) drejtuesi i prokurorisë së apelit pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm për prokurorët në prokurorinë përkatëse;

c) drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm për prokurorët e prokurorisë përkatëse;

ç) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme;

d) drejtuesi i seksionit për prokurorët e caktuar në seksionin përkatës.

2. Udhëzimet për çështje konkrete nuk janë të detyrueshme.

3. Udhëzimet në lidhje me procedime konkrete, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, mund të jepen kryesisht në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit, ose më pas, kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit.

4. Udhëzimet, sipas këtij neni, duhet të jepen me shkrim dhe të jenë të arsyetuara. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe, brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim.

5. Kur prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me udhëzimet e dhëna, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme lidhur me to. Drejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit është i detyruar të japë shpjegime mbi udhëzimet dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, përndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr. Në rast se prokurori, ndaj të cilit është përsëritur udhëzimi, me shkrim, vendos të mos e ndjekë atë, njofton me shkrim drejtuesin e prokurorisë apo drejtuesin e seksionit, sipas rastit.

6. Udhëzimi me shkrim dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit i bashkëngjiten akteve të procedimit.

Neni 49
Zëvendësimi i prokurorit

1. Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal.

2. Prokurori mund të zëvendësohet edhe kur, për shkak të mungesës ose

paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore.

3. Drejtuesi i prokurorisë merr vendim me shkrim lidhur me zëvendësimin e prokurorit. Vendimi për tërheqjen e çështjes i dorëzohet prokurorit përkatës. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, prokurori ka të drejtën të paraqesë ankim me shkrim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kundër vendimit të zëvendësimit, brenda 5 ditëve nga marrja njoftim e tij. Vendimi me shkrim dhe ankimi përkatës janë pjesë e dosjes.

4. Vendimi lidhur me ankimin duhet të merret brenda pesë ditëve nga marrja e tij.

5. Ankimi nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Nëse ankimi pranohet, çështja i caktohet sërish prokurorit të cilit i ishte tërhequr.

6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht, të paktën çdo vit, një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve.

Neni 50
Raportimi vjetor te Prokurori i Përgjithshëm

1. Prokurori i Përgjithshëm mund të marrë periodikisht të dhëna dhe informacione nga prokuroritë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së tyre.

2. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm përgatisin, brenda muajit shkurt të çdo viti, raportin vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës dhe ia paraqesin Prokurorit të Përgjithshëm. Raporti publikohet në faqen e internetit te Prokurorisë së Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave që përmbahen në raportin vjetor.

4. Në rast se raporti jep shkak për të besuar se është kryer një shkelje disiplinore, Prokurori i Përgjithshëm mund të depozitojë kërkesë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për hetimin e shkeljes disiplinore.

5. Përmbajtja e raportit vjetor që përgatitet nga drejtuesit e prokurorisë miratohet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 51
Shmangia e konfliktit të interesit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, prokurorët detyrohen të shmangin çdo

konflikt interesi, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

SEKSIONI II
ADMINISTRIMI I PUNËS NË PROKURORI

Neni 52
Drejtimi administrativ i prokurorisë

1. Drejtuesi i prokurorisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton.

2. Prokurorët kanë detyrimin të informojnë drejtuesin e prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me punën mbi çështje të caktuara dhe vendimmarrjen, si dhe, në raste të veçanta, për problematika që shfaqen në ecurinë e procedimit.

3. Drejtuesi i prokurorisë merr masa për të garantuar përmbushjen e funksioneve administrative të prokurorisë, përfshirë mbajtjen e regjistrave dhe raporteve, mbajtjen e protokollit dhe arkivit, administrimin financiar dhe material, menaxhimin informatik, ndarjen e brendshme e detyrave, shqyrtimin e ankesave dhe detyra të tjera që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë.

Neni 53
Shpërndarja e çështjeve

1. Prokurori i Përgjithshëm përcakton rregulla të detajuara për:

a) procedurat e shpërndarjes së çështjeve, të cilat sigurojnë transparencë dhe mundësi të mjaftueshme verifikimi;

b) kriteret për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në ngarkesën e çështjeve dhe specializimin e prokurorëve;

c) rastet dhe kriteret për rishpërndarjen e çështjeve;

ç) mënyrën e monitorimit dhe dokumentimit të tyre.

2. Rregullat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, parashikojnë që çështja t'i caktohet paraprakisht të paktën tre prokurorëve, ndërsa caktimi përfundimtar të kryhet me short, në mënyrë elektronike.

3. Drejtuesi drejton dhe mbikëqyr procesin e shpërndarjes së çështjeve,

bazuar në rregullat e miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm.

4. Drejtuesi i prokurorisë siguron paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë, duke marrë parasysh nevojën për shpërndarjen e drejtë të ngarkesës mes prokurorëve.

5. Prokuroria e Posaçme përcakton rregullat e veta për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në parimin e transparencës dhe objektivitetit, sipas pikës 1 të këtij neni.

6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime periodike mbi caktimin e çështjeve.

SEKSIONI III
MBLEDHJET E PROKURORËVE

Neni 54
Mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme

1. Mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme përbëhet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme:

a) merr në shqyrtim planin e punës dhe raportin e punës së prokurorisë;

b) referon dhe diskuton mbi çështjet administrative të funksionimit të organit;

c) jep mendim mbi rregulloren e organizimit të brendshëm të Prokurorisë së Përgjithshme;

ç) diskuton mbi çështje që lidhen me personelin, formimin profesional, disiplinën, sigurinë, organizimin e punës dhe çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë;

d) jep mendim për projektudhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm;

dh) evidenton dhe diskuton probleme të zbatimit të ligjeve dhe akteve normative me rëndësi në veprimtarinë e prokurorisë;

e) jep mendim lidhur me raportin e punës së Prokurorisë së Përgjithshme;

ë) diskuton çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e

prokurorisë, përfshirë ato që lidhen me disiplinimin, karrierën dhe trajnimin e prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorisë.

3. Mbledhja e Prokurorisë së Përgjithshme thirret me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm ka detyrimin të thërrasë mbledhjen e prokurorëve, kur kërkohet nga të paktën një e treta e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 55
Mbledhja e prokurorëve të prokurorive të tjera

1. Drejtuesi i prokurorisë thërret dhe drejton mbledhjen e prokurorëve të strukturës përkatëse, për të diskutuar çështje me rëndësi të veprimtarisë së prokurorisë.

2. Mbledhja e prokurorëve ka detyrat e mëposhtme:

a) jep mendim mbi rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë;

b) jep mendim lidhur me përshkrimet e punës të të gjitha kategorive të nëpunësve civilë dhe punonjësve të prokurorisë dhe përshtatjen e strukturës standard, të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm, me nevojat e prokurorisë dhe aftësitë e personave në detyrë;

c) jep mendim për ngritjen e seksioneve, për strukturën dhe përbërjen e tyre;

ç) jep mendim mbi projektbuxhetin e prokurorisë përkatëse, përpara se të dërgohet në Prokurorinë e Përgjithshme;

d) diskuton çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë, përfshirë ato që lidhen me disiplinimin, karrierën dhe trajnimin e prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorisë;

dh) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

3. Drejtuesit e prokurorive kanë detyrimin të thërrasin mbledhjen e prokurorëve, kur kërkohet nga të paktën një e treta e prokurorëve.

Neni 56
Zhvillimi dhe procedura e mbledhjes së prokurorëve

1. Data, vendi dhe rendi i ditës u njoftohen anëtarëve, të paktën tre ditë përpara zhvillimit të saj dhe shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtim.

2. Në raste të veçanta, me kërkesë të çdo anëtari, mbledhja mund të diskutojë mbi çështje që nuk përfshihen në rendin e ditës.

3. Për të gjitha mbledhjet e prokurorëve mbahet procesverbal i përmbledhur me shkrim.

4. Në rastin kur mbledhja e përgjithshme diskuton raportin vjetor të prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm njoftohet për mbledhjen dhe projektraportin, të paktën një javë përpara mbledhjes. Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje ose të dërgojë një përfaqësues të tij.

KREU VII
ORGANIZIMI I BRENDSHËM I PROKURORISË

SEKSIONI I
ADMINISTRATA E PROKURORISË

Neni 57
Organizimi i administratës së prokurorisë
(ndryshohet shkronja "a" e pikës 1, me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 3)

1. Administrata e prokurorisë realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme:

a) shërbimet e prokurorisë, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë e prokurorisë, duke përfshirë dokumentimin dhe aktivitete që kryhen nga kancelari, këshilltari ligjor dhe sekretaria;

b) shërbimet administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin e prokurorisë, sigurinë, si dhe burimet njerëzore;

c) shërbimet mbështetëse, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen sanitare të prokurorisë, mirëmbajtjen e mjediseve të prokurorisë.

2. Veprimtaritë që duhet të kryhen për secilin nga këto shërbime përcaktohen në rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm ose Prokurori i Posaçëm, respektivisht, sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse.

Neni 58
Kancelari

1. Kancelari i prokurorisë ndihmon drejtuesin e prokurorisë në përmbushjen e detyrimeve për administrimin e prokurorisë.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij, kancelari kryen këto detyra:

a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e personelit administrativ, administron mjediset e punës, mjetet financiare dhe burimet materiale të prokurorisë, nën autoritetin e Drejtuesit të Prokurorisë;

b) kryen funksionin e nëpunësit autorizues të nivelit të dytë për prokurorinë dhe është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të prokurorisë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe legjislacionit për menaxhimin buxhetor e financiar;

c) drejton dhe organizon veprimtarinë e zyrës së sekretarisë;

ç) ndjek zbatimin e rregullave të etikës dhe të rregullores së brendshme nga punonjësit e prokurorisë, njofton drejtuesin e prokurorisë për rastet e shkeljeve, si dhe rekomandon masat e nevojshme;

d) ndjek veprimtarinë për sigurinë dhe mirëmbajtjen e godinës;

dh) merr masa dhe kujdeset për pajisjen e prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore me mjete kancelarike, literaturë nga fushat e drejtësisë, si dhe artikuj të tjerë të domosdoshëm për funksionimin normal të prokurorisë;

e) së bashku me sekretarinë, përgatit informacionet statistikore që i dërgohen drejtuesit të prokurorisë;

ë) i propozon drejtuesit të prokurorisë nevojat për përmirësimin e strukturës dhe organizimit të administratës, sipas limitit organik të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm;

f) merr masa dhe kujdeset për mirëmbajtjen e regjistrave dhe librave të tjerë të prokurorisë;

g) mbikëqyr veprimtarinë e përditshme të administratës, me qëllim evidentimin dhe informimin e drejtuesit të prokurorisë për çështjet dhe problematikat e konstatuara;

gj) informon drejtuesin e prokurorisë në lidhje me çdo problem të lindur në prokurori, si dhe jep mendim për zgjidhjen e tyre;

h) zbaton urdhrat dhe udhëzimet e drejtuesit të prokurorisë në lidhje me mbarëvajtjen e veprimtarisë në institucion;

i) mban regjistrin e personelit dhe dokumentacionin për personelin e administratës, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;

j) kryen detyra të tjera që i ngarkohen nga drejtuesi i prokurorisë.

Neni 59
Sekretaria e prokurorisë

1. Sekretaria e prokurorisë kryen funksione administrative dhe procedurale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Sekretaria e prokurorisë ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme:

a) vërteton aktet e prokurorisë dhe lëshon vërtetime ose kopje të njësuara me origjinalin. Kur përdoren pajisje regjistrimi ose pajisje që kryejnë funksione të ngjashme, sekretari garanton që regjistrimi ose riprodhimi është origjinal dhe i paprekur;

b) ndihmon në mbajtjen dhe administrimin e dosjeve;

c) ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe për regjistrimet në regjistra dhe ndihmon në mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;

ç) bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave;

d) ndihmon në krijimin e statistikave të prokurorisë, sipas kritereve të përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave; dhe dh) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

3. Veprimtari të tjera, të cilat kryhen rregullisht nga sekretaria e prokurorisë, renditen në rregulloren standarde të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 60
Shërbimi financiar

Shërbimi financiar ushtron dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga ligi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe ligji për menaxhimin dhe kontrollin financiar, si dhe aktet në zbatim të tyre.

Neni 61
Marrëdhëniet me publikun

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit.

2. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen nën drejtimin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe mbikëqyren prej tij.

3. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

4. Drejtuesi i prokurorisë cakton nëpunësin civil për marrëdhëniet me publikun si koordinator në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit".

Neni 62
Shërbimi i teknologjisë së informacionit

Shërbimet e teknologjisë së informacionit sigurojnë:

a) mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në prokurori, të mbajtura në formë elektronike, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale; si dhe

b) ruajtjen e rregullt të statistikave të prokurorisë.

Neni 63
Shërbimi i arkivit të prokurorisë

1. Shërbimi i arkivit të prokurorisë mban dhe administron dokumentacionin e prokurorisë, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera të prokurorisë, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërorë.

2. Shërbimi i arkivit të prokurorisë bashkëpunon me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit të prokurorisë, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit.

Neni 64
Rregulli dhe siguria në prokurori

1. Rregulli dhe siguria në prokurori rregullohen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Këshilli i Ministrave, pasi merr mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përcakton kriteret dhe procedurat për garantimin e rregullit dhe sigurisë në prokurori.

3. Siguria në Prokurorinë e Posaçme rregullohet sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm.

SEKSIONI II
STRUKTURA E PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

Neni 65
Struktura e Prokurorisë së Përgjithshme
(ndryshohet pika 1, shkronja "d" me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 4)

1. Struktura e Prokurorisë së Përgjithshme përbëhet nga:

a) Sekretari i Përgjithshëm;

b) kabineti;

c) drejtoritë;

ç) sektorët, përfshirë ato të ekspertizës dhe të ndihmës për subjektet e posaçme, sipas ligjit procedural penal etj.;

d) Njësia e Shërbimit Ligjor.

2. Prokurori i Përgjithshëm përcakton strukturën dhe organikën e Prokurorisë së Përgjithshme në rregulloren e funksionimit të saj.

Neni 66
Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme është nëpunësi më i lartë civil i Prokurorisë së Përgjithshme dhe i të gjitha prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm kryen funksionin e nëpunësit autorizues për Prokurorinë e Përgjithshme dhe është përgjegjës për përgatitjen,

zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të prokurorisë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe legjislacionit për menaxhimin buxhetor e financiar.

3. Sekretari i Përgjithshëm drejton veprimtarinë administrative të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive të tjera pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, nën autoritetin e Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme zgjidhet përmes një procedure të hapur dhe transparente. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcakton rregulla të detajuara lidhur me procesin e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 67
Sektorët e ekspertizës

1. Në Prokurorinë e Përgjithshme dhe, kur është e mundur, edhe pranë prokurorive të tjera mund të ngrihen dhe funksionojnë sektorët e ekspertizës, që asistojnë prokurorët dhe kanë në dispozicion mjete të posaçme teknike dhe ekspertë të specializuar në fusha të caktuara të shkencës.

2. Ekspertët duhet të kenë përfunduar minimalisht studimet në nivelin "Master" në fushën e tyre të ekspertizës dhe të kenë të paktën pesë vjet përvojë në atë fushë.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcakton rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës së ekspertëve.

4. Ekspertët veprojnë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e drejtuesit të prokurorisë ku ushtrojnë funksionet e tyre.

Neni 68
Asistenca ndaj subjekteve me status të posaçëm

1. Prokuroritë duhet të garantojnë shërbimet e nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm, sipas Kodit të Procedurës Penale.

2. Secila prokurori duhet të ketë në përbërje të saj të paktën një koordinator, të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.

Neni 69
Njësia e Shërbimit Ligjor
(ndryshuar me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 5)

1. Pranë Prokurorisë së Përgjithshme funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor.

2. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Prokurorisë së Përgjithshme duke përfshirë:

a) analizimin, studimin e ankimeve dhe dosjeve penale;

b) përgatitjen e relacioneve për çështjet objekt gjykimi përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese;

c) kryerjen e kërkimeve ligjore;

ç) përgatitjen e projektakteve;

d) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjeve që i ngarkohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

3. Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili cakton këshilltarin ligjor pranë një prokurori ose drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre.

4. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

5. Prokurorët e komanduar caktohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në Prokurorinë e Përgjithshme sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Statusi i prokurorëve të komanduar përcaktohet në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

6. Vlerësimi i punës së prokurorëve të komanduar kryhet nga drejtuesi i prokurorisë, bazuar në mendimin e dhënë nga prokurori pranë të cilit është komanduar.

7. Këshilltarët ligjorë jomagjistratë emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj. Këshilltari ligjor jomagjistrat përfiton pagë të barabartë me "pagën bruto fillestare" të prokurorit pranë gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

8. Këshilltari ligjor jomagjistrat duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë diplomuar në drejtësi në nivelin "Master shkencor", të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) përvojë profesionale jo më pak se 5 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare;

c) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare;

ç) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit Evropian;

d) aftësi të shkrimit dhe arsyetimit ligjor;

dh) të mos ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme;

9. Këshilltari ligjor dhe ndihmësmagjistrati u nënshtrohen rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesave ashtu si magjistrati.

10. Prokurori i Përgjithshëm përfshin në projektbuxhet propozimin për numrin e këshilltarëve ligjorë.

11. Prokurori i Përgjithshëm miraton rregulla të detajuara për numrin e këshilltarëve ligjorë dhe funksionimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme."

SEKSIONI III
STATUSI I NËPUNËSVE CIVILË NË PROKURORI

Neni 70
Kategoritë e nëpunësve civilë në prokurori
(shtohet shkronja "a/1" në pikën 1 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 6)

1. Kategoritë e nëpunësve civilë të prokurorisë janë:

a) Sekretari i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme;

a/1) këshilltari ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme;

b) kancelari;

c) nëpunësit e financës dhe buxhetit;

ç) sekretaria e prokurorisë;

d) nëpunësit e tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhënieve me publikun e median.

2. Statusi i nëpunësve civilë të prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm rregullohet nga ky ligj. Statusi i nëpunësve civilë të Prokurorisë së Posaçme rregullohet nga ky ligj, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

Neni 71
Punonjësit e tjerë të prokurorisë

Marrëdhënia e punës e punonjësve të tjerë në prokurori rregullohet nga Kodi i Punës.

Neni 72
Formimi profesional
(ndryshohet pika 2 dhe 4 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 7)

1. Formimi profesional i nëpunësve civilë të prokurorisë garantohet nëpërmjet përfshirjes së tyre në programet e mëposhtme:

a) programin e formimit fillestar, mbi bazën e të cilit nëpunësit civilë të prokurorisë që pranohen në shërbimin civil, të rregulluar sipas këtij ligji, trajnohen brenda periudhës së provës së tyre;

b) programin e formimit vazhdues, përmes së cilit trajnohen nëpunësit në detyrë të shërbimit civil të prokurorisë.

2. Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë e Posaçme, kryen formimin fillestar dhe vazhdues të kancelarëve dhe këshilltarëve ligjorë në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe përgatit kurrikulën për formimin fillestar për kancelarin për një periudhë prej të paktën tre muajsh dhe për këshilltarët ligjorë për një periudhë prej të paktën nëntë muajsh, sipas kushteve të vendosura në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në bashkëpunim me Shkollën e

Magjistraturës, kryen formimin profesional fillestar dhe vazhdues të nëpunësve të tjerë civilë në prokurori dhe përgatit kurrikulën për formimin fillestar të tyre për një periudhë prej të paktën një muaji.

4. Shkolla e Magjistraturës miraton rregulla të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për kancelarët dhe këshilltarët ligjorë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregulla më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për gjithë nëpunësit e tjerë civilë të prokurorisë.

Neni 73
Vlerësimi kualifikues për kancelar dhe këshilltarë ligjorë
(ndryshohet titulli i nenit, ndryshohet pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 8)

1. Shkolla e Magjistraturës ofron formim fillestar për kancelarët dhe për këshilltarët ligjorë, të paktën çdo tre vjet.

2. Prokurori i Përgjithshëm, pasi merr mendimin e drejtuesve të prokurorive, përcakton numrin e vendeve të lira për këshilltarët ligjorë për vitin e ardhshëm dhe për kancelarë për tre vitet vijuese dhe ia njofton Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Shkollës së Magjistraturës.

3. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara pranë gjithë prokurorive, në faqet zyrtare të prokurorive, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka për detyrë:

a) të verifikojë nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës;

b) të përcaktojë listën e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit.

5. Shkolla e Magjistraturës:

a) zhvillon provimin e pranimit;

b) vlerëson dhe publikon rezultatet e provimit të pranimit;

c) përcakton kandidatët me pikët më të larta që duhet të pranohen në programin e formimit fillestar;

ç) organizon dhe zbaton programin e formimit fillestar.

6. Kandidatët e pranuar në programin e formimit fillestar janë të detyruar të ndjekin rregullisht programin dhe të respektojnë rregulloren e Shkollës së Magjistraturës.

7. Në përfundim të formimit fillestar, Shkolla e Magjistraturës organizon provimin përfundimtar. Kandidatët që marrin jo më pak se 70 për qind të pikëve totale në provimin përfundimtar, vlerësohen se kanë kaluar me sukses programin e formimit fillestar.

8. Në përputhje me pikën 7, të këtij neni, Shkolla e Magjistraturës rendit kandidatët fitues, sipas numrit të pikëve që kanë marrë. Lista e kandidatëve fitues miratohet nga Shkolla e Magjistraturës, publikohet në faqen zyrtare të saj dhe i paraqitet Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

9. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton me vendim rregulla më të hollësishme për mënyrën e përllogaritjes së numrit të kandidatëve që pranohen në programin e formimit fillestar dhe verifikimin e kandidatëve që pranohen në provimin e pranimit.

10. Shkolla e Magjistraturës miraton rregulla më të hollësishme për procedurën dhe vlerësimin e provimit të pranimit dhe provimit përfundimtar.

11. Nëpunësi civil i prokurorisë në Prokurorinë e Posaçme duhet të përmbushë edhe kërkesat dhe kushtet shtesë të parashikuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Neni 74
Vlerësimi kualifikues i nëpunësve civilë të prokurorisë

1. Pranimi në shërbimin civil i nëpunësve të tjerë të prokurorisë kryhet sipas rregullave të këtij neni, nëpërmjet një konkurrimi të hapur.

2. Pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, sipas nenit 77, të këtij ligji, Prokurori i Përgjithshëm, jo më vonë se tre javë nga marrja e njoftimit për vendin e lirë, shpall konkurrimin e hapur në faqen zyrtare të tij dhe i kërkon kancelarit ta shpallë atë edhe në faqen zyrtare të prokurorisë.

3. Njoftimi përmban informacion për vendin e lirë, afatin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumentacionin shoqërues, procedurën e kandidimit dhe vendin ku paraqitet kërkesa dhe dokumentacioni. Afati për paraqitjen e kërkesës së kandidimit nuk mund të jetë më pak se dy javë nga data e njoftimit.

4. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të publikuara në njoftim;

b) vlerësimi i kandidatëve.

5. Verifikimi paraprak bëhet nga kancelari, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i Pranimit në prokurori.

6. Komisioni i Pranimit rendit kandidatët fitues me më shumë pikë dhe që kanë marrë më shumë se 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, nëlistën e kandidatëve fitues referuar më poshtë si "lista e kandidatëve".

7. Prokurori i Përgjithshëm miraton me vendim rregulla të hollësishme për vlerësimin paraprak, krijimin, përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Pranimit, si dhe për procedurën e vlerësimit.

Neni 75
Kritere të përgjithshme për pranimin
(ndryshohet pika 1 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 9)

1. Për t'u pranuar në shërbimin civil të prokurorisë, të rregulluar sipas këtij ligji, dhe në provimin e pranimit për kancelarët dhe këshilltarët ligjorë në Shkollën e Magjistraturës, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, të parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil", si dhe kërkesat e veçanta të parashikuara nga ky ligj.

2. Për t'u pranuar në shërbimet e Prokurorisë së Posaçme, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë të caktuara me ligj të veçantë, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar nga kandidati dhe familjarët e afërm të kandidatit.

Neni 76
Kritere të veçanta për pranimin e nëpunësve civilë në prokurori
(shtohet pika 1/1 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 10)

1. Për t'u pranuar në provimin e pranimit për formimin fillestar për kancelar, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta si vijon:

a) të jenë diplomuar në drejtësi ose ekonomi në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) të kenë përvojë profesionale mbi tetë vjet, nga të cilat së paku tre vjet

në pozicione administruese ose pesë vjet në sistemin e prokurorisë.

1/1. Për pozicionin e këshilltarit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.

2. Për pozicionin e punonjësit të sekretarisë, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta:

a) të jenë diplomuar në drejtësi;

b) të kenë përvojë prej të paktën një viti të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë.

1/1. Për pozicionin e këshilltarit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji."

3. Për pozicionin e nëpunësit zbatues të financës ose buxhetit duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

4. Për pozicionin drejtues të buxhetit, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta:

a) të jenë diplomuar në shkenca ekonomike, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet në fushën e kontabilitetit dhe/ose menaxhimit të buxhetit.

5. Për pozicionet drejtuese si nëpunës civil në fusha të tjera të shërbimeve administrative të prokurorisë, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta:

a) të jenë diplomuar në drejtësi, ekonomi ose teknologji e informacionit, në shkenca komunikimi/gazetari ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) të kenë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë.

SEKSIONI IV
PRANIMI I NËPUNËSVE CIVILË NË PROKURORI

Neni 77
Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë

1. Plotësimi i vendeve të lira në shërbimin civil në prokurori bëhet sipas kësaj radhe:

a) fillimisht, vendi i lirë i ofrohet një nëpunësi civil të regjistruar në listën e nëpunësve civilë të prokurorisë, ose ata të cilët kanë të drejtë të rikthehen ose të transferohen, sipas dispozitës për efektet e pezullimit të ligjit "Për nëpunësin civil", nëse kjo është e zbatueshme;

b) nëse vendi nuk mund të plotësohet sipas procedurës së parashikuar në shkronjën "a", plotësimi bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele;

c) nëse vendi nuk mund të plotësohet, sipas procedurës së referuar në shkronjën "a" ose "b", plotësimi bëhet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

2. Nëpunësit e shërbimit civil të një kategorie të caktuar kanë të drejtë të kërkojnë të transferohen në pozicionet e së njëjtës kategori të një prokurorie tjetër.

3. Nëpunësit e shërbimit civil të një kategorie të caktuar, kanë të drejtë të aplikojnë nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në pozicionin e një kategorie më të lartë brenda të njëjtës prokurori ose në një prokurori tjetër.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme ose kancelari i prokurorisë njofton menjëherë dhe pa vonesë Këshillin e Lartë të Prokurorisë ose drejtuesin e prokurorisë përkatëse, sipas rastit, për vendin e lirë të krijuar në prokurori ose që mund të krijohet në të ardhmen, në çdo rast, jo më vonë se dy javë pas marrjes së informacionit.

5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në rastin e kancelarëve, ose drejtuesi i prokurorisë, në rastin e nëpunësve të tjerë, i ofron vendin kandidatit të regjistruar në listën përkatëse të nëpunësve civilë të prokurorisë, sipas pikës 1 të këtij neni.

6. Në rast se vendi i lirë nuk mund të plotësohet nga një procedurë e tillë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për kancelarët, ose Prokurori i Përgjithshëm, për nëpunësit e tjerë, shpallin fillimin e procedurave për lëvizje paralele

dhe ngritje në detyrë, duke njoftuar të gjithë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpunësit e shërbimit civil të kategorive më të ulëta, të cilët plotësojnë kriteret për kategorinë përkatëse më të lartë, për vendet e lira dhe hapjen e procedurave për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë.

7. Njoftimi shpallet pranë të gjitha prokurorive, përfshirë Prokurorinë e Posaçme. Ai përmban informacion për vendin e lirë, afatin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumentacionin shoqërues, procedurën e shqyrtimit të kërkesës dhe vendin ku paraqitet kërkesa dhe dokumentacioni. Afati për paraqitjen e kërkesës për kandidim nuk mund të jetë më pak se dy javë nga data e njoftimit.

8. Kërkesa për kandidim paraqitet pranë autoritetit që ka njoftuar vendin e lirë.

9. Komisioni i Pranimit në prokurori shqyrton kërkesat, bazuar në dokumentacionin e paraqitur. Në rastin e lëvizjes paralele, Komisioni i Pranimit mund të zhvillojë një intervistë. Në rastin e ngritjes në detyrë, zhvillimi i intervistës me kandidatët është i detyrueshëm.

10. Komisioni i Pranimit, në rastin e paraqitjes së dy ose më shumë kërkesave për të njëjtin pozicion, i rendit kandidatët sipas radhës së kritereve të mëposhtme:

a) rezultateve të vlerësimit të punës: në rast rezultatesh të njëjta Komisioni i Pranimit krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta;

b) viteve të përvojës profesionale në pozicionin përkatës;

c) viteve të përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës.

11. Komisioni i Pranimit përzgjedh dhe njofton kandidatin brenda dy javëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesës për kandidim.

12. Komisioni i Pranimit të prokurorisë në të cilën pranohet një nëpunës civil i ri, sipas këtij neni, brenda pesë ditëve nga përzgjedhja e kandidatit, njofton Prokurorin e Përgjithshëm për rezultatet e procedurës së lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë.

13. Në rastin e lëvizjeve paralele apo ngritjes në detyrë për pozicionin e kancelarit, shqyrtimi i kërkesave dhe përzgjedhja kryhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me procedurat e parashikuara në pikat 9, 10 dhe 11 të këtij neni.

14. Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm, sipas rastit, miratojnë me vendim rregulla më të detajuara për procedurat për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë të kancelarëve dhe nëpunësve civilë të tjerë në prokurori.

Neni 78
Emërimi në shërbimin civil të prokurorisë
(ndryshohet pika 2 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 11)

1. Pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë fillon procedurën e pranimit për emërimin e kandidatëve për vendet e mbetura të lira për kancelarë, ndërsa prokuroria përkatëse fillon procedurën e pranimit për emërimin e kandidatëve për vendet e tjera të lira të nëpunësve civilë.

2. Kandidatët fitues, të përcaktuar në përputhje me listën e Shkollës së Magjistraturës për renditjen e kancelarëve dhe këshilltarë ligjorë ose në përputhje me renditjen e bërë nga Komisioni i Pranimit, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të zgjedhin të emërohen në çdo pozicion të kategorisë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe prokuroria përkatëse emërojnë kandidatët në pozicionin e zgjedhur, sipas neneve 79 dhe 80 të këtij ligji.

3. Lista e kandidatëve fitues, e krijuar nga Shkolla e Magjistraturës, sipas nenit 73, pika 7, të këtij ligji, të paemëruar ende sipas pikës 2, të këtij neni, është e vlefshme për një periudhë katërvjeçare nga shpallja e fituesve. Lista e krijuar nga Komisioni i Pranimit, në përputhje me nenin 77, pika 6, të këtij ligji, të paemëruar ende sipas pikës 2, të këtij neni, është e vlefshme për një periudhë dyvjeçare nga shpallja e fituesve. Nëse gjatë kësaj periudhe, organizohet një konkurs tjetër për të njëjtën kategori, kandidatët fitues të listave, që nuk janë emëruar ende, renditen sërish sipas rezultatit përfundimtar.

4. Vendet e lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme, mund të plotësohen nga kandidatët fitues të paemëruar ende, sipas renditjes së tyre në listën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni. Në çdo rast, ky proces realizohet me pëlqimin e kandidatëve fitues dhe nuk cenon të drejtat që ata gëzojnë, sipas pikës 3 të këtij neni. Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe prokuroria bëjnë emërimin e përkohshëm respektivisht për këta nëpunës civilë të prokurorisë, pas marrjes së pëlqimit të tyre.

5. Çdo emërim në pozicione të shërbimit civil të prokurorisë, në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton me vendim rregulla më të hollësishme për procedurën në zbatim të këtij neni.

Neni 79
Emërimi i kancelarit dhe këshilltarit ligjor
(ndryshohet titulli i nenit dhe pikat 1,2 dhe 3 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 12)

1. Organi kompetent për emërimin e kancelarit dhe këshilltarit ligjor është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

2. Për vendin e lirë për kancelar dhe këshilltar ligjor, pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, kandidatët e renditur në listën e kandidatëve për pozicionin e kancelarit dhe këshilltarit ligjor, të publikuar nga Shkolla e Magjistraturës, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë zgjedh kandidatin për kancelar dhe për këshilltar ligjor, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme, sipas kësaj radhe:

a) renditjen në listën e kandidatëve;

b) çdo njohuri ose përvojë e veçantë e kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë; dhe

c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicionet drejtuese.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë arsyeton dhe publikon në faqen zyrtare vendimin për rezultatet e procedurës së emërimit. Vendimi i arsyetuar u njoftohet të gjithë kandidatëve. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të ankimojnë vendimin në gjykatën kompetente.

Neni 80
Emërimi i nëpunësve të tjerë civilë

1. Organi kompetent për emërimin e nëpunësve të tjerë civilë në prokuroritë përkatëse është drejtuesi i prokurorisë.

2. Për vendet e lira për nëpunësit e tjerë civilë, pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, kandidatët e renditur në listën e kandidatëve nga komisionet e pranimit, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë pranë drejtuesit të prokurorisë.

3. Komisioni i Pranimit fton kandidatët për intervistë dhe zgjedh

kandidatin për vendin e lirë përkatës në shërbimit civil, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme, sipas kësaj radhe:

a) renditjen në listën e kandidatëve;

b) çdo karakteristikë e veçantë e kandidatit në lidhje me vendin e lirë;

c) vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.

4. Komisioni i Pranimit arsyeton dhe publikon vendimin për rezultatet e procedurës së emërimit. Vendimi i arsyetuar i njoftohet të gjithë kandidatëve. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të ankimojnë vendimin në gjykatën kompetente.

Neni 81
Emërimi paraprak

1. Nëpunësi i shërbimit civil merr emërimin paraprak në shërbimin civil të prokurorisë me kushtin që vendimi i emërimit të mos cenohet nga një vendim gjyqësor.

2. Në rast se nuk bëhet ankim brenda afatit kundër vendimit të organit kompetent për emërimin e nëpunësve të shërbimit civil, vendimi bëhet përfundimtar dhe emërimi konsiderohet përfundimtar që nga data e mbarimit të afatit të ankimit ndaj këtij vendimi.

3. Në rast se bëhet ankim dhe vendimi gjyqësor përfundimtar lë në fuqi vendimin e emërimit, emërimi konsiderohet përfundimtar, duke filluar nga dita e njoftimit të vendimit gjyqësor te nëpunësi civil i emëruar.

4. Në rast se gjykata e cenon vendimin e emërimit, organi kompetent përkatës rivlerëson, sipas rregullave të vlerësimit, të gjitha kërkesat e kandidatëve në përputhje me këtë ligj dhe merr një vendim të ri pas dhënies së vendimit përfundimtar të gjykatës. Emërimi paraprak konsiderohet i përfunduar në datën e vendimit të organit kompetent, i cili rishikon vendimin e emërimit duke pasur parasysh vendimin përfundimtar të gjykatës. Kandidatët e emëruar paraprakisht dhe të porsaemëruar njoftohen në datën e dhënies së vendimit.

5. Viti i parë i shërbimit gjatë periudhës së emërimit paraprak konsiderohet si periudhë prove, sipas nenit 82 të këtij ligji.

6. Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme njoftojnë pa vonesë Këshillin e Lartë të Prokurorisë mbi rezultatin e procesit të pranimit, duke përfshirë ankimet e bëra dhe çdo vendim gjyqësor përfundimtar.

7. Në rast se organi kompetent vendos të ndërpresë marrëdhënien e punës për nëpunësin civil të emëruar paraprakisht, gjatë periudhës së provës, sipas nenit 82, të këtij ligji, ai njofton kandidatët e tjerë që kanë paraqitur kërkesë për vendin përkatës. Këta kandidatë mund të mbështesin kërkesën e tyre edhe në rastin kur ka mbaruar afati i listës së kandidatëve në të cilën ata janë përfshirë. Në rastet kur kandidatët kanë paraqitur ankim, ky ankim konsiderohet i tërhequr. Organi kompetent fton të gjithë kandidatët e tjerë nga lista përkatëse e kandidatëve për të paraqitur kërkesë për kandidim për vendin përkatës.

Neni 82
Periudha e provës

1. Personi, i cili në momentin e emërimit nuk e gëzon statusin e nëpunësit të shërbimit civil, i nënshtrohet periudhës së provës, e cila zgjat një vit nga data e njoftimit të vendimit të emërimit paraprak.

2. Gjatë periudhës së provës, nëpunësi civil kryen detyrat nën kujdesin e një nëpunësi të vjetër civil të së njëjtës kategori ose kategorie më të lartë.

3. Në fund të periudhës së provës, organi kompetent ku është emëruar nëpunësi i shërbimit civil vendos:

a) konfirmimin e nëpunësit civil;

b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në gjashtë muaj, nëse, për arsye të justifikuara, ka qenë i pamundur vlerësimi i nëpunësit civil; ose

c) moskonfirmimin e nëpunësit civil.

4. Vendimi, sipas pikës 3, të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve individuale të punës.

5. Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme i përcjellin vendimin Këshillit të Lartë të Prokurorisë brenda tre ditëve për emërimet që janë kompetencë e tij. Këshilli i Lartë i Prokurorisë regjistron vendimet e marra sipas këtij neni, në Regjistrin Qendror të Personelit brenda dhjetë ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 83
Dosja dhe Regjistri Qendror i Personelit

1. Sekretari i Përgjithshëm dhe kancelari i çdo prokurorie krijojnë dhe administrojnë dosjen individuale për çdo nëpunës civil dhe punonjës të administratës së prokurorisë. Dosja individuale përmban të dhënat

profesionale për çdo nëpunës civil të prokurorisë dhe punonjës të administratës, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me shërbimin civil ose marrëdhënien e punës.

2. Sekretari i përgjithshëm dhe kancelari i çdo prokurorie reflektojnë në Regjistrin Qendror të Personelit, të krijuar dhe administruar nga Departamenti i Administratës Publike, sipas parashikimeve të ligjit "Për nëpunësin civil" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij, të dhënat profesionale për çdo nëpunës civil të prokurorisë dhe punonjës të administratës, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me shërbimin civil ose marrëdhënien e punës, si dhe informacionin për strukturën dhe organikën e prokurorisë përkatëse.

3. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e administratorit të Regjistrit Qendror të Personelit, është i detyruar t'i sigurojë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe prokurorive akses të nevojshëm mbi të dhënat e prokurorive në këtë regjistër.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton me vendim rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe përdorimit të të dhënave.

5. Të gjithë nëpunësit civilë të prokurorisë dhe punonjësit e tjerë të administratës kanë akses të pakufizuar në dosjen e tyre personale, të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, e cila përmban të dhëna në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

SEKSIONI V
TË DREJTAT, DETYRIMET, VLERËSIMI I PUNËS, TRANSFERIMI

Neni 84
Të drejtat dhe detyrat e nëpunësit civil të prokurorisë

(ndryshohen pikat 3 dhe 6, shtohet pika 5/1 dhe shfuqizohet pika 8 me ligjin nr. 42/ datë 23.03.2021, neni 13)

1. Nëpunësit civilë gëzojnë të drejta dhe u nënshtrohen detyrimeve sipas dispozitave të parashikuara në kapitullin e të drejtave dhe detyrimeve në shërbimin civil të ligjit "Për nëpunësin civil", përveç kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Komisionit të

Pranimit në Gjykatën Administrative të Apelit. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton vetëm gabimet faktike ose procedurale, të cilat mund të kenë ndikuar në rezultatin e renditjes dhe nuk zëvendëson vlerësimin e kritereve me vlerësimin e saj. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet rekurs.

3. Vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për emërimin e kancelarëve, këshilltarëve ligjorë jomagjistratë dhe prokurorëve të komanduar ankimohen në përputhje me ligjin që rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshilli të Lartë të Prokurorisë.

4. Këshilli i Ministrave miraton me vendim:

a) rregulla mbi strukturën dhe rritjen e pagave për nëpunësit civilë, përmes së cilës, skema e pagës duhet të jetë së paku e njëjtë me atë të kategorive përkatëse të nëpunësit të shërbimit civil gjyqësor;

b) rregullat mbi kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës. Në përcaktimin e këtyre rregullave, duhet të sigurohet që nëpunësi i shërbimit civil të trajtohet në mënyrë të barabartë me nëpunësin e shërbimit civil gjyqësor.

5. Kancelari kandidat merr një shpërblim të barabartë me 50 për qind të pagës fillestare si kancelar gjatë programit të formimit fillestar.

5/1. Këshilltari ligjor kandidat merr një shpërblim të barabartë me 50 për qind të pagës fillestare si këshilltar ligjor gjatë kursit të formimit fillestar.

6. Kancelarët dhe këshilltarët ligjorë kandidatë detyrohen të kthejnë të gjithë shpërblimin e marrë brenda tre vjetëve, në rast se kandidati përjashtohet ose largohet nga shkolla; ose në rast se kandidati nuk kërkon të caktohet në një pozicion brenda një viti nga përfundimi i arsimimit në Shkollën e Magjistraturës. Kandidati detyrohet të kthejë 50 për qind të shpërblimit të marrë brenda tre vjetëve nga përfundimi i arsimimit në Shkollën e Magjistraturës, nëse kandidati nuk ka mundur të përmbushë kërkesat për t'u emëruar, sipas nenit 76 të këtij ligji, ose në rast se mandati i kancelarit ose këshilltarit ligjor përfundon përpara plotësimit të të paktën pesë viteve në ushtrimin e detyrës. Detyrimi për kthimin e shpërblimit të marrë nuk zbatohet në rastet që lidhen me arsye shëndetësore apo raste të tjera me arsye të justifikuara siç miratohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

7. Përcaktimi i nivelit të pagës së kancelarit bëhet në strukturën e

miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, bazuar në tre nivele page, në përputhje me ngarkesën e prokurorisë përkatëse. Niveli më i lartë i pagës së kancelarit të prokurorisë barazohet me pagën e funksionit drejtor i përgjithshëm dhe niveli më i ulët me pagën e funksionit përgjegjës sektori në ministri.

Neni 85
Vlerësimi i veprimtarisë së nëpunësit

1. Veprimtaria e çdo nëpunësi civil vlerësohet periodikisht të paktën çdo dy vjet, nga data e fillimit të ushtrimit të detyrës në vendin përkatës, sipas këtyre kritereve:

a) njohuritë profesionale dhe aftësitë teknike;

b) përkushtimi në punë;

c) etika në punë.

2. Drejtuesi i prokurorisë njofton nëpunësin civil për fillimin e procesit të vlerësimit dhe i kërkon atij vetëvlerësimin dy muaj para përfundimit të periudhës dyvjeçare të vlerësimit. Nëpunësit civilë bëjnë vetëvlerësimin brenda dy javëve nga data e marrjes së njoftimit përkatës. Nëpërmjet vetëvlerësimit, nëpunësi civil përshkruan veprimtaritë, identifikon nevojat për trajnim, sugjeron përmirësim të kushteve të punës dhe masa për zhvillimin e tij profesional, identifikon dobësitë dhe përparësitë në lidhje me çdo kriter vlerësimi.

3. Drejtuesi i prokurorisë njofton të gjithë eprorët të paraqesin brenda dy javëve nga data e njoftimit, mendim me shkrim për punën e nëpunësit civil, sipas kritereve të vlerësimit.

4. Nëpunësi civil që vlerësohet dhe eprori paraqesin aktet e vlerësimit te drejtuesi i prokurorisë, i cili është përgjegjës për të hartuar projektraportin e vlerësimit, brenda katër javëve pas njoftimit të nëpunësit civil. Me finalizimin e projektraportit të vlerësimit, nëpunësi civil njoftohet dhe ka të drejtë të ketë akses në dosjen e vlerësimit.

5. Nëpunësi civil ka të drejtën të kundërshtojë me shkrim projektraportin e vlerësimit, brenda dy javëve nga marrja e tij.

6. Në rast vlerësimi të nëpunësit civil të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, drejtuesi i prokurorisë i paraqet sekretarit të përgjithshëm projektvendimin e vlerësimit, projektraportin e vlerësimit, së bashku me vetëvlerësimin, mendimin me shkrim të të gjithë mbikëqyrësve dhe, sipas rastit, çdo kundërshtim, sipas pikës 5 të këtij neni. Në rast vlerësimi

të nëpunësit civil të Prokurorisë së Posaçme, është Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme që kryen vlerësimin.

7. Sekretari i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të vendosin të dëgjojnë nëpunësin civil që vlerësohet dhe të diskutojnë rastin, duke vendosur në përfundim vlerësimin me një nga këto nivele:

a) "Shumë mirë";

b) "Mirë";

c) "Kënaqshëm";

ç) "Jokënaqshëm".

8. Vendimi i marrë duhet të jetë i arsyetuar rregullisht me shkrim dhe t'i njoftohet nëpunësit civil brenda tre ditëve nga marrja e tij.

9. Në rast se vendimi i vlerësimit cakton vlerësimin më pak se "Mirë", nëpunësi civil ka të drejtë ta ankimojë vendimin brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin në gjykatën kompetente vetëm për çështje të ligjit për shkak të moszbatimit të njëjtë të tij.

10. Në rastin e një nëpunësi civil në periudhë prove, veprimtaria e tij vlerësohet për një periudhë prej gjashtë muajsh.

11. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton me vendim rregulla të mëtejshme për treguesit e kritereve që lidhen me kriteret e vlerësimit, burimet dhe procedurën e vlerësimit.

Neni 86
Transferimi i nëpunësve civilë
(ndryshohet pika 3 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 14)

1. Dispozitat e parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil" për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm zbatohen për aq sa është e mundur, përveçse kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Transferimi mund të zbatohet vetëm brenda shërbimit civil të prokurorisë. Nëpunësi civil mund edhe të transferohet përkohësisht për nevojat e organit të prokurorisë apo shtetit, në pozicionet që i përshtaten profilit të punës, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar.

3. Drejtuesi i prokurorisë, në të cilën nëpunësi civil transferohet, është kompetent për dhënien e vendimit të transferimit. Në rast transferimi në institucione të ndryshme nga prokuroria, drejtuesi i prokurorisë, në të

cilën nëpunësi civil është i punësuar, është organi kompetent që vendos për transferimin. Në rastin e kancelarit dhe këshilltarit ligjor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi kompetent që vendos për transferimin.

4. Drejtuesi i prokurorisë njofton Këshillin e Lartë të Prokurorisë në rastet kur nëpunësi civil kërkon transferimin në një institucion tjetër të shërbimit civil për shkak të:

a) arsyeve mjekësore ose gjatë shtatzënisë;

b) paaftësisë shëndetësore; ose

c) shmangies se një situate të vazhdueshme konflikti të interesit.

5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë regjistron nëpunësin civil në listë deri në sistemimin e tij në një pozicion të përshtatshëm. Dispozitat për efektet e pezullimit zbatohen rast pas rasti.

6. Në rast të mbylljes ose riorganizimit të strukturës së prokurorisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ngre Komisionin e Ristrukturimit, sipas ligjit "Për nëpunësin civil". Komisioni i Ristrukturimit drejtohet nga një përfaqësues i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në të bëjnë pjesë drejtuesit dhe kancelarët e prokurorive që i nënshtrohen procedurës së riorganizimit.

7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton me vendim rregulla më të hollësishme për procedurën e transferimit.

SEKSIONI VI
PEZULLIMI DHE PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 87
Pezullimi nga shërbimi civil

(ndryshohet pika 2 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 15)

1. Dispozitat e parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil" për pezullimin nga shërbimi civil, zbatohen edhe për nëpunësit civilë në prokurori, për aq sa është e mundur, përveçse kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Organi kompetent për deklarimin e pezullimit është Këshilli i Lartë i Prokurorisë për kancelarin dhe këshilltarin ligjor dhe drejtuesi i prokurorisë për nëpunësit e tjerë civilë.

3. Në rast pezullimi, sipas një kërkese të motivuar për shkak të një interesi

tjetër të ligjshëm të nëpunësit civil, organi kompetent mund të vendosë pezullimin për një periudhë deri në dy vjet, në përputhje me rregullat e nxjerra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Neni 88
Efektet e pezullimit

1. Gjatë periudhës së pezullimit nëpunësi civil nuk përfiton pagë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Nëpunësi civil përfiton pagën e plotë kur pezullohet, vetëm në këto raste:

a) në rastin e procedimit disiplinor;

b) në rastin ku pezullimi është vendosur si masë ndaluese nga gjykata;

c) nëse krijohet një situatë e vazhdueshme konflikti interesi që deklarohet në kohën dhe mënyrën e duhur, sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, deri në transferimin përfundimtar në një pozicion tjetër;

ç) gjatë ndjekjes së programit të formimit fillestar;

d) gjatë periudhës së pritjes për t'u transferuar në një pozicion të përshtatshëm të shërbimit civil, sipas këtij ligji.

3. Nëpunësi civil duhet të kthejë shumën prej 50 për qind të pagës së përfituar gjatë periudhës së pezullimit, bazuar në një procedurë të papërfunduar disiplinore ose penale në rastet kur:

a) është larguar nga detyra me vendim përfundimtar, në kuadër të procedimit disiplinor përkatës; ose

b) është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale në çështjen përkatëse, me vendim përfundimtar.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton me vendim rregulla më të hollësishme për efektet e pezullimit.

Neni 89
Përgjegjësia disiplinore
(ndryshohet pika 1, shkronjat "a" dhe "b" dhe pika 2, shkronja "a" me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 16)

1. Organi kompetent për propozimin e masave disiplinore është:

a) kancelari i prokurorisë, për nëpunësit civilë që ushtrojnë detyrën

në prokurorinë përkatëse, përveç kancelarit dhe këshilltarit ligjor;

b) drejtuesi i prokurorisë për kancelarin dhe këshilltarin ligjor.

2. Organi kompetent për të caktuar masat disiplinore është:

a) Këshilli i Lartë i Prokurorisë për kancelarin dhe këshilltarin ligjor;

dhe

b) drejtuesi i prokurorisë për nëpunësit e tjerë civilë.

3. Dispozitat e parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil" për përgjegjësinë disiplinore, zbatohen edhe për nëpunësit civilë, për aq sa është e mundur, me përjashtim të rastit kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Neni 90
Afatet e parashkrimit

1. Me kalimin e një afati prej dy vjetësh nga data në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, nuk mund të fillojnë hetime për shkeljen e pretenduar ndaj nëpunësit civil.

2. Afati i parashkrimit fillon të ecë në momentin e përfundimit të shkeljes.

3. Afati i parashkrimit ndërpritet nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se nëpunësi civil mund të jetë përfshirë në një shkelje tjetër të së njëjtës natyrë, e kryer brenda afatit të parashkrimit. Në këtë rast, afati fillon në momentin e përfundimit të shkeljes së re. Në çdo rast, parashkrimi nuk zgjatet më shumë se një vit.

4. Pavarësisht parashikimeve në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, shkeljet që njëkohësisht janë vepra penale, kanë të njëjtin afat parashkrimi sipas parashikimeve në Kodin Penal.

5. Afati i parashkrimit pezullohet gjatë kohës së procedimit penal, procedurës civile ose procedurës administrative, në lidhje me të njëjtin nëpunës civil, nëse e njëjta shkelje është objekt i këtyre procedurave.

6. Me fillimin e hetimit afati i parashkrimit nuk vazhdon të ecë më. Hetimi fillon, sipas këtij neni, në datën e marrjes së ankesës ose në atë të marrjes së informacionit që justifikon fillimin e hetimit kryesisht nga organi i lartë hetues.

Neni 91
Afatet për fillimin e hetimit

1. Organi kompetent për propozimin e masës disiplinore vendos për

arkivimin e ankesës ose fillimin e hetimit për shkeljen e pretenduar, brenda gjashtë muajve nga marrja e ankesës ose nga marrja e informacionit dhe fakteve të rëndësishme.

2. Organi kompetent ia paraqet propozimin organit kompetent për caktimin e masës disiplinore ose miraton me vendim mbylljen e hetimit brenda gjashtë muajve nga vendimi për fillimin e hetimit.

3. Organi kompetent për propozimin e masave disiplinore mund të vendosë shtyrjen e afatit gjashtëmujor të hetimit, sipas pikës 2, të këtij neni, edhe me gjashtë muaj të tjerë, në rastet e mëposhtme:

a) kur nëpunësi civil është i sëmurë ose kur nuk mund të paraqitet për shkaqe të justifikuara;

b) kur vendoset zgjerimi i hetimit ose kur ndryshon shkaku ligjor i hetimit; ose

c) në raste të tjera komplekse.

4. Në rast se pas përfundimit të afatit të hetimit, të përcaktuar në pikën 2 ose 3, të këtij neni, zbulohen prova të reja, të cilat tregojnë në mënyrë të arsyeshme se shkelja ka ndodhur, organi kompetent rihap hetimin, me kusht që afati i parashkrimit të mos ketë përfunduar, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 4, të nenit 90, të këtij ligji. Organi kompetent paraqet propozimin për caktimin e masës disiplinore ose miraton me vendim mbylljen e hetimit brenda gjashtë muajve nga vendimi për rifillimin e hetimit.

5. Në rast se organi kompetent, nuk vepron brenda afateve të parashikuara në pikat 2 deri 4, të këtij neni, nëpunësi civil ka të drejtë të ankimojë mosveprimin administrativ në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

6. Afatet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të pezullohen sipas parashikimeve të nenit 96 të këtij ligji.

Neni 92
Fillimi i hetimit disiplinor

1. Kushdo mund të paraqesë ankesë ndaj nëpunësit civil të prokurorisë.

2. Kushdo që mbikëqyr nëpunësin civil ose çdo organ publik me kompetenca kontrolli administrativ, financiar ose auditimi, mund t'i drejtohet me shkresë organit kompetent, sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, për fillimin e hetimit disiplinor, duke i parashtruar pretendimet për shkelje të detyrimeve të nëpunësve civilë, së bashku me provat.

3. Organi kompetent, sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, verifikon

pretendimet. Nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, sipas të cilave vlerësohet se shkelja ka ndodhur, organi kompetent duhet të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar. Nëse vlerësohet e nevojshme, organi kompetent mbledh prova të tjera, merr në pyetje dëshmitarë ose pyet mbikëqyrësit për konstatimet e tyre.

4. Nëse nuk ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të vlerësuar se shkelja ka ndodhur, organi kompetent e arkivon ankesën ose kërkesën që është haptazi e pabazuar.

5. Organi kompetent, i përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, përgatit raportin e hetimit, i cili përmbledh faktet, listën e provave dhe rëndësinë e tyre, si dhe konkluzionet që argumentojnë nëse këto fakte mund të përbëjnë shkelje të detyrimeve të nëpunësve civilë të prokurorisë sipas ligjit "Për nëpunësin civil".

6. Organi kompetent, i përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, i paraqet propozim për caktimin e masës disiplinore ose propozim për mbylljen e hetimit organit kompetent, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 89, të këtij ligji.

Neni 93
Të drejtat e nëpunësit civil gjatë hetimit disiplinor

1. Organi kompetent, sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, njofton nëpunësin civil për arkivimin ose fillimin e hetimit disiplinor, duke i dhënë informacionin për pretendimet dhe provat përkatëse, si dhe duke e informuar atë për të drejtat e tij.

2. Nëpunësi civil ka të drejtë të njihet me dosjen disiplinore, të përfaqësohet sipas parashikimeve në ligjin "Për nëpunësin civil", të paraqesë deklaratë dhe prova brenda një muaji nga marrja e njoftimit për vendimin e arkivimit dhe fillimit të hetimit.

3. Organi kompetent njofton nëpunësin civil dhe kërkuesin ose organin që e ka drejtuar kërkesën, lidhur me vendimin për mbylljen e hetimit.

Neni 94
Procedura disiplinore

1. Organi kompetent, sipas pikës 2, të nenit 89, të këtij ligji, e rrëzon kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, pa seancë dëgjimore, nëse nuk janë paraqitur shkaqe për kërkesën, nëse ka arsye për mbylljen e hetimit ose nëse në momentin e fillimit të hetimit afati i parashkrimit kishte kaluar.

2. Në raste të tjera, organi kompetent, sipas pikës 2, të nenit 89, të këtij ligji, cakton seancën dëgjimore jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së kërkesës për caktimin e masës disiplinore.

3. Nëpunësi civil ka të drejtë të dëgjohet, të paraqesë deklarata dhe prova të tjera, si dhe të përfaqësohet.

4. Organi kompetent, sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, paraqet përfundimet e hetimit gjatë seancës disiplinore.

5. Organi kompetent, sipas pikës 2, të nenit 89, të këtij ligji, shqyrton dhe vendos për propozimin.

Neni 95
Kriteret për caktimin e masave disiplinore

1. Në rast se provohet shkelja disiplinore, organi kompetent, sipas pikës 2, të nenit 89, të këtij ligji, cakton një masë disiplinore, sipas parashikimeve të ligjit "Për nëpunësin civil", duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe parimin e proporcionalitetit.

2. Në caktimin e masës, merren parasysh rrethanat rënduese në vijim kur:

a) shkelja kryhet më shumë se një herë;

b) shkelja ka zgjatur në kohë;

c) shkelja kryhet për shkak të motiveve diskriminuese;

ç) shkelja kryhet për motive të tjera të dobëta, të paraqitura para organit kompetent, të cilat duhen ndëshkuar;

d) nëpunësi civil nxit të tjerët të kryejnë shkelje ose veprime të paligjshme;

dh) shkelja kryhet duke shfrytëzuar dobësitë e të tjerëve; dhe

e) ekziston çdo rrethanë tjetër për të cilën organi kompetent çmon se rëndon shkeljen e kryer.

3. Në caktimin e masës duhet të merren parasysh rrethanat lehtësuese në vijim:

a) nëpunësi civil e kryen shkeljen për herë të parë;

b) nëpunësi civil ka vepruar nën ndikimin e një pale të tretë, për shkak të besimit ose frikës;

c) shkelja e nëpunësit civil ka pasur ndikim të pakët, duke marrë parasysh në tërësi rrethanat e çështjes;

ç) nëpunësi civil bashkëpunon në hetimin dhe procedimin disiplinor, duke përfshirë dhe rastet kur pranon shkeljen e kryer ose jep informacione që ndihmojnë në hetimin dhe procedimin disiplinor;

d) nëpunësi civil ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga shkelja ose ka ndihmuar për të zhdukur ose pakësuar pasojat e saj;

dh) shkelja ka ndodhur shumë kohë më parë;

e) ekziston çdo rrethanë tjetër që organi kompetent e çmon se lehtëson shkeljen e kryer.

Neni 96
Pezullimi i hetimeve dhe procedurës disiplinore

1. Organi kompetent, sipas këtij ligji, duhet të pezullojë hetimin ose procedurën disiplinore nëse janë duke u kryer procedura penale, administrative ose civile:

a) në të cilat, njëra nga palët është nëpunësi civil që i atribuohet shkelja;

dhe

b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte.

2. Hetimi ose procedura disiplinore pezullohet deri në dhënien e vendimit gjyqësor përfundimtar.

3. Kërkuesi, nëpunësi civil në fjalë, gjykatat dhe prokuroritë duhet të njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykatat dhe prokuroritë e interesuara duhet të dorëzojnë pa vonesë çdo vendim që është marrë për procedurat përkatëse.

4. Vendimi përfundimtar për pafajësinë ose rrëzimin e kërkimeve ndaj nëpunësit civil, në kuadër të një procesi penal, administrativ ose civil nuk përjashton hetimin ose caktimin e përgjegjësisë disiplinore të nëpunësit civil.

5. Organi kompetent u referohet vetëm fakteve, mbi të cilat bazohet vendimi përfundimtar dhe jo dënimit ose pafajësisë së dhënë në vendim.

6. Pezullimi i hetimeve ose procedurës disiplinore ndërpret afatet e parashkrimit, të parashikuara në nenin 90, dhe afatet për organin kompetent, të parashikuara në nenin 91 të këtij ligji.

7. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

Neni 97
Pezullimi nga detyra gjatë hetimit ose procedimit disiplinor

1. Nëse ekzistojnë shkaqe për të vlerësuar se ushtrimi i detyrave nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar hetimi ose procedura disiplinore, mund të dëmtojë procedurën disiplinore ose mund të dëmtojë rëndë ushtrimin e duhur të detyrave nga ky nëpunës, organi kompetent, sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, i paraqet organit kompetent kërkesën për pezullim.

2. Organi kompetent, sipas pikës 2, të nenit 89, të këtij ligji, e pezullon kryesisht nëpunësin civil ose me kërkesë, sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, ose merr çdo masë tjetër të përshtatshme dhe proporcionale.

3. Pezullimi mund të vendoset për një periudhë deri në 90 ditë, vetëm në rastet e shkeljeve të rënda dhe kur vazhdimi i ushtrimit të detyrës mund të paragjykojë hetimin e çështjes, shërbimin ose imazhin apo dinjitetin e funksionit.

4. Pezullimi ekzekutohet në mënyrë që të sigurojë garantimin e dinjitetit personal dhe profesional të nëpunësit civil.

Neni 98
E drejta për ankim

Nëpunësi civil përkatës, si dhe organi kompetent, sipas pikës 1, të nenit 89, të këtij ligji, ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit për çështje disiplinore.

Neni 99
Regjistrimet disiplinore

1. Vendimet përfundimtare për masat disiplinore mbahen në dosjen personale të nëpunësit civil dhe regjistrohen në Regjistrin Qendror të Personelit.

2. Vendimi përfundimtar për masën disiplinore dhe regjistri hiqet nga dosja personale dhe fshihet nga regjistri, kryesisht ose me kërkesë të nëpunësit civil nga drejtuesi i prokurorisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas afateve të përcaktuara në ligjin "Për nëpunësin civil".

SEKSIONI VII
NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL

Neni 100
Ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil të prokurorisë
(ndryshohet pika 3 me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 17)

1. Ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin për nëpunësit civil, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Me përjashtim të rasteve të tjera të parashikuara në ligjin "Për nëpunësin civil", marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet lirimit, në rastin e emërimit në funksionin e ministrit, zëvendësministrit, zyrtarit të emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave apo funksionarë të kabinetit.

3. Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për kancelarin dhe këshilltarin ligjor është Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe për nëpunësit e tjerë civilë është drejtuesi i prokurorisë ku ai ushtron detyrën.

Neni 101
Regjistrimi në Regjistrin Qendror të Personelit

Drejtuesi i prokurorisë, brenda tri ditëve nga marrja e njoftimit të dorëheqjes ose nga marrja e njoftimit për shkakun ligjor të ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil, njofton Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili regjistron vendimin në Regjistrin Qendror të Personelit.

Neni 102
Rregulla të hollësishme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil

Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregulla të hollësishme për procedurën për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil të prokurorisë.

KREU VIII
MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA

Neni 103
Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave

1. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit.

2. Rekomandimet miratohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Rekomandimet duhet të përmbajnë edhe informacion mbi ndryshimet e buxhetit që janë të nevojshme për realizimin e tyre.

3. Ministri i Drejtësisë ua bën të njohura rekomandimet e Këshillit të Ministrave drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se një muaj nga data e miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave.

4. Në marrëdhëniet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me Këshillin e Ministrave ndalohen rekomandimet për të proceduar ose jo për çështje konkrete.

5. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij.

Neni 104
Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, raportojnë në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vend, të paktën një herë në vit. Raportimi përfshin të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë.

2. Prokurori i Përgjithshëm informon mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën ndaj kriminalitetit, si vijon:

a) nëse Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë udhëzime të përgjithshme, bazuar në rekomandimet periodike të dhëna nga Këshilli i Ministrave;

b) nëse udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm, sipas shkronjës "a", të këtij neni, janë zbatuar dhe si kanë ndikuar ato

mbi gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara;

c) nëse është monitoruar prej Prokurorit të Përgjithshëm respektimi i këtyre udhëzimeve nga ana e prokurorëve.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme parashtrojnë gjithashtu përpara Kuvendit të dhëna të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe me elemente të tjera thelbësore në veprimtarinë e institucioneve përkatëse. Nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara me vendim të Kuvendit.

4. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme bashkëpunojnë me komisionet hetimore parlamentare, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në çdo rast, hetimi penal është i pavarur nga hetimet e komisioneve parlamentare.

Neni 105
Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë

1. Marrëdhëniet e prokurorisë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë përcaktohen në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

2. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme raportojnë, të paktën një herë në vit, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së strukturave përkatëse.

Neni 106
Marrëdhëniet me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për çështje në juridiksionin e tij dhe të informojnë lidhur me shkeljet disiplinore dhe problematikat që hasin në ushtrimin e veprimtarive të tyre.

2. Rregulla të veçanta mbi mënyrën e funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përcaktohen në ligjet e posaçme në fuqi.

Neni 107
Marrëdhëniet me Ministrin e Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë bashkëpunon me Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme dhe Kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në shqyrtimin paraprak të nevojave të buxhetit të tyre dhe i

paraqet dhe i mbron ato në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

2. Ministri i Drejtësisë ka detyrimin të depozitojë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesat që paraqiten kundër prokurorëve.

Neni 108
Marrëdhëniet me Policinë Gjyqësore

1. Prokurorët drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë hetimore të Policisë Gjyqësore, në përputhje me ligjin procedural penal dhe parashikimet e bëra në ligjin organik për Policinë Gjyqësore.

2. Urdhrat dhe udhëzimet e karakterit të përgjithshëm dhe të posaçëm që lidhen me procedimin penal janë të detyrueshme për Policinë Gjyqësore.

Neni 108/a
(shtuar me ligjin nr. 42, datë 23.03.2021, neni 18)

1. Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë të drejtë të kenë akses të drejtpërdrejtë, si subjekte të interesuara, në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e nevojshëm për hetimin e veprave penale që përfshihen në juridiksionin e tyre sipas nenit 148 të Kushtetutës.

2. Niveli i aksesimit për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, për çdo bazë të dhënash shtetërore, caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon bazat e të dhënave shtetërore, duke garantuar që në çdo rast ky nivel të jetë vetëm për përmbushjen e nevojës për informacion që kërkohet nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Prokurorët mund të aksesojnë një bazë të dhënash shtetërore vetëm në rastet kur informacioni që ruhet në atë bazë të dhënash shtetërore është i nevojshëm për të hetuar një vepër penale.

3. Aksesi në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, sipas këtij neni, u nënshtrohet rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi. Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si dhe institucionet shtetërore që administrojnë bazat e të dhënave shtetërore marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme ose aksidentale, si dhe nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Parashikimet e bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për

sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave që ruajnë dhe/ose përpunojnë informacion të klasifikuar "sekret shtetëror". Aksesi i prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror."

KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 109
Dispozitë kalimtare për kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë

1. Prokurori i Përgjithshëm në detyrë qëndron në detyrë deri në fund të mandatit, nëse nuk ka arsye për të përfunduar mandatin e tij, sipas kreut VIII, të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, sipas ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Në rast se mandati i Prokurorit të Përgjithshëm përfundon përpara kohe, përpara krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm, me vendim të Kuvendit, caktohet t'i kryejë përkohësisht një nga prokurorët me më shumë eksperiencë nga radhët e prokurorëve dhe që përmbush kushtet dhe kriteret e kreut IV, seksioni I, të këtij ligji.

3. Kompetencat kalimtare të Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë parashikohen në dispozitat kalimtare të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 110
Dispozita kalimtare për prokurorët dhe ndihmësit ligjorë në detyrë

Prokurorët dhe ndihmësit ligjorë në detyrë u nënshtrohen dispozitave të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 111
Dispozita kalimtare për Sekretarin e Përgjithshëm dhe kancelarin

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, brenda katër muajve nga krijimi i tij, kryen

verifikimin e figurës dhe të pasurisë, si dhe plotësimin e kushteve dhe procedurave të parashikuara nga ligji për shërbimin civil për sekretarin e përgjithshëm dhe kancelarët në detyrë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë paraqet kërkesë për informacion për verifikimin e të dhënave të gjendjes gjyqësore dhe çdo shkaku tjetër përjashtues, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokurorisë, organeve publike financiare, Byrosë Kombëtare të Hetimit, shërbimeve shtetërore informative, si dhe çdo organi disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e mëparshme të punës të kancelarit. Nëse vlerësohet e nevojshme, Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të kërkojë informacione shtesë nga institucione të tjera.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton një raport me rezultatet e deklaratave të pasurisë, si dhe vlerësimit të figurës. Sekretari i Përgjithshëm dhe kancelarët në detyrë kanë të drejtë të dëgjohen, të paraqesin deklarata dhe prova të tjera, si dhe të përfaqësohen.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendos ndërprerjen e kontratës ose konfirmon marrëdhënien civile, bazuar në informacionin e marrë, dhe njofton personin në detyrë për vendimin e arsyetuar.

5. Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i ankimueshëm, brenda dy javëve nga njoftimi, sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 112
Dispozita kalimtare për personat në detyrë në Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme

1. Personat në detyrë në Drejtorinë e Inspektimit dhe të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohen të komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme deri në momentin e krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda 4 muajve nga krijimi i tij, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendos në përputhje me këtë ligj, në lidhje me pozicionin e tyre.

2. Me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, personat në detyrë, të cilët janë caktuar për të kryer hetimet e shkeljeve disiplinore, me kërkesë të tyre, komandohen pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 113
Dispozitë e posaçme për të punësuarit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda

1. Nëpunësit civilë dhe punonjësit në detyrë në Prokurorinë e Shkallës së Parë dhe Prokurorinë e Apelit të Krimeve të Rënda konsiderohen nëpunës civilë dhe punonjës të Prokurorisë së Posaçme, nëse plotësojnë kushtet e sigurisë, të caktuara me ligj të veçantë, përfshirë deklaratën e heqjes dorë nga e drejta e privatësisë në telekomunikacion dhe në llogari bankare, e nënshkruar nga kandidati dhe anëtarët e afërm të familjes së tij.

2. Në rastet kur i punësuari ose nëpunësi civil në detyrë nuk përmbush kërkesat e pikës 1, të këtij neni, punonjësi në detyrë mund të transferohet si nëpunës civil në një pozicion të lirë në tjetër prokurori, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ose në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 114
Regjistri Qendror i Personelit

Sekretari i përgjithshëm dhe kancelari i çdo prokurorie reflekton në Regjistrin Qendror të Personelit të dhënat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 83, të këtij ligji, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 115
Aktet nënligjore

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, Këshilli i Lartë i Prokurorisë harton dhe miraton akte nënligjore në përputhje me këtë ligj.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton aktet e nevojshme nënligjore për ndihmësit ligjorë të paktën brenda tre muajve nga konstituimi i tij.

3. Çdo akt nënligjor, i miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohet për sa nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 116
Shfuqizime

1. Dispozitat në fuqi për pagat, shpërblimet dhe trajtimin financiar të prokurorëve dhe administratës së prokurorive shfuqizohen pasi të jetë vënë në zbatim sistemi i ri i pagave dhe përfitimeve, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dispozitat e ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 117
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miratuar në datën 6.10.2016

EUIVJUSTICE

Rruga “Abdi Toptani”
Godina Torre Drin, Kati i 10-të, Tiranë
E-mail: info@eu4justice.al
Web: www.eu4justice.al